

ENVER HOXHA

VEPRA

6

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

6

JANAR-DHJETOR 1949

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1971

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 6

Në vëllimin 6 të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen raporte, fjalime, diskutime, letra e artikuj të periudhës janar—dhjetor 1949.

Në veprat e këtij vëllimi gjejnë pasqyrim përpjekjet për zbatimin e vendimeve historike të Kongresit I të Partisë, për realizimin e kthesës, që vilosi ai në jetën e Partisë e të vendit.

Karakteristikë e periudhës në të cilën janë shkruar këto vepra ka qenë gjendja tepër e ndërlikuar për vendin tonë, e krijuar si rrjedhim i rrethimit gjeografik të RPSH pas tradhëtisë së udhëheqjes së PK dhe të shtetit fqinj jugosllav, e intensifikimit të veprimtarisë armiqësore të bashkërenduar të imperialistëve amerikanë dhe anglezë, të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë dhe neofashistëve italianë.

Kjo veprimtari armiqësore i krijoi Partisë dhe popullit shqiptar vështirësi të mëdha në rrugën e ndërtimit socialist të vendit, e nxiti shumë luftën e klasave të mundura shfrytëzuese, të cilave ju ngjallën shpresat në shembjen e pushtetit të demokracisë popullore dhe në rivendosjen e rendit çifligaro-borgjez me ndërhyrjen dhe ndihmën e drejtëpërdrejtë të imperialistëve e të shërbëtorëve të tyre.

Materialet e këtij vëllimi flasin për qëndresën he-

roike të Partisë e të popullit shqiptar përballë veprimtarisë armiqësore imperialiste e revizioniste, për luftën e tyre të guximshme në kapërcimin e vështirësive, për asgjësimin e planeve dhe kompleteve të armiqve të jashtëm e të brendshëm, flasin për qëndrimet revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë si ndaj problemeve të brendshme, ashtu edhe problemeve ndërkombëtare.

Në këto vepra del në pah lufta për forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletariatit, për rritjen e vigjilencës revolucionare dhe për fuqizimin e gjithanshëm të mbrojtjes së atdheut nën parullën e Partisë: «Të ndërtojme socializmin duke mbajtur në një rën dorë kazmën në dorën tjetër pushkën», për shpartallimin e armiqve të klasës mbi bazën e ruajtjes e të forcimit të aleancës midis klasës punëtore e fshatarësisë punonjëse.

Në materialet pasqyrohen përpjekjet e Partisë për zhvillimin me plan të ekonomisë popullore, për hedhjen e bazave të industrializimit socialist, për vënjen e bujqësisë në rrugën e daljes nga prapambetja dhe të hedhjes së themeleve që do të siguronin transformimin socialist të saj, për zgjidhjen e problemit të furnizimit të masave popullore me mallra të përdorimit të gjerë dhe të grumbullimit të prodhimeve bujqësore, problem që në atë kohë paraqitej tepër i vështirë dhe që kishte rëndësi vendimtare për lidhjet ekonomike midis qytetit e fshatit, rrjedhimisht, për aleancën midis klasës punëtore e fshatarësisë punonjëse.

Në veprat e këtij vëllimi tregohet kujdesi i madh i Partisë për kapërcimin e prapambetjes së trashëguar nga e kaluara, për forcimin e brendisë revolucionare të

shkollës, të letërsisë dhe të kulturës në përgjithësi, për shtrirjen e arësimit e të kulturës socialiste në çdo kënd të atdheut, për shndërrimin e tyre në pasuri të masave të gjera popullore, për krijimin e inteligjencies së re socialiste.

Në plotësimin e këtyre detyrave të mëdha theksi vihet në mobilizimin dhe përdorimin e të gjitha forcave dhe burimeve të brendshme njerëzore e materiale. Njëkohësisht çmohet lart ndihma e madhe internacionaliste e forcave revolucionare botërore, e vendeve socialiste, në radhë të parë e Partisë Bolshevike, e qeverisë dhe e popullit sovjetik të udhëhequr nga J.V. Stalini, i cili i këshillonte Partinë dhe popullin tonë të luftonin me të gjitha forcat për të ndërtuar në vend një bazë të atillë materiale, teknike e kulturele, që RPSH të ishte në gjendje të ecte me këmbët e veta.

Në këtë vëllim gjen shprehje edhe lufta klasore që ka zhvilluar Partia në gjirin e saj, kryesisht kundër oportunitizmit të djathtë, kundër disfatizmit dhe mosbesimit ndaj forcës dhe aftësive krijuese të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse, shfaqje këto të gjunjëzimit përpara presionit të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Duke zhvilluar një luftë të tillë, tregohet domosdoshmëria e saj për ruajtjen e forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë, për kapërcimin e vështirësive të jashtzakonshme dhe për sigurimin e zbatimit të detyrave të mëdha të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut.

Në veprat e këtij vëllimi vërehet një përpunim i mëtejshëm i vijës së Partisë në etapën e ndërtimit të bazave të socializmit në Shqipëri.

FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E MBYLLJES SË KURSIT TË SHTATË PËR OFICERË

7 janar 1949

Shokë oficerë,

Mbyllja me sukses e kursit tuaj është kënaqësi dhe gëzim i madh për Partinë tonë të Punës, për Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë sonë, për të gjithë ne. Për këtë sukses ju uroj me gjithë zemër në emër të PPSH dhe në emrin tim.

Ju e dini sa e dashur është për ne ushtria dhe me sa përpjekje e sakrifica e ngritëm këtë ushtri, nëpërmjet luftërash të përgjakshme, duke pasur për ideal lirinë e plotë të popullit tonë dhe çlirimin politik dhe ekonomik të tij. Partia e krijoi ushtrinë tonë me sakrifica dhe heroizma të mëdha dhe prandaj kujdesi i saj është i madh për ushtrinë. Ajo kujdeset që kjo të bëhet e fuqishme, të modernizohet dhe të bëhet e aftë për të mbrojtur të gjitha fitoret e popullit tonë.

Ne e duam ushtrinë tonë ta kemi të fortë, të modernizuar. Ne nuk kemi për qëllim luftën, ne jemi kundër luftës, por ka të tjerë që janë kundër paqes dhe duan të hedhin botën në një kasaphanë të re. Prandaj

për ta penguar luftën, ne duhet të kemi një ushtri të fortë e moderne; këtë e lyp interesi i paqes, interesi i atdheut. Sa më e fortë të jetë ushtria jonë, aq më e siguruar është pavarësia dhe sovraniteti i vendit tonë. Prandaj oficerët tanë që u mbuluan me lavdinë e Luftës nacional-çlirimtare, e kanë në zemër këtë qëllim të lartë. Është për këtë qëllim që Partia jonë i vë kujdes të veçantë ngritjes dhe edukimit të kuadrove tanë të ushtrisë, të cilët kanë përshkuar një provë të madhe, kanë fituar një eksperiencë të pakufishme në Luftën nacional-çlirimtare.

Ushtria jonë duhet të pajiset me eksperiencën ushtarake më moderne, që munda ushtrinë fashiste, dua të them të përvetësojë artin e lavdishëm ushtarak stalinian. Për këtë ushtria jonë i ka të gjitha mundësitë, sepse për vendin tonë, për popullin tonë, për ushtrinë tonë, interesohet, përkujdeset dhe na ndihmon i madhi Stalin.

Ne do të ndjekim me besnikëri rrugën e lavdishme të Ushtrisë Sovjetike si nga pikëpamja e artit ushtarak, ashtu dhe për edukimin e saj politik. Ushtria jonë të jetë e frymëzuar nga internacionalizmi proletar kundër pikëpamjeve të nacionalizmit borgjez, me të cilat edukohen ushtritë borgjeze, imperialiste, skllavëruese, që kanë për qëllim të shtypin popujt.

Ne do të ndjekim shembullin e Ushtrisë Sovjetike për të mbrojtur paqen, për të kundërshtuar luftërat agresive. Shoku Stalin na ka dërguar oficerë të shquar, të pajisur me artin e lartë ushtarak dhe që kanë luftuar me heroizëm kundër agresorëve fashistë. Ata kanë ardhur që të na ndihmojnë për të forcuar ushtrinë tonë, me qëllim që kjo të mbrojë më mirë ndërtimin e socia-

lizmit. Ushtria jonë duhet të përfitojë nga këshillat e vlefshme të shokëve sovjetikë që ajo të bëhet sa më e fortë për mbrojtjen e paqes. Oficerët dhe ushtarët tanë e kanë kuptuar këtë gjë, prandaj kujdesen që të përvehtësohet eksperiencia e madhe e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike. Ushtria jonë po vë të gjitha forcat për të përfitur nga kjo eksperiencë.

Ngritja e ndërgjegjes, e moralit, e disiplinës dhe e dashurisë së madhe të ushtrisë për popullin janë rezultate të mëdha që ua dedikojmë oficerëve tanë, besnikërisë së tyre ndaj popullit, ndaj Partisë.

Armiqtë e popullit, të Partisë dhe të ushtrisë sonë, janë përpjekur të na shkëputin nga kjo rrugë. Këta kanë qenë grupi nacionalist-trockist jugosllav me Titon në krye dhe bashkëpunëtorët e tyre në Partinë tonë, tradhëtarët Koçi Xoxe e Pandi Kristo.

Ata nuk mundën të kishin rezultatet që dëshironin. Ata dështuan. As Partinë e as ushtrinë tonë nuk mundën ta shtinin në dorë për të skllavëruar vendin tonë, për të degjeneruar Republikën Popullore dhe Partinë tonë ta bënë një parti në shërbim të borgjezisë. Nuk mundën se ishit ju, ishte gjithë Partia më këmbë për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të ecur në rrugën, që na ndriçonte Partia Bolshevike dhe shoku Stalin.

Ne triumfuam mbi armiqtë tanë dhe kurdoherë do të triumfojmë se ne mbrojmë çështjen e popullit, interesat e popullit, ashtu si na mëson Partia e lavdishme e Punës. Me vijën e drejtë të Partisë ne do të kapërcejmë çdo pengesë, që do të na dalë në rrugën tonë. Partia jonë do ta ngrejë, do ta forcojë ekonominë e popullit tonë; Partia jonë do ta forcojë e do ta çelënikosë ushtrinë

tonë, do t'i pajisë oficerët tanë me shkencën e diturinë dhe vendi ynë do të shkojë përpara me siguri. Partia jonë është një Parti e tipit leninist-stalinian dhe s'ka kala që ajo nuk merr.

Por duhet të kemi kurdoherë sytë hapur, sepse armiku nuk fle kurrë. Imperialistët amerikano-anglezë po përgatiten për të hedhur botën në luftë, prandaj ne duhet të jemi gati në çdo moment për të mbrojtur vendin dhe fitoret e popullit tonë. Përpyekjet e imperialistëve anglo-amerikanë do të dështojnë se në krye të kampit të pathyeshëm demokratik qëndron Bashkimi Sovjetik dhe politika e lavdishme staliniane i demaskon dita-ditës përpjekjet e imperialistëve duke vënë mirë në dukje qëllimet e tyre të poshtra dhe i frymëzon popujt e demokracive popullore dhe gjithë popujt përparimtarë të botës.

Populli ynë kurdoherë ka luftuar e ka derdhur gjak, por asnjëherë nuk ka fituar. Po këtë herë nuk ja rrëmbyen dot lirinë, sepse kishte në krye Partinë Komuniste të Shqipërisë, kishte përkrah Bashkimin Sovjetik. Nën udhëheqjen e Partisë sonë dhe në saje të ndihmës së BS ne fituam lirinë, forcojmë demokracinë, ngremë ekonominë dhe po ndërtojmë socializmin. Partia na mëson se kështu mbrohen interesat e paqes e të demokracisë, interesat e kampit demokratik në këtë kënd të Ballkanit.

Ju ftoj ta ngremë dollinë për Partinë tonë të Punës, për ushtrinë tonë të dashur, për oficerët tanë trima, që luftuan dhe tani punojnë me të gjitha forcat për ta bërë ushtrinë tonë një armë të fortë për të mbrojtur interesat e popullit tonë; për shëndetin e oficerëve,

që mbaruan kursin me sukses dhe për gjithë oficerët. Ta ngremë gjithashtu dollinë për mikun e madh dhe mësuesin e lavdishëm, shokun Stalin, për Bashkimin e fuqishëm Sovjetik, për Ushtrinë e lavdishme Sovjetike!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 7 (80), 8 janar 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 7 (80), 8 janar 1949

**FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN AKADEMIKE
ME RASTIN E 25-VJETORIT TË VDEKJES SË
V. I. LENINIT**

20 janar 1949

Shokë dhe shoqe,

Një çerek shekulli më parë, më 21 janar 1924, vdiq i madhi Lenin, gjeniu i njerëzimit dhe i Revolucionit, organizatori i Partisë së lavdishme Bolshevike dhe themeluesi i shtetit të parë sovjetik.

Idetë e pavdekshme të Leninit bënë me vete miliona dhe miliona njerëz përparimtarë të botës, të cilët u armatosën më së miri për të luftuar me sukses skllavërinë e kapitalit dhe për të këputur zinxhirët e imperia- lizmit dhe të diktaturës së egër të saj, fashizmit.

Një nga korifejtë e shkencës, njeriu më i madh i kohërave tona, siç e ka cilësuar Leninin, dishepulli dhe bashkëpunëtori i lavdishëm i tij, Josif Stalini, frymëzoi dhe udhëhoqi bolshevikët dhe gjithë popujt e Bashkimit Sovjetik në fitoren e madhe të socializmit. Lenini frymëzoi popujt e mbarë botës progresiste për t'u hedhur në luftë për të drejtat e tyre të grabitura nga imperia-

listët, ai u tregoi rrugën dhe mjetet e fitores, ai u forcoi besimin në forcat krijuese të popullit.

Lenini, revolucionari më i madh i kohërave, ka njëzet e pesë vjet që ka vdekur, por idetë e tija janë të pavdekshme dhe kurdoherë triumfuese. Partia Bolshevike dhe shteti i lavdishëm sovjetik, vepra të pavdekshme të tij, do të rrojnë ngadhnjimtare në shekuj. Ata po i prijnë njerëzimit përpërimtar për vendosjen e paqes së drejtë dhe të qëndrueshme, ata janë për popujt e etshëm për liri shembulli i gjallë i ndërtimit socialist, shembulli i luftës ngadhnjimtare dhe njëkohësisht ndihmësit e fuqishëm dhe besnikë të tyre në ngritjen, ndërtimin dhe fuqizimin e socializmit.

Flamurin e madh të Leninit e mban lart ngadhnjimtari Josif Stalini. Populli ynë dhe Partia e Punës i kanë në zemër Leninin dhe Stalinin, pse në saje të tyre populli ynë gjeti rrugën e shpëtimit dhe, duke u qëndruar besnikë atyre për jetë, ai po ndërton jetën e tij të lumtur dhe ecën me vendosmëri në rrugën e socializmit. Ne, komunistët, anëtarë të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar do ta kujtojmë, do ta duam, do ta studjojmë Iliçin, mësuesin tonë, ashtu si na këshillon shoku Stalin. Ne do të luftojmë dhe do të triumfojmë mbi armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, ashtu si bënte Iliçi dhe ashtu si na këshillon shoku Stalin. Ne do të ndërtojmë një jetë të re, ne do të ndërtojmë marrëdhënje të reja ekonomike e shoqërore, ashtu si na mëson Iliçi, ashtu si na këshillon shoku Stalin.

Ne do ta duam dhe do ta mbrojmë me të gjitha forcat tona Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe shokun e shtrenjtë Stalin. Ne do

ta mbajmë kurdoherë lart flamurin ngadhjimtari të internacionalizmit proletar të Marksit-Engelsit-Leninit e Stalinit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 18 (91), 21 janar 1949.

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 18 (91), 21 janar 1949

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E PARË TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

15 shkurt 1949

Të dashur shokë e shoqe,
kooperativistë, kooperativiste dhe fshatarë,

Ju sjell përshëndetjet më të përzemërta të Partisë së Punës dhe të Komitetit Qendror të saj, i cili më ka ngarkuar t'ju flas e t'ju jap disa këshilla, që do t'ju shërbejnë në veprën e madhe, që kryeni nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës së saj.

Kongresi juaj, që po mbahet sot, do të mbetet një datë me shumë rëndësi në historinë e Shqipërisë së re dhe vendimet e këtij kongresi do të ndihmojnë fshatarësinë në hedhjen e bazave dhe ndërtimin e socializmit në fshat.

Popullit shqiptar ju desh një luftë e përgjakshme kundër okupatorit dhe armiqve të popullit tonë, për të arritur sot të mblidhen fshatarët në një kongres të tyre, për të vendosur lirisht dhe me vullnetin e tyre forma të përparuara dhe socialiste në bujqësinë e vendit tonë. Partia që udhëhoqi me sukses luftën çlirimtare, me reformën agrare krijoi konditat e zhvillimit të koopera-

tivizmit në vendin tonë si e vetmja rrugë për ndërtimin e socializmit në fshat.

Për ndërtimin e socializmit në fshat duhet të ecim me hapa të matur, pse këtu nuk kemi të bëjmë me një kapitalist fabrike të qytetit, të cilit ja kemi shtetëzuar fabrikën dhe gjithë mjetet e tjera të prodhimit, por kemi të bëjmë me qindra mijë fshatarë, të varfër dhe të mesëm, që kanë një ekonomi të vogël bujqësore, që janë me pushtetin popullor, pse ky është i tyre, që janë për shkuarjen në socializëm, pse ky përfaqëson jetën më të lumtur për ta, por që në ta ekziston ndjenja e pronës private, ekziston akoma mentaliteti se me punën individuale dhe me mjetet, megjithëse të prapambetura për punimin e tokës, ata mund të përmirësojnë jetesën, ekziston ndër ta pikëpamja mikroborgjeze që ta shohin qytetin me një sy të dyshimtë dhe si një vend, ku të venë vetëm për të bërë tregëtinë e vogël dhe për të pasur disa përfitime më tepër, në mënyrë jo të drejtë. Kemi të bëjmë me fshatarë akoma të pazhvilluar, që nuk kanë kuptuar se ata s'duhet të qëndrojnë skllëvër të një copë toke dhe të një parmende të drunjtë me të cilën kanë punuar gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre; kemi të bëjmë me fshatarë, që nuk kanë kuptuar se bashkimi i forcave të tyre, i mjeteve të punës me ato të fqinjit, punimi i tokës bashkarisht, hapja e tokave të tjera të reja me mjete më të përparuar si plugje moderne dhe traktorë, do t'ua dyfishojnë dhe trifishojnë prodhimet dhe jeta e tyre do të përmirësohet jashtëzakonisht. Fshatari ynë akoma nuk ka kuptuar si duhet se bashkimi i forcave në fshat ndër kooperativa fshatare të punës, do të bëjë që me atë sasi

pune, që ai harxhën, kur punon si njeri i vetmuar, do të prodhojë shumë e më shumë, kur të jetë i bashkuar me fqinjët, do të prodhojë më shumë grurë, do të rritë më shumë bagëti, do të stabilizohen çmimet dhe do të blejë më shumë se ç'mund të blente, kur ai qëndronte në një ekonomi bujqësore të vogël dhe të prapambetur.

Fshatari punonjës i varfër dhe i mesëm, duhet ta shohë qartë dhe të bindet me prova konkrete se rruga e tij më e mirë është rruga e kolektivizimit të bujqësisë dhe jo rruga e izolimit në një ekonomi bujqësore individuale të prapambetur. Fshatari i izoluar nuk do të mund të përfitojë aq sa duhet nga mjetet e mekanizuara, nga plehrat dhe nga metodat agroteknike, që do t'u vërë në dispozicion të tyre shteti; fshatari i vetmuar nuk do të mund të përfitojë si duhet nga kreditë e shumë gjëra të tjera, që do t'u japë pushteti popullor.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, ne themi se në ngritjen e kooperativave të punës në fshat duhet të ecim me hapa të matur. Partia jonë nuk mund të lejojë kurrë që të luhet me një çështje kaq të rëndësishme dhe jetike, siç është çështja e ngritjes së kooperativave, nuk mund të lejohet që nga gabimet e disave të komprometohet çështja e kolektivizimit, që është e ardhshmja jonë e ndritur në fshat, që është rruga e socializmit.

Duhet të kuptohet se krijimi i një kooperative është një çështje jashtëzakonisht serioze dhe s'i lejohet askujt ta marrë këtë problem lehtësisht, duke ngritur kooperative sa për të ngritur kooperative, pa e studjuar çështjen nga të gjitha anët, si në lidhje me tokën ku ngrihet kooperative, ashtu dhe me njerëzit, që do të marrin pjesë në të. Eksperienca e Bashkimit Sovjetik, mësimet

e pavdekshme të Leninit dhe të Stalinit në këtë fushë, duhet të na ndriçojnë punën tonë, pse vetëm kështu ne nuk do të gabojmë kurrë dhe do t'ja arrijmë me siguri suksesit të dëshiruar nga Partia jonë e Punës. Sukseset në lidhje me kooperativat e punës në fshat do të arrihen, kur të zbatohen parimet kryesore të mëposhtme:

Pjesëmarrja lirisht në kooperativat fshatare të punës dhe marrja në konsideracion si duhet e konditave të ndryshme të rretheve, ku krijohen kooperativat. Kooperativat fshatare të punës, thotë Stalini,

«...nuk mund të ngrihen me forcë. Kjo do të ishte marrëzi dhe punë reaksionare»¹.

Nga ana tjetër kooperativat, na mëson eksperiencia sovjetike, duhet të ngrihen më parë në vendet ku prodhohen drithëra më shumë dhe ku ka mundësi të punojë mekanika bujqësore; ky duhet të jetë orientimi dhe mbasandaj të kalojmë në vendet më pak prodhuese e malore. Në vendet malore, na mëson Stalini, të ruhemi nga ngritja e kooperativave fshatare të punës me dekrete dhe me forcë, pse nga një veprimtari e tillë, përfiton vetëm armiku, e forcojmë këtë dhe diskreditojmë lëvizjen kooperativiste fshatare të punës.

Lenini dhe Stalini na mësojnë se kolektivizimi në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet me forcë, por me dashje dhe me bindje.

«Leninizmi na mëson se fshatarët mund të binden për epërsinë e ekonomisë kolektive — thotë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 189.

Stalini — *vetëm në rast se atyre do t'u tregohet dhe do t'u provohet me fakte, me anë të eksperiencës, se kolkozi është më i mirë se ekonomia individuale, se ai ka më shumë leverdi se ekonomia individuale, se kolkozi i hap fshatarit, fshatarit të varfër dhe të mesëm, rrugën për të dalë nga skamja dhe mjerimi»¹.*

Duhet patjetër të jemi të palëkundshëm dhe të marrim masa kundër atyre që veprojnë ndryshe dhe të hiqen menjëherë nga vendet e punës ndër fusha dhe fshatra ku punojnë

«...se këto gabime na çojnë drejtpërsëdrejti në diskreditimin e lëvizjes kolkoziane, në prishjen me fshatarin e mesëm, në çorganizimin e fshatarësisë së varfër, në çorientimin e radhëve tonë, në dobësimin e gjithë ndërtimit tonë socialist, në rimëkëmbjen e kulakëve»² — thotë Stalini.

Në lidhje me kolektivizimin ne kemi pasur suksese. Ngritja e kooperativave fshatare të punës filloi në vitin 1956 dhe sot ne kemi afro 56 kooperativa dhe ekziston dëshirë e madhe ndër fshatarët e varfër e të mesëm të krijojnë edhe kooperativa të tjera. Fshatarët që janë bashkuar në kooperativa, e duan kooperativën, kanë

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 201.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 208.

kuptuar rëndësinë e saj dhe të mirat që vijnë nga ajo, por në këto kooperativa janë konstatuar të meta parimore, si futja e tendencave kapitaliste në to, ndarja e prodhimeve 40 për qind në bazë të tokës, si dhe pjesëmarrja në to e kulakëve, e agallarëve të fshatit, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhen futur në kooperativat fshatare të punës, pse ata janë armiq të betuar të kooperativave dhe të fshatarëve të varfër dhe të mesëm. Gjithashtu në kooperativat tona nuk janë studjuar si duhet formimi i bloqeve, puna përgatitore, organizimi i punës brenda, ka munguar demokracia, kanë munguar planet dhe normat në punë, ka munguar përgjegjësia personale në punë dhe ndarja e prodhimeve nuk është bërë në rregull, gjë që ka shkaktuar moskënaqësira ndër kooperativistët. Nga ana e pushtetit dhe e Ministrisë së Bujqësisë, nuk u është dhënë kooperativave fshatare të punës ndihma e duhur dhe nuk është treguar kujdes i veçantë.

Na vihet përpara si detyrë që t'i zhdukim sa më parë këto të meta dhe të forcojmë e të konsolidojmë fitoren, që kemi arritur në këtë fushë kaq të rëndësishme dhe ta përdorim atë në mënyrë metodike e si bazë për të shkuar edhe më përpara. Na vihet për detyrë të forcojmë kooperativat e ngritura, t'i spastrojmë ato nga kulakët, t'i korrigjojmë nga gabimet administrative dhe t'i ndihmojmë politikisht, organizativisht e me mjete pune dhe të krijojmë edhe kooperativa të reja.

Partia duhet të luajë rolin kryesor në këtë drejtim, të luajë rolin drejtues ashtu si na mëson shoku Stalin. Kur shoku Stalin flet për kooperativat ai i këshillon anëtarët e partisë kështu:

«Arti i udhëheqjes është një punë serioze. Nuk duhet mbetur prapa nga lëvizja, sepse të mbetesh prapa — do të thotë të shkëputesh nga masat. Por as nuk duhet vrapuar shumë përpara, sepse të vraposh përpara do të thotë t'i humbësh masat dhe të izolosh vetëveten. Ai që don të udhëheqë lëvizjen dhe të ruajë njëkohësisht lidhjet me masat milionshe, ai duhet të luftojë në dy fronte — edhe kundër atyre që mbeten prapa, edhe kundër atyre që vrapojnë shumë përpara»¹.

Këshillimet e urta të shokut Stalin janë udhërrëfyese për punën tonë, në ngritjen e kooperativave fshatare të punës. Për asnjë çast të mos t'i harrojmë ato.

Të mos harrojmë gjithashtu se në fshatin tonë ekziston një armik i vendosur dhe i egër i kooperativave fshatare të punës, i fshatarëve të varfër dhe të mesëm. Ky është kulaku. Këtë duhet ta luftojmë me ashpërsinë më të madhe dhe të mos ta lëmë kurrsesi të ngrejë krye, të forcohet, të ngjallet dhe të na dëmtojë. Lufta e klasave në fshat duhet të bëhet dita-ditës dhe kjo duhet të bëhet e organizuar. Nën udhëheqjen e Partisë dhe të klasës punëtore duhet të mobilizohen dhe të bëhen si një blok i vetëm, fshatarësia e varfër dhe aleati i tyre, fshatari i mesëm. Parulla e Partisë është që në këtë periudhë ne duhet të kufizojmë veprimtarinë e kulakut, në të gjitha fushat, pse ai kudo na lufton dhe do të vazhdojë të na luftojë derisa të likuidohet krejtë-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 195.

sisht. Shumë vënë pyetjen: Cili është kulaku? Si mund ta bëjmë konkretisht dallimin e tij? Të kemi parasysh përcaktimin e të madhit Lenin, i cili në projektin e parë të tezave mbi çështjen agrare për në Kongresin e dytë të Internacionales Komuniste thotë:

«Fshatarësia e madhe përbëhet nga sipërmarrësit kapitalistë në bujqësi, të cilët e drejtojnë ekonominë e tyre sipas rregullit të përgjithshëm, duke pajtuar disa punëtorë me mëditje; ata i lidh me «fshatarësinë» vetëm nivelin e tyre të ulët kulturor, mënyra të jetesës, puna fizike personale në ekonominë e vet. Nga shtresat borgjeze kjo është shtresa më e madhe në numër dhe përfaqësuesit e kësaj shtrese janë armiq të drejtëpërdrejtë dhe të vendosur të proletariatit revolucionar. Në gjithë punën e partive komuniste në fshat vëmendja kryesore duhet të përqëndrohet mbi luftën kundër kësaj shtrese, mbi çlirimin e shumicës punonjëse dhe të shfrytëzuar të popullsisë së fshatit nga ndikimi ideologjik dhe politik i këtyre shfrytëzuesve...»

Megjithatë, edhe shpronësimi i fshatarëve të mëdhenj në asnjë mënyrë nuk mund të jetë detyra imediate e proletariatit ngadhënyes...»¹.

Duke u mbështetur në përcaktimin e Leninit ne mund të nxjerrim në vija të përgjithshme karakteristikat e kulakut në vendin tonë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 167-168.

Reforma agrare nuk i ka lënë kulakut përveçse një pjesë të tokës, që më të shumtat e herës, është bars me atë të fshatarit të mesëm. Por nuk mund kurrsesi ta dallojmë kulakun vetëm nga toka që zotëron ai sot; atë duhet ta shohim edhe nga ana e mjeteve të prodhimit, si kafshët e punës, veglat, shtëpia ku ai banon, stallat, hauret, plevicat, lëmënjt etj. Por karakteristika kryesore qëndron kurdoherë ajo që thotë Lenini, shfrytëzimi i punëtorëve mëditës ose hyzmeqarë, që përdor kulaku qoftë edhe në një periudhë të shkurtër. Kjo është tradita e tij, e paçrrenjosur, megjithëse ligji i reformës agrare e dënon këtë. Tokat më pjellore e më të mira, që ai ka mundur të ruajë pas reformës agrare dhe mjetet e prodhimit, që atij i janë lënë, e shtyjnë atë të vazhdojë traditën e një kapitalisti rural, duke i dredhuar edhe ligjit. Kulaku është spekulator, ai zhvillon tregun e zi, ai përpiqet të mos shlyejë detyrimet ndaj shtetit, ai i lufton ligjet dhe urdhëresat, ai është aleat i tregëtarit të qytetit dhe i matrapazit. Kulaku identifikohet, gjithashtu, nga e kaluara e tij e afërme dhe e largme, nga pikëpamjet e tija në atë kohë, marrëdhënjet me beun dhe qehajallarët e tij, nga pasuria e tij e vjetër, nga mjetet e prodhimit, nga tregëtia e tij, që ka pasë bërë duke spekuluar dhe duke bërë tregun e zi. E kaluara rëndon mbi kulakun, kjo të mos neglizhohet në identifikimin e tij.

Gjithashtu të mos harrohet dhe influenca, që ka pasur ai në fshat dhe që e ka ushtruar shekuj me radhë, duke pasur në duart e tija edhe pushtetin politik dhe atë ekonomik. Duke e pasur këtë fuqi, kulaku ka pasë krijuar një situatë të privilegjuar për të, është hequr si

njeriu më i zgjuar, më i matur etj. dhe këto që tani ai i ka humbur, përpiqet t'i rifitojë me çdo kusht. Në çdo fshat fshatarët e varfër dhe të mesëm, që u njohin dhëmbë e dhëmballë pasanikëve të fshatit, janë fare mirë në gjendje të bëjnë diferencimin e saktë, kurse do të jetë e zorshme të përcaktosh kulakun me karakteristikat identike për për çdo rreth e çdo zonë dhe kjo do të bëhet pasi të kemi të gjitha të dhënat e këtij problemi me rëndësi.

Do të jetë një gjë pa as më të voglin efekt, në rast se ne kënaqemi vetëm duke folur për luftën e klasave në fshat dhe për kufizimin e kulakut në të gjithë veprimtarinë e tij, në rast se ne nuk e zhvillojmë këtë luftë me të gjithë ashpërsinë e saj dhe në të gjitha format dhe trajtat e saja. Kulaku duhet luftuar politikisht, ai duhet luftuar në lëmin ekonomik; asnjë favor ndaj tij dhe asnjë lëshim s'i duhet bërë. Ai duhet të zbatohet me përpikëri ligjet dhe kur nuk i zbaton këto, të merren masat më të ashpra për të.

Por në asnjë mënyrë nuk duhet përdorur violenca ndaj fshatarit të mesëm. Të bëhet patjetër dallimi në mes kulakut dhe fshatarit të mesëm. Kulaku është armiku dhe fshatari i mesëm është aleati. Gabime të tilla janë bërë, këto janë të padurueshme dhe të palejueshme. Stalini thotë:

«...baza e lëvizjes kolkoziane në momentin e tanishëm është aleanca e klasës punëtore dhe e fshatarësisë së varfër me fshatarin e mesëm kundër kapitalizmit në përgjithësi, kundër kulakëve në veçanti».

«... violenca, që është e domosdoshme dhe e

dobishme në luftën kundër armiqve tanë të klasës, është e palejueshme dhe tepër e dëmshme po të përdoret kundrejt fshatarit të mesëm. . .»¹.

Në rast se ne përdorim violencën me fshatarin e mesëm, kufizimi i kulakut devijon nga rruga e drejtë.

Janë të paligjshme dhe të papranueshme veprimet për futjen me përdhunë në kooperativa të fshatarëve të varfër ose të mesëm, që nuk dëshirojnë dhe nuk janë bindur akoma. Kooperativat e kanë për detyrë t'i bindin ata, që lëkundën, me punën e tyre, me përparimin e kooperativës, me ngritjen e standardit të jetës së kooperativistëve dhe me ndihmën, që ata duhet t'u japin këtyre fshatarëve të lëkundshëm dhe që s'janë bindur akoma si edhe gjithë fshatarëve fqinj, rreth e rrotull kooperativave të tyre. Ata fshatarë të varfër o të mesëm, që nuk kanë hyrë në kooperativë, nuk janë aspak armiq, sikundër janë cilësuar në disa kooperativa, por ata akoma s'janë bindur, po nesër ata do të binden, nesër ata do të bëhen luftëtarë të pamposhtur të kolektivizimit. Vetëm kulaku është armik. Nuk lejohen nga ana e kooperativave veprime sikundër kanë ngjarë në disa raste që, me kokën e tyre ose me dijeni të komitetit të rrethit, të formojnë bloqet e tokave të kooperativës dhe t'i hedhin jashtë fshatarët e varfër e të mesëm nga tokat e tyre dhe shumë herë duke mos u interesuar për tokën, që do t'u jepej në vend të parcelave të marrura etj. Këto gjëra s'janë në kompetencën e

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 199.

tyre. Këto masa, në rast nevoje, i merr vetëm Ministria e Bujqësisë dhe kjo duhet t'i studjojë imtësisht këto raste.

Shokë,

Partia dhe qeveria po i vë kujdesin më të madh problemit të bujqësisë në vendin tonë, po vë forcat më të mëdha që bujqësia të përparojë, të ngrihet niveli i jetesës së fshatarit si nga ana ekonomike, ashtu dhe shoqërore e kulturele. Për ndërtimin e vendit tonë, për forcimin e bazave të socializmit në Shqipërinë e re, ne ndihmohemi në mënyrë të përzemërt e bujare nga Bashkimi Sovjetik dhe nga shoku Stalin. Si për industrinë tonë, ashtu dhe për bujqësinë, qeveria sovjetike na ka dhënë dhe po na jep vazhdimisht ndihmë të çmueshme në traktorë, në farëra, në specialistë, që bujqësia të përparojë dhe fshatari ynë të ndërtojë një jetë më të begatshme. Shoku Stalin është interesuar veçanërisht për fshatarësinë tonë heroike, luftëtare e pamposhtur; ai më ka pyetur imtësisht për bujqësinë, për jetën dhe punën e fshatarësisë sonë, ai më ka këshilluar për mbjelljen e drithërave, ai më ka këshilluar për organizimin e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, që këto të punojnë mirë tokat e shtetit, të kooperativave dhe të fshatarëve të varfër dhe të mesëm. Ne i jemi mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit për këtë ndihmë që po na jep. Ne jemi në gjendje t'i zbatojmë si duhet këshillat e shokut Stalin dhe të përfitojmë sa më mirë nga ndihmat që na jep Bashkimi Sovjetik, që kështu të ecim përpara në rrugën e socializmit. Duhet

mobilizim i plotë i të gjithëve për kryerjen e planit, duhet të vazhdojmë të bëjmë sakrifica, pse pa punë dhe pa sakrifica, nuk ndërtohet socializmi. Duhet të luftojmë me ashpërsi tendencat e mungesës së disiplinës në punë dhe në radhë të parë në njerëzit e pushtetit dhe në disa anëtarë të Partisë; duhet të hidhet tej dembellëku dhe pikëpamjet që nga zyrat mund të ndreqen gjërat dhe mund të mbarohen punët me dekrete dhe me kartëra. Jo, me shkresa, nuk mbarohen punët, me shkresa nuk zhvillohet bujqësia, nuk ndërtohen fabrikat, maqinat, traktorët, nuk bëhen bonifikimet etj. Duhet operativitet i gjallë, duhet të ndiqen punët dhe të ndihmohen e të kontrollohen njerëzit në punë. Këta të vihen përpara përgjegjësive. Ne nuk do të lejojmë që të krijohet një shtet memurësh dhe burokratësh, të cilët të mendojnë vetëm te rroga e tyre, të sigurojnë rrogat, pa punën le ta marrë lumi. Një gjë e tillë do të marrë fund dhe do të ketë deziluzione të hidhura për cilindo qoftë, anëtar partie ose jo anëtar partie, nëpunës i thjeshtë ose i lartë, në rast se ai nuk kryen detyrën, nuk punon me ndërgjegje dhe nuk merr përgjegjësinë e plotë për punën që i ka ngarkuar Partia dhe qeveria dhe ta kryejë këtë punë. Njerëzit e Partisë në radhë të parë dhe të gjithë të tjerët le të thellohen në këto gjëra që u këshilloi Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria jonë. Çdo njeri që nuk i zbaton këto gjëra elementare, nuk i shërben si duhet popullit dhe vetëvetiu lufta e drejtë e Partisë dhe e pushtetit tonë popullor, do t'i flakë mënjane këta njerëz të pandërgjegjshëm dhe parazitë. Jeta fitohet me punë dhe me nder, blofi, rrena dhe demagogjia e kanë jetën të shkurtër, përpara disiplinës së he-

kurt dhe të ndërgjegjshme të Partisë sonë heroike, e cila drejton me siguri popullin tonë në ndërtimin e socializmit. Kështu edhe fshatarësia punonjëse duhet të mobilizohet e tëra në punët e bujqësisë, të punojë sa më shumë, të hapë toka të reja, të prodhojë sa më tepër dhe sa më mirë, të përqafojë metodat e reja të punës, të zbatojë agroteknikën, të luftojë në kooperativat fshatare të punës, në kooperativat e shitblerjes duke u mbështetur fuqimisht në ligjet dhe urdhëresat e qeverisë. Fshatarësia punonjëse duhet t'i kuptojë drejt dhe t'i zbatojë urdhëresat e reja ekonomike. Ato janë bërë për interesin e fshatarësisë punonjëse dhe të klasës punëtore, në mes të të cilave duhet çdo ditë e më tepër të forcohet aleanca. Fshatarësia punonjëse nuk mund të ndërtojë një jetë të mirë, pa ndihmën dhe pa udhëheqjen e klasës punëtore. Ky është një ligj shkencor marksist, që «s'e tund as topi», siç thotë populli. Rruga tjetër e çon fshatarin punonjës drejt greminës, e çon atë drejt skllavërimit të përjetshëm nga ana e beut dhe e kapitalistit të qytetit. Jo, fshatari ynë dhe punëtori nuk e derdhën gjakun për të ecur prapa, por për të ecur përpara dhe kurdoherë përpara, drejt lumturisë.

Fshatari tani nuk do të furnizohet më me triska. A është kjo një masë e drejtë? Po, kjo është shumë e drejtë. Kjo është një masë që në asnjë mënyrë nuk ja pret fshatarit furnizimet për çka ai ka nevojë si sende të manifakturuara dhe prodhime industriale. Frutet e punës të klasës punëtore e të masave punonjëse të qytetit, janë dhe për fshatarin e varfër e të mesëm. Këta do të përfitojnë më parë, por duhet rregull dhe drejtësi në çdo punë. Ata që punojnë, që lodhen dhe dër-

sijnë më tepër, duhet të përfitojnë më parë dhe më lirë. Vallë a është e drejtë që punëtorët në qytete, në kantiere, në uzina, të prodhojnë naftë e vajguri, penjë e beze, të nxjerrin kripën nga deti, të bëjnë rrugë dhe hekurudha dhe të mos shohin një vezë me sy, ose të blejnë një kaposh deti 1 500-2 000 lekë? A mund të lejohet që me një kaposh deti fshatari të mund të blejë edhe penjët edhe vajgurin edhe litarin edhe bezen? Jo, këto s'janë aspak të drejta dhe vetë fshatari ynë e kupton se një situatë e tillë s'ka se si të vazhdojë më gjatë. Duhet vendosur harmonizim në treg dhe në çmime, pse në anarki nuk fitojnë as masat punonjëse të qytetit as fshatarët punonjës. Këta të fundit mund të kenë iluzionin se fitojnë, por në realitet fitojnë kapitalisti i fshatit dhe i qytetit, të cilët peshkojnë në ujërat e turbullta, nxitin anarkinë, rrëmujën, tregun e zi, dobësojnë pushtetin tonë dhe përgatitin rrëzimin e tij. Prandaj mënyra e re e marrëdhënjeve në mes qytetit dhe fshatit, mënyra e shkëmbimeve reciproke, është nga më të drejtat. Mënyra e grumbullimit të drithërave, të mishit etj., janë nga më të drejtat dhe këto duhet t'i respektojmë. Në zbatimin në praktikë të këtyre urdhërësive mund të ketë lëshime, mund të bëhen gabime, po këto duhet t'i luftojmë, t'i ndreqim atje ku shfaqen dhe të mos përsëriten më.

Çështja e bukës është problem i madh, për sigurimin e së cilës ne duhet të luftojmë shumë. Shoku Stalin, duke folur për kooperativat thotë:

«Arteli është hallka kryesore e lëvizjes kolkoziane, sepse ai është forma më e përshtatsh-

me për zgjidhjen e problemit të drithit. Mirëpo, problemi i drithit është hallka kryesore në sistemin e gjithë bujqësisë, sepse, pa zgjidhur atë, nuk mund të zgjidhet as problemi i blegtorisë (bagëtive të imta dhe të trasha), as problemi i kulturave industriale dhe speciale, që i japin industrisë lëndët e para kryesore»¹.

Nuk ka qenë e drejtë që shteti ynë t'u siguronte bukën dhe me një çmim të barabartë si atyre, që nuk punonin dhe nuk prodhonin edhe atyre që prodhonin e lodheshin. Në shtetin tonë duhet të vendoset me forcë motua: «kush punon, ha»; qeveria nuk i furnizon më me bukë, si më parë, të gjithë dembelët, fajdexhinjtë, tregëtarët e arit dhe matrapazët e qytetit e të fshatit. Ata le të punojnë dhe le të hanë. Me punë do ta sigurojnë bukën. Por në rast se ata e vazhdojnë zanatin e tyre prej spekulantësh duhet ta dinë se shteti ynë dhe ligjet tona janë shumë më të forta se pesëdhjetë matrapazë, të cilët s'do të peshkojnë për shumë kohë në ujë të turbullt. Sa për fshatarët joprodhues dhe që bëjnë fare pak bukë, qeveria jonë u ka hapur perspektiva të gjera që ta fitojnë bukën me punën e tyre. Por megjithëse atyre do t'u jepet diçka me kupona, kjo nuk mund të zgjidhë plotësisht problemin e bukës për ta. E drejta është që ata ta fitojnë bukën me punë, në vend që të qëndrojnë ndër shkropa me një ose me dy kokë dhi. Këta fshatarë duhet të vijnë të punojnë, në punërat e mëdha të shtetit, si dhe të krahinave të

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 192.

ndryshme në rrethet e tyre, ku ata do të kenë përnjëherë të gjitha trajtimet e një punëtori; përveç kësaj, kur fshatari do të shkojë të punojë, në këto punëra, e gjithë familja e tij do të ketë bukën të siguruar në fshat. Kjo është rruga e drejtë. Ose ky fshatar joprodhues, le të mobilizohet në krahinën e tij, të mbledhë lëndë të ndryshme që ka nevojë shteti dhe nga këto ka mjaft në vendin tonë, që venë dëm e që janë një pasuri e madhe. Por në rast se këta fshatarë joprodhues nuk duan të punojnë për interesin e tyre, të familjes së tyre dhe për interesin e shtetit e të të gjithë shoqërisë, ç'faj ka shteti e pse duhet shteti të interesohet për ta? Më duket se kjo është e drejtë. Duhet t'u shpjegohet mirë, ku është interesi i tyre, sa i ndihmon shteti; duke u krijuar gjithë këto mundësira, këta fshatarë duhet të thyejnë paragjykimet e vjetra për të mos u larguar nga fshati. Atdheu nuk ndërtohet, nuk përparon, nuk zbukurohet dhe nuk dashurohet duke qëndruar me duar lidhur majë bjeshkëve, me një dhi ose me një dynym tokë. Atdheu është kudo, në fabrika, në kantierë, është atje ku punohet, ku prodhohet, ku ndërtohet për të mirën e të gjithëve. Puna të bëhet nder për të gjithë; të bëhet njëkohësisht një detyrë e shenjtë. Ky është kuptimi i madh i urdhëresave tona të fundit dhe prandaj duhet t'i zbatojmë me vendosmërinë më të madhe. Urdhëresat e reja të Ministrisë së Tregëtisë, s'është aspak e vërtetë se u përngjasin urdhëresave ekonomike të jugosllavëve dhe as që janë marrë hua prej tyre, siç pretendojnë trockistët jugosllavë dhe organi i tyre i tradhëtisë «Borba». S'është as hera e parë dhe as do të jetë e fundit, që trockistët jugosllavë, për të gënjer

popujt e tyre, mburren se gjoja ata janë shpikës sistemesh socialiste qoftë në ushtri, qoftë në pushtet, qoftë në ekonomi e gjetkë. Ata deformojnë sistemet e vërteta socialiste, që kanë dhënë prova të padiskutueshme në atdheun e socializmit dhe në këto deformime, që s'bien erë marksizëm-leninizëm, trockistët jugosllavë me Titon në krye, përpiqen të mbulojnë qëllimet e vërteta të tyre antimarksiste në lëmin e ekonomisë dhe gjetkë; me këto ata mashtrojnë popujt e Jugosllavisë, pse qëllimet e grupit tradhëtar të Titos si dhe veprimet e tyre, synojnë në forcimin e kapitalizmit në Jugosllavi dhe vartësinë e kësaj të fundit nga kampi imperialist si ekonomikisht, ashtu dhe politikisht. Sistemet dhe metodat e tanishme në Jugosllavi, që nga sistemi i furnizimeve dhe i shkëmbimeve dhe të gjitha të tjerat me radhë, po e mahin kapitalistin e fshatit dhe të qytetit, po u japin të gjitha mundësitë këtyre kapitalistëve të pasurohen në kurrizin e fshatarit të varfër dhe të mesëm si edhe të punonjësve në qytete. Grupi tradhëtar, që drejton popujt e Jugosllavisë, s'po zhvillon asnjë luftë në fshat kundër kulakëve, të cilët kanë parcela të gjera tokash, kanë mjete të shumta pune dhe kundër tyre s'bëhet asnjë kufizim, përkundrazi ata pasurohen në saje e posaçërisht të urdhëresave pseudo-marksiste dhe kapitaliste, me të cilat rregullohen marrëdhënjet e fshatit dhe të qytetit në Jugosllavi. Kulaku në Jugosllavi është i lirë të spekulojë dhe të bëjë me të madhe tregun e zi, ai furnizohet me shumicë në magazinat shtetërore dhe në kooperativat e shitblerjes, për arsye se ekonomia e tij, jo vetëm që nuk është zvogëluar, por është forcuar edhe më shumë. Kulaku

në Jugosllavi i ka të paprekura tokën dhe mjetet e punës, jo vetëm kaq, por, nën regjimin e Titos, që është regjimi i tij, ai po e forcon ekonominë e vet në kurrizin e masave punonjëse të fshatit dhe të qytetit. Kështu kulaku në fshatin jugosllav është bërë një forcë e madhe dhe një mbështetje e sigurtë e klikës tradhëtare të Titos. Sistemet e ndryshme ekonomike e të tjera, që sot janë në fuqi në Jugosllavi, nuk mund t'u shërbejnë përveçse kapitalistëve, të cilët kanë te Titua dhe te grupi i tij, shërbëtorë besnikë dhe të bindur të tyre.

Të tjera janë urdhëresat e reja që ka shpallur qeveria jonë në fushën e marrëdhënjeve në mes fshatit dhe qytetit, po ashtu dhe qëllimet. Ato synojnë hedhjen e bazave të socializmit, ndërtimin e socializmit në rrugën e vërtetë që na mëson marksizëm-leninizmi, ndërtimin e një ekonomie socialiste në qytet dhe në fshat. Urdhëresat e ndryshme ekonomike të qeverisë sonë janë socialiste në parim dhe zbatim i tyre në jetë, ndjek gjithashtu rrugën e vërtetë marksiste-leniniste. Urdhëresat e reja të qeverisë sonë janë dhe do të zbatohen në interesin e fshatarit të varfër e të mesëm dhe në interesin e masave punonjëse të qytetit. Kapitalisti në fshatin tonë ose kulaku, nuk e bën gjumin rehat, ashtu sikundër e bëjnë shokët e tij në Jugosllavi. Pushteti ynë popullor, me në krye Partinë e Punës, ja ka prerë krahët; ai nuk e ka më në dorën e tij armën ekonomike në fshat, kjo armë ka kaluar në duar të tjera, në duart e fshatarësisë së varfër dhe të mesme. Kulakut i ka mbetur një copë tokë, i kanë mbetur ca kafshë pune, i ka mbetur dhe gjuha e tij e helmatisur, por sistemet ekonomike socialiste, organizimi i shëndoshë

i pushtetit tonë dhe puna e shëndoshë dhe e organizuar si duhet e Partisë sonë dhe e Frontit Demokratik, do t'ja vërë kulakut «kufinë te thana», si thotë populli ynë. Klasa jonë punëtore dhe fshatarësia e varfër, bashkë me aleaten e tyre, fshatarësinë e mesme, nën udhëheqjen e Partisë së tyre të Punës, do të bëhen dita-ditës një ushtri e madhe dhe e fuqishme politike, që do ta kufizojë kulakun në veprimtarinë e tij armiqësore, deri në shfarosjen e tij si klasë të fundit kapitaliste. Vallë nuk e di fshatari ynë i varfër dhe i mesëm, nga i kanë ardhur të gjitha të këqiat shekuj me radhë, apo nuk i kanë këta akoma krahët të dhembura nga shfrytëzimi i pamëshirshëm i bejlerëve, i agallarëve dhe i hyzmeqarëve të tyre? Vallë mund t'i harrojë fshatari ynë punonjës, fajdexhinjtë e fshatit dhe të qytetit, që duke i huajtur pesë napolona, ja merrnin tokën, bagëtinë, kasollen dhe, pasi ja kishin marrë të gjitha, fshatarit të shkretë i mbetej t'i paguante fajdexhiut edhe 150 napolona të tjerë? Kjo ishte si sëpata mbi kryet e fshatarit dhe nga kjo ai mbetej e punonte si skllav. Kulaku fajdexhi, gjakpirës i djeshëm, rron akoma në fshat. A mund ta ndërrojë kulaku lëkurën dhe shpirtin e tij? Jo, kurrë, ai është armik i betuar dhe i vendosur i fshatarësisë së varfër dhe të mesme, armik i betuar i klasës punëtore, i Republikës sonë Popullore, i demokracisë sonë. Populli punonjës i Shqipërisë e munda kulakun dhe kapitalistin e qytetit dhe s'do t'i lërë më të marrin frymë, të forcohen dhe të dëmtojnë. Kulakët pëshpëritin se gjoja me urdhëresat e reja, ata do të jenë të parët që do të përfitojnë. Ata e thonë këtë gjë, po ata vetë nuk e besojnë dhe kanë

arësye të plotë mos ta besojnë. Por kulakët janë në përka dhe kanë një qëllim që përhapin fjalë të tilla. Qëllimi i tyre është të sabotojnë urdhëresat e drejta të pushtetit tonë popullor, pse zbatimi i përpiktë i këtyre urdhëresave është vdekja e sigurtë e tyre, është zhdukja e tyre. Ata luftojnë për rrëmujën, për anarkinë, ata luftojnë për forcimin e tregut të zi, ata përpiqen të rrejnjë fshatarin punonjës, që ky të mos shohë përnjëherë ku është e mira e tij. E mira fshatarit do t'i vijë nga kooperativa e punës, nga kooperativa e shitblerjes, nga zbatimi i përpiktë i urdhëresave e i ligjeve të pushtetit, nga lufta e pamëshirshme, që duhet të bëjë kundër tregut të zi, kundër kulakut, armikut të betuar të tij, kundër rrëmujës dhe anarkisë në ekonomi. E mira fshatarit do t'i vijë, kur ai të bëhet një blok i vetëm me klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse të qytetit. Ashtu si prodhimet e klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve të qytetit do të jenë vetëm për fshatarët e varfër dhe të mesëm, ashtu duhet të jenë dhe prodhimet bujqësore për masat punonjëse të qytetit dhe këto shkëmbime të zhvillohen në harmoni të plotë e në rrugën e drejtë të marksizëm-leninizmit. Dhe kështu do të ngjasë. Fshatarët punonjës do të jenë ata, që do të furnizohen të parët në fshat dhe ata duhet të jenë të parët që të furnizojnë qytetin. Kulaku do të përpriqet t'u dredhojë ligjeve dhe urdhëresave, por çdo dredhi do t'i kushtojë shumë shtrenjtë. Pushteti ynë i ka lënë kulakut një copë tokë dhe kafshë të punojë dhe të respektojë ligjet me rigorozitetin më të madh. Çdo shkelje ligji nga ana e kulakut, sjell për të fatkeqësi të mëdha: atij do t'i vihen gjoba të rënda,

ai do të humbasë tokën dhe në fund atë do ta presë burgu. Pra, të zgjedhë rrugën. Por lufta kundër kapitalizmit në fshat lyp një punë të organizuar mirë dhe luftëtarë të radhës së parë duhet të jenë vetë fshatarët e varfër dhe të mesëm, të udhëhequr nga klasa punëtore dhe pararoja e saj, Partia e Punës. Fshatari s'duhet për asnjë çast ta shikojë veten të shkëputur nga masat punonjëse të qytetit dhe nga interesi i përgjithshëm. Në rast se e mendon veten, për një çast, në këtë rrugë, ai duhet të jetë i sigurtë se çoi ujë në mullirin e armiqve të tij, se ai bëri lodrën e armiqve të betuar të tij dhe të gjithë popullit. Armiqtë e popullit dhe të Partisë sonë, trockistët tradhëtarë Tito me shokë dhe me bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë si Koçi Xoxe e të tjerë, janë përpjekur që ta krijonin këtë hendek në mes të fshatarësisë punonjëse dhe masave punonjëse të qytetit, pikërisht me urdhëresat dhe ligjet e gabuara, që kishin arritur të zbatoheshin për një kohë në vendin tonë. Kulaku nuk qenkish prekur shumë në këtë mes nga urdhëresat, si ajo e grumbullimit të drithërave. Kulakut i qe lënë mundësia të fshihte grurin dhe misrin dhe në vend që lufta të drejtohej kundër tij e ashpër dhe e vendosur, janë bërë gabime, duke u marrë fshatarëve të varfër dhe farën për mbjellje. Politika armiqësore e trockistëve veproi në shumë drejtime. Urdhëresa e parë e grumbullimit, ishte në baza jo krejtësisht të drejta, kulaku nuk u prek dhe u bënë padrejtësira ndaj një shumice fshatarësh të varfër. Kjo krijoi një anarki në dëm të popullit dhe të shtetit. Mobilizimi i organeve të pushtetit dhe i njerëzve të Partisë, natyrisht nuk mund të ishte në rrugën e drejtë. Kishte kon-

fuzion të madh në çështjen e grumbullimit të prodhimëve bujqësorë e blegtorale. U krijua një mjegull e dendur, ku përfituan armiqtë e popullit. Shumë njerëz të ndërgjegjshëm të pushtetit dhe të Partisë, që merreshin me çështjen e grumbullimit, u çorën nga ferrat e mbjella prej trockistëve. Prestigji dhe vullneti i tyre i mirë për ta kryer me sukses çështjen e grumbullimit të bereqetit, që është një nga problemet jetike të vendit, u tronditën. Kjo situatë krijoi mjaft vështirësira dhe ngjau që një pjesë e fshatarëve nuk e kanë përmbushur detyrimin ndaj shtetit. Nën pretekstin e disa veprimeve të padrejta, këta fshatarë, që kanë prodhuar dhe që duhet të paguajnë detyrimet ndaj shtetit, qahen dhe kanë hyrë në radhët e viktimave, duke thënë se s'kanë prodhuar, se u është marrë drithi me forcë etj. Do t'ju sjell një shembull. Një fshatar nga Vithkuqi i Korçës, të cilit i kërkohej detyrimi, në vend që të jepte drithin e caktuar, bënte ofensivë çdo mëngjez në Komitetin ekzekutiv të Korçës, me kalamanët për dore duke kërkuar misër nga pushteti. Kur i thuhej këtij fshatari se jo vetëm që s'mund t'i jepej misër, por duhej të paguante detyrimin, ai përgjigjej: «ahere merrni kalamanët» ose «na lini të vdesim për bukë». Ndërkaq, kur ai po luante këtë komedi, organet e pushtetit i gjetën në shtëpi misër dhe grurë, deri për muajin e qershorit. Nga ana tjetër, njerëz të pushtetit dhe të Partisë, kanë rënë në shumë raste në pozitat e disa fshatarëve të pandërgjegjshëm që, duke pasur frikë nga gabimet e vërtetuara më parë në lidhje me grumbullimin, u çarmatosën dhe u gjendën në pozita oportuniste, duke thënë se fshatari s'jep, s'ka etj. Të dyja

këto rrugë, si ajo e atij fshatarit që përmenda, ashtu dhe e atyre shokëve, që merren me grumbullimin e bereqetit, nuk janë të drejta. Partia dhe pushteti duhet ta marrin me seriozitetin më të madh këtë problem jetësor dhe njerëzit tanë të mos i zërë gjumi për këtë çështje, sepse këtej varet buka e masave punonjëse të qytetit dhe të atyre fshatarëve shumë të varfër të malësive, që s'kanë tokë ose që kanë shumë pak. Plani i grumbullimit për vitin 1948 ka qenë reduktuar shumë dhe ky plan i reduktuar duhet të realizohet shpejt. Partia dhe pushteti duhet të mobilizohen fort për të gjitha problemet e fshatit e të qytetit dhe të zbatohen urdhëresat e qeverisë, pa asnjë lëshim dhe në rrugën e drejtë e ligjore. Urdhëresat ekonomike duhet të gjejnë mbështetjen e plotë të fshatarit të varfër dhe të mesëm. Shteti ua ka dhënë dhe do t'ua japë fshatarëve të gjithë ndihmën që puna e tyre të shkojë përpara dhe të përparojë ekonomia në fshat, por kjo nuk mund të bëhet ashtu si dëshirohet, në rast se fshatarësia punonjëse nuk i bën të vetat urdhëresat e pushtetit dhe të luftojë vetë e para për zbatimin e përpiktë të tyre, duke u mobilizuar në fshat si një ushtri e fuqishme për të goditur armiqtë e saj, të popullit dhe të pushtetit. Kooperativat fshatare të punës duhet të jenë shembull i kësaj përpikmërie dhe lufte për realizimin e planeve, për zbatimin e drejtë dhe të shpejtë të urdhëresave dhe për luftën kundër elementit kulak dhe spekulator në fshat.

Viti i ri bujqësor në vendin tonë, duhet të jetë një vit përpjekjesh të përgjithshme, nga ana e fshatarit në radhë të parë dhe nga ana e qeverisë dhe e Partisë për të punuar sa më shumë toka, për t'i punuar sa më

mirë dhe për të pasur bukë dhe prodhime të tjera më shumë se nga çdo vit tjetër. Gjatë vitit 1949 duhet të ndreqen të gjitha gabimet e vërtetuara në të kaluarën dhe të kapërcehet çdo pengesë; ky duhet të jetë një vit që të karakterizohet nga një organizim i shëndoshë i punës, që të zhdukë të gjitha shfaqjet e gabuara që kanë depërtuar nga puna armiqësore e trockistëve. Të gjithë njerëzit punonjës duhet të forcojnë disiplinën e rregullin, të luftojnë për zbatimin e shpejtë dhe të drejtë të ligjeve dhe të urdhëresave. Njerëzit e pushtetit duhet të dëgjojnë me vëmendje kërkesat dhe ankesat e fshatarëve dhe t'u japin zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë në dritën e ligjeve të Republikës Popullore. Anëtarët e Partisë duhet të mobilizohen në radhë të parë dhe të vënë të gjitha forcat e tyre që çdo angazhim i marrë dhe çdo detyrë, të kryhen patjetër dhe të jenë luftëtarë të radhës së parë, të shquhen nga zotësia e drejtimit, e organizimit, e drejtësisë, e disiplinës. Anëtarët e Partisë nuk lejohet të mbeten në bisht të situatave dhe të tremben nga përgjegjësitë.

Shokë të dashur,

Me bindje të plotë në punën tuaj kaq të rëndësishme që po vazhdoni, punë që përfaqëson sigurimin e jetës suaj, të kalamanëve tuaj dhe të të gjitha masave punonjëse, vini gjithë forcat tuaja në punë. Partia dhe qeveria juaj do t'ju ndihmojnë pa pushim. Të forcojmë ekonominë e vendit, pse kështu kemi forcuar atdheun, kemi mbrojtur paqen. Forconi dita-ditës alean-

cën me klasën punëtore nën udhëheqjen e sigurtë të së cilës ne do ta ndërtojmë socializmin në vendin tonë.

Rroftë Partia jonë e dashur!

Rroftë fshatarësia jonë punonjëse!

Rroftë Kongresi i parë i kooperativave bujqësore dhe ju urojmë sukses të plotë në punimet tuaja!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 40 (113), 16 shkurt 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA FJALA E MBAJTUR NË FSHATIN BRATILË
TË GRAMSHIT, PARA USHTARËVE DHE POPULLIT
ME RASTIN E INAUGURIMIT TË PUNIMEVE PËR
NDËRTIMIN E RRUGËS GRAMSH-LOZHAN**

2 mars 1949

Shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë,

Ne erdhëm këtu që t'ju lavdërojmë për veprën e rëndësishme që keni marrë përsipër. Komanda e Përgjithshme dhe Partia kanë besim të plotë se ju do ta kryeni me sukses këtë detyrë, ashtu siç keni kryer çdo detyrë tjetër. Ju keni çarë edhe rrugë të tjera, duke u shërbyer kështu interesave të popullit, duke i shërbyer mirëqenjes së popullit. Ju keni marrë pjesë në Luftën nacional-çlirimtare, të cilën e udhëhoqi Partia jonë e lavdishme, duke korrur për popullin fitore, që nuk ishin arritur kurrë ndonjëherë tjetër.

Ne luftuam për ta çliruar popullin dhe kësaj barre i dolëm në krye. Partia i dha popullit lirinë, i dha pushtetin në duart e tija. Sot ne duhet të përpigemi me të gjitha forcat që fitoret e arritura t'i shtojmë dhe t'i sigurojmë. Për këtë ushtria jonë duhet të bëhet sa më e fortë, pse kështu dhe vetëm kështu, i shërbehet më

mirë popullit. Detyra që ju ka ngarkuar Komanda, për t'u kryer me nder kërkon përpjekje, mundim dhe sakrifica, ashtu siç kërkon përpjekje dhe sakrifica ndërtimi i socializmit në vendin tonë. Por ne do t'i kalojmë me vendosmëri të gjitha pengesat dhe do të ecim përpara. Armiqtë na kanë zili për sukseset tona. Por ata le të na kenë zili. Ne do të vazhdojmë punën tonë me të gjitha forcat drejt socializmit.

Imperialistët na kanë kërcënuar vazhdimisht, me qëllim që të ndalin hovin e punës së popullit tonë, me qëllim që të trembemi. Populli ynë nuk trembet aspak nga kërcënimet e armiqtve të tij, pse populli ynë ka në krye Partinë e tij të Punës, pse ai ka mbrojtës Bashkimin e madh Sovjetik dhe Partinë e lavdishme Bolshevike.

Bashkimi Sovjetik lufton me vendosmëri kundër gjithë tentativave të armiqtve të paqes, kundër gjithë nxitësve të luftës.

Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore nuk e duan luftën ashtu si nuk e do edhe populli ynë. Ata nuk duan që të vriten përsëri me miliona njerëz; ne nuk duam që të vriten kalamanët tanë, djemtë dhe nënat tona.

Por për ta larguar luftën, ne duhet të jemi sa më të fortë, të punojmë me të gjitha forcat tona dhe nën udhëheqjen e Partisë të korrin suksese të reja. Dhe kështu kauza jonë e drejtë do të triumfojë. Do të triumfojë, pse popujt përparimtarë me Bashkimin e madh Sovjetik në krye, që udhëhiqet nga Partia e lavdishme Bolshevike e nga Stalini i madh, janë sot më të fortë se kurrë.

Kur imperialistët po përgatitin bomba atomike për të skllavëruar popujt, populli ynë çel rrugë të reja, ndërton udhë të hekurta, përpiket të përmirësojë jetesën e vet, përpiket të ndërtojë sa më shpejt socializmin.

Imperialistët me shtypin e tyre po nxitin trockistët jugosllavë për të dëmtuar popullin tonë. Por ne nuk trembemi, se ne kemi besim në forcat tona.

Bashkimi Sovjetik, që na shpëtoi nga fashizmi, sot na mbron nga armiqtë dhe na ndihmon me gjithë zemër që ne të ngremë sa më shpejt jetën tonë të re. Për ne interesohet vetë Stalini i madh. Prandaj, emri i Stalinit dhe i Bashkimit Sovjetik të nderohet edhe në kasollet më të veçuara të vendit tonë.

Të duam me gjithë shpirt Partinë tonë të Punës!

Rrofshin ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Ushtrisë sonë Kombëtare!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 53 (126), 3 mars 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 53 (126), 3 mars 1949

**LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË
TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME
DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PARTI**

6 mars 1949

**TË GJITHA ORGANIZATAVE TË PPSH NË TERREN
DHE NË USHTRI,**

TË GJITHË KOMUNISTËVE,

Komiteti Qendror i PPSH konstaton se në mjaft organizata të Partisë dhe nga mjaft anëtarë të Partisë është kuptuar shtrembër demokracia e brendshme e Partisë dhe si rrjedhim nuk respektohet me rigorozitet disiplina e Partisë, e cila buron prej saj.

Është e domosdoshme t'u jepet fund menjëherë dhe qysh tani në fillim të gjitha këtyre shfaqjeve të dëmshme, të cilat dobësojnë rëndë Partinë, dobësojnë unitetin dhe kompaktësinë luftarake të radhëve të saja, që të çojnë në një farë anarkie në punët e Partisë.

Partia jonë hedh poshtë kategorikisht atë kuptim të shtrembër mbi demokracinë në parti, që në të vërtetë i vë kazmën partisë, prish unitetin e mendimit dhe të veprimit në parti.

Lenini dhe Stalini na mësojnë se demokracinë e

partisë duhet ta kuptojmë si një armë për të shtuar aftësinë luftarake, si një metodë për punën e brendshme të partisë, që shton aktivitetin dhe kompaktësinë e të gjithë anëtarëve të partisë, që fut të gjithë partinë në përpunimin e vendimeve të partisë dhe në luftë aktive për zbatimin e tyre të shpejtë dhe të përpiktë.

Shoku Stalin ka thënë:

«Demokracia e brendshme e partisë është shtimi i aktivitetit të masave të partisë dhe forcimi i unitetit të partisë, forcimi i disiplinës së ndërgjegjshme proletare në parti»¹.

Nga e gjithë Partia duhet të kuptohet mirë se disiplina e hekurt dhe rigoroze, që kërkon Partia nga anëtarët e saj, nuk çënon aspak demokracinë e shëndoshë të Partisë sonë. Përkundrazi disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme, siç është disiplina e Partisë sonë, mund të zhvillohet vetëm në saje të demokracisë së brendshme të partisë.

Në Statutin e PPSH thuhet:

«Diskutimi i mirë dhe i shëndoshë mbi problemet e politikës së Partisë në organizatat e ndryshme ose në gjithë Partinë, është për çdo anëtar partie një e drejtë e paprekshme, që buron nga demokracia e brendshme e Partisë. Vetëm në bazë të demokracisë së brendshme

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 149.

të Partisë mund të zhvillohet kritika dhe auto-kritika e shëndoshë dhe të forcohet disiplina e Partisë e cila duhet të jetë konshiente dhe jomekanike»¹.

Kështu, forcimi i unitetit të brendshëm të Partisë, forcimi i disiplinës së Partisë konshiente dhe jomekanike, mund të mendohet vetëm në bazë të demokracisë së plotë të Partisë, sepse mbi këtë bazë ngrihet konshienca e komunistit, ngrihet niveli i tij politik e ideologjik.

Siç theksohet edhe në vendimet e Kongresit I të PKSH, ishte e natyrshme që dje, kur mungonte demokracia e brendshme e Partisë, kur në Parti si rezultat i punës armiqësore të Koçi Xoxes, të Pandi Kristos etj. ishin futur metoda ushtarake dhe policore, të mungonte disiplina e hekurt dhe konshiente e Partisë, të vihej disiplina mekanike, disiplina zyrtare mbi disiplinën e vërtetë të Partisë. Sot, kur të gjitha konditat për zhvillimin e plotë të demokracisë në Parti janë krijuar, çdo shtrembërim i demokracisë, çdo shkelje, sado e vogël qoftë e disiplinës së hekurt dhe të ndërgjegjshme të Partisë, është e palejueshme dhe e rrezikshme për Partinë.

Çfarë rastesh janë vënë re në Partinë tonë, që vërtetojnë se në mjaft organizata bazë dhe në shumë anëtarë partie është kuptuar keq demokracia e brendshme e Partisë dhe është shkelur disiplina e hekurt e Partisë?

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, f. 414.

a) Në shumë organizata bazë të Partisë, nuk respektohen mbledhjet e Partisë.

Është bërë pothuajse zakon në mjaft organizata bazë që mbledhjet të fillojnë me vonesë. . .

Gjithashtu ka anëtarë partie në shumë organizata bazë të Partisë, që mungojnë pa asnjë arsye në mbledhjet e organizatës bazë. . .

Në Shkodër, për shembull, është bërë si rrugë që, kur i dhemb pak koka, ose sepse gjoja ka punë në zyrë, anëtari i Partisë nuk vete në mbledhjen e organizatës bazë.

Një gjendje e tillë duhet të goditet me të tërë forcën në Parti. Ky indiferentizëm për mbledhjet e Partisë tregon në fund të fundit dhe indiferentizmin e moskëçarjen për zbatimin e vijës së Partisë, për realizimin e detyrave të Partisë. Ku, përveçse në mbledhjet e organizatës bazë, do të mund të njohë anëtari i Partisë vijën e Partisë, do të mund të vihet në dijeni të detyrave, që i shtron Partia, do të mund të ngarkohet me detyra për t'i kryer etj.?

Të mungosh nga mbledhjet e organizatës bazë të Partisë, do të thotë të shkëputesh nga jeta, nga fryma e Partisë dhe, më në fund, të punosh me kokën tënde, jo si të mëson dhe të udhëzon Partia. Ne duhet të kemi gjithnjë parasysh mësimet e Leninit të madh se çdo anëtar partie është përgjegjës për Partinë dhe Partia është përgjegjëse për çdo anëtar. Por, që Partia të mund të marrë përgjegjësi për çdo anëtar, është e domosdoshme të ketë siguruar kontrollin e vet mbi veprimtarinë dhe punën e çdo anëtari të saj.

Është për këtë arsye që pjesëmarrja në mbledhjet

e Partisë është një nga konditat e para për anëtarësinë në Parti. Natyrisht, ndaj atyre që nuk plotësojnë këto detyra partie, duhen marrë dhe masat ndëshkimore që parashikon Statuti.

Mungesa në mbledhjet e Partisë nuk i jep mundësi anëtarit të Partisë të zhvillojë aktivitet për Partinë, të punojë për të. Nga çdo komunist do kuptuar mirë se disiplina e Partisë sonë nuk presupozon një pajtim «me fjalë» me vijën e Partisë, por luftë konkrete dhe aktive për realizimin e kësaj vije me vepra, pikërisht në atë sektor, ku e ka vënë Partia anëtarin e saj.

Partia nuk lejon prishjen e disiplinës, as edhe në shkallën më të vogël; kjo është një nga karakteristikat e veçanta të disiplinës së Partisë sonë. Nuk lejohet në asnjë rast largimi nga programi dhe Statuti i Partisë. Ai komunist, që lë pas dore çfarëdo detyrë të Partisë, qoftë kjo pagesë e kuotizacionit, pjesëmarrja në mbledhjet e organizatës bazë, respektimi i orarit të mbledhjes, kryerja e ndonjë detyrë të veçantë të Partisë ose zbatimimi i vijës së Partisë, në atë organizatë ku anëtari i Partisë punon, ai ka shkelur disiplinën e Partisë.

b) Në shumë shokë janë paraqitur tendenca për moszbatimin e vendimeve dhe të detyrave të ngarkuara nga organizatat bazë, nga komitetet e rretheve e të qyteteve dhe deri nga Komiteti Qendror.

Ka pasur raste në mjaft organizata, që shokë të ngarkuar nga Partia të kryejnë këtë ose atë punë, nuk janë bindur, nuk kanë dëgjuar të shkojnë atje, ku u thotë Partia, të kryejnë detyrën që u ngarkon Partia.

Në qytetin e Shkodrës komiteti i Partisë kishte ur-

dhëruar organizatat bazë të lagjeve që të mobilizonin anëtarët e tyre për të grumbulluar popullin e lagjeve në disa konferenca që do të zhvilloheshin. Për këtë gjë u muar dhe vendim në organizatat bazë. Në këtë rast pati shokë në shumicën e lagjeve që, jo vetëm nuk punuan për grumbullimin e popullit në konferenca, por që nuk vajtën dhe vetë pa asnjë arësyë...

Raste tipike të mospranimit dhe të diskutimit të urdhërave të dhëna nga komitetet e Partisë ka pasur sidomos në lidhje me vendosjen e kuadrit. Nën parullën e «demokracisë» shumë shokë kanë kundërshtuar vendimin e komitetit të Partisë për të shkuar në krye të detyrës. Në lidhje me këtë çështje janë vënë re dhe tendenca karrierizmi duke mos parë në radhë të parë nevojat dhe interesin e Partisë e të vendit, por duke shikuar për pozitën e gradën.

Gjithashtu në shumë shokë dhe në disa organizata bazë është zhvilluar një frymë e sëmurë duke marrë në diskutim, në mënyrë jo të drejtë, vendimet e Partisë në vendosjen e kuadrit.

Në organizatën bazë të Ministrisë së Industrisë, disa anëtarë të Partisë nuk pranojnë vendimin e komitetit të qytetit, të aprovuar nga KQ i PPSH për caktimin provizorisht deri në zgjedhjet e reja të sekretarit dhe zëvendëssekretarit të organizatës bazë. Gjithashtu nga po këta shokë të kësaj organizate bazë diskutohet dhe konsiderohet i padrejtë vendimi i KQ të PPSH për vendosjen e disa kuadrove. Po kështu në organizatën bazë të Ministrisë së Tregëtisë, për katër orë rresht është diskutuar rreth vendosjes së kuadrove të ndryshëm nga ana e drejtorisë së kuadrit të KQ.

Në analizë të fundit, ku të shpien këto pikëpamje të shtrembra, këto shtrembërime të demokracisë, këto raste tipike të thyerjes së disiplinës? Ato të shpien në dobësimin ose humbjen e besimit ndaj udhëheqjes. Moskryerja e urdhërave dhe e vendimeve të dhëna nga forumet më të larta do të sillte si rrjedhim që çdo anëtar partie, të vepronte si t'i donte qejfi, të shkonte ku t'i pëlqente, që do të thoshte më në fund të vinte në pikëpyetje vijën e Partisë.

Anëtari i Partisë duhet t'i përgjigjet çdo detyre që i shtron Partia. Ai duhet të jetë gati të shkojë atje ku i thotë Partia, atje ku e gjen të nevojshme Partia. Për anëtarin e Partisë, nuk ka dy lloj interesash, interesi i Partisë dhe interesi personal. Për anëtarin e Partisë, Partia është mbi të gjitha. Kur interesi i Partisë e do që të shkohet edhe në fshatin më të largët, anëtari i Partisë duhet të jetë gati. Puna që duhet t'i pëlqejë më tepër anëtarit të Partisë është të shkojë atje ku ka më shumë nevojë Partia, të shkojë atje ku e kërkon Partia.

Në goftë se anëtarët e Partisë do të kërkonin të shkonin atje ku dëshironin ata, pa marrë parasysh nevojat e Partisë, kjo do të pengonte Partinë në shpërndarjen e drejtë të kuadrit, do t'i hiqte Partisë mundësinë të mbante fort nën kontrollin e saj të gjithë sektorët e ndryshëm të punës, të gjitha krahinat e vendit tonë.

Zbatimi i urdhërave dhe i vendimeve të Partisë është një ndër detyrat e para të anëtarit të Partisë. Statuti i PPSH parashikon për të gjithë ata që shkelin urdhërat e vendimet e Partisë një sërë masash dhe sanksionesh, që shkojnë deri në dënimin ekstrem: përjashtimin nga Partia.

«Vendimet e organeve qendrore të Partisë dhe administratave të shtetit duhet të zbatohen shpejt dhe pikë për pikë» — thuhet në Statutin e PPSH dhe më poshtë vijon:

«Mosaplikimi i vendimeve të organeve më të larta dhe akte të tjera, të cilësuar si delikte nga opinioni publik i Partisë sjellin me vete: për organizatën, vërejtjen dhe shpërndarjen e saj; për anëtarët e Partisë, vërejtjen me shënim në biografi, ndalimin e përkohshëm për të pasur një vend drejtonjës në Parti dhe përjashtimin nga Partia»¹.

Përgjegjësit e punës, komitetet e Partisë, janë të ngarkuar gjithnjë të verifikojnë kryerjen e detyrave nga ana e organizatave, nga ana e çdo anëtari të Partisë. T'i mungosh këtij kontrolli, do të thotë t'i lësh rrugë të lirë thyerjes së disiplinës. Te ne sot, në mjaft shokë, ka tendenca që kërkojnë t'i kufizojnë të drejtat e kontrollit të Partisë, që kërkojnë t'i shpëtojnë kontrollit të përgjegjësve mbi ta. Nga mjaft shokë, kur u kërkon llogari për moskryerjen e detyrave, është dëgjuar të thuhet: «shok, ti je me frymën e Plenumit VIII² etj.». Këto janë pikëpamje të shtrembra, këto nuk janë pikëpamje partie. Partia jonë e ka ngritur dhe do ta ngrejë gjithnjë me forcë nevojën e verifikimit të kryerjes së detyrave, pa të cilën s'ka disiplinë partie, s'ka realizim të detyrave të Partisë.

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH», Vëll. 1, f. 421.

² Plenumi VIII i KQ të PKSH që u mbledh në shkurt 1948.

c) Në mjaft organizata dhe nga mjaft shokë është shkëlur konspiracioni i Partisë.

Duke dalë nga gjendja e një konspiracioni të ekzagjeruar, kur mbahej fshehtë dhe vetë vija dhe qëllimet e mëdha të Partisë, shumë shokë kanë kaluar në anën tjetër duke bërë biseda rrugëve dhe kafeneve edhe ato gjëra që janë çështje të brendshme të Partisë.

Çështjet e brendshme të njërës organizatë (posaçërisht në dikastere), pa kaluar shumë kohë bëhen çështje bisede dhe për shumë organizata të tjera.

Por ka dhe raste gjithashtu që çështje të brendshme të Partisë janë bërë dhe biseda në popull. Në katundin Lekaj të rrethit të Kavajës, fjala vjen, bisedimet që janë bërë një natë më përpara në mbledhjen e organizatës bazë, janë marrë vesh të nesërmen nga mjaft persona në fshat dhe posaçërisht nga ata për të cilët ishte folur dhe ishin kritikuar në mbledhjen e organizatës. Në Koplik gjithashtu, disa anëtarë partie diskutojnë në klub se ku do të vendoset njëri dhe tjetri kuadër i Partisë. Këto biseda i dëgjojnë dhe njerëz jo anëtarë partie, njëri nga këta bile u thotë: «Mirë ju, që jeni anëtarë partie po e caktoni veten, po ne, ku do të na caktoni?».

Ka pasur raste gjithashtu që shokët, duke diskutuar me popullin (si në Pogon, rrethi i Gjirokastrës), të kenë dekonspiruar punën dhe format e punës së sigurimit.

Këto shkelje të disiplinës, që shfaqen në disa raste te disa shokë, duhen goditur me forcë nga ana e Partisë.

Veprime të tilla dobësojnë vigjilencën e anëtarëve të Partisë ndaj armikut, i japin mundësi armikut të na luftojë më kollaj, të dijë ku të na godasë.

c) *Në disiplinën shtetërore janë vënë re gjithashtu shënja të mosrespektimit të urdhërave eprorë.*

Ka pasur raste që shokë të ndryshëm në pushtet apo në ushtri, t'u shmangen urdhërave të eprorëve. Në Kombinatin Vajguror Kuçovë-Patos, fjala vjen, në mjaft shokë që punojnë në prodhim është dukur tendenca e mosbindjes në urdhërat e drejtorisë, duke lënë kështu pa realizuar detyrat që u shtrohen.

... Në aparatin tonë të shtetit dhe posaçërisht në radhët e Ushtrisë sonë Kombëtare, nuk mund të lejohen në asnjë mënyrë shfaqje indisciplinimi që prishin rendin, që i hapin rrugën rrëmujës dhe anarkisë.

Urdhëri epror, posaçërisht në ushtri, është i padiskutueshëm. Ai kryhet pa hezitim. Në kondita lufte, kush kundërshton urdhërin, merr dënimin më të rëndë.

Fakti që është anëtar partie, nuk i jep asnjë privilegj këtij, siç mund të mendojë ndokush ndaj disiplinës shtetërore, ndaj ligjeve të shtetit. Disiplina shtetërore dhe ligjet e shtetit janë të pacenueshme. Shkelja e tyre goftë edhe në masën më të vogël, është goditje direkte ndaj ndërtimit të vendit tonë. Prandaj komunistët duhet të jenë të parët, që t'i zbatojnë dhe t'i respektojnë me rigorozitet këto. Jo vetëm ata që janë të ngarkuar nga Partia, që të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për respektimin e kësaj discipline, por urdhërat dhe vendimet duhet të zbatohen nga e gjithë masa ku punon komunisti.

Shoku Stalin ka theksuar se të gjithë ata që shkelin ligjet e shtetit

«duhen shkarkuar pa ngurrim nga postet drejtuese, pa marrë parasysh meritat e tyre në të kaluarën. . . Kjo është e domosdoshme, në mënyrë që këtyre zotërinjve burokratë mëndjemëdhenj t'u ulet hunda dhe t'u tregohet vendi. Kjo është e domosdoshme, në mënyrë që të forcohet disiplina e Partisë dhe e pushtetit në gjithë punëtonë»¹.

d) Janë vërtetuar raste të thyerjes së disiplinës në punë për realizimin e planit të shtetit.

Si rrjedhim i një fryme të tillë shturjeje të disiplinës, në mjaft qendra pune e prodhimi janë vënë re shenja të demobilizimit në punë, që kanë sjellë si rrjedhim mosrealizimin e planeve.

Vlen të përmendet këtu shembulli i Kuçovës ku, për shkak të mungesës së disiplinës në punë nga ana e mjaft komunistëve dhe si rrjedhim dhe e mjaft punëtorëve, nga mungesa e shembullit personal të komunistit për të qenë në krye të punës, kurdoherë në sulm, ngjau që plani i prodhimit të muajit janar, megjithëse qe plotësisht i mundshëm, të mos realizohet.

Kjo në asnjë mënyrë nuk u lejohet anëtarëve të Partisë. Partia u shtron atyre në radhën e detyrave të para, detyrën që të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre në punën për realizimin e planit të shtetit. Dhe anëtari

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 356-357.

i Partisë jo vetëm që vetë duhet të punojë pa u lodhur dhe me abnegacion në punën që i ngarkohet, por njëkohësisht ai duhet të bëhet shembull i mirë në gjithë qendrën e punës për t'u ndjekur nga të gjithë punëtorët e tjerë.

Ku më mirë se në punën për realizimin e planit e tregon anëtari i Partisë sonë devocionin e tij për çështjen e Partisë, për ndërtimin e socializmit?

Statuti i Partisë sonë kërkon nga çdo komunist që të jetë shembull për respektimin e disiplinës në punë, pse nga ajo varet suksesi i ndërtimit socialist të vendit.

Sikundër e kam theksuar edhe në Kongresin e parë të kooperativave bujqësore:

«Duhet mobilizimi i plotë i të gjithëve për kryerjen e planit, duhet të vazhdojmë të bëjmë sakrifica, pse pa punë dhe pa sakrifica nuk ndërtohet socializmi. Duhet të luftojmë me ashpërsi tendencat e mungesës së disiplinës në punë dhe në radhë të parë në njerëzit e pushtetit dhe në disa anëtarë të Partisë; duhet të hidhet tej dembellëku dhe pikëpamjet që nga zyrat mund të ndreqen gjërat dhe mund të mbarohen punët me dekrete dhe me kartëra... Një gjë e tillë do të marrë fund dhe do të ketë deziluzione të hidhura për cilindo qoftë, anëtar partie ose jo anëtar partie, nëpunës i thjeshtë ose i lartë, në rast se ai nuk kryen detyrën, nuk punon me ndërgjegje dhe nuk merr përgjegjësinë e plotë për punën që i ka ngarkuar Partia dhe qeveria dhe ta kryejë këtë punë»¹.

¹ Shih në këtë vëllim, f. 20-21.

* * *

Përpara këtyre fakteve dhe të tjerave, që vërtetojnë se në mjaft organizata tona ka filluar të zhvillohet një frymë jo e shëndoshë dhe jo e Partisë, KQ i Partisë tërheq vëmendjen e të gjitha organizatave të PPSH, e të gjithë komunistëve që t'i japin fund menjëherë një situatë të tillë, të kuptojnë drejt dhe ta aplikojnë si duhet demokracinë e brendshme të Partisë dhe të respektojnë me rigorozitet disiplinën e hekurt të Partisë.

Në Partinë tonë nuk ka disiplinë qorre, bindje nga zori. Jo. Disiplina në Partinë tonë është e ndërgjegjshme, prandaj dhe është e fortë. Shoku Stalin ka thënë:

«...disiplina e hekurt nuk përjashton, por supozon një nënshtrim të ndërgjegjshëm dhe vullnetar, sepse vetëm një disiplinë e ndërgjegjshme mund të jetë disiplinë e hekurt»¹.

Të dobësosh sado pak disiplinën e Partisë, do të thotë të dobësosh Partinë, të rrezikosh Partinë. Respektimi rigoroz i disiplinës nga të gjithë anëtarët e Partisë merr një rëndësi të posaçme, sidomos sot, kur Partia është në fuqi. Lenini ka thënë:

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurt të Partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»².

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 186.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 33.

Të gjithë anëtarët e Partisë duhet t'i kenë gjithnjë parasysh këto fjalë të Leninit të madh.

Secili anëtar partie duhet t'i përmbahet pikë për pikë disiplinës në Parti e në punë, të punojë në mënyrë aktive dhe me vetëmohim për realizimin e Statutit të Partisë, për zbatimin e vijës dhe të detyrave të saja, duke siguruar unitetin e radhëve të Partisë.

Komiteti Qendror i Partisë i porosit të gjitha organizatat e Partisë, të gjithë komunistët që të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për të kuptuar drejt dhe siç e shtron Partia, demokracinë e brendshme të Partisë e si rrjedhim për të vendosur në Parti e në punë një regjim discipline shembullore.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË
KOMBINATIT VAJGUROR KUÇOVË-PATOS
NË LIDHJE ME GJENDJEN E KRIJUAR
NË ORGANIZATËN E PARTISË
TË KOMBINATIT**

12 mars 1949

**KOMITETIT TË PARTISË
PËR KOMBINATIN VAJGUROR**

Kuçovë-Patos

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbasi dëgjoi raportin e të deleguarit të saj mbi gjendjen e organizatës së Partisë në Kombinatin Vajguror Kuçovë-Patos, konstaton:

Nga puna e dobët e së kaluarës, nga orientimi i gabuar në lidhje me shtimin e radhëve të Partisë, duke synuar futjen në Parti të të gjithë punëtorëve (kjo po- saçërisht në Patos, ku deri sot janë futur në Parti pak më tepër se 50 për qind e punëtorëve) dhe nga mungesa e një kontrolli të përhershëm e të vazhdueshëm në organizatat bazë, është shkaktuar që në Parti të futen dhe elementë, që s'kanë asgjë të përbashkët me komunizmin, elementë arrivistë dhe deri armiq; është shkaktuar gjithashtu që të mos bëhet jetë e rregullt partie, të kup-

tohet shtrembër demokracia e brendshme e Partisë, të thyhet disiplina e hekurt e Partisë.

Nga ana tjetër, si rezultat i kësaj gjendjeje të dobët në Parti, puna për realizimin e planit të shtetit në të gjithë sektorët e këtij kombinati nuk ka qenë e kënaqshme. Për këtë arsye në muajin janar plani i krejt kombinatit për të prodhuar benzinë u realizua vetëm 86 për qind dhe në muajin shkurt plani për të nxjerrë naftë në Patos, u realizua vetëm 53 për qind. Gjithash-tu janë vërtetuar abuzime nga ana e disa shokëve përgjegjës (posaçërisht në Patos) mbi mallin e shtetit, janë vërtetuar shpërdorime nga ana e tyre ndaj arkës së shtetit etj.

Për këtë gjendje të krijuar në këtë kombinat ka përgjegjësi i gjithë Komiteti i Partisë për Kombinatin Vajguror Kuçovë-Patos.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë duke marrë parasysh këtë gjendje vendosi:

1.¹

2. Të vihen në zbatim të gjitha udhëzimet, që dha në vend i dërguari i Byrosë Politike, Sekretari i KQ të PPSH, shoku Mehmet Shehu, për të vënë kështu në rrugën e drejtë të zgjidhjes të gjitha problemet që preokupojnë sot organizatën e Partisë në Kombinatin Vajguror Kuçovë-Patos e për të përmirësuar kështu në një kohë sa më të shkurtër gjendjen e organizatës së Par-

¹ Në pikën e parë të kësaj letre përcaktohen masat që duhe-shin marrë ndaj disa kuadrove, që ishin përgjegjës për punën e dobët që u vërtetua në këtë kombinat.

tisë dhe të punës në atë kombinat. Në radhë të parë duhet të vihen në rrugë të drejtë këto çështje:

a) *Problemi i shtimit të radhëve të Partisë*: Të anulohet vendimi i atij komiteti për pezullimin e pranimeve në Parti. Të vendoset një kriter i drejtë dhe i shëndoshë për shtimin e radhëve të Partisë në mënyrë që pranimi i njerëzve në Parti të bëhet mbas një studimi të imtë të personit të propozuar, duke kërkuar që të plotësojë të gjitha konditat që kërkohen për të qenë anëtar partie. Rëndësi duhet t'i kushtohet gjithashtu procedimit për pranimin e anëtarëve të rinj në Parti, që të bëhen konform Statutit të PPSH.

b) *Problemi i pastrimit të radhëve të Partisë*: Të bëhet pastrimi i radhëve të Partisë nga elementët që kanë hyrë gabimisht në Parti për shkak të punës së dobët, që është bërë për shtimin e radhëve të Partisë. Kjo nuk duhet të kuptohet si revizionim.

Secila organizatë bazë e Partisë në kombinatin tuaj, duke e parë punën me syrin e drejtë të Partisë dhe nën kontrollin e komitetit, duhet të shqyrtojë dhe të marrë masa përjashtimi vetëm ndaj atyre, që nuk e meritojnë të jenë anëtarë të Partisë, pse kanë një të kaluar të zezë, pse kanë të meta shumë të mëdha në punë e kanë gabuar rëndë.

Për shokë të tjerë, që ju mendoni se s'meritojnë të jenë anëtarë partie, por që s'kanë të meta e gabime kaq të mëdha sa të parët, duhet t'i dërgoni KQ propozimet tuaja të motivuara konkretisht për secilin element që mendoni të përjashtohet nga Partia.

Shokët e tjerë që mund të kenë të meta më të vo-

gla, por që kanë shpresa të ndreqen, duhet të këshillohen e të edukohen dhe nëse do të ketë nga këta që, me gjithë këshillimet dhe vërejtjet, nuk do të përmirësohen, atëhere si rregullisht, do të merrni kundrejt tyre masa në bazë të Statutit.

c) Kuptimi i drejtë i demokracisë së brendshme të Partisë: Të luftohen me të gjitha forcat tendencat e thyerjes së disiplinës në Parti e në punë. Për këtë arësyje të punohet shpejt dhe të konkretizohet me shembuj, letra që ju ka dërguar kohët e fundit KQ i PPSH në lidhje me demokracinë e brendshme të Partisë. Komiteti i Partisë duhet të jetë rigoroz dhe të marrë masa menjëherë ndaj gjithë atyre, që kërkojnë të thyejnë disiplinën e hekurt të Partisë dhe të punës.

ç) Problemi i funksionimit të rregullt të organizatave bazë të Partisë: Të organizohen mbledhje të rregullta të tyre dhe të shërbejnë efektivisht këto mbledhje nga një anë për të edukuar anëtarët me moralin komunist e për të forcuar kështu konshiençën e tyre si anëtarë të Partisë pararojë, nga ana tjetër të shërbejnë për të mobilizuar me entuziazëm të gjithë anëtarët e Partisë, në punën e vrullshme për realizimin e planit të shtetit.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI DISA PROBLEME NË FSHAT

Letër e hapur dërguar rreshterit Safet...

16 mars 1949

Shok,

E mora letrën tuaj të datës 28 shkurt dhe meqë kam marrë edhe disa letra të tjera nga disa shokë, që po më shkruajnë gati për të njëjtat probleme, po ju përgjigjem të gjithëve me anën e kësaj letre.

Është i drejtë kujdesi juaj që tregoni për çështjen e popullit, kjo tregon se ju dhimbset çështja e popullit dhe e Partisë, por më duket e nevojshme t'ju sqaroj juve dhe disa shokëve të tjerë përsa më poshtë:

Ju thoni se sapo jeni liruar nga ushtria dhe tani gjendeni në fshatin tuaj, ku ju ka dërguar Partia të punoni. Pak ditë keni që jeni kthyer në fshat dhe ju më shkruani një letër shumë të dëshpëruar. Duket qartë se ju ka mbuluar pesimizmi, keni rënë në pozita jo të shëndosha dhe arrini në përfundime jo të drejta dhe disa herë shumë të gabuara, duke u mbështetur në disa vështirësi, që me të vërtetë janë, por që përpara këtyre vështirësive të kapërcyeshme ju jeni çarmatosur. Një

qëndrim i tillë nuk është i denjë dhe nuk mund të lejohet, për një nënoficer, që ka hasur vështirësi shumë më të mëdha në jetë dhe sidomos kur është dhe anëtar partie.

Në Ushtrinë Kombëtare, ku ju keni bërë pjesë deri në këto kohët e fundit, çdo gjë ka qenë në rregull: ushqimet, fjetja, ushtrimet, shkolla, rregulli, disiplina. Me të shkuar në fshat ju e keni humbur pusullën, pse keni kujtuar se edhe në fshat do të gjeni të gjitha ato çka latë në ushtri. Këtej rrjedh çorientimi dhe pesimizmi juaj. Vetëm mendoni pak se sa përpjekje i janë dashur Partisë sonë që ta krijojë Ushtrinë Kombëtare dhe të ketë në këtë kaq rregull dhe jetë të mirë. Partia ka punuar me një plan për t'ja arritur këtij qëllimi dhe në realizimin e këtij plani janë hasur vështirësi të mëdha, por përpara këtyre vështirësive, që shumë herë paguheshin me sakrificën e jetës, as Partia, as partizanët, as komandantët dhe as komisarët e ushtrisë sonë nuk u tronditën, nuk u zbrapsën, por i kapërcyen me sukses. A mund të çlirohej Tirana nga thonjtë e okupatorëve gjermanë pa një plan dhe pa sakrifica? Jo, aspak. Ky plan u hartua nga Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë, u studjua mirë nga shtabet e forcave partizane, që do të sulmonin Tiranën dhe çdo partizan e kishte të qartë detyrën, që duhej të përmbushte, detyrë që ishte e vështirë, pse armiku nuk luftonte me trëndafila, por me topa dhe me mitraloza më shumë dhe më modernë se tonat. Urdhëri i Komandës së Përgjithshme u zbatua si duhej dhe u kurorëzua me sukses dhe kjo ngjau, pse u kuptua mirë ky plan i Komandës nga forcat tona, u kuptua qëllimi, u kuptua mirë ç'rrjedhime do të kishte çli-

rimi i Tiranës dhe u muarën parasysh të gjitha sakrificat nga komandantët dhe nga partizanët heroikë. Këtë shembull, ndër shumë të tjerë jua kujtoj, pse më duket se mos e keni harruar, sepse Shqipëria e re nuk ndërtohet pa plan dhe pa luftë, pa mundime dhe pa sakrifica. Letra juaj ma jep këtë të drejtë të dyshoj dhe më detyron t'ju korrigjoj dhe t'ju çel perspektivën, që në këtë çast e keni të errësuar.

Askush nuk mund të jetë në gjendje të provojë se jeta e katundarit tonë nuk është përmirësuar dhe nuk shkon dita-ditës duke u përmirësuar. Po të krahasosh gjendjen e fshatarësisë në kohën e sotme me gjendjen e fshatarësisë në kohën e regjimeve të kaluara antipopullore do të arrish në përfundimin që ajo s'ka barazim, ajo është si dita me natën. Katundari i varfër dhe i mësimi mori tokën pas revolucionit popullor. Shteti që në vitet e para të çlirimit i vuri kujdesin më të madh bujqësisë që kjo të zhvillohej, të përparonte, u çeli bujqve kredit agrar për të shtuar mjetet e punës dhe këtë kredit po e shton dita-ditës; vuri në dispozicion të bujqve mjete pune të reja, të cilat i solli me shumë sakrifica nga jashtë, u vuri katundarëve në dispozicion pleh kimik që të pasuronin tokën e tyre; afro dy vjet pas fillimit të regjimit tonë popullor katundarët s'pagueuanin gati fare taksa bujqësore; pushteti ynë u mësoi katundarëve metodat e reja agroteknike, u çeli perspektivën dhe ua siguroi me ligj hapjen e tokave të reja, me anën e të cilave katundarët shtonin fondin e tokës së tyre, i udhëzoi të zhvillonin frutikulturën dhe të mbillnin bimë të reja industriale. Shteti u ka vënë në dispozicion katundarëve, me çmime shumë të arësyeshme, farën e dri-

thërave dhe të shumë bimëve foragjere; shteti bën përpjekje për seleksionimin sa më të mirë të këtyre farërave, duke sjellë bile nga jashtë farëra të përshtatshme dhe të sprovuara, që mund të rriten me sukses në vendin tonë. Blegtoria ka ecur përpara dhe numri i bagëtive e ka kapërcyer para luftën. Bujqësia jonë ka bërë shumë përparime dhe katundari ynë ka përmirësuar jetën e tij. Ky është një fakt i pamohueshëm. Me mbrojtje tezen se «katundari ynë është i pakënaqur sa s'ka ku të vejë më» është jo vetëm gabim, por kjo është një tezë armike dhe pa asnjë bazë.

Ka me të vërtetë një shtresë katundarësh, që s'janë aspak të kënaqur nga kjo gjendje, që nuk kanë përfitur nga kjo situatë dhe janë të egërsuar dhe të zemëruar sa s'ka më. Kjo shtresë katundarësh janë kulakët. Kjo është e vërtetë. Pra, me mbrojtje tezen se «katundarët tanë janë të pakënaqur sa s'ka më», është të mbrosh tezen e kulakut, të biesh në pozitën e kulakut. Kulaku është hedhur në një ofensivë të tillë, që ta përgjithësojë atë tezë për të rifitur ato që ka humbur përgjithmonë. Kulaku është në ofensivë, pse ai parashikon ditë më të zeza për të. Elementi i pasur në fshat e di mirë se luftën kundër pushtetit popullor nuk mund ta përballojë vetëm me forcat e tija, kjo është e pamundur; prandaj i duhet këtij të gjejë aleatë, të gënjejë njerëz që t'i shërbejnë çështjes së tij dhe të përhapin e të përgjithësojnë parullat e tija. Ju i dini mirë përpjekjet e bejlerëve çifligarë, të borgjezisë së qyteteve dhe të kulakëve në fshat në kohën e reformës agrare. Këta u përpoqën me çdo mënyrë ta sabotonin reformën agrare, ata futën njerëzit e tyre në komisionet e reformës,

ata depërtuan në këshillat e katundarëve të varfër, të krijuara si ndihmëse të ekipeve teknike të reformës agrare. Dhe ata patën disa suksese në veprën e tyre armiqësore. U bënë gabime dhe lëshime në reformë, të cilat u ndreqën dhe po ndreqen dita-ditës. Kulakët e fshatit arritën në shumë raste të mbanin për veten e tyre tokat më të mira dhe mjaft mjete pune, të cilat u kanë shërbyer gjatë këtyre vjetëve të prodhojnë më mirë dhe më shumë bereqet, të krijojnë dhe të fshchin fonde rezervë drithi dhe, me këto fonde rezervë drithi, të fshehura dhe të mbajtura ilegalisht, të bëjnë politikën e grurit, ashtu sikundër e pranon dhe ti në letrën tënde, duke e shitur këtë grurë o misër në treg të zi në katundarët e varfër «me 7 dhe 8 mijë lekë kuintalin ose edhe më shtrenjtë». Kulakët bënë të gjitha përpjekjet që të pengonin katundarët të merrnin tokën që u jepte reforma agrare, ata kanë arritur saqë të bëjnë atentate me bomba kundër katundarëve të varfër që përfituan nga reforma; kleri katolik u mobilizua i tëri që ta shmangte katundarin të merrte tokën, duke i thënë që «toka është e zotit», ose se «shpejt Shqipëria do të okupohet nga anglo-amerikanët dhe mbasandaj do të jepte llogari përpara zotit dhe përpara bejlerëve e kulakëve» e plot gjëra të tilla. Por reaksioni s'pati sukses. Duke qenë në dijeni të këtyre përpjekjeve të reaksionit dhe të fitoreve të pushtetit, të arrihet në konkluzione se tani kulakët dhe borgjezia i hodhën armët, u mundën krejtësisht dhe, pra, s'ka asnjë rrezik prej tyre dhe të pushosh luftën, do të thotë të bësh gabimin më të madh, të çarmatosesh përpara luftës së klasave në fshat dhe në qytet, të çarmatosesh përpara kulakut dhe borgjezi-

së së qytetit, të humbasësh perspektivën dhe të mos jesh në vijën e Partisë, e cila na mëson që lufta e klasave në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm nuk shkon duke u shuar, ajo vazhdon të jetë e ashpër.

Reaksioni juaj i parë, kur të lexoni çka po ju them më lart, do të jetë se «unë i di këto dhe s'i kam harruar». Por unë do t'ju sqaroj se ju këto mund t'i dini, por si formula, që ju kanë mbetur në kokë, por kur vjen rasti që këto formula të mëdha politike t'i lidhni ngushtë me problemet ekonomike, me praktikën e t'i zbatoni duke luftuar, ju nuk arrini dot ta bëni këtë. Jo vetëm, por ju arrini të bëni gabimin e madh, që të luftoni dhe t'i quani si të padrejta armët e shëndosha, që ju vë në dorë Partia juaj, siç janë urdhëresat ekonomike dhe të mos zhvillonin si duhet luftën kundër kulakut, kundër anarkisë në treg, luftën për të krijuar një jetë më të mirë për masat punonjëse të fshatit dhe të qytetit, për të ndërtuar bazat e socializmit në vendin tonë. Ju më flisni në letër, sigurisht, padashur dhe pa u thelluar, me gjuhën e një kulaku dhe jo si një anëtar partie. Ju po luftoni sistemet e reja dhe të drejta të grumbullimit të bereqetrave dhe të mishit, që ka shpallur Partia dhe qeveria dhe që juve jua ka vënë për detyrë të parë t'i zbatoni me përpikmërinë më të madhe.

Pikësëpari ju pranoni se në treg të zi katundari jo-prodhues po e blen misrin «me 7—8 mijë lekë kuintalin» dhe për ta blerë këtë ai shitka «qetë e parmendës». Këtë konstatim ju e bëni, por a thelloheni pse ngjet kjo dhe ç'masa duhen marrë që të ndalohet sa më parë kjo? Ju nuk jeni thelluar aspak, por Partia është thelluar

e ka marrë masa dhe këto masa të drejta janë ato, që ju, anëtar i Partisë, i quani me aq mendjelehtësi «të padrejta». Sipas mendimit tuaj ju kërkoni të luftoni anarkinë në treg dhe në ekonomi, me anarki. Kjo s'është rruga e Partisë, pra, s'duhet të jetë rruga juaj. Unë e pranoj tezën tënde se misër dhe grurë është prodhuar në vendin tonë. Kjo s'ka asnjë dyshim, por fakti është i pamohueshëm se fondi shtetëror i grumbullimit të drithërave për vitin 1948, është reduktuar tri herë nga komitetet ekzekutive të rretheve dhe akoma nga ky fond i reduktuar duhet të grumbullohen edhe 72 000 kv. Pse ka ngjarë një situatë e tillë? Kjo ka ngjarë, sepse zbatimi i urdhëresave të grumbullimit për vitin 1948 është bërë nga njerëzit e pushtetit në një mënyrë shumë të gabuar, pse puna armiqësore e trockistëve ka qenë e madhe në Partinë tonë. Nën influencën e kësaj pune armiqësore u shkelën shumë herë ligjet, u përdor violence dhe druri në disa raste. Kështu që me zbulimin e kësaj pune armiqësore, një numër funksionarësh u çarmatosën për zbatimin e drejtë të urdhëresave. Disa anëtarë partie u zbrapsën në katund e posaçërisht në çështjen e grumbullimit, duke i lënë dorë të lirë kulakut të veprojë, të fshehë misrin dhe grurin, të përhapë parullën në katundarët e varfër e të mesëm se «s'do bëhet më grumbullim» dhe të mos dorëzojnë bereqetin. Kulaku bërtiste më tepër se kushdo tjetër se puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e Koçi Xoxes e kishte goditur rëndë, gjë që s'ishte e vërtetë dhe disa anëtarë të Partisë dhe funksionarë të pushtetit, u gënjyen. Mbaroi puna e grumbullimit, por mbaroi në favor të kulakut. Dhe ata katundarë, që kishin prodhuar

drithë dhe duhej ta dorëzonin (jo badiava, por me pagesë, të kuptohemi mirë), u futën në radhët e të persekutuarve, u futën në radhën e atyre, që gjoja s'kishin prodhuar. Dhe ngjau ajo që thoni ju, që drithë ka, por shitet fshehurazi me 7—8 mijë lekë kuintalin. Këtë treg të zi e bën kryesisht kulaku i fshatit, por këtu s'përrjashtohet që e bëjnë edhe disa katundarë të mesëm. Këta të fundit e bëjnë këtë gjë nga mossqarimi i drejtë i tyre, pse kjo s'është në interesin e tyre.

Trockistët dhe kulakët, me punën e tyre armiqësore, kanë arritur ta influencojnë katundarin e varfër dhe të mesëm në këtë drejtim më shumë nga Partia jonë. Këtë situatë duhet ta njohim, se ndryshe nuk mund të ecim përpara dhe do ta vëmë Partinë tonë në gjumë.

Pra, në këtë anarki, përfitoi armiku i klasës, kulaku, u krijua një anarki në tregun e drithit dhe në tregun në përgjithësi, që është në favorin e armikut dhe që ne duhet ta zhdukim dhe ta vëmë drejt. Kjo do të bëhet me luftë dhe jo me tërheqje, jo me përralla, jo me fjalë të mëdha, që i merr era dhe që halladitin kulakun, por që pak e pickojnë. Është e turpshme dhe skandaloze kur arrihet që disa shokë të rrethit të Korçës, të Fierit, të Lushnjës e të Bregut të Matit të arrijnë të thonë që nuk mund të realizojnë planin e grumbullimit, shumë herë të reduktuar të krahinave të tyre, kur këto krahina janë hambari i vendit tonë dhe ku është fakt se atje po bëhet tregu i zi i drithit nga ana e kulakëve. Këta që pretendojnë gjëra të tilla, janë krejtësisht të çarmatosur dhe në pozita jo të shëndosha, janë në pozita oportuniste dhe kapitulluese. Këta rre-

zikohen të bien në pozitat e Plenumit VIII¹ dhe jo ata shokë, që kanë bërë dhe bëjnë me ndërgjegje detyrën e grumbulluesit, brenda ligjeve dhe urdhëresave të drejta të Partisë dhe të shtetit. Me zbatue drejt dhe pa lëkundje vendimet e Partisë, kjo është një meritë dhe merita më e madhe, pse në këto urdhëresa është parashikuar çdo gjë dhe këto janë në interesin e masave punonjëse, në interesin e fshatarëve të varfër e të mesëm dhe të masave punonjëse të qytetit.

Përkundrazi, me rënë në pozitat individualiste të katundarit dhe të harrosh ose të neglizhosh zbatimin e vendimit të Partisë dhe të qeverisë, kjo është oportunitizëm, që e dëmton katundarin, punëtorin, shtetin, Partinë dhe socializmin.

Ju thoni, shoku Safet, në letrën tuaj se katundari «shet qetë e arës që të blejë misër». Këtu nuk jam dakord me ju dhe kam arësye të mos jem dakord. Nuk mund të them se s'ka ndonjë rast të tillë, por jo ashtu si e paraqitni ju. Katundari ynë qoftë dhe i varfër, nga prodhimet e tij ka fituar mjaft pare. Ky është një fakt dhe kjo nuk mundet të mohohet, pse statistikat shtetërore e vërtetojnë këtë. Katundari ynë ka grumbulluar pare për shumë arësye. E para pse ai tani ka tokën e vet, që e punon, e mbjell dhe e korr për veten e tij dhe jo për beun dhe për aganë. Prodhimet dhe të korrat e katundarit s'kanë qenë të këqia.

¹ Është fjala për Plenumin VIII të KQ të PKSH që u mbledh në shkurt 1948, ku, si rezultat i ndërhyrjes armiqësore të revizionistëve jugosllavë dhe veprimtarisë armiqësore të Koçi Xoxes dhe të grupit të tij, u bënë përpjekje për të shtrembëruar vijën marksiste-leniniste të Partisë.

Kanë munguar edhe prodhimet e fabrikuara në treg, ku ai të mund të blente ose të bënte shkëmbimin. Ky faktor i fundit ka rrjedhur nga puna armiqësore e qeverisë jugosllave të Titos, e cila i shkeli të gjitha detyrimet dhe krijoi një anarki në tregun tonë. Në këtë anarki u futën dhe katundarë të mesëm bile dhe të varfër, që bënë lodrën e kulakut tamam në momentet më të rënda, nga ku kalonte vendi ynë. Puna armiqësore e jugosllavëve në Partinë tonë pati reperkusionet e veta dhe në ekonominë tonë. Këtu ishte qëllimi kryesor i Titos dhe i agjentëve të tij, për ta krijuar këtë krizë ekonomike që kështu Partia jonë të gjunjëzohej dhe të pranonte diktatin e shërbëtorëve të imperializmit, siç janë Titua me shokët e tij. Çmimet e prodhimeve bujqësore u ngritën. Po të jap disa shembuj: në tregun e Tiranës gjalpi shitet jashtë 1 300 lekë kilogrami, pulat 350 lekë, gjeli i detit 1 500 lekë, vezët 15 lekë, preshtë 40 lekë kilogrami etj. Vetë do ta pranosh se kjo është kriminale dhe e padurueshme. Kjo është puna e armikut, këto janë konsekuencat e punës armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe e shërbëtorëve të tyre. Pra, katundari s'ka si të mos ketë grumbulluar pare duke i shitur prodhimet e tij me këto çmime të paligjshme. Ne duhet ta sqarojmë katundarin e varfër dhe të mesëm, se kjo s'është rruga e interesit të tij, por e kulakut, pse në këtë labirinth çmimesh, me ato që fiton katundari, duke i shitur prodhimet e tij me çmime kaq të larta, detyrohet të blejë grurin ose misrin nga kulaku me 7-8 mijë lekë kv. Ai nuk bën gjë tjetër përveçse pasuron kulakun, armikun e tij, por nga ana tjetër, ai bën që të vuajnë masat punonjëse të qytetit, aleatët e tij,

nga të cilët katundari pret vajgurin, kripën, siç thua ti në letër, por ai pret gjithashtu bezen, patkoin, litarin, gozhdën, sapunin e shumë e shumë prodhime të tjera të fabrikuara. Është fare lehtë të arësyetoni ashtu sikundër bëni në letër «se katundari ynë nuk kërkon përveçse vajgurin dhe kripën, që prodhohet në vend dhe duron për ato që sjellim nga jashtë». Ky arësyetim s'është i drejtë. E para, Partia jonë nuk punon që katundarit t'i japë vetëm vajgurin dhe kripën. Partia jonë punon t'i japë katundarit kripën, vajin, rrugën e hekurt, fabrikën e sheqerit, fabrikën e leshit, fabrikën e vajit, t'i krijojë flotën tregëtare, t'i sjellë traktorë, t'i ndërtojë rrugët, shkollat, klubet, spitalet, t'i ndërtojë centralet elektrike, t'i ndërtojë rafineri të tjera të vajgurit, të hapë minierat e kromit, të hekurit, të serës, të bakrit etj. etj. Partia e çon popullin në socializëm, drejt dritës, drejt lumturisë dhe begatisë dhe nuk e çon në mesjetë. Partia punon për sot dhe për nesër, Partia punon për brezat e ardhshëm të vendit tonë.

Por le ta marrim çështjen, për një minutë, thjesht ashtu si e mendoni ju dhe vetë do ta kuptoni se nuk është aq e thjeshtë. Vajguri dhe kripa, që kërkonin ju, nuk mund të vijnë «me këmbët e tyre» në fshat. Këto, në radhë të parë, duhet të nxirren nga nëntoka dhe nga deti. Kripa nxirret nga deti me krahët e punëtorëve dhe vajguri nga nëntoka nxirret me maqina dhe me krahët e punëtorëve. Këto maqina duhet me i sjellë nga jashtë, këta punëtorë duhet me i pague dhe me u sigurue ushqimet, banesat e të tjera gjëra. Duhet me mendue se këta punëtorë nuk kanë përveçse rrogën e tyre mujore dhe rroga e tyre është baras me tre-katër gjela

deti, që një katundar del dhe i shet në treg. Të mos shkojmë më tej se mund t'jua ngatërrojmë problemin dhe nuk do ta kuptoni dot.

Katundarit shteti i ka dhënë të gjitha ato favore, ato ndihma, që përmenda më lart dhe do të vazhdojë t'ja shtojë këto ndihma, pse ndryshe nuk mund të përparojë populli ynë. Katundari, pra, ka pulën, ka vezën, ka qumështin, ka gjalpin, leshin, lëkurën, vajin, drithin etj. etj. Tani vihet pyetja: A është e drejtë që katundari, në bazë të urdhëresave të gabuara të mëparshme, të furnizohet njësor dhe me të njëjtat çmime si punëtori, me sende të fabrikuara? A është e ligjshme dhe e drejtë që ai fshatar, që shiste një gjel deti, vetëm një gjel deti, 1 500-2 000 lekë, ta blente vajin, kripën ose rotkën me penjë njësor si ai punëtori që merr rreth 4 000 lekë në muaj dhe që duhet të kalojë tërë muajin me këto të holla? A është e ligjshme dhe e drejtë që fshatarit t'i siguroheshin nga shteti me triska dhe me çmime të lira të gjitha ato sende të fabrikuara nga punëtori dhe punëtori nga ana e tij të mos gjente një fije presh në treg, të mos flasim për mishin dhe kur e gjente atë presh, ta blente 40 lekë kilogramin? A e gjeni me vend këtë gjendje? Sigurisht jo. Sigurisht, që ju nuk i gjeni të drejta këto gjëra, por e meta juaj është se nuk thelloheni në problemin, se nuk studjoni me vërejtje udhëzimet e Partisë dhe të qeverisë.

Tani duhet me u gjetë një rrugëdalje këtyre gjërave dhe rrugëdalje ka. Partia jonë e ka gjetë si kurdoherë rrugën e drejtë.

Të marrim çështjen e urdhëresave të reja të grumbullimit të mishit dhe urdhëresat e tjera. Ju gaboheni

rëndë kur këto i quani të padrejta, ju kështu nuk e mbronin vijën e Partisë, por e luftoni, prandaj që të mos gaboheni, duhet t'i vini vetes si detyrë të parë të thelloheni në vendimet dhe në udhëzimet e Partisë dhe t'i zbatoni me vendosmëri; ju duhet t'i vini vetes si detyrë të mësoni dhe të ngriheni, sepse këto probleme nuk janë aq të thjeshta sa mund të zgjidhen me një kalem ose me një letër, që shkruat. Anëtarët e Partisë duhet të jenë në pararojë të masave, por në pararojë konkretisht, me punë, me vepra, me zgjuarësi, me dituri dhe jo me fjalë.

Për të mos pranuar urdhëresat e reja, ju niseni nga arësyetimi duke thënë se katundari s'ka se ç'shpie në dyqanin e shtetit për të shkëmbyer me sende të manufakturuara, për të cilat ai ka nevojë. Nga ana tjetër ju e alarmoni këtë çështje derisa të thoni «se do të shkatërrohet fare bujqësia» etj. Sa mendjelehtësi dhe sa gabim i rëndë! Pse e bëni ju këtë gabim kaq të rëndë? Ju e bëni, sepse jeni në terrenin, që ka pregatitur kulaku i fshatit, i cili është me të gjitha forcat kundër urdhëresave të reja, pse ato janë vdekjeprurëse për të. Kulaku e ka kuptuar këtë kurse ju, që jeni anëtar i Partisë, s'e keni kuptuar. Kulakut të fshatit nuk i intereson kurrsesi që bujqësia jonë të përparojë, që blegtoria të përparojë dhe të shumëzohet; kulaku nuk dëshiron të pasurohet vendi ynë, të ngrihet ekonomia e katundarit të varfër e të mesëm. Ai është kundër aleancës së shëndoshë nën drejtimin e Partisë dhe të klasës punëtore, kulaku nuk don të forcohet pushteti ynë popullor. Ai dëshiron që fshatari punonjës të mbetet prapanik dhe të vijë rrotull pellgut, ku ai e kishte mbaj-

tur nën zgjedhë në kohët e kaluara. Pra, kulaku në fshat punon. Ai lufton kooperativat e ndryshme, ai nxit tregun e zi, ai praktikon në forma të ndryshme fajdenë, ai lufton Partinë, urdhëresat e të gjitha me radhë. Ju, shoku komunist, e keni nënvleftësuar këtë luftë të poshtër të kulakut dhe kjo propagandë e poshtër e tij fillon të zërë vend në disa katundarë.

Të marrim anën që mbroni ju, domethënë që «ka katundarë që s'kanë se ç'shpien për shkëmbim». Ka katundarë të tillë dhe këta janë veçanërisht në malësi. Në këtë terren është lufta e kulakut me Partinë. Kulaku helmatis opinionin duke thënë «ju s'mund të merrni asgjë, pse s'keni se ç'shpieni për shkëmbim. Po të doni vaj ose kripë duhet të shisni qetë» e të tjera gjëra të tilla, pra, sipas tyre «urdhëresat janë të gabuara, janë kundër fshatarësisë». Dhe këtej kurdisen parullat e kulakut: «luftoni urdhëresat», «mos i çoni prodhimet në kooperativë», «i shisni në treg të zi dhe me çmime të larta» etj. Ju, shoku komunist, keni rënë në këto pozita të kulakut dhe mbroni tezën e tij duke thënë se urdhëresat s'janë të drejta, se «katundari s'ka përveçse kaun», se «bujqësia u shkatërrua» dhe se më në fund «fshatarësia është e pakënaqur, sa s'ka ku vete më».

Ju duhet të keni të qartë dhe të jeni plotësisht të bindur se urdhëresat e reja janë plotësisht të drejta dhe të realizueshme. Pa këtë besim nuk mund të ecet përpara dhe ky besim nuk duhet të jetë në formë dogmatike, por i arësytuar. Kështu na mëson Partia jonë. Derisa pranohet me plot ndërgjegje heqja e triskave fshatarësisë, për arësyet, që përmenda më lart, atëhere duhet të pranohet një rrugëdalje pas këtij veprimi.

Çështja është si do të bëhen shkëmbimet: do të vazhdojmë me tregun e zi dhe me anarkinë, apo do të vëmë rregull dhe disiplinë në këta sektorë? Do të ecim me një plan, apo do të shkojmë duke i rënë njëri gozhdës dhe tjetri patkoit, duke lënë katundarin të prodhojë çfarë të dojë ai, sa të dojë ai, si të dojë ai dhe t'i shesë ose t'i përdorë si të dojë ai prodhimet? Gjithashtu edhe në sektorët e tjerë të aktivitetit shtetëror të lëmë fabrikat të punojnë pa plan, të prodhojnë çfarë të duan dhe sa të duan, të lëmë punëtorin të punojë sa të dojë dhe si të dojë, ose nëpunësit të venë në zyrë kur të duan dhe të punojnë sa të duan, të zbatojnë ligjin si të duan dhe kur të duan? Jo, patjetër nuk mund të ecim kështu, se kjo është rrugë e katastrofës, por do të ecim me plan dhe do të luftojmë me ashpërsinë më të madhe për disiplinën e fortë të planit. Kjo e fundit është rruga e drejtë e Partisë dhe për të ecur kështu ka ligje dhe urdhëresa.

Urdhëresat në lidhje me grumbullimet janë nga më të drejtat, por duhet t'i kuptojmë mirë dhe t'ua shpjegojmë fshatarëve mirë dhe jo të veprohet si një anëtar partie i rrethit të Delvinës, i cili e mori gazetën, ku ishin shtypur këto urdhëresa, e lexoi një herë si një roman të mërzhitshëm dhe mbasandaj e hodhi në zjarr, pse s'i pëlqeu. Ai s'mund të jetë një anëtar partie, ai është një këlysh kulaku, që ka hyrë kontrabandë në Parti. Urdhëresa për grumbullimin e drithit ka parashikuar kategorinë e tokës, rendimentin e saj, ka lënë një marzh përqindjeje për korigjime gabimesh, ka bërë përjashtime të ndryshme tokash, ka përjashtuar ato ekonomi private, që kanë deri më 8 dynym tokë, ka

parashikuar të ndreqen gabimet, atje ku është matur gabim toka dhe të ndreqen deri në katund edhe disa gabime në ekonomitë private. Nga ana tjetër urdhëresa u lë të lirë katundarëve të shesin tepricat ku të duan, pasi t'i kenë shitur shtetit detyrimet.

Kjo urdhëresë duhet të zbatohet me rigorozitetin më të madh nga të dy anët: edhe nga pushteti edhe nga fshatarët. Kundër lëshimeve do të merren masat më të ashpra, pse vetëm kështu, shoku komunist Safet, nuk do të ngjasë më këtë vit ajo, që thoni ju që «shitet misri nën dorë 7—8 mijë lekë kv.» Kjo është rruga, s'ka rrugë të tretë. Zbatimi rigoroz i një urdhërese të tillë do të bëjë që populli do të ketë bukë dhe do ta hajë bukën me 6 lekë kg., bile edhe më pak. Për këtë rezultat lufton Partia jonë dhe do të fitojë. Urdhëresa e grumbullimit mbështetet në parimin e shëndoshë, që ja cakton detyrimin fshatarit një herë e mirë dhe e nxit këtë të shtojë prodhimin për të mirën e tij. Në rast se e shohim këtë urdhëresë të grumbullimit nga pozita e kulakut ose nga pozita e ndonjë fshatari tjetër, i cili kërkon të numërojë në vend, të punojë dhe të mbjellë tokën me ato mjete dhe me ato forma, që e ka punuar dhe mbjellë stërgjyshi i tij, ose që nuk çan kokën hiç të përdorë metodat e reja të punës, ose nuk përpiqet të hapë toka të reja, ose të mos t'i bëjë si duhet hyzmet arës, atëherë kjo urdhëresë do të falimentojë. Por kjo nuk do të ngjasë kurrë, pse fshatarësia patriotë e varfër dhe e mesme nuk i shikon këto urdhëresa kështu. Partia dhe pushteti do të jenë vigjilentë dhe zbatimi i drejtë dhe pa lëshime i urdhëresës do ta bëjë fshatarin t'ja ndjejë lezetin kësaj urdhërese, pse kjo është në interesin

e tij dhe kundër armiqve të tij, kulakut me shokë.

Sa me mendjelehtësi e gjykoni urdhëresën e grumbullimit të mishit, shoku komunist Safet! Cila është ajo urdhëresë, që e detyron fshatarin të çojë kaun e vetëm për të shlyer detyrimin, që ka ndaj shtetit? Nuk ekziston një urdhëresë e tillë. Por po ta gjykosh nga pozitat e kulakut ose e një katundari tjetër që s'ka asnjë perspektivë dhe që kërkon të numërojë në vend dhe të lindë dhe të vdesë me një ka në derë, atëhere ekziston ajo urdhëresë dhe ai fshatar do të dëmtohet. Por për fat të mirë bujqësia jonë do të përparojë, blegtoria jonë do të shumëzohet, jeta e fshatarësisë, si e gjithë vendit, do të përmirësohet. Ky është qëllimi i Partisë dhe fshatarësia e varfër dhe e mesme e kupton dhe do ta kuptojë drejt këtë urdhëresë, që është në interesin e tyre dhe kundër armiqve të tyre, kulakut dhe shokëve të tij. Në realitet kjo urdhëresë i kërkon fshatarit një detyrim të arësyeshëm në mish dhe në bazë të tokës që ka. Mishin nuk mund ta fabrikojë nëpunësi në zyrë ose punëtori në fabrikë, ata prodhojnë të tjera gjëra, kurse fshatari merret me blegtorinë. Fshatari ka tokën, ka mundësitë, ka ndihmën e pushtetit të tij, të Partisë së tij, pra, le të punojë, të shtojë bagëtinë e trashë dhe të imtë, të shtojë pulat, gjelat e detit, të shtojë derrat sa të jetë e mundur më shumë dhe le t'i shesë një detyrim të caktuar shtetit, për të furnizuar masat punonjëse të qytetit. Shteti nuk i kërkon kaun e vetëm, por i kërkon një sasi mishi të caktuar në bazë të tokës, që zotëron dhe këtë sasi nuk ja kërkon brenda një dite ose një muaji, por brenda një periudhe prej një viti, ku fshatari ka mundësi të shumta ta krijojë këtë pasuri

në interesin e tij në radhë të parë dhe pastaj në interesin e gjithë popullit. Ju, duke folur për këtë urdhëresë, niseni nga arësyetimi se fshatari nuk ka mish të japë, në vend që të niseni nga arësyetimi që fshatari duhet të ketë mish, të punojë që të ketë mish, se kjo dëm s'i bën, por i bën mirë. Sipas pikëpamjeve tuaja duhet të ngremë duart, të prishim urdhëresat e drejta, të mos të ketë fshatari asnjë detyrim, të mos ta nxitim fshatarin të krijojë, të prodhojë sa më shumë, por të tërhiqemi para kulakut, para armikut dhe të themi kurdoherë «ai s'ka, ai s'ka». Ne e dimë që ka fshatarë që s'kanë, por duhet të bëjmë që të kenë, sepse ndryshe jo vetëm që do të vuajnë, por dhe gjaku i heronjve tanë, që ju përmendni në letër, ka shkuar dëm dhe mbi eshtrat e tyre do të hedhin valle bejlerët, kulakët dhe padronët e tyre, imperialistët anglo-amerikanë.

Nga të gjitha sa thamë më lart, më duket se keni edhe përgjegjen e urdhëresës mbi shkëmbimet reciproke. Do të jetë gabim të shkojmë nga parimi që katundarët s'kanë prodhime për të shkëmbyer dhe kështu vuajnë. Të kemi kujdes nga përgjithësimet dhe nga mentaliteti me numërue në vend dhe me u kënaqë me konstatime. Përkundrazi, Partia dhe shteti e kanë për detyrë t'u hapin perspektiva fshatarëve të varfër, që ata të hyjnë në prodhim. Partia ka menduar për të gjitha këto; shumë herë i ka sqaruar dhe dita-ditës do t'i sqarojë dhe do t'u japë ndihmën që të dalim nga këto situata. Por direktivat e Partisë duhet të studjohen, të vihen në jetë, të zbatohen, pse ndryshe të gjitha mbeten fjalëboshe. Urdhëresat parashikon dhënjen e kuponave

për ata katundarë që u mungon buka, duke u hapur perspektivë dhe duke i drejtuar të venë të punojnë në fabrika dhe në punë botore. Nga ana tjetër duhet që këta katundarë të tërhiqen për të grumbulluar materiale të vlefshme për eksportin ose për vendin. Detyra juaj është të mobilizoni katundarët të mbledhin dhe të çojnë në kooperativa për shkëmbim, valanidhin, bimët medicinale, që ka shumë në vendin tonë, badrën për të nxjerrë alkoolin, gjineshrën, që ka shumë — më duket edhe atje ku jeton në Lapulec — zhugën, lendet, gështenjat, që kalben në pyje të Veriut e shumë e shumë të tjera sende të vlefshme, që bëjnë një pasuri të madhe për vendin tonë. Të zhvillohet artizanati, të prodhohen lugë të drunjta, sende guzhine prej druri dhe prej balte, të prodhohen kupa, varela, krehre e të tjera. Të organizohet gjuctia e egërsirave për lëkurët e tyre të vlefshme e shumë e shumë gjëra të tjera. Në rast se anëtari i Partisë, atje ku punon, nuk i përvishet një pune të tillë dhe t'u çelë perspektiva njerëzve, atëhere s'kemi gjë në vijë, do të vazhdojmë kurdoherë të themi «se fshatari s'ka gjë për të shkëmbyer», «fshatari është i varfër» dhe në vend numëro.

Në vend që ju, shoku komunist, të thoni që «u prish bujqësia nga këto urdhëresa», ju duhet të këshilloni fshatarin se këto janë nga më të drejtat, por duhet më parë të jeni ju të bindur. Në vend që të ankoheni, shoku komunist, se «fshatari s'ka asgjë që të çojë për shkëmbim», i thoni fshatarit dhe ngulni këmbë që në rast se ai ka katër pula, duhet t'i bëjë njëqind pula, të shtojë derrat, të vëjë bagëti dhe këtë ta shtojë çdo vit, t'i drejtojë këto në kooperativa

dhe jo në treg të zi dhe, në vend që ta shesë preshin 40 lekë kg., ta shesë 3 lekë, pse vetëm kështu ai do të ketë beze më shumë, vajguri më shumë, patkoj dhe gozhdë më shumë dhe me çmime shumë më të lira, seç i paguan sot. Ju duhet t'i tregoni dhe ta bindni fshatarin në rrugën e re të përparimit, ku ecën Shqipëria jonë nën udhëheqjen e ndritur të Partisë së Punës. Ta mobilizoni fshatarin e varfër dhe të mesëm në punë, ta bëni atë një forcë të madhe politike dhe ta udhëhiqni në luftën më të ashpër kundër kulakëve, armiq të betuar të popullit tonë. Ju duhet t'i shpjegoni fshatarit se po ndërtohen fabrika, rrugë të hekurta, po ndërtohen ujësjellës dhe centrale elektrike, po sillen traktorë dhe të gjitha janë për të, për të ndërtuar jetën e tij më të mirë, për të siguruar mirëqenjen e popullit tonë, sot edhe nesër dhe për gjithë jetën. Dhe në këtë ndërtim të madh të Shqipërisë së re, kaundari duhet të marrë pjesë aktivisht.

Duhet t'i çelni horizontin fshatarit dhe jo të mbylletni ju në horizontin e tij të ngushtë dhe prapanik. Përpara, kurdoherë përpara të shohë fshatari, t'ja ndritë rrugën fshatarësisë sovjetike, të shohë rezultatet e mrekullueshme të atdheut të socializmit, të udhëhequr nga Partia e lavdishme e Lenin-Stalinit, në shembullin e së cilës ecën dhe Partia jonë e Punës. Shteti ynë ecën me një plan të caktuar dhe që duhet ta zbatojmë atë plan, ashtu si zbatonim planin për çlirimin e Tiranës. Atëhere kishim armiq, por mos harrojmë se dhe tani në ndërtimin e bazave të socializmit kemi armiq, që na luftojnë. Atëhere bëme sakrifica, u vramë, u dogjëm, por edhe tani mos të harrojmë se do të bëjmë sakrifica

për t'ja arritur fitores së socializmit. Me duarkryq dhe me konstatime asgjë nuk fitohet, por me luftë, me përpjekje, me sakrifica çdo gjë fitohet, çdo gjë arrihet, çdo gjë ndërtohet. Komunistët s'ka kala që nuk marrin, ka thënë Stalini. Lenini dhe Stalini, që na ndritën rrugën tonë, kështu na mësojnë të veprojmë, të punojmë dhe të fitojmë. Në fshat duhet të derdhim djersë, të mbathim opingat që nga anëtari i thjeshtë dhe deri te anëtari i Komitetit Qendror. Çështja e mbjelljeve të pranverës të bëhet një fushatë e madhe, jo vetëm me artikuj dhe me fjalime, por me punë, të ngjeshim këpucët me baltën e fshatit, të vemi të udhëzojmë fshatarin, ta ndihmojmë të mbjellë sa më mirë dhe sa më shumë. Por kjo s'mjafton, duhet të vazhdojë kujdesi ynë gjatë punimeve të mëvonshme dhe kjo fushatë, e filluar në këtë mënyrë me mbjelljet, të arrijë në kulm me fushatën e korrjeve, kështu të arrihen rezultatet e dëshiruara nga Partia, nga qeveria, nga populli i gjithë. Të kurorëzohet vepra e madhe e Partisë me suksesin më të madh, të përparojë vendi ynë, të shtohet bollëku, të shpartallohen armiqtë e vendit tonë.

Gjithë shokët komunistë dhe pa parti të mobilizohen në detyrën e shenjtë të popullit dhe të kenë besim në fitore. Shihni sa ndihmë të çmueshme na jep neve Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevike, Stalini ynë i dashur. Vendi ynë ndërton industrinë e tij, fabrikat e tija në saje të materialeve të ndryshme, që na jep Bashkimi Sovjetik me kredi me afate të gjata. Për bujqësinë tonë, që të përparojë, Bashkimi Sovjetik na dërgon traktorë e maqina të tjera përkatëse,

plehra kimike, farëra të zgjedhura bimësh industriale si dhe mallra të konsumit të gjerë. Dashuria e popujve të Bashkimit Sovjetik është e madhe për ne. Ata shokë, që vizitojnë Bashkimin Sovjetik, më thonë se deri në kolkozin më të vogël të Bashkimit Sovjetik, njihet Shqipëria jonë e vogël, ata gëzohen për përparimet e popullit tonë. Këtë mbështetje kaq të madhe, kaq të përzemërt kemi ne te Bashkimi Sovjetik dhe me plot të drejtë populli ynë e do Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike, shokun Stalin. Në punën tonë ndërtime na ndihmojnë dhe demokracitë popullore dhe shteti ynë po përfundon një sërë marrëveshesh të favorshme për ne.

Prandaj nuk mund të jemi kurrë dakord me ju, shok, nuk mund të jemi dakord me pesimizmin tuaj dhe me mënyrën jo të drejtë të shikimit të problemit.

Jam dakord me ju me një pikë dhe kjo është e drejtë kur thua se «ka shumë mungesa në punë, terreni s'punon në rregull, lokaliteti dhe kooperativat s'i furnizojnë në rregull, bëhet punë pas qejfit, kontroll s'ka». Ju ngreni një problem nga më të rëndësishmit, ku Partia duhet të zhvillojë luftën më të madhe, më të ashpër. Ka njerëz të pandërgjegjshëm, të poshtër, armiq, që neglizhojnë punën, që thyejnë disiplinën, që s'kanë ndërgjegje në punë, që s'u dhimbset populli, që s'u dhimbset pasuria e shtetit, që s'kanë dashuri për popullin dhe për atdheun dhe që fshihen nën maskën e demagogjisë, që hiqen si miq, por me punën e tyre ata sabotojnë. T'i godasim këta pa mëshirë, t'i zbulojmë këta, t'i vëmë përpara përgjegjësisë dhe përpara

gjqit. Partia dhe qeveria i dinë fare mirë ku qëndrojnë vështirësitë, por nuk lejojnë që nën mbulesën e këtyre vështirësive të fshihet puna e armikut, e sabotimit. Armiqtë e hapët ose të fshhtë kanë kujtuar për një moment se nga puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e shërbëtorëve të tyre brenda në vendin tonë do të shthurrej disiplina, ndërgjegjja, vigjilenca dhe ashpërsia e Partisë sonë dhe e qeverisë kundër këtyre armiqve të betuar të popullit tonë. Këta, natyrisht, janë gabuar. Tamam në atë situatë të sëmurë ata armiq kanë përfutuar, por nuk do të përfitojnë më pas asaj situatë, pse u spastrua Partia jonë dhe vendi ynë nga elementi trockist i brendshëm dhe i jashtëm. Armiqtë e popullit tentuan të futen në një thes me ata që, me të vërtetë, ishin dëmtuar nga puna armiqësore e Koçi Xoxes me shokë, por Partia jonë ishte vigjilente. Disa shokë, jo të shëndoshë, kanë rënë në pozita oportunisti, po bëjnë tërheqje, po tregohen të butë ndaj elementit armik, gjoja nën frikën e gabimeve që u vërtetuan dhe që e kanë pasur burimin në punën trockiste. Këta shokë nuk janë në rrugë të drejtë. Ndaj armikut s'ka lëshime, as mëshirë, as frikë se gabohe. Kurrë nuk gaboresh po të jesh i ashpër kundër armikut të klasës, në të kundërtën gabohe dhe je akoma në pozitën e Plenumit VIII, pse Plenumi VIII i goditi njerëzit e shëndoshë të Partisë, kurse njerëzit, që gjoja kanë frikë se mos gabojnë, lejojnë të mëkëmbet elementi armik. Të dyja këto veprime kanë një qëllim — shkatërrimin e Partisë dhe të shtetit tonë demokratik.

Është detyra e Partisë dhe e pushtetit tonë t'i sqarojë njerëzit vazhdimisht, t'i edukojë, t'i ndihmojë të

ngrihen dhe të përparojnë. Të gjitha përpjekjet po bëhen në këtë drejtim dhe ka rezultate, por nuk mund të quhen kurrsesi të mjaftueshme. Pa shkuar më larg, nuk ju lejohet juve, anëtar i Partisë, që shkoni në katundin e Lapulecit për të punuar atje, t'i gjykoni çështjet në atë mënyrë të gabuar e të humbisni besimin dhe perspektivën. Duhet të thelloheni në çështjet, të përpiqeni t'i kuptoni mirë problemet dhe t'i zbatoni me ndërgjegjen më të plotë dhe me disiplinën më të madhe, pse vetëm kështu do të ecim përpara.

Duhet të keni besim të madh te populli, në forcat e tija krijuese. Por masat e popullit duhet të shohin te ju, komunist, udhëheqësin që i drejton ato masa dhe nga ana tjetër ju duhet të mësoni shumë prej tyre. Dhe po të veproni kështu, do të shikoni se në realitet fshatarët e varfër nuk mendojnë ashtu si më shkruani në letër; ata mendojnë ndryshe, ata janë më përpara teje, ata kanë besim të madh në të ardhshmen, ata kanë besim të madh dhe dashuri të pakufishme për Partinë e tyre që u dha çdo gjë, që u siguron çdo gjë, që u siguron të ardhshmen e tyre të begatshme dhe të brezave të tyre të ardhshëm. Nuk është e vërtetë se katundari, sikundër pretendoni ju, është armiqësuar nga mungesa e kripës dhe e vajgurit. Patjetër ai dëshiron t'i ketë dhe ka të drejtë, ashtu sikundër ka të drejtë edhe ai punëtori të ketë mishin, preshin dhe fasulet. Dhe që t'i ketë dhe katundari dhe punëtori këto, Partia jonë dhe qeveria jonë punojnë, nxjerrin ligje dhe urdhëresa të drejta që të harmonizohen këto gjëra, që të forcohet aleanca në mes fshatarësisë dhe punëtorisë dhe që fshatarësia punonjëse të shikojë qartë se nën udhëheqjen e klasës

punëtore ajo do të dalë në selamet. Ju këshilloj të shikoni më me vërejtje rreth e rrotull jush nëpër fshatra dhe do ta shihni se fshatari i është përveshur punës për të zbatuar drejt urdhëresat e reja. Fshatari ka filluar të hapë toka të reja shumë e më shumë, ai ka filluar të çelë ugare, ai kërkon jonxhë sa më tepër, ai kërkon nëpër tregje derrkucë për ta shtuar këtë kafshë. Të jeni të bindur se fshatari i varfër dhe i mesëm e ka kuptuar në esencë rëndësinë e urdhëresave dhe dobinë që ai do shohë prej tyre. Përpiquni t'i shihni edhe ju më mirë.

Kam biseduar dhe unë me katundarë të varfër, kam shkuar edhe unë në kasollet e tyre për të parë gjendjen në vend, po ju siguroj se ata nuk kanë qenë në pozitë tuaja. Është e vërtetë se gjendja e tyre nuk ka qenë e shkëlqyer, por aspak alarmante ashtu si tregoni ju, përkundrazi ata ishin me plot besim në punën e tyre, në qeverinë dhe në Partinë e tyre, ata ishin plot shpresa në të ardhshmen. Katundari i varfër lufton me vështirësitë dhe vështirësi ka boll, por vështirësitë janë për të gjithë popullin dhe këtë katundari i varfër e kupton fare mirë dhe ka besim në të nesërmen, ai nuk e shikon çështjen aq ngushtë sikundër e shikoni ju, gjë që nuk ju lejohet, pse jeni anëtar i Partisë që ndërton jetën e re, që ndërton socializmin duke luftuar, duke bërë përpjekje të mëdha, duke sakrifikuar për të ardhshmen e mirë.

Do të jap një shembull: Papritur shkova në kasollen e një katundari të varfër, nga Peza e Vogël e Tiranës dhe bisedova me të. Gjendja e tij ishte e vështirë, por ai kishte marrë tokë, ai kishte hapur tokë të re.

Bisedova me të për çështjet e urdhëresave të reja. Komunistët dhe njerëzit e pushtetit s'ja kishin bërë të qartë dhe bile kur e pyeta se a vinin ndonjëherë komunistët e rrethit të tij në kasollen e tij, ai m'u përgjegj: «Asnjëherë s'kanë ardhur». Kur ja shpjegova qëllimin e urdhëresave fshatarit të varfër të Pezës, që kishte muaj pa marrë as kripë as vajguri as beze, ai m'u përgjegj: «Të gjitha këto do t'i zbatojmë, pse janë të drejta dhe janë të drejta, pse i ka nxjerrë Partia jonë, për të cilën unë ndenja dhe luftova dy vjet nëpër pyje, e cila më dha tokën, për të cilën dy djemtë e mi i kam ushtarë, njëri më është kthyer dhe tjetri qëndron akoma dhe kam shpresë se do të bëhet anëtar partie në ushtri. Unë kam qenë tërë jetën në hasmëri me bejlerët e Ndroqit, por na udhëhoqi Partia dhe ne i mundëm ata, ua muarëm tokën dhe të gjitha ç'kishin dhe tashti s'ndahemi kurrë nga Partia sa të jetë jeta, do të punojmë për sot dhe për nesër e përgjithmonë». Kështu më tha fshatari i varfër Adem Dunga nga Peza e Vogël e Tiranës. Adem Dunga është plak afro 100 vjeç, duart i kishte të zeza si toka, rrobet i kishte të rrecksura, por zemrën e kishte të re. Adem Dunga as nuk dinte se kush isha unë dhe vetëm kur u ndamë, i thashë kush isha. Merr shembull, shoku komunist, nga fshatari i varfër 100-vjeçar Adem Dunga që akoma i mungonin shumë gjëra dhe që tre nipërit e tij të vegjël, zbathur e me këmbë në borë po vërenin gjyshin e tyre të bisedonte me një mik që s'e njihnin, merr shembull nga kjo forcë e Partisë, që sido që Adem Dunga ka 100 vjeç, punon me bindje në të ardhshmen dhe është gati dhe kurdoherë në punë t'i kapërcejë pengesat dhe ta

dojë Partinë me të gjitha forcat e tija të trupit dhe të zemrës së tij të plakur, por kurdoherë të re, të re dhe të çelniktë, pse asaj i dha gjak të ri Partia jonë, Partia e tij.

Të fala shoqërore

Enver Hoxha

Sekretar i Përgjithshëm i Partisë .
së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 66 (139), 18 mars 1949*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**NGA PËRSHËNDETJA DREJTUAR POPUJVE
TË BASHKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI
I MOSKËS ME RASTIN E VIZITËS
SË DELEGACIONIT TË QEVERISË
SË RPSH NË BRSS**

21 mars 1949

Të dashur popuj sovjetikë,

Kam nderin e madh që nga kryeqyteti juaj i lavdishëm të bëhem interpret i ndjenjave më të thella të dashurisë dhe të besnikërisë që ushqen populli shqiptar për ju popujt heroikë të BRSS dhe udhëheqësin tuaj gjenial, Stalinin e madh.

Ne na ka dërguar Qeveria e Republikës sonë Popullore të forcojmë sa më tepër marrëdhënjet tona ekonomike me Bashkimin Sovjetik, i cili na ka ndihmuar dhe po na ndihmon që populli ynë të ngrejë ekonominë e tij e të ndërtojë socializmin.

Populli ynë ju falenderon nga zemra për këtë ndihmë e përkrahje dhe do t'ju jetë kurdoherë mirënjohës juve popujve sovjetikë, qeverisë suaj dhe Stalinit të madh. Në vendin tonë populli punon me të gjitha forcat për ta merituar këtë ndihmë të madhe që po na jepni. Ai ecën në shembullin tuaj të lavdishëm. Me luftën tuaj heroike kundër zaptuesve gjermanë, ju na dhatë mundësinë që edhe ne të fitojmë lirinë. Me ndihmën e ma-

dhe ekonomike ju na ndihmoni të ndërtojmë jetën e lumtur për popullin tonë dhe për brezat e ardhshëm të atdheut tonë. Politika e lavdishme staliniane për mbrojtjen e paqes, e udhëheq popullin tonë dhe gjithë popujt përparimtarë të botës në triumfin e plotë të kësaj kauze të drejtë të njerëzimit përparimtar.

Imperialistët po kurdisin pakte agresive kundër kampit të socializmit, po përgatitin një luftë të re dhe nën maskën e pseudodemokracisë së tyre të fëlliqur, po armatosen, po hartojnë buxhete lufte dhe po lënë mënjane problemet jetike të masave të popullit, të sigurimit të jetës së tyre, si dhe të arësimit, të shëndetësisë etj. Imperialistët po rimëkëmbin fashizmin agresor dhe po e përgatitin atë përsëri për akte të reja kriminale të regjimit të tyre të padrejtësisë dhe të skllavërisë.

Populli ynë i vogël nuk trembet nga kërcënimet e imperialistëve luftëdashës dhe shërbëtorëve të tyre, që sillen rrotull kufive tanë, ai lufton për një kauzë të drejtë, ai urren luftërat grabitqare, ai don paqen dhe lufton për paqen.

Të gjitha tentativat e nxitësve të luftës do të dështojnë. Kjo është bindja e plotë e popullit tonë, pse luftën për mbrojtjen e paqes së njerëzimit e udhëheq Bashkimi i lavdishëm Sovjetik me në krye Stalinin e madh.

Rroftë Bashkimi Sovjetik!

Rroftë Stalini i madh, udhëheqësi i lavdishëm, miku dhe dashamirësi më i shtrenjtë i popullit tonë të vogël!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 70 (143), 23 mars 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 70 (143), 23 mars 1949

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE
TË BASHKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI
I MOSKËS ME RASTIN E LARGIMIT
TË DELEGACIONIT TË QEVERISË
SË RPSH NGA BRSS**

11 prill 1949

Të dashur qytetarë sovjetikë,

Duke u larguar nga kryeqyteti juaj i mrekullueshëm ju përshëndes përzemërsisht në emër të delegacionit qeveritar shqiptar dhe në emrin tim, duke ju shfaqur njëkohësisht falenderimet dhe mirënjohjen tonë më të thellë për mikpritjen tuaj bujare dhe për simpatinë e madhe që ushqeni për popullin tonë, i cili do të ruajë si gjënë më të shtrenjtë dashurinë e madhe që ka për Bashkimin Sovjetik dhe për Gjeneralisimin Stalin dhe do të vërë të gjitha forcat që të çelnikosen çdo ditë e më tepër marrëdhënjet e ngushta të miqësisë në mes popujve tanë.

Ne jemi shumë të gëzuar dhe të entuziazmuar për punën e madhe ndërtimore dhe paqësore që bëhet në vendin tuaj. Fabrikat e shumta, institucionet e shkencës, të kulturës dhe të artit që ne kemi vizituar, vërtetojnë

madhështinë e rendit socialist dhe përparimet e pakrahasueshme në çdo lëmë të aktivitetit të jetës së Bashkimit të madh Sovjetik, kështjellë e pamposhtur e paqes dhe mbrojtës i lavdishëm i popujve të mëdhenj e të vegjël.

Ne falenderojmë nga zemra qeverinë sovjetike dhe udhëheqësin gjenial të popujve sovjetikë, Stalinin e madh, që me përzemërsi të madhe i muarën parasysh kërkesat ekonomike të popullit shqiptar dhe i siguruan këtij një ndihmë të çmueshme, e cila do ta ndihmojë fuqimisht të ndërtojë jetën e tij më të mirë.

Rrofshin popujt e Bashkimit Sovjetik!

Rroftë udhëheqësi i popujve sovjetikë, Stalini i madh!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 87 (160), 12 prill 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 87 (160), 12 prill 1949

**NGA FJALA PARA POPULLIT TË KRYEQYTETIT
ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT
TË QEVERISË SË RPSH NGA VIZITA NË BRSS**

11 prill 1949

Popull shqiptar,

Delegacioni qeveritar shqiptar, që shkoi para tri javëve në Bashkimin Sovjetik, u prit në qytetin e lavdishëm të Moskës me përzemërsinë më të madhe. Qeveria sovjetike dhe kryetari i saj, Stalini i madh, na shprehën me fjalët më të ngrohta simpatinë e madhe që ata ushqejnë për popullin tonë punonjës dhe heroik, ata u treguan si kurdoherë të gatshëm për të ndihmuar popullin shqiptar në lëmin ekonomik dhe kultural.

Ndaj kërkesave të delegacionit shqiptar, nga ana e udhëheqësve sovjetikë u tregua një mirëkuptim i madh dhe një kujdes i veçantë për të na përmbushur nevojat e popullit tonë në mënyrën më të drejtë, të dezinteresuar dhe të shpejtë.

Qeveria sovjetike i akordoi përsëri popullit tonë një kredi të çmueshme, me të cilën populli ynë siguroi ngritjen e një sërë fabrikash të reja si ajo e çimentos, e drurit, rafinerinë e naftës etj., që i shtohen serisë së kom-

binateve të para si ai i tekstilit, i sheqerit, i lëkurëve etj., që na janë akorduar më parë. Nga ana tjetër me anën e këtij krediti të ri të çmueshëm, shteti ynë siguron pajisje të reja industriale për fabrikat tona ekzistuese, për ngritjen dhe funksionimin e hidrocentralit të Selitës, të fabrikës së stofrave të leshit, për shtimin e prodhimit të naftës dhe të minierave, për zhvillimin e mëtejshëm të rritit tonë hekurudhor etj.

Krediti që na akordoi Bashkimi Sovjetik në mënyrë bujare dhe me kondita të favorshme për popullin tonë është një bazë e shëndoshë për ngritjen e ekonomisë sonë, është mbështetje për përpjekjet e drejta, që bën dhe do të bëjë populli ynë për të ngritur industrinë e tij, për ta rritur këtë industri, e cila duhet të shtojë dhe të zhvillojë pasuritë tona dhe të kënaqë kështu nevojat e popullit. Nga ana tjetër, qeveria sovjetike i akordon Shqipërisë me shkëmbim, mallra të konsumit të gjerë për nevojat e popullit dhe këto në kondita shumë të favorshme.

E gjithë kjo ndihmë e madhe si edhe ajo, po aq e rëndësishme në lëmin kultural dhe sidomos teknik duhet t'i shërbejnë popullit tonë si një mbështetje e shëndoshë për ndërtimin e bazave të socializmit dhe njëkohësisht si një frymëzim i fuqishëm për të shtuar përpjekjet e tija në punë, për një prodhim sa më të madh.

Duke e pasur këtë mbështetje nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë, si dhe nga demokracitë popullore motra, Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, populli ynë duhet t'i përvishet punës me forcë të dhjetëfishuara, të forcojë ndërgjegjen e disiplinën në punë, të forcojë ndjenjën e kursimeve, të shtojë sa

më shumë prodhimet e çdo lloji. Duhet të luftojmë konkretisht për këto, pse njëkohësisht me ndihmën që na jepet, populli ynë merr dhe detyrime, të cilat duhet t'i plotësojë me nder dhe medoemos. Vetëm kështu kuptohet solidariteti dhe ndihma reciproke në kampin tonë të socializmit, vetëm kështu ndërtohet socializmi, jeta më e mirë.

Kështu duhet ta kuptojmë këtë ndihmë që na akordohet nga Bashkimi Sovjetik dhe të ecim të vendosur në shembullin e lavdishëm të popujve sovjetikë: të punojmë si punojnë ata, ta duam atdheun si e duan ata atdheun e tyre, t'i duam popujt e tjerë ashtu si i duan ata, ta duam Stalinin e madh, mikun më të shtrenjtë të popullit tonë ashtu si e duan ata.

Delegacioni ynë vizitoi në Moskë shumë fabrika, uzina, institucione shkencore, kulture dhe atje pa gjëra të mrekullueshme, që kanë mundur të krijojnë e të ndërtojnë popujt sovjetikë, nën udhëheqjen e bolshevikëve e të Stalinit të madh, në të gjitha fushat e aktivitetit ekonomiko-shoqëror si dhe në shkencë, teknikë, në art e kulturë.

Njerëzit sovjetikë i frymëzojnë një patriotizëm i madh dhe një dashuri e papërshkruar për Partinë e lavdishme të tyre Bolshevike dhe kryetarin e tyre, Stalinin e madh.

Gjatë gjithë vizitave qemë dëshmitarë të një dashurie të madhe që ushqejnë popujt sovjetikë për popullin tonë. Udhëheqës, punëtorë, inxhinierë, teknikë, nxënë, studentë, kalamane të shtëpive të fëmijëve, të gjithë na flisnin me dashuri për popullin tonë, kërkonin të mësonin sa më shumë për vendin tonë. Këto ishin

shprehje të internacionalizmit të popujve sovjetikë, që i duan popujt e tjerë e që i ndihmojnë ata pa u kursyer.

Me të gjitha forcat tona të forcojmë dita-ditës marrëdhënjet kaq të ngushta dhe miqësore që ekzistojnë në mes të popullit tonë dhe popujve të Bashkimit Sovjetik.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Bashkimi Sovjetik!

Rroftë Stalini i madh!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 87 (160), 12 prill 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit» Nr. 87 (160), 12 prill 1949

**«MBI MASAT E MARRURA PËR ZBATIMIN E
VENDIMEVE TË KONGRESIT I TË PKSH DHE
DETYRAT QË SHTROHEN PARA PARTISË
DHE POPULLIT»**

Raport në Plenumin II të KQ të PPSH

28 prill 1949

Të dashur shokë,

Përpara Partisë dhe popullit shtrohen probleme të rëndësishme në të gjithë lëmet e aktivitetit. Prandaj në këtë mbledhje të zgjeruar të Plenumit të KQ duhet të diskutojmë mbi këto probleme dhe detyra të mëdha që kemi përpara ne dhe gjithë Partia. Që t'i kryejmë këto detyra jetike, duhet që Partia të jetë me tërë kuptimin e fjalës në krye të punës. Duhet të ngjallet dhe të forcohet ndjenja e plotë e përgjegjësisë së Partisë në tërësi dhe e çdo komunisti veç e veç ndaj popullit tonë dhe kampit të socializmit.

Detyrat do t'i kryejmë me sukses atëhere kur Partia jonë të jetë e gjitha e mobilizuar, të njohë mirë problemet dhe t'i zgjidhë drejt në vijën marksiste-leniniste, kur pastërtia e vijës së Partisë dhe Partia vetë të ruhen si drita e syrit nga armiku i klasës dhe i popullit,

kur ta kemi luftuar me sukses presionin e borgjezisë dhe të imperializmit, që kërcënojnë në çdo moment veprën tonë ndërtimtare, që përpiqen të luftojnë e të sabotojnë në mënyra të ndryshme realizimin e planit dhe politikën e drejtë të Partisë, kur të kemi ngjallur dhe forcuar si duhet në masat e Partisë dhe të popullit punonjës ndjenjat revolucionare, disiplinën e hekurt dhe përgjegjësinë në punë dhe në detyrë, kur të kemi bërë që patriotizmi i flaktë i masave të gjera punonjëse dhe uniteti i popullit të çelnikosen dita-ditës më shumë në punë krijuese dhe përballë kërcënimeve e shantazheve të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

Partia jonë është një parti revolucionare, plot gjallëri e vitalitet, ajo ecën gjithmonë përpara, mbron me vendosmërinë më të madhe dhe me konsekuencë marksizëm-leninizmin, ndërton bazat e socializmit në vendin tonë; lufton në krye të popullit të vet për një jetë më të mirë, lufton për mbrojtjen e paqes së vazhdueshme që kërcënohet nga luftëdashësit imperialistë.

Në Kongresin I të saj Partia jonë përcaktoi drejt vijën, që do të ndiqte në të gjitha fushat dhe pas kongresit çështja shtrohej që e gjithë Partia të mobilizohej në këtë vijë, ta zbatonte deri në fund këtë vijë në të gjithë kompleksitetin dhe dinamizmin e vet dhe në dialektikën e saj marksiste-leniniste. Partia jonë, sikundër e dimë, doli nga një gjendje e rëndë dhe shumë e vështirë ku e kishin futur trockistët jugosllavë dhe armiqtë e brendshëm të Partisë shonë; shumë gabime të rënda ishin vërtetuar në Parti, që do të ishin katastrofale për të dhe për popullin tonë, po të mos kishin ardhur Letrat e KQ të PK(b) të BS drejtuar KQ të PKJ dhe Re-

zoluta e Informbyrosë.¹ Partia jonë e mundi atë situatë armiqësore, ajo doli më e fortë se më parë, por pas kongresit i ngarkohej barra e rëndë dhe e vazhdueshme të ishte vigjilente kundër armiqve trockistë, kundër pikëpamjeve dhe metodave të tyre armiqësore, i vihej detyra të korrigjonte gabimet e vërtetuara, të edukonte njerëzit dhe sidomos ata me frymë të sëmurë, konsekuencat e së cilës nuk mund të zhdukeshin me një dekret, por me një punë të madhe, të matur, të pjekur, revolucionare.

**SI U MOBILIZUA PARTIA NË VIJËN E DREJTË
QË I ÇAKTOI KONGRESI. CILAT KANË QENË
SUKSESET DHE TË METAT**

Unë do të përpiqem t'i analizoj këto në këtë raport dhe në dritën e kësaj analize të mundim të nxjerrim detyrat e reja, që do ta forcojnë më tepër Partinë tonë dhe punës sonë do t'i japin një hov të ri krijues.

Do ta filloj nga gjendja politike ndërkombëtare, me qëllim që të kuptohet mirë politika që duhet të ndjekim përpara situatave që po zhvillohen. Për Partinë dhe për popullin ka qenë kurdoherë e qartë politika e vendosur dhe konsekuente që duhet dhe po ndjekim ndaj imperializmit amerikan dhe anglez e satelitëve të tyre, të cilët kërcënojnë botën me një luftë të tretë botërore dhe vendosmëria jonë, e popullit dhe e Partisë, për të luf-

¹ Është fjala për Rezolucionin e Byrosë Informative të disa partive komuniste e punëtore «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave» që u aprovua në muajin qershor të vitit 1948.

tuar me të gjitha forcat tona në kampin demokratik antiimperialist, për mbrojtjen e paqes së vazhdueshme. Politika paqësore staliniane është orientimi bazë i Partisë dhe i popullit tonë. Kundër kësaj politike është mobilizuar i gjithë reaksioni ndërkombëtar nën udhëheqjen e imperializmit amerikan. Orvatjet, përgatitjet dhe provokacionet e imperializmit po shtohen dita-ditës me qëllim që të përgatitin terrenin dhe t'i japin shkas një kasaphane të re. Imperializmi amerikan, duke u ndihmuar fuqimisht nga ai anglez, francez, italian etj., përpiqet të vendosë hegjemoninë e tij në të gjithë botën dhe për këtë atij i duhet të ndezë luftën kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore, armiq të be-tuar të tij dhe njëkohësisht të shtypë me terror popujt e Evropës Perëndimore dhe popujt e tjerë të botës, që aspirojnë për paqe dhe luftojnë për lirinë dhe demokracinë.

Doktrina e Trumanit po zbatohet nga imperializmi amerikan me egërsinë më të madhe. Lufta civile në Greqi, në Indonezi dhe në shumë vende të tjera të Azisë, po nxitet prej imperializmit amerikan dhe po merr proporcione të gjera kërcënuese e provokuese. Fashistët e këtyre vendeve qëndrojnë në fuqi dhe ndihmohen haptas nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës me kredi të mëdha në dollarë dhe në armatime, për të shtypur lëvizjet revolucionare dhe kryengritjet popullore në këto vende, për të krijuar baza detare, tokësore dhe ajrore me qëllim agresioni dhe lufte kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Plani skllavërues Marshall, që po zbatohet prej kohësh në vendet e Evropës Perëndimore, ka për qëllim kolonizimin e këtyre vende-

ve, hedhjen në dorë të ekonomive të tyre nga ana e imperializmit amerikan, që me ndihmën e veglave vendëse po orvatet të shtypë popujt e Evropës Perëndimore, të skllavërojë klasën punëtore, të shpartallojë partitë komuniste të këtyre vendeve dhe të rimëkëmbë kështu Gjermaninë naziste, ta bëjnë këtë një «place d'armes» për qëllimet e tyre agresive kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Frutet e planit imperialist Marshall janë katastrofale për popujt e Evropës Perëndimore. Pakti i Brukselit¹ dhe Pakti i Atlantikut² nuk janë përveçse pakte agresive dhe lufte kundër kampit të socializmit. Me këto pakte agresive, në kundërshtim me Kartën e OKB-së, imperializmi amerikan dhe anglez po kërcënon haptas paqen botërore, Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore.

Përpara këtij kërcënimi serioz të paqes së përbotshme, të qytetërimit dhe të ardhshmes së brezave të rinj, gjithë popujt e botës janë çuar në këmbë për të mbrojtur paqen që rrezikohet nga imperialistët. Kongresi i partizanëve të paqes që u mbajt në Paris³ është

¹ Pakt ushtarako-politik agresiv. U nënshkrua më 17 mars 1948 në Bruksel nga Anglia, Franca, Belgjika, Holanda e Luksemburgu. Një nga hallkat e Paktit të Atlantikut Verior.

² Blok ushtarak agresiv. U nënshkrua më 4 prill 1949 në Uashington nga përfaqësuesit e SHBA-së, Anglisë, Francës, Belgjikës, Hollandës, Luksemburgut, Kanadasë, Italisë, Portugalisë, Norvegjisë, Danimarkës, Islandës. Në vitin 1952 me të u bashkuan Greqia dhe Turqia, ndërsa në vitin 1955 hyri edhe Republika Federale Gjermane.

³ Është fjala për Kongresin e parë botëror të partizanëve të paqes, i cili i zhvilloi punimet nga data 20-25 prill 1949 në të njëjtën kohë edhe në Paris edhe në Pragë, për arsye se qeveria

shprehja legjitime e miliona e miliona njerëzve të thjeshtë të të gjithë botës, që ngrenë zërin e tyre të fuqishëm e demaskojnë orvatjet e planet e imperializmit agresor dhe luftëdashës. Popujt janë kundër luftërave grabitqare, ata janë për paqen dhe e mbrojnë këtë me të gjitha forcat e tyre. Ata s'duan që të përsëriten tmerrret e luftës, që solli si konsekuencë humbjen e kaq miliona njerëzve dhe pasurive të paçmueshme, të ndërhuara me djersën e masave punonjëse për të mirën e njerëzimit. Liria është e shtrenjtë për popujt e botës. Për ta fituar dhe për ta ruajtur, ata kanë derdhur dhe derdhin rrëke gjaku, ndërgjegjja e popujve është e lartë, lufta e tyre është e drejtë, e ashpër dhe konsekuente për paqen, prandaj kauza e paqes do të fitojë, kurse manevrat dhe përgatitjet e luftës nga ana e imperialistëve do të dështojnë. Paqja do të triumfojë dhe kjo varret nga përpjekjet dhe lufta e vazhdueshme që do të zhvillojnë popujt e botës, të bashkuar si një trup i vetëm në kampin demokratik antiimperialist, rreth Bashkimit Sovjetik.

Partia dhe populli ynë duhet t'i kuptojnë si duhet këto situata nga ku kalojmë, rëndësinë e jashtzakonshme të tyre dhe të mobilizohen me të gjitha forcat për këtë çështje të madhe. Mobilizimi i Partisë dhe i popullit për mbrojtjen e paqes do të thotë mbrojtja e popullit tonë, mbrojtja e lirisë, e independencës, e sovranitetit, e këtyre fitoreve të shkëlqyeshme të Luftës nacional-çlirimtare. Lufta për mbrojtjen e paqes duhet të

franceze u refuzoi vizat përfaqësuesve të Polonisë, Bullgarisë, Rumanisë, Shqipërisë dhe të disa vendeve të tjera.

mos bëhet në asnjë mënyrë në forma sloganesh ose me parulla të mërzitshme, me shprehje bombastike dhe të zbrazëta e pa kuptim, por kjo çështje të merret me seriozitetin më të madh nga Partia jonë. Duhet të çelnicohet patriotizmi i popullit tonë, të forcohet uniteti i tij revolucionar rreth Partisë, të luftojmë pikëpamjet ekstremiste dhe antimarksiste që mund të shfaqen dhe që të çojnë në gabime të rënda dhe në konsekuenca të rrezikshme, të kemi kurdoherë parasysh se ndërtojmë socializmin në një kohë kur kërcënimi është i madh nga ana e imperializmit. . .

Ndër shërbëtorët e ndytë dhe besnikë të imperializmit bën pjesë edhe trockisti Tito me klikën e tij tradhëtare, që sundon sot mbi popullin dhe Partinë Komuniste Jugosllave. Kjo klikë tradhëtare po e lidh Republikën e Jugosllavisë pas qerres së imperializmit dhe populli jugosllav është duke humbur lirinë dhe pavarësinë e tij. Partia Komuniste Jugosllave po shndërrohet në një vegël policie për të mbrojtur hegjemoninë e klikës, për të zbuluar, vrarë, burgosur dhe torturuar militantët antititistë. Në Jugosllavi sundon regjimi policor, sundon terrori, demagogjia. Klika e Titos po grumbullon rreth vetes gjithë borgjezinë reaksionare; me masat ekonomike etj, megjithëse i propagandon këto si masa «socialiste», ajo po u vë minat çdo baze ekonomike e politike për socializmin.

Klika e Titos dhe shërbëtorët e tyre trockistë në vendin tonë, me Koçi Xoxen në krye, kanë punuar sistematikisht brenda në Parti dhe në vendin tonë për të krijuar situata të favorshme për realizimin e planeve të tyre. Prandaj, duhet të forcohet vigjilenca në Parti

dhe në shtet dhe të ruhet shteti dhe Partia nga agjentët e tyre të hapët dhe të maskuar. Duhet të forcohet dhe të shtohet lufta e pamëshirshme kundër këtyre elementëve dhe Partia e populli të mobilizohen kundër këtij rreziku, i cili s'duhet të nënvleftësohet. Të kuptojnë mirë Partia dhe populli se ç'fshihen nën parullat demagogjike të klikës së Beogradit, e cila ka për qëllim të armiqësojë popujt e Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore.

Shqipëria ka qenë në një rrezik të madh nga banda e Titos, e cila ka pasur për qëllim të ndërronte situatën në vendin tonë me anë të forcës dhe me ushtrinë e saj, që ajo përpiqej të sillte në vendin tonë, gjoja për ta mbrojtur nga kërcënimet e Greqisë monarko-fashiste. Imperializmi, me anën e agjentit të tij Tito, kërkonte të realizonte atë që ai s'mundi dot të arrinte me kërcënime, me shantazhe, d.m.th. okupimin e Shqipërisë, copëtimin e saj dhe krijimin e një fronti unik në Ballkan: Jugosllavi, Shqipëri, Greqi, kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Kjo pjesë e planit të imperializmit e të Titos dështoi. Titua po përdor të njëjtat metoda që përdorin klikat antipopullore në Evropën Perëndimore në shërbim të amerikanëve. Ai s'është veçse një Caldaris¹ i dytë që po e kthen Jugosllavinë në një qendër të rrezikshme për paqen në Ballkan.

Komiteti Qendror dhe qeveria jonë duhet të kenë parasysh se vendi ynë është rrethuar me armiq: në Veri

¹ Udhëheqës politik reaksionar i Greqisë monarko-fashiste. Pas Luftës së dytë botërore me porosi të imperialistëve anglezë shtypi me gjak luftën civile në Greqi dhe vendosi regjimin monarkik.

kemi trockistët jugosllavë, në Jug monarko-fashistët grekë, në Perëndim neofashistët italianë dhe që të gjithë punojnë dhe konspirojnë kundër Republikës sonë Popullore, ata provokojnë në çdo çast dhe do të vazhdojnë të provokojnë edhe më shumë, do të përpiqen të krijojnë incidente, shantazhe, prandaj varet nga ne që të bëjmë një politikë të vendosur dhe të matur, të ruhemi dhe të evitojmë provokacionet, të mos biem në kurthin e tyre. Kjo ka një rëndësi të madhe. Imperialistët përpiqen të na izolojnë, ata duan që Shqipëria të mos ketë marrëdhënje me vende të tjera. Por qeveria jonë do të bëjë një politikë të drejtë edhe në këtë fushë dhe rezultatet po duken. Nga ana e qeverisë italiane janë bërë përçapje për të lidhur marrëdhënje diplomatike me ne, të cilave qeveria shqiptare u është përgjegjur pozitivisht. Siç dihet, ne jemi për marrëdhënje diplomatike edhe me Amerikën e gjithashtu me Anglinë, por ne nuk do t'u njohim atyre marrëveshjet skllavëruese që kishte përfunduar me to qeveria e Zogut. Duhet gjithashtu të përpiqemi të vendosim marrëdhënje diplomatike edhe me shtetet si Norvegjia, Danimarka e Finlanda. Përsa u përket marrëdhënjeve me demokracitë popullore të Mongolisë dhe të Koresë, përçapjet e qeverisë sonë janë bërë. Na duhet të punojmë aktivisht për të neutralizuar punën armiqësore të imperialistëve, të trockistëve dhe të emigracionit politik jashtë, të cilët punojnë që të gjithë së bashku kundër demokracisë sonë popullore, me qëllim që ne të jemi të izoluar. Imperialistët kërkojnë ta paraqesin vendin tonë si një vend agresor, gjoja që provokon, gjoja fajtor për luftën në Greqi dhe t'u mbushin mendjen popujve

të tyre, se kjo «çerdhe» duhet spastruar. Ne duhet ta ndërrojmë këtë situatë, të aktivizojmë propagandën tonë e t'u bëjmë të njohur popujve se çështja nuk qëndron ashtu si e paraqesin imperialistët dhe fashistët; ne duhet të krijojmë në masat e gjera punonjëse të vendeve të ndryshme, veçanërisht të vendeve fqinje, një simpati dhe një dashuri për popullin tonë të vogël. Duhet njëkohësisht të mos harrojmë kontradiktat, që ekzistojnë në mes të shteteve imperialiste, që konspirojnë kundër nesh dhe të dimë të përfitojmë nga këto kontradikta në favorin e vendit tonë. Për të gjitha këto arsye ne duhet të bëjmë një politikë të shëndoshë dhe të zgjuar si jashtë ashtu dhe brenda.

Çështja e situatës së brendshme është më e rëndësishmja për ne, pse çdo gjë varet prej kësaj. Sa më të fortë të jemi brenda, aq më i vogël është rreziku i jashtëm. Kongresi I i Partisë vuri në dukje punën armiqësore trockiste dhe dëmet e mëdha që kishte pësuar vendi ynë dhe Partia jonë prej saj. U vërtetuan gabimet të rënda politike në lidhje me disa qëndrime jo të drejta ndaj shtresave të ndryshme të popullit, ndaj fshatarësisë dhe disa intelektualëve etj. Trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe janë përpjekur, duke dobësuar Partinë nga brenda, të dobësonin njëkohësisht dhe lidhjet e saja me masat e gjera të popullit. Qëllimi kryesor i tyre ka qenë të krijonin në masat e popullit të vendit tonë një politikë pasigurie, frike, terrori dhe në këtë drejtim ata kanë punuar aktivisht. Uniteti i popullit tonë, i domosdoshëm dhe grumbullimi i tij rreth Partisë, ishte në rrezik, pse politika armiqësore e trockistëve godiste pa dallim anëtarët besnikë të Partisë dhe njerëz të

tjerë pa parti dhe patriotë, që kishin luftuar për çlirimin e vendit, ose që u lidhën me zemër dhe me interesat e tyre me regjimin e demokracisë popullore që udhëheq Partia. Trockistët krijuan një situatë shumë të vështirë për Partinë duke u përpjekur ta izolojnë atë nga masat e popullit me qëllim që të humbiste besimi i anëtarit të Partisë, jo vetëm te elementët patriotë, me të cilët kishte luftuar, por edhe te shoku i tij komunist. Çdo veprim dhe çdo njeri shpeshherë shikohej me dyshim. Ishtë errësuar pothuaj perspektiva e një bashkëpunimi të ngushtë të Partisë me masat e gjera të popullit dhe Partia pa popullin nuk mund të ecte përpara, të rritej e të forcohej, nuk mund të udhëhiqte dhe të realizonte programin e vet. Nën parulla ekstremiste e veprime arbitrare, armiqtë po e dëmtonin Partinë, po i lihej shteg oportunitizmit, elementi borgjez spekullonte, ai po forconte pozitat e veta dhe synonte të na luftonte nga brenda Partisë dhe nga jashtë. Është e padiskutueshme dhe tanimë e vërtetuar se trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe me shokë, kanë pasur për qëllim që ta bënë Partinë tonë të vepronte në mënyrë policeske, për të mbytur demokracinë tonë popullore dhe për të shndërruar Republikën tonë në një republikë borgjeze në shërbim të imperialistëve, pra, të pengonin hovin revolucionar të Partisë sonë dhe të popullit tonë, të shkatërronin ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë dhe të pushohej lufta kundër imperializmit. Lufta kundër imperializmit agresor për trockistët mbështillej në një tym fjalësh demagogjike, por veprimet dhe puna e tyre çonte ujin në mullirin e imperializmit.

ta forcuar inteligjencien popullore; shkenca dhe kultura marksiste të bëhen të masave të gjera të popullit dhe të jenë kurdoherë në shërbim të interesave të tij.

Dëshiroj të prek edhe një çështje tjetër, që ka rëndësi për ne dhe që Partia duhet ta shikojë drejt, pa e nënvleftësuar. Kjo është çështja e besimeve fetare. Siç dihet, kjo çështje ka të bëjë me ndjenjat e atyre njerëzve që besojnë, por marksizëm-leninizmi na tregon rrugën se si ne t'i çrrënjoshim këto besime fetare pa përbuzur dhe pa luajtur me sentimentet e këtij ose atij besimtar.

Në disa njerëz ekziston pikëpamja se populli ynë nuk beson, se ai e ka braktisur me kohë fenë dhe është krejtësisht ateist. Kjo s'është plotësisht e vërtetë dhe të mos bazohemi në të dhëna të gabuara. Mund të themi se në përgjithësi në Shqipërinë e Jugut populli nuk e praktikon në mënyrë fanatike vajtjen në xhami ose në kishë, mirëpo kjo gjë, nuk do të thotë se ndërgjegjja e të gjithëve është çliruar nga ndjenja e besimit, e zakoneve prapanike shekullore, të lidhura këto me jetën e tij dhe me injorancën e trashëguar nga e kaluara. Të mos harrojmë masën e gjerë të fshatarësisë sonë, e cila përbën shumicën dërmuese të popullsisë dhe ku ekziston injoranca e fanatizmi. Ndërkaq në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut besimet fetare janë më të theksuara. Problemi i fesë në Shqipëri, në të kaluarën ka ekzistuar në forma më të acaruar dhe është përdorur për të ndarë popullin në muslimanë e të krishterë, për t'i futur në grindje dhe në luftë me njëri-tjetrin në dëm të unitetit kombëtar. Në vendin tonë janë bërë

përparime në këtë drejtim dhe nuk mund të themi se çështja e fesë është bërë një problem preokupant saqë të ketë errësuar problemet e tjera. Lufta nacional-çlirimtare, revolucioni ynë popullor, që vuri në lëvizje masat e gjera të popullit tonë, që vuri në lëvizje fshatarësinë e varfër e të mesme, tronditi nga themelitet edhe veprën armiqësore të institucioneve fetare dhe të klerit reaksionar, agjentë të borgjezisë dhe të të huajve. Në këtë valë të madhe revolucionare, u përfshinë edhe një numër klerikësh popullorë dhe përparimtarë, të cilët me qëndrimet e tyre aktive ose neutrale ndihmuan Luftën nacional-çlirimtare.

Në çështjen e fesë, komunistët duhet të udhëhiqen kurdoherë nga parimet e drejta marksiste-leniniste. Marksi ka thënë se «*Feja është opiumi i popullit.*»¹

dhe Lenini thotë se

«...kjo thënje e Marksit është guri themeltar për gjithë botëkuptimin e marksizmit në çështjen e fesë. Të gjitha fetë dhe kishat e sotme, të gjitha organizatat fetare të çdo lloji, marksizmi i shikon gjithnjë si organe të reaksionit borgjez, që shërbejnë për të mbrojtur shfrytëzimin dhe për ta vënë në gjumë klasën punëtore»².

«Engelsi... — vazhdon Lenini — thotë se vetëm lufta e klasës e masave punëtore, du-

1 K. Marks F. Engels. Veprat, vëll. I, f. 415, bot. II rus.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 15, f. 455.

ke i tërhequr në mënyrë të gjithanshme shtresat më të gjera të proletariatit në praktikën shoqërore të ndërgjegjshme dhe revolucionare, është në gjendje t'i çlirojë praktikisht masat e shtypura nga zgjedha e fesë. . .»¹.

Duhet të ruhemi dhe të mos krijojmë ndarje fetare dhe problemin fetar të mos e vëmë në planin e parë, pse kështu ne tërheqim vëmendjen dhe devijojmë masat punonjëse nga lufta revolucionare e klasave, duhet të organizojmë edukimin e masave punonjëse, thotë Engelsi, veprim që do të shpjerë në dobësimin dhe në zhdukjen e fesë.

Kushtetuta e Republikës i jep liri besimit dhe kjo ka një kuptim për të gjitha arësyet që përmenda më lart. Por në vendin tonë, që ndërton shoqërinë socialiste, kisha është e ndarë nga shteti, arësimi gjithashtu është laik dhe kisha është e ndaluar të përzihet në edukimin e brezit të ri sikundër bënte në regjimet e kaluara. Kisha duhet të ketë disa të drejta në ushtrimin e besimit, në edukimin e kuadrove të saj shërbyes, në një numër strikt të kufizuar e vetëm për shërbimet fetare dhe këta të zgjidhen nga djemtë e popullit e patriotë, që të duan atdheun e popullin. Në këtë drejtim duhet të ruhemi nga shfaqjet oportuniste që ta konsiderojmë çështjen e fesë si një punë private dhe ta lëmë atë të bëjë çfarë të dojë. Engelsi ka luftuar kundër tendencave të tilla oportuniste në gjirin e socialdemokracisë dhe ai thotë:

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 15, f. 455.

«...se socialdemokracia e quan fenë çështje private për shtetin, por nuk e quan aspak të tillë për veten e saj, për marksizmin, për partinë punëtore»¹.

Lenini thotë:

«Marksisti duhet të jetë materialist, d.m.th. armik i fesë, por materialist dialektik, d.m.th. që e shtron çështjen e luftës kundër fesë jo në mënyrë abstrakte, jo mbi bazën e një propagande abstrakte, thjesht teorike, gjithnjë të një-llojtë, por në mënyrë konkrete, mbi bazën e luftës së klasës, që zhvillohet në praktikë dhe që i edukon masat më shumë dhe më mirë se çdo gjë tjetër. Marksisti duhet të dijë ta vlerësojë gjithë gjendjen konkrete, të gjejë gjithnjë kufirin midis anarkizmit dhe oportunizmit (ky kufi është relativ, i lëvizshëm, i ndryshueshëm, por ai ekziston), të mos bjerë as në «revolucionizmin» abstrakt, me fjalë, dhe praktikisht të zbrazët të anarkizmit, as në filisteizmin dhe oportunizmin e borgjezit të vogël ose të intelektualit liberal, i cili ka frikë nga lufta kundër fesë, e harron këtë detyrë të tij, pajtohet me besimin te zoti, udhëhiqet jo nga interesat e luftës së klasës, por nga një llogari e ulët, e dobët: të mos u prishet qejfi, të mos largohen, të

¹ Cituar sipas V. I. Leninit. Veprat, vëll. 15, f. 457.

mos tremben, udhëhiqet nga parimi shumë i urtë: «jeto dhe leri edhe të tjerët të jetojnë» etj. etj.

Të gjitha çështjet e veçanta që kanë të bëjnë me qëndrimin e socialdemokracisë ndaj fesë duhet të zgjidhen duke u nisur nga pikëpamja e mësipërme»¹.

Klasa jonë punëtore është shumë e re dhe punëtorët tanë janë fshatarë, në Partinë tonë shumica e anëtarëve janë fshatarë, këtë duhet ta kemi kurdoherë parasysh dhe ka në Partinë tonë njerëz që akoma besojnë te zoti, ka që mbajnë edhe ramazan, por njëkohësisht ata janë të lidhur me Partinë dhe luftojnë. Këtë çështje duhet ta shohim drejt dhe jo të mendojmë t'i përjashtojmë nga Partia përnjëherë këta njerëz, por t'i edukojmë.

U zgjata pak në këtë çështje, pse mendoj që është e vlefshme. Pushteti ynë ka marrë masa të ashpra dhe të drejta kundër elementëve reaksionarë dhe armiq të betuar të popullit dhe vegla të të huajve. Në këtë drejtim, as nuk duhet të lëshojmë, as nuk duhet të zbutemi. Duhet të zhvillojmë vigjilencën revolucionare, por duhet të bëjmë njëkohësisht një politikë të drejtë e të matur me klerikët e thjeshtë të fshatrave të cilët të zhvillojmë ndjenjën e patriotizmit, që ata të punojnë në interes të vendit, të përkrahin veprën ndërtimore të pushtetit, të mos luftojnë ligjet, të mos luftojnë arësimin dhe kulturën etj. Të ndalojmë sharjet, sjelljet

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 15. f. 461.

brutale dhe të paligjshme ndaj elementëve të ndershëm besimtarë, pse këto posaçërisht prekin sentimentet e njerëzve që kanë akoma besim te zoti.

Trockistët jugosllavë dhe agjenti i tyre Koçi Xoxe kanë bërë një politikë posaçërisht antimuslimane. Këta armiq nuk kanë dashur kurrë ta kuptonin drejt këtë çështje. Gjërat që populli i shikon dhe i vë re, ne të mos t'i neglizhojmë dhe, kur duhet, ta kemi parasysh proporcionin e besimeve të ndryshme, që ekzistojnë në vendin tonë dhe mundësitë tona të manevrimit në këtë drejtim janë të mëdha. Një manevrim i tillë i drejtë dhe i urtë forcon dhe lidh ca më tepër masat e gjëra të popullit tonë, akoma të prapambetura, me Partinë dhe me politikën e saj të drejtë dhe tej pamëse.

Zbulimi i punës armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe shqiptarë në vendin tonë, punimet e Plenumit XI dhe më vonë Kongresi I i Partisë, ngjallën në masat e gjëra të popullit tonë një entuziazëm të madh dhe një dashuri të pakufishme për Partinë tonë dhe për Bashkimin Sovjetik, që ndihmoi për shpëtimin e vendit tonë nga një rrezik iminent që e kërcënonte. Politika armiqësore e trockistëve në të gjitha lëmet e aktivitetit të vendit i kishte ndrydhur njerëzit. Populli mori frymë lirisht, sikundër mori frymë lirisht Partia. Ne asistuam në shpërthimin e një entuziazmi të madh të masave dhe në shfaqje prekëse të besimit ndaj Partisë. Kjo forcoi pozitat e Partisë brenda dhe jashtë.

Hovi revolucionar i Partisë sonë, të ringjallur e të pastruar nga një sëmundje e rëndë, hovi revolucionar i popullit tonë gjithashtu, bëri që armiku i brendshëm

të mos mundte dot të përfitonte nga momentet e kritikshme nga ku kalonte Partia dhe vendi ynë dhe propaganda e shfrenuar trockiste e klikës së Beogradit nuk mundi të acaronte situatën tonë të brendshme. Por kjo nuk do të thotë që trockistët jugosllavë qëndruan duarlidhur në këtë situatë të disfavorshme që u krijua për ta. Ata filluan kursin e tyre me një vrull për të konsoliduar agjunkturën e tyre dhe për ta vënë atë në lëvizje, kundër vijës së drejtë të Partisë sonë, kundër Byrosë Informative dhe Bashkimit Sovjetik. Trockistët jugosllavë, të ndihmuar nga Koçi Xoxe dhe shokët e tij, kishin punuar me sistem për të krijuar rrjetin e spiunazhit të tyre në shumë sektorë pune të vendit tonë, të cilin e vunë në lëvizje që në fillimin e zbulimit të veprës së tyre armiqësore. Nga ana tjetër ata u orvatën të marrin kontakt me njerëzit, që kishin gabuar e t'i lidhnin këta pas qerres së tyre dhe u përpoqën të përfitonin, gjithashtu edhe nga ata elementë të pakënaqur, që nuk patën satisfaksion imediat pas Plenumit XI ose pas kongresit. Trockistët jugosllavë dhe armiqtë e tjerë të brendshëm e të jashtëm si dhe agjunkturat e tyre në Shqipëri menduan se do të arrihej një shturje në Partinë tonë e në udhëheqjen e saj dhe Partia nuk do të mundte dot të delte nga situatat e vështira që ishin krijuar. Me gjithë rekomandimet e kongresit u vërtetuan disa teprime, të cilat na kanë dëmtuar, siç ka qenë çështja e konspiracionit, që nuk mund të them se u shtur mjaft dhe ka pasur raste që të jenë dekonspiruar sekretet e shtetit, njerëzit e sigurimit, rrjeti informativ i tij etj. Ky ishte në dëmin tonë dhe armiku përfitoi mjaft nga këto momente.

Situata jonë ekonomike paraqitej gjithashtu shumë e vështirë. Orientimet e gabuara ekonomike, marrëdhënjet me Jugosllavinë, që e shkaktuan këtë krizë ekonomike dhe që jugosllavët kishin punuar sistematikisht në këtë drejtim, mosrealizimi i planit tonë, mungesa e një disipline të hekurt në punë, mungesa e ndërjegjes në shumë njerëz, të cilët përfituan nga këto situata të turbullta, për të ngadalësuar ose sabotuar punën, sollën si rezultat që armiqtë e vendit tonë, agjentët jugosllavë dhe agjenturat e tjera të huaja si ato amerikane, angleze, franceze, italiane, të aktivizoheshin. Grupet e banditëve që ekzistonin nëpër male filluan të vihen në lëvizje dhe trockistët jugosllavë muarën lidhje me ta, për t'i organizuar dhe drejtuar kundër pushtetit tonë. Trockistët jugosllavë gjithashtu filluan të futin elementë diversantë nga kufiri i Veriut në tokën tonë dhe të bëjnë një propagandë intensive që ka pasur për qëllim të nxitë arratisjen e ndonjë elementi për në Jugosllavi. Po kështu, trockistët jugosllavë po orvaten të grumbullojnë rreth vetes armiq të pushtetit tonë, si bajraktarë ose ballistë, t'i armatosin këta për t'i futur në tokën tonë dhe të krijojnë kështu banda të armatosura për luftë dhe për aksione me armë. Aktiviteti armiqësor i trockistëve jugosllavë, që në bazë të fakteve është puqur me aktivitetin armiqësor të agjenturës imperialiste dhe monarko-fashiste greke, synon në organizimin e një kryengritjeje të armatosur për të ndryshuar gjendjen në Shqipëri dhe njëkohësisht për të neutralizuar lëvizjen e brendshme në Jugosllavi kundër regjimit të Titos. Nga informatat që kemi, qeveria jugosllave po grumbullon krerët e reaksionit shqiptar

që janë në arrati si Cen Elezi, Fiqri Dine, Muharrem Bajraktari etj, dhe këtë e bën me qëllime të caktuara që thamë më sipër. Përpara një situatë të tillë Partia në përgjithësi dhe sidomos organizatat e Partisë në Veri, në shumë raste nuk kanë qenë në gjendje të mobilizojnë si duhet popullin për t'i bërë ballë me forcë propagandës armike, për të neutralizuar dhe për të penguar veprimet e armikut. Si rrjedhim, armiku ka arritur të rekrutojë agjentët e tij, të cilët i ka vënë në lëvizje, ai ka mundur të organizojë disa dezertime dhe të përhapë në popull parulla armiqësore, të cilat disa organizata të Partisë nuk kanë mundur t'i luftojnë si duhet dhe, disa prej tyre, ka pasur raste që të kenë rënë në oportunitizëm. Në disa rrethe ligjet nuk janë mbrojtur me rreptësinë dhe vendosmërinë më të madhe; s'janë bërë përpjekje në shkallën e duhur që gazetat, shtypi, të përhapej kudo e të mobilizohej i tërë populli, të ngjallej dhe të forcohej patriotizmi i masave; realizimi i planeve nuk arrihej plotësisht dhe gjendeshin plot arsye justifikimi, prapa të cilave fshihej puna e armikut, e sabotatorëve, e të plogështve dhe që këtu vinte dobësimi i gjendjes ekonomike e politike, nga e cila këto kohët e fundit ka përfituar mjaft armiku. Siç e dini, qeveria bëri amnistinë e të arratisurve. Njëkohësisht, u dërguan edhe forca në ndjekje të banditëve. Mirëpo u konstatua që organizatat e Partisë sidomos ato në Veri, nuk e përdorën si duhet këtë vendim të Partisë dhe të qeverisë, nuk e propaganduan në masën e nevojshme këtë amnisti, që të arrinin në rezultatet e duhura dhe ndihma e Partisë dhënë forcave operuese nuk ka qenë shumë e dukshme. Si pasojë nga 300 të

arratisur politikë e ordinerë, që bredhin nëpër male me grupe të vogla, vetëm nja 60 prej tyre janë dorëzuar.

Përsa i përket organizatës së Frontit, nga analiza që bëri Partia janë vërtetuar gabime, por ka shokë që po bien në gabimin tjetër: ta eliminojnë krejtësisht Frontin dhe të mos punojnë politikisht me masat, gjoja nën pretekstin se këtë punë e bëjnë organizata e sindikatës, e gruas dhe e rinisë. Ky është një gabim i rëndë. Fronti duhet të aktivizohet nën drejtimin e Partisë, ashtu si duhet të aktivizohen dhe të luajnë rolin e tyre edhe organizatat e tjera të masave. Në rast se ne e neglizhojmë këtë detyrë të rëndësishme, do të kemi si rrjedhim edhe një dobësim të madh të punës politike dhe masat nuk do të aktivizohen sa duhet në realizimin e planit. Do t'ju sjell një shembull tipik, që vërteton pikëpamjen e gabuar në këtë drejtim. Deri në kohët e fundit rezultoi se në Patos, qendër kryesore e punëtorisë, nuk ekziston organizata e Frontit, me pretekst se atje ekziston sindikata. Mirë. Por në realitet atje edhe sindikata ka punuar dobët dhe 54 000 gazeta që duhej t'u shpërndaheshin punëtorëve i kishte mbuluar pluhuri në raftet. Atje s'bëheshin as konferenca, por armiku punonte, bëheshin sabotime dhe nuk realizohej plani. Në Kuçovë tri herë ka rënë zjarri dhe ky i vënë nga armiqtë e kamufluar në udhëheqjen e sindikatave. Dy herë i është vënë zjarri Shtëpisë së rinisë, janë djegur disa kooperativa, janë vjedhur dyqane të shtetit, disiplina në punë dhe vigjilenca kundër armikut kanë qenë të dobëta. Këto kanë një burim. Këtu ka diçka që nuk ecën e që duhet të na preokupojë jashtëzakonisht dhe të marrim menjëherë masat. Të jepet

alarmi kudo se armiku punon dhe bile me forcë, kurse disa anëtarë të Partisë, nuk reagojnë energjikisht ndaj presionit të tij, nuk luftojnë si duhet me vendosmërinë më të madhe për të mbrojtur Partinë, për të mbrojtur pushtetin, për të mbrojtur atdheun nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme. Këto rreziqe s'duhet t'i nënvleftësojmë në asnjë mënyrë. Partia duhet të ndjejë mirë përgjegjësinë e madhe që ka përpara popullit, përpara historisë. Momentet janë shumë të vështira. Imperializmi është në ofensivë të tërbuar për të ndezur vatra të reja lufte; trockistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë po punojnë dhe janë në ofensivë kundër atdheut tonë. A do të lejojmë ne që të vazhdohet të punohet dhe të luftohet me këtë ritëm e me këto metoda? Jo, në asnjë mënyrë. Partia jonë dhe populli ynë janë në gjendje, janë të zot t'i kapërcejnë këto pengesa, t'i mundin orvatjet e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, prandaj të luftojmë më me këmbëngulje kundër dobësive e të metave, që përmendëm më lart, të marrim përgjegjësinë dhe të realizojmë deri në fund detyrat që kemi përpara. Të mobilizohemi dhe të mbështetemi fuqimisht në forcat e pashterura të popullit tonë, t'u japim besim njerëzve të ndershëm dhe patriotë, t'i drejtojmë këta në rrugën e Partisë sonë, në rrugën e socializmit, por jo t'i drejtojmë me fjalë boshe dhe bombastike, me parulla të vjetëruara dhe të mërzitshme. Populli i çmon dhe i don njerëzit luftëtarë, njerëzit e sakrificës dhe ecën tok me ta. Por populli i lë në baltë llafazanët e sëmurë, kritizerët, njerëzit pa kurrfarë inisiative dhe të paaftë të nxjerrin një punë nga dora, pse në çdo rast e minutë

nxjerrin njëmijë pretekste, krijojnë njëmijë pengesa që ajo punë të mos realizohet. As Partia as populli s'ka ç'i do ata pseudokomunistë që, përpara interesit të Partisë dhe të popullit, vënë interesin e tyre personal, s'ka ç'i do ata megalomanë dhe arrivistë, të cilët në vend që t'i përvishen punës me ndërgjegje, shikojnë postet dhe gradat, s'ka ç'i do ata njerëz që shikojnë rehatinë e sendet e tyre personale dhe braktisin e shkatërrojnë pasurinë e shtetit dhe të popullit. Partia jonë duhet të reagojë me forcë përpara këtyre problemeve të rëndësishme dhe të mobilizohet e tëra e të hidhet në luftë me të gjitha forcat e saja, pse tani është momenti më tepër se kurrë. Partia jonë tani ka një eksperiencë të madhe dhe njerëzit e saj nuk mund të quhen më njerëz të rinj dhe pa eksperiencë, nuk na lejohen gabime dhe lëshime, pse gabimet dhe lëshimet tona dëmtojnë kauzën e popullit, kauzën e socializmit.

Me situatën e brendshme janë të lidhura ngushtë çështjet ekonomike, të cilat duhet t'i zgjidhim shpejt dhe drejt, pse këtej varet e ardhshmja e vendit tonë, mirëqenja e popullit tonë, ndërtimi i bazave ekonomike të socializmit.

Problemet ekonomike e kanë preokupuar vazhdimisht Partinë dhe popullin tonë, megjithatë, nuk mund të themi se këto probleme janë zgjidhur të gjitha në mënyrë të kënaqshme. Vështirësitë ekonomike ekzistojnë dhe ato janë të mëdha. Gjendja jonë ekonomike u dëmtua jashtëzakonisht nga puna armiqësore e troçkistëve jugosllavë, të cilët jo vetëm që nuk mbajtën angazhimet e tyre, por kishin punuar në atë drejtim që planet tona ekonomike të mos ishin të drejta, të

ishin të fryra, të perealizueshme dhe me orientim të gabuar. Pas kongresit ne u gjendëm në luftë me vështirësi të mëdha ekonomike, të cilat nuk ishte lehtë të kapërceheshin. Partia u mobilizua dhe luftoi, por disa organizata dhe anëtarë të Partisë, në shumë sektorë, u tërhoqën përpara vështirësive dhe disa herë ranë në pozita jo të shëndosha, duke mos i mbrojtur me forcë ligjet dhe urdhëresat e shtetit, duke mos e forcuar disiplinën e planit. Mjaft njerëz të Partisë në këto momente të rënda, nga ku kalonim, nuk kanë qenë në lartësinë e detyrës, që u ngarkohej në sektorin ekonomik. Kjo bëri që të vështirësohej edhe ca më shumë situata. Ndihamat nga Bashkimi Sovjetik erdhën pa u vonuar, që në vitin 1948 dhe ato e frenuan keqësimin e gjendjes sonë ekonomike. Këto ndihma duhet të ishin një nxitje e një forcim i mëtejshëm i besimit në punë e në detyrë për njerëzit e Partisë dhe të pushtetit, të cilët në këtë kohë, kur ishin duke u korrigjuar mjaft gabime, mjaft orientime të shtrembra, duhej të zotëronin më tepër situatën, të frenonin më shumë tregun e zi, të forconin më tej organizimin në të gjithë sektorët dhe të bënin akoma përpjekje të jashtzakonshme për të realizuar planin në të gjithë sektorët. Por këto nuk u arritën në shkallën e duhur. Grumbullimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale nuk bëhej sipas urdhëresave të qeverisë dhe disa shokë ranë në pozita oportuniste, ata u tërhoqën përpara kulakëve dhe disa fshatarëve të tjerë në fshat, të cilët, duke dashur të përfitojnë nga këto situata, fshehën grurët dhe prodhimet e tjera që u bënë armë spekulimi në treg të zi. Në Partinë tonë ishte krijuar një mentalitet i rrezikshëm dhe shumë i dëmshëm,

sipas të cilit, situatën ekonomike në vendin tonë, nuk mund ta shpëtojë përveçse ndihma e ardhur nga jashtë. Nuk mendohej se ndihma nga jashtë është me të vërtetë një faktor i çmucshëm, por njëkohësisht duheshin shtuar përpjekjet brenda, në punë dhe në organizim, për të shtuar prodhimin në të gjithë sektorët, për të bërë drejt shpërndarjen e tyre, për të shtuar rendimentin në punë, për të forcuar disiplinën dhe ndërgjegjen e njerëzve në punë, për të bërë kursime dhe sakrifica, pse momentet ishin për t'i bërë këto më shumë se kurrë. Njerëzit kërkonin të luftonin anarkinë në treg me anarki; përpara ekzagjerimeve, mjaft njerëz të Partisë dhe të pushtetit u treguan të plogësht; përpara kërkesave me vend dhe pa vend, ata s'u treguan shumë të drejtë dhe as të fortë sa duhet; përpara kërkesave të Partisë dhe të shtetit ata s'u treguan shumë të vendosur.

Në këto situata të vështira Komiteti Qendror u shtroi organizatave të Partisë si dhe pushtetit detyra si në fushën e grumbullimit të bereqetit ose të shpërndarjes së produkteve të manifakturuara industriale, ashtu edhe për mobilizimin total të njerëzve për realizimin e planeve, por rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme. Kjo bëri që të vështirësohet jashtëzakonisht situata e tregut. Ishim në «rrezik urie», në një kohë kur bereqet kishte, por ai ishte fshehur dhe shitej kontrabandë në treg të zi me çmime kolosale. Disa anëtarë partie e shikonin këtë gjë jo vetëm pa reaguari, por bashkonin me ankesat e masave edhe pakënaqësitë e tyre, sikur këta ishin të huaj dhe kishin larë duart nga kjo situatë e vështirë. Këta nuk mendonin se si komu-

nistë, ishin edhe vetë nga të parët përgjegjës për këtë situatë. Në çdo moment dhe çdo gjë ata e kërkonin nga lart, alarmonin çështjen e bukës dhe e kërkonin t'u zgjidhej nga lart, kurse vetë s'bënin përpjekje të mëdha për të realizuar grumbullimin e bereqetit, të mishit ose të prodhimeve të tjera dhe nuk mendonin gjithashtu se lart s'kishte as depo as rezerva, pse depot dhe rezervat duhet t'i siguronin ata vetë. Disa nga drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rrethe kërkonin miliona lekë për nëpunësit, të cilët nuk ishin paguar, por ata vetë nuk kishin zbatuar ligjet dhe nuk kishin nxjerrë detyrimet dhe taksat. Këta shokë as nuk mendonin që inflacioni i monedhës sonë ishte i madh dhe duhej frenuar. Drejtuesit e Partisë, bile këtu në mbledhje ka edhe sekretarë rrethesh, që jo vetëm akoma s'kanë kuptuar, por e gjejnë të padrejtë vendimin e qeverisë që të hidhet një sasi mallrash në treg të lirë, për të mundur të tërhiqen sa të jetë e mundur të hollat që ka grumbulluar fshatari. Çështjet shikoheshin dhe shikohen akoma jashtëzakonisht ngushtë dhe në mënyrë të dëmshme. Këto janë shenja të papjekurisë së disa njerëzve dhe tregojnë mungesën e forcës së organizimit, të mobilizimit, mungesën e inisiativës së tyre krijuese. Si rrjedhim, furnizimi i popullit shpeshherë s'ka qenë në rregull. Ka ndodhur që në disa qytete si Gjirokastra e të tjera, të ketë munguar mishi; kjo është skandaloze, pse mishi është në Shqipëri. Shumë rrethe kanë nga tre-katër muaj që nuk kanë marrë kripë e vajguri, të cilat gjithashtu dhe këto janë prodhime të vendit, që ne i kemi, por që nuk janë bërë përpjekje sa duhet që të prodhohen, të nxirren dhe t'i ndahen në

rregull popullit. Tregu i fshatit ka drejtuar dhe ka influencuar tregun tonë shtetëror dhe kooperativist, në vend që këta të fundit ta drejtojnë, ta orientojnë dhe ta kanalizojnë atë. Plot justifikime pa baza nxirren nga njerëz përgjegjës të punës për mosrealizimin si duhet të këtyre detyrave; secili përpiqet t'ja hedhë fajin tjetrit. Kur kërkohet nga KQ ose nga qeveria të realizohet një çështje, përgjegjësi që vihet përpara detyrës, në më të shumtat e rasteve të vë përpara me qindra arsye të justifikueshme dhe të pajustificueshme, që ta errëson krejtësisht problemin dhe ta bën të parealizueshëm. Justifikimi i moskryerjes së punës është në rendin e ditës. Të gjithë njerëzit përgjegjës janë të aftë të konstatojnë, por shumë prej tyre s'janë të aftë të nxjerrin konkluzione dhe të kenë inisiativë të madhe e të marrin masa të shpejta, të organizojnë, të zhdukin vështirësitë, të koordinojnë punët dhe të nxjerrin punën nga dora. Kjo gjë na duhet, por kjo nuk praktikohet si duhet. Vështirësi ka shumë, kjo nuk mund të mohohet, por a na lejohet të çarmatosemi përpara vështirësive, a na lejohet të mos marrim përgjegjësitë në punë? Jo, në asnjë mënyrë. Duhet ta ndërrojmë me çdo kusht këtë situatë, duhet ta përmirësojmë situatën ekonomike të vendit tonë, kjo është në dorën tonë dhe në mundësitë tona.

Për të dalë nga kjo gjendje, për të forcuar ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë, ne kemi ndihmën konkrete të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore. Delegacionet e qeverisë sonë shkuan në Bashkimin Sovjetik e në të gjitha vendet e demokracisë popullore dhe përfunduan një sërë marrëvesh-

jesh për kredi dhe tregtare, në kushte shumë të favorshme për vendin tonë. Pritja e delegacionit tonë qeveritar prej qeverisë sovjetike dhe shokut Stalin ka qenë jashtëzakonisht e përzemërt dhe shoqërore dhe ndihma, që na akorduan, është shumë e çmueshme si nga ana e kreditit, si nga ana materiale, aq edhe nga ana e orientimit që ne duhet të ndjekim në ngritjen e ekonomisë sonë. Qeveria sovjetike na akordoi një kredi prej 110 milion rublash¹. Ky kredit është për katër vjet i ndarë në kuota të barabarta. Me këtë kredi ne siguroam nga Bashkimi Sovjetik një sërë fabrikash të reja siç është ajo e çimentos, rafineria për Kuçovën, fabrika imprenjimi dhe staxhionimi të drurit, fabrikë fuçiasht etj., si edhe material të nevojshëm për përmirësimin e industrisë ekzistuese. Kredia e Bashkimit Sovjetik do të përdoret vetëm për këto gjëra dhe për asgjë tjetër. Nga Bashkimi Sovjetik na vijnë dhe mallra për konsum të gjerë. Bashkimi Sovjetik do të na dërgojë sivjet dy ekipe specialistësh, që të studjojnë, njëri pasuritë e nëntokës sonë dhe tjetri forcën hidroelektrike të ujërave tona. Bashkimi Sovjetik na bëri favore edhe për studentët tanë etj. Përsa u përket shkëmbimeve tregëtare, në mallra konsumi të gjerë ose çfarëdo gjë tjetër, që do të kemi nevojë, këto do të bëhen me shkëmbime reciproke dhe nga sasia e eksportimeve tona do të varen edhe importimet nga Bashkimi Sovjetik. Aq sa do të jemi në gjendje t'i japim, aq do të marrim. Ky është orientimi më i drejtë që mund të bëhet. Bashkimi Sovjetik, me kredi me afate të gjata,

¹ Të vjetra.

siguron ndërtimin dhe zhvillimin e industrisë sonë të lehtë dhe të rëndë, në mënyrë që ne të shtojmë prodhimet tona të nëntokës dhe të mbitokës, të furnizojmë popullin tonë me produkte dhe të shpëtojmë prej importimeve nga jashtë për shumë artikuj të tregëtuar. Nga ana tjetër, na vihet përpara çështja e mobilizimit të të gjithë popullit në punë për realizimin e planit të shtetit në bujqësi, në industri, në transport e gjetkë, për të shtuar prodhimet tona për popullin dhe për eksportimet. Në rast se ne dëshirojmë të importojmë mallra, duhet edhe ne të bëjmë përpjekje të eksportojmë nga prodhimet tona. Duhet t'u jepet fund pikëpamjeve të gabuara që mund të kenë mbetur në kokën e disa njerëzve, që mosrealizimin e planit tonë, vështirësitë ekonomike, që janë si rrjedhim i kësaj, të kërkojmë të na i përmbushin të tjerët.

Gjithashtu edhe nga ana e vendeve të demokracisë popullore na u akorduan kredi shumë të mira, të cilat duhet t'i përdorim mirë dhe të kuptojmë se edhe popujt vëllezër të këtyre vendeve, po bëjnë përpjekje aq sa bëjmë edhe ne, kanë dhe ata vështirësi si ne. Nuk mund të paraqitemi në vitet e ardhshme po me ato eksportime të dobëta, sikundër u paraqitëm sivjet. Duhet të kemi të qartë dhe kjo është më e rëndësishmja, se BS na siguroi bazat materiale për hartimin e planit tonë dyvjeçar, i cili është duke u punuar dhe do të dalë së shpejti, ai na siguroi gjithashtu edhe një kredi për dy vitet e tjera jashtë planit tonë dyvjeçar, d.m.th. deri në vitin 1952. Ne tani dimë ku t'i bazojmë dhe si t'i hartojmë planet tona ekonomike — këtë herë të drejta dhe reale. Kjo është kryesore. Deri tani planet

tona s'kanë qenë reale, pse s'ishin të bazuara në një kredi stabël dhe në një orientim të drejtë. Realizimi i planit tonë dyvjeçar tani varet nga ne, varet nga mobilizimi i gjithanshëm i Partisë, varet nga mobilizimi i gjithë njerëzve pa parti, nga patriotët e ndershëm, nga të gjitha masat punonjëse të vendit tonë. Ne kemi marrë ndihmë të çmueshme nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore, por njëkohësisht kemi marrë edhe detyrime, të cilat duhet t'i mbajmë. Sistemi i marrëdhënjeve tregëtare dhe i shkëmbimeve reciproke kërkojnë nga ana jonë të realizojmë me çdo kusht eksportimet tona që do të thotë të realizojmë planin tonë. Kjo gjë të mos mbetet vetëm një parullë e thatë dhe boshe, por të bëhet realitet. E gjithë Partia duhet të jetë e qartë në këtë gjë dhe ka me mijëra faktorë që kondicionojnë realizimin e planit tonë. Këta faktorë duhet t'i studjojmë, t'i zgjidhim dhe të marrim përgjegjësinë e plotë, në radhë të parë ne anëtarët e Partisë.

Bujqësia është një nga problemet më të rëndësishme ekonomike të vendit tonë, prandaj duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh. Çështjet bujqësore nuk kanë shkuar mirë dhe kjo ka ndodhur nga orientimet e gabuara që kemi pasur dhe nga mungesa e mobilizimit të duhur të Partisë në këtë sektor. Toka e bujqësia në përgjithësi janë në duart e fshatarëve individualë, pra, në vendin tonë predominon elementi mikroborgjez. Lenini thotë:

«Borgjezia e vogël kundërshton çdo ndërhyrje nga ana e shtetit, çdo evidencë ose kontroll,

qofshin këta të natyrës kapitaliste-shtetërore apo socialiste»¹.

Kjo është vërtetuar në vendin tonë dhe ne nuk kemi qenë dhe aq të prerë e të drejtë në realizimin e planit në bujqësi. Partia në fshat nuk ka punuar sa duhet, pushteti aty është treguar i dobët. Që të realizohet si duhet plani i shtetit në bujqësi nga ekonomitë e vogla fshatare, duhet t'i qëndrohet në kokë problemit, të studjohet cilësia dhe sasia e tokës, të studjohen lëvizjet që mund të ngjasin në fondin e tokës, të ndiqen punimet e tokës dhe të mbjellat e ndryshme. Që në kohën e mbjelljeve dhe deri në korrje, duhet të udhëzohet vazhdimisht fshatari mbi metodat e reja agroteknike, t'i tregohet mirë se ç'duhet të bëjë ai për rritjen e mirëqenjes së tij dhe forcimin e shtetit, t'i tregohet dhe të bindet për nevojat që ka ai dhe populli për mbjelljen e asaj ose të kësaj kulture dhe një tok gjërash të tjera, që kanë lidhje me këtë problem të madh dhe të koklavitur. Kjo gjë s'është bërë dhe vazhdon të mos bëhet si duhet.

Komiteti Qendror dhe qeveria lëshuan një urdhëresë të përbashkët për mbjelljet e pranverës, me anën e së cilës u bëhet thirrje njerëzve të Partisë dhe të pushtetit si dhe gjithë fshatarësisë të hidhen në sulm për të mbjellë sa më tepër bereqet dhe bimë industriale, për të hapur toka të reja etj. Ne konstatojmë që tani se jemi shumë prapa në realizimin e kontraktimeve për mbjelljen e bimëve industriale dhe këto nuk do të zënë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 393.

as 50—60 për qind të sipërfaqes së planifikuar. Kjo është shenjë shumë e keqe, kështu nuk mundet të ecim. Që tani ne parashikojmë se nevojat e popullit për prodhime të tilla dhe eksportimet tona në këto materiale, nuk do t'i përmbushim, pra, nuk do të mbajmë detyrimet dhe angazhimet që kemi marrë para Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Në rast se ne shkojmë në këtë rrugë edhe për të tjerat, duhet të mendojmë se në vitet e ardhshme do të kemi importime jashtëzakonisht të vogla dhe gjendja jonë ekonomike në vend që të shkojë drejt përmirësimit, do të keqësohet, do të vihet para vështirësive Partia jonë, kurse pushteti ynë dhe demokracia jonë popullore do të jenë më të kërcënuar nga armiqtë. Nga Ministria e Bujqësisë, nga njerëzit e Partisë dhe të bujqësisë u muarën angazhime, janë lidhur kontrata me fshatarët për t'u punuar tokat me traktorë. Por, SMT-të nuk janë në rregull, traktorët s'punojnë në rregull, angazhimet nuk mbahen. A do ta lejojmë të vazhdojë kjo gjendje? Jo. Kundër njerëzve përgjegjës duhet të merren masa që ata të kryejnë si duhet detyrat. Mund të nxirren shumë arsye dhe justifikime, por në rast se ne rrimë t'i studjojmë këto, një nga një, atëhere vajhalli, s'kemi për të dalë kurrë nga ky qorsokak.

Çështja e grumbullimeve është një problem i madh për Partinë dhe shtetin tonë. Sigurimi i bukës së popullit është çështja kryesore dhe kjo s'është marrë me seriozitetin që meriton. Në këtë drejtim janë bërë shumë lëshime; ka shokë që kanë rënë në oportunitizëm ose janë tërhequr nga vështirësitë. Populli thotë se «ç'të mbjellësh, do të korrësh». Direktiva është të mbillet sa më

shumë dhe të kontrollohen mbjelljet. Toka ekziston, ekziston gjithashtu edhe urdhëresa e grumbullimit, e cila është nga më të drejtat. Pra, fondi i grumbullimit që do të caktohet nga qeveria duhet të grumbullohet pa-tjetër e me çdo kusht. Kundër çdonjërit që do të bëjë lëshime në këtë drejtim, kundër çdonjërit, që do të përpiqet të justifikohet dhe të përsëritë historinë e viteve të kaluara, duhet të merren masat më të rrepta. Llogaritë e fondit shtetëror të drithërave të bëhen mirë, as të influencuara nga pikëpamjet e gabuara të atyre njerëzve të Partisë, që kërkojnë të caktohet fondi i grumbullimit të sivjetëm duke marrë për bazë grumbullimet e viteve të kaluara, të cilat kanë qenë krejtësisht të gabuara e ashtu si kanë dashur kulakët ose fshatarë të tjerë të pandërgjegjshëm, por as edhe ashtu si thonë disa drejtues të bujqësisë dhe të tregëtisë, pa marrë parasysh disa faktorë, si mungesë toke ose lëvizje toke nga një dorë në tjetrën. Por e keqja është se njerëzit e Partisë dhe të pushtetit dhe në radhë të parë njerëzit e bujqësisë i nxjerrin këto pengesa dhe këto vërejtje pas të vjelit. Ata nuk e kanë ndjekur çështjen e reformës agrare dhe të tokës në përgjithësi në dinamizmin e saj, nuk e kanë përmirësuar kadastrën me studime në vend e të sigurta dhe njerëzit e dobët, njerëzit joaktivë, njerëzit pa perspektivë dhe inisiativë, i quajnë këto si shkaqe kryesore, për të mos pranuar fondin e grumbullimit shtetëror të drithërave dhe këto vërejtje të tyre, të cilat duhet vetë t'i kishin zgjidhur që më parë, kërkojnë t'i ruajnë si rezerva për mosrealizimin më vonë të fondit të grumbullimit të drithërave. Kjo është e palejueshme e kriminale. Komiteti Qendror ka kërkuar

nga rrethet të bëjnë vërejtjet e tyre konkrete dhe të arësytuar në këtë drejtim dhe vendimi i Komitetit Qendror dhe i qeverisë që do të dalë duhet të zbatohet qind për qind. Përgjegjës janë të gjithë njerëzit e Partisë, që nga kreu deri në fund, si edhe të gjithë funksionarët e shtetit. Me bukën e popullit nuk mund të luajmë. Grumbullimi i drithërave do të bëhet në bazë të urdhëresës që është lëshuar¹, në bazë të tokës, në bazë të cilësisë së tokës dhe të koeficientëve që janë caktuar në urdhëresë. Fshatari ka kohë që është paralajmëruar për këtë taksë në natyrë, e cila është nga më të drejtat dhe duhet të grumbullohet. Kështu duhet të grumbullohen edhe të gjitha prodhimet e tjera të caktuara me urdhëresa, si mishi, bimët industriale etj.

Ky vit duhet të jetë një vit vendimtar për të zbatuar drejt në jetë vendimet e pushtetit popullor. Këtu do të shikohet patriotizmi i masave, zotësia dhe vendosmëria e njerëzve në të gjitha punët shtetërore, që janë punët e Partisë, do të provohet besnikëria e njerëzve ndaj Partisë dhe çështjes së popullit. Duhet të mobilizohet Partia në fshat, që tani dhe vazhdimisht, pa humbur asnjë minutë kohë. Me fshatarët jemi treguar shumë dorëlëshuar, në grumbullimet, në pagimin e taksave, në moskërkimin nga ata të kontributit të madh për ndërtimin e vendit, në mosbërjen nga ana e tyre e sakrificave si të gjitha masat e tjera punonjëse të vendit tonë. Fshatarësia ka grumbulluar mjaft para, kjo ka

¹ Kjo urdhëresë u lëshua nga Qeveria e RPSH në janar 1949 në bazë të vendimit të KQ të PPSH «Mbi sistemin e ri të grumbullimit dhe furnizimit».

bërë të ngrihet inflacioni, kjo ka bërë të shiten shpejt ose të mos gjenden aspak mallra dhe prodhime bujqësore në treg, por që këto të shiten në treg të zi. Ne s'jemi kundër përmirësimit të gjendjes ekonomike të fshatarit, por kjo duhet të shkojë në rrugën normale ligjore dhe paralel me përmirësimin e gjendjes ekonomike të të gjitha shtresave punonjëse të vendit. Standardi i jetesës së popullit tonë duhet të ngrihet në mënyrë të harmonishme. Tendenca ka qenë dhe është që për të mos e trembur fshatarin, t'i japim këtij çdo gjë me çmime të lira dhe ta lëmë atë të shesë prodhimin e tij sa të dojë. Ka shokë që kanë frikë t'i zbatojnë si duhet urdhëresat e drejta, që janë proklamuar dhe ligjruar, se mos akuzohen si trockistë dhe njerëz të Koçi Xoxes. Duhet të shohim të metat e fshatarëve dhe tendencat e tyre mikroborgjeze, por duhet njëkohësisht të njohim dhe të shohim edhe të metat tona. T'i kërkojmë vetes çdo mbrëmje llogari për çka kemi bërë gjithë ditën. Të pyesim veten: A e kemi organizuar mirë punën në fshat, a e kemi mobilizuar si duhet fshatarin, a ja kemi mbajtur sa duhet gjallë ndjenjën e patriotizmit, a i kemi luftuar me efikasitet parullat dhe veprimet armiqësore të kulakut? Pa ja bërë vetes këto pyetje, pa i analizuar punët tona dhe pa i zhdukur imediatisht të metat në punë, ne do të dëmtohem rëndë. Si mund të mbajnë fjalime për shpirtin mikroborgjez të fshatarit dhe për tendencat e tija, ata shokë që janë vënë nën presionin e borgjezisë për këto probleme dhe bien në pozitë e saja duke harruar vijën e Partisë, detyrën, luftën e paepur që duhet të bëjnë? Socializmi nuk ndërtohet pa luftë, pa përpjekje. Lufta e klasave nuk konsiston në

fjalë boshe, por në përpjekje dhe këtu, në këtë luftë klasash, do të dallohen njerëzit besnikë të Partisë, do të demaskohen elementët e plogësht, elementët kulakë dhe armiq, që kanë depërtuar kontrabandë në Parti dhe në pushtet.

Fshatarësia është forca e madhe e popullit tonë dhe e Partisë sonë, në të ekziston e zhvilluar ndjenja e patriotizmit dhe dashuria për Partinë tonë. Këta faktorë kryesorë të mos t'i harrojmë. Komunisti të punojë me pjekurinë më të madhe, pse vendimet e Partisë që kanë dorë janë të atilla që synojnë vetëm mirëqenjen e fshatarësisë dhe të mos mendohet se këto urdhëresa, që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe me fshatarësinë në përgjithësi, fshatarësia «nuk i pranon, por i lufton». Në rast se ndonjëri mendon kështu, atëhere ka rënë në pozitë e kulakut dhe ka bërë lodrën e tij. Fshatarësia e varfër dhe e mesme i pranon këto urdhëresa, pse janë të drejta, pse e kupton që janë në favorin e saj, por në rast se puna e Partisë do të jetë e dobët, në rast se agjitacioni dhe propaganda jonë do të vazhdojnë të jenë të dobëta, sikundër paraqiten, në rast se ndihma jonë fshatit nuk do të jetë konkrete dhe organizimi ynë jo i mirë, patjetër armiku do të përfitojë dhe do të influencojë shtresat fshatare të varfëra dhe të mesme në drejtim të kundërt me tonin. Këtu është lufta e vazhdueshme që duhet zhvilluar, për të lidhur akoma më shumë fshatarësinë me pushtetin dhe për ta çrrënjësuar ditë-ditës kapitalizmin në fshat.

Problemi bujqësor është një kompleks i tërë dhe që Partia duhet ta zgjidhë drejt. Që të kemi mbjellje të mira dhe korrje të bollshme, ne duhet të kujdesemi për

tokën që kjo të punohet sa më mirë, të plehërohet gjithashtu, të studjohet natyra e saj dhe të mbillen në të bimët e përshtatshme, të hapen toka të reja, të shtohen kanalet ujitëse dhe kulluese, të studjohet problemi i bonifikimeve të vogla, të merret në studim çështja e pyjeve, shfrytëzimi i tyre, shtimi dhe ruajtja e tyre, të seleksionohen farërat, të shtohen drurët frutorë, të futen metodat e reja të punimit në bujqësi, të organizohen qendrat e mekanikës bujqësore në fermat shtetërore dhe këto të punojnë tokat e fermave shtetërore dhe të fshatarëve që dëshirojnë t'i punojnë tokat me traktorë kundrejt pagesës në natyrë dhe jo në të holla. Duhet t'i vihet kujdes i madh blegtorisë, të përmirësohen dhe të shtohen bagëtitë e trasha dhe të imta, të studjohet çështja e kullotave verore dhe dimërore, të studjohet çështja e ushqimit të kafshëve dhe të mos gjendemi përpara të papriturave, të shtohen shpendët dhe prodhimet e tyre, të përmirësohet ekonomia fshatare, duke rritur derra e kafshë të tjera të vlefshme. Të gjitha këto na vihen si detyra të domosdoshme dhe urgjente që duhet t'i zbatojmë. Partia do t'i zbatojë, ne do t'i zbatojmë. Kjo të jetë e qartë. Këtu është çështje studimi dhe organizimi që nga lart, por këtu është edhe një punë e palodhur, krijuese, frutdhënëse nga gjithë organizata e Partisë në bazë, këtu është çështja e zhvillimit të iniciativës së Partisë në bazë, zotësia e drejtuesve në terren.

Përsa u përket kooperativave bujqësore, ato nuk shkojnë mirë, atje përveç gabimeve parimore, që u kritikuan në kongres, ka edhe shumë gabime të tjera organizimi, drejtimi, keqkuptime dhe kërkesa nga ana e

disa anëtarëve për të dalë nga kooperativa bujqësore. Është konstatuar gjithashtu se shumë kooperativa bujqësore janë deficit dhe mjaft të tjera kanë prodhuar pak. Sido që nuk jemi shpejtuar në ngritjen me shumicë të kooperativave, gjendja e atyreve ekzistuese dhe e vendit tonë malor na bën të mos shpejtohemi në ngritjen e kooperativave të reja bujqësore. Prandaj, është e këshillueshme që për një kohë të mos krijojmë më kooperativa të tjera. Në BS, në ato vende, që janë të përngjashme me vendin tonë, kolkozet janë krijuar më vonë. Nuk duhet ta komprometojmë çështjen e kolektivizimit. Neve na vihet për detyrë që këto kooperativa që kemi, t'i ndërtojmë si duhet, t'i forcojmë, t'i organizojmë mirë dhe të bëhen model për të ardhshmen.

Nga ana tjetër u tërheqim vëmendjen shokëve komunistë që punojnë në sektorët e bujqësisë, që nga aparati i ministrisë dhe deri në bazë, të rishikojnë mirë punën e tyre, pse atje ka shumë plogështi, mungon operativiteti, ka burokratizëm, mungon inisiativa dhe organizimi, nuk ka disiplinë në punë. Njerëzit mbyllen dhe qëndrojnë në zyra, nuk shohin sa duhet terrenin. Në udhëheqjen e bujqësisë ekziston një frymë liberalizmi, një tendencë luksi dhe zemërgjerësie ndaj fshatarit. Çdo gjë kërkohet t'u jepet falas ose me çmime qesharake. Me zor mund të bazohesh në të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë dhe këto të dhëna ndërrojnë dita-ditës. Ndër fermat e shtetit, me gjithë nevojat e shumta, vazhdon të ketë çmobilizim, plane jo të drejta dhe të pastudjuara dhe këto ferma nga viti në vit kanë deficite. Me një regjim të tillë pune nuk mund të ecet

përpara. Ministria e Bujqësisë, në radhë të parë drejtuesit, duhet t'i përvishen punës më me gjallëri.

Çështja e industrisë dhe e minierave në vendin tonë është gjithashtu një problem i rëndësishëm. Edhe në këta sektorë punët nuk shkojnë mirë, planet nuk realizohen, s'ka sa duhet disiplinë në punë dhe ka mjaft çmobilizim. Kjo duhet të na preokupojë seriozisht. Vendi ynë dhe industria jonë ekzistuese ka nevojë për naftë, benzinë, vajguri dhe të tjera nënprodukte. Nga ana tjetër ne kemi angazhime për eksportim nafte brut etj. Nga të dhënat e deritanishme planet e tremujorit të parë nuk janë realizuar dhe kjo, jo më shumë për arsye objektive se sa pakujdesi dhe mungesë discipline në punë nga ana e udhëheqjes së Partisë të kombinatit dhe njëkohësisht të mjaft punëtorëve. Kjo ngjet edhe në minierat e bakrit, të bitumit, të qymyrgurit si dhe në industrinë tonë të lehtë etj. Planet në industri nuk realizohen kudo. Në industri punohet pa norma ose më mirë pak punohet me norma dhe s'ka përpjekje për shtimin e prodhimit dhe për uljen e kostos. Në vend që ne të shkojmë duke e ulur koston, shkojmë duke e ngritur. Maqinat nuk ruhen si duhet, ka dëmtime, shkatërrime, sabotime të çuditshme. Ka tendenca që kërkojnë kurdoherë maqina të reja, vegla ndërrimi të reja dhe s'bëhet sa duhet përpjekje që të mbahen mirë maqinat që ekzistojnë, të riparohen me veglat që ekzistojnë dhe të bëhen përpjekje të mëdha në këtë drejtim. Nuk mendohet aspak se nga dhe me se do të sillen këto maqina dhe këto vegla ndërrimi. Nëpër fabrika e kantiere të ndryshme ekziston material i painventarizuar, i hedhur mënjanë, që s'dihet ku është dhe i kujt është

dhe që, as përdoret, as i jepet hua një fabrike tjetër, por preferohet të prishet, të ndryshket dhe s'i jepet atij, që ka nevojë dhe kjo bëhet gjoja nën pretekstin e ligjeve dhe të urdhërsave që ekzistojnë dhe që drejtojnë aktivitetin e ndërmarrjeve, të fabrikave ose të kantierëve. Mungon organizimi i mirë në punë dhe koordinimi i punëve dhe i planeve me dikasteret e tjera. Kur është gati prodhimi, mungon transporti dhe kur s'mungon transporti, mungon prodhimi. Kjo gjë ngjet sikur të jetë kurdisur dhe këtej dalin një sërë justifikimesh të padrejta, të cilat shkaktojnë që populli herë pas here të mbetet pa makarona, pa naftë, pa vajguri, pa kripë etj. dhe kur vijnë vaporët, për të eksportuar mallin që i detyrohem BS ose vendeve të demokracisë popullore, ne s'e kemi gjithë sasinë e caktuar.

Industria jonë e lehtë duhet të punojë pareshtur dhe me rendiment të plotë. Ne importojmë një sasi të vogël tekstilësh, prandaj të merren të gjitha masat që fabrika jonë e Shkodrës dhe e Korçës të punojnë në rregull dhe të plotësojnë planin. Fabrika e litarit në Rogozhinë duhet të ngrihet shpejt dhe të prodhojë; po kështu dhe ajo e alkoolit, fabrikat e lëkurëve, të cigareve etj. Drejtuesit e industrisë dhe të gjithë njerëzit e Partisë, që punojnë në industri dhe miniera, duhet ta marrin me seriozitetin më të madh këtë punë, duhet të bëjnë përpjekje të mëdha, të organizojnë punën si duhet, të mobilizojnë njerëzit, t'i bëjnë këta të ndërgegjeshëm dhe të disiplinuar. Të vendosen normat në punë, pse pa norma nuk mund të realizohet plani dhe plani duhet patjetër të realizohet.

Një mungesë e madhe që vërehet në industri dhe në

ndërtim është ajo e fuqisë punëtore. Me të vërtetë kjo është shumë e çuditshme dhe rrjedh sepse shkelen dhe nuk zbatohen urdhëresat e qeverisë dhe të Partisë. Në Ministrinë e Tregëtisë venë shumë njoftime për një shpërdorim të madh të drithit nga ana e komiteteve, atëhere pse të mos nxirret fuqi punëtore po nga këto rrethe? Kjo është e pakuptueshme. Në Republikën tonë duhet të jctë e qartë se kush punon, ha. Prandaj janë lëshuar urdhëresa që të mos u jepet bukë atyre që nuk punojnë dhe në rast se duan bukë, të punojnë dhe të marrin bukë e sende të tjera që u duhen. Në rast se veprohet ndryshe, vallë ku do ta gjejë shteti bukën, si do t'i ndërtojë shteti fabrikat, si do t'i vërë në funksionim këto fabrika? Unë kërkoj nga shokët që ndodhen këtu dhe që nuk i zbatojnë urdhëresat e qeverisë dhe të Partisë të propozojnë zgjidhjen. Në rast se nuk përgjigjen për këtë, atëhere të përgjigjen pse nuk ka punëtorë. Vihet pyetja: a ka fshatarë që kanë pak tokë? Ç'po bëjnë këta njerëz, me se rrojnë dhe ç'detyrime ka shteti ndaj tyre? Pse vallë shokët e rretheve nuk preokupohen sa duhet dhe nuk e bëjnë alarm në organizatë mungesën e punëtorëve, që rrezikon planin e shtetit, që rrezikon dhe vështirëson jetën e punonjësve? Duhet ta thyejmë një situatë të tillë dhe në radhë të parë këtë duhet ta bëjë Partia. Në rast se përkëdhelet dembeli e paraziti dhe ka sentimentalizëm ndaj tij, nuk është bërë detyra që kërkon Partia. Prandaj, t'ua presim bukën menjëherë këtyre elementëve dhe kjo të mos trembë njeri, pse ata që s'punojnë, nuk do të preferojnë të vdesin me duar lidhur, por do të kërkojnë punë dhe puna është nder, puna është siguria e jetesës. Kështu

duhet t'i edukojmë njerëzit dhe kështu duhet të veprojmë që ta zgjidhim sa më parë këtë problem. Të çuditshme janë dhe urdhërat që jepen në këtë drejtim. Kërkojen punëtorë nga rrethet, por as përcaktohet ku do të shkojnë, as mendohet si do të transportohen, as caktohen afatet dhe detyrat e të dy palëve dhe mbi të gjitha që të tërë kërkojnë punëtorë. Kur i thuhet njerit: «Pse s'i ke dërguar punëtorët», ai të përgjigjet dhe të thotë: «S'di ku t'i çoj, s'kam automjete». Kur i thua: «Po të çoj automjete që nesër», ai të kthehet dhe të thotë: «Punëtorët i kam në fshat». Kjo do të thotë që këto plane janë të pabazuara dhe jepen urdhëra në erë. Kështu do të vazhdojmë të punojmë? Këtu në Plenumin e KQ duhet të zgjidhen këto gjëra dhe të marrin fund një herë e mirë, pse ne jemi përgjegjës për këto, ne e kemi fajin, ne s'i bëjmë punët në rregull. Duhet të vendoset rregulli e disiplina e hekurt e Partisë, duhet të merren masa të rënda ndaj atyre që e bëjnë punën shkel e shko. Kemi përgjegjësi të mëdha përpara popullit, përpara Partisë. T'i marrim këto përgjegjësi dhe ata që s'janë të zot, të shkarkohen dhe t'ua lënë vendin shokëve të tjerë më të zot, më të aftë dhe që u dhimbset seriozisht puna.

Tregëtia shtetërore dhe ajo kooperativiste është një problem tjetër i rëndësishëm për Partinë dhe shtetin tonë. Në përgjithësi ne mund të themi se në këtë sektor jemi të dobët dhe njerëzit tanë nuk dinë të bëjnë tregëti. Komunistët që janë shitësa në sektorin e tregëtisë duhet të mësohen në radhë të parë të bëjnë tregëti dhe të bëhen tregëtarë të mirë. Në plan të parë është çështja e organizimit dhe e shpërndarjes së mallrave, është

gjithashtu edhe çështja e tregëtimit në detalje. Tregëtia jonë nuk ka qenë kurrë e bazuar në plane të sigurta dhe ajo është bërë me hope, pa kriter, ka ekzistuar një çorganizim i madh, nuk është bërë me kohë racionimi i mallrave, nuk janë dërguar ato rregullisht në qendrat e ndryshme, ka ekzistuar një babiloni e madhe çmimesh dhe një shpërdorim dhe dëmtim i jashtëzakonshëm i mallit të shtetit. Kontabilitetet janë si mos më keq dhe këtej rrjedhin abuzime të mëdha në dëm të arkës së shtetit tonë, që është arka e popullit. Ndër dyqanet e shtetit s'ka shumë rregull, disiplinë në shitje dhe dashuri për punën e për pasurinë e popullit. Në punonjësit e dyqaneve të shtetit ka raste të theksuara favorizimi dhe jo ndërgjegje të lartë revolucionare. Ndër ta nuk ka përpjekje serioze për të mësuar se si të bëhet tregëti dhe të përfitohet nga borgjezia e vogël tregëtare, së cilës duhet t'i marrin zanatin. Ka një moskokëçarje të çuditshme në këtë drejtim. Kësaj gjendjeje duhet t'i japim fund dhe menjëherë të duket përmirësimi në këtë sektor.

Që të lulëzojë tregëtia, ajo duhet të furnizohet, që të punojë dyqani, ai duhet të ketë mall. Ku do t'i gjejmë këto mallra? Burimet janë dy: burimi i brendshëm dhe importimet. Që të dyja këto burime do të shtohen, në rast se realizohet si duhet plani i shtetit, përndryshe tregëtia jonë ka shteruar. Duhet, pra, në radhë të parë të prodhojmë dhe fabrikat tona të realizojnë planin. Shtimi i prodhimeve tona të eksportit, do të ngrejë dhe fuqinë blerëse jashtë. Ne kemi qenë në një gjendje shumë të rëndë në këtë drejtim dhe do të vazhdojmë edhe për një kohë të luftojmë me vështirësitë. Për këtë

arësye duhet të bëhen përpjekje të mëdha për t'i kapërcyer këto vështirësi dhe njëkohësisht të bëjë sakrifica i gjithë populli. Por sakrificat e popullit të mos shkojnë kot nga mungesa e një organizimi të mirë, nga gabimet tona, nga lëshimet tona. Populli të ketë të qartë se do të bëjë sot sakrifica, që nesër të jetë i sigurtë, pse situata do të stabilizohet, gjendja do të përmirësohet, do të zhduket tregu i zi dhe spekulimi, do të luftohet anarkia në treg. Këtë Partia do ta bëjë, sepse ajo për këtë gjë lufton. Po këtu duhet të koncentrohen energji të mëdha të Partisë, të harmonizohen punët dhe veprimet, të mos merren problemet të shkëputura, se s'janë të shkëputura. Qeveria tani është e qartë për mallin që pret nga jashtë dhe kur i vjen ky mall. Ministria e Tregëtisë duhet të studjojë mirë shpërndarjen dhe çmimet.

Përsa i përket caktimit të çmimeve, ne kemi ecur në tym dhe jemi dëmtuar jashtëzakonisht. Në kohën e marrëdhënjeve me jugosllavët, jo vetëm ne nuk kishim akumulacion mbi mallrat që blenim prej tyre, por ato shiteshin te ata me çmime jashtëzakonisht të lira. Nga ana tjetër ne kishim një lloj çmimesh për të gjithë, si për fshatarët ashtu edhe për masat punonjëse të qytetit. Nuk ekzistonin fare çmime të tregut të lirë. Fshatari ishte në një gjendje shumë më të favorizuar nga punëtori i qytetit. Po kështu, urdhëresat e grumbullimit të bereqetit e të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, ishin në rrugë të gabuar dhe favorizonin pasurimin e fshatarit dhe sidomos të kulakut, në kurriz të masave punonjëse të qytetit. Nga të gjitha këto arritëm në situatën që fshatari të grumbullojë para dhe të bëjë

politikën e çmimeve në treg. Një situatë e tillë nuk ka qenë e drejtë dhe me urdhëresat e reja kjo duhet të marrë fund. Urdhëresat e reja duhet të studjohen mirë nga njerëzit e Partisë dhe të pushtetit, të kuptohen dhe të zbatohen. Sikundër e dini, do të ketë tri çmime: një çmim për masat punonjëse të qyteteve, një çmim më i lartë për fshatarët dhe një çmim akoma më i lartë për tregun e lirë. Fshatari duhet të paguajë mallin që merr më shtrenjtë nga të tjerët, pse gjendja e tij ekonomike është përmirësuar më shumë nga ajo e punonjësit të qytetit. Ai ka një fuqi blerëse më të madhe. Ai ka në xhepin e tij shuma të mëdha lekësh. Derisa ai t'i ketë këto parë në xhep, jo vetëm që nuk do të ketë nevojë për të shtuar më shumë prodhimet, por edhe ato që prodhon, do të përpiqet t'i shesë me çmime të larta, jashtë ligjit dhe në treg të zi. Këtej rrjedh çështja e mosrealizimit të planeve në bujqësi, mosuksesi në mbjellje dhe korrje dhe mosrealizimi i urdhëresave të grumbullimit. Prandaj, të hollat që ka fshatari duhet t'ja tërheqim dhe kjo është e drejtë, pse duhet të stabilizojmë dhe të përmirësojmë standardin e jetës së popullit. Çmimet e tregut të lirë janë të domosdoshme në situatën tonë dhe shokët e Partisë duhet ta kuptojnë drejt këtë problem. Por si do t'ja tërheqim paratë fshatarit? Me tregun reciprok, kjo s'është e mjaftueshme, pse s'kemi shumë mallra që t'i hedhim në dyqanet e shtetit dhe në kooperativat e shitblerjes. Duhet patjetër të gjendet një mënyrë suplementare dhe kjo është hedhja e një pjese të mallit në treg të lirë me çmime të larta. Këtu dëmtohet interesi i masave punonjëse të qytetit, pse atyre do t'u mungojnë disa gjëra, do t'u

shkurtohet ca racioni i blerjes së mallrave dhe ato s'do të mundin dot të blejnë në tregun e lirë, siç blen fshatari. Kjo është e vërtetë. Por këtë sakrificë duhet ta bëjë punëtori i qytetit dhe ai pranon ta bëjë këtë sakrificë, që të stabilizohet gjendja. Por këtu shteti duhet të ketë kontroll të fortë dhe të mbështetet fuqimisht në shtresat punëtore dhe të varfëra. Lenini thotë:

«Çështja shtrohet kështu dhe vetëm kështu. . .

Borgjezi i vogël, që grumbullon disa mijëshe, është armik i kapitalizmit shtetëror, dhe këto mijëshe ai do t'i realizojë krejt për vete, kundër të vobektëve, kundër çdo kontrolli shtetëror; mirëpo, shuma e të gjitha këtyre mijësheve përbën bazën e një spekulimi prej shumë miliardesh, që minon ndërtimin tonë socialist. Ta zëmë se një numër i caktuar punëtorësh japin brenda disa ditëve një sasi sendesh me vlerë që shprehet me shifrën 1 000. Ta zëmë, pastaj, se 200 nga kjo shumë na humbasin si pasojë e spekulimit të vogël, e vjedhjeve të çdo lloji dhe përpjekjeve që bëjnë pronarët e vegjël për t'u «bërë bisht» dekreteve sovjetike dhe dispozitave sovjetike. Çdo punëtor i ndërgjegjshëm do të thotë: sikur të kisha mundësi të jepja 300 nga të njëmijat për të krijuar një rregull më të madh dhe një organizim më të fortë, unë do të jepja me gjithë qejf treqind në vend të dyqind, sepse nën Pushtetin Sovjetik më vonë pakësimi i këtij «haraçi», të themi deri në njëqind ose pesëdhjetë, do të jetë një detyrë fare

e lehtë, kur të jetë vendosur rregulli dhe të jetë vënë në vijë organizimi, kur të jenë likuiduar përgjithmonë përpjekjet e pronarëve të vegjël për të sabotuar çdo monopol shtetëror»¹.

Lenini gjithashtu thotë:

«... E vlen që të paguajmë «për të mësuar», sepse kjo është e dobishme për punëtorët, sepse fitorja mbi çrregullimin, rrënimin ekonomik dhe shthurjen ka rëndësi më tepër se çdo gjë tjetër, sepse vazhdimi i anarkisë mikroborgjeze është rreziku më i madh, rreziku më kërcënues, rrezik që do të na hedhë patjetër në greminë (po të mos e mposhtim), ndërsa, në qoftë se i paguajmë më shumë kapitalizmit shtetëror, kjo jo vetëm që nuk na hedh në greminë, por do të na çojë në rrugën më të sigurtë drejt socializmit»².

Duhet të zhvillohet në shkallë të gjerë artizanati ndër kooperativa dhe ndër punishte private. Këto të mos presin vetëm material nga shteti, por të përpiqen vetë të gjejnë material të vjetër, të papërdorur dhe të prodhojnë sende të tregëtueshme për popullin e qyteve dhe për fshatarët.

Në kushtet që po kalon vendi ynë, kur sektori i tregëtisë shtetërore e kooperativiste nuk është akoma në gjendje të plotësojë të gjitha kërkesat e punonjësve, nuk na priset shumë puna në qoftë se lejojmë persona

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 394.

² Po aty f. 395.

të veçantë të prodhojnë e të shesin vetë p.sh. gëlqere, qymyr ose sende të tjera të kësaj natyre, për të cilat populli ka nevojë. Natyrisht, kjo do të thotë të lejosh deri në një farë mase zhvillimin e tregëtisë së vogël private. Por këto do jenë disa masa provizore për një kohë të caktuar. Dhe nga ana tjetër rreziku i zhvillimit të elementëve kapitalistë ka mundësi të mënjanohet nga kontrolli sistematik që ushtron shteti ynë dhe nga perspektivat që ka forcimi gjithnjë e më shumë i tregëtisë shtetërore e kooperativiste në vendin tonë.

Në lidhje me fshatarët, Partisë e organeve të pushtetit u vihet si detyrë e madhe të praktikojnë një politikë shkëmbimi të zgjuar, të shpejtë, të shumanshme, të bëjnë përpjekje të krijojnë punishte në bazë, të prodhojnë sa më shumë sende të nevojshme dhe të dorës së parë për fshatarët me anë të artizanatit, të përdorin çdo gjë që t'i tërheqin fshatarit tepricat që do t'i mben, pasi ai të ketë paguar taksën në natyrë. Partisë i vihet si detyrë të forcojë organizimin e tregëtisë dhe njerëzit e Partisë dhe të pushtetit duhet të zbatojnë me përpikëri urdhëresat e Ministrisë së Tregëtisë dhe udhëzimet që lëshon Komiteti i Grumbullimeve. Në gjithë këtë punë nuk përjashtohen edhe gabimet, por çështja është që këto gabime duhet të sinjalizohen me kohë dhe jo të shtrembërohen urdhëresat e të veprohet në mënyrë anarkike dhe të mos marrë vesh i pari të dytin.

Çështja e transportit është gjithashtu një nga problemet kyçe të shtetit. Transporti nuk është i organizuar si duhet, atje ka çrregullime, ka shpërdorime, ka prishje maqinash dhe mungon disiplina dhe ndërgjegjja në punë. Po nuk zgjidhëm mirë çështjen e transportit,

plani ynë do të na ngelë në baltë. Por s'mjafton vetëm që të merren masat për një organizim më të mirë të transportit, këtu duhet të merren masa dhe në të gjithë sektorët e tjerë që kanë të bëjnë me transportin. Çdo dikaster dhe në radhë të parë Dikasteri i Industrisë, i Tregëtisë, i Punëve Botore dhe gjithë ndërmarrjet e ndryshme, duhet të kenë planet e veta në rregull dhe ta ndihmojnë transportin në punën e tij dhe jo nga çrregullimet e tyre në realizimin e planit, nga mungesa e disiplinës etj., t'ja hedhin fajin transportit. Nën pretextin e mungesës së transportit, shumë ndërmarrje dhe dikastere fshehin gabimet, të metat, mosrealizimin e planeve të tyre. Kjo duhet të zgjidhet drejt dhe të marrë fund.

Çështjet ekonomike janë, po e përsërit edhe një herë, gjëja më kryesore e Partisë që duhet të zgjidhet. Duhet të shkundet Partia, të mobilizohen Partia, klasa punëtore dhe gjithë masat punonjëse. Të mbarojmë me praktikën e vjetër, të sëmurë, të justifikimeve të kota, duhet të kapërcehen vështirësitë me punë të palodhur, me sakrifica të mëdha, me disiplinë të hekurt. Në ballë të këtyre gjërave, në ballë të punës dhe të drejtimit duhet të jetë Partia, e fortë, e spastruar nga armiqtë dhe elementët e sëmurë e të plogësht, që mund të kenë hyrë kontrabandë në të dhe që pengojnë punën.

GJENDJA NË PARTI PAS KONGRESIT

Në kongres dolën të metat dhe gabimet, që ishin vërtetuar në Parti dhe pas kongresit u zbuluan dhe shumë të meta praktike. Organizatat e Partisë ishin shu-

më të dobëta dhe jo në gjendje të përballonin dhe të drejtonin si duhej jetën politike, ekonomike dhe kulturele të rretheve përkatëse. Byroja Politike dhe KQ muarën masa të menjëhershme për t'i forcuar organizatat dhe mund të themi se u përmirësua gjendja. Materialet e kongresit u punuan në aktive dhe u pritën me entuziazëm dhe me interesim të madh. Punimi i rezolucionit të tij ka ngjallur entuziazëm dhe interesim të madh në komunistët e në popull dhe ka shërbyer për mobilizimin e tyre në vijën e Partisë. Punimi i rezolucionit tregoi edhe një herë unitetin dhe vendosmërinë e gjithë Partisë për marksizëm-leninizmin, dashurinë dhe besnikërinë për Partinë Bolshevike e Bashkimin Sovjetik dhe urrejtjen për klikën e Titos dhe agjentët e saj Koçi Xoxe etj. Partia u tregua e vendosur dhe e gatshme për të zbatuar me sukses vijën e kongresit, po nga ana tjetër u manifestuan, gjithashtu, tendenca të gabuara dhe keqkuptime në vijë. Pas një regjimi sektar-burokratik në Parti dhe kalimit nga një disiplinë formale në një situatë të shëndoshë, ku ekziston demokracia e brendshme e Partisë, janë vërtetuar keqkuptime dhe interpretime të gabuara të demokracisë në Parti. Këtej ka rrjedhur thyerje e disiplinës, mosrespektim i mbledhjeve të Partisë, shkelje rregullash e konspiracioni të Partisë; s'janë zbatuar si duhet urdhërat e organeve eprore të pushtetit, është thyer disiplina në punë për realizimin e planit. Byroja Politike ka marrë masa në këtë drejtim dhe mund të themi se është përmirësuar gjendja. Ka pasur pikëpamje të shtrembra në lidhje me kritikën dhe autokritikën; kritika nuk ka qenë e motivuar dhe konstruktive, por në mjaft raste

është bërë pa përgjegjësi, pa fakte dhe hera-herës në formë shpifjeje dhe ofenduese, me një dozë ambicie personale. Janë vërtetuar gjithashtu pikëpamje oportuniste në çështjen e kritikës. Autokritika paraqitet mjaft e dobët dhe sidomos në shokët që kanë gabuar. Një dobësi tjetër është se komunistët, që janë kritikuar për gabimet e tyre, nuk janë mobilizuar dhe nuk u ka shërbyer sa duhej ky mësim, por janë dekurajuar dhe kanë rënë në pozita oportuniste dhe nuk kryejnë si duhet detyrat që u ngarkohen.

Nga analiza që i bëri Byroja Politike situatës, Partia ishte shtrirë jashtë masës. Mjaft elementë të dobët, të paaftë dhe pa stazh partie, kishin hyrë në radhët tona dhe koncepti i gabuar trockist i Koçi Xoxes mbi Partinë dhe mbi kuadrin, kishin shkaktuar grumbullimin e një shumice njerëzish në qendër duke dobësuar bazën dhe rezultati i kësaj politike ishte dobësimi i lidhjes së Partisë me masat. Nga strukturat e gabuara në Parti dhe në pushtet ekzistonin organika të fryra dhe me detyra të pacaktuara, kishte burokratizëm dhe konfuzion, udhëheqja drejtonte më shumë me letra dhe me qarkore, pa koordinim dhe pa kontroll të mjaftueshëm, që sillnin sëmundjen e justifikimeve, të lustrës dhe të zbukurimit të gjendjes reale. Buxheti i shtetit ishte i ngarkuar rëndë me personel të panevojshëm. Kishte, pra, centralizim dhe konfuzion të tepruar në punë dhe ishte dobësuar përgjegjësia. Centralizmi demokratik ishte shumë i dobët, s'kishte një udhëheqje të fortë kolegjiale dhe ngritja politike, kulturele dhe ideologjike e masës së Partisë ishin lënë pas dore.

Në lidhje me pranimet në Parti si dhe me përjash-

timet nga radhët e saja nga ana e komisioneve të revizionit janë konstatuar gabime. Pas punimeve të kongresit ne konstatojmë se Partia u rrit, por u futën dhe elementë që s'meritonin dhe janë vërtetuar të meta në çështjen e pranimeve, pse nuk respektohen si duhet rregullat që përcakton Statuti për pranimin në Parti dhe nuk studjohet elementi që futet në Parti. Nga gabimet e së kaluarës dhe nga pakujdesia në kohën e tanishme janë vërtetuar raste që anëtarë partie të kapitullojnë, të mos presin mirë sistemin e ri të grumbullimit etj. Prandaj organizatat e Partisë duhet që në këtë çështje të respektojnë rregullat e Statutit, të tregojnë kujdes për kandidatët që pranohen në Parti dhe të mbahet proporcioni në mes të kandidatëve dhe anëtarëve të Partisë. Nga ana tjetër të spastrohen nga Partia të gjithë elementët, që kanë hyrë kontrabandë dhe të organizohet një punë e gjerë për edukimin e komunistëve, të bëhet çmos për të shpëtuar çdo anëtar partie nga përjashtimi.

Në lidhje me këtë situatë, pas kongresit u dërguan në rrethe në krye të Partisë dhe të pushtetit shokë të zgjedhur nga më të mirët dhe më të aftët, me garanci për Partinë dhe që gëzonin besimin e masave. Kjo pati efekt të mirë në punë. U muar në studim dhe u përfundua gjithashtu ndarja e re administrative e Partisë dhe shtetërore duke u marrë parasysh mundësitë e tanishme për t'i forcuar me kuadro të aftë organikat e Partisë dhe të pushtetit. Kështu u përqëndruan forcat në më pak pika, por këto pika janë më të forta se përpara dhe kanë më shumë mundësi të drejtojnë, të kontrollojnë dhe të ndihmojnë bazën. Një organizim i tillë

do të na bëjë të shkojmë më me siguri drejt forcimit të pushtetit në bazë dhe afrimit të mëtejshëm të tij me popullin, boshllëk ky, që e kemi zgjidhur provizorisht, duke ngritur këshillat e fshatit në baza vullnetare me kompetenca të kufizuara. Nga ky ndryshim organik u shkurtua dhe personeli dhe kjo na dha mundësi të kemi më shumë kuadro disponibël për të zgjedhur dhe për të vënë në pozita kyçe shokët më të mirë, më të aftë dhe më me garanci për Partinë. Gjithashtu pas rishikimit të organikave në qendër u bënë shkurtime të mëdha, në dikastere dhe në institucione qendrore u seleksionua kuadri dhe në organika mbetën kuadrot më të mirë.

Për të plotësuar të gjitha nevojat, jemi detyruar të bëjmë edhe ndryshime e transferime kuadrosh dhe në qendër. Shumë kuadro të lartë në aparatit e Komitetit Qendror janë ndryshuar dhe zëvendësuar me të tjerë, kemi organizuar aparatit e KQ dhe kemi shtuar dy drejtori të reja, një për bujqësinë, një për industri-transportin dhe kemi forcuar ato që ekzistonin. Mjaft kuadro të tjerë janë marrë nga ushtria pa e dobësuar këtë dhe u kemi dhënë mundësi kuadrove të tjerë të ushtrisë të ngrihen në përgjegjësi.

Në të gjitha komitetet e Partisë dhe të pushtetit kemi emëruar kuadrin e ri, gjithashtu dhe në aparatet e tyre. Zgjedhja e këtij kuadri është bërë pas një pune të shëndoshë e të gjerë, po në këtë rast, nuk përjash-tohen edhe gabime nga ana jonë dhe këto gabime do t'i korrigjojë masa e Partisë në zgjedhjet demokratike që do të bëjë.

Përbërja shoqërore e këtij kuadri, stazhi në Parti dhe niveli kultural i tyre paraqitet shumë më i mirë

nga e kaluara. Kuadri i emëruar ka një stazh partie më të mirë dhe një nivel kultural gjithashtu më të lartë, por përsa i përket shtresës, përqindja e të varfërve është ulur pak. Sipas mendimit tonë kjo shpjegohet se çështja e shtresës nuk është shumë e saktë në dokumentat e Partisë. Orientimi i zgjedhjes së kuadrove ka qenë nga shtresat e varfëra, brenda mundësive të Partisë sonë dhe nga besnikëria ndaj Partisë. Drejtoria e kuadrit ka pasur parasysh, në bazë të udhëzimeve të KQ, të ngrejë në vende të meritueshme shokë të mirë, të goditur padrejtësisht nga Plenumi VIII dhe të spastrojë nga komitetet e Partisë elementët e pavendosur, të diskredituar në masat e popullit për keqsjellje dhe vendime të padrejta si edhe me frymë trockiste.

Si konkluzion i këtyre masave të marrura deri tani nga KQ, forcat e Partisë janë shpërndarë në një mënyrë më të drejtë se përpara, Partia dhe pushteti janë forcuar në mënyrë të harmonishme në qendër dhe në bazë. Lidhjet e Partisë me masat janë vënë në udhën e forcimit, i është mbyllur në një farë mase shtegu burokratizmit dhe njerëzit i kanë më të qarta detyrat duke u vënë përpara përgjegjësisë. Mundësia e kontrollit dhe e ndihmës nga ana e KQ mbi bazën dhe aparatet e veta është shtuar. Centralizmi dhe inisiativa janë tani më reale dhe jemi duke vendosur drejtimin kolegjial në Parti. Nga ana tjetër ndryshimet e formave të vjetra të organizimit dhe të punës dhe zëvendësimi i tyre me forma dhe metoda të reja, na japin garanci të mjaftueshme se vija politike e caktuar nga kongresi do të realizohet duke i kapërcyer pengesat dhe në harmoni me punën organizative.

Në këto momente Partia është duke bërë zgjedhjet e saja si edhe ato të pushtetit. Këtyre zgjedhjeve duhet t'u vëmë rëndësinë më të madhe dhe të bëhen një mjet mobilizues i Partisë për forcimin e saj dhe të pushtetit. Zgjedhjet nëpër organizatat bazë të qyteteve janë përfunduar dhe mund të themi se kanë qenë të kënaqshme. Në krye të organizatave bazë të qyteteve kanë ardhur shokë më të mirë, të aftë dhe besnikë të Partisë. Zgjedhjet janë zhvilluar në rregull dhe janë respektuar rregullat e Statutit. Por gjatë zhvillimit të zgjedhjeve, në mjaft vende, në propozimin e njerëzve nuk janë vënë sa duhet në dukje edhe të metat që mund të ketë pasur ndonjë kandidat dhe është mjaftuar vetëm me ndonjë kritikë dhe kjo jo gjithmonë konstruktive. Zgjedhjet e Partisë nëpër organizatat bazë në lokalitete dhe në fshat janë duke u zhvilluar. Atje e gjithë Partia duhet të vëjë kujdesin që të zgjidhen njerëz të mirë, udhëheqës të zot. Gjithashtu edhe në komitetet e lokaliteteve ose të rretheve të zgjidhen njerëz të mirë e të aftë, pse ata luajnë një rol të madh në realizimin e programit të Partisë dhe planit të shtetit. Në zgjedhjet e pushtetit Partia dhe gjithë organizatat e masave duhet të vihen në lëvizje dhe tok me to, të arrihet një mobilizim i gjerë i popullit për t'u hedhur më me vrull në luftë për realizimin e planit të shtetit. Gjendja e organizatave të masave është shumë e dobët dhe këto nuk kanë shërbyer efektivisht sa duhet për aktivizimin e anëtarëve të tyre në zbatimin e vendimeve të Partisë. Kjo vjen nga dobësitë e trashëguara nga e kaluara dhe për shkak të dobësimi të organizatave të Partisë, të cilat nuk kanë ditur t'i përdorin si duhet këto organi-

zata. Në sindikatat konstatojmë mjaft konfuzion në organizimin e tyre. Akoma nuk janë përcaktuar si duhet detyrat e tyre, ato nuk kanë pasur kompetencat që duhet të kishin dhe kuadri ka qenë mjaft i dobët. Në këtë drejtim duhet të mobilizohet Partia. Në organizatën e gruas vërehet mjaft plogështi dhe ajo paraqitet shumë e dobët organizativisht. Organizata e rinisë, megjithëse ka qenë organizata më me formë, për shkak të vendimeve të Plenumit VII të saj, u çorientua mjaft në punën e vet dhe sidomos duke pritur shkrirjen e të dy organizatave. Përsa i përket Frontit, sikundër thamë edhe më lart, nuk po dëgjohet sa duhet. Nga gabimi i së kaluarës, kur Fronti ishte në dukje më shumë se vetë Partia, është kaluar në ekstremin tjetër, prapë jo të drejtë, që Fronti të mos përdoret për mobilizimin e masave të gjera të popullit në problemet politike dhe ekonomike. Bile qarkullojnë mendime të gabuara se «Fronti s'është më i nevojshëm».

Duhet të na preokupojë shumë puna politike me masat, pse ajo ka rënë mjaft. Nga ana e Partisë nuk tregohet preokupacioni i duhur për organizimin e shëndoshë të një pune të dëndur për edukimin politik të masave, për t'i bindur masat, për t'i lidhur ato me vijën e Partisë. Duhet të preokupojë gjithë Partinë edukimi në radhë të parë i anëtarëve të saj, pse këta vazhdojnë të jenë shumë të ulët nga ana ideologjike dhe kulture. Nuk tregohet kujdes për këtë gjë, puna praktike e përditshme e tërheq zvarrë anëtarin e Partisë, deri edhe udhëheqësin dhe ky s'ka kohë as të mendojë që duhet të zhvillojë njohuritë e tija ideologjike dhe kulture, pa të cilat nuk mund të zgjidhen si duhet

problemet. Duhet të forcohet Partia jonë duke përmirësuar përbërjen shoqërore, të sjellim në Parti elementë të klasës punëtore, t'i edukojmë këta, t'u japim besim dhe t'i vëmë të drejtojnë. Partia sot ka më tepër se kurrë nevojë të forcohet me elementë besnikë dhe të aftë, drejtues të shëndoshë, të disiplinuar dhe të ngritur. Duhet, pra, të na preokupojë shumë çështja e ngritjes dhe e edukimit të kuadrove. Në këtë drejtim nuk bëhen shumë përpjekje. Nevoja e madhe e kuadrove, disa herë zëvendësohet me transferime dhe me lëvizje pa vend dhe sidomos horizontalisht. Këtëj rrjedhin shumë të këqia, këtëj rrjedh moskokëçarja, mungesa e disiplinës dhe e dashurisë për punën, dobësohet kujdesi për ndjekjen dhe zgjidhjen e drejtë të problemeve, këtëj lindin moskënaqësitë. Jo vetëm duhet të interesohemi të krijojmë kurse për specializimin e njerëzve që punojnë në fabrika, në kantiere, në qendra të ndryshme dhe institucione shtetërore, por Partia duhet të kujdeset veçanërisht për edukimin e brezit të ri nëpër shkolla. Organizatat e Partisë dhe udhëheqja e tyre nuk interesohen sa duhet, për të mos thënë aspak, për çështjet e shkollave. Kjo gjë kaq e rëndësishme konsiderohet si e huaj për organizatat e Partisë dhe sikur kjo u përket vetëm njerëzve që merren me arësim. Kjo është bërë monopol i këtyre të fundit dhe Partia, në më të shumtët e rasteve, nuk ka dijeni se ç'bëhet nëpër shkolla. Nga një moskujdesi e tillë ne konstatojmë që propaganda nëpër shkolla është lënë në dorën e mësuesve, kështu ne shohim të përdoren parulla dhe të dalin këngë të pakontrolluara dhe shumë herë të dëmshme, me të cilat rritet brezi ynë i ri. Ne vërejmë me keqar-

dhje se anëtarët e Partisë nuk lexojnë shtypin dhe revistat që dalin, qofshin këto të Partisë ose të shtetit. Shtypi ynë nuk shkon gati fare në fshat, por kjo ngjet edhe në qytete e në qendra pune. Sa për leximin e artikujve bazë që shtypen, jo vetëm që nuk komentohen në masat e gjera të popullit, por as nuk lexohen nga vetë anëtarët e Partisë. Kjo është një gjë e çuditshme dhe e palejueshme. Duhet t'i japim menjëherë fund një praktike të tillë.

Duhet të forcohet centralizmi demokratik në Parti, të forcohet disiplina e hekurt, konspiracioni, të forcohet kritika dhe autokritika, të forcohet dashuria për punën dhe për pasurinë shtetërore. Për këto gjëra anëtarët e Partisë duhet të jenë shembull në popull. Është e palejueshme pakujdesia për pasurinë shtetërore, për këtë duhet të bëjmë alarm në Parti. Ka vende ku nuk tregohet kujdes, asnjë s'merr dhe s'ka përgjegjësi, por gjatë kësaj kohe po dëmtohet, po shkatërrohet pasuria e shtetit. Nuk ekziston te të gjithë ndërgjegjja dhe ndjenja e rregullit. Këto duhet t'i formojmë medoemos në shpirtin e çdo anëtari të Partisë dhe në të gjithë punonjësit. Në disa njerëz ekziston pikëpamja e gabuar që pasi hyjnë në Parti, fitojnë të drejtën të komandojnë në rrugë jo të drejtë e të dënueshme; kanë të drejta të jashtligjshme dhe i shikojnë njerëzit nga lart e fryhen si gjela. Nga shkurtimet e kuadrit disa anëtarë partie janë jashtë kuadrit. Këta njerëz, në asnjë mënyrë nuk pranojnë të punojnë në rrugë, në miniera, në kantiere, por dëshirojnë vende në zyra dhe në poste komandimi. Ata mendojnë se të futesh në Parti do të thotë të fitosh pozitë dhe të marrësh frena komande në dorë, pa tre-

guar zotësi, pa dhënë prova me punë të palodhur. Duhet të ngremë ndërgjegjen e anëtarëve të Partisë, të luftojmë parazitizmin, arrivizmin dhe fodullëkun në radhët e tyre. Njerëzit e Partisë të jenë modestë, të jenë punëtorë, të shkëlqejnë nga zotësia në punë dhe jo nga llafet dhe fjalimet. Më pak fjalë dhe më shumë punë. Më shumë punë dhe më pak manifestime. Nuk guxon një udhëheqës të vejë të vizitojë një fabrikë, një kantier, një shkollë, pse manifestimet, brohoritjet janë aq të mëdha, aq pa vend, sa ai nuk ka kohë të bisedojë me punëtorët, t'i udhëzojë ata, të këshillohet me ta dhe të shohë të mirat dhe të metat në punë. Dashuria për udhëheqësit, për KQ, nuk tregohet vetëm duke brohoritur me vend e pa vend, po dashuria e madhe tregohet me thjeshtësinë e saj. Të mësojmë shumë gjëra nga populli, populli ynë është modest dhe s'i ka në gjak as në zakon gjërat e tepruara dhe reklamat e lustrat. T'i zhdukim gjërat e tepërta, t'i edukojmë njerëzit në rrugën e drejtë. Partia dhe vetëm Partia e ka këtë rol edukues të masave.

Të jemi të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që kemi përpara dhe të mobilizojmë të gjithë Partinë në punë për realizimin e planit. Ne udhëheqësit, duhet të japim tonin, duhet të kontrollojmë punën si duhet, ta organizojmë më së miri. Udhëheqja duhet të jetë në lëvizje, të marrë kontakt të gjallë me bazën dhe jo me letra, ta ndihmojë bazën në punën e rëndë, ta sqarojë për problemet që i vihen përpara, ta udhëzojë vazhdimisht. Në këtë shembull duhet të punojë edhe baza me popullin. Partia është udhëheqësja, por ajo duhet të vëjë në lëvizje gjithë masat e popullit, pse ndryshe punët

nuk do të ecin mirë, të kemi besim të madh te populli, te njerëzit e ndershëm, te patriotët dhe t'i ngarkojmë me punë, t'i udhëheqim, t'i udhëzojmë në rrugën dhe në vijën e drejtë të Partisë. Çështjet ekonomike, e përsërit edhe një herë, janë më të rëndësishmet, më të koklaviturat; Partia duhet t'i përvishet punës me forcë të madhe, duhet të mobilizohemi totalisht për realizimin e planit të shtetit. Çdo gjë varet nga Partia jonë. Të forcojmë Partinë, të edukojmë Partinë në rrugën e marksizëm-leninizmit, të mobilizojmë popullin tonë në punë dhe forcimi i atdheut tonë, forcimi i pavarësisë së vendit tonë varet shumë nga politika e urtë e qeverisë sonë dhe nga puna e palodhur dhe e frutshme e Partisë dhe e popullit; të forcojmë patriotizmin dhe unitetin e popullit, të luftojmë me ashpërsinë më të madhe armiqte, që përpiqen të na dëmtojnë në punën tonë, të ndërtojmë ekonominë tonë, të forcojmë çdo ditë bazat e socializmit në Shqipëri. Kështu do të ngrihet mirëqenja e popullit tonë dhe do të përparojë e do të forcohet vendi ynë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arhivin Qendror të Partisë, me disa shkurtime.

**FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN VII TË
LEGJISLATURËS SË PARË TË KUVENDIT
POPULLOR ME RASTIN E PARAQITJES
PËR APROVIM TË PROJEKTLIGJIT
TË PLANIT DYVJEÇAR TË SHTETIT
PËR VITIN 1949-1950**

1 qershor 1949

Shokë deputetë,

Qeveria e Republikës del sot para Kuvendit Popullor me projektplanin dyvjeçar të shtetit për vitin 1949 dhe 1950.

Për herë të parë në jetën e Republikës sonë Popullore po dilet me një plan ekonomik shtetëror dyvjeçar, gjë që përbën një sukses me rëndësi dhe një hap të madh përpara në ndërtimin dhe forcimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Plani ynë dyvjeçar, që del pas një studimi të gjatë dhe të kujdesshëm të të gjithë aparatit, është plani ynë i parë perspektiv dhe, ajo që ka rëndësi është se ky del pas vitit 1948. Siç e dimë, viti 1948 ka qenë më i vështiri që kemi kaluar, sepse në gjashtëmujorin e parë të tij, udhëheqja jugosllave shtoi ndërhyrjen e saj të posh-

tër në punët e brendshme të vendit tonë. Megjithkëtë ndërhyrje, si dhe me gjithë mungesat e pengesat objektive që ju paraqitën ekonomisë sonë, realizimi i planit për vitin 1948 ka qenë mjaft i kënaqshëm. Prodhimi si vleftë në minierat arriti 75,27 për qind, kurse në disa sektorë, si në atë të vajgurit brut — 84,7 për qind, të serës së pastruar — 90,9 për qind etj. Në vitin 1948, në krahasim me 1947-n dhe paraluftën, nafta brut respektivisht arriti në 119,7 për qind dhe 159,7 për qind, bitumi i pastruar — 172,4 për qind dhe 142 për qind. Vlefta e përgjithshme e prodhimit të industrisë u realizua 84,4 për qind, d.m.th. 165,2 për qind në krahasim me 1947-n dhe 321,6 për qind në krahasim me 1938-n. Po kështu prodhimi i vajit u realizua 152,6 për qind dhe 115,2 për qind me 1947-n dhe 263,6 për qind në krahasim me 1938-n; prodhimi i makaronave u realizua 82,1 për qind ose 134,7 për qind me 1947-n dhe 358,9 për qind me 1938-n etj. Sipërfaqja e mbjellë në vitin 1948 arriti në 317 000 ha. që do të thotë 96,6 për qind me planin, 103,9 për qind në krahasim me 1947-n dhe 143,4 për qind në krahasim me 1938-n.

Sigurisht, mund të ishte bërë edhe më tepër në sektorin e prodhimit, kurse investimet u penguan shumë nga mungesa e materialeve të importit, si çimento, hekur, maqineri, goma, karburante etj. që duhej të vinin nga Jugosllavia, të cilat s'na erdhën kurrë. Me gjithë këto mungesa në sektorin e ndërtimeve plani u realizua 88 për qind (22 për qind në gjashtëmuorin e parë dhe 66 për qind në gjashtëmuorin e dytë). U vazhdua kështu ndërtimi i veprave më të rëndësishme si hekurudha Durrës-Tiranë, Hidrocentrali i Selitës, kalata e Portit të

Durrësit, kanali i Myzeqesë, ai i Maliqit, i Bedenit etj.

Plani ynë dyvjeçar synon të rritë prodhimet në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, në miniera, në industri e në bujqësi. Është e natyrshme se investimet më të mëdha do të bëhen në këta tre sektorë, si dhe në atë, që u jep këtyre jetë e gjallëri, në komunikacion. Kështu këta katër sektorë zënë 86,78 për qind të investimeve të dyvjeçarit, shumë kjo, që është baras me 4,147 miliard lekë. Në industri investimet kapin 26,61 për qind, në komunikacion 26,30 për qind, në miniera 20,17 për qind dhe në bujqësi 13,70 për qind. Pjesa që tepron, d.m.th. 13,22 për qind, investohet në gjithë sektorët e tjerë të aktivitetit shtetëror si 3,24 për qind në ndërtimet lokale, 1,80 për qind për shëndetin e popullit, 1,72 për qind për arësimin etj.

Diagrami i investimeve në miliona lekë, prej 1946 deri më 1950, në këta sektorë shkon kështu:

Sektori	1946	1947	1948	1949	1950
Industri e miniera	83,6	210,8	505,8	839,6	1 100,3
Komunikacion	162,2	545,0	485,6	621,2	463,6
Bujqësi	121,5	138,6	238	271,9	293,3

Dhe po t'i shohim këto investime më 1950, në krahasim me 1946-n dhe me 1948-n, kemi përkatësisht këto përqindje:

Industri-miniera 1 317 për qind dhe 218 për qind; komunikacion 288 për qind dhe 96,4 për qind dhe bujqësi 244 për qind e 103 për qind.

Prodhimi në këta sektorë sipas planit, në krahasim me vitin 1948, rritet kështu:

Vajguri brut	124 ⁰ / ₀	më 1949	dhe	160 ⁰ / ₀	më 1950
Bitumi i pastruar	104 ⁰ / ₀	»	»	123 ⁰ / ₀	»
Kromi	286 ⁰ / ₀	»	»	572 ⁰ / ₀	»
Bakri blister	214 ⁰ / ₀	»	»	363 ⁰ / ₀	»
Linjiti	204 ⁰ / ₀	»		255 ⁰ / ₀	»
Vajrat vegjetale	108 ⁰ / ₀	»		171 ⁰ / ₀	»
Makaronat	172 ⁰ / ₀	»	»	246 ⁰ / ₀	»
Lëkurët e imta	92 ⁰ / ₀	»	»	142 ⁰ / ₀	»
Këpucët	182 ⁰ / ₀	»	»	872 ⁰ / ₀	»
Cigaret	124 ⁰ / ₀	»	»	124 ⁰ / ₀	»
Çimentoja	151 ⁰ / ₀	»	»	156 ⁰ / ₀	»
Lënda e drurit	195 ⁰ / ₀	»	»	246 ⁰ / ₀	»
Gruri	116 ⁰ / ₀	»		125 ⁰ / ₀	»
Misri	103 ⁰ / ₀	»		112 ⁰ / ₀	»
Tërshëra	159 ⁰ / ₀			161 ⁰ / ₀	»
Pambuku	231 ⁰ / ₀			257 ⁰ / ₀	»
Panxhari i sheqerit	109 ⁰ / ₀			122 ⁰ / ₀	»
Perimet	109 ⁰ / ₀			129 ⁰ / ₀	»
Patatet	121 ⁰ / ₀			150 ⁰ / ₀	»

Edhe kapaciteti i transportit gjatë dyvjeçarit rritet në atë masë sa t'u bëjë ballë të gjitha nevojave kryesore të planeve tona në sferën e investimeve dhe të prodhimit.

Në arësim ndërtohen 95 shkolla fillore të reja, 20 shkolla 7-vjeçare në fshatra dhe 7 në qytete; zëvendësohen 52 lokale shkollash fillore dhe ndërtohet konvikti i Peshkopisë, d.m.th. rrjeti i shkollave fillore në 1950—1951 arrin numrin 1945, d.m.th. 302,4 për qind

më shumë në krahasim me 1938-n dhe 105 për qind në krahasim me 1948-n; shkollat 7-vjeçare arrijnë numrin 172 ose 1 563 për qind më shumë në krahasim me 1938-n dhe 117,8 për qind me 1948-n. Numri i nxënësve në shkollat fillore do të jetë 337,5 për qind më i madh në krahasim me 1938-n dhe 107,2 për qind në krahasim me 1948-n, kurse ai i shkollave 7-vjeçare 514,8 për qind me 1938-n dhe 142,2 për qind me 1948-n.

Në shëndetësi numri i shtretërve në spitale, maternitete e sanatoriume tani arrin në 5 445, që do të thotë 672 për qind në krahasim me 1938-n dhe 134 për qind në krahasim me 1948-n. Numri i shtretërve për fëmijë në çerdhet ditore dhe në befotrofet arrin në 1 200 nga 350 më 1948.

Investimet bazë për industrializimin e vendit dhe për shfrytëzimin e minierave tona, për mekanizimin e bujqësisë dhe për fuqizimin e transportit për këtë dyvjeçar, vepra të tilla si Kombinati i tekstileve në Tiranë, ai i sheqerit në Maliq, dy fabrika staxhionimi dhe një fabrikë imprenjim druri, një fabrikë kompensatoje, një fabrikë për fuçi metalike, një fabrikë zhveshëse ori-zi, investimet për fabrikën e fermentimit të duhanit, krejt materiali, tubacioni, maqineritë dhe filli për tension të lartë për Hidrocentralin e Selitës¹, maqineri, motora, tubacione për kombinatin e naftës, për minierën e bakrit, për minierat e kromit dhe të linjtit, traktorë, maqina shirëse dhe korrëse, plugje, ofiçina etj. për sektorin e bujqësisë, automjete për transportin, për ndërtime, për tregëtinë, për shëndetësinë, për botoren etj.,

¹ Hidrocentrali «V. I. Lenin»

motora, maqineri e vegla për industrinë, transportin e ndërtimet, na sigurohen nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë.

Veç këtyre Bashkimi Sovjetik na siguron për vitet 1951—1952 edhe këto investime të tjera: një rafineri me kapacitet 150 000 ton naftë në vit komplet me stacionin termoelektrik, një fabrikë tjetër për staxhionim druri, kështu që bashkë me dy të tjerat që përmenda do të arrijnë kapacitetin 40 000 m³ në vit, plotësimin e maqinerisë së tekstilit të leshit nga 1 400 boshte në 5 000 boshte, një radiostacion me valë të mesme me fuqi 60 kilovatësh, projektet e fabrikës së filaturës së pambukut prej 8 000 boshtesh në Tiranë, ekipe për studime gjeologjike dhe hidroelektrike, si dhe studimet, projektet dhe ndihmën teknike për drejtimin e punimeve, për instalimin e maqinerisë etj.

Nga republikat popullore motra të Polonisë, Çekosllovakisë, Hungarisë, Rumanisë e Bullgarisë, ne marrim për vitin 1949 gjithashtu me kredit materiale dhe maqineri të ndryshme për të përballuar investimet, si dhe mallra të konsumit të gjerë.

Për atë pjesë të vogël që marrim me shkëmbim nga të gjitha këto shtete miq e vëllezër, ne japim ato prodhime minerale, bujqësore e industriale që kemi. Prandaj, të gjithë ne, i madh e i vogël, është e domosdoshme të bëjmë një luftë të vazhdueshme për të shtuar gjithnjë e më shumë eksportimet tona.

Plani dyvjeçar është një sukses, që u arrit në saje të punës së palodhur, të përpjekjeve dhe të sakrificave të masave tona punonjëse dhe në saje të ndihmës së madhe e bujare që i jep vendit tonë Bashkimi Sovjetik,

ashtu sikundër u jep edhe vendeve të tjera të demokracisë popullore për ndërtimin e socializmit. Janë të shumta sot ato vende që marrin ndihmë morale e politike nga Bashkimi Sovjetik. Prandaj popujt e botës e duan Bashkimin Sovjetik dhe shtërngojnë fort radhët rreth tij.

Për këtë arsye imperializmi amerikan, që kërkon dhe lufton për të vendosur hegjemoninë e tij në botë dhe për të hedhur njerëzimin në një kasaphanë të re të tmerrshme, e lufton me të gjitha forcat e tija Bashkimin Sovjetik, kokën e kampit të paqes dhe të socializmit në botë.

Për të pasur suksese në skllavërimin e popujve, imperializmi amerikan po përdor të gjitha mjetet e dënueshme nga bota përparimtare, siç janë shantazhet e kërcënimet. Për të përcarë e luftuar Bashkimin Sovjetik, vendet e reja të demokracisë popullore dhe unitetin e shëndoshë të proletariatit botëror, ai po shfrytëzon kudo që janë gjithë tradhëtarët e klasës punëtore dhe renegatët e marksizëm-leninizmit. Një nga këta renegatë të marksizëm-leninizmit, që është bërë vegël e imperializmit kundër Bashkimit Sovjetik, vendeve të demokracisë popullore dhe kampit të socializmit, është edhe Titua me klikën e tij trockiste që sundon me terror mbi popujt e Jugosllavisë dhe mbi proletariatin jugosllav, rruga e tretë e të cilit është ajo e Blumëve¹, e Bevinëve², e Saragatëve³ etj.

¹ Leon Blum, personalitet politik francez, drejtues i Partisë Socialiste. Armik i lëvizjes komuniste dhe punëtore. Disa herë ka kryesuar qeveritë borgjeze të Francës.

² Ernest Bevin, politikan reaksionar anglez. Një nga drej--

Grupit trockist të Titos i është gjerrë krejtësisht maska. Ai me parullat e Gëbelsit po lufton haptas Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, Partinë Bolshevike, udhëheqësin e madh Stalin dhe gjithë demokracitë e reja. Ai është hedhur kokë e këmbë definitivisht në kampin e imperializmit dhe është kthyer në një agjenturë të imperializmit amerikano-anglez.

Historia vërteton se të gjithë renegatët e marksizëm-leninizmit kanë dështuar në veprën e tyre tradhëtare, ata kurdoherë janë mundur. Një fat i tillë e pret dhe grupin trockist të Titos.

Ne shqiptarët e filluam dhe e zhvilluam Luftën nacional-çlirimtare me besim të patundur në fitoren, pse në krye të saj ishte Partia Komuniste e Shqipërisë, besnike për jetë e marksizëm-leninizmit, që e mobilizoi popullin totalisht dhe pse luftën e çlirimit e udhëhiqte Bashkimi Sovjetik dhe Ushtria Sovjetike korri suksese të njëpasnjëshme mbi armiqtë nazi-fashistë.

Gjatë këtyre gati pesë vjetëve jetë të lirë e të pavarur ne kemi arritur shumë suksese, një nga të cilët është edhe përgatitja e planit dyvjeçar që po paraqesim sot përpara Kuvendit Popullor për aprovim. Ky është një plan i realizueshëm, pse mbështetet në mundësitë e vendit tonë dhe në ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovje-

tuesit e djathtë të tredunioneve dhe i Partisë Laburiste Angleze. Pjesëmarrës në qeveritë borgjeze të Anglisë. Një nga organizatorët e Paktit të Atlantikut Verior.

3 Xhiusepe Saragaç, një nga udhëheqësit e djathtë të Partisë Socialdemokrate Italiane. Shumë herë ka marrë pjesë në qeveritë borgjeze të Italisë.

tik dhe të vendeve vëllezër të demokracisë popullore.

Pregatitja e planit dyvjeçar u bë e mundshme në një moment me rëndësi historike për vendin tonë, pas zbulimit të veprës armiqësore të trockistëve të Beogradit ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, të cilët, nën maskën e kreditit që na dhanë, kishin për qëllim të mbytnin ekonominë tonë dhe ta drejtonin këtë në rrugën kapitaliste. Orientimi dhe qëllimi i vërtetë i akordimit të kreditit Shqipërisë nga ana e nacionalistëve të Beogradit nuk është përveçse kopja e kësaj kushteve që Trumani u vinte vendeve, të cilat do të pranonin ndihmën e planit Marshall. Ja detyrimet që Trumani u impononte vendeve të marshallizuara në projektin ose fjalimin e tij përpara Kongresit amerikan:

1. Stabilizimi i monedhave të tyre, domethënë zhvleftësimin e tyre sipas nevojave të dollarit.

2. Sheshimi i kufive doganorë, domethënë zhdukjen e çdo ndalesë për t'u futur në tregjet e tyre.

3. Përdorimi në mënyrë të frutshme i burimeve të tyre, domethënë shfrytëzimin e këtyre në favor të interesave amerikane.

4. Nxitja e prodhimit të lëndëve të para të nevojshme për Shtetet e Bashkuara.

5. Pranimi që «ndihma» e marrë të kontrollohej në vend nga Shtetet e Bashkuara.

Çdo njeri, duke zëvendësuar fjalën dollarë me dinarë dhe fjalën Shtetet e Bashkuara me Jugosllavi, mund të konstatojë vetë se klika e Titos ka ndjekur pikë për pikë direktivat e Trumanit për të marshallizuar Shqipërinë e re. Në këtë drejtim të hapët imperialist ka dashur dhe është përpjekur ta degjenerojë ajo ndihmën

që popujt vëllezër të Jugosllavisë i akorduan popullit vëlla shqiptar. Në këtë drejtim të hapët imperialist, në një vend të marshallizuar, po e ndryshon Jugosllavinë e re Titua me shokë.

E famshmja hua jugosllave dhënë Shqipërisë nuk figuron në asnjë traktat se në ç'afate do të kthehej dhe me ç'interes na jepej. Qeveria shqiptare, për disa herë, e kishte ngritur këtë çështje përpara qeverisë jugosllave, por kjo, jo vetëm s'kishte dashur t'i caktonte këto gjëra, por e akuzonte qeverinë tonë, sikur s'kishte besim në aleancën derisa ngrinte të tilla probleme. «Pse të interesohet qeveria shqiptare për këtë gjë», ishte përgjegjja e Beogradit; «huaja që ne ju kemi dhënë, nuk do të kthehet kurrë, pse vendet tona shkojnë në socializëm». E kuptoni vetë në çfarë «socializëm» bevinist do të na çonte Titua me shokët e tij!

Grupi i Titos nën presionet ekonomike u përpoq ta izolojë Shqipërinë nga aleati i madh, Bashkimi Sovjetik, si dhe nga vendet e demokracisë popullore. Shqipëria duhej të punonte, të prodhonte për Jugosllavinë dhe nën drejtimin e Beogradit. Nën presionet ekonomike grupi i Titos i hoqi doganat, u përpoq të hidhte në dorë dhe t'i lidhte drejtpërdrejt nga Beogradi të gjitha minierat tona, ndërsa agjenti titist, Savo Zllatiç, në momentin e fundit të qëndrimit të tij në Shqipëri, arriti të propozojë që në marrëdhënjet e dy vendeve të përdorim format e Beneluksit¹. Klika e Beogradit u përpoq të unifi-

¹ Beneluks — Emërtim i shkurtuar i bashkimit ekonomiko-politik midis Belgjikës, Hollandës dhe Luksemburgut, i krijuar në vitin 1944.

konte ushtrinë tonë me atë të saj, ajo u përpoq të zhdukte Bankën e Shtetit tonë dhe ta zëvendësonte me Bankën shqiptaro-jugosllave, parifikoi monedhën tonë me dinarin; ajo nuk ka dashur në asnjë mënyrë të investojë në minierat tona, në bazë të akordeve dhe të traktateve, sepse ajo më parë duhej të konsumonte aneksimin e plotë të Shqipërisë mbasandaj të investonte. Beogradi nuk ndihmoi aspak në zhvillimin e industrisë sonë të lehtë, përkundrazi, kërkonte që asnjë lëndë e parë të mos punohej në Shqipëri, por të shkonte në Jugosllavi.

Titistët, me paturpësinë më të madhe, mburrën se kanë sjellë te ne një fabrikë sheqeri, e cila në fakt jo vetëm është qind për qind e konsumuar dhe s'ka veçse dy vjet jetë, por është paguar shtrenjtë prej nesh, filatura e pambukut është paguar me dollarët tanë, kurse hekurudha Tiranë-Peqin u ngrit me paret e popullit tonë, me krahët dhe djersën e rinisë sonë heroike që aq shumë urrehej nga titistët. Banda e Titos, pasi konsumoi të gjitha këto përpjekje të pafrutshme, pse vazhdimisht gjente rezistencë, përdori më në fund edhe armën e frikës e të shantazhit deri në orvatjen për pushtimin e vendit tonë me armë.

Ne kemi besuar se Mosha Pijade, «mbronte» sovranitetin e Shqipërisë në bisedimet e fshehta që ka pasur me Caldarisin në Paris¹, kur ky i fundit i propozoi copëtimin e Shqipërisë. Tani është e qartë për ne se ku e

¹ Bisedimet midis Mosha Pijades dhe Caldarisit u zhvilluan gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris më 29 korrik — 15 tetor 1946.

kishte qëllimin klika titiste. Caldarisi s'u gabua në qëllimet e Titos me shokë, ai kishte dijeni se me kë kishte të bënte dhe, nëse Titua e Mosha Pijade s'i pranuan propozimet e Caldarisit për ta ndarë vendin tonë, këtë e bënë pse dëshironin dhe mendonin që Shqipërinë e kishin të tërë, të sigurtë në fund të xhepit të tyre. Mirëpo Titos nuk i dolën hesapet ashtu si i kishte bërë. Atëhere klika e tij u përpoq të fuste ushtrinë jugosllave në vendin tonë, të krijonte incidente ndërkombëtare dhe nën maskën se gjoja mbronte Shqipërinë, ta okuponte këtë krejtësisht, të ndryshonte rrënjësisht situatën në vendin tonë, të sillte në fuqi agjentët e tij, Koçi Xoxen me shokë dhe të krijonte kështu një Jugosllavi të madhe siç kanë ëndërruar dhe gjithë krajlët e Serbisë e të Jugosllavisë së vjetër, ta kthente këtë në një bazë të reaktionit një «place d'armes» në Ballkan kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Imperializmi amerikan kishte gjetur një kalë të mirë te renegati Tito, për të hedhur kthetrat në Evropën Juglindore. Por planet e tij u përmbysën dhe u demaskuan.

Klika e Beogradit pati sukses për një kohë, por asaj ju çor maska dhe Titua me klikën e tij dolën me fytyrën e tyre të vërtetë prej tradhëtarësh e veglash të imperializmit. Partia Bolshevike e lavdishme dhe Byroja Informativë, në dritën e fakteve të pakundërshtueshme, zbuluan rrezikshmërinë e madhe që u vinte popujve të Jugosllavisë dhe kampit socialist nga kjo klikë.

Ju e dini, sa i madh ishte rreziku që kërcënonte veçanërisht vendin tonë nga grupi trockist i Beogradit. Shqipëria jonë, demokracia jonë, e ardhshmeja e popullit tonë ishin në rrezik të madh.

Orvatjet për kolonizimin e Shqipërisë klika e Titos i filloi me një hua që i dha Republikës sonë. Ne e pranuan huan me gjithë zemër dhe kemi folur shumë mirë për këtë ndihmë që na jepnin popujt e Jugosllavisë. Ne kemi qenë të sigurtë në qëllimet tona, por më vonë u zbulua se çfarë fshihej në këtë «vazo me lule».

Klika e Titos po bën tani zhurmë të madhe rreth tharjes së Liqenit të Shkodrës dhe refuzimit nga ana jonë. Dëshiroj të them disa fjalë mbi këtë çështje, sido që çdo gjë është e qartë mbi qëllimet e fushatës së Titos dhe të shokëve të tij.

Si mund të pranohet propozimin e qeverisë së Beogradit mbi tharjen e Liqenit të Shkodrës pas gjithë atyre ngjarjeve tragjike që u vërtetuan? Të pranosh këtë, do të thotë t'u hapësh portat përsëri agjentëve të Titos, të cilët për disa vjet me radhë përdorën të gjitha mjetet dhe metodat për të kolonizuar vendin tonë. Për popullin shqiptar tashmë u bënë të qarta qëllimet e klikës së Beogradit. Atë që bëri Musolini kundër vendit tonë më 1939, atë u përpoq të bënte edhe Titua.

Tharja e Liqenit të Shkodrës është ngritur nga Titua për të futur edhe një herë këmbët në Shqipëri. Ai ishte i sigurtë se s'do të kishte sukses, por nga ky dështim, ai u përpoq të nxirrte disa përfitime propagandistike, për t'i thënë, për shembull, popullit tonë se qeveria «bujare» e Titos propozoi të thaheshin fushat e bregdetit të Shqipërisë së Veriut, por qeveria shqiptare s'pranoi, kështu populli i Shkodrës, Lezhës etj. kanë për të vdekur nga malarja. Por Titua e di fare mirë se populli shqiptar dhe qeveria e tij janë në gjendje ta luftojnë malarjen me sukses, sikundër kanë bërë, por

cdhe sikur të mos kishin mundësi, preferojnë më mirë t'i pickojnë ca mushkonjat anofele, se sa t'i pinë gjakun «mushkonjat» titiste.

Arësyeja tjetër që klika e Titos ka ngritur tharjen e Liqenit të Shkodrës është te Mali i Zi, pika e dobët e kësaj klikë. Populli heroik i Malit të Zi, që ka luftuar me trimëri për lirinë, për demokracinë e vërtetë, për vëllazërimin me popujt e Bashkimit Sovjetik, për miqësinë e ngushtë me popullin tonë, vuan tmerrësisht nga klika e Titos, që ja shtypi të gjitha aspiratat shekullore atij dhe gjithë popujve të Jugosllavisë. Populli i vogël heroik i Malit të Zi nuk mund ta durojë shtypjen, prandaj klika e Tito-Rankoviçit merr masa për të shtypur rezistencën e tij. Plani i tharjes së Liqenit të Shkodrës është një demagogji për ta gënjyer popullin e Malit të Zi. Që në fillim klika e Titos ka nxjerrë arësyet e mosrealizimit të këtij plani duke trumbetuar se «është një aksion i zorshëm», «shumë i kushtueshëm» se «Shqipëria s'pranoi të bëheshin punimet në tokën e saj» etj. Kjo klikë me këta argumenta kërkon të armiqësojë malazeztë me shqiptarët, të përdorë armën e helmatisur të nacionalizmit dhe të shovinizmit të kral Aleksandrit. Por taktika e saj do të dështojë, pse populli i Malit të Zi i provoi vetë shqiptarët që s'kursyen gjakun e tyre, duke luftuar tok me të për të çliruar Malin e Zi nga thonjtë e gjermanëve. Populli i Malit të Zi e kupton fare mirë se populli shqiptar, duke mbrojtur pavarësinë e vet nga agjentët e Titos, mbron dhe ndihmon njëkohësisht popullin e Malit të Zi dhe të Jugosllavisë.

Trumbetimi i tharjes së Liqenit të Shkodrës nga klika e Titos ka për qëllim të shmangë popullin e Malit

të Zi nga preokupimi i tij kryesor, çlirimi sa më shpejt nga klika e Titos. Terrori është i madh, burgjet janë mbushur me patriotë, prandaj edhe mëria e popullit malazez kundër Titos është e madhe dhe do të vijë koha që malet e këtij vendi do të ndjellin në gjirin e tyre heronjtë e rinj të çlirimit të Jugosllavisë nga banda e trockistëve të Beogradit, heronjtë që ndjekin rrugën e lavdishme të Arso Jovanoviçit¹ dhe që luftojnë nën flamurin e internacionalizmit, kundër klikës nacionaliste të Titos, agjente e imperializmit, që po i bën varrin Jugosllavisë së re, për të cilën malazeztë derdhën aq gjak.

Të njëjtat masa barbare po merr klika e Titos kundër shqiptarëve të Kosovës, të Metohisë, të Maqedonisë e gjetkë. S'mjaftuan krimet e pashembullta që janë bërë nga kral Aleksandri kundër kosovarëve, s'mjaftuan krimet dhe vrasjet në masë të kosovarëve shqiptarë në prakun e çlirimit të Jugosllavisë të bëra nga klika Tito-Rankoviç të fshehur nën maskën e komunistit. Tani kanë filluar më me egërsi persekutimet e shqiptarëve të Kosovës, të cilët s'gëzojnë asnjë liri. Disa shkolla shqipe që ekzistojnë, janë sa për sy e faqe, në pushtet është skartuar elementi i ndershëm dhe punonjës shqiptar; vetëm disa shërbëtorë të klikës së Titos e spiunë të Rankoviçit përfaqësojnë atje gjoja popullin shqiptar të Kosovës. Reforma agrare u bë për sy e për faqe dhe tani me masa arbitrare bujqve kosovarë po u rrëmbehet

¹ Arso Jovanoviç (1906—1948). Hero i popujve të Jugosllavisë, udhëheqës i shquar ushtarak jugosllav në luftën kundër pushtuesve fashistë italo-gjermanë. U vra pabesisht nga organet e shërbimit të fshehtë të Jugosllavisë.

loka e gjëja e gjallë, po u grabiten prodhimet nga emisarët e Titos e të Rankoviçit.

Klika nacionaliste e Titos ka në plan shfarosjen e shqiptarëve të Kosovës, ajo ka në plan mobilizimin e 7 kurave burrash kosovarë për t'i shpërngulur nga vendi i tyre dhe për t'i mbyllur të vdesin në ndonjë kamp me gjëmba nga Banati o nga Sllovenia. Ne ngremë zërin për mbrojtjen e vëllezërve tanë kosovarë, pse Titua dhe banda e tij po përgatitin për ta atë që bëri shoku i tyre Caldarsi për çamët. Ky është një krim i ri i Titos kundër shqiptarëve në Kosovë. Shovinistët e Beogradit kanë mbrojtur e ruajtur xhelatët e popullit të Kosovës dhe agjentët e Inteligens Servis-it si Gani Kryezinë dhe për t'i pasur për këto momente, për t'i përdorur kundër Shqipërisë së re dhe njëkohësisht për të shtypur e shfarosur shqiptarët e Kosovës, ata po grumbullojnë banditët shqiptarë si Cen Elezi, Dan Kaloshi etj. Disa dhjetëra fshatarë mendjeshkurtër nga kufitë e rretheve Kukës e Tropojë janë arratisur nga atdheu dhe kanë shkuar me familje në «parajsën» titiste. Populli shqiptar i Kosovës i urren këta njerëz dhe i quan tradhëtarë të atdheut të vet. Por këta të arratisur kanë filluar ta njohin «parajsën» e Titos. Gratë dhe kalamanët atyre u janë internuar diku në Banat me qëllim që këta mendjelehtë, nën presionin dhe gënjeshtër të Rankoviçit t'i shërbejnë agjenturës titiste, kundër atdheut të tyre. Fati i këtyre njerëzve është fati i spiunëve. Ata do të mbarojnë të pushkatuar prapa shpine nga plumbat e Rankoviçit ose do të lënë koskat në bjeshkët tona kufitare të mbrojtura me vigjilencë dhe me heroizëm nga Ushtria jonë e lavdishme Kombëtare dhe gjithë popullsia

fshatare kufitare. Sa për familjet e tyre ato do të vdesin urie dhe do të torturohen për vdekje nga bandat e Rankoviçit në Majdanikët¹ e rinj.

Klika nacionaliste e Titos po nxit në Kosovë hasmëritë e vjetra dhe shovinizmin ndërmjet shqiptarëve, malazezve dhe serbëve, të cilët persekutohen në të njëjtën mënyrë si shqiptarët. Burra të guximshëm dhe patriotë malazez, që mbrojnë popullin shqiptar të Kosovës nga klika e Titos, burgosen përnjëherësh dhe torturohen për vdekje. Me çdo kusht klika e Titos kërkon të pengojë vëllazërimin e shqiptarëve dhe jugosllavëve, aq shumë i dëshirueshëm dhe shpëtimtar, pse vetëm kështu, në një vëllazërim të ngushtë dhe të sinqertë në luftë kundër klikës së Titos, do të shpëtojnë popujt e Jugosllavisë nga katastrofa ku i çon Titua me shokë, pse vetëm kështu do të fitohen liria dhe të drejtat e ligjshme të popujve të Jugosllavisë dhe të shqiptarëve të Kosovës, Metohisë, Maqedonisë etj. Populli shqiptar është i bindur se vëllazërit shqiptarë të Kosovës do të bashkojnë të gjitha forcat e tyre me popujt vëllazër të Malit të Zi, të Serbisë etj. dhe së bashku me ta do ta dërmojnë klikën tradhëtare të Titos, renegate e marksizëm-leninizmit dhe e kauzës së shenjtë të proletariatit.

Kundër Shqipërisë titistët kanë shpërthyer një fushatë të egër shpifjesh. S'ka ditë që organi i ndytë i klikës nacionaliste jugosllave «Borba» të mos vjellë vrer kundër nesh. Ata po mbrojnë mikun dhe agjentin e

¹ Kamp përqëndrimi i nazistëve gjermanë në afërsi të Lublinit (Poloni) ku gjetën vdekjen miliona njerëz nga vendet e ndryshme të Evropës së okupuar nga hitlerianët.

tyre Koçi Xoxe dhe kështu provojnë tradhëtinë e këtij spiuni titist. Por nuk mjafton kjo, klika e Titos po vazhdon taktikën e Caldarsit në kufirin e Veriut duke provokuar vazhdimisht me armë dhe me aeroplanë që dërgon për të shkelur sovranitetin e tokës sonë në zonën e Shkodrës. Këto provokacione ajo i përdor për të krijuar në popujt e Jugosllavisë armiqësinë kundër Shqipërisë; ajo pengon nënshtetasit shqiptarë të kalojnë tranzit nëpër Jugosllavi, duke mos u akorduar vizat, nën pretextin e shpifur dhe aspak të bazuar se gjoja Shqipëria nuk u jep vizë nënshtetasve jugosllavë që banojnë në Shqipëri dhe dëshirojnë të kthehen në Jugosllavi. Por Shqipëria e vogël heroike nuk tutet nga këto kërcënime e shantazhe. Asaj i janë bërë vazhdimisht veprime të tilla nga padronët e Titos, imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tjerë të këtyre, monarko-fashistët grekë dhe u ka bërë ballë me sukses. Populli shqiptar dhe Republika jonë Popullore po forcohen dita-ditës, ata po çelnikosen në përpjekje dhe kurdoherë do të ecin përpara në rrugën e tyre të drejtë, të vendosur në kampin e socializmit dhe me besnikëri të pakufishme për Bashkimin Sovjetik dhe Josif Stalinin.

Shokë deputetë,

Nëpërmjet shumë situatash të vështira ka kaluar vendi ynë, por kurdoherë populli shqiptar i ka kapërcyer këto dhe ka korrur suksese. Sukseset këtej e tutje do të jenë edhe më të mëdha, pse shumë gjëra të gabuara janë ndrequr dhe çështjet janë vënë në rrugën e drejtë.

Politika ekonomike e shtetit tonë, e spastruar nga pikëpamjet e gabuara trockiste jugosllave ka filluar të japë frutet e veta. Urdhëresat e reja ekonomike janë kuptuar drejt dhe janë përqafuluar nga masat punonjëse të fshatit dhe të qytetit. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm s'kanë munguar t'i luftojnë këto urdhëresa, që janë krejtësisht në interesin e masave të gjera punonjëse dhe siç ka dështuar çdo përpjekje e reaksionit për të na dëmtuar, ashtu do të dështojnë edhe përpjekjet e bëra në këtë drejtim. Në politikën ekonomike të shtetit tonë, fshatari ka parë qartë rrugën e vërtetë të ngritjes së standardit të jetës së tij dhe të masave punonjëse të qytetit, ka parë rrugën për forcimin e pushtetit të tij popullor, rrugën e aleancës me klasën punëtore dhe së bashku nën udhëheqjen e Partisë, shkojnë drejt fitoreve të reja. Masat e gjera të fshatarëve punonjës e kanë kuptuar dhe, sa kohë shkon, binden edhe më tepër mbi drejtësinë e urdhëresave të reja ekonomike, që nxitin fshatarësinë të prodhojë më shumë e më mirë, për të mirën e saj dhe të të gjithë punonjësve të tjerë. Ato u bëjnë të qarta fshatarësisë dhe gjithë popullit se kaosi në prodhim dhe në tregëti duhet të luftohet me të gjitha forcat, pse ai u shërben armiqve të popullit, kapitalistit të qytetit dhe të fshatit, të cilët luftojnë me të gjitha mjetet për të dëmtuar pushtetin popullor, për të dobësuar forcën e tij dhe për të rrezikuar kësisoj pavarësinë e vendit tonë. Reaksioni i brendshëm synon në rivendosjen e pushtetit të beut dhe të agait, gjë që masat e gjera punonjëse të fshatit dhe të qytetit e kuptojnë fare mirë ç'do të thotë.

Siç thashë më lart, efektet e urdhëresave të drejta

tu qëndron madhështia e marrëdhënjeve dhe e ndihmës së çmueshme që ai u jep vendeve tona për të ndërtuar socializmin.

Kurse plani Marshall po i skllavëron ato vende ku ka futur kthetrat. Mallrat amerikane kanë mbuluar tregjet e tyre dhe ato fabrika që kanë mbetur në këmbë kapitali amerikan përpiqet t'i futë nën mbikëqyrjen dhe shfrytëzimin e tij. Pavarësia ekonomike e vendeve të marshallizuara, ku sundon thundra e hekurt e imperia-lizmit amerikan po zhduket. Atje po zhduket liria po-litike dhe ekonomike, po mbyllen fabrikat nacionale, po shtohet papunësia dhe mjerimi i popujve, kurse në vendet e reja të demokracisë popullore ngjet krejt e kundërta: forcohen liria e pavarësia, zhvillohet indus-tria me shtimin e fabrikave, zhvillohet e modernizohet bujqësia, përparojnë arti, kultura, arësimi, shkenca, ngrihet me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë standardi i jetës së popullit, po shkohet, me një fjalë, në socializëm.

Bujqësisë shteti ynë i ka vënë një kujdes të veçantë, gjë që shihet nga investimet e mëdha që janë cak-tuar për këtë sektor. Dhe ky është një orientim më se i drejtë. Bujqësia jonë duhet të modernizohet dhe të ecë kurdoherë përpara. Në plan parashikohet mbarimi i mjaft veprave të mëdha bonifikuese, që do të shtojnë fondin e tokës së punueshme, do të bëjnë të thahen kë-neta dhe të ujiten toka që vuajnë nga thatësira. Në plan parashikohen gjithashtu përmirësime në fermat shtetë-rore, ndihma kooperativave bujqësore, ndihma për për-mirësime në cilësi dhe në sasi të blegtorisë sonë, inves-time për mirëmbajtjen dhe shtimin e pyjeve, të pemëve frutore etj.

Plani ynë dyvjeçar synon të shtohet buka e popullit dhe në të ardhshmen të shpëtojmë nga importimi i drithit, që është një barrë e madhe për vendin tonë. Nga ana tjetër plani ynë synon të shtohen prodhimet që rrjedhin nga bimët industriale për nevojat e fabrikave tona dhe për të eksportuar, ai synon gjithashtu në shtimin e blegtorisë për të kënaqur nevojat e popullit me prodhime blegtorale dhe për eksport. Këtë synon ky plan edhe në sektorët e tjerë të bujqësisë dhe në pyjet.

Krahas me këta sektorë të rëndësishëm, plani ynë i kushton një rëndësi të veçantë sektorit të komunikacionit dhe të transportit duke investuar për këtë qëllim shuma të konsiderueshme.

Plani ynë dyvjeçar u kushton një kujdes të veçantë kulturës, arësimit, shkencës, ngritjes së kuadrove të rinj në të gjithë sektorët e aktivitetit ekonomik dhe social.

Siç e shihni, shokë deputetë, janë të gjitha mundësitë që plani dyvjeçar të realizohet me sukses, gjë që kërkon mobilizimin e gjithë popullit tonë. Të gjitha forcat e gjalla të popullit duhet të vihen në veprim dhe, me hovin revolucionar e entuziazmin e papërshkrueshëm që karakterizon masat tona punonjëse, t'i përvishemi kësaj pune, që ka të bëjë me ndërtimin e jetës sonë më të mirë, që siguron të ardhshmen e sigurtë dhe të lumtur të brezave të rinj të vendit tonë, ndërtimin e socializmit në Shqipërinë e re.

Çdo nënshtetas i Republikës sonë Popullore, kudo që është, ta ketë për nder dhe për mburrje punën për realizimin e planit të shtetit. Kjo është një detyrë e madhe patriotike që do të thotë të forcosh pavarësinë eko-

nomike dhe politike, të forcosh lirinë dhe pavarësinë e vendit, të përballosh me sukses kërcënimet dhe shantazhet e armiqve të jashtëm dhe të zhdukësh nga rrënjët armiqtë e brendshëm, t'ua presësh këtyre duart, t'i çarmatosësh krejtësisht.

Detyra të mëdha vihen përpara gjithë punonjësve të vendit tonë. Planin tonë dyvjeçar ne duhet ta realizojmë dhe do ta realizojmë. Garancia më e shëndoshë për këtë është patriotizmi i madh i masave tona punonjëse, i klasës sonë punëtore heroike, i fshatarësisë patriote, i rinisë heroike dhe i gruas trime shqiptare, që kanë dhënë prova të shkëlqyera të atdhedashurisë, të sakrificave të papërshekrueshme e të heroizmit në kohën e Luftës nacional-çlirimtare dhe në kryerjen e detyrave të rindërtimit pas luftës. Masat e popullit tonë heroik, nën udhëheqjen e Partisë, arritën gjithë këto fitore. Në udhëheqjen e Partisë heroike të Punës dhe të Qeverisë së Republikës sonë Popullore, populli ynë po shkon tani drejt fitoreve të reja.

Vendimet e Kongresit I të Partisë, që përcaktoi drejtimet dhe detyrat e planit dyvjeçar, populli ynë do t'i vërë në jetë me besim të patundur dhe të shumëfishuar te Partia e tij e dashur që e udhëheq në rrugën e socializmit. Po ndërtojmë jetën tonë më të begatshme e të lirë, po punojmë për lulëzimin e fushave dhe të pyjeve tona, po derdhim djersë për të nxjerrë dhe për të shumuar pasuritë e nëntokës, po luftojmë që populli të ketë më shumë, që jetën ta shkojë të lumtur e të gëzuar, po luftojmë për të ndërtuar shtëpi, shkolla e kopshte, ku njerëzit e kalamanët tanë të rrojnë të lumtur, të gëzuar, të lirë, të edukohen me frymën e madhe të

patriotizmit, me traditat bujare, heroike, liridashëse, paqësore të popullit tonë, të rrojnë e të luftojnë të frymëzuar nga internacionalizmi proletar dhe me një dashuri të pakufishme për popujt e Bashkimit Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe Stalinin, shpëtimtarët e ndihmësit e mëdhenj të popullit tonë.

Kështu mendon, kështu ndjen dhe me këtë entuziazëm ka luftuar dhe lufton populli ynë. Ai e ka të qartë ç'përfaqëson realizimi i planit të shtetit për të, se ai është jeta e tij, është forcimi i atdheut të dashur, është forcimi i pavarësisë së Shqipërisë, është ecja për në socializëm.

Hovi i vrullshëm i popullit do t'i fshijë të gjithë ata armiq, që do të pengojnë realizimin e planit dhe njëkohësisht do t'u japë dorën, do t'i ndihmojë ata që mbajnë qëndrime indiferente, por që nuk pranojnë të keqen e atdheut, që nuk pranojnë të rrezikohet ai nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Të aktivizohen të gjithë këta njerëz nga masat revolucionare të popullit, të përveshin krahët në çdo punë për ndërtimin e jetës së re dhe do të shohin si të gjithë se jeta vlen të jetohet në atdheun e lirë e sovran. Atdheu është i të gjithëve, por është më se e natyrshme që atdheun dhe popullin i duan më shumë ata që luftojnë, që vriten, që derdhin djersë, që punojnë ditë e natë për të. Të lidhësh duart dhe nga ana tjetër të pretendosh atë që s'të përket dhe që s'e meriton, të jesh i sigurtë se s'ka për të ta dhënë njeri. Populli do të të dojë, do të të ndihmojë, do të të respektojë, kur të kesh bërë detyrën ndaj tij, kur të kesh kryer me nder, me guxim e heroizëm detyrat e qytetarit, kur të jesh kurdoherë në shërbim të popullit,

kur të jesh i thjeshtë e modest në punën që të është ngarkuar, qoftë kjo nga më të lartat në administratën shtetërore.

Partia jonë e Punës, që udhëheq fatet e popullit dhe që po i edukon njerëzit e saj në këtë frymë, është njëkohësisht Partia e dashur e të gjithë patriotëve pa parti, e të gjithë anëtarëve të Frontit Demokratik. Ajo është forca mobilizuese e të gjithëve që do të kujdeset, do t'i ndihmojë, do t'i mbrojë e do t'i edukojë me gjithë zemër ata që e duan atdheun dhe popullin. Ky është roli i saj pararojë i masave punonjëse të vendit tonë. As energjinë më të vogël Partia jonë nuk do ta lërë të mos shkojë në interes të popullit dhe të atdheut. Ajo do të vijtojë me kujdesin më të madh dhe në unitet të çelniktë me popullin, do të grumbullojë të gjitha energjitë e shëndosha të vendit në një forcë të pathyeshme; të gjithëve do t'u hapë perspektiva të rrojnë, të luftojnë dhe të punojnë me nder. Trockistët jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë u përpoqën shumë të ndanin Partinë nga masat, të armiqësonin njerëzit me Partinë, por ata dështuan në veprën e tyre shkatërrimtare. Partia u lidh edhe më fort me popullin, ajo është bërë tani më e shtrenjtë, më e dashur, më e vyer, pse ajo është udhëheqësja dhe mbrojtësja e lavdishme e interesave të popullit dhe të atdheut.

Për realizimin e planit të mobilizohet totalisht klasa punëtore në fabrika, në kantiere, në punishte, ajo të bëhet faktori kryesor për këtë qëllim dhe njëkohësisht shembull për të gjithë të tjerët. Klasa punëtore të jetë në ballë për të përvetësuar dhe për të përmirësuar teknologjinë e prodhimit, të mirëmbajë dhe të ruajë si sytë

e ballit maqineritë, të zhdrukë çorganizimin në punë, të punojë me norma dhe me gara, të bëjë që plani të njihet mirë nga çdo repart, sektor dhe individ, të luftojë kudo për të vënë një disiplinë të hekurt në punë; të punojë në mënyrë që të prodhohet me kosto sa më të ulët dhe me kualitet sa më të mirë. Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, gjithë punëtorëve, teknikëve, inxhinierëve u ngarkohen detyra të rëndësishme për të organizuar sa më mirë punën për plotësimin me sukses të detyrave. Të ndihmohen dhe të inkurajohen novatorët e shpikësit deri te inisiativa më e vogël. Të përmirësohen kushtet e punës e të jetesës të punëtorëve dhe të ndihmohet zhvillimi sa më i madh i lëvizjes sulmuese. Të inkurajohen, të ndihmohen dhe të shpërblehen sipas meritave dhe zotësisë teknikët dhe inxhinierët që të vënë në shërbim të atdheut gjithë dituritë e tyre.

Artizanati të inkurajohet dhe të zhvillohet më tej që të shtohen kësisoj prodhimet, që kanë qenë tradicionale në këtë sektor. Artizanati të ndihmojë industrinë tonë të lehtë dhe të përmbushë një pjesë të nevojave me artikuj të dorës së parë. Për këtë qëllim, të inkurajohet dhe t'i jepet ndihmë nga ana e organizatave ngritjes së kooperativave të artizanatit.

Fshatarësia jonë të mobilizojë të gjitha forcat e veta për të prodhuar sa më shumë e sa më mirë, të hapë toka të reja dhe të përvetësojë metodat e reja agroteknike për të shtuar prodhimet. Shteti duhet t'i japë bujqësisë ndihmën teknike, duke mobilizuar për këtë, të gjithë teknikët dhe specialistët bujqësorë të vendit, të cilët të largohen nga puna burokratike e zyraive, për të shkuar atje ku punohet toka dhe ku prodhohet.

Përveç bonifikimeve që parashikohen në plan, vetë fshatarësia të shtojë përpjekjet dhe inisiativën e vet për çeljen e kanaleve të vogla ujitëse lokale, të përmirësojë dhe të shtojë bagëtinë e kafshët e punës, shpendët dhe bletët, të shtojë derrat dhe kafshët e tjera shtëpiake.

Fshatarësia jonë të forcojë dita-ditës sa më shumë aleancën me klasën punëtore dhe me të gjitha masat punonjëse të qytetit. Urdhëresat e reja ekonomike duhet të jenë orientimi i vetëm i fshatarësisë së varfër dhe të mesme, prandaj t'i kuptojë, t'i mbrojë dhe t'i zbatojë ato, pse vetëm në këtë mënyrë ajo do të përmirësojë dita-ditës kushtet e jetesës. Fshatarësia e varfër dhe e mesme, nën udhëheqjen e klasës punëtore, të mos e pushojë për asnjë çast luftën kundër elementit kulak, i cili po lufton urdhëresat e qeverisë dhe rrugën e drejtë që ndjek populli ynë për ndërtimin e bazave të socializmit.

Ministria e Bujqësisë dhe gjithë njerëzit, që punojnë në këtë dikaster, në fermat shtetërore dhe në SMT-të, duke filluar që nga punëtori i thjeshtë dhe deri te tekniku e funksionari më i lartë, të vënë tërë kujdesin për organizimin më të mirë të punës, për zhdukjen e shumë të metave e çrregullimeve që ekzistojnë. Të shtohet rendimenti dhe të përmirësohet kualiteti i prodhimeve në fermat shtetërore, të cilat të bëhen qendra të mëdha prodhimi dhe studimi, modele dhe ndihmëse për fshatarësinë dhe për kooperativat bujqësore në radhë të parë. SMT-ve t'u vihet një kujdes i veçantë, pse në to ka shumë neglizhenca dhe pakujdesi, që duhet të marrin fund.

Në lëmin e arësimit dhe të kulturës plani dyvjeçar,

që prej të voglit deri te i madhi, vë detyra të rëndësishme. Në radhë të parë duhet të luftohet me të gjitha forcat analfabetizmi. Kjo luftë duhet të bëhet një detyrë e madhe patriotike jo vetëm për arsimtarët, për rininë, për punonjësit e artit etj., por për gjithë popullin. Çdo njeri analfabet te ne duhet t'i vëjë vetes si detyrë të parë të mësojë të shkruajë dhe të lexojë. Shtetit i bie barra ta zhvillojë këtë fushatë në mënyrë të organizuar dhe ta kontrollojë.

Rinia jonë të ndjekë në rregull shkollat dhe të mësojë mirë. Kjo detyrë i vihet rinisë punëtore e fshatare në radhë të parë dhe gjithë rinisë sonë në përgjithësi. Shtetit dhe veçanërisht dikasterit të arsimit i vihen detyra të rënda për ta ngritur shkollën në nivelin e duhur. Një kujdes i veçantë u duhet vënë shkollave në fshat, të cilat të pajisen me mjetet e nevojshme dhe atje të dërgohen nga mësuesit më të mirë.

Edukimit të mësuesve të shkollave fillore, shtatvjeçare e të mesme t'i kushtohet një kujdes i veçantë; të ndihmohen e të përkrahen këta në punën e tyre dhe brenda mundësive, nevojat e tyre të plotësohen nga shteti. Të ndihmohen veçanërisht njerëzit e shkencës, të artit e të kulturës, si nga ana politike, ashtu dhe materiale dhe dituritë e tyre këta t'i vënë në shërbim të popullit.

Ne konstatojmë me kënaqësi se përpjekjet e shtetit tonë, për t'i dhënë një hov sa më të madh edukimit të rinisë me shkencë dhe me kulturë të re, zhvillimit të artit, të muzikës, të sportit, aktivizimit të shkencëtarëve e të shkrimtarëve tanë, kanë dhënë rezultate, por këto s'mund t'i quajmë të mjafta. Për këtë arsye kër-

kohet një mobilizim më i madh, kurdoherë më i madh dhe ne do ta bëjmë këtë, pse brumi është nga më të mirët, pse njerëzit tanë kanë një vullnet të çuditshëm dhe janë të etshëm për të përvetësuar shkencën, kulturën, letërsinë dhe artin përparimtar.

T'i vëmë rëndësi të veçantë ngritjes profesionale të kuadrit, pse vetëm kështu do të realizojmë me sukses detyrat që cakton plani dyvjeçar. Prandaj, nëpërmjet një rrjeti shkollash dhe kursesh, të punohet që të ngrihen kuadrot nga ana teknike dhe profesionale.

Të tregohet kujdes i madh për mbrojtjen e popullit nga sëmundjet, të luftohen vazhdimisht malarja dhe sëmundjet e tjera. Të interesohemi në mënyrë të veçantë për shëndetin e rinisë sonë dhe të kalamanëve.

Tregëtia dhe organet e grumbullimit duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për furnizimin e popullit dhe për grumbullimet e ndryshme. Të zbatohet si duhet sistemi i ri i shkëmbimit reciprok, i cili të bëhet i kuptueshëm për popullin. Fondet e grumbullimeve shtetërore, si dhe grumbullimi i tepricave, të realizohen qind për qind dhe pa as më të voglin lëshim. Ndaj kujtdo që bën lëshime në këtë drejtim dhe shkel ligjet e urdhëresat, qofshin këto organe shtetërore, qofshin prodhues, do të merren masa të rrepta ndëshkimore. Rrjeti i tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste të organizohet më mirë dhe t'i shërbehet më mirë e më shpejt popullit. Të zbatohen drejt dhe në kohën e duhur të gjitha urdhëresat e qeverisë për grumbullimin e detyrueshëm të prodhimeve si për nevojat e brendshme, ashtu edhe për eksportime dhe të respektojmë medoemos detyrimet me jashtë për të ecur gradualisht drejt balancimit

të importimeve me eksportimet dhe për të siguruar investime të tjera për të ardhshmen.

Tregëtarët e vegjël patriotë dhe zanatçinjtë e vegjël, që u është njohur e drejta të ushtrojnë një farë tregëtie, duhet të punojnë ndershmërisht dhe me punën e dyqanet e tyre të vogla të ndihmojnë tregëtinë shtetërore, t'i shërbejnë kështu popullit e të fitojnë për vete bukën. Këta të kenë kurdoherë parasysh se spekulimi dënohet rëndë nga ligjet e shtetit tonë dhe organet e pushtetit do të vigjilojnë vazhdimisht në këtë drejtim.

T'i vihet një rëndësi e madhe forcimit dhe zhvillimit të komunikacionit. Të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen mirë linjat hekurudhore, të ruhen me kujdes lokomotivat, të shtohen dhe të shfrytëzohen plotësisht mjetet detare, të organizohet puna më mirë në transportin automobilistik, ku të vihet një disiplinë e fortë, që tani mungon, të ngrihen kuadro të rinj në këtë sektor dhe të punohet që maqinat të ruhen si sytë e ballit.

Realizimi i planit kërkon nga të gjithë të mobilizojmë forcat dhe të organizojmë kudo punën në mënyrë të shëndoshë, të luftojmë pa mëshirë burokratizmin, konfuzionin, mungesën e disiplinës, abuzimet. Ata që abuzojnë të dënohen, por nga ana tjetër t'i ndihmojmë kuadrot konkretisht në punë, t'i mësojmë, t'i orientojmë dhe të mos i lëmë vetëm përballë vështirësive. Të vendoset një kontroll i rreptë kudo dhe t'u kërkohej të gjithëve llogari për detyrën që u është ngarkuar. Të shtojmë operativitetin në punë, të përkrahim dhe të nxitim inisiativën dhe përgjegjësinë personale. Puna

me plan të bëhet sistem dhe të hyjë në gjakun e në jetën e njerëzve tanë. Disiplina e planit duhet të jetë e çelniktë, të luftohen lëshimet, shthurjet dhe moskoordinimi i punëve, sidomos midis ndërmarrjeve ekonomike. Të ruhet si sytë e ballit pasuria shtetërore dhe kjo të bëhet një detyrë e madhe patriotike për të gjithë, të bëhen kursime kudo.

Shokë deputetë,

Përpara gjithë popullit, siç e shihni, shtrohen detyra të mëdha për të realizuar planin, që po i paraqitim sot Kuvendit Popullor për aprovim. Ne jemi të bindur se masat e gjera të popullit tonë punonjës do ta presin atë me entuziazëm të madh, pse përfaqëson dëshirat e tija. I bashkuar në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë, populli ynë do të mobilizohet totalisht. Populli ynë pas disa ditësh do të shkojë në votimet për të zgjedhur njerëzit më të mirë, më të dashur, më besnikë, në këshillat e pushtetit të fshatrave, të lokaliteteve, të rretheve. Të bëhet dita e zgjedhjeve një festë e madhe popullore, një shprehje e lartë e patriotizmit, ku të gjithë njerëzit tanë, që kanë të drejtën e votës, të shkojnë pa përjashtim në votime dhe të gjithë të votojnë për njerëzit e Frontit, që janë nga njerëzit më të mirë dhe më besnikë të çështjes së popullit. Të forcohet dita-ditës pushteti ynë popullor, të demokratizohet ai çdo ditë e më tepër dhe të bëhet shprehja besnike e vullnetit të popullit për të kryer me nder detyrat që i ngarkon ai.

Përpara, pra, të gjithë në punë për realizimin e planit!

Rroftë populli shqiptar dhe udhëheqja e lavdishme e tij, Partia e Punës e Shqipërisë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 131 (204), 2 qershor 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë, me disa shkurtime

LETËRSIA JONË TË ECË NË RRUGËN E REALIZMIT SOCIALIST

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

7 qershor 1949

Duke ju drejtuar shokëve të Lidhjes së Shkrimtarëve, që ishin ftuar në mbledhjen e Byrosë Politike, shoku Enver tha:

Dëshirojmë të dimë si mendoni ju të zhvillohet Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve në mënyrë që të kemi dhe ne mundësi t'ju ndihmojmë me këshillat tona. Në materialin tuaj, ku janë hedhur idetë kryesore të referatit, flitet shumë për shkrimtarët e paraluftës, ndërsa për shkrimtarët e Luftës nacional-çlirimtare e të pasluftës shumë pak. Në këtë mënyrë shkrimtarët e vjetër eklipsojnë të rinjtë. Ne dëshirojmë që ju të na thoni si keni ardhur në këto rezultate që pastaj, siç thashë, t'ju japim dhe ne ndihmën tonë.

¹ Byroja Politike e KQ të PPSH në këtë mbledhje dëgjoi raportin që bënë disa nga drejtuesit e Lidhjes së Shkrimtarëve mbi problemet, që mendonin të ngrinin në Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve.

Në fund të diskutimeve shoku Enver tha:

Konferenca e shkrimtarëve ka një rëndësi të madhe. Për pregatitjen dhe zhvillimin e saj me sukses, sigurisht, jeni të interesuar si ju shkrimtarët, ashtu edhe ne. Por duhet thënë se problemi nuk është kapur si duhet, në tërësinë e rëndësinë e tij. Vëmendja kryesore nuk duhet përqëndruar në 6-7 shkrimtarë të njohur, që dallohen me shkrimet e tyre, po në problemin e madh të ngritjes së literaturës sonë të re përparimtare si dhe në përkrahjen e talenteve tona të reja. Ne do të bënim gabim, po të kërkonim qysh tani përsosmëri në shkrimet e letrarëve të rinj, kjo do të vijë gradualisht. Ne do të bënim gjithashtu gabim po të mjaftoheshim duke u kënaqur vetëm me ata pak shkrimtarë të afirmuar. Mendoj që konferenca e shkrimtarëve, si qëllim kryesor të vetin duhet të ketë përkrahjen e talenteve të reja, inkurajimin e tyre të madh nga Partia, ndihmën e veçantë që duhet t'u jepet për edukimin e tyre ideologjik.

Niveli kultural i kuadrove tanë është akoma i ulët, po kjo nuk do të thotë që ata të kenë drojtje të shprehin hapur mendimet e tyre për problemet e letërsisë. Një gjë e tillë nuk arrihet pa përpjekje. Këtë ta kuptojmë si duhet. Po të mendohet se për të krijuar duhet të shkëputen shkrimtarët nga puna, prapë do të na dalin klishera. Na thuhet se në Bashkimin Sovjetik ka shkrimtarë, që janë shkëputur nga çdo punë tjetër për t'u marrë me veprimtari krijuese letrare, por të kemi parasysh se edhe ata, në fillim, kanë punuar ku ka qenë e nevojshme, disa prej tyre dhe në fabrika dhe në të njëjtën kohë shkruanin. Edhe tani ata bëjnë konferenca, merren me aktivitete të tjera e vazhdojnë të

shkruajnë. Me këtë dua të them që shkrimtarët tanë diku duhet të punojnë, po njëkohësisht ata duhet edhe të shkruajnë. Unë jam dakord që shkrimtarët të lehtësohen nga disa ngarkesa që i pengojnë në veprimtarinë e tyre letrare, por kjo nuk duhet kuptuar që kohën ta kalojnë duke shëtitur nga të katër anët. Jeta dhe lufta e përditshme së toku me masat punonjëse do t'i ndihmojë shkrimtarët tanë në punën e tyre krijuese. Po të vesh për shembull në hekurudhë, të rrosh e të punosh me rininë, s'ka dyshim që do të frymëzohesh, kurse po të shkëputesh nga masat nuk mund të kesh frymëzim.

Në disa nga diskutimet që dëgjuam këtu nga shokët e Lidhjes unë vë re një farë doze pesimizmi. Kërkohet më shumë nga brumi që ekziston sot te ne. Por sipas pikëpamjes sime, Fishta me satirat e tija nuk pin ujë përpara «Epopesë së Ballit Kombëtar», të Shefqet Musarajt. Veprat e shokëve tanë, që shkruajnë për luftën, për jetën dhe punën e popullit qëndrojnë më lart, janë me një përmbajtje të shëndoshë. Aktualisht mund të kenë disa të meta nga ana e formës, por të jemi të bindur se, me kalimin e kohës, ato do të bëhen gjithnjë e më të përsosura edhe në këtë drejtim.

Me gjithë këto, studimi që ka paraqitur shoku Dhimitër Shuteriqi është i mirë. Prandaj, duhet të punojmë në këtë drejtim që të ndihmojmë zhvillimin e letërsisë së re socialiste. T'i inkurajojmë shkrimtarët tanë, të kemi më shpesh kontakte me ta, t'i ndihmojmë të studjojnë, të ngrihen nga ana ideologjike, kulturele e profesionale, që të prodhojnë më shumë e më mirë. Shkrimet tuaja të vihen më tepër në dukje, se ato nuk

po popullarizohen sa duhet. Kjo ndodh jo se nuk do njëri apo tjetri, por për arsye nënvleftësimi dhe se është krijuar mendimi se, që të shkruash, duhet të jesh specialist. Duhet ta luftojmë një mendim të tillë. Shtypi duhet të luajë një rol pozitiv në këtë drejtim. Të merrni pjesë edhe ju vetë në shtyp, që ta përmirësojmë këtë, se na është bërë si një pllakë gramafoni, që përsëritet vazhdimisht me një frazeologji të mërztitshme, me të njëjtat fjalë e shprehje, pa gjallëri, pa jetë, me ca reportazhe monotone. Të interesohemi që në shtyp të dalin shkrime më të mira për vlerësimin e veprave të shkrimtarëve tanë të rinj; këtu ta vëmë theksin. Natyrisht, kjo nuk duhet të bëhet pengesë për të analizuar veprat e së kaluarës, për të vlerësuar anët e mira të tyre dhe për të hedhur poshtë ato që janë të dëmshme. Të bëhet një studim i mirë, për shembull, për veprën e Naim Frashërit, është një gjë e madhe, pse kështu do t'i mësojmë njerëzit tanë jo vetëm si ta vlerësojnë Naimin, por edhe të orientohen drejt në vlerësimin e të tjerëve, të mos bëjnë gabime. Por në qendër të vëmendjes sonë të jenë problemet aktuale. Të mos merremi me diskutime boshe për autorë reaksionarë si Fishta, Koliqi etj., por të vëmë në dukje vlerat e atyre që shkruajnë për popullin. Si kudo, edhe në fushën e letërsisë, ne duhet të qëndrojmë fort në pozitat e Partisë.

Gjatë kësaj kohe letërsia është forcuar, ka ecur përpara, po debutojnë vazhdimisht talente të reja. Ajo duhet të zhvillohet në rrugën e realizmit socialist duke u mbështetur fort në terrenin kombëtar dhe në ideologjinë marksiste-leniniste. Në punën për zhvillimin e letërsisë sonë të thellohemi më tepër. Kjo kërkon që

vetë shokët tanë shkrimtarë, përveç të tjerave, të lexojnë më shumë e të mos thonë «nuk kemi kohë për të lexuar». Edhe ne kemi punë, por përpiqemi të gjejmë kohë dhe në fakt lexojmë. Një shkrimtar, që nuk bën përpjekje për të ngritur në radhë të parë nivelin e tij politik e ideologjik, mund të bëhet një profesionist, por jo në kuptimin tonë e të shëndoshë të fjalës. Për ju shkrimtarët, mendoj, leximi i një romani duhet të shkaktojë një shtytje a emocione të brendshme, ndryshe nga të tjerët. Lidhja e Shkrimtarëve të marrë masa që libraritë e bibliotekat tona të pasurohen edhe me vepra letrare të shkrimtarëve sovjetikë, si dhe të shkrimtarëve komunistë e përparimtarë të vendeve të tjera. Kohët e fundit kam lexuar romanin e një shkrimtari sovjetik. Sipas titullit kujtova se në të trajtohej problemi i dashurisë, por në fakt autori flet aty për fabrikat dhe veprat e tjera të mëdha të ndërtuara gjatë pushtetit sovjetik dhe shpreh dashurinë e gëzimin që ai ndjen për to. Një roman si ky i edukon drejt njerëzit tanë.

Është e drejtë ajo që tha shoku Shefqet Musaraj se duhet praktikuar puna kolektive me punonjësit e krijimtarisë letrare, të këmbehen mendime ndërmjet tyre, të bëhet kështu me ta një punë e frutshme konstruktive. Një punë e organizuar mirë duhet bërë për zgjerimin e rrethit të shkrimtarëve me elementë të rinj, po nuk duhet të harrohen dhe autorë të afirmuar si Nonda Bulka me shokë. Lexova në një revistë franceze ku një shkrimtar frëng, tregon se si frekuentonte një klub, ku shkonin më shumë komunistë. Megjithëse pohonte vetë se nuk ishte komunist, po vetëm një element i rezisten-

cës kundër fashizmit dhe, megjithëse kritikohet nga disa njerëz pse vente atje, ai s'tundej nga qëndrimi i tij, vazhdonte ta frekuentonte klubin dhe ngulte këmbë se nuk kishte dëshirë të largohej nga vija e rezistencës. Duke ju drejtuar atyre që e kritikonin, se që larguar nga shoqëria me ta, ai u thoshte se ishin ata që qenë larguar prej tij, ndërsa ai vetë, me ndjekjen e atij klubi, ndjente se duke u shoqëruar me komunistët, përfitonte shumë prej tyre. Një politikë e tillë duhet bërë nga ana juaj me shkrimtarët e vjetër pa parti, ndryshe këta, pa u afruar me ju, pa marrë pjesë në diskutimet tuaja, pa njohur pikëpamjet tuaja etj., nuk ka si të orientohen drejt dhe të aktivizohen.

Ju kërkuaq ndihmën tonë për problemet orientative që do të shtroni në konferencë dhe ne duhet t'ju ndihmojmë më shumë, kjo është një punë, që në asnjë mënyrë nuk duhet të nënvleftësohet. Ju vetë keni punuar në këtë drejtim dhe konstatojmë se shumë çështje i keni parë drejt. Shkrimtarëve të vjetër ua keni vënë mirë në dukje si anët pozitive, ashtu edhe të metat, po të keni kujdes që si në referat edhe në konferencë kjo çështje të mos bëhet problem central, ky problem mund të ngrihet, po në një formë tjetër e masë më të kufizuar.

Organizimin, që mendoni, bëjeni, pse koha kërkon të keni një drejtim më të shëndoshë. Ju keni nevojë për një ndihmë më të madhe që të lehtësoheni nga disa barrë, me qëllim që t'i kushtoheni më shumë krijimtarisë letrare. Partia ju ngarkon ju ta organizoni dhe ta drejtoni konferencën dhe ka besim se këtë punë do ta kryeni mirë. Mos nënvleftësoni forcat tuaja.

Në punimet e konferencës të keni parasysh të keni mirë nga përmbajtja ideologjike e krijimtarisë letrare. Veprat e Naimit, të Çajupit e të shkrimtarëve tanë të tjerë, që janë me vlerë, të studjohen patjetër. Ne kemi biseduar me shokun Shefqet Musaraj që të vihen në qarkullim pjesë të rilindasve, të Sami Frashërit, të Çajupit etj., që kanë lidhje me mbrojtjen e atdheut, po kjo të mos bëhet pengesë për të inkurajuar shkrimtarët tanë për të krijuar vepra me subjekte të reja. Dhe për shkrimtarët tanë të rinj një burim i madh subjektësh duhet të jenë, në radhë të parë, Lufta nacional-çlirimtare dhe ndërtimi i ri i atdheut. Këto subjekte të mos neglizhohen në asnjë mënyrë, bile të jenë kryesoret, të kemi sa më shumë vepra me përmbajtje nga lufta dhe jeta e popullit tonë të këtyre viteve. Mendojmë, shokë, në këto drejtime të vini më tepër theksin në konferencë. Punë të mbarë!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

MBI PUNËN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE DISA MASA PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

14 qershor 1949

Është e domosdoshme që ministri i bujqësisë të jetë më në krye të punëve. Këtë e theksoj për arsye se Byroja Politike nuk është e qartë si shkojnë punët në sektorin e bujqësisë. Nga sa del këtu, punonjësit me përgjegjësi të këtij dikasteri nuk i ndjekin si duhet punët, po hiqen zvarrë nga çështjet e vogla. Na paraqiten plane, merren angazhime dhe në fund na vijnë raporte jockzakte. A mund të ecim në këtë mënyrë? Bujqësia ka shumë probleme, është sektor i gjerë. Këtu kemi të bëjmë shumë me ekonomitë individuale, por paraqiten edhe probleme të tjera, siç janë pyjet, blegtoria e për të cilat nuk na raportohet fare. Kanë kaluar pesë vjet që Shqipëria është e lirë, megjithatë në këtë sektor nuk shohim përmirësime në shkallën që duhet.

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u shqyrtuan rezultatet e mbjelljeve pranverore për vitin 1949.

Prandaj, ministri i bujqësisë duhet ta drejtojë më mirë punën. Kritika që bëjmë, të mos i dekurajojë shokët e kësaj ministrie, por t'i nxitë për të përmirësuar punën. Kështu për shembull, për statistikën është folur shumë herë, por akoma kjo qëndron në vend; unë nuk shoh asnjë përmirësim në statistikë. E kam thënë edhe herë të tjera se Ministria e Bujqësisë dhe njerëzit e bujqësisë nuk mbështeten në eksperiencën e kaluar. Duhet kuptuar mirë se në këtë sektor nuk mundesh t'i largohesh kësaj eksperience, pa të cilën ne nuk do të dalim kurrë nga situata që jemi.

Në ferma, në SMT e në kooperativa bujqësore duhet të kemi rezultate më konkrete e më të mëdha. Edhe mosrealizimi i planit të bimëve industriale është një çështje e rëndësishme dhe Ministria e Bujqësisë të tregojë më shumë kujdes për këtë, ndryshe do të na ulen eksportet për këto bimë dhe ne nuk do të mbajmë dot angazhimet që kemi ndaj vendeve miq e do të vihem në pozitë të vështirë ndaj tyre. Këto çështje kaq të mëdha kërkojnë edhe një ndihmë e kontroll më të mirë nga shokët e Drejtorisë së bujqësisë të aparatit të KQ, të cilët duhet ta vënë më mirë në lëvizje të gjithë aparatit e Ministrisë së Bujqësisë.

Për qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj kulakëve ne kemi folur edhe më parë, por e quaj të nevojshme të theksoj përsëri që këtyre të mos u jepet kredi nga shteti e të mos ndihmohen nga SMT-të; përveç kësaj kulakëve duhet t'u caktohen disa detyrime suplementare ndaj shtetit; kur shohim se kulaku pasurohet përsëri, atëhere përsëri t'i vëmë taksa. Në procesin e luftës politike dhe të kufizimit ekonomik, në qoftë se këta

shkelin ligjet, do t'i gjobitim dhe po të vazhdojnë të propagandojnë kundër pushtetit popullor, atëhere do t'i futim edhe në burg si armiq politikë. Në këtë mënyrë do ta zhvillojmë drejt luftën e klasave kundër kulakëve, të bëjmë drejt politikën e izolimit politik dhe të kufizimit ekonomik. Lufta që do të zhvillojë Partia kundër këtyre njerëzve, do të shpjerë në atë që këta të njihen më mirë nga masat punonjëse se cilët janë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË ZONËS ELEKTORALE NR. 60 TË QYTETIT TË TIRANËS

14 qershor 1949

Vëllezër e motra të dashura,

Me plot të drejtë ju sot jeni të gëzuar dhe të lumtur, sepse sot pushteti popullor ju ka dhënë një armë të fortë në dorë, armën e votës. Nga ana tjetër unë jam shumë i lumtur dhe shumë i gëzuar që gjendem në mes tuaj, që keni luftuar me heroizëm, që e keni dashur Partinë tonë me të gjithë forcën e zemrës suaj, që e keni mbrojtur Partinë tonë, e keni mbrojtur dhe keni ecur nën drejtimin e saj, sepse ju e kuptuat që në ditët e rrezikshme, se shpëtimi i popullit tonë, çlirimi, do të arrihej me luftë dhe duke pasur në ballë të luftës, Partinë heroike Komuniste të Shqipërisë.

Unë jam i gëzuar dhe i lumtur që ju më keni propozuar kandidat për deputet në listën e Frontit të lagjes suaj. Unë, si djali juaj, në kohën më të zezë, luftova këtu, në gjirin tuaj dhe këtu unë i pashë e i njoha ndjenjat e mendimet tuaja në kohën e luftës. Në ato momente, kur po hidhte themelitet e saja, Partia na tha neve: Ja, shkoni! Baza juaj janë këto mëhalla popullore, aty punoni, luftoni, se aty do të gjeni përkrahjen e po-

pullit fukara, që është baza e shëndoshë dhe e çelnihtë e Partisë sonë. Dhe ne erdhëm te ju dhe ju na hapët krahët tuaj. Nuk na njihnit kush ishim, se ishim djem të rinj, si djemtë tuaj. Asnjë nga ju nuk e njihte emrin e Qemal Stafës, të Enver Hoxhës, të Mehmet Shehut, të Vojo Kushit, të Misto Mames etj. Këta ishin emra, emra për ju, po ata ishin djemtë tuaj, që kishin ndërmarrë një punë të rëndë për t'ja arritur një qëllimi të lartë. Luftoni për çlirimin e atdheut dhe për popullin — bënte thirrje Partia dhe ju na i hapët dyert, na mbrojtët dhe na ushqyet. Në dhomat tuaja të varfëra shtypeshin traktet e Partisë, fshiheshin bombat, fshiheshin armët, fshiheshin municionet, me të cilat ne luftonim kundër armikut tuaj, kundër armikut të vendit tonë. S'u trembët kurrë, ju qëndruat me heroizëm. Shpesh këto anë, këto mëhalla e këto shtëpi rrethoheshin nga xhandarët e kuislingët, por ju nuk u trembët kurrë, s'u trembët, se ishit të lidhur me Partinë si mi shi me koskën; ju mbronit bijtë tuaj, bijtë e vendit, se kishit në zemër Partinë, kishit besim të madh te Partia. Ne u rrethuam në këto shtëpi, por ne shpëtuam, shpëtuam se na mbrojti populli, se na mbrojtët ju. Aty nga viti 1942, në fund të rrugës së «Barrikadave», u rrethua për herë të parë Qemal Stafa me disa shokë. Krisi pushka, filloi mitralozi, ne kujtuam se humbëm Qemal Stafën, shokun tonë, po jo, ai u kthye menjëherë te ne, këtu, në një shtëpi, ku na tregoi se si kishte shpëtuar. «Luftuam — na thoshte ai — dhe, duke kapërcyer kopshte e mure, u gjenda përnjëherësh në godinën e një familjeje të varfër që po hante bukë. Porsa më pa plaku i shtëpisë, u ngrit në këmbë e më pyeti: «Nga

je, ç'je ti?» Unë i thashë: Jam komunist, luftoj për popullin tim të mjerë, për çlirimin e tij dhe, duke m'u drejtuar, plaku shtoi: «Ulu djalë, na bukën dhe qepën, fatet tona u lidhën sonte me ty, ne do të shpëtojmë të tërë ose do të vdesim të tërë këtu». Dhe Qemal Stafa shpëtoi. Trimi Qemal Stafa, biri i Partisë heroike, e dinte se ishte një ushtar i popullit dhe një ushtar i Partisë. Ai s'luftoi për lavdi, ai nuk i tha asaj familjeje emrin e tij, sepse s'kishte rëndësi, ai ju përgjegj: «Jam komunist» dhe vetëm fjala komunist ja ngriti peshë zemrat gjithë asaj familjeje. Kështu Partia jonë ngriti peshë zemrën e popullit, i cili u hodh në luftë dhe i mundi armiqtë, mundi fashistët italianë, mundi gjermanët, mundi bejlerët dhe agallarët, ai i mundi që të gjithë, sepse në zemrën e tij flakëronte ideali i lirisë së popullit, ideali i Partisë. Populli ishte i pamposhtur, populli do të dilte fitimtar. Ai që është me popullin dhe i qëndron besnik popullit, ai kurdoherë do të fitojë, dhe Partia jonë fitoi dhe kurdoherë do të fitojë e do ecë përpara, se ka popullin me vete, se i tërë populli është me Partinë.

Ju e dini sa e vështirë ishte lufta, sa të egër ishin armiqtë, çfarë dinakërie përdorën ata, po me gjithë këto, ne fituam, fitoi vegjëlia, fituan ata që ishin të mjeruar, ata që vuanin, fitoi shumica, shumica e dërmoi pakicën, i dërmoi ata qindra vetë, ato familje të pasura, që kishin spekuluar në mjerimet e popullit tonë. Ne çliruam Shqipërinë dhe ngritëm demokracinë popullore në vendin tonë. Populli mori pushtetin në duart e tija, qeverinë, gjënë kryesore. Pushteti: për këtë luftojnë të tërë, për këtë lufton reaksioni, për këtë luftoi

Partia jonë. Dhe ne u ndeshëm. Kush do ta fitonte këtë, ai do të drejtonte fatet e popullit. Në rast se ky binte në duart e bejlerëve dhe të agallarëve, vajhalli për popullin tonë, ai do të shqelmohej si një skllav; po ta fitonte Partia jonë, populli do të ishte në fuqi. Dhe Partia fitoi, sepse Partia ishte me popullin, sepse Partia ishte me fukaranë. I fituam të gjitha të drejtat tona, i mposhtëm armiqtë dhe filluam rindërtimin e vendit tonë, duke kaluar njëmijë e një halle, se jeta është luftë dhe kjo nuk mund të fitohej me duarlidhur, me duarkryq, por duhej të kapërcenim vështirësira, të bënim sakrifica, madje nuk kishim të hanim as bukë aq sa na hahej dhe nuk kishim as veshje aq sa na duheshin. Kjo atëhere ishte e natyrshme. Por, me marrjen e fuqisë në dorë nga ana e popullit, ne do t'i zgjidhnim të gjitha problemet dhe hallet e popullit dhe deri tani kemi zgjidhur një sërë hallesh. Vendi ynë po ecën përpara dhe populli do të shohë ditë për ditë të mira. Dhe kur thotë Partia do të bëhet kështu — do të bëhet patjetër, sepse Partia përfaqëson vullnetin tuaj, vullnetin e punonjësve.

Gjatë përpjekjeve tona për rindërtimin, ju e dini se mbeturinat e borgjezisë e të reaksionit filluan përsëri të na luftojnë; ata lëshonin vrer e pëshpëritnin, sepse pushteti ynë dhe populli ua rrëmbeu të gjitha pasuritë, që kishin vënë në saje të shtypjes dhe të shfrytëzimit që i bënin popullit. Çka kujtonin ata, se do t'ua linim ne këto? Jo, aspak, këto do t'ua merrnim. Dhe ndaj atyre njerëzve, që kërkonin si të sabotonin veprën e pushtetit, veprën e Partisë, nuk do të kishim mëshirë dhe nuk mund të kishim, sepse ata kishin bërë të vuante populli dhe po të krahasosh atë, që u bëme

ne atyre, me atë që i bënë ata popullit, kjo, është e paktë. Ne i çarmatosëm nga çdo gjë politikisht dhe ekonomikisht; kjo ishte e drejtë dhe kjo e drejtë qëndron kurdoherë e drejtë. Ju dini gjithashtu se me përpjekjet tuaja plot sukses, u mëkëmbën gjithë këto fabrika, u ndërtuan këto rrugë, u hapën shkolla, u përhap arësimi, u përmirësua bujqësia jonë; këto janë suksese të mëdha, këto i ka parë populli, i ndjen populli. Dhe këto u arritën në saje të përpjekjeve tuaja, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, të Partisë suaj.

Imperialistët u përpoqën me çdo mjet, me çdo mënyrë të rrëzojnë pushtetin tonë, ata organizuan reaksionin brenda, ata përgatitën sabotime dhe kryengritje, të gjitha me radhë. Por ata humbën, ata nuk mund të fitonin përpara forcës së madhe të popullit tonë dhe ata do të humbasin kurdoherë. Sa vete, dita-ditës, forca e tyre zvogëlohet; kurse forca e popullit bëhet më e madhe, populli çelnikoset në luftë, në përpjekje. Populli e ka rrethuar Partinë me një dashuri të madhe dhe prandaj armiqtë kurrë nuk do të kenë sukses. Partia jonë, si thashë më parë, luftoi që pushtetin ta merrte populli në dorë dhe e mori. Sot ne bëjmë zgjedhjet për këtë pushtet; ç'është kjo? Kjo do të thotë që ne të mos lejojmë në asnjë mënyrë që në qeverinë tonë, në pushtetin tonë popullor, të vijjnë armiqtë, të vijjnë nga ata njerëz që, duke u fshehur nën maska me disa fjalë të bukura, të futen brenda në pushtetin tonë popullor e të na e rrëzojnë nga brenda. Prandaj, pushteti ynë duhet të jetë në duart e popullit punonjës, në duart e njerëzve më të adershëm, të njerëzve patriotë, të njerëzve, që u dhimset çështja e popullit,

që nuk i zë gjumi, në duart e komunistëve në radhë të parë, dhe të të gjithë patriotëve, të cilët kur të vijnë në pushtet, nuk duhet t'i zërë gjumi, por të kryejnë si duhet detyrat e popullit, të kenë kurdoherë sytë hapët dhe kështu populli të flejë rehat, të rrojë i lumtur. Kështu na mëson Partia jonë; ata që nuk mendojnë kështu, gabohen.

Votimet që do të bëjmë kanë një rëndësi të jashtzakonshme. Këtu provohen forcat. Reaksioni po punon dita-ditës, po hedh parulla andej-këtej; «i ka të shkur tëra ky regjim ditët; për një javë, për dy javë do të zbresin amerikanët, po arrijnë ata, po na vijnë ata». Ata disaprovojnë, shpifin, për urdhëresat e drejta dhe çdo gjë që pushteti ynë popullor kërkon të vëjë në jetë; ata e luftojnë pushtetin tonë popullor. Pushteti u ka dhënë votën në dorë dhe u ka thënë: «Futeni këtu ose aty, ku të doni» dhe ata i provuan forcat e tyre. Në votimet e deritanishme ne jemi 98 për qind, 99 për qind, 97 për qind, kurse armiqtë janë dy për qind, tre-katër për qind. Ja ku qëndrojnë forcat e tyre. Zotërinjtë reaksionarë e panë sa pare u bënte lëkura. Populli ynë e ka treguar gjatë votimeve dhe do ta tregojë përsëri mbas dy ditëve, sa i lidhur është me Partinë, si e ka përqaftuar vijën e drejtë të Partisë, si i ka kuptuar drejt populli gjithë urdhëresat dhe ligjet ekonomike, që ka nxjerrë qeveria. Ju e dini se çka pëshpërisin zotërinjtë e reaksionit: «Ua mori të gjitha qeveria, nuk do t'ju lërë asgjëkafshë, do t'ju marrë tokat, ju ka vënë taksa të rënda», por, me gjithë lehjet e tyre, ju, patriotë shqiptarë, keni votuar dhe do të votoni qind për qind për kandidatët e Frontit. Kjo tregon se regjimi ynë popu-

llor, nuk i ka të numëruara ditët, siç thonë ata, por çdo ditë forcohet më tepër, ditët po shkurtohen për ata, jo për popullin tonë, as për pushtetin tonë popullor.

Ne, në rindërtimin e vendit tonë, kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Ne po ndërtojmë vendin tonë, ekonominë tonë, ne po ndërtojmë fabrikat tona, të cilat do të bëjnë që populli të ketë më bollëk, të shohë ditë më të mira, të mos i mungojë as buka as sheqeri as djathi as qumështi as veshjet. Ju e dini fare mirë që këto nuk mund të bëhen me një ditë, pas gjithë këtyre situatave të vështira, që ka kaluar vendi ynë. Klika e Titos kishte punuar në mënyrë të tillë që të rrëzonte pushtetin tonë popullor, të binte në fuqi Koçi Xoxen, për ta lidhur Shqipërinë me qerren e imperialistëve anglo-amerikanë, për t'ja marrë përsëri popullit nga duart fuqinë dhe të sillnin përsëri në fuqi kapitalistët, borgjezinë e agallarët, që t'ja pinin përsëri gjakun popullit tonë. Dhe çështjet kryesore në të cilat trockistët e Beogradit u përpoqën të na dëmtonin ishin çështjet ekonomike; ata kërkonin që ta bënin të pakënaqur popullin nga pushteti dhe Partia jonë. Këtu ishte qëllimi. Por nuk ja arritën dot këtij qëllimi, se Partia jonë ishte e fortë, se ne patëm ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit. Ju i keni dëgjuar detyrat që i vihen të gjithë popullit për realizimin e planit tonë, planit të shtetit, që përfaqëson të ardhshmen tuaj, të ardhshmen e kalamanëve tuaj, prandaj duhet të mobilizohemi të gjithë. Kudo: në ara, në fabrika, në shkolla, kudo që punohet, të mobilizohemi për ta realizuar këtë plan. Realizimi i planit do të thotë bollëk dhe bollëku do të vijë. Kjo është e sigurtë, rruga është e drejtë, parimet që udhëheqin Partinë tonë janë

të drejta, vënja e tyre në jetë do të sjellë lumturinë e popullit tonë. Ta forconi besimin tuaj ndaj pushtetit dhe Partisë, të jeni vigjilentë për mbrojtjen e pushtetit, ta kontrolloni pushtetin. Nuk mjafton vetëm t'i japim votën njerit ose tjetrit që është në listë, por këta duhet të kryejnë detyrat dhe ju t'i kontrolloni dhe në rast se nuk i kryejnë ato, ju keni të drejtë t'i shkarkoni, keni të drejtën e revokimit. Në pushtet duhet të vijnë ata njerëz që i shërbejnë popullit me gjithë forcat e tyre; prandaj populli duhet të ketë kontrollin mbi pushtetin, të kritikojë në mbledhjet e rregullta që i lejon kushtetuta; të gjithë njerëzve të pushtetit, që nuk punojnë mirë, t'u thuhet haptas të metat dhe në rast se ata nuk i ndreqin, të shkojnë në shtëpi, kurse në pushtet të vijnë të tjerë, më të aftë e më besnikë ndaj popullit. Këto të drejta ja ka siguruar popullit Partia jonë me Kushtetutën e Republikës dhe këto ai duhet t'i përdorë mirë. Kështu do të demokratizohet pushteti ynë, kështu do t'i ndjejnë me të vërtetë detyrat që kanë ndaj popullit ata njerëz që janë në pushtet, kështu do të ngjallet ndërgjegjja e njerëzve tanë, prandaj me votimet të zgjidhen njerëzit më të mirë dhe mbasandaj të kontrollohen këta në punë, të kritikohen ashpër dhe kur ata nuk i shërbejnë si duhet popullit, të dërgohen në vendin ku meritojnë. Me një besim të tillë ne duhet t'i përvishemi punës dhe të jemi të sigurtë në fitoren tonë. Partia jonë e Punës do të vërë të gjitha forcat për realizimin e planit. Komunistët duhet të jenë në ballë të punës, të kryejnë detyrat dhe të dëgjojnë fjalën e popullit, i cili në Republikën tonë Popullore është në fuqi.

Me qindra dhe mijëra patriotë shqiptarë kanë shku-

ar dhe do të shkojnë në votime dhe kanë votuar dhe do të votojnë për atdheun e tyre të fortë, për Partinë e tyre të dashur, për Frontin e tyre. Ata do të votojnë që atdheu i tyre të ndërtohet, të ndërtohet socializmi në vendin tonë, ata kanë votuar dhe do të votojnë që Shqipëria të rrojë e lirë dhe e pavarur, që të konsolidohet pushteti i popullit tonë, që të ndërtohen fabrikat, që të lulëzojnë fushat dhe pyjet tona. Me qindra kanë votuar dhe do të votojnë kundër luftës, kundër nxitësve të luftës, kundër atyre që kërkojnë të bëjnë një kasaphanë tjetër, ku të vriten me miliona njerëz, do të votojnë kundër atyre që kërkojnë të na digjen përsëri shtëpitë tona, të na shkatërrohen arat tona, të na vriten kalamant tanë. Populli ynë i fuqishëm do të vejë në votime dhe do të tregojë vullnetin e tij të çelniktë. Prandaj votat kanë një rëndësi të madhe, të jashtëzakonshme. Prandaj përdoreni votën ashtu si duhet, mendohuni mirë kujt ja jepni dhe ata që marrin votën, të kontrollohen nga populli, që ta kryejnë mirë detyrën. Këto kërkon populli nga ata që do të zgjidhen dhe ne do të vëmë të gjitha forcat që t'i kryejmë detyrat tona.

Të vëmë forcat tona në shërbim të popullit, të vëmë forcat tona që të mëkëmbim ekonominë tonë, të ndërtojmë jetën e mirë për ne dhe për kalamant tanë, që ata të mos shohin ditë të zeza, të mos shohin më kurrë luftë. Prandaj, të gjithë në votime, të gjitha votat për Frontin!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 142 (215), 15 qershor 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 142 (215), 15 qershor 1949

KËSHILLA PËR SHKRIMTARËT E RINJ¹

23 qershor 1949

Të ndiqet zhvillimi i shkrimtarëve tanë të rinj dhe t'u jepet ndihma e duhur që të zhvillojnë talentet e tyre.

Të orientohen ata të shkruajnë mbi Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë dhe mbi rindërtimin e vendit.

a) Që të mundë shkrimtari të krijojë një vepër të vërtetë, të përshkruajë realitetin e të krijojë personazhe të vërteta nga jeta, ai duhet të jetë një observator i zgjuar dhe i apasionuar. Jetën dhe procesin e zhvillimit ta shohë në të gjitha pamjet, në mënyrë realiste dhe në dinamizmin e progresivitetin e saj.

Detyra e shkrimtarëve të rinj është të afrohen shumë me popullin dhe të përshkruajnë ndjenjat, idealet dhe jetën e tij reale. Aty do të shquhet dhe zotësia e tyre.

Në kontakt të paprerë me masat ata do të frymëzohen për tema të larta, do të gjejnë shprehjet më të for-

¹ Këto shënime janë nxjerrë nga një dorëshkrim i shokut Enver të pregatitur në prak të Konferencës III të Lidhjes së Shkrimtarëve, por të pabotuara më parë.

ta dhe më të dashura të popullit. Në shkrimet e tyre duhet të dallohen përshkrimet e fuqishme për njerëzit e thjeshtë, por madhështorë, që përfaqësojnë heroizmin, virtytet e larta, shijet e holla dhe të pastra të popullit tonë. Vetëm atëhere veprat e tyre do të lexohen me etje nga populli, pse ato do të pasqyrojnë realitetin e vërtetë të jetës së tij.

b) Shkrimtarët tanë të rinj duhet t'i zgjedhin subjektet e tyre në evenimentet madhështore të historisë së popullit tonë në të kaluarën, sidomos në Luftën e lavdishme nacional-çlirimtare dhe në ndërtimin e bazave të socializmit në Shqipëri.

Nga evenimentet historike të popullit tonë, nga luftërat heroike të tija, të dalin vepra me një përmbajtje të re, ku të ndritë realizmi dhe e vërteta.

Shkrimtarët tanë të rinj duhet të mësojnë nga trashëgimia e letërsisë përparimtare botërore dhe sidomos nga letërsia sovjetike e realizmit socialist.

c) Realizmi socialist duhet të bëhet metodë drejtuese në detyrën e madhe, që kanë shkrimtarët tanë të rinj popullorë.

Realizmi socialist në shkrimet e shkrimtarëve tanë të rinj do ta bëjë veprën e tyre të pandarë nga interesat e popullit, nga përpjekjet dhe lufta e tij, nga ndjenjat më të mira, më të pastra, më patetike dhe heroike të popullit. Ky realizëm shpreh në termat më të thekshme patriotizmin e masave për atdheun, për lirinë, për pavarësinë, shpreh urrejtjen për imperializmin, për fa-shizmin, për luftën, pasqyron me besnikëri luftën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe u hap masave të gjera punonjëse perspektiva të qarta, u hap ho-

rizonte pune dhe fitoreje, u ndriçon atyre rrugën drejt së ardhshmes më të lulëzuar, i edukon njerëzit me idealët e socializmit.

Shkrimtarët e rinj të luftojnë tendencat dekadente në letërsi. Të zhduken nga shkrimet e tyre shfaqjet e idealizmit, të artit për art, të romanticizmit të sëmurë. Përkundrazi të krijohet në shkrimet e tyre një atmosferë që të komunikojë një shëndet të bukur moral, të krijohen me kurajë personazhe që karakterizojnë heroizmin e popullit tonë. Vetëm në këtë mënyrë vepra e tyre do të bëjë një përshtypje të fortë në masat e popullit, pse vetëm kështu ajo do të jetë e vërtetë.

Populli dëshiron të pasqyrohet realiteti ynë, ai dëshiron të shohë në veprat e shkrimtarëve tanë të rinj vetën e tij: në familje, në jetë, në punë, në luftë. Në këto vepra, tok me përshkrimet reale të natyrës, të fushave me grurë, të fabrikave, të minierave etj., ai kërkon të shohë njëkohësisht edhe rrugën e mëtejshme ku e çon vullneti, puna dhe përpjekjet që po bën, ai do të shohë rrugën ku e çon Partia e tij e dashur.

Populli ynë dëshiron të shohë në shkrimet e shkrimtarëve të rinj, të pasqyrohet dashuria për Bashkimin Sovjetik dhe për popujt e tjerë vëllezër, të njohë jetën e tyre, ndjenjat e përbasnkëta që i frymëzojnë në luftën kundër tiranisë për mbrojtjen e paqes e për forcimin e demokracisë popullore.

Shkrimtarët e rinj duhet, pra, të ndjejnë thellë dhe të zhvillojnë ndjenjën e patriotizmit dhe të internacionalizmit. Patriotizmi është i pandarë nga internaciona-

lizmi. Internacionalizmi sot po tërheq të gjitha forcat përparimtare që kanë një platformë demokratike dhe antiimperialiste. Internacionalistët janë për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore.

Ne jemi kundër kozmopolitizmit, sepse kozmopolitizmi përpiqet të zhdukë dashurinë për vendin tënd që duhet të jetë kurdoherë e pakufishme. Për kozmopolitët borgjezë ndjenjat dhe idealet e popullit janë të huaja.

Kozmopolitizmi është në luftë me kulturën përparimtare, pse kozmopolitët qëndrojnë larg popullit dhe larg jetës së vërtetë të tij.

Ka disa të ashtuquajtur shkrimtarë, që kanë formuar vetëbindjen se penda e tyre nxjerr xhevahire. Ata, jo të bindur në jetën e re dhe duke qëndruar larg frymës së re revolucionare, përpiqen të imitojnë në mënyrë të dobët realizmin e tipit të vjetër, ata mendojnë se veprat e tyre mund të jenë të pranueshme, duke u përpjekur vetëm të nxjerrin lakuriq veset e një shoqërie të perënduar, që rronte mbi kurrizin e popullit, të vënë në dukje vetëm veset e bejlerëve, jetën e tyre plot krim, ahengje dhe kusërira.

Shkrimtarët e rinj duhet ta braktisin këtë rrugë dhe të ndjekin rrugën e realizmit socialist, që pasqyron realitetin e ri, jetën e re, forcën e re. Nëpërmjet përshkrimit të tipit të ri të shëndoshë nga trupi dhe nga mendja, tipit kurajoz, heroik, përfaqësuesit të popullit, që lufton për jetën e re, për jetën e lirë, realizmi socialist denoncon të kaluarën shtypëse, veset e këqia, obskurantizmin, shtypjen e klasave feudale dhe borgjeze, denoncon dhe lufton shpirtin mikroborgjez dhe çdo

gjë që e ndalon njeriun e ri të ecë në rrugën e tij të lavdishme dhe të realizojë aspiratat e tija për të ardhshmen, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT
VASIL KOLAROV ME RASTIN E VDEKJES SË
GJERGJ DIMITROVIT**

3 korrik 1949

**SHOKUT VASIL KOLAROV, ZËVENDËSKRYETAR I
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
POPULLORE TË BULLGARISË**

Sofje

Në emër të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar si dhe në emrin tim personal ju drejtoj me hidhërim të madh, Juve dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë dhe popullit bullgar, shprehjen e ngushëllimeve më të thella për vdekjen e kryetarit tuaj të shquar dhe mikut tonë të shtrenjtë, Gjergj Mihajloviç Dimitrov.

Populli shqiptar merr pjesë me hidhërim të thellë në zënë e popullit bullgar, mik dhe aleat, për humbjen e dhimbshme që ka pësuar në personin e udhëheqësit të tij heroik, që ja kushtoi tërë jetën e tij lirisë së popullit bullgar dhe kauzës së lëvizjes punëtore ndërkombëtare.

Në këtë ditë zie të humbjes së birit më të denjë të popullit bullgar, populli shqiptar vajton mikun e sin-

qertë, që ka punuar me vendosmëri për përforcimin e miqësisë dhe të aleancës midis dy vendeve tona.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
Republikës Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 158 (231), 3 korrik 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 158 (231),
3 korrik 1949*

**MBI RËNDËSINË E DËRGIMIT TË BRIGADAVE
KULTURALE NË FSHAT DHE MBI ZGJEDHJEN
E ANËTARËVE TË KOMITETEVE EKZEKUTIVE
TË KP TË RRETHEVE**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

14 korrik 1949

Çështjet që u ngritën në këtë mbledhje, kërkojnë një organizim të mirë, pse kështu ato do të gjejnë zbatim të plotë. Unë jam dakord me diskutimet që u zhvilluan, por kam dy vërejtje:

Vërejtjen e parë e kam lidhur me brigadat kulturore që do të dërgohen në fshat. Brigadat që do të dërgohen në fshat, duhet të kenë një qëllim të caktuar: të zhvillojnë punë politike e kulturore me masat. Kjo do të thotë që njerëzit e këtyre brigadave duhet të kenë një

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH, midis problemeve të tjera, u diskutua çështja e dërgimit të agjitorëve në disa rrethe të vendit, të cilët do të ndihmonin në sqarimin politik të fshatarëve mbi problemet ekonomike. Po kështu u diskutua edhe rreth anëtarëve të komiteteve ekzekutive të kp të rretheve pas zgjedhjeve që ishin zhvilluar në atë kohë.

program të veçantë për edukimin dhe argëtimin e punonjësve të bujqësisë. Këta nuk duhet të ngatërrohen me çështje të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, pse për këtë problem është mobilizuar e gjithë Partia. Këto brigada duhet të merren posaçërisht me punë kulturale e me forcimin e punës së agjitacionit. Nga ana tjetër nuk mund të dërgohen me këto brigada edhe shokët më me përgjegjësi, sikurse u referua këtu, sepse këta kuadro janë angazhuar me punë të tjera, sidomos për çështjen e grumbullimit, pse siç dihet sigurimi i bukës është problemi kryesor për ne në këtë fazë. Punë kulturale në fshat mund të zhvillojnë njerëz të kategorive të tjera, jo medoemos kuadro drejtues, por mund të jenë fare mirë intelektualë, mësues, nxënës shkollash, aktivistë shoqërorë nga qytetet etj.

Vërejtjen e dytë e kam lidhur me anëtarët e komitetëve ekzekutive. Këta mund të jenë edhe njerëz pa parti, s'është konditë të jenë vetëm anëtarë partie siç bëhet propozimi në materialin e paraqitur. Kur themi që në komitetet ekzekutive duhet të ketë edhe njerëz patriotë, të mos e themi këtë vetëm në parim, po ta vëmë në jetë. Njerëzve pa parti, patriotëve, duhet t'u jepet më tepër besim dhe jo t'i kemi këta vetëm sa për t'i thirrur në ndonjë paradë ose për t'i dërguar me ndonjë delegacion. Them të kemi më shumë besim, sepse ata e duan Partinë dhe populli i dëgjon.

Në komitetet ekzekutive të zgjidhen njerëz patriotë jo vetëm për figurë, po ata të jenë në gjendje që të punojnë dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Po që se kjo çështje nuk zgjidhet drejt, ka dy rreziqe: nga njëra anë është rreziku që zgjidhen patriotët sa për

formalitet dhe nga ana tjetër, gjë që është akoma më e rrezikshme, është fakti që po të zgjidhen në komitete ekzekutive patriotë, njerëz pa parti që nuk janë në gjendje të japin, po që do rrinë gojëmbyllur në mbledhjet e komitetit ekzekutiv, do ta pengojnë punën. Sidoqoftë duhet të kemi më shumë besim në ta dhe ta vlerësojmë kontributin e tyre.

Këto ishin, shkurtimisht, dy vërejtje që kisha, me të cilat doja të sqaroja dy nga çështjet që u diskutuan në këtë mbledhje.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË
NË LIDHJE ME GABIMET E VËRTETUARA NË
ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT
TË LUSHNJËS**

23 korrik 1949

**MBI PUNËN E SËMURË NË ORGANIZATËN
E LUSHNJËS**

Organizata e Lushnjës është një organizatë me kua-
dro të rinj dhe të ulët ideologjikisht. Një pjesë e mirë
e anëtarëve të kësaj organizate janë pranuar në Parti
gjatë viteve 1945-1949. Një tjetër karakteristikë është se
organizata e Partisë në qytet dominon organizatën e
fshatit. Numri i anëtarëve të organizatës është gati i
ndarë si vijon: 50 për qind e anëtarëve bëjnë pjesë në
organizatën e qytetit dhe gjysma tjetër janë në fshat.
Lushnja dhe rrethi i saj, sikundër dihet, është një vend
bujqësor dhe i mungon krejt industria, qoftë kjo e për-
faqësuar nga ndonjë fabrikë e vogël. Artizanati është
shumë pak i zhvilluar. Prandaj duke marrë parasysh
këtë fakt, ka qenë gabim që janë pranuar në fillim më
shumë nga qyteti dhe nuk është bërë shpërndarja e
drejtë e forcave të Partisë duke lënë, siç thamë, 50 për

qind të komunistëve në qytet dhe 50 për qind në fshat. Organizata e Partisë, në një periudhë relativisht të shkurtër, është zgjeruar jashtëzakonisht shumë; proporcioni midis kandidatëve dhe anëtarëve nuk është i drejtë, ka më shumë kandidatë se sa anëtarë. Pranimi në Parti s'është bërë i studjuar dhe në baza të shëndosha. Organizata, sidomos ajo e qytetit, është zgjeruar mjaft me elementë jo të shëndoshë. Janë futur në Parti elementë me qëndrim jo të shëndoshë gjatë luftës, me origjinë agai e kulaku, intelektualë të sëmurë, ambiciozë dhe kritizerë, elementë pretenciozë, që dëshirojnë të përfitojnë duke ekzagjeruar meritat e tyre të luftës, me qëllim që të nxjerrin këtej nga një anë përfitime personale dhe nga ana tjetër të mbytin elementin e ri dhe të shëndoshë të Partisë, që po ngrihet dhe po rritet në luftë për ndërtimin e vendit tonë. Të tillë elementë me origjinë borgjeze dhe mikroborgjeze, të futur në organizatën e qytetit të Lushnjës dhe sidomos në atë të pushtetit, janë bërë një pengesë në zhvillimin normal të Partisë, në zbatimin e drejtë të vijës, në zhvillimin e drejtë të punës së Partisë dhe të pushtetit në fshat.

Lushnja është një rreth bujqësor; duke qenë kështu, Partia duhej të mbështetej fuqimisht në elementin fshatar të varfër dhe të mesëm, i cili, në bazë të fitores së pushtetit popullor dhe të reformës agrare, u çlirua dhe mori tokën. Kjo nuk është bërë si duhet dhe këtë e provon shtrirja e dobët e organizatës së Partisë në fshat si dhe kompozicioni i udhëheqjes në këtë organizatë. Këtej ka rrjedhur që nuk është zhvilluar një punë organizative e shëndoshë dhe një punë politike e zgjeruar. Në këto drejtime kanë gabuar një pjesë e udhë-

heqësve të ndryshëm të kësaj organizate dhe njëkohësisht KQ nuk ka pasur kontrollin e duhur mbi zhvillimin e kësaj organizate. Drejtuesit e ndryshëm kryesorë të kësaj organizate, me të meta dhe me gabime, që rrjedhin nga mbeturinat mikroborgjeze, nga mungesa e një lufte nga ana e tyre për zhdukjen e këtyre të metave me anën e kritikës dhe të autokritikës, nga niveli i ulët ideologjik i tyre, nga ambiciet e sëmura, s'kanë pasur perspektiva të qarta, kanë bërë gabime, të cilat s'i kanë njohur dhe s'i kanë korigjuar, kanë ecur në rrugë të gabuar, kanë qenë të lëkundur e të influencuar shumë herë nga njerëz me interesa të kundërt me ato të Partisë dhe kanë neglizhuar luftën e klasave. Praktikisht, në të gjitha këto situata të vështira nga ku ka kaluar Partia, borgjezia nuk ka fjetur dhe ka përfituar nga shkujdesia e udhëheqjes së organizatës.

Presioni i borgjezisë ka qenë i vazhdueshëm mbi disa elementë në udhëheqje, të cilët e kanë pranuar këtë dhe kanë punuar nën këtë presion dëmprurës. Kjo situatë do të mund të luftohej në rast se këta elementë nuk do të fshihnin gabimet e tyre, në rast se do të zhvisheshin nga mbeturinat e moralit borgjez dhe në rast se do të mbështeteshin në vijën e drejtë të Partisë dhe në elementin e shëndoshë të fshatarësisë së varfër e të mesme. Organizata e Lushnjës është drejtuar nga këta shokë me frymë tarafi e jo nga shokë me frymë revolucionare dhe në vijën e drejtë të Partisë. Kjo punë tarafi, që ekzistonte në kryet e organizatës, kishte moltipur dhe një sërë shokësh, sidomos në organizatën e qytetit dhe të pushtetit. Disa shokë të sëmurë çështjen e Partisë e lidhnin me disa persona në udhëheqje. Kjo

rridhte, pse këta njerëz të sëmurë dhe karrieristë, e shikonin Partinë si një grup, që mund të fshihte të metat dhe gabimet e tyre, që do t'u kënaqte ambiciet e tyre dhe do t'i lejonte të manevronin duke e thyer vijën politike dhe organizative të Partisë. Rruga që ndiqnin këta njerëz, do t'i çonte në armiçësi me Partinë.

Armiku i klasës dhe i Partisë, duke bërë presion direkt ose indirekt në këta elementë të sëmurë, ishte mjaft i interesuar që kjo sëmundje në udhëheqjen e organizatës së Lushnjës, të thellohej dhe të forconte kësh-tu pozitat e tija në këtë rreth, brenda në Parti dhe në radhë të parë në udhëheqje.

Qëllimi i borgjezisë është reflektuar në këta drejtues të organizatës së Lushnjës në çështjen: kush të ketë pushtetin në dorë. Borgjezia e këtij rrethi, si e gjithë borgjezia armike e vendit, jo në gjendje të organizuar, ka për qëllim rrëzimin e pushtetit dhe shndërrimin e Partisë në një parti mbrojtëse të borgjezisë e të kulakëve. Por ajo e sheh se marrja e pushtetit në duart e veta është krejtësisht e pamundur, por me pasë njerëzit e saj në pushtet dhe në Parti për t'i minuar këto nga brenda, kjo i është e mundur, në rast se Partia vihet në gjumë. Elementi i sëmurë në udhëheqjen e kësaj organizate ka shikuar kurdoherë në objektivin e marrjes së postit kryesor në udhëheqjen e Partisë dhe që andej të kishte nën kontrollin e vet Partinë dhe pushtetin. Partia dhe pushteti kësajsoj të shndërroheshin në një detashment partizan, nën drejtimin e disa ambiciozëve, që me siguri do të kalonin në rrugën antiparti.

Pra, në gjirin e organizatës së Lushnjës prej një kohe ekzistonte një antagonizëm në udhëheqje, zhvillo-

hej një punë personale e tarafi dhe me veprime anti-parti; në këtë organizatë, ku influenca e borgjezisë ka qenë e paevitueshme, u formuan dy tarafe shokësh. Shokët që s'ndjekin vijën e Partisë, që nuk i shohin çështjet në prizmin dhe në interesin e Partisë, që nuk e mbrojnë Partinë, që nuk e mbështetin dhe nuk e fuqizojnë Partinë me elementin e shëndoshë punëtor, fshatar dhe intelektual të ndershëm, patriot e pa njolla, ata, pa asnjë dyshim, bien në pozitë të borgjezisë dhe pranojnë ligjin e saj.

Klasa armike ka menduar se duhej të përkrahte një prej këtyre tarafeve, të krijuara në gjirin e organizatës dhe do të përkrahte atë anë, që tregojë libe-rale dhe oportuniste ndaj saj.

Në organizatën e Lushnjës ka pasur një punë tarafi shumë të theksuar dhe të dëmshme, që po të mos ishte diktuar me kohë nga Komiteti Qendror, mund të degjeneronte në formë më të rrezikshme për Partinë.

Një nga këto tarafe ka pasur si figurë në krye Hasan Ginën dhe ishte tarafi më i rrezikshëm. Prapa Hasan Ginës ka një sërë shokësh të pakënaqur, disa të goditur padrejtësisht nga puna armiqësore e trockistëve, por që pas Plenumit XI nuk e shikuan kthesën në rrugën dhe në vijën e Partisë. Me metoda jo të drejta dhe me pikëpamje politike jo të qarta, ata kujtuan se «rruga e drejtë» ishte hakmarrja, mbivlerësimi i meritave të tyre jashtë çdo mase dhe shumë herë i falsifikuar. Ky shikim i çështjeve nën këtë prizëm nga këta shokë ishte i rrezikshëm dhe do të bënte që këta të gabonin më vonë. Në këtë grup ka pasur shokë ambi-

ciozë, arrivistë, njerëz me të kaluar jo të pastër dhe me origjinë jo të shtresës..

Në mes të këtij grupi shokësh të sëmurë, ai më i sëmuri, i cili ka vepruar vazhdimisht (me gjithë këshillimet e KQ) për keqësimin e situatës, ka qenë Halit Ahmeti.

Tarafi i dytë, i cili nuk ka pasur një figurë në krye, por që përpiquej të krijonte një të tillë (prandaj u përpoq të fshihej pas ish-sekretarit të parë të organizatës, i cili nuk del i implikuar në këtë grup), formohej prej shokësh që kishin bërë gabime para Plenumit XI, që ishin goditur për gabimet e tyre dhe që ishin lidhur me njëri-tjetrin me familjaritet të sëmurë dhe si të solidarizuar në «fatkeqësinë» që u ngjau. Ky ishte në opozicion me tarafin e Hasan Ginës, në rrugë jo të drejtë dhe shumë herë të paprincipitë e jo në baza të shëndosha.

Me këto metoda të sëmura luftonin midis tyre këto dy palë tarafe: tarafi i parë, i Hasan Ginës, për t'i eliminuar krejtësisht këta shokë dhe për të pasur vetë në duar drejtimin e Partisë dhe të pushtetit dhe tarafi i dytë për t'u mbrojtur.

Sekretari i parë i Partisë së rrethit nga ana e tij, megjithëse nuk ka qenë i implikuar në këtë luftë të paprincipitë në mes këtyre shokëve, ai s'ka ditur të diktojë këtë punë të dëmshme që ekzistonte dhe s'ka vënë në dijeni KQ për këtë çështje. Ai, si sekretar politik i kësaj organizate, nuk ka ditur ta frenojë dhe ta shërojë këtë situatë.

Tarafi i Hasan Ginës ka pasur për qëllim të vinte në udhëheqje ose të qëndronte në udhëheqje me çdo

kusht dhe me mënyra dhe metoda të gabuara dhe të dënueshme nga parimet e Partisë, në kundërshtim me urdhërat dhe qarkoret e KQ dhe me forma e me metoda që binin erë frymë borgjeze. Lufta e këtij tarafi zhvillohej gjoja në format e sipërme kundër sekretarit të parë të Partisë për Lushnjën kur ky ishte emëruar tok me një byro provizore nga KQ deri në zgjedhjet e reja, gjoja pse ky kishte gabuar në të kaluarën, sikur gabimet e Hasan Ginës dhe të shokëve të tjerë të këtij grupi nuk ishin po ato të sekretarit të parë për mos me thënë më të rënda.

Shoku Hasan Gina ka rënë në këtë terren të kalbur dhe ka gabuar. Njëkohësisht shumë elementë të sëmurë kanë influencuar te ai dhe kanë vepruar në dëm të Partisë duke u fshehur dhe duke u mbështetur nga shoku Hasan Gina. Këta kanë ditur të përfitojnë nga fryma e ambicies që ekziston te Hasan Gina, nga një shikim jo i shëndoshë i kapaciteteve të tij, nga liberalizmi dhe butësia e tij dhe e kanë nxjerrë përpara Hasan Ginën. Këta elementë, direkt ose indirekt, i kanë sjellë Hasan Ginës pikëpamjet dhe frymën e borgjezisë për veprim dhe ky ka vepruar, disa herë me ndërjegje, disa herë në mënyrë inkoshiente në rrugë të gabuar. Një nga elementët më të dëmshëm, që ka influencuar Hasan Ginën, ka qenë Halit Ahmeti.

Shoku Hasan Gina, i shtyrë nga ambicia personale, nga miqësitë e sëmura, nga gjykimet jo të shëndosha dhe të thella mbi situatat e krijuara dhe mbi shokët, ka humbur rrugën, ka harruar rregullat dhe vijën e Partisë, ka harruar luftën që zhvillon Partia kundër kulakëve dhe borgjezisë armike të qytetit dhe të fshatit.

Një punë e tillë e sëmurë në organizatën e Lushnjës e ka burimin që para Plenumit XI. Duke marrë parasysh përbërjen sociale të gjithë rrethit të Lushnjës, borgjezia armike do të përpiquej që aksionet e saj të mbështeteshin nga elementi i lëkundshëm dhe i butë i Partisë e i pushtetit dhe, natyrisht, nga elementët e tillë të qytetit, të cilët, përveç të metave të klasës, që ekzistojnë në ta, nuk kishin kaluar në fazat e ashpra të luftës dhe tamam në këto faza ata s'kishin mundur të rezistonin, kush më shumë dhe kush më pak. Një gjë e tillë shkaktoi mungesë vigjilence dhe mosvazhdimësi në konsolidimin e Partisë dhe të pushtetit. Këta u treguan liberalë dhe të influencuar nga rrethe të ndryshme mikroborgjeze, pranonin lehtësisht influencën direkte ose indirekte të shtresave të larta, të goditura nga lufta dhe nga reformat e pushtetit. Lufta e klasës, pra, nuk u ashpërsua. Në ndarjen e tokës fshatarëve të varfër dhe të mesëm, u bënë gabime në dëmin e këtyre; fshatarët që muarën tokën u kërcënuan prej kulakëve, bejlerëve dhe tregëtarëve fajdexhinj. Disa elementë, që influenconin udhëheqjen e Partisë dhe të pushtetit në rreth, nën flamurin e Frontit, përhapnin moskënaqësira dhe kërcënime të mbuluara dhe të tërthorta. Ekzistonin dhe përkraheshin në një situatë të tillë hatëret, favorizimet, nxiteshin intrigat e fshatit dhe politika në fshat bëhej në plan dhe në pozitat e këtyre thashethemeve dhe intrigave të vogla.

Nga ana tjetër fryma e sëmurë që ekzistonte në Parti, puna armiqtësore e trockistëve jugosllavë dhe e Koçi Xoxes, reflektohej dhe vepronte edhe në këtë rreth duke favorizuar një mentalitet të tillë në udhë-

heqje. Veprime jo të drejta, të papeshuara mirë e arbitrare janë bërë nga disa udhëheqës të Partisë dhe të sigurimit. Një politikë e gabuar kuadri është zhvilluar dhe në këtë organizatë, ashtu si edhe në të tjerat. Njerëz të luftës janë përkrahur, pastaj janë goditur, janë favorizuar pastaj janë lënë pas dore. Kjo varej nga një informatë, nga një përshtypje, nga një mëri personale, nga intrigat, që bënte njëri ose tjetri. Veprime të tilla që lindnin nga një situatë e tillë e sëmurë, përfundonin në vendime jo të drejta për kuadrin.

Pas Plenumit XI dhe pas Kongresit I u bënë të qarta veprimet e gabuara në vijë, u bë e qartë puna armiqësore e trockistëve dhe konsekuencat e saja, gjithashtu u bë e qartë vija dhe taktika e Partisë përndreqjen e këtyre gjërave. Por disa udhëheqës të organizatës së Lushnjës ishin larg nga kuptimi i drejtë i vijës së kongresit dhe taktikës që duhej ndjekur dhe zbatuar. Elementët e pakënaqur, që ndaj tyre ishin mbajtur qëndrime jo të drejta nga ana e drejtuesve të Partisë dhe të sigurimit, në këto momente spastrimi dhe shërimi të përgjithshëm, duke mos i njohur të metat e veta që ekzistonin dhe ekzistojnë akoma në ta e që s'bënë autokritikën e shëndoshë të punës së tyre, në mënyrë që të viheshin çështjet një herë e mirë në vendin e duhur, pse kështu do të dilnin edhe gabimet e të tjerëve, këta elementë vepruan në mënyrë jo të drejtë dhe jo në rrugë të Partisë. Ata menduan se kishte ardhur koha të hakmerreshin kundër elementit që kishte gabuar para Plenumit XI. Kjo kategori shokësh, ku bën pjesë Hasan Gina dhe Halit Ahmeti dolën si të persekutuar nga puna trockiste, muarën bajrakun

e luftës për «ndreqjen e gabimeve», që ishin vërtetuar, por ky bajrak nuk ishte në duar të shëndosha dhe sikundër u provua dhe më vonë, ky grup nuk ndoqi rrugën e caktuar nga kongresi, por u përpoq të vepronte në frymë tarafi, ambicie etj. që i dënon Partia.

Është e vërtetë se disa shokë drejtues të organizatës së Lushnjës dhe të sigurimit të atjeshëm kanë gabuar dhe duhej përpara masës së Partisë të bënin autokritikë të shëndoshë, pse kjo është e vetmja rrugë e shërimit të tyre. Këta shokë kanë marrë dënimin që kanë merituar, por këtyre duhej medoemos t'u jepej dora të ngriheshin dhe të ndihmoheshin. Gabimet e këtyre shokëve në tërësi nuk ishin krime të shëmtuara. Gabimet e tyre duhej të mateshin në masën e gabimeve të të gjithë asaj pune të gabuar që ishte vërtetuar para kongresit dhe të korrigjoheshin në bazë të orientimeve të drejta të kongresit. Kjo nuk u bë në organizatën e Lushnjës, bile u bë e kundërta. Kritika dhe autokritika ka qenë e dobët nga të gjithë. Njerëzit, që kishin gabuar, u goditën ashpërsisht, u diskredituan, saqë çdo njeri mund të mendonte «si mbahen në Parti këta njerëz që kanë bërë gjithë këto gjëra të palejueshme». Por u shkua edhe më tej. Nga pikëpamje të tilla të sëmura dhe sektare ndaj kuadrit, dalin dhe pikëpamjet oportuniste ndaj elementit të dobët dhe armikut të klasës. Këto janë si motër e vëlla.

Janë shtyrë direkt ose indirekt elementë të borgjezisë armike të kërkojnë hedhjen në gjyq të shokëve të sigurimit, pse ata i kishin konfiskuar çiften ndonjë beu, sipas urdhërit që kishin nga lart, ose të çonin në gjyq shokë komunistë, që kishin rrëzuar portat e bej-

lerëve etj. gjëra të tilla. U është bërë një luftë e shnder-
shme dhe antiparti shokëve komunistë, që kishin bërë
disa gabime, por që i kishin kuptuar këto gabime dhe
që punonin me të gjitha forcat për t'ja larë Partisë.
Këta ishin hedhur në punë, zhvillonin aktivitet, por
pikëpamja mbi këta shokë, që rehabilitoheshin, qën-
dronte po ajo e vjetra dhe si rezultat, vazhdohej të
diskreditoheshin këta shokë.

Tarafi i Hasan Ginës, i Halit Ahmetit me shokë,
duke dashur të djegë, duke i futur krejtësisht në rrugë
jo të drejtë dhe aspak të shëndoshë shokët e rinj, që
kishin bërë gabime; theu rregullat e Partisë, nuk ruaj-
ti konspiracionin. Çdo gjë që zhvillohej në organizatat
bazë, bëhej shkas muhabeti në popull dhe në konfe-
renca. Nga njerëz të dyshimtë dhe armiq po mbahe-
shin nëpër gojë shokë komunistë për çka thuhej dhe
vendosej për ta në celula e në komitete. Reaksioni po
krijonte opinione për të ngritur në qiell një palë dhe
për të futur në varr palën tjetër. Tarafi i Hasan Ginës
ka pasur tendencë dhe ka vepruar, duke thyer çdo
rregull organizativ, t'i sjellë shokët e organizatave ba-
zë të ndryshme të gjykohen, të kritikohen në organiza-
tën bazë të pushtetit të qytetit, ku ata kishin mbësh-
tetjen dhe që kjo organizatë paraqitej dhe paraqitet
më e sëmura, pse ishte e përbërë në përgjithësi me ele-
mentë jo të shëndoshë dhe me plot të meta.

Tarafi i Hasan Ginës dhe i Halit Ahmetit me shokë
gjatë gjithë kësaj periudhe kanë adoptuar një qëndrim
oportunist ndaj borgjezisë së qytetit dhe të fshatit. Kjo
u është ofruar shokëve të këtij grupi dhe është pritur
jo keq prej tyre. Këta shokë kanë dëgjuar me kujdes

ankimet e këtyre «shqerave të persekutuar nga komunistët», ju kanë dhënë shumë herë të drejtë, ju kanë dhënë të shpresojnë dhe të atakojnë njerëzit e Partisë. Shokë nga të këtij grupi kanë shkuar si pa të keq të përgëzojnë njerëz, që kishin dalë nga burgu, pse u ishte falur dënimi, pa gjykuar pak se këtyre elementëve armiq të dënuar u ishte falur me të vërtetë një pjesë e dënimit, por ata kanë qenë fajtorë. Një sërë veprimesh të tilla të gabuara, orientonin borgjezinë të shikonte në këtë grup një mbështetje për veprime më të guximshme kundër popullit, prandaj borgjezia e mbështeste me parulla e me propagandë veprimin e këtyre shokëve. Elementi i huaj i Partisë po merrte pjesë në këtë situatë, që zhvillohej dhe influenconte brenda në njerëzit e Partisë, pra, në veprimet e saj.

Në veprimtarinë e tarafit të Hasan Ginës dhe të Halit Ahmetit me shokë filloi të dukej dhe një tendencë e rrezikshme dhe karakteristike e luftës që zhvillon borgjezia kundër pushtetit tonë: çështja e dallimeve fetare. Karakteristike është se shumica e shokëve të sëmurë të këtij grupi janë me origjinë muslimane dhe presioni i borgjezisë, që bëhej në këtë grup, vinte nga elementi musliman i goditur. Një rigrupim i tillë, ndofta inkoshient, shikohej edhe në grupin tjetër në opozicion me grupin e Hasan Ginës e të Halit Ahmetit me shokë. Në këtë grup antagonist janë shokë me origjinë të krishtere. Tendenca të tilla, që vërtetojnë metodat e luftës së borgjezisë, u shfaqën në këtë punë të sëmurë, që po zhvillohej në Lushnjë dhe kështu në forma indirekte shfaqej dhe organizohej fillimi i një përçarjeje në rrugë fetare.

Tarafi në opozicion me tarafin e Hasan Ginës e të Halit Ahmetit me shokë përbëhet kryesisht me elementë, që kanë gabuar para Plenumit XI dhe që edhe këta jo në rrugën e drejtë të Partisë kërkojnë të thyejnë tarafin e Hasanit, të forcojnë pozitat e tyre personale, të punojnë po me ato metoda të gabuara që lufton tarafi i Hasan Ginës.

Fill pas punimeve të kongresit, Komiteti Qendror emëroi Hasan Ginën sekretar të parë provizor të organizatës. Hasan Gina në funksionet e sekretarit zhvilloi një aktivitet të sëmurë sikundër u analizua më lart dhe nuk e mbante drejt në korent Komitetin Qendror.

Më vonë Komiteti Qendror, në interesin e Partisë mori masa duke emëruar byrotë dhe sekretarët provizorë në rrethe, për të shëndoshur punën në organizatat, derisa të bëheshin zgjedhjet e reja. Një vendim i tillë u muar dhe për Lushnjën. Para se t'i komunikohet organizatës së Lushnjës ky vendim, Hasan Gina dhe Halit Ahmeti me shokë, alarmohen nga thashethemet pa përgjegjësi të një shoku dhe i drejtojnë një letër alarmante Komitetit Qendror. Këta shokë alarmohen, pse kanë frikë se hiqen nga pozitat që kanë zënë dhe natyrisht ambicia e tyre i mundon. Këta shokë kanë pasur një botëkuptim të sëmurë mbi Partinë dhe me pikëpamjet e tyre të ngushta e konsideronin Komitetin Qendror si një forum, ku lehtë mund të intrigojë ndonjëri për të emëruar ose pushuar një funksionar qoftë edhe të vogël të Partisë.

Pas emërimit të byrosë provizore dhe të sekretarëve në Lushnjë, ku Hasan Gina nuk figuronte si sekretar i parë, ky dhe shokët e tij i drejtuan Komitetit

Qendror edhe një letër tjetër më alarmante akoma për situatën e organizatës së Lushnjës dhe tarafi i tyre filloi pëshpëritjet për ta vështirësuar edhe më tepër gjendjen që kishin krijuar në organizatë, për të diskredituar vendimet e Komitetit Qendror, me të cilat vendime, Hasan Gina, Halit Ahmeti dhe shokët e tyre nuk ishin dakord.

Megjithëse Hasan Gina dhe Halit Ahmeti u thirrën para Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe ikën gjoja të sqaruar, ata jo vetëm që nuk u bindën, por puna e tyre e mëvonshme e tregoi se vazhdonin në rrugën e gabuar.

Përpara zgjedhjeve të Partisë ata filluan aktivitetin e tyre në forma të gabuara dhe të dënueshme nga rregullat e Partisë.

Në kohën e zgjedhjeve të Partisë çështja mori formë të acaruara dhe u duk qartë gjithë kjo punë e sëmurë. Në konferencën e Partisë në Lushnjë, me gjithë orientimin që u jepej nga i deleguari i KQ, tarafi i Hasan Ginës filloi kritikën joparimore, të pabazuara e të ekzagjeruara. Tarafi tjetër filloi dhe ai mbrojtjen e tij dhe kritikën e tija po të kësaj natyre, pra, zgjedhjet u zhvilluan në platforma tarafi të paprincipitë në një atmosferë shumë të sëmurë, ku dukej një kritikë dhe autokritikë shumë e sëmurë, ku dominonte ambicia, intriga etj. e këtyre njerëzve të sëmurë të ndarë në tarafe. Një mision kaq të rëndësishëm, që u kishte ngarkuar organizata, këta e përdorën për të plotësuar ambiciet e tyre personale dhe qëllimet e sëmura të tyre. Duke orientuar keq zgjedhjet u arrit në rezultatin që të dy tarafet të mos votojnë për njëri-tjetrin dhe të

kenë vota më pak se të gjithë të tjerët duke u ndodhur kështu në fund të listës. Duken qartë, pra, qëllimet që u synuan në atë konferencë. Kjo punë e tillë pati dhe një konsekuencë tjetër të rëndë, se në Komitetin e Partisë u zgjodhën shumë shokë jo të përshtatshëm për udhëheqje dhe që s'mund të ishte ndryshe, pse nga kjo punë e tillë e sëmurë tarafi dhe ambicie, do të dilnin të tillë elementë në udhëheqje.



1. — Duke pasur kurdoherë bindjen e plotë se në organizatën e Lushnjës ekziston një numër i madh shokësh të shëndoshë, besnikë, të pastër dhe të klasës punëtore, Komiteti Qendror u rekomandon këtyre që të vënë të gjitha forcat për spastrimin e këtyre sëmurdjeve dhe të metave që ekzistojnë në organizatën e tyre, ta forcojnë këtë, ta bëjnë luftëtare revolucionare për realizimin e plotë të programit të Partisë, ta bëjnë të pamëshirshme kundër armikut të klasës dhe të zhvillojnë me sukses luftën e klasave.

Komiteti Qendror i rekomandon organizatës së Lushnjës, të thellohet ca më shumë në direktivat dhe në vijën e Partisë, t'i bëjë këto mish dhe gjak të saj dhe me gjak të ri, të hidhet në punë dhe në luftë.

Komiteti Qendror është i bindur se të metat dhe gabimet, që janë vërtetuar në disa njerëz të kësaj organizate, do të spastrohen sa më parë, duke përdorur fuqimisht dhe drejt armët e fuqishme të Partisë, kritikën dhe autokritikën.

Kritika dhe autokritika janë kondita të domosdoshme për një aktivitet militant të drejtë, domethënë, vetëm me anën e këtyre mund të nxjerrim mësim, mund të nxjerrim gabimet dhe dobësitë që nga rrënja, me qëllim që t'i korrigjojmë.

Duhet me punue mirë dhe çdo njeri duhet të punojë mirë, por dhe kritika e autokritika janë mjete që të bëjnë të punosh mirë. Kritika dhe autokritika, të kuptuara mirë për rolin e tyre të madh, e bëjnë militantin që i përdor këto në mënyrë të ndërgjegjshme, t'i mbajë këmbët në tokë, e bëjnë të kuptojë dhe të luftojë influencën e ideologjisë borgjeze në konshiençën e punonjësve.

Kuptimi i drejtë i rolit të kritikës dhe të autokritikës, sjell si rezultat afrimin e komunistit me masat dhe e detyron militantin, të njohë më parë mirë vetëveten, të mos harrojë rrugën, që ai ka kaluar, e detyron militantin të jetë i kuptueshëm, të jetë modest dhe jopedant.

Morali borgjez ka lënë njolla ndër ne. Ka shokë me një sedër të sëmurë, që s'duan të njohin se kanë gabuar, që rrojnë me të kaluarën dhe mjaftohen me eksperiencën që kanë fituar një herë e përgjithmonë. Këta gabohen, por gabojnë edhe të tjerët. Këta shokë kënaqen me veten e tyre dhe mbivlerësojnë zotësinë e tyre. Këta bëhen predikatorë pedantë dhe kur kritikohen për gabimet që bëjnë, i mbrojnë këto gabime dhe ka njerëz rreth tyre që i duartrokitin dhe i aprovojnë me ndërgjegje ose jo. Ka edhe njerëz që nuk i aprovojnë. Duke ditur fare mirë se kanë gabuar ose se s'kanë të drejtë në çështjen që ata mbrojnë, duke

ditur se ata mbrojnë gabimin, ata mburren se e kanë dërmuar kundërshtarin, ata janë kryelartë për këtë gjë. Ata njëkohësisht kanë gënjer veten dhe një sërë shokësh, që i kanë duartrokatur ose aprovuar, ata kanë dëmtuar çështjen e Partisë. Pra, kanë bërë një punë shumë të dëmshme.

Një shok bën një gabim kundër një shoku ose kundër organizatës. Ai duhet të njohë haptas gabimin, por ka shokë, që nga sedra e sëmurë s'e pranojnë; ata vënë veten mbi çdo gjë. Shokë të tjerë e dinë që ky po gabon, por e mbrojnë për «miqësi personale», dhe e vënë këtë «miqësi personale» mbi çdo gjë, mbi të drejtën dhe mbi organizatën. Por një mbrojtje e tillë e vetes dhe e gabimeve, nuk mund të qëndrojë për shumë kohë në këmbë. Atëhere ai shok që gabon dhe s'pranon gabimin, përpiqet të gjejë mbështetje në bazë të miqësive personale dhe në rast se këtë e gjen në gjirin e organizatës, atëhere formohet tarafi kundër organizatës dhe Partisë. Por kjo s'mbetet me kaq. Që këtë ai kërkon mbështetje jashtë Partisë dhe, pa u lodhur, ai e gjen në kundërshtarët e Partisë. Ai e gjen mbështetjen në borgjezinë. Morali borgjez është i tillë që i pret me krahë hapët të tillë njerëz, që gabojnë dhe që s'njohin gabimet, por që i mbrojnë, që i fshehin, që kanë sedër të sëmurë, që janë fodullë dhe egoistë. Morali borgjez lejon njerëz të tillë jo vetëm të rrojnë në gjirin e saj, por edhe të zhvillojnë këto të meta që janë cilësitë e çmueshme për moralin borgjez. Disa shokë të organizatës së Lushnjës, që përmendëm, kanë bërë gabime dhe s'i kanë njohur. Kjo gjë ka bërë që të krijojnë tarafe mbështetjeje në elementë të tjerë

të sëmurë. Kur janë kritikuar, ata s'kanë pranuar fajin dhe këtej kanë shkuar larg sikundër u tregua më sipër.

Disa shokë nuk rrojnë jashtë guaskës së tyre dhe as që mund t'i shohin gabimet e tyre. Ata në vend që t'ua dinë për të mirë shokëve që ua vënë në dukje këto gabime, përkundrazi zemërohen; ka shokë të tjerë që, për hatërin e miqësisë personale, që s'është veçse një miqësi formale dhe e përciptë, nuk ua vënë në dukje gabimet, por i vijnë rrotull gabimit, ose shumë herë ua thonë gabimet dhe i kritikojnë pa u dhënë as shpjegimin më të vogël, ose, që të mos i prekin në sedrën e tyre, vënë të tjerë t'ua thonë. Me ngurrue t'i thuash të metat tjetrit, nuk është tjetër gjë veçse pasqyrimi i raporteve false të politesës borgjeze dhe që të bën të jesh hipokrit, që bën të grumbullohen kritikrat dhe armiqësitë. Në mes shokëve militantë duhet me fol hapët, me thënë qetësisht të vërtetën dhe t'i nënshtrohemi vullnetarisht, me ndërgjegje e haptas kritikës dhe autokritikës dhe jo t'i konsiderojmë këto vetëm si detyrë, por si një funksion i domosdoshëm i aktivitetit militant.

Kritika dhe autokritika janë forcë lëvizëse e shoqërisë socialiste. Këto bëjnë që të zhduken nga ne të gjitha mbeturinat e moralit borgjez.

Morali revolucionar, që na lejon të ballafaqojmë mendimet dhe veprimet tona i ka bazat në principet e shoqërisë së re pa klasa dhe kjo ndërgjegje revolucionare ka elementët permanent të formimit dhe të zhvillimit në klasën punëtoare dhe në raportin me masat.

Duke pasur, pra, kurdoherë parasysh detyrat tona ndaj klasës punëtore, ne duhet t'ja nënshtrojmë veprimet tona kritikës dhe autokritikës bolshevike — vetëm kështu ne do të luftojmë mbeturinat e moralit borgjez, që ekzistojnë në militantët, vetëm kështu do të luftojmë me ashpërsinë më të madhe presionin e ideologjisë reaksionare dhe presionin e borgjezisë. Kështu do të forcojmë dhe do të kalitim veten tonë si militantë dhe kështu Partia jonë do të çelënikoset gjithnjë e më shumë.

2. — Komiteti Qendror pas studimit të imtë që i bëri kësaj çështjeje vendosi anulimin e zgjedhjeve të organizatës së Lushnjës, pse këto zgjedhje u zhvilluan në situatat e sëmura që u theksuan më lart.

3. — Byroja Politike e Komitetit Qendror cakton byronë provizore të Komitetit të Partisë për Lushnjën me shokun Mihal Bisha si sekretar politik. Përbërja e Byrosë provizore deri në zgjedhjet e reja i njoftohet veçanërisht Komitetit të Partisë për rrethin e Lushnjës.

4.¹

5. — Kjo letër të punohet në organizatat e Partisë për rrethin e Lushnjës dhe në të gjitha organizatat e Partisë të rretheve të tjera dhe të shërbejë si mësim për gjithë Partinë për të luftuar me ashpërsi të tilla shfaqje të huaja për Partinë tonë, gjithashtu të armato-

¹ Në këtë pikë radhiten masat edukative që u muarën ndaj atyre që kishin gabuar dhe mbanin përgjegjësi për dobësitë e vërtetuara në punën e organizatës së Partisë të rrethit të Lushnjës.

set Partia nga kjo eksperiencë, duke u ruajtur dhe duke luftuar presionin e borgjezisë dhe metodat e saja armiqësore.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë sipas
originalit që gjendet në Arki-
vin Qendror të Partisë*

MBI DISA MASA QË DUHEN MARRE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PRODHIMIT TË NAFTËS NË KUÇOVË E PATOS

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 korrik 1949

Shokët e Kuçovës e të Patosit që na raportuan, ngritën shumë probleme, të cilat në përgjithësi janë të drejta, por unë nuk e kam shumë të qartë se çfarë bëni ju, shokë, që ju ka ngarkuar Partia të drejtoni punën në këta sektorë me rëndësi, si luftoni ju për t'i eliminuar këto të meta që thatë, si do të realizohet plani etj. Ju, ju kemi dërguar atje si drejtues dhe jo vetëm si konstatues. Atëhere, pse nuk merrni masa që plani të realizohet, por gjeni «arësye», duke thënë se «nuk kemi atë e nuk kemi këtë»? Si drejtues të këtij sektori, ju përket të merrni masa të tilla që të ketë një tjetër situatë dhe plani të realizohet plotësisht. Shu-

¹ Në këtë mbledhje Sekretariati i KQ të PPSH mori në shqyrtim gjendjen e Kombinatit vajguror Kuçovë-Patos dhe caktoi detyrat për përmirësimin e saj.

më nga ato që u thanë këtu, Byroja Politike i di, por ne na interesonte të dinim luftën konkrete që bëhet nga ana juaj kundër mungesave subjektive.

Punëtorët te ne janë zot të vendit dhe e ndjejnë se detyrat duhen plotësuar, por varet si organizohen e drejtohen ata, sa përdoren energjitë e tyre të mëdha, sa tërhiqen ata në punët drejtuese. Këto kanë rëndësi shumë të madhe dhe nuk zgjidhen vetëm me mbledhje; ka një tendencë që për një gjë të vogël mblidhet populli, mblidhen punëtorët. Edhe mbledhje do të bëjmë, po punëtori ynë ka edhe shumë nevoja të tjera, prandaj nuk duhet ta mbajmë gjithnjë në mbledhje, ai ka nevojë edhe për dëfrim e mësim dhe këto duhen bërë të organizuara. Punëtorit duhet t'i kërkojmë realizimin e planit, po njëkohësisht atij duhet dhe t'i japim. Për shembull a është llogaritur sa shtëpi ka në fshatrat përreth dhe a ka mundësi që, me pak vështirësi, të krijohen edhe mundësi që të vendosen familjet e punëtorëve në ato fshatra? Nëse nuk ka banesa punëtorët nuk vijnë të punojnë në këto qendra prodhimi. Megjithatë ne të mos kërkojmë që qysh tani të ndërtojmë aty pallate, po të ndërtojmë banesa të thjeshta e të sigurohet në këtë mënyrë strehimi i punëtorëve. Pra edhe nga këto gjëra varet realizimi i planeve të prodhimit.

Fakti është se në Kuçovë e Patos nuk është punuar mirë as nga organizata e Partisë, as nga drejtorja e kombinatit vajguror si dhe as nga Ministria e Industrisë. Realizimi i planit ka rëndësi të madhe e për këtë jemi të gjithë përgjegjës. Por në mënyrë të veçantë për realizimin e planit të prodhimit të naftës është

ngarkuar Ministria e Industrisë dhe Drejtoria e Kombinatit vajguror Kuçovë-Patos, të cilat mund të themi se nuk janë në krye të situatës. Ministria e Industrisë pranon ato që thotë drejtoria e kombinatit, i quan këto si gjëra të drejta, po nuk kontrollon si duhet punën. Kjo ministri ka angazhime të mëdha përpara shtetit dhe shteti, në bazë të planit të paraqitur, ka angazhimet e tij ndaj vendeve të tjera miq, te të cilët duhet të eksportohen prodhimet e naftës. Pra, angazhimet kanë dy kuptime: po nuk eksportuam naftën, nuk mund të importojmë tubat, që na duhen për shpimet e puseve. Këtej rrjedhin detyrat tona të mëdha dhe këtu duhet të përqëndrohen forcat tona për të mobilizuar tërë masat që plani të realizohet e të tejkalohet.

Ne e kuptojmë se për realizimin e planit ka dhe mungesa, të cilat pengojnë, por dimë se edhe shumë gjëra, që mund të bëheshin, nuk janë bërë. Shpeshherë, në Kuçovë e Patos nuk i është dalë përpara situatës, megjithëse atje është dhe drejtoria e kombinatit dhe komiteti i Partisë. Detyrat e organeve të Partisë dhe të organeve të shtetit janë të ndara, po janë dhe të lidhura dhe të gjitha këto ne duhet t'i shikojmë me syrin politik. Në Ministrinë e Industrisë është shfaqur pikëpamja se për realizimin e planit kemi mungesa të mëdha. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që nga mosrealizimi i planit të prodhimit të naftës të shtohen deficitet tona të eksportit. Po si mund ta pranojmë ne këtë pikëpamje? Përkundrazi, ne jemi për të shtuar eksportet dhe për të pakësuar importet, gjë që nuk mund të bëhet pa realizuar planin. Çështja e eksportimeve duhet të mos neglizhohet dhe këtë ta shohim

në kompleks, sepse pambuku nuk është bërë, plani i grumbullimit të leshit nuk u realizua, plani i prodhimit të bitumit e kromit po kështu nuk u realizua. Po, tani për tani, këto janë pasuritë tona. Qeveria jonë ka marrëdhënje ekonomike me qeveritë e vendeve të tjera dhe po qe se nuk u përmbahet angazhimeve që ka ndaj tyre, vihet në pozita të vështira. Këtu kemi përgjegjësi të madhe, prandaj duhet të mobilizohemi mirë që nga ministri deri në bazë, po kështu edhe si Parti, pse nuk mund të themi se punon mirë Partia, kur plani mbetet pa realizuar. Disa thonë se komunistët, që punojnë në këta sektorë, janë me nivel të ulët dhe kjo pengon realizimin e planit. Ashtu është, shokët tanë janë vërtet me nivel të ulët, po pikërisht këtu qëndron detyra e madhe e Partisë, që të punojë për ngritjen e nivelit të anëtarëve të saj, të punojë për edukimin e tyre. Nga ana tjetër, vetë anëtarët e Partisë duhet të bëjnë përpjekje e sakrifica që të ngrenë nivelin e tyre. Kjo do të ndihmojë që Partia të mobilizohet më shumë, të ketë iniciativë dhe disiplinë.

Për realizimin e planit ka rëndësi jo vetëm forcimi i punës me punëtorët, me drejtuesit, me komunistët, por edhe me inxhinierët e teknikët. Personelit inxhiniero-teknik t'i ngrihet autoriteti dhe të inkurajohet në punën që bën, të luftohet që udhëzimet e tij të drejta të zbatohen nga punëtorët. Për këto gjëra interesohet Komiteti Qendror dhe qeveria, sepse kanë të bëjnë direkt me realizimin e planit.

Kurseve të kualifikimit duhet t'u vihet rëndësi e madhe, sepse neve na mungojnë njerëzit e mësuar. Përpjekje për ngritjen e këtyre kurseve janë bërë, por

mund dhe duhet bërë më shumë. Ja një detyrë e posaçme ku mund të aktivizohen inxhinierët dhe teknikët tanë për të ngritur nivelin teknik të punëtorëve. Me këtë punë të merret më mirë edhe sindikata, e cila të mos merret vetëm me organizimin e garave dhe shpërndarjen e flamurëve.

Gjendja në Kombinatin vajguror Kuçovë-Patos është e vështirë, po meqenëse në kantierin e Patosit puna çalon më shumë dhe konditat e punës janë më të vështira atje duhet me i qëndrue punës më në kokë. Atje ka plot njerëz, që kanë përgjegjësi dhe duhet të merren më mirë me realizimin e planit.

Të gjitha këto që u thanë këtu, shokët i kuptojnë dhe ne nuk themi se në Patos e Kuçovë nuk luftohet dhe s'kemi rezultate, por dhe këto të meta e mungesa për të cilat u fol, duhet të përpiqemi t'i zhdukim. Edhe shokët e qendrës, kur venë nga lart, duhet të rrinë më shumë në bazë, të bisedojnë me punëtorët dhe të ndihmojnë. Kjo çështje të merret seriozisht se gjithnjë e themi, po akoma nuk po zgjidhet si duhet. Të bëhet një ndarje më e mirë e forcave. Kuçova ka traditë, të cilën ne duhet ta përdorim për rezultate më të mëdha në punë. Kështu, me siguri, situata në Kuçovë e Patos do të ndryshojë dhe plani do të realizohet.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

**NGA FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E
PËRBASHKËT TË BYROSË POLITIKE TË KQ
TË PPSH DHE TË QEVERISË SË RPSH ME
RASTIN E SHQYRTIMIT TË REALIZIMIT TË
PLANIT TË GJASHTËMUJORIT TË PARË**

2 gusht 1949

Në këtë mbledhje të përbashkët të Byrosë Politike dhe të qeverisë, do të shqyrtojmë realizimin e planit për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Për këtë qëllim është menduar që të marrin pjesë edhe disa zëvendësministra, të cilët janë në dijeni të vendimeve që do të merren në këtë mbledhje.

Para se të raportojë shoku Spiro Koleka mbi gjendjen e planit ekonomik të shtetit për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, unë do të dëshiroja të thoshja disa gjëra.

Siç dihet, realizimi i planit është jashtëzakonisht prapa. Shkaqet kryesore janë subjektive, mungesë organizimi dhe përgjegjësie në punë. Por plotësimi i planit është një çështje kryesore për Partinë dhe vendin tonë, prandaj për ta zbatuar atë në të gjithë treguesit e tij, duhet të vëmë të gjitha energjitë tona.

Duhet thënë, se ka mjaft shokë që venë me mendi-

min e gabuar se «është vështirë të realizohet plani, pse ka një varg pengesash». Si pasojë, duke u nisur nga ky mendim, nuk ka luftë për kapërcimin e këtyre pengesave.

Partia dhe qeveria kërkojnë që të kuptohet thellë përgjegjësia nga secili, pse kemi të bëjmë këtu me një çështje të madhe jetike. Për ndonjë që nuk e koncepton kështu problemin, mendoj të marrim edhe masa si p.sh. në Ministrinë e Komunikacionit, ku puna nuk ka shkuar mirë, ka pasur çorganizim, lëshime dhe pikëpamje të rrezikshme, në radhë të parë nga Niazi Islami, i cili edhe punën që ka bërë armiku në komunikacion, ua ka hedhur neglizhencave të njërit e të tjetrit. Nga ana tjetër, ai ka pasur një kuptim jo të drejtë mbi drejtimin e punëve, duke kujtuar se vetëm ai është kompetent për çdo gjë. Nuk ka pasur konsideratë për anëtarët e qeverisë, bile ka shkuar deri atje sa të hedhë poshtë vendimet e saj, të firmosura nga unë.

Si mund të realizohej plani në këtë dikaster kur aty ka pasur një punë të sëmurë; në hekurudhë mungonte disiplina e shëndoshë, çdo njeri vepronte me kokën e tij. Dhe këto ishin të natyrshme, përderisa Niazi Islamit i pëlqente mendja e tij, pikëpamje kjo e rrezikshme për komunistët, prandaj ai duhet hequr nga Ministria e Komunikacionit dhe në vend të tij propozoj që shoku Shefqet Peçi ta marrë në dorë atë sektor, ku të vendosë një disiplinë ushtarake. Të gjitha dikasteret duhet të kenë parasysh se tani e tutje do të hasin atje në një sistem pune të rreptë, prandaj po të mos jenë në rregull, do të duket qartë se ku çalon puna, pse nuk janë të rralla rastet, kur sektorët e tjerë të ekonomisë,

duke mos realizuar planin, fajin ja hedhin transportit. Në këtë mënyrë nuk mund të ecet, kontratat duhet të respektohen dhe kështu do të dalë më mirë se kush është përgjegjës për mosrealizimin e planeve.

Kjo mbledhje, shokë, nuk duhet të bëhet shkel e shko. Unë kërkoj nga secili që t'i bëjë një analizë të shëndoshë punës në sektorin e tij, një kritikë dhe auto-kritikë bolshevike, pse nuk mund të dalim këtej pa nxjerrë shkaqet dhe shkaktarët e mosrealizimit të planit. Kjo është një çështje me rëndësi, pa të cilën punët nuk mund të na shkojnë përpara. Të përpiqemi që këto çështje të mos mbeten deklarata të thata, po të marrim masa të forta e konkrete për të zbatuar si duhet detyrat kudo që punojmë dhe të forcojmë llogarinë.

Pas raportit që u mbajt, gjatë dy ditëve që vazhdoi mbledhja, u zhvilluan gjerësisht diskutime e u rrahën mendimet. Në fund duke mbyllur mbledhjen shoku Enver tha:

Kjo mbledhje e Byrosë Politike dhe e qeverisë, siç e theksova dhe në fillim, nuk kishte vetëm për qëllim sa të mbahet një raport për realizimin e planit. Qëllimi kryesor ishte që ky raport dhe diskutimet që u zhvilluan, të na bëjnë që të marrim masa politike, organizative, teknike për realizimin e plotë të planit. Kjo do të bëhej mbi bazën e analizës së shëndoshë të punës, duke vënë në dukje gabimet e bëra, sidomos ato më të mëdhatë, qofshin objektive ose subjektive dhe të dilnim me konkluzione që ta realizojmë planin në të gjithë zërrat e tij. Këto objektiva duhet t'i arrijmë patjetër, pse mundësitë ekzistojnë. Ne, me punën e shëndoshë që u bë nga Partia vjet, dolëm nga një situatë e vështirë.

Udhëheqja e Partisë dhe qeveria orientuan që të hartohet një plan në bazë të mundësive tona dhe të ndihmës që do të na jepte Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore. Dhe ky plan u hartua, natyrisht edhe me mungesa, por po të bëheshin përpjekjet e duhura, ai nuk do të kishte pasur shumë të meta dhe boshllëqe, të cilat, sigurisht, nuk mund të përjashtoheshin fare, ngaqë koha ka qenë e paktë.

Unë mendoj se çështjen e realizimit të planit, shokët ministra, nuk e kanë marrë me tërë seriozitetin e duhur, gjë kjo që nuk do të thotë se ata nuk kanë punuar fare, por këtu është çështja e mosorganizimit të mirë të punës dhe e mungesës së kontrollit të drejtë e të shpejtë për të shikuar se si plotësohet plani i shtetit. Ne kemi thënë se planin do ta realizojmë dhe muarëm parasysh se duheshin bërë dhe sakrifica. Kjo kërkonte që shokët ministra të organizonin mirë punën, por kjo gjë nuk u bë nga ana e tyre.

Ka një kuptim të gabuar në disa shokë, sikur, tani pas fitores së pushtetit popullor, s'na mbetet veçse të përfitojmë nga ato që kemi fituar me aq sakrifica dhe sikur mund të flemë mendjen e të gëzohemi me to, pa menduar se ato janë vërtet bazë, por, për të vajtur në socializëm, duhen sakrifica të tjera, akoma më të mëdha. Ne luftuam dhe fituam, do të luftojmë e do të punojmë përsëri që të fitojmë, se fitoret nuk vijnë vetë. Po nuk mendoj e po nuk veproji kështu komunisti, ai do të mbetet pas dhe brezi i ri, që rritet, nuk do të pajtohet me të. Është fakt se te rinia ka ndjenja të sakrificës dhe të një patriotizmi të jashtëzakonshëm; ajo i kupton menjëherë direktivat e Partisë dhe çan, hidhet

në sulm. Kudo që i është bërë thirrje për të marrë pjesë në aksione, si në ndërtim të rrugëve të reja, në hekurudhë etj., rinia, kjo rezervë e madhe e Partisë, është mobilizuar dhe e ka bërë detyrën. Prandaj, shumë komunistë duhet të marrin shembull prej saj. Kjo është e nevojshme, pse Partia u thotë anëtarëve të vet të venë në prodhim, por ka komunistë që nuk shkojnë, kurse të rinjtë venë menjëherë, pa e bërë dysh fjalën e Partisë. Këto gjëra kanë një rëndësi të madhe dhe duhet të kuptohen thellë. Plani nuk realizohet pa një mobilizim të madh për ndërtimin e vendit.

Ne kemi vendosur që plani të plotësohet dhe në këtë gjë duhet të qëndrojmë fort dhe fjalën e dhënë ta mbajmë. Këtë del se nuk mund të lejojmë që plani të mos realizohet për shkak të mungesave tona dhe të një drejtimi të keq. Ne kemi marrë një barrë të rëndë për gjashtëmujorin e dytë dhe kësaj nuk mund t'i shpëtojmë. E them këtë, sepse ka shokë, që me fjalë e thonë se planin do ta realizojmë, por akoma nuk kanë bindje dhe besim të plotë. Por, të mos harrojmë se, për realizimin e planit, ka disiplinë; qeveria është përgjegjëse përpara Partisë dhe ministrat janë përgjegjës përpara Partisë dhe qeverisë. Këtë gjë duhet ta kuptojmë mirë e t'i korrigjojmë në praktikë këto gabime. Të gjithë anëtarët e qeverisë duhet ta marrin mirë punën në dorë dhe të jenë të rreptë ndaj atyre, që nuk i kryejnë dërrin në fund detyrat, por bëjnë lëshime të tilla, të cilat janë në kurriz të planit. Nuk duhet të pranojmë asnjë justifikim për materiale që sigurohen brenda vendit. Mungesa objektive janë vetëm ato materiale që na vijnë nga jashtë, por po ta gryojmë mirë edhe këtë problem,

prapë gjejmë arësye subjektive, pse shpeshherë ne i kemi bërë kërkesat me vonësë. Qeveria duhet të forcojë përgjegjësinë e ministrave dhe të ministrive dhe duhet thënë se në mjaft ministri punët nuk shkojnë mirë, ka shfaqje oportunizmi dhe familjariteti të sëmurë. Do forcuar disiplina në punë. Këtu nuk është çështja me qenë arrogant, por ai që drejton, duhet ta zotërojë mirë punën, të jetë operativ dhe rigoroz në kryerjen e detyrave, të kërkojë llogari pa bërë lëshime, por edhe t'i ndihmojë vartësit kur kanë nevojë, siç bën shoku Mehmet në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kështu duhet të punojë çdo ministër në sektorin e tij. Ne i kemi thënë dhe herë të tjera këto çështje, por ato akoma nuk po gjejnë zbatim.

Një ministri tjetër që ka punuar mirë, është edhe ajo e Financave. Shumë shokë, duke mos qenë në rregull me çështjet financiare kanë dashur t'u shpëtojnë përgjegjësiave, por nuk kanë mundur, sepse kanë hasur në rezistencën e Ministrisë së Financave, e cila, kur nuk punohet mirë, ka të drejtë të presë edhe pagat. Po të mos ketë disiplinë financiare, atëherë ka shturje. Është e qartë se duhet vepruar me energji për të forcuar punën në çdo ministri. Është fakt se ka detyra që nuk ndiqen si duhet, mirëpo kështu nuk zbatohen vendimet e qeverisë. Ka ministra që edhe kur i ndjekin çështjet duke shkuar në vend, shpesh këtë e bëjnë jo si duhet, ata venë në bazë më shumë si konstatare dhe nuk u hyjnë thellë punëve. Duhet kuptuar mirë se një ministër, kur voto në bazë, duhet të shohë mirë punën dhe të ndryshojë patjetër situatën. Nuk na duhen vajtje e ardhje me duar bosh, me konstatime. Ministrat

janë anëtarë dhe kandidatë të Komitetit Qendror, ka dhe të tjerë, që nuk janë të tillë, por që kanë besimin e Partisë dhe janë veshur me autoritetin e ministrit. Të gjithëve Partia u jep mjaft autoritet, që kur venë poshtë për të parë një gjë, ata të marrin menjëherë masat e duhura e jo të sjellin vetëm konstatime, por të veprojnë siç kanë kompetencat e tyre. Jo vetëm kaq, por një udhëheqës, kur shkon poshtë, duhet të shohë dhe të zgjidhë vërtet punët e tija, por të mos bëjë sehir problemet e sektorëve të tjerë, për të cilat ai duhet të marrë gjithashtu masa në vend; kështu rritet roli i tij; po të punohet kështu edhe sikur udhëzimet dhe masat të jenë të gabuara, do të kemi mundësi t'i ndreqim.

Komisioni i Planit ka pasur shumë punë, por ai ka për detyrë jo vetëm t'i hartojë planet, por dhe t'i ndjekë. Është e vërtetë se plani është dinamik, po çdo ndryshim që mund t'i bëhet atij, duhet të arësyetohet mirë. Këtu duhet të kuptohet mirë se për mungesën e inisiativës, të një enti dhe për të metat që thamë më lart, nuk mundet t'i hidhet faji Komisionit të Planit, prandaj për zgjidhjen e shumë gjërave, duhet të mendojë vetë secili, por këtu, ka faj edhe Komisioni i Planit, i cili i ka pranuar këto kërkesa të ministrive, duke humbur kështu shumë kohë. Komisioni i Planit nuk duhet të pranojë më gjëra të tilla dhe ai ministër, që kërkon të bëhen ndryshime në plan, le të vijë në qeveri t'i kërkojë, sepse shumë vetë kërkojnë të ndreqin gabimet e tyre, por nuk kërkojnë asnjëherë të japin llogari.

Në mbledhjen e qeverisë konstatoj se nga ana e mjaft shokëve, nuk tregohet një optimizëm i shëndoshë

që të dalin me plot bindje se ne do ta realizojmë planin. Duke e rrethuar një problem të caktuar me shumë vështirësira, ndonjëri arrin deri aty sa nuk ka kurajë të marrë përgjegjësinë e plotë për të luftuar, për të kapërcyer vështirësitë dhe për të fituar mbi to. Ose ndodh edhe ndryshe, që ndonjë shok thotë shumë gjëra, por kur fillon që t'i vëjë në zbatim, vetë ai kundërshton dhe puna mbetet pa bërë. Te ne flitet se po ecim me plan, po në realitet ka shokë, që nuk punojnë në bazë të planit. Plani duhet të realizohet mirë si në sasi, në cilësi dhe në pikëpamje financiare, mbasi të gjitha këto anë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe duhet të shkojnë tok. Në këtë drejtim ne vihemi përpara detyrave dhe angazhimeve e në radhë të parë Ministria e Industrisë, e cila duhet ta realizojë planin në të gjithë treguesit ekonomikë. Ne nuk duhet të pranojmë fjalët e shokëve të Kuçovës, të cilët thonë se «mosrealizimi i planit vjen nga mungesa objektive» dhe se «deficiti do të shtohet edhe më shumë». Të tregohet shumë kujdes se aty janë të ardhurat tona kryesore, se andej varet një pjesë e madhe e eksportimeve tona. Duhet të dimë se miqtë tanë na ndihmojnë me gjithë zemër, sidomos Bashkimi Sovjetik, po ne duhet t'u përmbahemi fort detyrimeve tona. Kredia na është dhënë si një ndihmë për të ecur përpara dhe megjithatë ne kemi gjithë këto vështirësi. Ne duhet të zbulojmë e të shfrytëzojmë më tepër rezervat tona, forcat tona. Ministria e Industrisë është sektori më i rëndësishëm, por edhe më i dobët. Aty duhet të zhduken format burokrautike të punës, javashllëku, mungesa e operativitetit dhe e ndjekjes së çështjeve. Ne duhet ta realizojmë planin e nxjerrjes së

naftës, të kromit, të bitumit, të bakrit etj. Deficiti në naftë duhet të ulet patjetër dhe në një shkallë të madhe. Çështja e mungesës së fuqisë punëtore dhe vështirësitë e tjera luajnë rolin e tyre, por duhet të merren masat që të gjejnë zgjidhjen e drejtë ato çështje, që na kanë zënë këmbët dhe pse ne nuk i kemi studjuar mirë, prandaj na kanë mbuluar punët. Kjo gjë vjen, sepse shumë probleme nuk zgjidhen nga vetë ministrat, bile edhe këta nuk duhet t'i zgjidhin vetë të tëra çështjet, por të ngarkojnë e të aktivizojnë më mirë vartësit e tyre.

Edhe në Ministrinë e Bujqësisë situata nuk është e mirë. Në këtë dikaster ka nevojë për më shumë gjallëri dhe operativitet. Në sektorin e bujqësisë ka pasur shumë gabime, me të cilat nuk mundet të ecet përpara. Njerëzit që punojnë aty duhet të shkunden mirë se është një sektor nga më kryesorët, të shtrohen më drejt çështjet, të merren përgjegjësitë e duhura dhe të bëhen mirë llogaritë për të gjitha problemet. Plani i pambukut duhet të realizohet se kemi edhe angazhime.

Në Ministrinë e Tregëtisë shokët janë mjaft operativë, por çështjet nuk duhet t'i shohin nën një prizëm të ngushtë. Në udhëzimet, që nxjerr ky dikaster, duhet të parashikohet më mirë gjithshka, pse çdo gabim që bëhet na kushton shtrenjtë në situatën që po kalojmë. Të përpiqemi të organizojmë mirë tregëtinë, t'i ndihmojmë kuadrot dhe t'i udhëzojmë.

Mjaft e rëndësishme është çështja e sigurimit të fuqisë punëtore. E gjithë Partia të përpiqet që të nxjerrë e të plotësojë nevojat me punëtorë, por ne të gjithë të Partisë jemi, prandaj të bëjmë edhe vetë përpjekje e të mos i kërkojmë gjërat gati, ndryshe nuk dalim dot

nga kjo gjendje që jemi. Njerëzit tanë duhet të venë më shumë në terren dhe të rrinë më pak në zyra e të luftohet kundër burokratizmit, në të gjitha format e shfaqjes së tij.

Për të gjitha këto të meta që dolën këtu, jemi të gjithë përgjegjës duke filluar që nga unë, prandaj këto që thamë t'i kuptojmë mirë dhe t'i zbatojmë. Organet e drejtësisë të jenë në pozita më luftarake për çdo gjë që nuk shkon mirë, po kështu dhe Kontrolli i Shtetit. Kontrolli duhet të jetë rigoroz, me qëllim që secili të kryejë mirë detyrën. Tani neve na mbetet që të mobilizohemi e të punojmë ashtu siç thamë. Me çështjet ekonomike janë të lidhura të gjitha çështjet e tjera si ato të drejtësisë, të arësimit, të kulturës, të propagandës etj. Në Kucovë p.sh. nuk shihet asnjë parullë e shkruar për të nxitur sindikatat dhe punëtorët që të punojnë më mirë. Për këto gjëra duhet të mos na zërë gjumi, po t'i vëmë në rrugë të drejtë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

**NGA DISKUTIMI NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT
TË BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH DHE
TË QEVERISE SË RPSH ME RASTIN E
SHQYRTIMIT TË PROJEKTVENDIMIT
PËR MBJELLJET E VJESHTËS**

15 gusht 1949

Kam edhe unë disa mendime rreth projektvendimit që na paraqitet për mbjelljet e vjeshtës. Ky projektvendim më duket se është shumë i gjatë, ka mundësi të shkurtohet, të formulohen më mirë e të paraqiten më qartë detyrat që na dalin. Por rëndësi ka zbatimi i plotë i tyre dhe, kur vendosim për një gjë, ajo duhet vënë në jetë patjetër. Unë nuk jam dakord me atë që na thuhet në hyrje të projektvendimit, ku gjendja paraqitet sikur të gjitha problemet në bujqësi kanë shkuar mirë. Sigurisht, suksese kemi dhe ato do t'i themi, por duhet të vihen në dukje dhe të metat, pse i tillë është realiteti. Kështu duhet parë p.sh. çështja e rendimenteve për të cilat flitet në projektvendim.

Përsa i përket çështjes së transportit të plehut kimik nga depot në fushë, në projektvendim theksohet se ne e kemi bërë, kurse në të vërtetë nuk është ashtu; në fakt ne kemi transportuar sasira të kufizuara dhe jo aq sa ishte e nevojshme. Prandaj të jemi më të saktë.

Po kështu në projektvendim vihet në dukje se «fshatarët kanë bërë kritikë dhe autokritikë të shëndoshë». Unë them se edhe kjo s'duhet vënë kaq absolute, pse ne nuk jemi akoma kaq të përsosur në këtë çështje. Ka rëndësi të vihet theksi në atë që plani i mbjelljes së pambukut duhet të realizohet e të tejkalohet dhe të mos nisemi nga parimi që, duke qenë se gjejmë rezistencë te fshatari, që nuk ka dëshirë ta mbjellë këtë kulturë, t'ua ngarkojmë të tërë sasinë e planifikuar për të mbjellë fermave të shtetit. Me këtë rast dua të theksoj se dhe çështja e fermave duhet të shihet me kujdes. Në Sukth p.sh. kanë mbjellë lule dieili në formën e mbjelljes së grurit, por kjo kërkon shumë krahë pune. Ne, vërtet kemi eksperiencë, po kemi gjithnjë nevojë për të thelluar njohuritë tona. Duhet të dimë se ku mbillet pambuku, në cilat zona. Po kështu duhet vepruar për çdo bimë industriale, për të cilat kërkohen njohuri të mira agroteknike. Fshatari duhet bindur që të mbjellë bimë industriale, aq më tepër që ne i kemi premtuar atij shumë gjëra dhe nuk kemi mundur t'ja plotësojmë të gjitha siç është p.sh. çështja e sigurimit të bukës, e punimit të tokave me traktorë etj. Prandaj, kur premtojmë, duhet të matemi mirë. Pse na shtrohet sot që nuk bëhet orizi në Sarandë e nuk na është thënë më parë? Kjo gjë duhet ditur e studjuar me kohë, me qëllim që t'i dalim së keqes përpara. Edhe çështjen e sigurimit të farërave duhet ta kemi mirë parasysh, ato t'i sigurojmë me kohë dhe t'i zgjedhim. Me rëndësi të madhe është çështja e mbjelljes së fasules dhe e patates, ndërsa përsa i përket misrit mundet ta shkurtojmë ca sipërfaqen e mbjellë me këtë kulturë.

Këtu u propozua që të zhvillohet një mbledhje në KQ me kuadrot e bujqësisë; këtë mund ta bëjmë, po jo në aparatin e KQ. Kjo mbledhje të bëhet në Ministrinë e Bujqësisë, pse kështu kjo do të forcojë më tepër përgjegjësinë e saj. Ne themi që pushteti është levë e Partisë, por kjo nuk vihet si duhet në praktikë, një gjë e tillë dobëson rolin e pushtetit. Po të bëhen mbledhjet për problemet që duhet të zgjidhë pushteti, në Parti, atëhere humbet roli i pushtetit. Organizatat e Partisë të mobilizohen që vendimet e pushtetit të zbatohen, por të gjithë të marrin përgjegjësitë e veta, sepse kështu edhe autoriteti i pushtetit ngrihet, edhe roli drejtues i Partisë gjithashtu, prandaj funksionet që ka pushteti duhet t'i ushtrojë me rigorozitet. Kur është e nevojshme zhvillohen mbledhje edhe në Parti për problemet e pushtetit, por kjo nuk duhet bërë vijë, sepse ndryshe spostohet roli i organeve të pushtetit. Nuk duhet të ndodhë që komiteti i Partisë të marrë kompetencat e komiteteve ekzekutive, sepse kështu paralizohen këto të fundit, por kur paraqitet nevoja në rreth, sekretari i Partisë duhet të shkojë ta ndihmojë aparatin e pushtetit.

Tani s'na mbetet gjë tjetër veçse të bëjmë të gjitha përpjekjet që këtë vendim ta realizojmë. Nga eksperiencia që kemi mund të themi se sivjet puna do të ecë më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR OFICERËVE
PENSIONISTË SHOKËVE RIZA KODHELI
DHE AHMET STARAVECKA ME TË CILËN I
FALENDERON PËR GATISHMËRINË
E SHFAQUR PËR TË LUFTUAR
NË MBROJTJE TË KUFIRIT¹**

26 gusht 1949

**SHOKËVE NËNKOLONEL RIZA KODHELI DHE
KAPITEN AHMET STARAVECKA**

Unë e di se ju, si dhe gjithë luftëtarët trima të Luftës nacional-çlirimtare, që çliruan atdheun nga okupacioni fashist, jeni gati të mbronni kurdoherë pavarësinë e vendit, fitoret e mëdha të Luftës nacional-çlirimtare, punën paqësore të popullit tonë.

Armiku nuk mund të shkelë asnjë pëllëmbë të tokës sonë, pse populli ynë si kurdoherë është vigjilent dhe ushtria jonë trime është në roje të pavarësisë, të paqes e të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

¹ Kjo letër ju dërgua këtyre oficerëve si përgjigje të gatishmërisë së treguar nga ata për të luftuar në mbrojtje të kufive shtetërorë të RPSH gjatë provokacioneve të muajit gusht 1949, të organizuara nga monarko-fashistët grekë, kundër vendit tonë.

Ju falenderoj nga zemra ju dhe shokët e panumërt të luftës, që me letra e telegrame, shfaqin dashurinë e besnikërinë ndaj atdheut, popullit, Partisë sonë, ndaj kauzës së madhe të paqes e demokracisë dhe ndaj Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe Stalinit të madh.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 205 (278), 26 gusht 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 205 (278), 26 gusht 1949

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR POPULLIT TË
PESHKOPISË ME RASTIN E PËRVJETORIT
TË PESTË TË ÇLIRIMIT TË QYTETIT**

31 gusht 1949

POPULLIT TË PESHKOPISË

Me rastin e përvjetorit të pestë të çlirimit tuaj nga hordhitë fashiste dhe tradhëtarët e vendit, ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta dhe urimet më të sinqerta. Populli i Peshkopisë, i shtypur dhe i shfrytëzuar për vite me radhë nga sundimi i klikave gjakpirëse të bajraktarëve, fitoi lirinë e tij dhe doli nga errësira në dritë, sikurse gjithë populli shqiptar, me Luftën heroike nac.-çl. të udhëhequr nga Partia jonë Komuniste. Me gjithë reaksionin e fortë të bajraktarëve të bashkuar me fashistët e nazistët, ju, nën udhëheqjen e shokëve komunistë, në çetat tuaja dhe në batalionin e Dibrës, të komanduar nga biri juaj i shquar e udhëheqësi trim gjeneral-major Haxhi Lleshi, luftuat dhe dhatë kontributin tuaj të vlefshëm në Luftën nac.-çl. Qysh prej çlirimit të Shqipërisë populli i Peshkopisë, ka korrur suksese të mëdha në luftën për ndërtimin e Shqipërisë së re, për zbatimin e politikës së drejtë të Partisë dhe të qeverisë,

duke u mobilizuar i tëri në luftën për ndërtimin e atdheut, për të goditur pa mëshirë mbeturinat e reaksionit të brendshëm e armiqtë e jashtëm dhe veçanërisht kundër armiqve të popullit tonë, grupit të Titos me shokë.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 210 (283), 1 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 210 (283), 1 shtator 1949

**FJALA E MBAJTUR PARA USHTARËVE
TË PLAGOSUR NË PROVOKACIONET E
MONARKO-FASHISTËVE GREKË
KUNDËR RPSH**

2 shtator 1949

Të dashur shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë,

Ju përshëndes dhe ju uroj nga zemra në emër të qeverisë dhe të Partisë sonë për patriotizmin e lartë, që keni treguar duke mbrojtur kufitë e atdheut tonë të dashur nga sulmet e poshtra të monarko-fashistëve grekë. Ju keni kryer detyrën tuaj dhe keni merituar mirënjohjen e popullit tonë, i cili sheh në ushtrinë e tij, mbrojtësen e lavdishme të atdheut, të fitoreve të Luftës nacional-çlirimtare, të ndërtimit të socializmit në vendin tonë dhe të paqes./

Populli ynë ka një dashuri të pakufishme për Ushtrinë Popullore dhe kur ju luftonit kundër provokatorëve monarko-fashistë i gjithë populli ynë i kishte sytë te ju dhe kishte besim të patundur se kufitë tanë të shenjtë nuk do të cënoheshin dhe ashtu ngjau. Monarko-fashistët i kaluan për shumë herë kufitë tanë, por vendosmëria juaj, heroizmi juaj i bëri ata të thyhen me turp dhe të lënë me dhjetëra të vrarë dhe të plagosur

në truallin tonë. Ju në çdo moment stabilizuat gjendjen në kufi dhe e ruajtët këtë si sytë e ballit. Populli ynë mburret me ushtrinë e tij dhe me ju, pjesëtarët heroikë të saj.

Monarko-fashistët dhe padronët e tyre nuk kanë pasur vetëm për qëllim të bënin disa provokacione të vogla, por ata kishin qëllime më të mëdha. Nën pretekste se gjoja ne ndihmojmë ushtrinë demokratike greke në luftën e saj të çlirimit, ata kërkonin të futnin zjarrin e luftës dhe në tokën tonë. Ata i kishin përgatitur planet që më parë, por ua shkatërruat ju. Planet e tyre kriminale dështuan nga qëndrimi juaj heroik. Ju mbrojtët në kufitë tanë të Jugut, jo vetëm atdheun tuaj, jo vetëm jetën, të drejtat e lirinë e popullit tonë, por njëkohësisht ju mbrojtët paqen në Ballkan. Për këtë arsye ju keni merituar dashurinë dhe respektin e botës përparimtare.

Një egërsi e pashembullt tregohet ndaj Shqipërisë së vogël demokratike popullore nga ana e imperialistëve luftëdashës dhe shërbëtorëve të tyre, monarko-fashistëve grekë, trockistëve titistë etj. Provokacione të panumërta dhe shpifje e kërcënime të poshtra po bëhen prej shumë kohësh ndaj vendit tonë, për ta dëmtuar këtë vend paqedashës dhe përparimtar. Por këta kriminelë, nuk kanë mundur dhe nuk do t'ua arrijnë kurrë qëllimeve të tyre, pse populli ynë me heroizëm dhe me gjakftohtësinë më të madhe bën të dështojë çdo përpjekje e tyre. Populli shqiptar lufton me të gjitha forcat për mbrojtjen e paqes dhe nervat e tij i ka të fortë. Populli shqiptar, pjesëtar i vendosur i kampit demokratik antiimperialist, në krye të të cilit qëndron Bash-

kimi Sovjetik, e ndjen veten më të fortë se kurrë, pse lufton për një kauzë të drejtë. Më kot monarko-fashistët, titistët dhe padronët e tyre imperialistë, me të gjithë aparatit e tyre propagandistik, përpiqen ta bëjnë Shqipërinë përgjegjëse për luftën heroike që bën populli grek për çlirim. Më kot këta përpiqen të fshehin veprën e tyre kriminale dhe të mbulojnë disfatat që pësojnë, duke akuzuar një popull të vogël paqësor dhe liridashës. Ju i dini mirë deklaratat e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, që shumë herë ka deklaruar se vendi ynë nuk përzihet në çështjet e brendshme të Greqisë. Ju keni njohur urdhërin e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë sonë, e cila ju porosiste që të ndiqni provokatorët monarko-fashistë nga toka jonë dhe të mos kaloni asnjë pëllëmbë përtej kufirit në tokën greke. Ju këtë urdhër e keni zbatuar me përpikmëri. Por monarko-fashistët e imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre na akuzojnë se ne kemi sulmuar tokën greke. Kuptojeni vetë ju, që keni qenë në kufi, që keni luftuar, që jeni plagosur e vrarë, se sa të poshtira e trilluese janë pretendimet e tyre. Por këta luftëdashës i krijojnë këto gjëra për të arritur qëllimet e tyre të paracaktuara politike dhe ushtarake. Ata dëshpërojnë në planet e tyre ushtarake, pse Shqipëria e vogël dhe ushtria e saj trimë, dinë të luftojnë dhe të mbrohen mirë, kur është çështja për të mbrojtur kufitë, integritetin tokësor dhe lirinë e vendit tonë. Kanë kaluar kohët, kur imperialistët luftëdashës dhe shërbëtorët e tyre mund ta bënin Shqipërinë një shesh lufte dhe pronë të tyre. Gjithashtu dhe manevrat e tyre politike do të dështojnë me turp, pse ato janë me baza

të rrema dhe të shpifura. Populli ynë i vogël, trim dhe paqedashës nuk është vetëm në botë. Ai mbrohet nga Bashkimi i madh Sovjetik, nga udhëheqësi i tij Stalini i madh, nga kampi demokratik antiimperialist si dhe nga gjithë bota përparimtare. Populli shqiptar mbron dhe do të mbrojë kurdoherë me vendosmëri të drejtat e tija dhe me miqtë e dashur dhe të fuqishëm që ka Shqipëria në botë, kurrë nuk do të shkelet, kurrë nuk do të humbasë pavarësinë e saj dhe kurrë nuk do të cënohen interesat e saj jetike.

Armiqtë e vendit tonë sot po bëjnë plot zhurmë, përhapin shpifje dhe gënjeshtër, po bëjnë shantazhe që të na frikësojnë. Ata duhet të dinë se nuk mund t'u arrijnë dot qëllimeve të tyre. Imperialistët kanë vënë në lëvizje të gjithë agjentët e tyre për të krijuar një psikozë lufte ndaj vendit tonë. Agjentët trocistë të Beogradit me Titon në krye, monarko-fashistët grekë, kuislingët dhe kriminelët e luftës të popullit shqiptar, që gjenden në arrati, neofashistët italianë, papa dhe Vatikani, të gjithë kanë hyrë në valle për të kërcënuar Shqipërinë. Imperialistët amerikanë dhe anglezë, që mbajnë në prehrin e tyre kriminelët e luftës me damkë të popullit shqiptar siç janë Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Mustafa Kruja, Ernest Koliqi, Abaz Ermenji, Ali Këlcyra etj. të gjithë kuislingët, fashistë, bashkëpunëtorë dhe agjentë të okupatorit fashist italian, të nazistëve gjermanë, të fashistëve të Metaksait dhe tani në shërbim të imperializmit amerikan dhe anglez, i kanë grumbulluar këta në një komitet¹, që

¹ Komiteti «Shqipëria e Lirë» u krijua me ndihmën e

mund ta quajmë komiteti i banditëve. Populli shqiptar i ka çdo ditë më të qarta qëllimet e imperialistëve amerikanë dhe anglezë kundër vendit tonë si dhe ç'përfaqësojnë në gojën e imperialistëve fjalët «liri e demokraci». Populli shqiptar i njeh mirë këta tradhëtarë dhe kuislingë, që luftuan krah për krah me okupatorët për të shtypur popullin tonë. Këta kuislingë e tradhëtarë gjetën padronë të rinj, që kanë në plan të përsëritin veprën e Hitlerit. Por ky komitet tradhëtarësh do të ketë fatin e tradhëtarëve. Komiteti i tradhëtarëve ka në program të bëjë zhurmë dhe të bashkojë zërin e tij me çakejt e Beogradit dhe të Athinës kundër vendit tonë dhe pushtetit popullor. Imperialistët i kanë vënë për detyrë këtij komiteti që, me zhurmën e tij, t'u japë pak kurajë reaksionarëve të brendshëm të vendit tonë.

Por reaksionarët e brendshëm të vendit tonë, e dinë mirë sa u vlen lëkura dhe njohin mirë forcën e popullit dhe të regjimit popullor. Reaksioni i brendshëm e sheh më realisht fatin e tij, kurse tradhëtarët e jashtëm rrojnë me ëndërra. Tradhëtarët e jashtëm presin nga reaksionarët e brendshëm dhe reaksioni i brendshëm pret nga ndërhyrja e jashtëme. Të dyja shpresat janë të kota dhe të dyja tentativat do të dështojnë me turp. Populli ynë nuk trembet nga këta kalbësira dhe as nuk gënjejhet nga demagogjia e tradhë-

anglo-amerikanëve në Paris nga të arratisurit kriminelë lufteshqiptarë, pas dështimit të planit të parë të imperialistëve kundër vendit tonë në provokacionet e gushtit 1949, por po nga fundi i këtij viti ky komitet famëkeq u shkatërrua.

tarëve të Beogradit, që kërkojnë të fshehin lidhjet e tyre kriminale me monarko-fashistët, me neofashistët italianë, për të dëmtuar demokracinë popullore të Shqipërisë. Më kot trockisti Tito dhe banda e tij lëshon komunikata se gjoja ata janë për pavarësinë e vendit tonë. Ata nuk janë përveçse agjentë të imperializmit, që kanë kërkuar dhe kërkojnë t'i bëjnë varrin vendit tonë; ata janë në bashkëpunim të ngushtë me monarko-fashistët për të copëtuar Shqipërinë dhe ata e kanë bërë Jugosllavinë një qendër spiunazhi dhe diversantësh për të dëmtuar atdheun tonë. Jugosllavia është bërë qendra e banditëve shqiptarë, shokë të Mithat Frashërit, të Abaz Kupit dhe të Seit Kryeziut, tradhëtarë dhe xhelatë të popullit shqiptar dhe të kosovarëve shqiptarë. Lodra e qepur me pe të bardhë e tradhëtarit Tito, nuk gënjen asnjë shqiptar, qoftë ky qytetar i Republikës Popullore të Shqipërisë, qoftë qytetar i Kosovës e Metohisë dhe lidhjet e titistëve me imperialistët anglo-amerikanë janë të qarta. «Fshati që duket, s'do kallauz» — thotë populli ynë. Nacionalistit Tito dhe shokëve të tij, u është çjerrë maska. Me veprimet e tyre agjentët e kralëve të Serbisë dhe gjakatarët e popullit të Kosovës Gani Beg Kryeziu dhe Seit Beg Kryeziu, tani agjentë të Inteligens Servis-it dhe njëkohësisht bashkëpunëtorë të ngushtë të shtypësve të rinj të popullit shqiptar të Kosovës, të klikës së Tito-Rankoviç nuk do të gënjejnë asnjë kosovar shqiptar për fatkeqësitë e reja që përgatit imperializmi dhe agjenti i tyre Tito në kurrizin e shqiptarëve të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës dhe të Metohisë do të dinë t'u bëjnë ballë veprimeve të këtyre agjentëve të rinj të

imperialistëve, që kurdoherë në të kaluarën dhe në të tanishmen po luajnë me fatin dhe me aspiratat e tyre.

Por, shokë të dashur, të gjitha tentativat e armiqve të vendit tonë do të dështojnë, se vendi ynë me të vërtetë është një vend i vogël, por është një kafshatë e pagëlltitshme nga imperialistët dhe shërbëtorët e tyre. Populli ynë qëndron i patrembur, pse është në rrugën e drejtë, ai zhvillon një punë paqësore, ai lufton me këmbëngulje për paqen, por njëkohësisht ai është vigjilent dhe dita-ditës po forcohet. Populli ynë është i pathyeshëm, pse është një pjesëtar i pamposhtur i kampit demokratik, pse ai ka te Bashkimi i madh Sovjetik, te Stalini dhe në gjithë demokracitë e tjera popullore miq të dashur, besnikë të pakufishëm, që e duan dhe e mbrojnë. Populli ynë është i pamposhtur dhe do të rrojë për jetë.

Shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, ju e dini sa e shtrenjtë është jeta e njeriut në demokracitë tona popullore dhe me sa vendosmëri luftohet që jeta e njerëzve tanë të mbrohet dhe të bëhet dita-ditës më e mirë. Por jeta e njeriut në vendin tonë është e lidhur ngushtë me pavarësinë e atdheut, me mbrojtjen e lirive të fituara me gjak dhe me djersë, me ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Kur këto vihen në rrezik nga luftëdashësit, për njerëzit e popullit tonë jeta nuk kursehet. Për mbrojtjen e paqes dhe për mbrojtjen e atdheut tonë, ne jemi kurdoherë gati të luftojmë me abnegacion. Këtë e dinë mirë miqtë tanë dhe kanë besim të pätundur te ne, pse ne kryejmë detyrën më të shenjtë; këtë le ta kenë parasysh edhe armiqtë e popullit tonë.

Unë ju uroj të shërohëni sa më shpejt dhe të ktheheni sa më parë në repartet tuaja, ku ju pret detyra. Për aktet tuaja heroike dhe shërbimet e larta që i keni bërë atdheut, Presidiumi i Kuvendit Popullor, ju ka dekoruar si ju, ashtu dhe shokët tuaj heroikë, që ranë në fushën e nderit për të mbrojtur kufitë e Shqipërisë. Dëshmorët që dhanë jetën në kufi për atdheun tonë, do të mbeten të paharruar në histori. Ata shtojnë vargun e heronjve të popullit tonë, i cili do të ruajë në zemër kujtimin e këtyre bijve heroikë dhe ata do të kujtohen nga brezat e ardhshëm, se në sajë të sakrificave të mëdha të tyre, po ndërtohet socializmi në vendin tonë, po ndërtohet jeta e lirë dhe e qetë për kalamanët tanë. Brezat e ardhshëm me nderim do të kujtojnë vëllezërit dhe prindërit e tyre, që dhanë jetën për t'i siguruar paqen njerëzimit.

Si kurdoherë të jemi të gatshëm të mbrojmë paqen, të mbrojmë popullin, të mbrojmë Republikën tonë Popullore.

Rroftë Ushtria jonë heroike Popullore!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 213 (286), 4 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 213 (286), 4 shtator 1949

TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË HEKURUDHËS KASHAR-ZONA INDUSTRIALE

4 shtator 1949

TË RINJVE NDËRTUES TË HEKURUDHËS KASHAR-ZONA INDUSTRIALE

Mora përshëndetjet dhe lajmin tuaj gazmor për mbarimin me sukses të punimeve të hekurudhës Kashar-Zona industriale. Ju shtuat një fitore të re në vargun e fitoreve të shkëlqyera të rinisë sonë heroike, që ka mbajtur gjithmonë lart flamurin e Partisë sonë, që është treguar gjithmonë e gatshme t'u përgjigjet detyrave të saja me besim dhe me entuziazëm shembullor, si në çlirimin edhe në mbrojtjen e atdheut, si në rindërtimin edhe në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Me plot të drejtë Partia, qeveria dhe populli ynë mburren me rininë e vendit tonë, e cila me hovin dhe entuziazmin e saj revolucionar, me disiplinën dhe me shpirtin e saj të sakrificës, me besimin e saj të pamposhtur në të ardhshmen, ka merituar dashurinë e madhe të tyre. Me mbarimin e hekurudhës Kashar-Zona industriale ju treguat edhe një herë vetitë e

shkëlqyeshme të rinisë sonë heroike dhe patriotizmin tuaj të lartë.

Përshëndetjet e mia më të përzemërta dhe urime për suksese të reja.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 213 (286), 4 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 213 (286), 4 shtator 1949

FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË QYTETIT DHE TË MALËSIVE TË SHKODRËS

15 shtator 1949

I dashur popull i Shkodrës dhe i malësive,

Një gëzim të madh dhe të papërshkrueshëm ndjejmë ne sot, pse gjendemi në mes tuaj, në gjirin e këtij populli heroik e patriot, zemra e të cilit ka rrahur në çdo kohë të historisë sonë për atdheun dhe për lirinë. Më lejoni t'ju transmetoj përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Populli i kësaj krahine, sikundër gjithë populli shqiptar, në historinë e tij shekullore ka vuajtur të zezat e ullirit, ka njohur shtypjen e egër të pushtuesve të huaj dhe ka qenë preja e xhelatëve feudalë e bajraktarë, të cilët, të shitur kurdoherë te i huaji, spekulonin dhe maheshin në kurrizin e popullit tonë. Por në këto male kreshnike nuk depërtonin dot kollaj as armiqtë e popullit as turqit e sulltanit as ushtarët e Franc Josef¹ dhe as bandat e Karagjorgjeviçevë²,

¹ Perandor i Austro-Hungarisë. Ndoqi një politikë ekspansioniste ndaj vendeve ballkanike.

² Dinasti mbretërore në Serbi dhe më vonë në Jugosllavi që ndoqi një politikë thellësisht armiqësore ndaj Shqipërisë.

sepse në këto gërxe luftonin me trimëri nip-stërnipërit e Skënderbeut, të cilët mbronin jetën dhe nderin e tyre me pushkë në dorë, duke ruajtur në shekuj kombësinë, gjuhën dhe zakonet e tyre.

Regjimi gjakpirës i Ahmet Zogut, i mbështetur te feudalët, bajraktarët dhe klerikët e lartë katolikë e muslimanë, sundoi për shumë vjet mbi popullin tonë, të cilin, me anën e armëve, të tradhëtisë dhe të fesë, e vriste, e përçante dhe i pinte gjakun. Ky regjim, që s'ishte veçse vazhdimi i kohëve të errëta të mesjetës, e konsideronte Shqipërinë si një çiflik të tij, nga duhej të nxirrte sa më tepër fitime për veten dhe për rrethin e tij hajdut, e konsideronte si një berr ose lopë, që duhej mjelur dhe më në fund duhej shitur. Zogu dhe klika e tij, për të qëndruar në fuqi, mbështeteshin te bajraktarët e ndryshëm, të cilët zbatonin ndaj popullit metodat më të egra të mesjetës dhe një politikë djallëzore, që s'kishte dallim nga ajo e sulltanëve të Stambollit. Politika e tyre ka qenë: të ripnin popullin, ta mbanin në errësirën më të madhe, pa shkollë dhe pa dituri, ta çonin ku të donin ata, si berri te kasapi, t'i rrëmbenin çdo gjë, deri edhe jetën.

Këto krahina kreshnike mbaheshin të ndara ndër fise dhe bajraqe. Kur mbretit Zog s'i pëlqente një bajraktar, ai ndërrente të tjerët kundër atij dhe në këtë mes intrigat e bajraktarëve dhe të Zogut i paguante populli me gjak. Për Zogun, për feudalët dhe për bajraktarët e tij nuk ekzistonte ndjenja e unitetit të popullit shqiptar. Për këta xhelatë të popullit tonë nuk ekzistonte politikisht një Shqipëri, por ekzistonte një Shqipëri e ndarë në toskë dhe gegë, në muslimanë, or-

todoksë e katolikë, që i vinin në grindje me njëri-tjetrin. Nën regjimin e Ahmet Zogut nuk vihej kurrë në hesap populli, por thuhej «këtu kena Gjon Mark Gjonin», «këtu kena Maliq Begun», «atje kena Abaz Kupin», «atje kena Taf Kaziun», «atje kena Sali Myftiun», «ma tej kena Patër Anton Harapin» dhe kështu me radhë të gjithë feudalët e tradhëtarët e popullit. Në këta mbështetëj regjimi i Zogut për të mbajtur popullin në zgjedhë e robëri dhe për t'ja shitur më në fund të, tërë Italisë fashiste.

Po ata bejlerë, agallarë e bajraktarë që i shërbyen Zogut, u hodhën në prehrin e Musolinit. Pas pushtimit të Shqipërisë, fashizmi italian, i përkrahur nga këta, u mundua edhe në Shkodër, si në gjithë Shqipërinë, të shfrytëzonte vendin tonë, ta kolonizonte atë dhe popullin ta shkombëtarizonte. Por ora e çlirimit të Shqipërisë kishte afruar dhe çlirimi do të bëhej nga vetë populli. Shkodra trime nuk mund të pranonte robërinë, nuk mund të bëhej vegël e fashizmit e t'i nënshtrohej armikut dhe këlyshëve të tij. Kur një pjesë e parisë së Shkodrës me disa klerikë të besimeve të ndryshme dilnin ta prisnin okupatorin për t'i uruar mirëseardhjen, patriotët shkodranë e pritën atë me pushkë të Ura e Bahçellëkut, e cila nuk u kalua pa u ngjyer me gjakun e pushtuesve. Nga Kalaja e Shkodrës dhe Taraboshi krisi pushka e patriotëve, përpjekjet e të cilëve u shtuan vazhdimisht. Do të shkruhen në histori demonstratat e Shkodrës të vitit 1939, 1940 dhe 1941, si dhe lufta e punëtorit Vaso Kadija, që ra heroikisht në parkun e Shkodrës. Epopeja legjendare e Perlat Rexhepit, e Jordan Misjes dhe e Branko Kadisë,

një nga episodet më heroike të Luftës sonë nacional-çlirimtare, ngriti peshë gjithë Shqipërinë dhe i dha zemër e kurajë vegjëlisë, i tregoi popullit se duhej luftuar deri në fund kundër okupatorit dhe se për të shpëtuar popullin dhe atdheun nga robëria, nuk mund të ketë nder më të madh se të sakrifikosh jetën. Këta heronj i lindi populli fukara, i edukoi dhe i drejtoi Partia heroike Komuniste e Shqipërisë, e cila i organizoi dhe i frymëzoi në këto akte sublime me shembullin e anëtarëve të saj trima.

Populli i Shkodrës dhe i malësive, punëtorët trima dhe rinia heroike e kësaj krahine, që kishte besim të patundur te komunistët, të cilët drejtonin lëvizjen sipas udhëzimeve të Partisë, ruajti dhe mbrojti në gjirin e vet luftëtarët e lirisë. Patrioti plak Abaz Bekteshi, kur i vajtën dy komunistë për t'u strehuar në shtëpinë e tij, i priti me bujarinë e shqiptarit dhe, pa marrë parasysh rrezikun e milicëve e të karabinierëve që kishin bllokuar lagjen dhe shtëpinë, ai shkoi në depon e barit, nxori tre mauzerë të vjetër turqie, një arkë me fishekë dhe një shportë me bomba dhe ua dorëzoi shokëve tanë, duke u thënë: «Ishalla nuk ka me na ndodhë ndonji rrezik, por në qoftë se spiunët e fashizmit u kanë diktue tue hy te unë dhe na rrethohet shpia, ju mos mendoni për shpinë time, për gruan dhe fëmijët e mi, flaka le t'i dalë shpisë, veç mos turpnoni Partinë, mos turpnoni vendin dhe Abaz Bekteshin, që ka me luftue bashkë me ju derisa të ketë frymë». Në këtë mënyrë i ka dashur, i ka pritur dhe i ka ruajtur populli i Shkodrës dhe i krahinave luftëtarët e lirisë.

Bajram Curri, që luftoi e ra heroikisht te shpella e Dragobisë legjendare, ishte bërë simbol frymëzimi për luftëtarët e rinj heroikë, që i rriti populli dhe i edukoi Partia të luftonin, të vriteshin dhe të fitonin për popullin.

Në Shkodër u rrit Heroi i Popullit, Qemal Stafa, në Shkodër u rrit Heroi i Popullit, punëtori Vasil Shanto, që ra duke luftuar në buzë të liqenit, të cilin ai e donte aq shumë. Krahinat e këtyre malësive dhe Shkodra janë vendi i Pashko Vasës, Vasil Shantos, Perlat Rexhepit, Manush Alimanit, Jordan Misjes, Branko Kadisë, Ndoc Mazit, Naim Gjylbegut, Esat Gjylit, Fahri Ramadanit, Hajrulla Kastratit, Tom Kolës, Salo Halilit, Bardhok Bibës, i dëshmorëve të Prishtinës dhe i shumë e shumë të tjerëve, që dhanë jetën në fushën e nderit për popullin dhe për atdheun, i dolën për zot vegjëlisë dhe e udhëhoqën atë në luftën më të madhe që ka parë historia e popullit tonë. Ata luftuan me heroizëm kundër fashistëve italianë e gjermanë, kundër OVRA-s dhe Gestapos, kundër terrorit e bandave të Hasan Isufit, të Gjon Marka Gjonit, të Kolë Bibë Mirakës, të Mustafa Krujës e të tjerë kuislingëve dhe dhanë kështu një kontribut të madh në Luftën nacional-çlirimtare të popullit shqiptar.

Populli shqiptar triumfoi, ai u çlirua përgjithmonë dhe s'do të ketë forcë në botë që t'ja prekë pavarësinë dhe lirinë e vet dhe të atdheut të tij. Këto i ka të siguruara, pse nuk ja fali njeri, por i fitoi me gjakun e tij.

Në çdo moment të jetës së vet, populli ynë mendon me dashuri të madhe dhe me mirënjohje të pafund

për Bashkimin e madh Sovjetik dhe për udhëheqësin e tij të lavdishëm, Stalinin e madh. Merita e madhe e Partisë sonë qëndron në faktin se ajo u ndërtua në baza marksiste-leniniste dhe që në ditët e para të jetës së saj i vuri si detyrë të parë vetes t'i bënte të njohur popullit tonë rolin vendimtar të Bashkimit Sovjetik në botë, të krijonte te ai besimin e patundur në fitore.

Popull i Shkodrës dhe i malësive,

Shqipëria jonë e re, që prej çlirimit dhe deri tani, ka bërë hapa shumë të mëdhenj drejt përparimit, drejt një jete më të mirë. Këto përparime, gjatë këtyre pesë vjetëve jetë të lirë në demokracinë tonë popullore, nuk mund të barazohen as me 25 vjet në regjimet e kaluara. Kjo ndodhi sepse populli mori me luftë fatin në duart e tija dhe se duke likuiduar përgjithmonë bazat ekonomike e politike të klasave pasanike, që i pinin gjakun, vendosi regjimin e tij popullor. Partia Komuniste e udhëhoqi popullin në fitoren e plotë mbi pushtuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit dhe sot e udhëheq me sukses në rrugën e socializmit. Unë nuk do të numëroj fitoret e mëdha të popullit tonë në fushën politike, ekonomike dhe sociale, pse këto populli i di, mbasi ka qenë vetë faktori që i realizoi ato. Vetëm një popull me një vullnet të çelniktë dhe me një patriotizëm të shquar, vetëm një popull i udhëhequr nga një parti komuniste marksiste-leniniste, siç është populli ynë dhe Partia e tij, mund të realizojnë me përpjekje, me heroizëm dhe me sakrifica këto që

janë realizuar në vendin tonë. Pengesat, ju i dini, kanë qenë shumë të mëdha, por këto nuk e trembën në asnjë moment as popullin as Partinë e tij.

Mendoni pak ç'mjerim kishte në Shqipëri. Në vendin tonë kishin bërë prenë imperialistët e ndryshëm që në kohën e Luftës së parë botërore, për të mos shkuar më tej. S'mjaftoi kaq. Populli ynë vuajti dhe u roptua gjatë regjimit të katilit Ahmet Zog, që ropi popullin fukara deri në palcë, që shiti çdo pasuri të vendit tonë për të mbushur xhepat e tij dhe të kusarëve që kishte rrotull dhe më në fund tapitë e Shqipërisë ja shiti Musolinit. Mjerim i madh mbretëronte në Shqipëri; kishin të hanin mirë vetëm bejlerët, spiunët, agallarët, funksionarët e lartë të regjimit etj.; kishin të drejtë të merrnin kulturë të lartë vetëm bijtë e fajdexhinjve, të tregëtarëve spekulatorë, që shfrytëzonin popullin pa mëshirë. Okupatorët i vunë kazmën deri në fund vendit tonë dhe ne dolëm nga lufta të djegur e të shkatërruar ekonomikisht dhe si trashëgim i kësaj të kaluarë të tmerrshme, populli pati gërmadha në çdo anë, por ai fitoi gjënë më të shtrenjtë në botë: lirinë dhe pavarësinë, vendosi pushtetin e tij popullor, me të cilin do t'i ndërtonte të gjitha, sikundër po i ndërton.

Nën udhëheqjen e Partisë, punëtori u bë zot i fabrikës dhe i minierës së tij, të cilat i rindërtoi, i zgjeroi, i shumëzoi dhe bëri që të kapërcehet prodhimi i paraluftës. Fshatari doli nga varfëria shekullore, ai u bë zot i tokës dhe hyri në rrugën e zhvillimit të bujqësisë. U hapën me qindra shkolla të reja dhe arësimi e kultura u bënë të masave të gjera të popullit; me

dhjetëra mijë djem e vajza të popullit, të etshëm për arësim dhe kulturë, mbushin shkollat tona. Po mbrohet shëndeti i popullit tonë, spitale dhe ambulanca po shtohen dita-ditës për t'i shërbyer popullit, që lëngonte nga sëmundjet në regjimet e kaluara. U forcua ekonomia, u forcua pushteti ynë popullor, u përmirësua jeta e popullit, u forcua Republika jonë Popullore. Një entuziazëm i papërshkrueshëm, që s'është parë kurrë në historinë e vendit, përfshiu masat e gjera të popullit tonë. Nën udhëheqjen e Partisë së tyre të dashur, rinia, burrat, gratë, punëtorët, fshatarët, intelektualët patriotë u mobilizuan në të katër anët e Shqipërisë dhe me këngë në gojë, herë me barkun plot dhe herë jo, ata ndërtuan hekurudha, rrugë automobilistike, ndërtuan miniera, fabrika, centrale elektrike, shkolla e spitale, porte dhe kanale, ata punuan arat dhe pyllëzuan kodrat, që Shqipëria e tyre të lulëzonte, që jeta e tyre të përmirësohej, siç u përmirësua.

Trockistët jugosllavë u përpoqën ta pengonin këtë hov të papërshkrueshëm të popullit tonë, të grabitnin pasuritë dhe djersën e popullit tonë, ata sabotuan kudo rindërtimin e Shqipërisë dhe na dëmtuan mjaft. Por Shqipëria shpëtoi edhe nga drita që hodhën letrat e KQ të PK të BS drejtuar KQ të PKJ, si dhe nga ndihma që na dha Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin. Kreditë që na ka akorduar Bashkimi Sovjetik, fabrikat që po ngremë, ndihma e çmueshme që na jep ai për të zgjeruar dhe për të shfrytëzuar më tepër minierat tona, traktorët dhe maqinat e ndryshme, që na ka dhënë për zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë, ndihmat në lëmin e kulturës dhe të arësimit që marrim prej tij,

janë një faktor me rëndësi të madhe, që do ta çojnë Shqipërinë përpara. Ndihamat që vendet e demokracisë popullore i japin popullit tonë janë gjithashtu një ndihmë tjetër për ne në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Populli ynë do të dijë t'i përdorë si duhet këto ndihma. Ai do të mobilizohet i tëri për realizimin e planit të shtetit në të gjithë sektorët. Pra, detyra të rëndësishme na vihen përpara të gjithëve, udhëheqësve, punëtorëve, fshatarëve, rinisë heroike, grave, gjithë popullit. Prandaj të mobilizohemi t'i kryejmë me ndërgjegje këto detyra, të vëmë maksimumin e forcave tona fizike dhe mendore në shërbim të atdheut. Të punojmë me ndërgjegje dhe me drejtësinë më të madhe, të prodhojmë sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë dhe çdo gjë të vihet në shërbim të popullit. Të ruhet pasuria e popullit si sytë e ballit, të jemi të gjithë vigjilentë dhe kurdoherë të gatshëm për të goditur pa mëshirë agjentët e armikut dhe sabotatorët, që do të përpiqen të na dëmtojnë në rrugën tonë ndërtimtare.

Ju e dini se jeta fitohet me punë dhe me djersë. Ju e dini se ne kemi akoma shumë mungesa, pengesa e vështirësi përpara, po këto do t'i kapërcejmë, sikurse i kemi kapërcyer. Jeta e begatshme nuk mund të ndërtohet pa lodhje dhe pa sakrifica. Populli ynë s'trembet as nga lodhja as nga sakrificat, pse ai është i sigurtë se punon për veten e tij, për shtëpinë e tij, për të ndërtuar një jetë më të lumtur për kalamanët e tij, për atdheun e tij. Kjo është rruga e socializmit. Kjo është rruga që na mësojnë Lenini dhe Stalini dhe në këtë rrugë s'ka forcë që ta ndalojë popullin tonë.

Zgjedhjet për organet e larta të pushtetit popullor, që u zhvilluan disa muaj më parë, treguan forcën e madhe të Partisë dhe të popullit tonë. Huaja shtetërore tregoi sa i lidhur është populli me Partinë dhe pushtetin e vet. Zbatimi nga ana e popullit i urdhëresave ekonomike që ka lëshuar qeveria, tregojnë lidhjet e shëndosha të tij me pushtetin. Kulakët dhe mbeturinat e feudalëve u përpoqën t'i shtrembëronin këto urdhëresa të drejta të qeverisë, por ata dështuan. Fshatarët dhe malësorët tanë patriotë i kuptuan se këto urdhëresa janë vetëm në dobinë e tyre. Aleanca e punëtorisë dhe e fshatarësisë sonë dita-ditës po forcohet. Kjo është siguria e popullit tonë për të ardhshmen e tij të lumtur.

Në krahinën tuaj, me gjithë përpjekjet e reaksionit, hovi i madh i masave punonjëse të popullit të qytetit dhe të malësive ka qenë i madh dhe dita-ditës po shtohet. Punëtorët heroikë të qytetit të Shkodrës shquhen për punën e tyre të palodhur, të disiplinuar, të organizuar. Fabrikat e tyre mbahen dhe prodhojnë mirë. Punëtorët e Shkodrës janë një nga shtyllat e shëndosha të Partisë dhe të shtetit tonë. Zanatçinjtë e Shkodrës janë mjeshtër të përsosur, prandaj duhet të vlerësohet më shumë puna e tyre. Fshatarët e të gjitha këtyre krahinave punojnë me vullnet dhe do të vijë koha kur pushteti do të marrë masa që tokat e tyre të mos i mbytë më Drini. Malësorët dhe malësoret kreshnike të këtyre krahinave po dalin nga errësira, shkojnë ndër aksione të ndryshme, luftojnë fanatizmin, çojnë bijtë dhe bijat në shkollë.

Njerëzit e këtyre maleve kreshnike janë nga thesarët më të çmueshëm të atdheut tonë. Njeriu i malë-

sive të Shkodrës do të triumfojë mbi jetën, ai dita-ditës do të kuptojë sa e tmerrshme ka qenë jeta e tij nën regjimet e kaluara, nën terrorin e bajraktarëve e të klerikëve reaksionarë dhe sa e lumtur dhe e gëzuar është jeta në Shqipërinë e tij të lirë, në pushtetin e tij popullor. Rinia heroike e Shqipërisë, si kurdoherë, do të jetë në ballë të luftës, në rrugën e Partisë, në rrugën e Qemal Stafës dhe të Manush Alimanit.

E ardhshmja e lumtur e vendit tonë është e siguar, sepse populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë, punon dhe lufton me vetëmohim. Veçanërisht krahinat e Veriut, në një të ardhshme jo shumë të largët, do të jenë objekt i kërkimeve dhe i zbulimeve të pasurive të nëntokës, që do të pasurojnë popullin tonë, që do të përmirësojnë jetën e tij dhe do të sjellin mirëqenjen e përparimin kurdoherë më të madh në këto krahina. Fati i popullit tonë është në duart e vetë popullit. Të ecim, pra, përpara dhe me siguri do të fitojmë, do të ndërtojmë bazat e socializmit.

Dëshiroj tani të them disa fjalë në lidhje me besimet fetare dhe mbi kishën katolike të Shkodrës.

Qëndrimi i Qeverisë së Republikës Popullore ka qenë dhe do të jetë kurdoherë i drejtë dhe i njëllojtë për të gjitha besimet që ekzistojnë në Shqipëri. Ky qëndrim i qeverisë sonë pasqyron dëshirat dhe ndjenjat e popullit duke përfshirë dhe atë pjesë që beson te zoti.

Reaksioni i brendshëm dhe disa klerikë të lartë katolikë dhe muslimanë të Shkodrës kanë qenë kurdoherë të lidhur me armiqtë e jashtëm të popullit tonë, me shkelësit e huaj e regjimet antipopullore dhe kanë

qenë vënë në shërbim të tyre. Këta kanë qenë vegla të turqve, të austro-hungarezëve, të fashistëve italianë, të Vatikanit, të nazistëve gjermanë dhe të imperializmit agresor e luftëdashës amerikano-anglez etj.

Disa klerikë të lartë katolikë të Shkodrës për asnjë çast nuk e kanë ndjerë veten shqiptarë, por si qytetarë të Vatikanit dhe agjentë të tij në Shqipëri. Vatikani, gjatë gjithë historisë së vet shekullore, nën maskën e fesë, ka përfaqësuar reaksionin më të zi dhe ka qenë sunduesi më i egër i popullit. Ai mbronte errësirën, ai sundonte dhe përfaqësonte mesjetën, ai ishte inkuizicioni, ai ishte mbrojtësi i despotëve, i mbretërve, i fashizmit italian, i nazizmit gjerman, ai është edhe sot vegla e imperializmit amerikan, është një nga spekulatorët kapitalistë më të mëdhenj të botës dhe armik i betuar i pavarësisë e i lirisë së atdheut dhe popullit tonë.

Merimanga e zezë e Vatikanit kishte endur pëlhu-rën e vet edhe në një skaj të Shqipërisë, pikërisht këtu në Shkodër. Regjimi i Zogut u kishte lënë dorë të lirë njerëzve të Vatikanit, të cilët kishin krijuar një mbretëri më vete në të ashtuquajturën mbretëri të satrapit Ahmet Zog. Këta klerikë të lartë katolikë të Shkodrës ishin në ujdi të plotë me regjimin e Zogut, pse kishin të njëjtin armik që duhej ta luftonin, popullin shqiptar. Klerikë katolikë popullorë, që e kanë dashur popullin dhe që i kanë shërbyer këtij, siç kanë qenë Dom Ndre Mjeda etj kanë qenë përbuzur, dënuar e persekutuar nga Vatikani dhe agjentët e tij. «Princërit» e kishës katolike në Shqipëri, nën maskën e fesë, me anë të shantazheve, të kërcënimeve me zotin dhe të skandaleve, mbanin nën pre-

sion priftërinjtë popullorë dhe besimtarët, që vuanin nën regjimin e dyfishtë të terrorit kishëtar dhe atij zogollian.

Zogu dhe këta klerikë të lartë të kishës katolike përgatitën ardhjen e fashizmit në Shqipëri. Kur Shqipëria lëngonte nën thundrën e fashizmit gjakatar dhe populli luftonte për t'u çliruar, këta klerikë kryesorë katolikë muarën flamurin e antishqiptarizmit dhe u treguan shumë aktivë në luftën kundër popullit shqiptar. Ata muarën pozita të rëndësishme politike nën fashizmin dhe me egërsinë më të madhe u hodhën në luftë kundër popullit.

Disfata e turpshme e Musolinit i dëshpëroi këta zotërinj me veladon. Por ata s'i humbën shpresat dhe u vunë nën shërbimin direkt të Hitlerit, u bënë regjentë e xhelatë dhe s'lanë gjë pa bërë kundër popullit tonë, derisa i përlau dhe i shpartalloi furtuna revolucionare e Luftës sonë të lavdishme nacional-çlirimtare.

Fitoi revolucioni i madh popullor. Shekuj e shekuj me radhë populli ynë i shtypur, i gjakosur dhe i skllavëruar ëndërronte për një drejtësi të madhe, të cilën e realizoi ai vetë, nëpërmjet luftërave të përgjakshme. Populli ynë i tregoi vetitë e tija të larta, si gjatë luftës ashtu edhe pas çlirimit. Aq sa ai u tregua heroik dhe i pamposhtur në luftë, aq i matur, gjakftohtë e i drejtë, i ashpër dhe i pamëshirshëm për armiqtë e betuar të tij u tregua ai pas çlirimit. Tradhëtarëve të popullit ai u dha dënimin që meritonin.

Partia jonë e lavdishme Komuniste, që ngriti popullin në luftën për çlirim, i bëri këtij thirrje të rrokte armët pa dallim feje për të shpëtuar atdheun. Dhe popu-

lli ju përgjegj me besimin më të madh thirrjes së Partisë. Me mijëra e mijëra nga populli, pa dallim, nëse ishin muslimanë, ortodoksë, katolikë, bektashinj, ata rrokën armët. Ndër ta kishte edhe klerikë të besimeve të ndryshme, bile kryetarë të këtyre besimeve. Disa nga kishat, xhamitë, teqetë dhe manastiret u bënë strehë e luftëtarëve të lirisë, kurse disa klerikë të lartë katolikë u hodhën në anën e kundërt të barrikadës dhe luftuan kundër popullit, kundër besimtarëve katolikë patriotë dhe luftëtarë të shquar.

Qeveria e Republikës sonë, që në ditët e para të jetës së saj, duke pasur për qëllim unitetin e shëndoshë të popullit tonë, u ka dhënë një zgjidhje të drejtë besimeve të ndryshme në Shqipëri. Ajo nuk i ka lejuar vetes të vihet në kundërshtim me ndjenjat e besimit që ka një pjesë e njerëzve. Por çdo individ, ent civil ose fetar, duhet t'u bindet dhe t'u nënshtrohet ligjeve të shtetit, që ka vendosur populli, prandaj kushdo që i shkel ato, vihet në kundërshtim me popullin dhe, pa asnjë përjashtim, ata që shkelin ligjet, dënohen.

Ne kemi qenë dhe do të jemi kundër gjithë atyre klerikëve reaksionarë të çdo besimi qofshin që, nën maskën e fesë, mashtrojnë besimtarët, mbrojnë reaksionin dhe errësirën, luftojnë popullin dhe komplotojnë kundër Republikës. Me këta elementë tradhëtarë, populli dhe qeveria e tij janë në luftë e do të jenë në luftë derisa t'i shfarosin krejtësisht. Ne nuk i kemi përzier kurrë klerikët armiq dhe tradhëtarë me besimtarët, siç bëjnë armiqtë e popullit që, për t'ua arritur qëllimeve të tyre të errëta, kërkojnë t'i përziejnë këto dy gjëra.

Disa klerikë të lartë katolikë të Shkodrës, i kanë

mashtruar paturpësisht dhe në mënyrë kriminale besimtarët përse u përket qëllimeve të mira të Qeverisë së Republikës, me qëllim që të zemëronin popullin e qytetit dhe të malësive të rrethit tuaj me pushtetin e tyre.

Kështu kanë qëndruar çështjet, prandaj le të gjykojë vetë populli, sa i drejtë dhe i durueshëm ka qenë qëndrimi i qeverisë sonë ndaj këtyre klerikëve të lartë katolikë të Shkodrës. Pas çlirimit, populli shqiptar ju vu me heroizëm punës për të ndërtuar atdheun e tij të rrënuar. Mirëpo kleri i lartë katolik i Shkodrës vazhonte në rrugën e tij armiqësore. I ngarkuar nga qeveria, kam thirrur personalisht në Tiranë ish-arqipeshkvin e Shkodrës, zotin Thaçi dhe me mirëkuptim i kam shpërguar qartë pikëpamjet e qeverisë sonë ndaj të gjitha besimeve në Shqipëri. Ky zotni, duke fërkuar duart, siç e kanë zakon, i gjeti të drejta këto pikëpamje dhe premtoi se kisha katolike do të punonte në këtë rrugë. Por këto s'ishin veçse hipokrizi për të na vënë në gjumë. Ai me disa shokë të tij dhe me agjentin e Vatikanit, zotin Negriz, diktator i plotfuqishëm dhe i egër i kishës katolike në Shqipëri, organizoi fshehurazi komplot kundër popullit dhe regjimit të tij. Arqipeshkvi dhe bashkëpunëtori i tij Negriz kujtonin se ne kishim rënë në gjumë të rëndë. Por jo, ne ishim në dijeni mbi të gjithë veprimtarinë e tyre kriminale kundër popullit, por u treguam të durueshëm, me qëllim që t'i shmangnim ata nga kjo rrugë e gabuar. Për dy herë rresht kam thirrur ish-ipeshkvin e Durrësit, zotin Vinçenc Prendushin, të cilit i kam parashtruar përsëri me mirëkuptim pikëpamjet e qeverisë, e kam këshilluar dhe i kam treguar rrugën e drejtë dhe patriotike. Ky zotni, në të dy

herët, duke fërkuar gjithashtu duart, siç e kanë zakon, u shpreh se pajtohej me pikëpamjet e qeverisë dhe se me personalitetin e tij do të ndërhynte që çështjet të shkonin në rrugë të drejtë. Por këto qenë vetëm hipokrizi, pse këshillimet dhe paralajmërimet e qeverisë sonë, nga një vesh u hynin, nga veshi tjetër u delnin, siç thotë populli. Altaret e kishave ata i kishin shndërruar në depo armësh dhe seminarët fetare e kishat në çerdhe konspiratorësh. Qeveria u doli borxhit, por ata e mbushën kupën; këta zotërinj vazhdonin të organizonin komplotet dhe të gënjenin besimtarët duke shtrembëruar qëllimet e mira të qeverisë sonë. U zbulua i gjithë komploti kriminal i tyre, i cili provoi se ata ishin në shërbim të armikut të popullit shqiptar, Vatikanit dhe në lidhje me reaksionin e brendshëm e të jashtëm. Ata kërkonin t'i bënin varrin popullit tonë, por ranë vetë brenda. Masat e drejta që mori drejtësia popullore i aprovoi i gjithë populli, i aprovuan besimtarët patriotë katolikë, i aprovuan klerikët popullorë dhe patriotë katolikë. Por fajet e dënueshme të këtyre klerikëve të lartë në asnjë mënyrë nuk mund t'u ngarkohen edhe të pafajshmëve, atyre që besimin dhe fatin e tyre nuk e kanë lidhur me disa klerikë armiq të popullit që muerën dënimin e merituar.

Qeveria e Republikës edhe pas këtyre ngjarjeve nuk e ka ndryshuar qëndrimin e drejtë të saj ndaj besimtarëve katolikë. Besimtarët katolikë të Shkodrës dhe të malësive, dëshirojnë të ccin në rrugën e drejtë të popullit. Këtë kërkon edhe qeveria jonë. Pjesa katolike e popullit të Shkodrës dhe e malësive dhe pushteti i tyre popullor dëshirojnë që çështja e besimit të mos jetë më

një problem përçarës. Ne kemi bindje se ky vullnet do të realizohet. Qeveria jonë në asnjë mënyrë nuk do të lejojë që Vatikani të ndërhyjë ashtu siç ka ndërhyrë në çështjet e brendshme të kishës katolike të Shqipërisë, duke e bërë këtë një çerdhe spiunazhi në dëm të atdheut tonë. Shteti ynë nuk mund të lejojë që të shkellet Kushtetuta e Republikës dhe ligjet në fuqi, të cilat duhet të respektohen njëlloj nga të gjitha entet fetare.

Por në rrugën e tradhëtisë kundër popullit nuk kanë qenë vetëm disa klerikë të lartë të kishës katolike. Ka pasë të tillë tradhëtarë me damkë, kriminelë lufte dhe armiq të egër të popullit shqiptar edhe në radhët e bile në krye të klerit musliman të Shkodrës, si kriminelët e luftës Sali Myftija dhe Hafëz Ali Tarja, të cilët ishin nga krerët e reaksionit të Shkodrës dhe bashkë me Sulçe Begun, Maliq Bushatin si dhe të tjerë tradhëtarë si Riza Dani, i cili pas çlirimit të vendit tradhëtoi çështjen e popullit, janë përpjekur t'i bëjnë varrin popullit shqiptar dhe të mbajnë kurdoherë gjallë, në interesin e shkelësve të vendit tonë, përçarjen në mes të muslimanëve dhe të katolikëve të Shkodrës. Këta tradhëtarë e kuislingë, që kanë shitur kurdoherë atdheun dhe nderin e Shqipërisë, e kanë pritur me brohoritje fashizmin italian e gjerman dhe janë vënë në shërbimin e tyre të plotë, ata kanë gjakosur popullin, por ky i dërmoi.

Populli i Shkodrës nuk mund t'i harrojë grindjet dhe përçarjet që krijonin klerikët e lartë, katolikë dhe muslimanë që, të bashkuar me feudalët e rrethit të Shkodrës, nxitnin besimtarët katolikë e muslimanë të vriteshin me njëri-tjetrin për interesat e këtyre gjakpi-

rësve. Revolucioni popullor i hapi sytë popullit. Katolikët dhe muslimanët janë vëllezër, bij të mëmës Shqipëri, janë patriotë, ata asgjë s'mund t'i ndajë, përkundrazi çdo gjë i bashkon. Nuk mund të ekzistojë në Republikën tonë Popullore ndarje fetare dhe këtë e provojnë faktet. I gjithë populli i Shkodrës dhe i malësive, qoftë ky katolik, musliman ose ortodoks, është i bashkuar si një trup i vetëm. Kështu ka qenë ai në kohën e luftës, kështu është edhe sot në kohën e rindërtimit të atdheut. Mbarë populli ynë, pa dallim feje, luftoi me vendosmëri për çlirimin e atdheut, ai lufton sot gjithashtu me heroizëm për mbrojtjen dhe ndërtimin e ri të atdheut. Të rinj, burra, gra, pleq po derdhin djersë për ndërtimin e Shqipërisë së re. Me mijëra e me mijëra gra e burra të malësisë e të qytetit shkojnë ndër aksione të ndryshme për realizimin e planit të shtetit dhe janë bërë shembull heroizmi e vetëmohimi. Njerëzit e malësisë, burra me besë dhe kreshnikë, deri dje të mbajtur në errësirë nga feudalët, nga bajraktarët dhe nga klerikët reaksionarë, sot po mësojnë me etje të madhe dhe përparojnë. S'mund të ketë forcë në botë që t'i ndalojë këta të ecin drejt dritës dhe përparimit. Kushtet shoqërore tani kanë ndryshuar dhe kush nuk i ka ato parasysh dhe nuk i çmon si duhet, do të gabojë, pse kohët e vjetra kanë kaluar përgjithmonë dhe s'kthehen kurë më.

Matanë kufive Veriore të atdheut tonë, mbi popujt vëllezër të Jugosllavisë sundon një klikë tradhëtarësh dhe shtypës popujsh, klika e trockistit Tito, që tradhëtoi kampin e socializmit, revolucionin popullor në Jugosllavi, që shkeli gjakun e qindra mijëra jugosllavëve,

të cilët luftuan me heroizëm për çlirimin e atdheut të tyre. Titos dhe shokëve të tij u është çjerrë krejtësisht maska, ata kanë dalë me fytyrën e vërtetë të agjentëve në shërbim të imperialistëve amerikanë dhe anglezë. Titua dhe banda e tij u hodhën zinxhirët e robërisë popujve të Jugosllavisë, ku sot mbretëron terrori dhe vendi është kthyer në një burg popujsh. Partia Komuniste Jugosllave po shndërrohet në një parti të tipit fashist, që tani në fakt luan rolin e një Gestapo-je të dytë nën urdhërat e xhelatit Rankoviç dhe në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e fshehta të spiunazhit amerikan dhe të Inteligens Servis-it anglez. Titua po e shndërron Jugosllavinë në një republikë borgjeze dhe fitoret po ua rrëmben nga duart masave punonjëse të Jugosllavisë dhe ja rikthen borgjezisë tradhëtare jugosllave, kulakëve, serbomëdhenjve. Ai me shokët e tij, tani janë bërë hapët përfaqësuesit e reaksionit jugosllav, mbrojtësit e interesave të kapitalit monopolist amerikan në Jugosllavi.

Të njëjtat metoda propagandistike që përdorte Gëbelsi po përdorin sot edhe Titua, Gjilasi, Kardeli e Rankoviçi kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Imperialistët amerikanë kanë gjetur te kjo klikë shërbëtorë të denjë në interes të tyre.

Titua i hapi dyert kapitalizmit amerikan, i cili po hedh në dorë vendet kyçe ekonomike, strategjike dhe politike të Jugosllavisë. Ai s'është veçse një papagall pa pendë i imperialistëve amerikanë dhe një zbatues i paturpshëm i dëshirave të tyre kriminale e luftëdashëse.

Kampi unik i socializmit në botë dhe veçanërisht populli ynë u janë mirënjohës Partisë Bolshevike dhe

Stalinit të dashur që na ndihmuan për të shpëtuar nga banda e Beogradit, duke ua zbuluar titistëve deri në rrënjë tradhëtinë e tyre. Në kurrizin e popullit tonë ata kanë luajtur aq poshtërsira dhe krime saqë ai është armatosur tani me një eksperiencë të madhe dhe do të dijë t'u bëjë ballë me sukses veprimeve kriminale të titistëve në të ardhshmen dhe të triumfojë në çdo kohë e rast kundër tyre.

Klika e Titos u përpoq me mashtrime, me shantazhe, me kërcënime ta bënte Shqipërinë tonë koloninë e saj, ta vinte atë nën thundrën e vet dhe të imperializmit, ta shfrytëzonte popullin tonë deri në palcë për interesat e veta dhe të borgjezisë kapitaliste jugosllave që ajo përfaqëson. Por Shqipëria i shpëtoi nga dora.

Partia dhe populli ynë qëndruan heroikisht përballë këtyre armiqve të betuar të Shqipërisë. Të gjitha qëllimet djallëzore të Titos dhe të agjentit të tij në Shqipëri, tradhëtarit Koçi Xoxe, u dërmuan. Partia jonë dhe populli shqiptar shpëtuan dhe u forcuan më shumë. «Ndihma ekonomike» e qeverisë jugosllave, s'ka qenë veçse një blufë i madh për të fshehur qëllimet e saj grabitqare e kolonizuese. Kjo «ndihmë» donte të thoshte: «të të jap një dhe të të grabit dhjetë», domethënë të hidhte në dorën e vet të gjitha kyçet ekonomike, politike, ushtarake dhe strategjike të Shqipërisë së re, ta bënte vendin tonë koloninë e Jugosllavisë. Këto ishin qëllimet e Titos. Këto kanë qenë dhe qëllimet e Musolinit, këto janë dhe qëllimet e imperializmit amerikano-anglez mbi Shqipërinë.

Klika e Titos vazhdimisht po provokon me armë në kufitë tanë, po vjell vrer me radiot dhe shtypin e saj,

po shkel të gjitha ligjet ndërkombëtare, shkel çdo ditë traktatin e alcancës, që ekziston në mes të dy popujve tanë. Titua dhe shokët e tij, pas disfatës së turpshme që patën, u përpoqën të gënjenin për t'u arratisur nga Shqipëria disa dhjetëra njerëz, armiq dhe të lehtë nga mendja, për t'i organizuar në Jugosllavi në banda diversantësh dhe për t'i futur pastaj në vendin tonë për të krijuar turbullira. Por edhe këtu ata dështuan me turp. Ju i keni lexuar deklaratat e atyre njerëzve të penduar, që janë rikthyer në atdhe dhe kanë treguar qëllimet e poshtra të titistëve ndaj vendit tonë, si dhe gjendjen e vajtueshme ekonomike dhe terrorin e zi që ekziston në Jugosllavi. Ju e dini fatin që pësuan disa dhjetëra kriminelë luftime dhe banditë ordinerë, që endeshin nëpër malet e Veriut dhe që vepronin nën drejtimin e Rankoviçit për të vrarë disa nga shokët tanë, si bënë me komunistin e shquar Bardhok Bibën. Dhjetëra nga këta kriminelë tradhëtarë u shfarosën nga forcat e mbrojtjes sonë dhe të tjerët që mbetën, të rreckosur e të uritur, në pamundësi për të qëndruar në Shqipëri, u hodhën në panik në tokën jugosllave.

Ju i dini orvatjet e klikës së Titos për çështjen e tharjes së Liqenit të Shkodrës. Kjo s'ishte veçse një pretext për të kallur këmbët përsëri në Shqipëri, kjo ishte manevra e «kalit të Trojës» për «invadimin paqësor» nga këta armiq të tërbuar të Shqipërisë. Dhe Titua e papagallët e tij, pas refuzimit të qeverisë sonë, filluan «të qanin hallin» dhe të lëshonin lot krokodili për «të mjerin popull të Shkodrës që do ta pickonin mushkonjat dhe do të vuante për bukë» etj. As kjo s'e gënjeu popullin e Shkodrës, prandaj megafonet e Beo-

gradit e mbyllën këtë muhabet. Por a i ka hedhur armët Titua? Jo. Ai po i mpreh ato vazhdimisht kundër popullit tonë. Vetëm se hesapet i bën pa hanxhinë dhe hanxhiu në këtë rast është populli shqiptar dhe aleatët e miqtë e tij që e mbrojnë.

Titua s'është veçse një kral i ri në shërbim të borjezisë jugosllave dhe të imperialistëve dhe politika e tij ndaj Shqipërisë s'është veçse ajo e kralëve të Serbisë dhe e të njëjtëve imperialistë. Janë po këta imperialistë që e copëtuan Shqipërinë dhe e kishin bërë monedhë shkëmbimi vite me radhë, që i shkëputën Shqipërisë Kosovën, që kërkonin t'ja jepnin Shkodrën dhe Shqipërinë e Veriut Jugosllavisë së Karagjorgjeviçëve e të Vlladan Gjorgjeviçëve¹, Shqipërinë e Jugut Greqisë, kurse Vlorën e Sazanin Italisë.

Titos i dështoi plani për të rrëmbyer gjithë Shqipërinë. Ai oreksin e ka të madh, por ka edhe qenër të tjerë, që lehin për Shqipërinë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë. Imperializmi amerikano-anglez përpiket t'u ndajë rolet, të vëjë rregull në kasollen e qenve të tij.

Në arrati, jashtë Shqipërisë, ndodhen një numër kriminelësh lufte shqiptarë, tradhëtarë, gjakatarë të popullit tonë, bashkëpunëtorë të fashistëve italianë dhe gjermanë. Ju i njihni kush janë këta dhe s'është nevoja t'jua prezantoj, pse e dini ç'kanë bërë dhe sa u vlen lë-

¹ Shovinist i tërbuar serbomadh. Kryeministër i Serbisë në vitet 1897-1900. Në librin «Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha» që botoi në vitin 1913 u ngrit me tërbim kundër krijimit të shtetit të pavarur shqiptar.

kura. Ne e dimë mirë se sa ishte forca e tyre, bile edhe në kohën kur ata mbroheshin nga ushtritë italiane dhe gjermane. Ushtria Nacional-Çlirimtare i dërmoi këta kriminelë dhe mbrojtësit e tyre. Po ai Abaz Kupi dhe mercenarët e tij ishin ata, që u shpartalluan brenda dy orëve dhe u detyruan të merrnin çoparkat në krahë e të iknin me shpejtësi në Itali, tok me misionet angleze; po ai tradhëtar Mithat Frashër dhe bandat e tija të «Ballit Kombëtar» ishin që u shpartalluan pa nishan dhe ikën me shpejtësi në Itali, tok me misionet angleze; po ai Muharrem Bajraktar, zabit pa asqer, ishte që ndejti dy vjet i fshehur në një shpellë, derisa u largua i lemerisur nga ndjekja e forcave tona, të cilit populli s'i jepte as bukë të hante; po ai Mustafa Krujë xhelati ishte që, në kulmin e fuqisë së tij, lufta e popullit tonë e demaskoi keq dhe padroni i tij, Musolini, u detyrua ta hiqte nga fronti. E kështu me radhë për të gjithë këta tradhëtarë gjakatarë. Këta njerëz s'përfaqësojnë asgjë-kafshë dhe populli i ka qëruar nga rrënjët lakrat me ta. Këtë e dinë mirë edhe ata vetë, këtë e dinë mirë dhe padronët e tyre anglo-amerikanë.

Megjithatë kukullat duhen përdorur, se anglo-amerikanët kot s'i ushqejnë, s'ka gjale edhe nëse këto kukulla shërbejnë për të shkaktuar të qeshura. Anglo-amerikanët s'ja dorëzuan Shqipërisë këta kriminelë lufte në bazë të vendimeve të Potsdamit¹. Imperialistët amerikanë, me këto plehra, që i mbanin në Itali, organizu-

¹ Është fjala për vendimet që u muarën në Konferencën e Potsdamit (17 korrik — 2 gusht 1945) të kryetarëve të qeverive të BRSS, SHBA, Anglisë.

an një komitet¹, i cili që të mos komprometohej Italia, u krijua në Francë. Në këtë komitet ka spiunë të amerikanëve, të anglezëve, të jugosllavëve, të italianëve, të monarko-fashistëve e të Vatikanit. Siç e shihni të gjitha bajraçet përfaqësohen në këtë stan çakejsh e lepujsh; vetëm bajraku i vërtetë i popullit e i Shqipërisë nuk është dhe nuk do të jetë kurrë. Flamurin e Shqipërisë e mban lart populli shqiptar dhe kurrë nuk do ta lërë të përkulet, të njolloset, po do të bëjë të valojë i lirë e krenar në atdheun e tij të lirë, në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Këta spiunë dhe tradhëtarë të popullit, që kurdoherë këtë tregëti kanë bërë me atdheun dhe pavarësinë e tij, janë mbledhur që të lehin. Qentë le të lehin, Shqipëria e re ecën kurdoherë përpara.

Ç'rol luan Titua dhe shokët e tij në këtë mes?

Si ai që ka mizën nën kësulë, për të fshehur manevrën e tij dhe lidhjet që ka me shërbimet e fshehta të imperializmit amerikan dhe anglez, Titua u shpejtua të deklarojë se është «për pavarësinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar», se ai «s'ka lidhje me këtë farë komiteti» etj. dokrra të tilla. Por Titua dhe shokët e tij e bëjnë këtë për të gënjyer sado pak popullin shqiptar dhe shqiptarët e Kosovës. Lodra e Titos është e qepur me pe të bardhë që shihet edhe prej qorrit. Titua dhe Jugosllavia janë epiqendra e kësaj intrige që kurdisin imperialistët kundër Shqipërisë.

Ne jemi në dijeni të mbledhjes së përbashkët që është bërë në Trieste me të deleguarit e Mithat Frashërit

¹ Komiteti «Shqipëria e lirë».

dhe agjentin e monarko-fashistëve Abaz Ermenin, me xhelatin Xhafer Devën, me agjentët e Tito-Rankoviçit, në mes të të cilëve dhe kriminelin e xhelatin e popullit të Kosovës, agjentin e vjetër të kralëve të Serbisë dhe tani agjentin e Inteligens Servis-it dhe të klikës së Titos, Gani Kryeziun. Në këtë mbledhje kanë qenë të pranishëm edhe oficerë të spiunazhit amerikan e anglez. Ujdia ka qenë e plotë në mes këtyre banditëve. Ne jemi në dijeni ç'detyra i ka dhënë Shkupit dhe Prishtinës klika e Titos dhe pse i ruan dhe i ushqen kriminelët e luftës në këto qytete.

Por kush është ky Gani Beg Kryeziu dhe ç'rol po luan ky bastard i popullit shqiptar të Kosovës? Kral Aleksandri, për të shtypur dhe për të gjakosur popullin shqiptar të Kosovës, kishte në shërbim të tij familjen e Kryezinjve, feudalë të Kosovës, që prej Ceno Begut, Gani Begut, Seit Begut etj. Tok me ta vepronin gjithashtu edhe xhelatët e popullit kosovar si Ferhat Dragët, Iljaz Agushët, Xhafer Devët etj. Populli shqiptar i Kosovës i di mirë ç'tmerre ka hequr nga serbomëdhenjtë dhe nga agjentët e tij, si Kryezinjët e të tjerë. Serbomëdhenjtë, Zogu dhe Kryezinjët janë vrasësit e patriotit Bajram Curri. Në okupacionin fashist italian dhe gjerman një pjesë e këtyre spiunëve dhe xhelatëve të popullit shqiptar të Kosovës, hynë në shërbim të italianëve dhe të gjermanëve, të tjerët si Gani dhe Seit Beg Kryeziu ndërruan padron dhe u bënë spiunë të Inteligens Servis-it. Në vitin 1944 Gani dhe Seit Beg Kryeziu, tok me tradhëtarin e trockistin Zai Fundo, ndodheshin në malet e Veriut së bashku me një mision anglez. Qëllimi i kësaj bande ishte të bashkonte bajrak-

tarët kriminelë të Veriut në luftë kundër popullit shqiptar dhe Luftës së tij nacional-çlirimtare. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare i kapi këta banditë dhe i dënoi me vdekje, por ekzekutimi i tyre u pezullua, përveç atij të Zai Fundos, nga ndërhyrja brutale e Titos dhe e shokëve të tij. Titua dhe shokët e tij kërcënuan me prerje marrëdhënesh me ne, në rast se do të pushkatonim Gani Kryezinë. Ata kërkuan me këmbëngulje nga ne që t'u dorëzonim jugosllavëve Gani Begun, kurse Seit Beg Kryezinë t'ua dorëzonim anglezëve, të cilët e dërguan me acroplan në Bari. E gjithë kjo çështje, në dritën e ngjarjeve të mëvonshme, tregon qartë se Titua dhe shokët e tij kanë qenë që me kohë agjentë të Inteligens Servis-it.

Krali Tito, haptas shkon me vendosmëri në rrugën e kral Aleksandrit dhe të Pasiçit, për të copëtuar Shqipërinë dhe për të shfarosur shqiptarët kosovarë. Por ai do të dështojë me siguri në planet e tij imperialiste, pse Shqipëria e re s'është më ajo e vitit 1924, pse populli është në fuqi, prandaj s'është më në mëshirën e imperialistëve; pastaj Shqipëria sot s'është vetëm në këtë botë, por ka aleatë e miq të fuqishëm e të pamposhtur, që mbrojnë lirinë dhe pavarësinë e popujve të vegjël, ajo vetë popujt e Jugosllavisë i ka miq dhe aleatë besnikë.

Armiqtë e atdheut dhe të popullit tonë kurrë nuk do të mundin të realizojnë ëndrrat e tyre. Pavarësia dhe sovraniteti i atdheut tonë janë të siguruar për jetë. Kjo siguri mbështetet në forcën dhe vitalitetin e popullit shqiptar dhe të aleatëve e miqve të tij. Me një popull trim, patriot e të vendosur si populli ynë, me një

parti marksiste-leniniste e heroike, siç është Partia jonë, me një ushtri besnike e të gatshme, siç është Ushtria jonë Popullore, me një rini të lavdishme, si rinia jonë dhe me aleatë e miq besnikë e të fortë, siç janë aleatët e miqtë tanë, është e siguar për jetë pavarësi dhe lumturi e vendit tonë.

Klika Tito-Rankoviç pushkatoi me qindra kosovarë në Kosovë dhe në Ulqin, duke i akuzuar këta si reaktionarë, ndërsa Gani Beg Kryezinë jugosllavët gjoja e dënuan me tre-katër vjet burg, kurse tani ky agjent i anglezëve është agjent i Titos dhe ndërlidhës i tij me komitetin e Mithat Frashërit¹. Rolet janë të ndara në mes të dy vëllezërve Kryezinj. Gani Begu punon në Jugosllavi dhe Seit Begu qëndron në komitetin e tradhëtarëve, që u formua në Paris. Pse janë ndarë kështu këto role? Vetëm për të gënjer dhe për të fshehur lodrën e vërtetë, që është e qartë për të gjithë. Mithat Frashëri dhe shokët e tij kanë marrë në komitetin famëkeq kosovarin Seit Kryeziu, gjoja për t'i treguar popullit tonë dhe kosovarëve se ata janë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Tradhëtarët e dinë mirë se Kosova nuk mundet të bashkohet me Shqipërinë në rrugën e Mithat Frashërit, në rrugën e Titos dhe të imperializmit. As aleati i tyre, krali Tito, nuk do t'ja japë kurrë Kosovën, komitetit të Mithat Frashërit, sepse ai do ta mbajë për vete Kosovën dhe ka bërë me kohë tratativa të fshehta me Calderisin për copëtimin e Shqipërisë, tjetër gjë se ky akord Pijade-Calderis nuk u realizua e nuk do të realizohet dot kurrë. As imperialistët, padronët e komitetit, nuk

¹ Komitetin «Shqipëria e lirë»

do ta çënojnë agjentin e tyre Tito, pse ky ka një vlerë më të madhe për ta, se sa larot e këtij famëkeqi komitet.

Populli shqiptar i njeh mirë këta tradhëtarë e imperialistë dhe nuk gënjehet me këto manevra. Por këta banditë dhe padronët e tyre e kanë hallin në Kosovë. Strategët e kafeneve të Romës, pa popull dhe pa ushtri, përpiqen të rekrutojnë disa mercenarë në Kosovë. Titua Kosovën s'ua jep kurrë, por sipas marrëveshjes, që ka bërë me ta, nën hijen e oficerëve të spiunazhit amerikan dhe anglez, mercenarët mund t'ua japë me gjithë qejf, pse Titua ka një fitim të dyfishtë: të shfarosë shqiptarët e Kosovës në përpjekje me vëllezërit e tyre të Shqipërisë dhe të shmangë ose të shtypë më lehtë shqiptarët e Kosovës. Por këta në luftë, tok me popujt e tjerë të Jugosllavisë, do të fitojnë lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes. Këto janë qëllimet që Seit Beg Kryeziu ndodhet në komitetin e Parisit; ky është qëllimi i klikës së Titos dhe i agjentit të saj Gani Beg Kryeziut; këto janë qëllimet e mbledhjes në Trieste; për këto qëllime Xhafer Deva, kriminel lufte, kërkon të përsëritë manevrën, që bëri kur ishte kuisling i gjermanëve, duke grumbulluar mercenarë në Kosovë.

Në ujdi të plotë me klikën e Titos dhe nën patronazhin e imperializmit amerikano-anglez, monarko-fashistët grekë vite me radhë po provokojnë vendin tonë, po shpifin dhe kërcënojnë.

Në ç'mënyrë monarko-fashistët dhe padronët e tyre mund të shfajësohen për krimet e mëdha që bëjnë kundër një populli të tërë heroik, siç është populli grek? Në ç'mënyrë mund të fshehin disfatat që ata po pësojnë nga lufta heroike e ushtrisë demokratike greke?

Ata e kanë gjetur mënyrën: «Fajin e ka Shqipëria». Për imperialistët dhe monarko-fashistët «lufta e popullit grek po bëhet, pse ekziston Shqipëria», «ushtria demokratike greke fiton, pse e ndihmon Shqipëria». Monarko-fashistët thyhen dhe kryekomandanti i tyre amerikan Van Flit bërtet: «Fajin e ka Shqipëria». Të tilla shpifje dhe shantazhe të poshtra i përngjasin përrallës së ujkut. Jo zotërinj, e përsëritim edhe një herë: Shqipëria kurrë nuk është përzier në punët e brendshme të Greqisë dhe përgjegjës për çka ngjet në Greqi, janë monarko-fashistët dhe padronët e tyre dhe vetëm ata.

Ushtarët shqiptarë kanë urdhër kategorik nga komanda e tyre për të ruajtur me vendosmëri kufirin dhe të mos kalojnë asnjë pëllëmbë në tokën greke. Dhe kështu kanë bërë. Në të kundërtën ka vepruar ushtria monarko-fashiste. Këta kanë sulmuar tokën tonë në dhjetëra raste dhe kanë marrë mësimin e merituar nga ushtarët tanë trima, të cilët kanë mbrojtur me heroizëm atdheun dhe kufitë e tij. Me mijëra gjyle topi të monarko-fashistëve kanë goditur objektiva në tokën tonë, kanë djegur shtëpi dhe kanë vrarë fshatarë që punonin të qetë në arat e tyre. Këto akte kriminale të monarko-fashistëve duhet të marrin fund. Këta dhe padronët e tyre bëjnë shumë zhurmë dhe shpifin për të mbuluar krimet e tmerrshme të tyre. Britmat e tyre hysterike nuk e trembin popullin shqiptar dhe s'ka forcë që të çënojë pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë.

Populli i vogël shqiptar është një popull që e do paqen dhe lufton për të me të gjitha forcat e tija. Të pretendosh, si imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, se Shqipëria e vogël është një vend agresor dhe fajtor për

luftën në Greqi, do të thotë të shpifësh në mes të ditës dhe të tallësh haptas me botën. Por s'ka sot njeri me pak ndjenja njeriu në zemër që t'i gëlltitë këto shpifje. E gjithë bota përparimtare është me Shqipërinë e vogël heroike, është me popullin shqiptar, që punon dhe dërsin për të ndërtuar vendin e tij, jetën e tij në rrugën paqësore.

Imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre përpiqen të pregatitin një luftë të re dhe të gjakosin përsëri njerëzimin. Ata kërkojnë të shpien zjarrin e luftës kudo. Por planet e tyre do të dështojnë. Kampi i paqes, me në krye Bashkimin Sovjetik, është më i fortë se kurrë. Të gjithë popujt përparimtarë të botës: burrat me zemër njeriu, mëmat kudo, e gjithë rinia përparimtare e botës janë kundër luftës grabitqare imperialiste. Luftëdashësit s'e mposhtin dot këtë vullnet të çelniktë të njerëzimit. Luftën nuk e fiton dot bomba atomike, por njerëzit dhe të gjithë njerëzit përparimtarë të botës, përkrah popujve të kampit të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik e Stalini i madh.

Populli shqiptar është i vendosur në rrugën e drejtë të ndërtimit të socializmit. Ai do të mobilizohet i tëri me forca të dhjetëfishuara për realizimin e planit të shtetit dhe si një trup i vetëm rreth Partisë dhe qeverisë të tij, do t'i vërë shpatullat ndërtimit të ri të atdheut të vet, për një jetë më të mirë. Populli shqiptar do të forcojë mbrojtjen e vendit të tij, do të jetë i pamëshirshëm kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe kurdoherë i gatshëm dhe vigjilent për mbrojtjen e kufive të tij, të pavarësisë dhe të integritetit tokësor të atdheut. Me besim të patundur në të ardhshmen e

tij më të mirë, populli shqiptar do të punojë me të gjitha forcat për fuqizimin e atdheut të tij dhe të kampit demokratik antiimperialist, do të shtojë dhe do të çeltnikosë dashurinë e tij të madhe për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për Stalinin.

Përpara, pra, popull i Shkodrës, i malësive dhe i gjithë Shqipërisë, të hidhemi me vendosmëri në punë që të forcohet dhe të lulëzojë Shqipëria jonë e dashur, demokratike, popullore!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli heroik i Shkodrës dhe i malësive!

Rroftë Partia jonë e Punës, udhëheqësja e lavdishme e popullit tonë!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Republika jonë demokratike Popullore!

Rroftë Ushtria jonë e lavdishme Popullore, mbrojtësja vigjilente e atdheut tonë dhe e fitoreve të popullit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 223 (296), 16 shtator 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë me disa shkurtime

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E UNIFIKIMIT TË DY ORGANIZATAVE TË RINISË

16 shtator 1949

Të dashur shokë e shoqe, delegatë të rinisë sonë heroike,

Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të nxeha dhe më të përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë sonë të Punës, të Qeverisë së Republikës Popullore dhe të miat personale.

Ju keni mbledhur kongresin tuaj në qytetin historik dhe kreshnik të Shkodrës, në qytetin ku mësoi dhe filloi aktivitetin e tij revolucionar udhëheqësi juaj, shoku ynë i dashur, Qemal Stafa, në qytetin ku luftuan si trima legjendarë Perlati me shokë, në qytetin e qindra dëshmorëve të rinisë si Manush Alimani, Ndoc Mazi, Esat Gjyli etj.

Kongresi juaj, shokë, është mbledhur të kryejë veçanërisht një detyrë të madhe, atë të unifikimit të Rinisë Komuniste dhe të Rinisë Popullore në një organizatë të vetme, e cila të përmbledhë në gjirin e saj të gjithë të rinjtë e të rejat patriotë që, nën udhëheqjen, kujdesin e ndihmën e vazhdueshme të Partisë, do të

vazhdojë me hov të ri luftën që ka zhvilluar rinia deri më sot me aq heroizëm.

Sot Partia, populli dhe miqtë e Republikës sonë Popullore, përshëndesin rininë dhe gëzohen për sukseset e saj. Rruga e rinisë është me të vërtetë një faqe e lavdishme e historisë së popullit tonë.

8 vjet më parë, i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë, asistova në Konferencën e parë të Rinisë Komuniste. Ishte hapi i parë drejt organizimit të rinisë, e cila, e udhëhequr nga Partia, e ndritur nga shembulli i komsomolit heroik, do të që e aftë për vepra të mëdha e akte heroizmi.

Unë kam ndjekur çdo përparim tuajin, kam asistuar në kongreset tuaja e kam konstatuar se jeni paraqitur gjithmonë me suksese të reja, se gjithmonë me entuziazëm, besim e vendosmëri jeni angazhuar në rrugën e re, në detyrat e reja, që ju ka ngarkuar Partia dhe atdheu. Kam bindjen se ky kongres do të jetë një provë e re.

Partia dhe populli ynë ndjekin me admirim dhe besim hapat e mëdhenj që bën rinia dhe gëzohen e mburren se kanë një rini të artë, zemra, mendja e fuqia e së cilës është e vënë pa rezerva në shërbim të atdheut e të luftës së popullit tonë, për sigurimin e zhvillimin e fitoreve të Luftës nacional-çlirimtare, për ndërtimin e socializmit dhe triumfin e kauzës së demokracisë dhe paqes në botë.

Lufta e rinisë sonë dhe sukseset e saj janë dëgjuar dhe nga miqtë e popullit tonë, nga popujt e rinia e Bashkimit Sovjetik, të demokracive popullore dhe nga masat progresiste në botë. Dhe ata përshëndesin dhe gë-

zohen për sukseset tuaja. Është një nder dhe ndihmë e madhe për rininë e vendit tonë që ka ardhur t'ju përshëndesë dhe të ndihmojë kongresin tuaj delegacioni i komsomolit heroik të Bashkimit Sovjetik.

Mësimet që rinia jonë dhe rinia përparimtare e të gjithë botës merr nga rinia leniniste-staliniane, nga rinia që ka edukuar Partia Bolshevike, nga rinia që doli e kurorëzuar me aq lavdi nga lufta kundër fashizmit për mbrojtjen e atdheut të vet dhe të mbarë njerëzimit, nga rinia që ndërtoi socializmin dhe po ndërton sot komunizmin, janë fanari, që i ndriçon rrugën rinisë sonë, që e armatosin atë me entuziazëm, besim e dije të re.

Në kongresin tuaj marrin pjesë delegatë nga rininë e demokracive popullore dhe të rinive të tjera përparimtare, për të shprehur miqësinë dhe solidaritetin me rininë e popullit tonë.

Prezenca e Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës Botërore të Rinisë, nderon kongresin tuaj dhe dëshmon se rinia jonë e kryen me nder detyrën, që i përket në radhët e organizatës së madhe e të fuqishme të të rinjve, në Federatën Botërore të Rinisë, që lufton me vendosmëri për të siguruar paqen në botë e një jetë e të ardhshme të lumtur për rininë.

Gjatë luftës ishte rinia ajo që ndjeu shpejt thirrjen e Partisë për luftën kundër okupatorëve fashistë dhe për çlirimin e atdheut e të popullit, ajo jo vetëm braktisi vendin e punës, bankën e shkollës, arën e bagëtinë, por u tregua e gatshme deri në sakrificën supreme, të dhurojë jetën e saj të re.

Rinia luftoi me aq heroizëm, se kishte besim në

udhëheqjen e fjalën e Partisë. Rinia Komuniste ushqe me gjakun dhe energjinë e saj Partinë tonë të re. Rinia u bë një mbështetje e fuqishme e luftës që udhëhiqte Partia jonë. Prandaj, populli ynë i këndon lavdinë rinisë së tij heroike. Populli dhe rinia jonë nuk e harrojnë kurrë se ajo që i dha fuqi luftës sonë dhe që ndihmoi në sigurimin e lirisë, pavarësisë e demokracisë për atdheun tonë, ishte lufta që popujt dhe ushtria famëmadhe e Bashkimit Sovjetik, e udhëhequr nga gjenia e Stalinit, bënë kundër agresorëve barbarë fashistë, është mbrojtja dhe ndihma e paçmueshme që popujt sovjetikë, Partia e lavdishme Bolshevike dhe mbrojtësi dhe miku i shtrenjtë i popullit tonë, Stalini i madh, nuk ua kanë kursyer kurrë vendit dhe popullit tonë. Prandaj, rinia jonë, ashtu si gjithë populli ynë, ushqen një dashuri të pakufishme për vendin e socializmit, Partinë Bolshevike dhe mësuesin e adhuruar të masave punonjëse të të gjithë botës, shokun Stalin, prandaj ajo e ruan dhe e forcon atë si gjënë më të shtrenjtë.

Në luftën e re për ndërtimin e Shqipërisë së re, prapë është rinia ajo, që në radhë të parë i është përgjegjur gjithmonë thirrjes së Partisë dhe kurdoherë është dalluar për entuziazmin, vendosmërinë dhe sakrificat në punë. Rinia është bërë një rezervë e çmueshme për Partinë tonë dhe si dje në luftë, ashtu dhe sot, ajo ushqen me forca të reja Partinë tonë, forcon radhët e saja dhe vë në shërbim të Partisë shpirtin e saj luftarak e revolucionar. Rinia e ka kuptuar se fitoret e popullit duhet të ruhen, të zhvillohen e të forcohen, rinia ka kuptuar se në këtë rrugë populli ynë ka armiq, që kërkojnë të pengojnë veprën ndërtimtare dhe të prishin

jetën paqësore të popullit tonë. Rinia e ka kuptuar se për të ndërtuar të renë, për të ecur përpara, duhen kapërcyer pengesa e duhen luftuar vështirësitë. Por ajo ashtu si dje, në luftën e saj kundër vështirësive, kundër armiqve, në luftën për ndërtimin e jetës së re, frymëzohet nga shembulli plot vetëmohim në rrugën tridhjetë e ca vjeçare të popujve sovjetikë dhe të komsomolit heroik.

Rinia jonë është e pajisur me një vitalitet dhe shpirt revolucionar të lartë e konsekuent. Ajo nuk u deh nga fitoret e saja, nuk lidhi duart para sukseseve, por me hov e heroizëm të ri, me entuziazmin e vetëmohimin që e karakterizon, rinia jonë vazhdon luftën në frontin e punës e të arësimit.

Dhe kudo që ajo është angazhuar ka fituar dhe ka treguar se është e denjë për besimin dhe dashurinë e popullit dhe të Partisë.

Aksionet për realizimin e objekteve të rëndësishme të planit të shtetit, në të cilat është angazhuar rinia, janë bërë simbol i kësaj vendosmërie të rinisë sonë. Të rinjtë e të rejtat e qyteteve, të fshatrave e të malësive tona, jo vetëm kanë vënë të gjitha fuqitë e tyre që të realizojnë angazhimin, por në këto aksione kanë treguar e zhvilluar cilësitë e tyre prej organizatori dhe i kanë kthyer këto qendra pune në qendra ku rritet e zhvillohet dashuria e ndërgjegjja për punën, ku forcohet bashkimi i rinisë së krahinave të ndryshme, ku dalin në dritë ndjenjat e larta të patriotizmit të rinisë sonë, dalin kuadro, që plotësojnë nevojat e shumta të planit të shtetit.

Prezenca në këtë kongres e shumë punëtorëve të

rinj, që mbajnë medaljet e punës dhe titujt e sulmuesit, dëshmojnë se rinia është në radhët e para të klasës punëtore për realizimin e planeve ekonomike të shtetit në qendrat e prodhimit. Rezultatet në shkollat e Republikës sonë çdo vit po përmirësohen në saje të përpjekjeve të rinisë sonë. Në saje të pjesëmarrjes dhe të bashkëpunimit të rinisë u arrit që shkollat tona të vihen në baza të reja. Të rinjtë që qeveria jonë i ka dërguar për studime në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera mike të demokracive popullore, përgjithësisht kanë marrë nota të shkëlqyera e kanë treguar se ndërgjegjja e tyre është në lartësinë e nevojave që ka atdheu ynë për kuadro të kualifikuar dhe se rezultatet e tyre në mësim janë një shprehje e patriotizmit të lartë, që ushqejnë zemrën e mendjen e tyre.

Në të gjitha manifestimet e festivalet kulturele, artistike e sportive, që ka organizuar rinia jonë, ka treguar se ajo ka dëshirë të madhe e dashuri për kulturën, artin, sportin dhe ka nxjerrë talente të reja, që ndihmojnë zhvillimin e kulturës e të artit në vendin tonë.

Ju, përfaqësuesit e kësaj rinie, keni ardhur në këtë kongres për të dëshmuar sukseset, punën, heroizmat e të rinjve dhe të të rejave tona, qofshin këto në shkolla, fabrika e fshatra. Por ne kemi bindjen që ju keni ardhur të tregoni dhe se rinia jonë është e vendosur të vazhdojë në këtë rrugë të lavdishme dhe të kurorëzojë organizatën e saj me suksese të reja jo më pak të shkëlqyera se ato të deritanishmet.

Kongresi juaj do të jetë një faktor i rëndësishëm për mobilizimin e gjerë të rinisë në aktivitetin politik,

ekonomik, kultural e social që zhvillohet në vendin tonë. Kongresi juaj do të hedhë dritë të re në rrugën e detyrave që ka përpara rinia jonë. Me ndihmën e Komitetit Qendror e të të gjithë Partisë si dhe duke mësuar nga puna e ndritur e komsomolit, kongresi juaj dhe udhëheqja, që ju do të zgjidhni, do të shtojnë fuqinë organizative dhe mobilizuese të organizatës suaj të unifikuar.

Pak kohë më parë, Komiteti Qendror i Partisë sonë, në një vendim të posaçëm për rininë¹, ka përcaktuar detyrat. Këtë vendim duhet ta keni parasysh dhe në bazë të tij dhe të referateve që drejtuesit tuaj do t'ju parashtrorjnë, diskutoni dhe vendosni për problemet dhe detyrat e rinisë.

Më lejoni t'ju këshilloj se ajo që do të garantojë një sukses të plotë të kongresit dhe që efektet e saj të jenë të ndjeshme në punën tuaj në të ardhshmen, është që ky kongres të bëhet një tribunë, ku të parashtrorhet eksperiencia e gjallë e punës së rinisë. Të ngrihet zëri juaj, të tregoni se si keni punuar në fshat a qytet, në fabrikë a shkollë, ç'forma pune u kanë ndihmuar në arritjen e këtyre rezultateve, si duhet ta ngrini e ta forconi organizatën tuaj, ç'duhet t'i jepni e ç'duhet t'ju japë ajo juve.

Ky kongres duhet të rritë forcën organizative të organizatës suaj, që ajo të mundë t'i përgjigjet gatishmërisë së rinisë, aspiratave të saja dhe nevojave, që ka

¹ Është fjala për «Rezolutën e Komitetit Qendror të PPSH për punën me rininë» që u aprovua në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 9 qershor 1949.

Republika, populli dhe Partia për punën e rinisë sonë të palodhur.

Dua të tërheq veçanërisht vëmendjen e kongresit që të marrë vendime efektive për forcimin e punës së organizatës së rinisë në fshat. Atje kemi një masë të gjerë të rinjsh, që janë një mbështetje e madhe për punën e Partisë dhe të pushtetit popullor, janë një forcë që është e lidhur me të ardhshmen, që don të ecë përpara, që e don jetën e re dhe shumë herë e shumë mirë e ka treguar se si lufton për të. Ne duam t'ja ndërrojmë faqen fshatit, të modernizojmë bujqësinë, të zhdukim nga fshati injorancën, prapambetjen dhe paragjykimet. Kush e kupton më mirë këtë luftë? Pa dyshim i riu. I riu duhet të jetë në ballë e organizata e rinisë duhet ta ndihmojë që të jetë në ballë të kësaj lufte për ndërtimin e jetës së re. Ndërtimi i bazave të socializmit është i lidhur shumë ngushtë me këtë detyrë. Kantieret, minierat, fabrikat, kombinatet kanë nevojë dhe tërheqin në gjirin e tyre kryesisht këtë rini. Me i ndihmue këta të rinj për t'u ngritur në shkallën e teknikës së prodhimit dhe me e drejtue e zotëruc atë, me i edukue të punojnë me ndërgjegjen dhe vetëmohimin, që duhet të karakterizojë klasën avangarde të ndërtimit të socializmit, është një detyrë me rëndësi, që duhet t'i kushtoni një kujdes të veçantë.

Kongresi do të caktojë detyrat, që u përkasin të rinjve dhe s'ka dyshim që të rinjtë e vendit tonë do t'i kryejnë me nder. Por kongresi, shokë të rinj, duhet të diskutojë e të vendosë dhe ç'duhet t'u japë të rinjve organizata juaj. Në botën e të riut ziejnë një tok aspiratash për të ardhshmen e tij, të atdheut të tij, të popullit dhe

për të ardhshmen e njerëzimit. Të gjitha këto aspirata mund dhe duhet të harmonizohen në mënyrë të përsosur në aktivitetin e organizatës së rinisë. Është e nevojshme që organizata e rinisë dhe udhëheqja e saj të luftojnë disa neglizhenca dhe sektarizma në këtë drejtim. Duhet të adaptohen e të organizohen forma të tilla pune që rinia jonë të zhvillojë talentet individuale, të rinjtë duhet të ndihmohen në këtë drejtim. Përveç kësaj rinia ka nevojë dhe ka të drejtë të dëfrojë më shumë. Organizata e rinisë duhet të organizojë dëfrimin e rinisë. Rinia jonë duhet të gëzojë, zemra e saj e re të mos jetë kurrë e rënduar dhe e pezmatuar. Rinia jonë mëson, punon pa u lodhur; dëfrimi i organizuar, nuk do të jetë kurrë i dëmshëm. Ai bëhet i dëmshëm, kur iniciativat në këtë drejtim janë jashtë e larg kontrollit e ndihmës së organizatës së rinisë.

Të dashur shokë të rinisë,

Kongresi dhe gjithë rinia duhet të kenë parasysh se lufta e popullit tonë dhe e miqve tanë për të ndër-tuar, bëhet në një kohë kur imperialistët amerikanë dhe ortakët e tyre përgatitin plane të shkatërrojnë çdo gjë.

U përpoqën imperialistët amerikano-anglezë të futin këmbët në tokën tonë me maskën e «aleatit» dhe kur s'u ndezi dredhia, filluan presionet, kërcënimet, shantazhet, organizimin e agjenturave etj. I mbajti shpresa shumë se do ta futnin në dorë vendin tonë me anën e agjentëve të tyre, klikës nacionaliste kolonizatore të Titos, por edhe kjo shpresë u dogj. Kurdisin

provokacione në kufitë tanë dhe tentojnë të prekin sovranitetin dhe integritetin tokësor të vendit tonë. Por të gjitha këto dështojnë, dështojnë me turp, pse populli, me në krye Partinë dhe qeverinë, vigjilon mbi fitoret e Luftës nacional-çlirimtare, pse ushtria mban lart amanetin e shokëve tanë që ranë në fushën e nderit, mban lart flamurin e lirisë e të pavarësisë që i ka besuar populli; dështojnë pse në Shqipëri rritet dhe lufton një rini si kjo e jona. Planet e tyre dështojnë se ne jemi pjesëtarë të një familjeje të madhe e të fuqishme demokratike që udhëhiqet nga Stalini i madh.

Shokë e shoqe,

Është e nevojshme që organizata e rinisë të gjithë aktivitetin e saj ta lidhë me luftën që bën populli ynë për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë dhe me luftën, që bëjnë gjithë masat punonjëse progresiste në botë, me Bashkimin Sovjetik në krye, për paqen, demokracinë e sigurinë e popujve. Ajo duhet të forcojë solidaritetin e riniqë sonë me rininë përparimdashëse e demokratike të vendeve të tjera e të zhvillojë aktivitetin e saj për paqen e demokracinë në gjirin e Federatës Botërore të Rinisë, ashtu siç e mëson Partia, ashtu siç punon e lufton rinia e Bashkimit të madh Sovjetik.

Imperialistët hartojnë plane provokimesh dhe kurdisin maqinën e shtypit e të propagandës së tyre të fëlliqur e luftëdashëse kundër vendit tonë. Populli ynë dhe bashkë me të, gjithë opinioni botëror demokratik paqedashës, i dënnon ato me indinjatë e neveri dhe i de-

noncon si akte që kërcënojnë paqen e sigurinë në botë. Kongresi juaj duhet t'i denoncojë këto akte agresioni të imperialistëve dhe organizata e rinisë të zhvillojë në masat e rinisë vigjilencën revolucionare dhe t'i edukojë ato të punojnë e të luftojnë për sigurimin e paqes.

Në rrugën e luftës së popullit tonë dhe të popujve të Bashkimit Sovjetik si dhe të demokracive popullore kundër qëllimeve të imperialistëve, dolën në shesh armiq të rinj, tradhëtarët e Beogradit të kryesuar nga Tito, armiq të betuar të Bashkimit Sovjetik e të popullit tonë. Ata u munduan t'i hedhin lakun tradhëtisht vendit tonë, u munduan të mbytin entuziazmin e rinisë sonë, u munduan të na shkëputin nga udha e marksizëm-leninizmit e mësimet e Partisë Bolshevike, por puna e tyre kriminale dhe agjentura e tyre trockiste me tradhëtarin Koçi Xoxe në krye, haste në rezistencën e Partisë, të Komitetit Qendror dhe në vullnetin e përkulur të popullit e të rinisë sonë, në ndjenjat e larta të patriotizmit e të internacionalizmit, në dashurinë e madhe për Bashkimin Sovjetik e Stalinin e madh që ushqen populli dhe rinia jonë. Dhe kur Partia Bolshevike e shoku Stalin dhe Byroja Informativ e Partive Komuniste e Punëtore hodhën dritë mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave dhe zbuluan tradhëtinë e klikës së Titos, mina, që kriminelët titistë po vinin në gjirin e Partisë dhe në themelet e Republikës sonë, u plasi në dorë. Maska që mbulonte fytyrën e këtyre agjentëve të ndyrë e kriminelë në shërbim të imperialistëve amerikanë e kompani u gris dhe ata po përdorin të gjitha mjetet që të luftojnë Bashkimin Sovjetik, demokracitë popullore e kampin unik të socializmit. Titua

e klika e tij mundohen të ngjallin në popujt e rininë e Jugosllavisë urrejtjen për Bashkimin Sovjetik e demokracitë popullore. Por popujt e Jugosllavisë dhe rinia e saj, nuk mund të shkelin mbi gjakun e mijëra dëshmorëve të Ushtrisë Sovjetike, që dhanë jetën për çlirimin e Jugosllavisë, nuk mund të shkelin mbi gjakun e mijëra bijve të tyre patriotë dhe internacionalistë, që dhanë jetën për të ndërtuar një Jugosllavi të re socialiste, të vëllazëruar me popujt e demokracive popullore dhe e radhitur në kampin demokratik antiimperialist. Do të vijë dita që popujt dhe rinia e Jugosllavisë do të ndërtojnë partinë e tyre komuniste internacionaliste në rrugën e marksizëm-leninizmit dhe Republika Popullore Federative e Jugosllavisë do të kthehet në rrugën marksiste-leninistë të socializmit.

Kongresi juaj do të jetë një manifestim i gjallë i miqësisë dhe i dashurisë që ushqen populli ynë për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin. Kongresi, pa dyshim, do t'i shtrojë rinisë si një detyrë të dorës së parë që këtë miqësi, dashuri e mirënjohje ta forcojë çdo ditë e më shumë.

Shokë e shoqe të rinisë,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës dhe nga ana ime, ju urojmë punë të mbarë e sukses të plotë në kongresin tuaj për unifikimin e organizatës së Rinisë heroike Komuniste dhe të Rinisë Popullore.

Le të ushtojë, shokë e shoqe të rinisë, zëri i kon-

gresit tuaj në të gjitha anët e Shqipërisë e le të mobilizojë rininë e vendit tonë për ndërtimin e bazave të socializmit, në realizimin e planit dyvjeçar, për ta bërë vendin tonë më të fortë, më të begatshëm e më të përparuar.

Rroftë rinia heroike e Shqipërisë dhe Kongresi i unifikimit të organizatave të saja!

Rroftë lufta e rinisë demokratike të të gjithë botës, me në krye komsomolin heroik, për ndërtimin e një jete të re e për mbrojtjen e paqes e të demokracisë në botë!

Lavdi popullit tonë dhe Partisë së tij, që e udhëheq në rrugën e socializmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 224 (297), 17 shtator 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË RRETHIT TË MIRDITËS DHE PUNËTORËVE TË MINIERËS SË RUBIKUT

18 shtator 1949

Popull i dashur i Mirditës dhe shokë punëtorë të Rubikut,

Më ka çue Partia dhe qeveria që t'i sjell përshëndetjet më të përzemërta popullit trim të Mirditës dhe punëtorëve të palodhur të minierës së Rubikut. Për mua dhe për shokët e Partisë dhe të qeverisë është një gëzim i madh që ndodhemi në gjirin tuaj, në gjirin e popullit të Mirditës kreshnike, që ka vuajtur tërë jetën nën zgjedhën e okupatorëve të huaj dhe nën zgjedhën e bajraktarëve. Populli i Mirditës si dhe gjithë populli shqiptar shekuj me radhë ka qenë preja e turqve, e austro-hungarezëve, e italianëve, e gjermanëve, të cilët kishin në shërbimin e tyre të gjithë feudalët, të gjithë pasanikët, të gjithë bajraktarët dhe disa klerikë tradhëtarë dhe me këta e shtypnin popullin, i pinin gjakun popullit, i rrëmbenin çdo gjë që kishte. Mirëpo populli shqiptar gjatë historisë së tij ka luftuar për t'u çliruar nga i huaji dhe nga shushunjat, që i pinin gjakun. Popu-

lli shqiptar donte të jetonte i lirë, të ishte zot i jetës së tij, i tokës së tij, i vetes së tij. Këto kanë qenë për shekuj dëshirat e popullit tonë dhe për t'i arritur këto qëllime, populli ynë gjatë historisë së tij shekullore ka luftuar me heroizëm kundër këtyre shkelësve dhe kundër atyre, që ishin lidhur me shkelësit, me armiqtë e popullit tonë.

Pasi foli për luftërat heroike të popullit tonë me në krye prijësin legjendar Gjergj Kastriotin, Skënderbeun kundër hordhive të sulltanëve dhe për luftërat e paprera të popullit tonë kundër bajraktarëve, mbretërve e feudalëve të ndryshëm shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në kohë jo shumë të largëta populli ynë dhe i të gjithë botës ishin në rrezik të madh që të shfaroseshin nga ushtritë e Musolinit dhe të Hitlerit, të cilat okupuan vendin tonë dhe kërkonin ta zhduknin popullin tonë. Shqipëria u okupua nga Italia dhe italianët erdhën këtu me ndihmën e tradhëtarëve të popullit tonë. Një nga ata tradhëtarë ka qenë Gjon Marka Gjoni, tradhëtar tërë jetën e tij. Familja e tij ka qenë e shitur te të huajt e në shërbim të tyre për të shtypur popullin fukara, për të pirë gjakun e popullit. Gjon Marka Gjoni, Mustafa Kruja, Abaz Kupi, Mithat Frashëri e shumë të tjerë ishin shërbëtorët e Italisë, ata përgatitën rrugën për ardhjen e Italisë këtu që të kolonizonte Shqipërinë dhe ta ripte popullin shqiptar. Mirëpo populli shqiptar nuk u përkul. Ai rroku armët, doli malit dhe luftoi. Ata hajdutë, ata bajraktarë, që i shërbenin Musolinit u tallën me popullin dhe thoshin: «Ç'janë këta që janë ngritur me armë? Ata do ta mundin Italinë, që ka topa, aeroplana e tankse?»

Po. Ky popull, ju e mundët Italinë, e mundët Gjon Marka Gjonin, Mustafa Krujën dhe të tjerë. Kullat e Gjon Marka Gjonit, që nuk i kishte djegur as sulltani as Italia as Gjermania, ato që ishin bërë fortesë e lyer me gjakun e popullit, i shkatërroi ushtria e popullit, bijtë e popullit fukara, djemtë e popullit të vuajtur, djemtë tuaj. Ato kulla përfaqësonin për popullin e Mirditës mjerimin e madh, tmerret, që kishte hequr populli nga ajo familje. Por populli i shkatërroi nga themelitet dhe kurrë nuk do të ngrihen ato, kurrë dera e Gjon Marka Gjonit nuk do ta shohë më Shqipërinë. Ata do të vdesin atje në arrati, do të vdesin si ata spiunët, këlyshët, duke lëpirë koskat që u hedh armiku, aty do të lënë edhe eshtrat e tyre.

Duke folur për Partinë, e cila udhëhoqi popullin në fitore mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm ai vazhdoi:

Ne jemi popull i vogël, por nuk jemi vetëm. Miqtë tanë me Bashkimin Sovjetik në krye, janë të fuqishëm dhe të pamposhtur. Ushtria e Bashkimit Sovjetik e fitoi luftën dhe aleatët e Luftës së dytë botërore, anglo-amerikanët u futën në valle në fund të dasmës, siç thotë populli, për të ngrënë ndonjë copë. Ne nga lufta që bëmë fituam një gjë të madhe, fituam lirinë dhe pavarësinë dhe populli mori pushtetin në dorën e vet, mori qeverinë në duart e veta se qeveria është e popullit dhe vetëm e popullit.

Më poshtë shoku Enver, pasi foli për tradhëtinë që i bëri vendit tonë Zogu dhe klika e tij, për dëmet, që na shkaktuan okupatorët italianë e gjermanë si dhe për punën e madhe të popullit tonë dhe për ndërtimin e këtyre shkatërrimeve, tha:

Qeveria dhe Partia ndërtuan minierat dhe fabrikat dhe ato tani prodhojnë, jo për tregëtarët spekulatorë, jo për bajraktarët, jo për Ahmet Zogun, po për ju, punëtorë dhe fshatarë dhe do të prodhojnë që ju të rroni më mirë, që ju të përparoni, që kalamanët tanë të mos shohin më ditë të zeza, sikur kemi kaluar ne, po të shohin një jetë më të mirë. Ata e meritojnë. Dhe ne luftojmë dhe do të luftojmë që ata të dalin në selsamet. Kjo rrugë është rruga që na mëson Partia dhe Partia ecën kurdoherë përpara me vendosmëri, sepse Partia është pjella e popullit, ajo ka mbështetjen te ju. Push-teti, që ndërtoi populli me gjak, po forcohet dita-ditës. Armiqtë e popullit tonë, reaksionarët, këlyshët e Gjon Marka Gjonit dhe shokët e tij pëshpërisin: «Kjo qeveri i ka ditët e shkurtëra, për një muaj do të rrëzohet». Kalojnë ditët, shkojnë vitet dhe ata thonë gjithnjë: «Pak ditë dhe mbaroi, hyri greku, erdhi inglizi dolën andej, dolën këndej». Të gjitha këto janë profka, të gjitha bëhen me qëllim që të gënjehen disa mendjelehtë, por këto nuk kanë asnjë bazë. As larot që lehin as reaksionarët e huaj as anglo-amerikanët as fashistët italianë, kurrën e kurrës s'janë në gjendje që të rrëzojnë pushtetin e popullit, s'janë në gjendje të dhunojnë pavarësinë dhe lirinë e popullit tonë, sepse ne jemi të gatshëm ta mbrojmë këtë, sepse ne jemi të gatshëm ta mbrojmë jetën e popullit tonë dhe të atdheut tonë. Disa kriminelë, që enden në këto male na vranë shokun tonë të dashur dhe të shquar, komunistin Bardhok Bibën, djalin e dashur, të shtrenjtë e të urtë të popullit shqiptar, të popullit të Mirditës, të Partisë sonë. Bardhok Biba, që kur ka qenë i ri ka luftuar që në bankat e

shkollës për popullin dhe vetëm për popullin. Atij nuk ju tremb syri nga fashistët italianë, nga terrori i Mustafa Krujës, nga terrori i Gjon Marka Gjonit dhe nga spiunët e Kolë Bibë Mirakajt. Por ai si hero, si djalë i popullit trim të Mirditës luftoi deri në fund. Kriminelët na e vranë, po Bardhok Biba s'ka vdekur: ai është pranë popullit shqiptar, pranë popullit të Mirditës. Për kujtimin e komunistit të shquar, Bardhok Bibës, birit më të shtrenjtë të kësaj krahine ju ftoj të mbajmë dy minuta heshtje. I përjetshëm do të mbetet kujtimi i tij!

Populli i Mirditës është i dashur, është i shtrenjtë për Partinë dhe qeverinë tonë. Partia e qeveria jonë luftojnë për popullin e Mirditës, ndërsa marrin masa kundër kriminelëve që kanë qenë dhe janë kundërshtarë dhe armiq të popullit të Mirditës. Partia dhe qeveria kanë një amanet të madh, populli u ka ngarkuar një detyrë të madhe që të qërojnë ferrat që pengojnë lulëzimin e Shqipërisë, që pengojnë të ardhshmen e Shqipërisë, që pengojnë mirëqenjen tuaj. Masat që u muarën, u muarën kundër kriminelëve dhe jo kundër popullit të Mirditës. Përkundrazi Partia dhe qeveria kanë besim të madh te populli i Mirditës dhe do ta ndihmojnë me të gjitha forcat e tyre. Populli i Mirditës është një popull trim, një popull i zgjuar dhe ai do të ecë përpara. Regjimet e kaluara nuk hapën asnjë shkollë, ato kishin frikë nga ju, se po të hapeshin shkollat, do të hapeshin sytë tuaj dhe do t'i shikonit më mirë dallaveret e Gjon Marka Gjonit dhe qëllimet e tij kundër jush. Por regjimi i popullit mendon ndryshe. Pushteti i popullit do të vërë të gjitha forcat që populli të mësojë dhe të hapë sytë, të kuptojë sa e tmerrshme ka qenë jeta juaj për-

para. Tani në pushtetin popullor jeta juaj do të bëhet më e mirë, shumë më e mirë, çdo ditë e çdo vit. Reakzionarët, me anë të shërbëtorëve dhe të armiqve, do hapin parulla të tjera armiqësore. Po ata nuk mund t'ua arrijnë qëllimeve, sepse populli i ka sytë hapët dhe e shikon rrugën e drejtë të qeverisë. Tani ata reaksionarë kanë gjetur strehë te Titua, te armiku i betuar i popullit tonë dhe i popujve të Jugosllavisë. Titua nuk është veçse një krajl, si krajlrat e vjetër, që kërkonin të copëtonin Shqipërinë, që kërkon Shqipërinë e Veriut ta vëjë nën thundrën e serbomëdhenjve. Ai kërkon që popullin e Kosovës ta shfarosë e të gjakosë popujt njëri me tjetrin, ai kërkon t'i bëjë varrin popullit tonë, por ai do të humbasë, do të mundet, sikur janë mundur të gjithë krajlrat e Serbisë. Dhe tani ata reaksionarë, ato mbeturinat e Gjon Marka Gjonit dhe të banditëve të tjerë, pas grushteve të rënda që u dha ushtria jonë, janë hedhur matanë kufirit, sepse ata nuk mund të rrojnë këtu, sepse populli nuk u jep asnjë kafshatë bukë. Ata kanë shkuar në Jugosllavi, janë futur në shërbim të klikës titiste që t'i përdorë ajo si kriminelë. Por ata do t'i lënë koskat në kufirin tonë që mbrohet nga djemtë tuaj heroikë, nga Ushtria jonë e lavdishme Popullore.

Popull i Mirditës,

Neve na vihen përpara detyra të mëdha. Duke pasur kurdoherë parasysh interesat e atdheut tonë, duhet të tërë të mobilizohemi në punë: kush në arë, kush në fabrikë, kush në shkollë, kush në zyrë që të japim sa

më shumë, që të përparojë bujqësia, që të ndërtohen fabrikat, që të prodhojmë sa më shumë, që populli të ketë sa më me bollëk. Ju e dini dhe ne e dimë që shumë gjëra mungojnë, shumë gjëra nuk i ka akoma populli. Po këto do të plotësohen se i tërë populli punon për veten e tij. Fabrikat punojnë që të furnizojnë katundarët me më shumë beze, me më shumë këpucë, me më shumë sapun e kripë, për të cilat ju keni shumë nevojë. Gjithashtu populli dhe punëtorët e qyteteve kanë nevojë për bukë dhe për gjëra të tjera të bujqësisë, të cilat i prodhon fshatarësia, prandaj të bashkuar, punëtorë e katundarë t'i futemi punës, të prodhojmë sa më shumë dhe sa më mirë që të ulim koston e jetës që kështu të ngrihet mirëqenja e popullit tonë. Këtë do ta arrijmë me siguri, se populli ynë punon me këmbëngulje, sepse ne kemi ndihmën më të madhe të Bashkimit Sovjetik, i cili po na jep fabrika, po na jep ndihmë të shumanshme. Duhet që ne njëkohësisht të shtërnojmë radhët tona, të shtojmë dashurinë për shoqi-shoqin, të kemi sytë hapur kundër atyre që nuk duan të mirën e popullit dhe t'i gjurmojmë ata pa mëshirë, të mpos u zërë këmba vend e t'i shfarosim.

Pasi tregoi se si ushtria e popullit tonë i likuidoi njëri pas tjetrit të gjithë armiqtë e vendit tonë si Mustafa Krujën, Abaz Kupin, Gjon Marka Gjonin etj. shoku Enver vazhdoi:

Populli të shtërnojë radhët rreth Partisë e qeverisë dhe me siguri ne do të shkojmë në rrugën e bollëkut, në rrugën e socializmit.

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë populli heroik i Mirditës!

Rroftë Partia jonë!

Rroftë ushtria jonë!

Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 227 (300), 21 shtator 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 227 (300),
21 shtatori 1949*

NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË RRETHIT TË LEZHËS

18 shtator 1949

I dashur popull i qytetit të Lezhës dhe i krahinave,

Më ka ngarkuar Partia dhe qeveria jonë që të vij këtu në gjirin tuaj e t'ju sjell përshëndetjet më të nxeh-ta e më vëllazërore të qeverisë, të Partisë dhe të miat.

Partia dhe qeveria jonë janë të popullit dhe nje-rëzit e qeverisë dhe të Partisë sonë nuk mund të kenë kurrë një gëzim më të madh se ai kur ndodhen në mes të popullit. Edhe Partia e qeveria forcat e tyre i kanë vetëm te populli, te ju.

Një qeveri që nuk mbështetet mirë në popull, ajo qeveri nuk mund të rrojë, ajo i ka ditët e shkurtëra. Po, Partia jonë që ka dalë nga gjiri i popullit fukara, do të rrojë sa malet, ashtu si do të rrojë populli ynë.

Ju vëllezër e motra e dini historinë e hidhur të popullit tonë, historinë shekullore plot vuajtje dhe plot luftëra heroike, që ka bërë populli ynë. Stërgjyshërit tuaj kanë luftuar heroikisht nën udhëheqjen e Skën-derbeut dhe kurrë nuk janë mundur, kurrë nuk janë

thyer, pse Heroi i Kombit tonë, Gjergj Kastrioti, e udhëhoqi popullin në fitore.

Gjergj Kastrioti, Skënderbeu ishte një udhëheqës i urtë, ishte një udhëheqës që luftoi për lirinë e popullit tonë nga armiku që kishte zaptuar Shqipërinë. Skënderbeu nuk u mund kurrë, pse aspiratat, dëshirat, që kërkonte të realizonte, ishin liri për popullin, që ky të ishte zot i vendit të tij, të kishte tokën e vet, të kishte shtëpinë e tij në këtë truall, që e kishte qysh me kohë. Dhe populli luftoi përkrah Skënderbeut dhe fitoi.

Pas vdekjes së Heroit tonë, Skënderbeut, populli ynë pati ditë të zeza për shekuj me radhë, po ai nuk u mposht. Nuk mundet kurrë të mposhtet populli.

Kanë ardhur despotë, kanë ardhur mbretër, kanë ardhur bajraktarë, që e kanë shfrytëzuar popullin, por e kanë thyer zverkun. Të gjithë janë rrëzuar, janë shfarosur, po populli ka qëndruar më këmbë si malet tona.

Lezha është e shtrenjtë për popullin tonë. Ajo është një vend historik, ku është mbledhur Kuvendi në kohën e Skënderbeut¹, që kishte për qëllim të bashkojë popullin e princat patriotë kundër okupatorit otoman.

Lezha është e shtrenjtë për popullin tonë, sepse këtu janë eshtrat e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, i cili ka frymëzuar popullin tonë edhe në luftën më të madhe që ka parë historia jonë, në Luftën nacional-çlirimtare, kundër një armiku më të egër, kundër një armiku të armatosur deri në dhëmbë, kundër Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste, kundër spiunëve dhe xhelatëve të përhershëm të popullit tonë, kundër bej-

¹ Kuvendi i Lezhës u mbajt më 2 mars 1444.

lerëve, bajraktarëve dhe feudalëve, që i kishin grabitur tokën popullit dhe që e mbanin popullin tonë në terror dhe jeta e popullit tonë varej nga qejfi i beut, i agait ose i feudalit bajraktar.

Populli ynë luftoi dhe fitoi. Populli ynë nxori një udhëheqje të re dhe kjo udhëheqje qe Partia Komuniste.

Ishin bijtë tuaj, bijtë e katundarëve të varfër, bijtë e punëtorëve, bijtë e patriotëve që mbanin në kurrizin e tyre kaq vuajtje shekullore, ishin bijtë heroikë të popullit tonë, që pa marrë parasysh vdekjen i thanë vetes: «Duam të luftojmë deri në fund për lirinë e popullit tonë, të vdesim ose të fitojmë, s'ka rrugë tjetër». Dhe besimi i tyre ishte i madh. Ata do të fitonin se i tërë populli ishte me ta dhe u hodhën në luftë pa armë dhe të zhveshur, bile nuk kishin as bukë të hanin, por kishin zemër trimash. Ishte drejtësia në anën tonë dhe drejtësia që përfaqëson popullin, është drejtësia e vërtetë. Ne kishim besim se do të fitonim mbi armiqtë e egër në luftë kundër fashistëve, kundër gjermanëve, kundër tradhëtarëve, pse këtë luftë e udhëhiqte Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh.

Pasi foli për punën e armiqve që kërkonin të sabotonin luftën e popullit tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Edhe pas çlirimit të Shqipërisë, po këta armiq filluan të na luftojnë me parulla të ndryshme. Përhapën parulla se nuk kemi dituri, se nuk kemi eksperiencë, se i kemi ditët e shkurtëra. Po, ata kishin dituri, po kishin «dituri» për t'i pirë gjakun popullit, për ta zhveshur dhe për ta vvarë. Po puna nuk u shkoi ashtu si u dëshironte zemra, puna shkoi krejt ndryshe.

Pastaj, pasi foli për sukseset që arriti populli ynë pas çlirimit dhe vendosjes së pushtetit popullor dhe pasi tregoi si u mobilizuan masat e gjera të popullit tonë për realizimin e planit të shtetit, shoku Enver vazhdoi:

Reforma agrare i dha fshatarësisë sonë tokën, punëtorët u bënë zot të fabrikave dhe populli mori ekonominë dhe gjithë jetën e vendit në duart e tija dhe i udhëhequr nga Partia dhe qeveria arriti në suksese të rëndësishme politike dhe ekonomike.

Pushteti ynë është pushteti i popullit. Populli vetë i zgjedh organet e qeverisjes, si në qendër dhe në bazë. Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive, që dolën nga votimet, i keni zgjedhur ju. Ata duhet të punojnë me drejtësinë më të madhe që t'i shërbejnë popullit. Ata që nuk punojnë mirë në komitetet dhe në këshillat, ju vetë duhet t'i hiqni. Ata që punojnë mirë, në interesin e popullit, në vijën e Partisë, populli t'i mbrojtë, t'i nderojë se ata janë bijtë e tij.

Me kushtetutën e Republikës, e cila është rezultat i Luftës sonë nacional-çlirimtare, populli ka të drejtë të kritikojë, të heqë dhe të rrëzojë ata njerëz që nuk punojnë mirë dhe këtë armë ja jep në duart e tija Kushtetuta dhe të mos ketë frikë aspak, por ta përdorë këtë të drejtë, se ka mbështetjen e Partisë dhe të qeverisë.

Ju e dini më mirë, vëllezër e motra të malësisë, sa e vështirë është jeta, se jetën ju e fitoni me mundime dhe djersë. Prandaj i gjithë populli ynë duhet t'i përvishet punës, se Shqipëria e re nuk ndreqet kollaj. Nuk ndreqet me nuska dhe me fjalë, por ndërtohet me shpatulla, me djersë dhe dituri. Prandaj Partia dhe qe-

veria kanë çelur me mijëra shkolla, që të zgjohet populli, të mësojë populli, të hapë sytë dhe atë punë që më përpara e ka bërë për disa muaj, ta kryejë për disa ditë. Fabrikat mezi nxirrnin më përpara pak prodhime, por tani duhet të nxjerrin shumë e më shumë. Në kohën e kaluar, në kohën e regjimit shtypës të bajraktarëve, ndalohej populli të mësonte, pse sunduesit e dinin se mësimi ishte armiku më i madh i tyre. Ata donin që populli të mbetej në errësirë. Ata e gënjenin popullin me anën e fesë, me anën e fanatizmit. Qeveria jonë edhe këtë çështje e ka zgjidhur drejt. Ka njerëz dhe klerikë antipopullorë që kërkojnë të mashtrojnë popullin duke thënë se Partia e qeveria jonë «dënojnë ata që besojnë zotin, dënojnë ata që shkojnë në kishë e në xhami». Ata që besojnë dhe venë në kishë ose në xhami, qeveria nuk i dënon, por qeveria jonë nuk mund të jetë me ata priftërinj që janë kundër popullit. Qeveria është me ata që e duan popullin, që e duan atdheun, që e duan lirinë. Me ata është kurdoherë qeveria, sepse ka pasur klerikë të lartë, të cilët kanë përdorur fenë në interes të feudalëve, të bajraktarëve dhe të të huajve në dëm të popullit. Ata kërkojnë të shtypin popullin, po populli ngrihet dhe i shtyp ata. Nuk mund të jetë ndryshe. As populli as qeveria nuk mund të lejojnë që të cënohen interesat, pavarësia dhe liria e atdheut. Këto janë të shenjta për popullin. Prandaj të gjithë ata që s'duan të ecin në rrugën e popullit, populli dhe qeveria e tij do t'i luftojnë.

Rruga e Partisë është shumë e qartë dhe prandaj ata njerëz që nuk duan ta shohin këtë, që vihen kundër interesave të popullit, janë kundër popullit. Populli do

të ecë me siguri me besimin më të madh në rrugën e Partisë, se kjo është rruga e tij, rruga e përmirësimit të jetës së tij nga çdo pikëpamje.

Populli ynë ka besim në të ardhshmen. Ai ka miq si Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore. Po të mos ishte Bashkimi Sovjetik nuk mund të mundej fashizmi. Bashkimi Sovjetik me ushtrinë e tij ishte ai që mundi fashizmin. Edhe anglo-amerikanët ishin në luftë kundër fashizmit, por ata donin të derdhej gjaku i ushtarëve të Bashkimit Sovjetik dhe i popullit tonë dhe në fund ata të përfitonin. Por kjo nuk u doli. Ata kanë filluar tani intrigat e tyre të vjetra. Imperialistët anglo-amerikanë, kanë filluar përgatitjen e një lufte të re. Ata kanë zënë vendin e Hitlerit dhe të Musolinit për t'i hedhur popujt në një kasaphanë të re, por ata me siguri do të dështojnë. Do të dështojnë gjithë planet e tyre, sepse popujt nuk duan luftë dhe se luftën për mbrojtjen e paqes e udhëheqin Bashkimi i madh Sovjetik dhe demokracitë popullore. Edhe nënat nuk duan që të vriten bijtë e tyre dhe rinia e gjithë botës nuk don luftë. E gjithë bota demokratike është kundër luftërave grabitqare që bëjnë imperialistët.

Kundër Shqipërisë qysh prej vjetësh po bëhen intriga, po bëhen kërcënime. Mirëpo populli ynë nuk trembet. Populli ynë i ka nervat të shëndoshë. Populli ynë ka parë mjerime të shumta dhe këto e kanë çel-nikosur.

Imperialistët kanë grumbulluar të gjithë tradhëtarët si Mithat Frashërin, Abaz Kupin, Muharrem Bajraktarin, Mustafa Krujën e të tjerë, me një fjalë të gjithë fashistët dhe xhelatët e popullit shqiptar dhe kanë

krijuar një farë komiteti në Paris. Ata nuk janë veçse spiunët e anglezëve dhe të amerikanëve që tërë jetën atë punë kanë bërë. Kanë shitur Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

Ata janë njerëz pa nder dhe forcat e tyre i pamë. Cilat ishin forcat e këtyre tradhëtarëve si Mustafa Kruja, Muharrem Bajraktari, Abaz Kupi dhe të tjerë? Ushtria Nacional-Çlirimtare këto forca i shpartalloi. Atyre nuk u zuri këmba vend në Shqipëri, se ata s'kishin asnjë lidhje me popullin dhe populli ishte kundër tyre. Ata kishin me vete disa banditë, disa kusarë. Me këta kusarë nuk pajtohej populli ynë dhe e dinte se sa u vliente lëkura atyre. Kurrë nuk do të preket pavarësia e Shqipërisë. Shqipëria e re do të përparojë, do të lulëzojë, do të rrojë megjithëse anglezët, amerikanët dhe tradhëtarët përpiqen ta dëmtojnë.

Puna e këtyre tradhëtarëve që përpiqen të gënjejnë popullin është që, duke hedhur parulla si «dhe një muaj e kanë me ardhë anglezët, kanë me ardhë grekët», ta çoroditin atë, mirëpo të gjitha këto janë përralla dhe populli ynë nuk gënjehet me to.

E panë monarko-fashistët se me kë kanë të bëjnë në këta muajt e fundit në kufirin tonë nga ana e Korçës. Ata kishin qëllim të shkelnin vendin tonë. Ata nuk bënë asnjë hap përpara brenda kufive tanë, pse ata i mbronin djemtë tuaj me heroizëm dhe pasi lanë disa qindra të vrarë u kthyen me turp në tokën e tyre. E panë se me zjarr nuk luhet. Këtë e panë edhe amerikanët e anglezët, e panë mirë se Shqipëria nuk preket.

Këto gjëra i bëjnë që popullin tonë ta ndalojnë në vrullin e tij, për ndërtimin e jetës së tij të re. Duan të

krijojnë një situatë të turbullt. Elementët e këqinj i thonë popullit: «Mos dorëzoni grurin, mos ju bindni urdhëresave të qeverisë» e të tjera gjëra. Populli ynë është i mobilizuar i tëri për realizimin e planit të shtetit, për zbatimin e urdhëresave të qeverisë. Urdhëresat e qeverisë janë vetëm e vetëm në interes të popullit. Këto do t'i sjellin një jetë më të mirë popullit tonë. Posaçërisht për këtë gjë armiqtë tanë na luftojnë, pse ata kërkojnë të kthehen ditët e tyre të kohës së vjetër. Ju e dini mirë atë kohë sa e trishtueshme ka qenë. Ne kemi vështirësi për të kaluar, kemi dhe shumë pengesa. Qeveria dhe Partia jonë e dinë se sa nevoja kanë malësitë tona, të cilat kanë qenë kurdoherë të shtypura nga regjimet e kaluara, po këto vështirësi e pengesa do t'i kapërcejmë, ashtu siç i kemi kapërcyer edhe të tjerat, jo më pak të mëdha. Populli ynë nuk ka kursyer asgjë për çlirimin e atdheut, është vrarë dhe është djegur dhe jo ma mos të mobilizohet të punojë në fabrika e në ara, të shkojë në shkolla etj. Këto gjëra do t'i bëjë që të gjitha populli ynë dhe në këtë rrugë do ta udhëheqë me sukses Partia dhe qeveria e tij.

Siç e dini, në Shkodër po bëhet Kongresi i unifikimit të rinisë sonë heroike. Atje janë mbledhur përfaqësuesit e rinisë sonë. Populli ynë mburret me këtë rini, e cila është e fortë, e çelniktë, është patriote, është e sakrificës, është e punës. Ajo është e ardhshmja e popullit tonë.

Populli ynë ka një ushtri të nxjerrë nga gjiri i vet. Janë djemtë tuaj që ju i keni mësuar të ruajnë në zemrat e tyre dashurinë për atdheun e popullin. Prandaj, ushtria jonë është garancia e lirisë, e pavarësisë dhe e

fitores së popullit tonë. Ne kemi Partinë tonë të fortë, ajo na udhëheq në rrugën e marksizëm-leninizmit dhe kjo do të bëjë që të triumfojnë qëllimet e larta të popullit. Partia jonë është garancia më e madhe e sigurimit të jetës së popullit tonë, e pavarësisë dhe sovranitetit të atdheut tonë, garancia më e madhe e së ardhshmes së popullit tonë. Prandaj, i dashur popull i Lezhës, të bashkohemi dhe të shtërngojmë radhët tona për mbrojtjen e fitoreve të popullit tonë, për mbrojtjen e atdheut dhe të pavarësisë së tij. Të shtërngojmë radhët rreth Partisë së Punës dhe qeverisë sonë që na udhëheqin në rrugën e drejtë.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i qytetit dhe i rrethit të Lezhës!

Rrofshin malësorët tanë trima!

Rroftë ushtria jonë!

Rroftë Partia jonë e Punës!

Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe i madhi Stalin!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË MILOTIT

18 shtator 1949

Pasi përshëndeti në emër të Partisë dhe të qeverisë dhe pasi vuri në dukje rolin e madh të Partisë në udhëheqjen e popullit, shoku Enver tha:

Ju e dini mirë si lindi Partia jonë. Partia lindi në momentet më të rënda të historisë së Shqipërisë, lindi në ato kohë kur ishte në rrezik fati i popullit tonë, ishte në rrezik e ardhshmjia e brezave të popullit tonë, kur mbi atdheun tonë rëndonte zgjedha fashiste dhe e tradhëtarëve.

Shoku Enver më poshtë vuri në dukje luftën heroike që bëri populli ynë kundër fashistëve italianë dhe tradhëtarëve të vendit, tradhëtinë e Abaz Kupit, të Mustafa Krujës, të Prenk Previzit, të Gjon Marka Gjoni etj., të cilët viheshin pa rezerva në shërbim të çdo të huaji që ka shkelur Shqipërinë për të shtypur dhe rjepur popullin tonë dhe pasi foli për luftën që bëri ky, i udhëhequr nga Partia, ai tha:

Ne u çliruam dhe ndërtuam pushtetin tonë, ku erdhi populli në fuqi. Për këtë u derdh gjak dhe u bënë sa-

krifca, prandaj këtë pushtet ta ruajmë mirë, ta bëjmë sa më të fortë.

Duke folur për njerëzit që duhet të vihen në krye të pushtetit ai vazhdoi:

Në pushtet duhet të vijnë njerëzit që i qajnë hallin popullit, njerëzit e vegjëlisë, që dinë ku i dhemb popullit, që dinë t'ja shërojnë shpejt plagët e tija, të mos e lënë të presë populli, po t'ua gjejnë shpejt ilaçin sëmundjeve. Dhe ata që nuk i shërbejnë mirë popullit, t'i hiqni, se ju vetë i keni zgjedhur. Këtë të drejtë jua jep Kushtetuta, këtë të drejtë duhet ta zbatoni, sepse përndryshe nuk mund të ndërtojmë Shqipërinë e re dhe jetën e mirë të popullit tonë. Shumë shokë nga Miloti — *vazhdoi shoku Enver* — kanë rënë për atdhenë, për lirinë. Ju të gjithë e njihni Ndoc Dedën, dëshmor i popullit, i cili nuk kurseu jetën që populli i tij të ketë liri, që populli i tij të ndërtojë jetën më të mirë. Ndue Jak Shijaku, Riza Musa, Mustafa Dibra, Xhemal Tafa, të tërë këta, janë bijtë tuaj, bijtë më trima, që s'kursyen jetën, që u vranë nga okupatorët dhe tradhëtarët. Por populli ynë ua mori hakën dhe i dënoi të gjithë tradhëtarët.

Pasi shoku Enver foli për veprimtarinë e poshtër të kriminelëve, këlyshët e Gjon Marka Gjonit, që sot kanë gjetur strehë dhe përkrahje nga klika e Titos dhe për dënimin që kanë marrë këta nga gjyqet e popullit, përmendi heroizmat e ushtrisë sonë heroike, ushtri e dalë nga gjiri i popullit tonë dhe që mbron me abnegacion interesat dhe jetën e këtij nga armiqtë dhe tradhëtarët. Ai pastaj tha:

Me veprimtarinë e tyre armiqtë nuk do të arrijnë

kurrë që ta dëmtojnë popullin tonë të ndershëm dhe të dhunojnë pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë, sepse ne nuk jemi vetëm, kemi miq të fortë, kemi Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh.

Ata që janë me të vërtetë trima nuk mburren, ata janë kurdoherë të qetë dhe heshtin, sepse nuk kanë frikë. Ata që nuk janë burra, bërtasin se «jemi të fortë, se kemi bomba atomike» dhe këtë e bëjnë me qëllim që të tremben të tjerët. Mirëpo të tjerët s'tremben dhe këtë e kanë treguar me prova. Luftën kundër Gjermanisë dhe Italisë e fitoi Bashkimi Sovjetik dhe Ushtria Sovjetike. Ju e dini mirë se luftën nuk e bën vetëm dyfeku, por e bën zemra.

Në vazhdim të fjalës së tij, pasi përmendi shkatërrimet, që solli lufta dhe punën e madhe që po bën populli ynë sot, shoku Enver tha:

Pas luftës katundari mori tokën për tërë jetën dhe nuk ka zot që t'ja marrë këtë. Qeveria do ta ndihmojë dhe do të krijohet bollëku. Qeveria nga ana tjetër ndërton fabrika, shkolla, bën kanalizime, hap puse të tjera vajguri, do të hapë miniera të tjera edhe këtej nga Shqipëria e Veriut, që është vend i pasur dhe do të nxjerrë bakër, hekur dhe shumë metale të tjera. Të gjitha këto do ta pasurojnë vendin tonë, kjo është e ardhshmeja e vendit tonë, kjo është rruga e socializmit, që ka me na çue në komunizëm. Socializmi: ky është qëllimi i Partisë dhe i popullit tonë. Që të arrihet dita-ditës një jetë më e mirë, që të shohim ditë më të bardha, për këtë punon Partia dhe për këtë gjë jemi mobilizuar. Kundër kësaj rruge janë zotërinjtë feudalë dhe kapitalistë, agallarët etj., por ata do të humbasin me siguri.

Më poshtë shoku Enver pasi demaskoi parullat që hedhin disa agallarë, kulakë, miq të Abaz Kupit, të Mustafa Krujës etj., tha:

Këto parulla s'kanë asnjë rrënjë ku të mbahen në popull.

Duke folur në lidhje me provokacionet e monarko-fashistëve grekë në kufitë tanë të Jugut, ai tha:

Tantuan monarko-fashistët të shkelin kufitë tanë, na bënë dëme, por ushtarët tanë qëndronin syzgjuar dhe monarko-fashistët e paguan mirë me kokë këtë guxim të tyre. Me qindra qenë të vrrarët që lanë dhe pastaj ikën përtej kufirit. Shqipëria ka zot. Dhe ky zot është populli.

Pastaj, duke këshilluar fshatarët, shoku Enver tha:

Të dërgoni kalamanët në shkollë, sepse shkolla të nxjerr në dritë. Që të punojmë mirë, na duhen njerëz të mësuar. Këta do të jenë njerëzit tanë të mësuar. Që të ngrihen fabrika të mëdha dhe të prodhojnë sa më shumë, na duhen inxhinierë. Ja, këta djem do të bëhen inxhinierë. Që të prodhojë sa më mirë toka, duhen agronomë, njerëz të mësuar.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT NË URËN E ZEZË

18 shtator 1949

Shoku Enver Hoxha, si përshëndeti popullin e Urës së Zezë në emër të qeverisë dhe të Partisë, foli për rolin e Partisë Komuniste, që shpëtoi popullin tonë nga skllavëria dhe mjerimi dhe që do ta çojë atë në një jetë më të lumtur. Shoku Enver u tregoi fshatarëve se po të mos ishte Partia, populli ynë do të vuante nën robërinë më të rëndë, sepse armiqtë e tij do ta shtypnin dhe do ta shfrytëzonin duke i pirë gjakun. Si vuri në dukje luftën që bëri populli ynë kundër okupatorëve fashistë italo-gjermanë dhe kundër bejlerëve, agallarëve, feudalëve, çifligarëve, bajraktarëve, tregëtarëve të mëdhenj, që deshën t'i bënin varrin popullit, shoku Enver tha:

Ju e dini se në Shqipërinë e re brenda pesë vjet çlirimi janë bërë gjëra të mëdha. Mendoni pak sa gjëra kanë ndryshuar, sa ka ndryshuar jeta e fshatarit tonë, e punëtorit, e njerëzve të ndershëm që rrojnë në atdheun tonë. Jeta e vjetër ka qenë gjithë mjerim. Katundari punonte për Abaz Kupin dhe për gjakatarët e vendit. Ju i keni provuar në kurriz çka ata kanë bërë kundër

popullit. Dhe tani përpiqen, të fitojnë atë që humbën, po kurrë nuk do të fitojnë. As Abaz Kupi as shokët e tij, kurrë nuk do të vënë këmbët e tyre në këtë vend, sepse Shqipëria e re nuk është më Shqipëria që njohin ata, nuk është më monedhë shkëmbimi që ta bëjnë imperialistët amerikanë dhe anglezë si ta duan. Kaluan ato kohë që e copëtonin Shqipërinë: gjysmën ja jepnin grekut, gjysmën serbit, e ndonjë copë Italisë. Ato kohë s'vijjnë më. Ne i dimë kush janë Mustafa Kruja, Abaz Kupi, Mithat Frashëri, Gjon Marka Gjoni, i dimë sa para u vlen lëkura.

Tani ata kanë ngritur në Paris një komitet, këtë e kanë bërë për të gënjyer popullin, për t'i thënë popullit tonë se do të vijjnë gjoja anglezët dhe amerikanët. Këlyshët e tyre këtu lëshojnë parulla se «kjo qeveri dhe pak muajt dhe dorëzohet». Kalojnë muajt dhe vitet, por pushteti i popullit bëhet gjithnjë më i fortë, pushteti i popullit do të rrojë, populli gjithnjë do të fitojë e kurrë nuk do të humbasë.

Si vuri në dukje rolin vendimtar që luajti Ushtria Sovjetike në luftën kundër Gjermanisë dhe përpjekjet e mëdha që bën kampi demokratik dhe antiimperialist me në krye Bashkimin Sovjetik për mbrojtjen e paqes kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikano-anglezë shoku Enver vazhdoi:

Bashkimi Sovjetik dhe kampi i socializmit do të bëjnë që të dështojnë të gjitha përpjekjet e anglo-amerikanëve. Ata do të dështojnë, sepse kur të shohin të dobët, të hidhen në grykë, por kur të shohin të fortë, largohen se kanë frikë. Dhe megjithëse luftën nuk e bëjnë vetëm armët, ato duhet t'i mbajnë në dorë njerë-

zit. Dhe kur njeriu di përse lufton, kur ka si ideal luftën për atdheun e tij, për popullin e tij, atëhere kjo armë bëhet e tmerrshme. Prandaj kampi ynë është më i fortë, më i fuqishëm dhe do t'i mposhtë imperialistët. Ne kemi armiq rreth e rrotull. Ndër ta është klika e Titos, e cila është një vegël e anglo-amerikanëve. Kjo është përpjekur t'i hedhë duart në grykë popullit tonë, ta mbytë, ta bëjë koloni, po populli ynë shpëtoi në saje të Bashkimit Sovjetik, në saje të Stalinit dhe unitetit të Partisë sonë.

Populli dhe Partia jonë kanë fituar mjaft eksperiencë dhe njohin mirë qëllimet e Titos me shokë. Planet e tyre do të dështojnë, sepse atyre nuk ju ecin armët kundër nesh. Ata mbrojnë të arratisurit, ata kanë lidhje me komitetin e kriminelëve shqiptarë dhe përpiqen të gënjejnë disa kosovarë, t'i hedhin në vëllavrasje me popullin shqiptar. Këtu Titua ka për qëllim të shfarosë kosovarët, vëllezërit tanë që kanë vuajtur nën shtypjen e serbomëdhenjve dhe nën pasanikët serbë dhe kroatë. Do të vijë dita që Kosova do të çlirohet dhe ajo do të çlirohet në rrugën e demokracisë popullore dhe jo në rrugën e Abaz Kupit dhe të Mithat Frashërit.

Pastaj shoku Enver tha:

Populli ynë me besim të madh është hedhur në punë për të realizuar planin e shtetit, i cili përfaqëson të ardhshmen e vendit tonë.

T'i punosh sa më mirë arat, t'i mbjellësh sa më mirë, të marrësh sa më shumë grurë e bereqet, sa më shumë bimë industriale, këto janë pasuria jonë, e gjithë atdheut tonë.

Shoku Enver pasi i këshilloi fshatarët që të mobi-

lizohen të gjithë për të punuar dhe për të forcuar bashkimin e popullit, për të luftuar armiqtë e popullit pa mëshirë, duke e përfunduar fjalimin e tij, tha:

Partia dhe qeveria do të vënë të gjitha forcat që t'i ndihmojnë fshatarët me çdo mjet që bujqësia jonë të shkojë përpara. Për këtë të jeni të sigurtë. Por ka edhe pengesa, ka edhe mungesa dhe këto ne nuk i fshehim, se po t'i fshehim, do të bënim gabim të madh. Por këto do të kapërcëhen. Përnjëherësh nuk ndreqet shtëpia, as nuk ndreqet atdheu. Kjo do kohë, do mundime dhe sakrifica. Ne këto pengesa nuk na trembin aspak. Populli ynë ka kapërcyer vështirësi edhe më të mëdha dhe ka dalë me sukses e jo tani që ka në aktivin e vet kaq fitore, që ka në dorë pushtetin.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 227 (300), 21 shtator 1949

**TË SHTOJMË VIGJILENCËN REVOLUCIONARE PËR
TË RUAJTUR FITORET E ARRITURA, TË VËMË TË
GJITHA FORCAT PËR REALIZIMIN E DETYRAVE
TË PLANIT**

*Fjala e mbylljes në Plenumin III të zgjeruar të
KQ të PPSH*

13 tetor 1949

Mendoj që ky plenum ka qenë i dobishëm për të gjithë kuadrot udhëheqës, pse u shtruan dy nga problemet më të rëndësishme që preokupojnë sot Partinë tonë, çështjet e politikës së brendshme e të jashtme të Partisë, si dhe çështjet ekonomike. Problemet këtu u diskutuan mirë dhe drejt nga të gjithë shokët dhe është pozitiv fakti se ndjehet një siguri në ecjen përpara, në realizimin e programit të Partisë. Shokët sekretarë politikë të rretheve, në pjesën më të madhe të tyre, duket që kanë bërë mjaft përparime në punë, janë në krye të detyrave që u janë vënë përpara për t'i zgjidhur. Ata ka një preokupacion të jashtëzakonshëm për t'i zotëruar çështjet e Partisë. Kjo është mjaft pozitive dhe një garanci për të ardhshmen. Por kjo nuk do të thotë që, si ne dhe shokët sekretarë të rretheve, e kemi mba-

ruar detyrën dhe nuk duhet të preokupohemi më, përkundrazi sa më shumë suksese të kemi, aq më tepër duhet të hidhemi me vrull në punë dhe njëkohësisht të mësojmë sa më shumë, sepse që të gjithë ne shumë pak dimë, kurse përsa i përket planit kemi shumë detyra përpara për të realizuar, të cilat do t'i prek pak, që t'i kemi më të qarta për të ardhshmen.

Shoku Mehmet në referatin e tij i shtroi mirë problemet politike. Ky nuk është vetëm një referat teorik, por në të shtrohen edhe çështje praktike, të lidhura ngushtë me situatën e vendit tonë. Prandaj, propozoj që ky referat të punohet mirë në organizatat e Partisë, të kuptohet si duhet kudo dhe e tërë Partia të mobilizohet në masën që duhet për të realizuar detyrat e rëndësishme politike që na ngarkon gjendja. Këto çështje kanë shumë rëndësi, pse çështja e rritjes së fuqisë mbrojtëse të vendit është kryesorja, ajo ka të bëjë me ruajtjen e pavarësisë dhe të fitoreve të popullit tonë.

Momentet që kemi kaluar kanë qenë të vështira, pse vendi ynë kërcënohej nga një rrezik i madh, si nga ana e armiqve të jashtëm, ashtu dhe atyre të brendshëm, por vendosmëria e Partisë sonë, patriotizmi i madh i masave të popullit dhe përpjekjet e mëdha të Armës së Sigurimit të Shtetit bënë që të dështonin planet e armikut ndaj vendit tonë.

Ju e dini që imperializmi është në sulm kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracive popullore. Kjo nuk është një gjë e rastit, po e përgatitur me kohë dhe me qëllim që të nxitë shpërthimin e një lufte të re botërore. Këtë luftë imperializmi po e përgatit dhe, megjithëse u tha dhe në referat, po e theksoj edhe

unë që, të gjithë shokët dhe sidomos sekretarët politikë të Partisë në rrethet, duhet ta ndjekin mirë situatën dhe ta njohin e ta kuptojnë si duhet politikën e kampit demokratik antiimperialist të udhëhequr nga BRSS.

Komiteti Qendror i Partisë përpiqet gjithnjë që çështjet politike t'ua bëjë të qarta të gjitha masave të Partisë dhe popullit me anën e shtypit. Në çdo numër të gazetave tona vihet në dukje politika e drejtë e Bashkimit Sovjetik si dhe demaskimi që i bëhet imperializmit nga ana e tij. Këtë e them sepse shokët tanë nuk i vënë rëndësi kësaj çështjeje, kurse nuk duhet të harrojmë se realizimi i planeve ekonomike, mbrojtja e lirisë dhe e pavarësisë së vendit dhe të popullit shqiptar, janë të lidhura ngushtë edhe me çështjet e politikës së jashtme dhe të brendshme. Kur ishim në Moskë, këtë vit, shoku Stalin na tha se aktualisht nuk ekziston ndonjë rrezik që Shqipëria të invadohet nga imperializmi nga cilado anë qoftë, së pari sepse kjo nuk është e lehtë dhe sepse nga ana tjetër ka kontradikta të mëdha në mes vendeve imperialiste për çështjen e Shqipërisë. Megjithatë vazhdoi ai, ju duhet të tregoheni të kujdesshëm për të evituar provokacionet që bëjnë armiqtë e vendit dhe të popullit shqiptar ndaj vendit tuaj.

Nga ana tjetër duhet që njerëzit e Partisë të mobilizojnë popullin rreth problemeve të Partisë, ta sqarojnë atë politikisht, të lidhen ngushtë me të, pse atje ku nuk shkon fjala e Partisë, punon më lehtë armiku. Populli duhet të dijë çfarë bëhet jashtë vendit, ç'ndodh e ç'bëhet në Bashkimin Sovjetik, në Angli, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, çfarë po bëhet me çështjen e armëve atomike etj. Populli don të dijë rreth këtyre

gjërave dhe kur i thuhet si duhet, kjo përbën një ushqim politik për të dhe ai lidhet më shumë me Partinë. Këto gjëra asnjëherë nuk duhet t'i harrojmë, pse atëhere do t'i lëmë shteg armikut që të bëjë punën e tij, të hedhë parulla të ndryshme dhe të krijojë situata në favor të tij.

Armiqtë e brendshëm flasin në mes të rrugës, në pazar, gjithfarë gjërash të servirura nga reaksioni, siç është parulla që ka dalë se «është krijuar një qeveri jashtë, e cila do të kërkojë të vijë në Shqipëri» e të tjera parulla të tilla armiqësore. Këto parulla i marr fshatari në qytet dhe i shpie në fshat, ku menjëherë përhapen, shtohen e zmadhohen. Prandaj, Partia duhet të mbajë qëndrim në çdo situatë, të sqarojë popullin, pse kështu do të bëhet e mundshme prerja e hovit të parullave që përhap armiku. Reaksioni goditjet kryesore i bën kundër BRSS, pse BS lufton për lirinë dhe sigurimin e popujve, pse duke luftuar kundër BRSS, ai ka luftuar njëkohësisht kundër vendeve të demokracisë popullore që bëjnë pjesë në kampin antiimperialist. Po ne e dimë që kampi ynë është shumë i fuqishëm e i pamposhtur. I tillë është realiteti që duket çdo ditë. Politika e drejtë dhe e vendosur e kampit tonë bën që të dështojë vazhdimisht politika e shantazheve të imperializmit. Po të shohim ngjarjet e kohëve të fundit do të vëmë re se përpjekjet e imperializmit për të gllabëruar gjithë shtetet, që kanë hyrë në planin Marshall janë të vazhdueshme. Ky plan nuk është gjë tjetër përveçse një orvatje nga ana e imperializmit amerikan për të vendosur hegjemoninë e tij kudo. Por këtë plan me kohë e ka demaskuar dhe e demaskon vazhdimisht

Bashkimi Sovjetik e vendet e demokracisë popullore dhe rezultatet e kësaj pune duken qartë. Kjo e ka shpejtuar krizën e imperializmit, që vete çdo ditë duke u keqësuar. Për imperializmin amerikan dhe shtetet e marshallizuara papunësia po shtohet çdo ditë e më shumë, kurse forcat përparimtare venë gjithnjë përpara dhe arrijnë rezultate të kënaqshme në luftën kundër imperializmit amerikan dhe satelitëve të tij. Kjo shihet mirë në Itali, në Francë etj.

Çështje me rëndësi është ajo e Gjermanisë. Reakcioni ndërkombëtar deshi ta bënte atë një armë kundër BRSS për të pregatitur një luftë të tretë botërore. Kjo kishte dhe ka rëndësi të madhe. Të gjitha traktatet që janë firmuar nga fuqitë e mëdha në lidhje me Gjermaninë janë shkelur nga shtetet e Perëndimit. Asgjë nuk po bëhet në Gjermaninë Perëndimore në bazë të angazhimeve që janë marrë, as çmilitarizimi as denazifikimi dhe as përpjekje për të demokratizuar vendin, përkundrazi atje janë vënë të gjitha forcat nga ana e imperializmit që të armatoset Gjermania Perëndimore dhe të bëhet kështu një vatër e re agresioni. Për këtë qëllim u krijua edhe qeveria e Bonit¹. Mirëpo, si çdo masë që është marrë pa bashkëpunimin e BRSS edhe kjo do të pësojë fiasko. Ju keni dëgjuar se kohët e fundit u shpall Republika Demokratike Gjermane² e u zgjodh demokratikisht qeveria nga përfaqësuesit e popullit të Gjermanisë Lindore. Pas këtyre ngjarjeve qeveria sovjetike të gjithë pushtetin ja dha kësaj qeverie,

¹ Qeveria e Gjermanisë Perëndimore u krijua në shtator 1949.

² Republika Demokratike Gjermane u shpall më 7 tetor 1949.

pse kjo përfaqëson interesat e popullit gjerman. Me shpalljen e RD Gjermane, ky shtet do të bëhet strumbullari i forcave përparimtare gjermane në të gjithë Gjermaninë dhe njëkohësisht një faktor paqeje dhe jo lufte. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe. Krijimi dhe roli që do të luajë Qeveria Demokratike Gjermane do të ketë reperkusione shumë të mëdha në anën tjetër të Gjermanisë së okupuar nga anglo-franko-amerikanët.

Një ngjarje e jashtzakonshme dhe një fitore e pallogaritshme për kampin tonë, është fitorja e revolucionit popullor në Kinë, fitore e madhe e popullit kinez. Imperializmi humbi Kinën, e cila u bashkua me kampin demokratik. Kjo fitore e madhe do të thotë se tashmë nuk është aq e lehtë për imperializmin amerikan të ndezë luftën, përkundrazi është shumë e vështirë. Tani duhet të bëhen mirë llogaritë dhe imperialistët i bëjnë këto llogari, ata nuk shkojnë në tym, pse përpara se të ndërmarin një punë, mendojnë të fitojnë dhe llogaritin se kundërshtari që kanë nuk thyhet kollaj. SHBA e ndihmuan me të gjitha forcat e tyre Çan Kai Shinë, i cili me gjithë armatimet e bollshme që i dhanë amerikanët, u shpartallua nga Ushtria Popullore e Kinës, sepse një ushtri e udhëhequr nga një parti komuniste nuk mund të mposhtet. Fitorja e revolucionit popullor në Kinë është një fitore e madhe e kampit tonë dhe e gjithë njerëzimit, pse kjo që një goditje e rëndë për imperializmin amerikan, i cili nxirrte nga Kina përfitime të mëdha. Tani pasuria e gjithë këtij vendi të madh i kaloi popullit kinez, që u radhit në kampin e paqes e të socializmit.

Shantazhi i bombës atomike, të e cila imperializmi

amerikan kishte mbështetur të gjitha shpresat për fitoren e tij, i plasi në duar. Bashkimi Sovjetik e kishte thënë me kohë se kishte zbuluar sekretin e përgatitjes së armëve atomike dhe se e kishte bombën atomike. Tani u bë më e qartë për të gjithë se me armët atomike është i kotë shantazhi. Prandaj lëvizja për mbrojtjen e paqes bëhet çdo ditë më e madhe dhe më e fuqishme.

Përgatitjet për luftë imperializmi amerikan i bënë edhe me anën e agjenturave të veta për minimin e pushtetit në vendet e demokracisë popullore. Një gjë të tillë e zbuloi shumë mirë gjyqi i Rajkut¹. Në këtë gjyq u zbulua edhe më thellë puna armiqësore e klikës së Titos. Në gjyqin e Budapestit doli në shesh veprimtaria e kësaj agjente të madhe ndërkombëtare. Me çështjen e Koçi Xoxes u bë e qartë puna armiqësore e klikës së Titos në Shqipëri, po gjyqi i Rajkut zbuloi gjëra të tjera me shumë rëndësi. Imperializmi amerikan u përpoq që me anën e agjenturës së vet, të shkëputë nga kampi socialist shtetet e demokracisë popullore rreth Danubit dhe ato të Evropës Juglindore. Në këtë gjyq u demaskuan edhe planet e vjetra të imperializmit, plane këto që dështuan nga politika e drejtë e Stalinit dhe nga veprimtaria e rrufeshme e Ushtrisë Sovjetike në Ballkan dhe në Evropën Qendrore. Megjithatë imperialistët nuk

¹ Lazlo Rajk, ish-ministër i jashtëm i Republikës Popullore të Hungarisë. Agjent i imperialistëve anglo-amerikanë dhe i revizionistëve jugosllavë. Bashkë me grupin e tij punoi për përmbysjen e pushtetit popullor në Hungari. Gjyqi i popullit, që u zhvillua në qytetin e Budapestit më 16—22 shtator 1949, i dha dënimin e merituar.

i hodhën armët, ata e vazhduan punën e tyre, e cila u zbulua ca më mirë kohët e fundit në Budapest.

Nga kjo ngjarje Partia jonë duhet të nxjerrë mësimë të rëndësishme. Titua me shokët e tij të mos konsiderohen vetëm si elementë armiq të kufizuar, që donin të kolonizonin vetëm Shqipërinë dhe që mjaftoheshin të zhduknin vetëm Partinë tonë. Kjo është vetëm njëra anë e punës së tyre, por qëllimi i tyre synonte më larg. Ata donin të shtinin në dorën e tyre, për hesap të imperializmit amerikan, të gjitha shtetet e demokracisë popullore, duke i shkëputur ato nga lidhjet e ngushta që kanë me BRSS. Duke vepruar në këtë mënyrë, ata donin të dobësonin kampin tonë.

Nga këto ngjarje Partia jonë duhet të nxjerrë gjithashtu mësimë edhe përsa i përket vigjilencës. Çështjet të mos gjykohen lehtë e lehtë nga shokët tanë. Ndaj gjithë atyre anëtarëve të Partisë, që ishin implikuar me çështjen e jugosllavëve, qëndrimi i Partisë ka qenë i drejtë. Partia jonë do t'i ndihmojë ata që kanë gabuar në këtë çështje, po shokët e Partisë duhet të jenë vigjilentë dhe vetë ata që kanë gabuar të bëjnë përpjekje të mëdha dhe të japin prova të shumta për të larë gabimet që kanë bërë, të provojnë se vazhdimisht janë gati të sakrifikohen kur ta dojë interesi i Partisë dhe i popullit. Nuk duhet të harrohen për asnjë moment gjithë ato gjëra që na kanë ngjarë. Shokët që kanë gabuar, me punë dhe me prova të mëdha të tregojnë se po ecin në rrugën e drejtë. Partia duhet të jetë sa më vigjilente, se armiku nuk flë. Veprimtaria armiqësore e imperializmit të ndiqet me kujdes dhe të luftohet me ashpërsinë më të madhe. Njerëzit tanë duhet të maten me metron

e punës dhe të qëndrimeve konkrete, kurse për ata që nuk i kryejnë detyrat që u ngarkohen nuk duhet të bëhen lëshime. Është tjetër punë kur nuk kryhen punët personale, po për moskryerjen e detyrave të Partisë, nuk duhet të ketë lëshime. Në këtë gjë të jemi të rreptë dhe të drejtë, çështjet t'i peshojmë mirë. Aty ku gabimet bëhen me qëllim dhe me ndërgjegje, t'i luftojmë me ashpërsi, pse ato ndihmojnë armikun dhe duhet të shohim në to punën e tij.

Roli drejtues i komiteteve të Partisë duhet të dalë mirë në këto çështje. Ato duhet të dinë të dallojnë të mirët nga të ligjtë, të përpiqen t'i izolojnë të ligjtë në kohën e duhur dhe ata që shihet se punojnë me qëllim që të dëmtojnë punën, të luftohen pa mëshirë.

Një tjetër problem me shumë rëndësi është goditja që duhet t'u bëhet orvatjeve të armikut për të hyrë në radhët e Partisë. Në lidhje me këtë çështje, Komiteti Qendror ka dhënë shumë direktiva, si për vigjilencën si dhe për çështje të tjera me rëndësi për Partinë. Anëtari i Partisë duhet të edukohet që në çdo punë që bën, të ketë parasysh interesin e popullit. Sentimentet dhe personaliteti i një njeriu nuk kanë vlerë përpara interesave të mëdha të popullit. Interesat e anëtarëve të Partisë duhet të lidhen ngushtë me ato të popullit. Po të shihen kështu problemet, atëhere do të forcohet Partia dhe anëtarët e saj do të bëhen si ai komunisti në Kuçovë, që megjithëse kishte pakënaqësira ndaj disa shokëve të komitetit të Partisë, kur pa se rrezikoheshin interesat e Partisë dhe të popullit, shkoi menjëherë në komitetin e Partisë dhe tregoi të gjithë punën që donte të bënte një element armik, i futur kontrabandë në

radhët e Partisë. Njerëzit mund të bëjnë edhe gabime, po të merren masa që këto të ndreqen shpejt, të mos bëhen të atilla sa të molepsin Partinë.

Shokët drejtues të organizatave të Partisë kanë për detyrë t'i dëgjojnë me vërejtje e gjakftohtësi ankimet dhe vërejtjet e anëtarëve të thjeshtë të Partisë, të shihen mirë e drejt ankimet që vijnë nga poshtë, pse po të shohë arbitraritet dhe moskokëçarje për ankimet, shoku i thjeshtë i Partisë nuk do të mendojë mirë për Partinë. Edhe ne të gjithë, që jemi në udhëheqje të Partisë, të mendojmë një herë mirë se derisa kemi ardhur këtu, sa të meta kemi pasur, por Partia na ka ndrequr. Prandaj njerëzit të mos i gjykojmë nga lart, po t'i shohim si duhet dhe me drejtësinë më të madhe. Mendimet e njerëzve nuk duhet t'i shohim në mënyrë të rrëmbyer. Vigjilenca në Parti të mbahet vazhdimisht e ngritur në çdo moment, por të mos marrë karakterin e një vigjilence policore dhe të sëmurë, po të jetë e pastër, revolucionare.

Njerëzit tanë mund t'i realizojnë të gjitha detyrat, pse Partia jonë, megjithëse e re, ka një eksperiencë të madhe. Kjo është një armë e fortë në duart e saja, e cila duhet të përdoret mirë. Ne njohim edhe taktikat që përdor armiku për të na luftuar, prandaj të jemi sa më vigjilentë.

Edhe përsa i përket politikës së brendshme, këtë çështje shoku Mehmet e shtroi mirë e gjerë në referatin e tij. Siç u pa aty, armiku nuk përpiqet të na godasë vetëm nga ana ekonomike, por goditjet e tija kundër nesh i drejton nga të gjitha anët.

Këtu u ngrit edhe çështja e gjykatave dhe e pro-

kurorive. Në këta sektorë janë bërë lëshime që na kanë dëmtuar. Mundet që armiku të ketë edhe njerëzit e vet në këto organe, mbasi në radhët e njerëzve të drejtësisë ka edhe elementë të vjetër. Prandaj Partisë i bie një barrë e rëndë që të bëjë një punë më të madhe politike me këta njerëz, që kanë pikëpamje ideologjike borgjeze, të ndihmohen ata që të bëhen qytetarë të mirë të Republikës. Qëndrimet oportuniste dhe sidomos në organet e prokurorisë, duke filluar që nga Prokuroria e Përgjithshme, favorizojnë ofensivën e armikut kundër pushtetit tonë, kundër organeve tona shtetërore. Nuk mundet të ketë autoritet shtetëror dhe ligje pa gjykata, pa prokurori dhe pa organe të punëve të brendshme. Po të mos shkojnë mirë këto organe, atëhere autoriteti shtetëror bie dhe armiku do të gjejë kështu shteg të lirë për ta mbytur demokracinë tonë popullore.

Në organet e drejtësisë ka pasur një oportunizëm të rrezikshëm, që synonte të godiste autoritetin e Partisë dhe të shtetit tonë. Duhet ditur dhe pasur mirë parasysh që, ndër ne, nuk mundet të ketë ligje dhe as gjyqe jashtë interesave të klasës punëtore. Ligjet në demokracinë tonë popullore bëhen që të mbrohen interesat e kësaj klase dhe të të gjitha masave të tjera punonjëse, për të shtypur me anën e tyre borgjezinë, e cila synon t'i pengojë në përparimin e tyre. Përkundrazi në shtetet kapitaliste ligjet janë për të mbrojtur interesat e borgjezisë në dëmin e masave punonjëse. Imperializmi me parullën false të «independencës së organeve të drejtësisë», kërkon të mbulojë ndërhyrjen e tij në punët e organeve të drejtësisë, po kjo në asnjë mënyrë nuk i përgjigjet realitetit dhe është një bluf i madh.

Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta zbulojmë armikun dhe ta goditim pa mëshirë që në vezë, pse kështu do t'i sjellim një fitore të madhe popullit dhe në këtë drejtim ne nuk duhet të jemi aspak dorëlëshuar e zemërgjerë dhe të interpretojmë ligjet formalisht.

Në Prokurorinë e Përgjithshme ka ekzistuar pikëpamja dhe është krijuar një frymë e tillë pas kongresit të Partisë sipas së cilës, gjoja ajo nuk është prekur nga puna e ngushtë armiqësore e Koçi Xoxes. Të thuash e të mendosh kështu në këtë situatë, kur të gjitha institucionet shtetërore i ishin nënshtruar kësaj influencë, nuk është e drejtë. Po të ishte Prokuroria e Përgjithshme në pozita të drejta kundër veprimtarisë së shtrembër e të dëmshme që bëhej atëhere nga ana e organeve të punëve të brendshme, atëhere ndryshon puna, por nuk ka ndodhur kështu. Prokuroria e Përgjithshme i nënshtrohej ndërhyrjes së Koçi Xoxes me shokë si dhe shumë organe të tjera. Ka pasur shokë në Prokurorinë e Përgjithshme që kanë kundërshtuar punën trockiste të Koçi Xoxes dhe shfaqjet arbitrare të organeve të sigurimit, të cilat ndiqnin atëhere një rrugë të gabuar. Por tani që Partia bëri kthesën dhe organet e Sigurimit të Shtetit janë vënë në rrugën e Partisë dhe punojnë mirë, disa shokë të prokurorisë mbajnë akoma pikëpamje të gabuara për organet e sigurimit, sikurse mbajnë edhe për Partinë, që gjoja ndërhyka dhe shkelka pavarësinë e gjyqeve.

Organet e Sigurimit të Shtetit, pas kongresit të Partisë, kanë punuar nën platformën e Komitetit Qendror dhe kanë bërë përparime të dukshme dhe në këtë

drejtim ato janë për t'u lavdëruar. Është merita e punonjësve të Sigurimit të Shtetit që kanë zbuluar edhe gjithë këto qëndrime oportuniste të organeve të prokurorisë dhe të gjykatave e në radhë të parë merita e shokut Mehmet Shehu që drejton Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili ja bën të ditur me kohë Partisë këtë gjendje të sëmurë në organet e drejtësisë. Për këto që kanë ngjarë do të informohet edhe Partia.

U fol këtu edhe për gabimet që janë dukur në zbatimin e një vije oportuniste nga gjykatat, por e keqja më e madhe është se këto gabime janë vërtetuar më shumë në organet e prokurorisë, ku janë pothuaj që të gjithë kuadrot drejtues anëtarë partie. Tani organeve të prokurorisë duhet t'u jepet ndihma e duhur e rëndësia që u përket dhe prokurorët të mos shihen, në asnjë mënyrë, si njerëz që kanë gabuar, sepse do të na ndodhë si pas kongresit të Partisë që, për një kohë, i shikonin organet e sigurimit me sy jo të mirë. Është e vërtetë ajo që u ngrit këtu se Partia nuk i ka ndihmuar sa duhet organet e prokurorisë dhe të gjykatave. Disa shokë sekretarë thanë se as prokurorët nuk u kanë shkuar për t'ua kërkuar këtë ndihmë. Kjo, natyrisht, do të ishte e mirë, por e domosdoshme është çështja që udhëheqja e Partisë në rreth të thërrasë prokurorin, trupin gjykues, trupin arësimor, njerëzit e artit dhe të kulturës, të vihet në kontakte me to dhe të futë në këta sektorë frymën e Partisë.

Le të marrim tani sektorin e kulturës. Ky sektor përpara shihej në mënyrë sektare, po kongresi i Partisë ndreqi në këtë drejtim shumë gabime që ishin bërë.

Në këtë sektor ka shumë elementë pa parti, ka bile njerëz që kanë qenë edhe me armikun, po që tani janë të dispozuar dhe duan të japin për Partinë dhe për popullin. Por nuk mund të themi se në këtë sektor është zbatuar plotësisht vija e Partisë, e përcaktuar drejt dhe që synon me i ndihmue dhe me i korrigjue njerëzit, me i mësue dhe me i sqarue ata. Në momentet e para, si në çdo drejtim, edhe në arësim e kulturë, ka pasur entuziazëm dhe shokët, të tërhequr nga ky, nuk kanë parë gabimet që bëheshin; kjo nuk është një gjë e mirë.

Le të marrim çështjen e shkrimtarëve. Në radhët e tyre ka nga ata që kanë qenë në pozita jo të shëndosha, ka të tillë që kanë qenë edhe në burg dhe u liruan. Por është e kuptueshme e duhet të dihet mirë se ata, që kanë qenë nëpër burgje, nuk janë të gjithë krejt të larë. Mbase në dhënjen e dënimeve ndaj tyre ka pasur ekzagjerime, por gjithnjë duhet pasur parasysh se mjaft nga ata diçka kanë pasur, prandaj Partia nuk bën mirë t'i harrojë këto gjëra. Por duhet t'i ndihmojë që të ndreqen e të mos përsëriten gabimet, siç u duk dhe në konferencën e shkrimtarëve¹. Disa nga këta njerëz përpiqen me arrivizmin e tyre të dalin në krye. Ka njerëz si Sejfulla Malëshova e ndonjë tjetër, të cilëve sa ju dha rasti, filluan të nxjerrin pikëpamjet edhe në shkrimet e tyre, duke i hedhur lule njëri-tjetrit, të shprehen me fjalë të bukura për njëri-tjetrin, siç po bëjnë Sejfulla Malëshova e Ymer Dishnica. Këta njerëz dolën «en bloc» si të organizuar në konferencën e

¹ Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë zhvilloi punimet në Tiranë më 9—12 tetor 1949.

shkrimtarëve, ata kritikuan haptas referatin, sepse në të ndaheshin shkrimtarët e vendit tonë në dysh: Në elementë që kanë qenë patriotë dhe me shkrimet e tyre i kanë shërbyer popullit dhe në elementë që u kanë shërbyer okupatorëve. Mirëpo Sejfulla Malëshova me shokë nuk janë dakord me këtë vijë, megjithëse e dinë fort mirë se kjo është edhe pikëpamja e Partisë. Ata përpiqen të ngrenë elementë antipopullorë si At Gjergj Fishtën e të tjerë të këtij lloji. Partia kësaj çështje i ka bërë një analizë dhe ka arritur në konkluzionin se, që të gjykohen veprat e një shkrimtari, bashkë me to, duhet të gjykohet edhe aktiviteti i tij politik. Kur shkrimtari është një reaksionar e agjent i shitur edhe vepra e tij nuk mund të jetë popullore, prandaj ajo nuk mund të lejohet për edukimin e rinisë, pse gjuha, vargu, ritmi dhe gjithë arti i tij, është përdorur për të përhapur ideologjinë e klasës që ai mbron. Një element i tillë ka qenë Fishta, i cili ka qenë shërbëtor i austriakëve, i italianëve dhe i Vatikanit dhe që më në fund vdiq akademik i Italisë fashiste. Fishta në veprat e tija nxit shovinizmin e popullit tonë në luftë kundër sllavëve. Këtë njeri antipopullor mbron Sejfulla Malëshova, pse me këtë mënyrë mendon të mbrojë veten e krijimet e tij letrare.

Edhe Sejfulla Malëshova ka bërë disa vjersha, por nga ana politike ky ka qenë një oportunist në shërbim të borgjezisë. Edhe sot e kësaj dite ai nuk i ka njohur gabimet e tij dhe këtë qëndrim e mban, sepse nuk është aspak marksist, megjithëse, me fjalë, pretendon të jetë i tillë dhe përdor shpesh fraza e parulla marksiste. Por njerëzit duken në punë sa japin dhe

çfarë japin. Sejfulla Malëshova gjatë luftës ka përkrahur Selahudin Toton dhe agjentë të tjerë të armiqve të vendit tonë, që i zbuloi vigjilenca e Partisë. Ai sot na del si përkrahës i Fishtës.

Sejfulla Malëshova ka atakuar vijën e Partisë nga të gjitha anët. Kështu edhe në fushën e letërsisë. Këto janë shfaqje kundër të cilave duhet të luftojmë. Shfaqje të tilla oportuniste në fushën e letërsisë dhe të artit ka pasur edhe në Bashkimin Sovjetik dhe që, siç e dini, ato i ka luftuar KQ i PK (b) të BS. Ka pasur edhe atje elementë armiq, që kanë dashur të godasin vijën e Partisë. Me një fjalë armiq të ne na sulmojnë nga të katër anët.

Partia jonë duhet të mobilizohet në çdo sektor që t'i aktivizojë njerëzit e letërsisë. Elementi anëtar partie në radhët e shkrimtarëve tanë duhet të bëhet i zoti, që kur të ngrihen njerëz të tillë si Sejfulla Malëshova, që godasin vijën e Partisë, të jenë në gjendje t'i luftojnë dhe t'i godasin dhe aty në vend të rrëzojnë tezat e tyre. Një gjë e tillë unë mendoj se mund të bëhet, mbasi nga shokët tanë ka njerëz më të zot se Sejfulla Malëshova, që hiqet sikur ka shumë haber nga këto gjëra. Prandaj, shokët tanë duhet t'i godasin pikëpamjet e tija të gabuara dhe oportuniste antiparti edhe në fushën e letërsisë dhe të artit.

Në konferencën e shkrimtarëve pati edhe ndonjë element, si S.L., që bërtiste të lejohej të fliste Sejfulla Malëshova se «te ne ka liri fjale». Tipa si ky kanë një kuptim borgjez për lirinë e fjalës dhe janë gati në cmër të saj të mbrojnë e të kënaqin interesat e tyre të ngushta prej intelektualit të sëmurë e arrivisti pa princip.

Del si detyrë për anëtarët e Partisë, që punojnë në çfarëdo sektor qoftë, që të mësojnë sa më shumë dhe të bëhen mjeshtrë të punës që u është ngarkuar dhe nga koha në kohë të duket përparimi i tyre. Kështu është edhe puna në shkollat dhe kudo ku punon Partia. Njerëzit tanë duhet të ngrihen ideologjikisht dhe të jenë gati për të luftuar, gjë që shokëve tanë kjo ngritje dhe kurajë u mungon, cave nga mosditja dhe cave nga modestia e tyre. Kur një tezë është e gabuar, ajo duhet të luftohet menjëherë nga shokët tanë. Lufta jonë është lufta në mes së resë, që rritet dhe zhvillohet dhe së vjetrës, që është në rënje dhe duhet të vdesë. E reja do të fitojë patjetër, prandaj edhe anëtari i Partisë duhet të luftojë me vendosmëri. Kur dy-tri vetë dalin dhe e kundërshtojnë vijën e drejtë të Partisë, kur e shoh se ata gabojnë dhe dëmtohet interesi i Partisë, atëhere komunisti duhet të luftojë me bindje dhe vendosmëri dhe të mos i frikësohet askujt, po ta demaskojë në kohën e duhur dhe ta vëjë në vend kundërshtarin, ndryshe pa një luftë të tillë ne humbim, sepse armiku na sulmon gjithnjë e ne duhet të luftojmë kudo me ashpërsi, qoftë pikëpamjet, qoftë parullat, qoftë veprimtarinë e tij.

Armiku përveç të tjerave na lufton edhe me anën e organizimit të tij duke krijuar banda. Tani në periudhën e dimrit ai do të mundohet të krijojë disa baza, të përgatitet për të bërë diçka në kohën e pranverës. Prandaj e gjithë Partia duhet të mobilizohet, që këto baza t'i shkatërrojmë, të mos i lëmë armikut t'i zënë këmbët dhe dhe në këtë drejtim po bëhet mjaft punë. Por përveç punës së organeve të Sigurimit të Shtetit, të cilat kanë pasur mjaft suksese në luftën kundër bandave,

duhet të jetë edhe puna e Partisë që të mobilizojë në radhë të parë anëtarët e saj dhe pastaj edhe mbarë masat e popullit kundër armiqve; të arrihet që anëtarët e Partisë të marrin pjesë edhe në luftë të armatosur kundër bandave. Në rrethin e Vlorës sidomos ka pasur anëtarë partie, që kanë mbajtur qëndrim shumë të mirë dhe kanë ndihmuar mjaft në luftën kundër bandave, kështu ndodh edhe në disa rrethe të tjera, veç në këtë drejtim duhet të aktivizohet edhe populli, të mobilizohet i tërë duke i bërë thirrje patriotizmit të tij.

Partia duhet të bëjë pastaj edhe një luftë të madhe politike dhe të mos e mbështetim punën tonë vetëm në marrjen e disa masave; këto të jenë të fundit, pse ne nuk duam që të futim njerëzit në burg, pse kështu i japim mundësi armikut të zgjerojë rrethin e tij. Ne duhet të bëjmë që armiku të ketë sa më pak njerëz ose më mirë aspak dhe kundër njerëzve që e ndihmojnë, të marrim masa shumë të rënda. Armiku duhet të goditet edhe me anën e propagandës dhe në këtë drejtim Partia të jetë vigjilente.

Byroja Politike ka orientuar edhe për qëndrimin që duhet të mbajë Partia në lidhje me klerin. Klerikët ashtu si të gjithë, duhet t'u binden ligjeve. Kjo do të thotë që këta njerëz (është fjala për klerin katolik) të njohin pushtetin popullor dhe të shkëputin marrëdhënjet me Vatikanin. Për të rregulluar çështjen e klerit po bëhet një ligj në bazë të të cilit masa e klerikëve duhet të zgjedhë vetë udhëheqjen, por, në bazë të ligjit që do të dalë, kjo udhëheqje, para se të fillojë nga puna, duhet të njihet nga shteti dhe t'u bindet ligjeve të Republikës. Por klerikët për këtë çështje bëjnë rezistencë.

Edhe në Çekosllovakia, Hungari, Poloni e gjetkë këto agjentura të Vatikanit kanë zhvilluar veprimtari armiqësore e kanë komplotuar për rrëzimin e pushtetit popullor. Prandaj nuk mundet të lejohet që agjencurat e Vatikanit të dobësojnë demokracinë tonë popullore. Për rregullimin e kësaj çështjeje në vendin tonë mundet të ketë klerikë popullorë që janë dakord, por kjo punë nuk është një gjë e lehtë, sepse feja nuk mundet të luftohet menjëherë, lufta kundër saj do të bëhet nëpërmjet një lufte të vazhdueshme revolucionare, duke luftuar në radhë të parë injorancën, me përhapjen e arësimit dhe të kulturës në masat e popullit.

Tani të kalojmë në çështjen e planit. Ky është problemi kryesor për ne, për realizimin e të cilit duhet të vihen të gjitha energjitë tona, pse realizimi i planit përfaqëson ngritjen e mirëqenjes së popullit. Sa më mirë e më shpejt që të realizohet plani, aq më mirë e më shpejt do të përmirësohet jeta e popullit. Përndryshe nuk do t'ja arrijmë kësaj dhe jeta e njerëzve tanë do të jetë e vështirë dhe për këtë do të jemi ne përgjegjës. Me realizimin e planit matet sa ka punuar Partia, me realizimin e planit matet edhe sa ka punuar çdo individ. Ne mund të themi se ka mjaft përparime në mobilizimin e Partisë për këtë çështje të madhe. Gjithashtu përpjekjet e udhëheqjes nga poshtë-lart kanë qenë dhe janë të mëdha. Edhe njerëzit që punojnë në sektorë shtetërorë duken që po bëjnë shumë përpjekje, kurse nga punëtorët po bëhen sakrifica të mëdha. Unë mendoj se njerëzit në bazë bëjnë më shumë përpjekje dhe sakrifica se sa këtu lart, prandaj ne duhet t'i njo-

him të metat e të mos kërkojmë vetëm nga të tjerët. Po të mos ketë organizim të mirë të punës në bazë, nuk ka si të thuhet që në qendër punët venë mirë. Po të interesohet koka si duhet, atëhere punët do të kryhen mirë kudo. Prandaj, në rast se shokët e bazës nuk ndihmohen, do të thotë se as ne nuk e kemi kryer de-tyrën. Këtu nuk përjashtohen gabime dhe të tilla ka kudo. Në planin tonë ka edhe gjëra që janë gabim, por të mos kuptohet tani se ai nuk u realizua, ngaqë është ireal; arësyeja është se nuk janë bërë studimet si duhet, megjithëse edhe këtë do ta shohim sa e vërtetë është, sepse këtu nuk është çështja për disa mosrealizime të vogla, por për disa sektorë, ku plani nuk është realizuar 50 për qind. Megjithatë, si të studjohen këto gjëra, atëhere do të sqarohet ku qëndron shkaku.

Planin e këtij viti ne e kemi bërë në kushte shumë të vështira. Byroja Politike dhe qeveria kanë bërë një gabim pse të gjitha dikastereve ato duhet t'u kishin vënë kuota të caktuara dhe me shumatat që do t'u jepeshin, secili duhet të bënte planin e vet. Po kjo nuk u bë, u muar plani i vjetër, që mbështetej mbi punën e jugosllavëve, pra, u punua në bazë të tij. Por edhe ky plan nuk mund të bëhej pa gabime, pse ne nuk dinim sa do të ishin kreditë që do të na jepnin miqtë. Kështu, pra, duke u bazuar në planin e përparshëm dhe në bazë të disa drejtimeve të dhëna nga Byroja Politike, Komisioni i Planit hartoi një plan në bazë të të cilit BRSS duhej të na jepte kredi deri në 120 milion rubla.¹ Këtë shifër Byroja Politike e ktheu, prandaj plani u ripunua

¹ Rubla të vjetra.

dy-tri herë. Kjo ndodhi për arësye se shokët e dikaste-reve të ndryshme patën bërë kërkesa të fryra, duke kërkuar materiale, që nuk ndodheshin as në BRSS. Ngandonjëherë bile, u veprua si në garë, kush të planifikonte më shumë kërkesa. Kjo na vështirësoi situatën dhe ne nuk qemë në gjendje të dallonim cila prej kërkesave kishte rëndësi dhe cila nuk kishte që të hiqej. Mbas gjithë këtyre veprimeve arritëm të bënim një plan më të reduktuar në bazë të të cilit parashikonim deri në 40 milion rubla kërkesë kredie nga Bashkimi Sovjetik.

Sovjetikët e studjuan kërkesën tonë dhe na dhanë 20 milion rubla kredi dhe jo për një kohë aq të shkurtër sa e kishim kërkuar ne, po për katër vjet. Me këtë ne muarëm një mësim, që do të na bëjë që tjetër herë t'i bëjmë llogaritë ndryshe. Kjo bëri që ne vetë në Moskë të bënim krasitje të mëdha në lidhje me të gjitha ndryshimet, që ju bënë parashikimeve tona. Sovjetikët na thanë se do të na dërgonin mallra konsumi në shkallën e shkëmbimeve tona. Kjo na detyroi t'u bënim shumë shkurtime kërkesave tona. Tani sa drejt u bënë këto veprime atje nga ne, që punuam mbi këtë plan, nuk dimë akoma. Në atë kohë situata jonë ishte shumë e vështirë, sepse shumë gjëra ne nuk i parashikuam mirë, kështu u lanë mjaft gjëra pa u porositur, në një kohë që në tregun tonë nuk kishte asgjë.

Në këtë kohë na duhej gjithashtu të vinim në zbatim edhe një numër urdhëresash të rëndësishme ekonomike, gjë që kërkonte patjetër të hidheshin në treg dhe një sasi plaçkash që të mund të zbatoheshin këto urdhëresa të reja. Ndihma që na u dha në këtë kohë,

na shërbeu shumë, sepse situata jonë ishte shumë e rëndë. Partia duhej të vinte kështu të gjitha forcat që të realizonte planin në këto kondita të vështira. Në këto kondita mosrealizimi i planit mund të justifikohet deri në një farë shkallë, por jo në një shkallë të tillë, siç na e ka paraqitur Ministria e Industrisë. Mund të kishte dhe ka, sigurisht, gjëra të paparashikuara, po jo të ishim kaq shumë pas në këtë sektor. Mirë të themi se çështjen e naftës nuk e pamë mirë, po të tjerat, që nuk kanë të bëjnë me studimet gjeologjike, përse nuk janë realizuar? Këto çështje ne do t'i shohim mirë, pse këtu kemi shumë gabime dhe të meta dhe nuk është e mjaftueshme të kalohet vetëm me një autokritikë, ashtu sa për të shkuar nga radha, po me një autokritikë shumë të shëndoshë dhe këto gjëra të na bëhen mësim, pse jemi shumë prapa me planin e detyrimeve të naftës dhe mallrave të tjera, që duhet t'u dërgonim BRSS dhe shteteve të tjera. Natyrisht, BRSS nuk do të na vërë thikën në grykë për këtë gjë, po duhet të dihet se nuk është aspak mirë që ne nuk jemi korrekt ndaj miqve. Nga ana tjetër ky mosrealizim do të influencojë edhe në planet e ardhshme. Këtë vit, ne jemi duke larë borxhet e 1948-s, mot do të lajmë të 1949-s, kurse në vitin 1951 do të fillojmë të paguajmë ratat¹ e kredive, që na janë dhënë, prandaj po të jetë se këto të meta dhe gabime nuk i ndreqim që në vitin e ardhshëm, punët për popullin tonë nuk do të shkojnë mirë, ai do të vuajë dhe për këtë jemi ne përgjegjës përpara tij.

1 Ajo pjesë e kredisë, që shlyhet sipas marrëveshjes së përfunduar kur është dhënë kredia.

Duhet thënë se punët në Ministrinë e Industrisë nuk kanë shkuar mirë dhe sektori kryesor atje është ai i naftës. Këtë çështje ne duhet ta jhohim mirë se Byroja Politike dhe Komiteti Qendror nuk mund të kënaqen nga këto që thotë Ministria e Industrisë. Të gjitha sa u thanë nga shokët e këtij dikasteri do të shikohen nga njerëz kompetentë. U tha se atje puna e jugosllavëve kishte ulur prodhimin, po përse këto gjëra nuk u muarën në konsideracion mbasi ikën jugosllavët dhe të kontrolloheshin pusët, që ishin vendosur shumë afër njëri-tjetrit etj? Këtu ka dhe mund të ketë akoma edhe gjëra të tjera, që janë shumë delikate, pse nuk mundet të merret me mend që një shtresë e pasur, siç është ajo e Patosit, të mbarohet brenda një viti. Edhe unë them dhe jam dakord se nafta nuk mund të nxirret pa specialistë, disa prej të cilëve dhe na janë vonuar në ardhje, po duhet menduar sa nevoja të mëdha ka gjithë kampi demokratik për specialistë të shumtë, që kërkohen nga Bashkimi Sovjetik e që do të na dërgohen edhe ne.

Çështja e naftës ka qenë preokupante për Byronë Politike, prandaj kjo çështje është marrë shumë herë në shqyrtim nga ana e saj. Por nga njerëzit e industrisë dhe të Kombinatit vajguror nuk na janë thënë më përpara këto që 'dolën këtu dhe që na i thoni tani, siç është ajo e mungesës së studimeve etj. Prandaj duhet që njerëzit e industrisë ta analizojnë dhe ta studjojnë mirë këtë çështje dhe t'i ndreqin gjërat. Në atë sektor ka punë armiqësore dhe këtë ne duhet ta zbulojmë, se është një situatë mjaft e vështirë. Pajo Islami tha këtu se në këtë gjendje ata nuk dinë çfarë të bëjnë, mbasi deficitin vjen duke u ngritur për çdo ditë dhe se ku do

të mbarojë ky defiçit, as ata vetë nuk dinë. Në mbledhjen e fundit Byroja Politike ka pranuar të gjitha defiçitet, që na thanë shokët e industrisë, kurse Pajua tani del e thotë se duhen bërë këto e ato, se ndryshe nuk ka mundësi të nxiten punëtorët për të shtuar prodhimin. Atje duhet të mobilizohen punëtorët në bazë të planit, që ata vetë e kanë propozuar dhe Byroja Politike e ka aprovuar. Çështja e Patosit katër—pesë herë është bërë shumë preokupante për ne dhe të thuash tani se si duhet bërë mobilizimi në të ardhshmen për realizimin e këtij plani, do të thotë që Partia atje punon në tymb, d.m.th. se Partia atje nuk është mobilizuar akoma. Nga të gjitha këto merret me mend se si e pse kanë vajtur punët kështu. Sigurisht që mosardhja e disa veglave ka influencuar në mosrealizimin e planit dhe në çmobilizimin e punëtorëve, po këtu fajin e ka koka, drejtuesit dhe jo punëtorët, nga të cilët kërkohet çdo gjë. Nuk duhet të shkohet nga parimi që të goditet më i dobëti, po të shihen drejt punët dhe atje ku janë bërë gabime, atje të bëhet edhe goditja.

Ministria e Industrisë ka edhe një favor tjetër që ka të gjitha ofiçinat në vartësinë e saj, por ajo nuk ka ditur ta shfrytëzojë këtë favor për shtimin e prodhimit. Janë dashur zinxhirë dhe për këtë gjë janë kërkuar të vijnë nga BRSS dhe mbas dy—tre muajsh me radhë këto kërkesa nuk u bënë më, pse u pa që ato bëheshin në ofiçinat tona. Kështu ndodhi edhe me çështjen e telit. Ne e kemi thënë shumë herë që duhet të bëhen shumë përpjekje nga njerëzit tanë që shumë gjëra t'i bëjmë vetë me forcat tona, me mundësitë dhe materialet që kemi në vend; gjithshka kemi vetëm se duhet të dimë

t'i shfrytëzojmë në maksimum, pse pa material nuk ecet përpara. Këtu nuk është çështja për lëndë të parë për filaturë, për automobila, goma e materiale të tjera, që nuk ka mundësi të bëhen në vend dhe mosardhja e tyre vërtet na pengon, por është fjala për ato gjëra që, me disa përpjekje, ne mund t'i bëjmë këtu.

Përsa u përket gomave, ne nuk e shohim çështjen ashtu si u ngrit këtu në diskutime. Është e vërtetë se transporti një muaj të tërë u mobilizua për lëvizjen e trupave, por nuk mund të pranohet mosrealizimi i planit të kromit për tërë vitin, sepse, në kohën që vinin kamionat nga Korça bosh, ne i thamë me kohë Ministrisë së Industrisë, po nuk u bë gjë, kromi nuk ngarkohej, se atje puna nuk ishte e organizuar mirë dhe shpejt; mbaheshin kamionat kot me orë të tëra, pa bërë asgjësendi, kështu ngarkimi bëhej me ngadalësi. Këto gjëra duhej të ishin menduar mirë se, po të punohet në këtë mënyrë, pa menduar për organizimin e punës dhe për shfrytëzimin në maksimum të transportit, atëhere, sigurisht, planet tona nuk mund dhe s'ka se si të realizohen. Prandaj, të gjejmë sëmundjen, të shohim ku çalon puna, ndryshe nuk kemi si të shkojmë përpara.

Ja, për shembull, përse u realizua plani në minierën e Selenicës? Edhe atje plani përpara nuk realizohej dhe për këtë kishte plot justifikime, duke u ngritur me forcë sidomos çështja se mungonin rezervat. Nga kjo gjë qeveria u vu në pozita të vështira me vendet e demokracisë popullore, se ato i kanë realizuar 80 për qind detyrimet që kanë marrë përsipër ndaj nesh deri tani, kurse ne nuk kemi eksportuar për te ato, sipas angazhimeve që kemi marrë, as 20 për qind të tyre. Atëhere

qeveria vendosi të dërgojë një brigadë nga të rinisë në Selenicë dhe ja që me vajtjen dhe me mobilizimin e të rinjve, plani u realizua.

Në Ministrinë e Industrisë ka një mungesë të theksuar operativiteti. Nga ana tjetër ministria i ka pranuar të gjitha raportet që i vijnë nga poshtë. Drejtuesit duhet të kenë besim te vartësit e tyre, po duhet edhe t'i kontrollojnë, pse kështu punët do të venë më mirë. Në industri ka munguar kontrolli. Çështja e industrisë ka qenë dhe është akoma delikate, pse nga realizimi i planit në këtë sektor, varet shumica e eksportimeve tona, në të cilat ne jemi shumë pas për këtë vit. Duhet të dënohet pikëpamja e drejtuesve të industrisë se nafta nuk do të realizohet as për dyvjeçarin. Kjo është shfaqje disfatizmi. Është e vërtetë se për ta realizuar planin në këtë sektor, duhet të kemi disa materiale dhe kjo gjendje, që kemi pasur sivjet, duhet të na bëjë të mësojmë shumë. Miqve ne do t'u themi për të metat tona në mosrealizimin e angazhimeve të marrura ndaj tyre dhe për këtë nuk duhet të na vijë zor, por duhet të bëjmë që tani përpjekje që planin e vitit 1950 ta realizojmë në mos 100 për qind, të jemi aty afër. Të dihet që më përpara sa do të jetë deficiti i mundshëm. Po të punojmë kështu, me parashikime dhe të marrim masat për çdo gjë me kohë, atëhere do të jemi në gjendje të realizojmë më mirë planet, të përmirësojmë shpejt jetën e popullit tonë, ta ngremë standardin e jetesës së tij. Po këtu duhet të bëhen përpjekje të mëdha që të thyejmë rezistencën, që na paraqitet nga ata që thonë se nuk ka mundësi realizimi.

Cili ishte mendimi juaj kur qeveria caktoi fondin

e grumbullimeve të drithërave për këtë vit? Të gjithë ju, shokë sekretarë, e kundërshtuat atë, e kundërshtoi edhe vetë Ministria e Bujqësisë. Një situatë e tillë është reflektuar edhe në bazë, pse ju jeni bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara. Por nuk ndodhi ashtu. Plani u realizua dhe u realizua pa marrë masa shtërguese ndaj fshatarëve. Kjo do të thotë se Partia punoi me besim dhe kjo është një gjë pozitive për Partinë. Plani i është afruar tani shumë realizimit. Ne mund të kemi bërë edhe gabime gjatë hartimit të planit, po ky në grumbullimet nuk është realizuar vetëm 12 deri 15 për qind, po jo dhe 40 për qind, sikurse ndodh në sektorin e industrisë; në këtë rast na jepet mundësia të bëjmë edhe korrigjime.

Përsa i përket industrisë duhet të bëhen përpjekje të mëdha sidomos gjatë këtyre dy muajve që na mbeten; të kemi besim të madh në planet që kemi hartuar, se me një punë të organizuar më mirë, mund të ulet më shumë deficitin ose të paktën të qëndrojmë në shifrat që na ka dhënë Ministria e Industrisë, megjithëse Byroja Politike nuk është e bindur aspak në ato. Kështu duhet t'i kuptojë gjërat shoku Pajo Islami, prandaj Partia të mobilizohet më shumë në sektorin e naftës. Atje duhet të bëhen gara, të caktohen flamurë dhe të përdoren të gjitha format e emulacionit.

Ku mbështetet Partia, kur thotë që ne kemi përparime në punën tonë, megjithëse planin nuk e kemi realizuar? Ajo është mbështetur në faktin që në qendrat e tjera të prodhimit është dukur një shpirt i lartë sakrifice, emulacioni është organizuar mirë dhe bëhen përpjekje të mëdha në punë. Kështu ndodh edhe në indus-

trinë e lehtë. Në këtë sektor nuk ka pasur arësye që të na jetë dashur shumë material nga jashtë, por mosrealizimi ka ndodhur ngaqë këtu ka pasur shumë neglizhenca. Le të marrim si shembull gjendjen e disa ndërmarrjeve. Ato përpara shkonin shumë keq nga ana e drejtimit dhe kishin shumë mosmarrëveshje me financën, pse kjo u pengonte fondet, kur nuk kryenin angazhimet e marrura ndaj financës së shtetit. Për këtë gjë shumë dikastere u revoltuan, mbasi financa i pengonte, nuk u jepte fonde për të paguar rrogat e punëtorëve. Por tani nuk kemi dëgjuar të na vijnë më ankime për këtë çështje; duket se kjo gjë u vu në rrugë të mirë. Më përpara, në fabrikën e çimentos, mbeteshin shumë gjëra pa u realizuar, se nuk kishte transport, mirëpo kur dërgoheshin mjetet, thoshin «nuk kemi si të ngarkojmë, sepse nuk kemi ambalazh» dhe mjetet ktheheshin bosh; kështu nuk realizoheshin fondet e ndërmarrjes. Po tani puna nuk vete aq keq si përpara, sepse kjo çështje u vu në rrugë. Nga kjo kuptojmë se shokët që drejtojnë, pranojnë me shumë zor masat e rregullat që vihen për të mirën e punës. Këto gjëra ndodhnin atëhere, sepse Ministria e Industrisë nuk interesohet si duhet, por rregullat që vihen duhet të zbatohen, se kështu do të kapërcehen vështirësitë, se pa këto rregulla, ka shumë mundësi që njerëzit, prapa këtyre mungesave, të fshehin të metat dhe gabimet e tyre. Po këto gjëra do të eliminohen. Gabimet duhen goditur dhe përgjegjësia është e madhe, po nuk u bënë përpjekje për zhdukjen e tyre.

Një sektor tjetër, që nuk është në rregull, është ai i bujqësisë. Natyra e punës në këtë sektor është më e

zorshme, pse ke të bësh me pronën private të fshatarësisë, por po të jetë drejtimi i shëndoshë, këto gjëra gjejnë zgjidhje. Punët në bujqësi kanë gjetur një farë rruge, po ato nuk janë akoma në vijën që duhet. Duke ditur se problemet e bujqësisë janë të vështira duhet të bëhen shumë përpjekje që të zgjidhen mirë dhe të ecet më mirë, ngadalë dhe në baza të shëndosha se sa të ecet shpejt dhe t'i kemi gjithnjë si probleme të pazgjidhura. Ja, për shembull, çështja e kadastrës duhet të fillohet që tani, të bëhet pak nga pak, e studjuar mirë dhe të mbarohet pas disa vjetësh. Fermat tona duhet të përparojnë. Aty të vihen si duhet në zbatim metodat më të mira agroteknike, që kemi mundësi t'i zbatojmë. Të bëhet që fermat të jenë shembull në çdo drejtim dhe të mos ndodhë që në fermat, si tani, ashtu edhe në kooperativat bujqësore, të ketë deficite. Në këto ndërmarrje bujqësore nga viti në vit duhet të kemi përparime të dukshme; këto masa merren për të përmirësuar jetën dhe jo për të pasur deficite e për ta rënduar gjendjen. I them këto, sepse po shoh që çështjet nuk po gjejnë zgjidhjen e duhur nga organet e bujqësisë dhe fermat e kooperativat bujqësore. Në vend që këto të shkojnë shumë mirë e të ndihmojnë në ngritjen e ekonomisë dhe të bëhen shembull edhe për fshatarët, ato nuk shkojnë si duhet. Drejtuesit e bujqësisë duhet të kenë shumë më tepër gjallëri dhe plani i bujqësisë duhet të realizohet, mbasi ky sektor ka lidhje të ngushtë me bukën e popullit dhe me furnizimin e industrisë me lëndë të parë, që duhet të sigurohet nga sektori i bujqësisë.

Ne po ndërtojmë kombinatë dhe fabrika të reja,

të cilat për t'u vënë në funksionim, kanë nevojë për lëndë të parë, për të cilën Ministria e Bujqësisë duhet të mendojë me kohë që ta sigurojë. Sjellja e kësaj lënde nga jashtë është shumë e vështirë, ajo nuk gjendet kollaj dhe vetë shtetet e demokracisë popullore e sjellin nga vendet kapitaliste. Ne nga këto vende nuk mund të marrim, pse si këmbim na kërkojnë material strategjik, që nuk duhet t'u jepet në asnjë mënyrë. Prandaj kjo çështje e sidomos ajo e pambukut, duhet të shtrohet me gjithë seriozitetin e duhur nga ana e Ministrisë së Bujqësisë. Duhet të bëhen shumë përpjekje, sepse fshatarët nuk binden kollaj, prandaj këtu duhet një kujdes i veçantë edhe nga vetë Partia. Plani i drithërave të bukës duhet të realizohet, po ashtu edhe ai i kanalizimeve dhe i bonifikimeve dhe në këtë punë nuk duhet të ketë më justifikime; të arrijmë që fati i misrit dhe i grurit tonë, të mos varet 80 për qind nga shiu, por nga puna jonë; ndryshe nuk mund të ecet përpara në përmirësimin e jetës së popullit.

Urdhëresat e reja, që janë vënë në zbatim, janë të drejta. Megjithëse në fillim ka pasur rezistencë, rezultatet e para në këtë drejtim po duken dhe janë të kënaqshme. Gjendja e tregut po përmirësohet dhe në të ardhshmen do të përmirësohet akoma më shumë. Një gjë e tillë do të ketë efekt në të gjitha punët tona, si në forcimin e gjendjes politike, ashtu edhe në lidhje me realizimin e planit. Tani që i sheh rezultatet e këtyre urdhërësive, populli ka filluar të thotë se qeveria nuk e kishte gabim që vuri në zbatim masa të tilla, prandaj këtë situatë të mos e lëmë të na ikë nga dora, po ta mbajmë gjallë. Vetëm të mbahet parasysh që një për-

mirësim i tillë në Tiranë, nuk duhet të bëhet në kurriz të qyteteve të tjera. Tani që u përmirësua gjendja në Tiranë, të qëndrohet e të forcohen këto pozita, por të shihet që të përmirësohet gjendja edhe jashtë kryeqytetit. Me punën tonë të arrijmë që fshatarëve t'u shesim sa më shumë mallra, pse duke blerë, ata do të kënaqin kërkesat e tyre dhe do të fillojnë të nxjerrin sa më shumë mallra në treg; kështu ata do të përparojnë edhe më shumë.

Huaja e parë shtetërore, që shpalli shteti, ka një rëndësi të madhe, si nga ana politike, pse e rrit patriotizmin në radhët e masave, që japin para për ndërtimin e vendit, ashtu edhe për faktin se fshatarët i japin shtetit një sasi të mirë të hollash, gjë që ndihmon forcimin e monedhës së vendit dhe të arkës së shtetit. Partia duhet të mobilizohet edhe për realizimin e tati-meve bujqësore, për grumbullimin e misrit, të grurit, të leshit, të vezëve etj. Në këtë mënyrë do të përmirësohet gjendja e tregut, prandaj edhe nga realizimi i mirë dhe në kohë i të gjitha këtyre detyrave, fjala e Partisë do të dëgjohet më mirë. Një gjendje e tillë do të influencojë edhe në realizimin e shpejtë të planit. Duhet të shfrytëzohet sa më shumë kapaciteti i ndërmarrjeve tona ekonomike, që të ketë sa më shumë gjëra në treg, ku do të ketë gjallëri më të madhe. Atëhere edhe fshatari, po të ketë më shumë plaçka në treg, do të ketë dëshirë të sjellë më shumë gjëra për shitje në treg. Tani këto gjëra kanë hyrë në rrugë, po duhet të bëhen më shumë përpjekje, në radhë të parë nga Ministria e Tregëtisë, nga Komiteti i Grumbullimeve dhe nga i gjithë aparati i Partisë. Nga vetë Partia

duhet të ketë një mobilizim sa më të madh për këto probleme.

Përse i përket sigurimit të fuqisë punëtore ne duhet të marrim masa të shpejta që të përmirësohet gjendja e punëtorëve në qendrat e punës, ndryshe nuk mund të kemi punëtorë stabil. Në qendrat e punës përgjithësisht thuhet se nuk ka punëtorë. Shokët tanë janë shumë burokratë dhe sektarë lidhur me plotësimin e numrit të punëtorëve dhe të nevojave të tyre. Po si mund të rrinë punëtorët atje në këtë gjendje që është; asgjë nuk ka se çfarë ta tërheqë fshatarin që të shkëputet nga fshati e të vijë këtu dhe kjo ndodh se në shtëpinë e tij ai e ka gjendjen më të mirë. Çështja e mungesës së punëtorëve në sharrat e Pukës ka dy-tre vjet që është bërë problem preokupant. Përse të mos bëhen atje baraka për të banuar punëtorët, kurse ne kemi dërrasa dhe gozhdë, të cilat në radhë të parë të dërgohen atje, pastaj për nevojat e popullit. Po t'u lihen këto punë punëtorëve, ata janë në gjendje të bëjnë shumë gjëra vetë dhe kanë më shumë inisiativë nga shokët tanë.

Duke marrë parasysh gjendjen tonë, nuk duhet të pretendojmë të bëjmë pallate për punëtorët, por në fillim mjaftojnë disa baraka dhe pastaj të bëjmë ndërtime të tjera më të mira, po të mundemi t'i bëjmë, e duhet t'i bëjmë. Këtyre gjërave ne duhet t'u japim prioritet. Me forcë, ne nuk mund të arrijmë në rezultate të kënaqshme për sigurimin e fuqisë punëtore. Traditat e popullit nuk thyhen dot kollaj, nuk është punë aq e lehtë të shkulet malësori nga vendi i tij. Prandaj, këtu duhen marrë masa për përmirësimin e kushteve të

jetesës të punëtorëve, të bëhet një punë e madhe politike që të tërheqim punëtorët e nevojshëm në qendrat e punës. Ne duhet t'i krijojmë punëtorit një ambient sa më të kënaqshëm e aq sa na lejojnë mundësitë tona dhe të mos shkojmë me mendimin se meqë ai nuk i ka konditat më të mira në fshat, të mos tregojmë kujdesin e duhur për këtë çështje të rëndësishme. Nga ana tjetër, kur të vijne punëtorët e rinj në qendrat e punës, shokët që punojnë atje, të ndihmuar edhe nga Partia, duhet të dinë t'i mbajnë mirë, të udhëzohen punëtorët e vjetër që t'u japin përkrahje shokëve të tyre të rinj dhe kur mundet, drejtoria t'u bëjë atyre ndonjë përkrahje si në veshje, në banim ose në ndonjë drejtim tjetër dhe kjo, po t'u shpjegohet punëtorëve më të vjetër që ta kuptojnë këtë gjë, ata nuk do të thonë asgjë dhe nuk do t'u vijë keq, por me gjithë zemër do të pranojnë të rrinë vetë pa to, vetëm të kenë shokë të rinj. Ministrinë në këtë drejtim duhet të kenë më shumë inisiativë, po ashtu edhe Komisioni i Planit. Është e drejtë që ne duhet të bëjmë sa më shumë kursime, por në këtë situatë të vështirë që jemi për sigurimin e fuqisë punëtore, ne duhet të bëjmë disa koncesione si p.sh. të mos u merren qira të mëdha, në çështjen e mensave të tregohet kujdes që të mos ngrihen çmimet. Në këto nuk duhet të synohet për të marrë fitime, por ushqimin ta paguajnë në kosto. Derisa të përmirësohet situata, pra, ata të kenë favorizime në qira, në dritë elektrike, në ujë etj. Veç këtyre, për punëtorët që gabojnë dhe dëmtojnë ekonominë pa qëllim, duhet të bëhet një punë sa më e gjerë politike, të përdorim rrugën e bindjes dhe vetëm kur të jenë përdorur të gjitha këto masa, atëhere

të merren masa administrative, të zbatohen mirë ligjet. Por, para se të arrihet këtu, duhet të bëhet shumë punë nga njerëzit tanë, pse nuk i delet mbanë punës me procedime; me masa nuk mundet të zgjidhen gjithë këto probleme me rëndësi që kemi përpara dhe gjithë punonjësit duhet t'i bëjmë patriotë të mirë, që t'u dhimbset gjëja e popullit e të mësohen ta mbrojnë.

Një gjë tjetër, që duhet të rregullohet, është edhe çështja e mbledhjeve, të cilat duhet të shkurtohen sa më shumë. Ne kemi një të metë, që mbledhjet i bëjmë të gjata. Edhe për fjalimet po këtë mani kemi. Partia duhet t'i mësojë njerëzit që të çmojnë kohën, të flasin shkurt, se edhe duke u zgjatur çështjet ndërlikohen më shumë dhe puna nuk bëhet mirë. Po të bëhen mbledhje të gjata, atëhere nuk ke mundësi të bësh as agjitacion, pse njerëzit do të preokupohen me hartimin e raporteve të gjata dhe kështu çështjet e tjera do të lihen mbas dore. Shokët tanë në këtë drejtim, duhet të bëjnë përpjekje dhe vetë Komiteti Qendror të japë shembullin i pari. E them këtë, se që këtu duhet të japim shembull, sepse në bazë dërgojmë shumë gjëra dhe njerëzit i preokupojmë gjatë aq sa nuk u lëmë kohë as të çlodhen. Njeriu ka nevojë dhe të çlodhet, të studjojë, të vejë në kinema dhe t'i mbetet ca kohë që të merret edhe me familjen. Partia duhet t'i studjojë dhe t'i ketë parasysh këto gjëra. Ka anëtarë partie, që nuk janë të vendosur, po ka dhe të tillë, që nuk e kuptojnë gjendjen dhe nuk flasin fare, kur shohin se punët nuk shkojnë mirë. Nga organet e Komitetit Qendror të studjohet mirë që poshtë të venë vetëm ato gjëra, që me të vërtetë vlejnë të shkojnë dhe të mos preokupohen

shokët në bazë edhe për gjëra fare të vogla. Nga ana tjetër, duhet t'u lihet më shumë inisiativë shokëve, sepse sekretarët e Partisë në rrethe janë personalitete të Partisë dhe nuk është mirë që ata çdo gjë ta presin nga lart. Me këtë mënyrë nuk mundet të kryhen shumë punë në kohën e duhur.

Shumë kujdes të kemi në çështjen e përjashtimeve nga Partia, të mos bëjmë pastrime pa vend, të përjashtojme me të vërtetë njerëzit, që nuk meritojnë të jenë në Parti. Cilët janë këta, do ta tregojë puna, që do të bëjë secili, se njerëzit duken në punë. Kështu që duhet të tregohet kujdes e të mos nxirren nga Partia njerëz të thjeshtë nga shtresa punëtorësh dhe fshatarësh të varfër, që e duan Partinë, e cila duhet dhe e ka për detyrë t'i edukojë. Elementët e tjerë duhet të pastrohen, d.m.th. ata që nuk vlejnë për Partinë. Por kujdes të madh duhet të kemi në çështjen e punëtorëve, si në pranimin e tyre në Parti, ashtu edhe në përjashtimin e tyre nga Partia. Bile Byroja Politike, duke i dhënë rëndësi të madhe çështjes së shtimit të radhëve të Partisë me punëtorë, ka vendosur që përjashtimi i tyre, të mos vendoset nga komitetet e rretheve, po nga vetë Sekretariati i Komitetit Qendror.

Ky hov dhe mobilizim, që është dukur muajt e fundit, duhet të shtohet dhe më shumë akoma dhe në radhë të parë nga të gjithë njerëzit e Partisë. Ata duhet të jenë kurdoherë në krye të punëve dhe të jenë të palodhur.

Përsa i përket kthesës që bëri Partia pas Kongresit I ajo ka qenë një kthesë rrënjësore, puna trockiste u mposht dhe përgjegjësit e saj kryesorë muarën godit-

jen. Baza e Partisë ishte e shëndoshë, po zbulimi i kësaj pune e çelnikosi më shumë atë dhe udhëheqjen, pse në krye erdhën njerëzit më të mirë, të zgjedhur demokratikisht nga kongresi i Partisë. Pastaj u bënë konferencat e Partisë në rrethe ku pati mjaft luftë dhe njerëzit u shoshitën mirë, sido që pati edhe gabime, të cilat po ndreqen vazhdimisht. Kjo punë bëri që Partia të mposhtë këtë rrezik dhe ne këtu patëm mjaft sukses. Sukses ne patëm edhe në çështjen e forcimit të gatishmërisë luftarake të ushtrisë dhe kjo u provua në kohën më të rrezikshme të provokacioneve të mëdha të gushtit që ju bënë vendit tonë nga ana e Greqisë. Këtu nuk pati asnjë lëkundje në kuadrot ushtarake, të cilët luftuan heroikisht. Kjo do të thotë se puna trockiste aty u pastrua dhe tani nuk përbën më një rrezik për Partinë tonë. Edhe populli e ka parë që është bërë një kthesë rrënjësore. Për Partinë puna e këtij viti ishte kolosale. U bënë zgjedhjet e pushtetit dhe të Partisë, u bë ndarja e re administrative, u bënë gjithë këto lëvizje të mëdha kuadrosh, duke u vënë secili sa ishte e mundur, në vendin e tij. Në këtë çështje mundet të ketë edhe lëvizje pa vend, po këto do të ndreqen. Partia ka marrë masa shumë të rëndësishme dhe tani ajo me siguri mund të ecë përpara. Në këtë situatë, kaq të vështirë nga ana ndërkombëtare, të rrethuar nga armiq, Greqia nuk ka munguar të bëjë provokacione të vazhdueshme, jo vetëm po ka pasur edhe qëllim të hynte brenda vendit tonë, po një gjë të tillë nuk e arriti, në saje të ushtrisë sonë dhe të patriotizmit të masave të popullit. Në këtë drejtim, pra, është bërë një kthesë shumë e fortë dhe bolshevike, Partia është çelnikosur,

por nuk duhet harruar se Partia ka armiq jashtë dhe të fshehur brenda radhëve të saja, që duhet t'i zbulojmë, t'i luftojmë. Si përfundim unë them se kthesa është bërë në mënyrë rrënjësore dhe bolshevike dhe këtë situatë ne do ta forcojmë dita-ditës.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arhivin Qendror të Partisë, me disa shkurtime

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT
MAO CE DUN ME RASTIN E FORMIMIT TË
RP TË KINËS**

19 tetor 1949

**SHOKUT MAO CE DUN
KRYETAR I QEVERISË POPULLORE QENDRORE TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS**

P e k i n

Në emër të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe timin personal, Ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet më të sinqerta për formimin e Republikës Popullore të Kinës.

Populli ynë liridashës ka ndjekur me interesim të veçantë luftën legjendare të popullit heroik kinez dhe ushqen për të dhe për Partinë e tij Komuniste një miqësi të sinqertë, të cilën do ta ruajë dhe do ta forcojë gjithnjë e më tepër.

Fitoret e mëdha të luftës suaj dhe formimi i Republikës Popullore të Kinës, që sollën shkëputjen e vendit tuaj të madh nga zinxhirët skllavërues të feudalizmit dhe të imperializmit, i japin një hov edhe më të madh luftës së popujve për çlirimin nacional dhe përbëjnë

edhe një provë tjetër të shkëlqyer se forcat e paqes, të demokracisë e të socializmit janë të pathyeshme dhe se ato, me në krye popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, do të triumfojnë gjithmonë e kudo në botë.

Ju uroj edhe një herë për triumfin e plotë të revolucionit tuaj popullor dhe për ndërtimin e socializmit në Republikën Popullore të Kinës.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
RP të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 251 (324), 19 tetor 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 251 (324),
19 tetor 1949*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR OTO GROTEVOLIT
ME RASTIN E FORMIMIT TË RD GJERMANE**

20 tetor 1949

**ZOTIT OTO GROTEVOL,
KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS DEMOKRATIKE GJERMANE**

Berlin

Me rastin e formimit të Republikës Demokratike Gjermane dhe të zgjedhjes Suaj si Kryeministër, kam nderin t'Ju drejtoj Juve dhe popullit gjerman urimet më të përzemërta.

Populli shqiptar dhe qeveria e tij, si gjithë popujt e tjerë liridashës dhe demokratë, e pritën me gëzim të madh dhe simpati formimin e Republikës Demokratike Gjermane, si një fitore të madhe dhe të rëndësishme për ndërtimin e një Gjermanie të unifikuar dhe demokratike.

Me këtë fitore populli gjerman radhitet me vendosmëri me kampin e fuqishëm të paqes dhe të demokracisë, që ka në krye mbrojtësin e popujve liridashës,

Bashkimin e madh Sovjetik dhe u jep një grusht imperialistëve, të cilët kanë për qëllim të ndezin një luftë të re.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
RP të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 253 (326), 21 tetor 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 253 (326),
21 tetor 1949*

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E DYTË TË SINDIKATAVE¹

23 tetor 1949

Shokë dhe shoqe të dashura,

Komiteti Qendror i Partisë sonë më ka ngarkuar t'ju sjell pjesëmarrësve të kongresit tuaj dhe nëpërmjet jush klasës heroike punëtore dhe masave punonjëse të vendit, përshëndetjet më të përzemërta dhe më të nxehta dhe t'ju uroj suksese kurdoherë më të mëdha në rrugën e ndritur, ku na udhëheq Partia jonë e dashur.

Sot gëzon i gjithë populli ynë dhe shtërngon më fort radhët e tija rreth Partisë, e cila në çdo etapë të revolucionit popullor triumfoi mbi armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm dhe kapërceu me sukses vështirësitë, që i dolën në rrugën për fitoren e madhe të çlirimit, për vendosjen e diktaturës së demokracisë popullore dhe tani në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Sot klasa jonë punëtore dhe të gjitha masat punonjëse të Shqipërisë, që kanë dërguar delegatët e tyre në këtë kongres, kujtojnë të kaluarën e hidhur të po-

¹ Që nga ky kongres, sindikatat u quajtën Bashkimet Profesionale të Shqipërisë.

pullit dhe të atdheut tonë: mjerimet, vuajtjet, urinë, skllavërinë, që nuk do të kthehen kurrë më dhe nga ana tjetër ata gëzojnë të tanishmen: lirinë, pavarësinë, gëzojnë pushtetin e tyre popullor që e ngritën me luftë dhe me sakrifica të mëdha, gëzojnë se ndërtojnë me duart dhe me diturinë e tyre një të ardhshme më të mirë. Populli ynë kaloi nga errësira në dritë dhe nga skllavëria, ku e mbanin regjimet e errëta antipopullore e feudalo-borgjeze dhe, nëpërmjet luftës legjendare të çlirimit, ai mposhti përgjithmonë armiqtë e klasës, mori fuqinë në dorë dhe u bë zot i fateve të tij.

Këto fitore të shkëlqyera, ai ja detyron Partisë së tij heroike, e cila, e frymëzuar nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe duke mbajtur kurdoherë lart dhe të papërkulur flamurin e internacionalizmit proletar, e udhëhoqi popullin në rrugën e shpëtimit dhe sot e udhëhoq në rrugën e socializmit. Këto fitore ja detyron luftës legjendare të popujve sovjetikë nën udhëheqjen e Stalinit të madh kundër agresorëve fashistë.

Fitoret tona janë të mëdha, ato janë politike dhe ekonomike. Ekzistenca dhe fatet e një populli varen nga kush i mban në dorë dhe në interes të cilës klasë përdoren këto fitore. Armët politike dhe ekonomike, që përbëjnë forcën e një shteti në vendin tonë i përkasin popullit, i përkasin shumicës. Lufta e madhe në prodhim, puna e palodhur për të zotëruar dhe për të shfrytëzuar pasuritë e natyrës, që përbëjnë burimet ekonomike, janë fruti i përpjekjeve, i luftës, i punës së masave të gjera punonjëse. Këto armë dhe këto frute ja kishin rrëmbyer popullit tonë feudalët, bejlerët, borgjezia e pasur tregëtare dhe përfaqësuesi i tyre mbreti

Zog. Po a mund të përjetësohet shtypja e popujve nga ana e kapitalit? Vallë zinxhirët, që ka farkëtuar imperializmi për të mbajtur nën zgjedhë popujt e botës, janë të pakëputshëm? Jo. Ata nuk janë të përjetshëm dhe as të pathyeshëm. Mësuesit e mëdhenj të proletariatit Marks, Engels, Lenin, Stalin, i vunë në dorë proletariatit të përbotshëm armën e mprehtë të revolucionit, teorinë shkencore marksiste-leniniste, e cila ka bërë të mposhtet kapitali në një pjesë të madhe të botës dhe të shpejtohet zhdukja e imperializmit që po kalbet. Në një të gjashtën e botës Bashkimi Sovjetik mposhti kapitalizmin dhe atje u ngrit shteti i parë socialist. Në saje të ekzistencës e të ndihmës së Bashkimit Sovjetik triumfuan popujt në vendet e demokracive popullore. Populli i madh e heroik i Kinës u shkëput përgjithmonë nga thonjtë e imperializmit. E ardhshmja u përket popujve përparimtarë.

Me fitue me revolucion dhe me luftë çka është e drejta jote, sikundër bëri populli ynë, do të thotë të shpëtosh përgjithmonë nga hallet. Shqipëria jonë shpëtoi dhe ajo s'është më në mëshirën e shteteve imperialiste dhe të politikës mercenare të njerëzve antipullorë.

Populli rronte në mjerim të madh para lufte, ai shfrytëzohej pa mëshirë. Punëtorët dhe fshatarët ishin në mëshirën e beut, të agait dhe të punëdhënësit. Djersa e tyre transformohej në flori, që mbushte xhepin e njerëzve të regjimit të Zogut dhe për punëtorin, bujkun, punonjësit e Shqipërisë nuk kishte veçse mundime, lodhje, uri dhe kërbaç. Sunduesit feudalo-borgjezë ishin si përfaqësuesit tipikë të mesjetës, por me ndryshimin

se rronin dhe shtypnin popullin në shekullin XX. Në regjimin e Zogut dhe nën fashizmin jo vetëm që nga fshatari ynë nuk njihej as emri i traktorit, por ai nuk njihte dhe nuk i jepej asnjë mundësi të ndërronte parrmendën e tij të drunjtë me një parrmendë prej hekuri. Format moderne të punimit të tokës ishin të panjohura për të. Fshatari rronte në mjerimin më të madh, tokën ja kishin rrëmbyer të tjerët bashkë me prodhimet e saj dhe çifliqet e tokat tok me bujqit kalonin nga duart e bejlerëve myflizë¹ në duart e borgjezisë tregëtare, sikur këta të ishin kafshë pune. Për fshatarin s'kishte shkollë dhe dituri, kurse sëmundje dhe vdekje po, bile me shumicë. Për punëtorët tanë shtypja dhe vuajtjet ishin të pandara nga jeta e tyre. Në dyqanet e errëta të padronëve, ata punonin gjithë ditën të kërrusur e nuk arrinin të fitonin as kafshatën e gojës, punonin në ndërtime rrugësh ose në punishtet e kapitalistëve vetëm për disa lekë në ditë. Asnjë gëzim dhe asnjë siguri nuk ekzistonte për ta. Kur u hapën disa miniera nga italianët, si Kuçova e të tjera, jo vetëm që pasuria e nëntokës sonë shkonte në xhepat e fashistëve italianë, por punëtori ynë nuk mund të gjente punë në këto qendra dhe kur arrinte të pranohej, ai trajtohej dhe paguhej si negrit e Afrikës. Ju i kujtoni grevat e punëtorëve të Kuçovës, të Korçës etj. Këta janë shembuj të vuajtjeve të punëtorëve tanë, por njëkohësisht dhe të përpjekjeve të klasës sonë punëtoresh të porsalindur me shfrytëzuesit kapitalistë.

Kjo jetë e errësirës dhe e mizerjes kaloi dhe s'do të

¹ Të falimentuar.

kthehet më. Shqipëria e re e shkundi pluhurin e së kaluarës dhe e shkundi me një tërmet të madh saqë u shkulën nga rrënjët themelitet dhe u rrëzuan oxhaqet e klasave pasanike të vendit tonë.

Pas një muaji populli ynë do të festojë pesëvjetorin e çlirimit të atdheut. Në këta pesë vjet janë bërë hapa të mëdhenj përpara në rrugën e përparimit, në lëmin ekonomik, kultural dhe social; janë krijuar të gjitha mundësitë për ndërtimin e bazave të socializmit dhe populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, me entuziazëm dhe heroizëm po e ndërton socializmin. Bujqësia po bën hapa të mëdhenj përpara. Me qindra traktorë dhe mjete të tjera moderne për punimin e tokës, që na ka dërguar aleati ynë i madh, Bashkimi Sovjetik, çajnë dhe punojnë tokat e fermave shtetërore, të kooperativave bujqësore të fshatarëve. Fshatari përfaqon me etje metodat e reja të punës dhe agroteknikën moderne; ai ka kuptuar se, si zot i tokës që ja dha pushteti i tij, duhet ta punojë mirë këtë tokë dhe të nxjerrë prodhime të bollshme dhe të mira. Këtë gjë ja kërkon interesi i tij, pse i dalë nga varfëria dhe mizerja, ai dëshiron të përmirësojë jetën e tij, të ndërtojë një shtëpi më të mirë, të ushqehet dhe të vishet më mirë, të mbrojë fëmijët e tij nga sëmundja dhe t'i edukojë këta me dituri, mbasi të gjitha mundësitë ja ka krijuar pushteti i tij. Fshatari e ka kuptuar se rruga, ku e drejton Partia dhe qeveria e çon në një jetë çdo ditë më të mirë. Këtë e provon kuptimi i drejtë nga ana e fshatarëve i të gjitha ligjeve dhe urdhëresave në fuqi si dhe mobilizimi i tij për t'i zbatuar këto në jetë dhe për t'i mbrojtur nga armiqtë kulakë.

A kishte parë ndonjëherë Shqipëria një numër kaq të madh fabrikash dhe punishtesh, që janë ndërtuar dhe meremetuar brenda këtyre pesë vjetëve? A ekzistonin në Shqipëri kaq kantiere shfrytëzimi minierash, që kanë tejkaluar me një përqindje të lartë prodhimin e paraluftës, që janë prona e popullit dhe nxjerrin pasurinë e nëntokës për të përmirësuar jetën e popullit? A kanë ekzistuar në Shqipëri këto kombinatë dhe fabrika të ndryshme që na i jep Bashkimi Sovjetik dhe që do të punojnë dhe do të prodhojnë për popullin dhe vetëm për popullin tonë? Sigurisht nga të gjitha këto asnjë s'ekzistonte më parë në Shqipëri. Këto u ndërtuan brenda këtyre pesë vjetëve, i ndërtoi klasa jonë heroike punëtore, i ndërtoi rinia jonë heroike, i ndërtuan masat punonjëse të Shqipërisë me djersë dhe me vullnetin e tyre të çelniktë, u ndërtuan dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Hovi i zhvillimit ekonomik të vendit tonë ka përfshirë në punë të gjitha masat punonjëse. Në vendin tonë nuk njihet papunësia, por ndjehet nevoja për fuqi punëtore, kurse në vendet ku sundon kapitali, me miliona punëtorë mbeten pa punë dhe bashkë me familjet e tyre vuajnë nga skamja dhe uria. Drejtimi i sigurtë dhe i urtë i Partisë sonë, ka bërë që të bonifikohen me dhjetëra mijë hektarë tokë, të thahen liqene e moçale, të ujiten toka të thata dhe të bëhen pjellore, të hapen toka të reja buke, të ndërtohen hekurudha, të ndërtohen rrugë dhe ura të reja, të ndërtohen ujësjellës dhe centrale elektrike, të ndërtohen shkolla nga të katër anët e Shqipërisë, të ngrihen spitale dhe sanatoriume në qytete dhe në fshatra, të ngrihen banesa dhe vende

prehjeje për punëtorët, të ngrihen kopshte dhe çerdhe fëmijësh etj. Të gjitha këto kanë sjellë një përmirësim të dukshëm në jetën e popullit tonë, që e bëjnë këtë të pakrahasueshme me atë të paraluftës. Këto vepra dhe këto rezultate, nuk mund të arrihen përveçse në një shtet, ku populli është në fuqi dhe drejtohet nga një parti marksiste-leniniste.

Armiqtë e popullit tonë i vërejnë këto suksese me zili dhe urrejtje, sepse këto ua shkëputin çdo shpresë të vogël që mund të ëndërrojnë për kthimin e kohës së kaluar. Ata që s'kishin krijuar asgjë, por që vetëm ripnin popullin, ata që hiqeshin «të zot», po që ishin njerëzit më injorantë, ata që hiqeshin si «organizatorë» dhe «drejtues» të mirë, por që në realitet nuk ishin përveçse mjeshtrit e anarkisë, të parazitizmit dhe të dembellëkut otoman, përpiqen t'i përçmojnë veprat e regjimit tonë dhe t'i luftojnë me të gjitha forcat dhe mjetet që u kanë mbetur akoma në dispozicion, dua të them me parullat e helmatisura që hedhin dhe sabotimet e fshehta që bëjnë atje ku mundin. Populli është dhe do të jetë në luftë të vazhdueshme me ta dhe sa më të mëdha që të jenë përparimet tona, aq më e ashpër do të bëhet lufta e elementit armik deri në shfarosjen e tij të plotë. Ashpërsimi i luftës së klasave do t'i qërojë edhe këto ferra që kanë ngelur, pse ata që kanë ëndërruar, predikuar dhe punuar për falimentimin e punës ndërtimore të popullit tonë, e kanë humbur përgjithmonë davanë.

Në veprën e madhe të ndërtimit të bazave të socializmit, Partia jonë diti të mobilizojë dhe të drejtojë të gjitha energjitë e pashteruara të popullit në një punë

të frutshme dhe ndërtimtare. Një entuziazëm i madh që dita-ditës shtohet, përshkon punonjësit e vendit tonë. Këta me vrull i përvishen punës, që u është besuar, pse janë të bindur në fitoren dhe të sigurtë në të ardhshmen e tyre. Njerëzit fitojnë çdo ditë eksperiencë në punë, ata edukohen, fitojnë dituri në shkolla, në teknikumë, në universitete, ata perfeksionohen në kurse të shumta dhe të ndryshme, ata zotërojnë zanatet dhe maqinat dhe çdo ditë njerëz të rinj ngrihen për të shtuar radhët, për të fuqizuar punën dhe ta bëjnë të ecë me sukses përpara.

Por me gjithë këto suksese të konsiderueshme, ne nuk mundet të kënaqemi me kaq, ne jemi akoma mbrapa dhe kemi shumë për të bërë. Ekonomia jonë shtetërore ecën me plan dhe realizimi i plotë i planit duhet të jetë qederi më i madh që nga udhëheqësit dhe deri te punëtori më i thjeshtë. Në konditat e vendit tonë, i cili trashëgoi varfërinë nga e kaluara, realizimi i planit kërkon një luftë të organizuar fort, një disiplinë të hekurt në punë dhe sakrifica. Disa njerëz mendojnë se pas luftës, bile dhe pas pesë vjet çlirimi, ata duhet të kishin me bollëk çdo gjë që u dëshironte zemra dhe shkonin me mendimin se meqë luftuan, me pak mundime dhe me pak sakrifica, ata duhej të bënin një jetë shumë të mirë. Por masat punonjëse të vendit tonë me në krye klasën punëtore, nuk mendojnë si këta njerëz dhe nuk kanë ndër mend që fitoret e mëdha të luftës t'i harxhojnë duke lidhur duart, përkundrazi ata mendojnë se këto fitore duhet të çelnicosen, të mbrohen dhe të shumëzohen. Kjo gjë nuk mund të bëhet përveçse duke punuar. Vetëm puna e palodhur, e disipli-

nuar, e organizuar dhe me vetëmohim do të sjellë çdo ditë, çdo vit përmirësimin e jetesës. Ne kemi shumë mungesa dhe shumë gabime në punën tonë të deritanishme dhe kërkohen përpjekje nga të gjithë që të eliminohen këto sa më parë. Duhet të na preokupojë ngritja e përditshme e ndërgjegjes së njerëzve në punë dhe çdo njeri të kuptojë se kërkohet prej tij maksimumi i përpjekjes në punën që i është ngarkuar, kërkohet prej tij ta kryejë punën pastër, në kohën e caktuar dhe me ndershmerinë më të madhe. Në rast se për çdo punonjës nuk ngjet kështu, ai duhet të jetë plotësisht i bindur se ka dëmtuar shtetin dhe njëkohësisht dhe veten e tij, pse ai është pjesëtar i shoqërisë së re që po ndërtohet dhe frutet e punës së tij janë pasuria e përbashkët. Në rast se kjo pasuri e përbashkët, nuk përmirësohet, nuk shtohet, as pasuria e tij individuale, jeta e tij dhe e familjes së tij nuk mund të përmirësohet. Ka njerëz që punojnë pa ndërgjegje, që s'kanë inisiativë, që harxhojnë dhe prishin duke menduar se është mall i shtetit, se është mall i huaj për të. Kjo është një e keqe e madhe dhe mbeturinë e së kaluarës që duhet të luftohet pa mëshirë. Shteti është i popullit dhe pasuria e shtetit është pasuria e popullit. Kush nuk kujdeset dhe e dëmton këtë pasuri, ai ka dëmtuar veten e tij. Ka njerëz që i shikojnë çështjet shumë ngushtë, nën prizmin e interesave thjesht personale dhe të shkëputura nga interesi i përgjithshëm, ka njerëz me pretendime të mëdha, por atyre u vjen rëndë, kur u kërkohet të japin maksimumin në punën e tyre. Ekzigjencat për një jetesë më të mirë, duhet të shkojnë krahas me një rendiment të madh në punë. Kursimet duhet të jenë

në rendin e ditës, në çdo ndërmarrje shtetërore, në çdo kantier, në çdo fabrikë, në çdo institucion shtetëror, pse vetëm kështu ne do të mundim të ekonomizojmë shumë për të plotësuar boshllëqet, për të ulur koston e prodhimeve. Këto i them dhe i përsërit pse në realizimin e planit të vitit të parë të planit tonë dyvjeçar këto të meta dhe lëshime kanë qenë të theksuara dhe kanë influencuar në mosrealizimin në një shkallë mjaft të ngritur të planit për këta nëntë muajt e parë. Këto të meta dhe lëshime duhet të shihen në sy pa frikë, si nga udhëheqësit, ashtu edhe nga punonjësit dhe të na shërbejnë si mësim për të bërë përpjekje të mëdha brenda këtyre muajve që mbeten si edhe në të ardhshmen.

Sindikatat e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, do të luajnë rolin vendimtar në realizimin e planit dhe këto me siguri do ta kryejnë me nder detyrën. Sindikatat kanë një rol të madh e të dyfishtë: Të bëhen mbështetja kryesore dhe e fuqishme e Partisë dhe e pushtetit tonë dhe njëkohësisht si thotë shoku Stalin:

«...organe ndihmëse dhe rrypa transmissioni që lidhin partinë me klasën e saj»¹.

Sindikatat janë leva kryesore e Partisë për realizimin e planit të shtetit dhe njëkohësisht janë shkolla e komunizmit dhe këtu do të formohet dhe do të çelënikoset në luftë dhe në punë brumi i pastër që përbëhet nga njerëzit punonjës të vendit tonë. Lenini na mëson se komunizmi do të ndërtohet me atë material që na ka lënë trashëgim kapitalizmi.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 182.

Stalini na mëson gjithashtu se

«Për t'i mobilizuar masat milionshe të klasës punëtore kundër rrënimt ekonomik, duhet zhvilluar inisiativa, ndërgjegjja dhe aktiviteti i masave të gjera, duhen bindur ato me fakte konkrete se rrënimi ekonomik përbën një rrezik po aq real dhe vdekjeprurës sa edhe rreziku i luftës në të kaluarën...»¹.

Pa një bashkim profesional të shëndoshë, të ngritur mbi bazat e parimeve marksiste-leniniste, pa një bashkim profesional që të përfitojë nga eksperiencia e sindikatave sovjetike dhe nga eksperiencia e përditshme e tyre në punë, realizimi i planit ekonomik do të çalojë shumë. Sindikatat janë leva që lidhin Partinë me masat dhe me ndihmën e tyre të madhe Partia dhe pushteti do të ndërtojnë bazat e socializmit, pse atje është grumbulluar klasa punëtore, shtylla e çelniqtë e Partisë, rreth së cilës dhe nën drejtimin e së cilës punojnë dhe luftojnë masat e gjera punonjëse të vendit. Ato duhet të organizohen më së miri në parime të shëndosha dhe të edukohen gjithashtu në frymën e Partisë, në frymën e internacionalizmit proletar. Të kemi kurdoherë parasysh mësimet e Leninit që thotë:

«Sikundër fabrika më e mirë me motor të mrekullueshëm dhe maqina të dorës së parë do të mbetet e paralizuar, po të prishet mekanizmi i transmisionit, që lidh motorin me maqinën, ashtu është e pashmangshme katastrofa e ndërtimit

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 9.

tonë socialist, po të mos jetë ndërtuar mirë dhe po të mos punojë mirë mekanizmi i transmisio- nit, që lidh partinë komuniste me masat — bashkimet profesionale. Nuk mjafton që kjo e vërtetë të shpjegohet, të kujtohet, të provohet, ajo duhet të përforcohet në mënyrë organizative në gjithë strukturën e bashkimeve profesionale dhe në punën e tyre të përditshme»¹.

Ky mësim i Leninit do të frymëzojë Kongresin tonë të dytë të Sindikatave në punën e tij dhe në vendimet organizative e politike që do të marrë këtu.

Puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe agjentëve të tyre shqiptarë e kishte dobësuar forcën e sindikatave tona. Mund të themi se deri në një farë shkalle ata kanë pasur sukses dhe kjo gjë ka bërë që të kemi reperkursione të dëmshme në realizimin e planeve tona. Garat socialiste, emulacioni socialist, puna me sulm, mund të themi se s'kanë qenë përdorur me kriter të drejtë për të mos thënë se shpesh s'janë përdorur fare dhe s'kanë dhënë frutin që pritej si një lëvizje e gjerë e klasës punëtore. Nevojat e punëtorëve, kujdesi nga ana e drejtuesve dhe e dikastereve për përmbushjen e nevojave kulturele dhe materiale të punëtorëve dhe të nëpunësve, nuk ka qenë i madh dhe i vazhdueshëm. Punët e sindikatave kërkojnë një kujdes të veçantë, jo vetëm në çështjet parimore, por pasi këto janë vendosur mirë, lypset një kujdes i veçantë dhe për gjërat shumë herë të vogla dhe të përditshme që përbëjnë jetën e

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 206.

masave punonjëse. Me u kënaq se ke vendosë parimin dhe me neglizhue zbatimin e këtij parimi në veçantitë më të vogla, që përbëjnë kompleksin e gjithë jetës së punonjësve, atëhere s'kemi gjë, s'kemi punuar mirë. Dhe ne kemi bërë në këtë drejtim lëshime të palejueshme. Nuk janë bërë përpjekjet nga organet shtetërore për t'u ardhur në ndihmë dhe për të përmbushur nevojat e punëtorëve brenda mundësive që disponon shteti ynë. Në qoftë se ka kush që i kupton si duhet mungesat që ekzistojnë në vendin tonë dhe nevojën e sakrificës, në radhë të parë është klasa jonë punëtoare. Por e keqja është se dhe ato që na ka lejuar mundësia dhe që i ka vendosur Partia dhe qeveria, shumë herë janë neglizhuar, janë vonuar në dëm të punëtorëve. Kjo është e palejueshme dhe duhet të marrë fund. Punëtorët tanë e kuptojnë më mirë se kushdo tjetër, se shteti ynë nuk është në gjendje të ngrejë tani për tani godina të mëdha banimi për ta, por me i lënë punëtorët pa banesa, pa mbulesa dhe këto neglizhenca të fshihen nën fjalët se «s'kemi gozhda» ose «s'kemi llamarina», s'kemi këtë ose atë, kjo është e papranueshme. Të lihen qendrat e punës pa u furnizuar në rregull me sendet ushqimore ose me mallra të tjera, që i ka caktuar qeveria, nën pretekstin se «s'ka transport», kjo është e palejueshme dhe e papranueshme dhe duhet të marrë fund. Çka ekziston dhe çka është vendosur, duhet t'i jepet punëtorit. Nesër ai do të ketë më shumë. Këtë situatë do ta ndryshojmë me punën tonë, por drejtuesit duhet t'i zhdukin përnjëherësh këto mungesa. Vetë sindikatat duhet të interesohen në mënyrë sistematike për jetën e punëtorit në fabrikë e jashtë dhe t'i mbrojnë intere-

sat e punëtorëve kundër kujt do, që i shkel këto interesa. Ka pikëpamje të gabuara që thonë se, kundër kujt sindikatat do të mbrojnë interesat e punëtorëve në demokracinë popullore? Pikërisht në demokracinë popullore, që udhëheq Partia e Punës, organizata e klasës punëtore, sindikatat duhet të jenë një mbështetje dhe një armë e Partisë për të mbrojtur direktivat dhe ligjet e Partisë dhe të pushtetit kundër atyre që nuk i zbatojnë dhe ka njerëz që nuk i zbatojnë, qoftë sepse neglizhojnë ose qoftë sepse janë armiq të fshehtë. Duhet të ngrihet autoriteti i sindikatave dhe ky autoritet do të shtohet kur çdo punëtor të shohë te sindikatat, organizatën e tij, ku mund të zgjidhë të gjitha problemet që e shqetësojnë.

Duhet të gjallërohet më shumë puna kulturele dhe arësimore, duhet të forcohet puna politike në sindikatat, duhet të luftohet analfabetizmi. Mos të harrojmë prapambetjen e madhe në këtë sektor. Mos harrojmë se klasa jonë punëtore është e re, ajo zmadhohet çdo ditë me elementë fshatarë, që sjellin me vete pikëpamjet mikroborgjeze të fshatit. Për këta lypset një edukim i shëndoshë dhe një kujdes i veçantë dhe i gjithanshëm politik dhe ekonomik. Në luftë dhe në punë duhet të formojmë dhe të farkëtojmë klasën punëtore të vendit tonë, të forcojmë bazën e Partisë sonë të Punës. Duke e pasur kurdoherë parasysh këtë gjë, të mendojmë sa përgjegjësi të madhe kanë drejtuesit, që do të dalin nga ky kongres, sa përgjegjësi të madhe kanë të gjithë anëtarët e Partisë, që punojnë në sindikata dhe në prodhim, sa përgjegjësi kanë punëtorët e vjetër e me stazh, në ndihmën dhe përkrahjen që duhet t'i

japin Partisë në zbatimin e direktivave të saja dhe në përkrahjen e punëtorëve të rinj të ardhur nga fshati.

Stalini na mëson se sindikatat

«grumbullojnë punëtorët e të gjitha profesioneve. Kjo nuk është një organizatë partie. Bashkimet profesionale mund të quhen organizatë e gjithë klasës punëtore, e klasës që sundon te ne. Ato janë shkolla e komunizmit. Ato nxjerrin nga radhët e veta njerëzit më të mirë për punët udhëheqëse në të gjitha fushat e administrimit. Ato sigurojnë lidhjen midis elementëve të përparuar dhe elementëve të prapambetur në gjirin e klasës punëtore. Ato bashkojnë masat punëtore me pararojën e klasës punëtore»¹.

Këto mësimë të madha të shokut Stalin duhet t'i kemi kurdoherë parasysh dhe të na ndriçojnë në punën tonë me sindikatat.

Këtej rrjedh roli i rëndësishëm i sindikatave në prodhim. Këto duhet të marrin pjesë gjallërisht në punimin e planeve në ndërmarrje, në fabrika e gjetkë. Nga eksperiencia e Partisë Bolshevike ne mësojmë se kalimi i drejtimit të ndërmarrjeve në duart e sindikatave duhet konsideruar si absolutisht i dëmshëm dhe i papranueshëm. Por do të ishte gjithashtu krejt e padrejtë që, kjo e vërtetë e pakontestueshme të interpretohej në kuptimin që t'u mohohet sindikatave roli i tyre në organizimin socialist të industrisë dhe në drejtimin e industrisë shtetërore. Punëtorët duhet ta njohin

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 3, f. 33.

planin, pse ndryshe nuk mund të mobilizohen si duhet për realizimin e tij. Sindikatat duhet të interesohen vazhdimisht për rritjen e rendimentit në punë, për kursime dhe për uljen e kostos. Duhet të interesohen për edukimin e kuadrit dhe edukimin e tyre, të vënë në duart e tyre armën e paçmueshme marksizëm-leninizmin, pse vetëm kështu njerëzit e Shqipërisë së re do të përparojnë dhe do të kapërcejnë çdo vështirësi në ndërtimin e bazave të socializmit. Partia dhe qeveria do të vënë të gjitha forcat për të ndihmuar sindikatat që këto të forcohen dita-ditës dhe jeta e punonjësve të përmirësohet çdo ditë.

Me propozimin e Komitetit Qendror, Qeveria e Republikës Popullore ka marrë disa vendime në ndihmë të sindikatave dhe më ka ngarkuar t'jua komunikoj në këtë kongres. Këto janë:

1. — Të bëhen pronë e sindikatave dhe të shërbejnë për çlodhjen e punëtorëve godinat e mëposhtme: Pallati në Tiranë, ku janë zyrat e Këshillit të Sindikatave, i gjithë pallati i Kinemasë «Punëtori» në Tiranë, të gjitha vilat në Plazhin e Durrësit që formonin kampin e punëtorëve si edhe dy pallate në Ujë të Ftohtë në Vlorë. U akordohen gjithashtu troje në Bogë, në Qafën e Shtamës dhe në Pogradec, ku sindikatat të ngrënë shtëpi verimi për punëtorët.

2. — T'u akordojë sindikatave për çdo vit nga fondi total i rrogave shtetërore 0,5 për qind, që sot përfaqëson një shumë prej afro 13 milion lekë, të cilat të shërbejnë vetëm për fondin kultural të sindikatave¹.

¹ Me forcimin e gjendjes financiare të bashkimeve profesionale ky fond nuk krijohet më.

3. — Shteti të marrë mbi vete të gjitha shpenzimet e mensave në qendrat e punës dhe punëtori të mos paguajë veçse çmimin e ushqimeve.

Shokë dhe shoqe të dashura,

Ju e dini se imperializmi i egër amerikan dhe satelitët e tij përpiqen të përgatitin një luftë të re botërore me shpresë që të vendosin hegjemoninë e tyre në botë dhe t'i shpëtojnë krizës së tmerrshme që i kërcënon në strofkat e tyre. Me kërcënime, shantazhe, me bandat e spiunëve dhe të kuislingëve imperialistët kanë ndezur luftën në shumë vende të botës, duke shpresuar të asgjësojnë revolucionin që ka shpërthyer në këto vende dhe njëkohësisht zjarrin e luftës ta çojnë dhe në vende të tjera. Imperialistët amerikanë, anglezë etj., po mobilizojnë forcat e tyre, po organizojnë fashizmin gjerman për t'i hedhur këta në luftë kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Kërcënimet dhe shantazhet e tyre janë në rendin e ditës, por këto janë armë që mund të trembin njerëzit me nerva të dobët dhe jo kampin e pathyeshëm të socializmit dhe të paqes, që e udhëheq Bashkimi i lavdishëm Sovjetik me në krye udhëheqësin e madh, Josif Stalinin. Imperializmi amerikan dhe satelitët e tij shkojnë dita-ditës duke u dobësuar dhe politika e tyre e shantazheve po pëson fiasko. Doktrina e Leninit dhe e Stalinit, që udhëheq popujt përparimtarë të botës, po triumfon. Kampi i paqes dhe i socializmit po forcohet dita-ditës. Imperializmi amerikan e humbi davanë përgjithmonë në Republikën e madhe

Popullore të Kinës. Krijimi i Gjermanisë Demokratike dhe pasojat e rëndësishme në Evropë, që shprehen në mesazhin e Gjeneralisimit Stalin, drejtuar udhëheqësve të Qeverisë Demokratike Gjermane, lufta heroike e popujve të tjerë të shtypur të Azisë, të Spanjës, të Greqisë etj., falimentimi i planit skllavërues Marshall dhe lufta heroike e masave punonjëse të drejtuara nga partitë komuniste të vendeve të marshallizuara, janë prova të gjalla dhe konkrete të forcimit të kampit të paqes dhe të socializmit në botë dhe nga ana tjetër të dobësimit të kampit imperialist agresor dhe luftëdashës. Politika e shantazhit atomik e imperialistëve amerikanë mori fund, pse sekretin e përgatitjes së armëve atomike Bashkimi Sovjetik e ka zbuluar që më 1947. Por imperializmi amerikan dhe satelitët e tij, nuk i kanë hedhur armët, përkundrazi sa më tepër u afrohet vdekja, aq më tepër ata do të bëjnë përpjekje për të gjakosur njerëzimin. Lufta për mbrojtjen e paqes duhet të mobilizojë të gjithë njerëzit e thjeshtë të botës dhe të organizohen të gjitha energjitë e popujve që planet e luftëdashësve të dështojnë. Dhe këto me siguri do të dështojnë. Politika staliniane do të triumfojë, sepse ajo shpreh dëshirat dhe aspiratat e zjarra të miliona e miliona njerëzve, sepse ajo përfaqëson idealet e njerëzve të thjeshtë që duan lirinë, që urrejnë gjakderdhjen, që nuk duan më të shohin tmerret e luftërave të kaluara. Politika staliniane e paqes është e pamposhtur, siç janë të pamposhtur popujt, pse ajo s'është veçse shprehja besnike e vullnetit të popujve. Populli ynë me vendosmërinë më të madhe do të ecë në rrugën që na ndrit Stalini i madh. Për popullin tonë paqja është

shumë e shtrenjtë. Kërcënimet e imperializmit, të monarko-fashistëve grekë dhe të klikës së Titos e kompani kanë qenë të vazhdueshme, por populli ynë nën udhëheqjen e Partisë triumfoi dhe do të triumfojë kurdoherë. Agjentët e vjetër të amerikanëve, Tito, Rankoviç dhe shokët e tyre u përpoqën në mënyrë djallëzore të koloniznin Shqipërinë, të asgjësonin Partinë tonë dhe të mbytnin demokracinë popullore. Ata u përpoqën të zbatonin planin e padronit të tyre, për të minuar nga brenda demokracinë popullore dhe duke sjellë në fuqi klikat fashiste, t'i transformonin këto në «place d'armes» kundër atdheut të socializmit. Aktiviteti i agjentëve jugosllavë në Shqipëri, në Bullgari dhe në Hungari, gjyqi i fundit kundër agjentit Rajk, që u mbajt në Budapest, zbuluan deri në rrënjë orvatjet e imperializmit amerikan dhe të agjentëve të tyre të Beogradit. U zbulua rrezikshmëria e madhe e këtyre shërbëtorëve të imperialistëve amerikanë, shpëtuan popujt e demokracive popullore dhe këtë ja detyrojmë Partisë së lavdishme Bolshevike dhe shokut Stalin. Imperialistët e klika titiste kishin mundur të infiltronin me kohë ose të përgatitnin në radhët e klasës punëtore dhe të pararojës së saj, partisë komuniste, agjentët e tyre. Në Partinë tonë klika trockiste e Titos kishte agjentët e vet si Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Nuri Hutën, Vaskë Kolecin e të tjerë. Partia jonë i shtypi këta, u forcua, shtërngoi radhët e saja dhe u armatos për të goditur pa mëshirë armiqtë e saj dhe të popullit. Eksperienca e madhe e Partisë Bolshevike duhet të jetë arma e Partisë sonë dhe ajo na mëson të forcojmë radhët e Partisë sonë, t'i shtojmë radhët e saj në radhë të parë dhe sidomos

me punëtorë besnikë të kauzës së marksizëm-leninizmit, të jemi vigjilentë për të mbrojtur popullin, Partinë, fitoret e Luftës nacional-çlirimtare, të mbrojmë jetën e re, që punonjësit e vendit tonë e ndërtojnë me djersë dhe sakrifica. Kauza e popullit të jetë për të gjithë punonjësit gjëja më e shenjtë, që qëndron mbi çdo gjë, mbi interesat personale dhe mbi sakrificën më të madhe, jetën e gjithsecilit. Një ndërgjegje të tillë në njerëzit e Shqipërisë lufton për të farkëtuar Partia dhe Partia do të triumfojë në veprën e saj të pavdekshme.

Shokë dhe shoqe, t'i përvishemi punës me vull të madh, me besim të madh të realizojmë planet e shtetit tonë, pse kjo do të thotë të shkojmë në socializëm. Të forcojmë ekonominë tonë dhe fuqinë mbrojtëse të demokracisë sonë popullore. Të duam dhe të mbrojmë popullin me të gjitha forcat tona. Të ngremë gjithnjë më lart dhe të çelnikosim patriotizmin e masave të gjera të popullit. Të ruajmë dhe të zhvillojmë dita-ditës fitoret e mëdha të Luftës nacional-çlirimtare. Puna të jetë një nder dhe detyrë për të gjithë qytetarët e Republikës.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Rroftë klasa jonë heroike punëtoare!

Të rrojnë dhe të forcohen sindikatat tona!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 256 (329), 25 tetor 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RROFTË SA MALET PARTIA JONË E DASHUR¹

8 Nëntor 1949

Më 8 Nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë, pararoja e klasës punëtore dhe e gjithë masave punonjëse të vendit tonë. Kjo është një nga datat më të shënuara të historisë së popullit tonë. Këtë herë, pas kaq shekujsh robërie dhe vuajtjesh të shkaktuara nga imperialistët e ndryshëm dhe nga klasa feudalo-borgjeze e vendit, populli krijoi nga gjiri i vet udhëheqjen e vërtetë të tij, besnike dhe trime që kishte në programin e saj luftën për realizimin e aspiratave të popullit tonë.

Duke u mbështetur në teorinë marksiste-leniniste, duke ndjekur me besnikëri mësimet e pavdekshme të Revolucionit të madh të Tetorit dhe të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, që udhëhoqi me lavdi klasën punëtore dhe fshatarësinë e Rusisë në fitoren e vendosjes së diktaturës së proletariatis, të krijimit të shtetit socialist sovjetik dhe të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, Partia jonë Komuniste ndërmori veprën

¹ Artikull i botuar në gazetën «Zëri i Popullit», me rastin e përvjetorit të tetë të themelimit të Partisë.

e saj të madhe dhe kreu me sukses detyrat e mëdha historike që i viheshin përpara.

Vendi ynë ishte i okupuar nga fashistët italianë dhe bota ishte në zjarr. Nazizmi gjerman kishte ndezur Luftën e dytë botërore dhe kishte sulmuar tradhëtisht Bashkimin Sovjetik. Ishin momente shumë të rënda, por edhe decizive për të gjithë popujt si dhe për popullin tonë të vogël. Paraqiteshin dy rrugë: ose me luftue deri në fund kundër fashizmit gjerman, italian etj. dhe me i mundë këta, ose me pranue zgjedhën mesjetare të tyre dhe shfarosjen e plotë në interesin e imperializmit dhe të fashizmit. Popujt nuk mund të pranonin veçse rrugën e parë dhe në këtë rrugë këta u ndritën nga Bashkimi Sovjetik dhe nga udhëheqësi i tij i madh, Gjeneralisimi Stalin. S'mund të kishte fitore për popujt e robëruar nga fashizmi gjerman, italian etj. pa luftën heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik. Popujt e robëruar nuk mund të organizonin rezistencën dhe të fitonin lirinë e vërtetë në luftën e tyre çlirimtare, pa qenë të udhëhequr nga një parti komuniste, besnike e marksizëm-leninizmit. Ishte e natyrshme se, në këtë luftë vendimtare, populli ynë me udhëheqësen e tij, Partinë Komuniste, jo vetëm do të luftonin kundër shkelësve fashistë, por njëkohësisht edhe kundër klasës pasanike, borgjezisë dhe feudalëve, interesat e të cilëve pajtoheshin me ato të okupatorëve. Pra, popullit tonë dhe Partisë së tij Komuniste u viheshin përpara detyra që të çlironin atdheun nga okupatori, të dërmonin njëkohësisht forcat e tradhëtarëve dhe të kuislingëve, të shkatërronin nga themelitë shtetin e vjetër borgjez dhe të vendosnin diktaturën e demokracisë popullore,

diktaturën e klasës punëtore dhe të fshatarëve të varfër. Partia jonë Komuniste diti të mobilizojë gjithë masat e popullit punonjës të Shqipërisë dhe t'i përmbushë detyrat e saja. Punëtorët, fshatarët dhe gjithë masat e shtypura të qytetit, me besnikërinë më të madhe, ndoqën rrugën e shpëtimit, ku i udhëhiqte Partia. Ata luftuan me heroizmin dhe me vetëmohimin më të madh, pse kishin besim në drejtësinë për të cilën luftonte Partia, pse kjo ishte drejtësia e një populli të tërë, që kërkonte të çlirohej përgjithmonë dhe të vendoste pushtetin e tij. Fitorja e madhe e popullit tonë u arrit në sajë të udhëheqjes së Partisë Komuniste si dhe në sajë të përkrahjes të Bashkimit Sovjetik dhe të luftërave legjendare të Ushtrisë Sovjetike kundër agresorëve fashistë. Këtë çështje populli ynë që në fillim të luftës e kuptoi aq mirë sa që kjo gjë u bë e pandarë nga besimi në suksesin e fitores. Pa këtë besim dhe këtë bindje, nuk do që e mundur të zhvillohej me sukses lufta e popullit tonë. Kjo ishte fitorja e madhe e parë e domosdoshme që korri Partia jonë. Kundër Bashkimit Sovjetik kishin punuar imperialistët, fashistët, feudalët dhe borgjezia pasanike në vendin tonë, por ata nuk kishin mundur të tronditnin besimin e popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik. Më kot fashizmi dhe reaksioni i brendshëm e akuzuan Partinë tonë si «një parti të huaj që s'përfaqësonte interesat e popullit». Partia kurrrë nuk e hoqi nga kryet e programit të luftës së saj, çështjen e dashurisë së popullit tonë për popujt e Bashkimit Sovjetik.

Radhët e Partisë sonë, të vogla në fillim, u zgjeruan dhe u forcuan. Komunistët u çelnikosën në luftëra.

të përgjakshme dhe u armatosën me mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit dhe ditën të luftonin dhe të vepronin në momente shumë të vështira dhe të ndërlikuara. Partia jonë Komuniste ishte shenja kryesore ku qëllonin fashistët, kuislingët dhe elementët armiq që kishin hyrë kontrabandë në Parti. Partia luftoi në dy fronte: kundër armikut të jashtëm dhe kundër armiqve të brendshëm të Partisë. Elementët armiq të Partisë, që kërkonin të përçanin unitetin dhe aleancën e klasës punëtore dhe të fshatarësisë, elementët që kërkonin të likuidonin Partinë dhe të zhduknin rolin e saj drejtues, u dërmuan pa mëshirë.

Vepra armiqësore, e fshehur, e agjentëve të imperializmit: Titos, Vukmanoviç Tempos, Blazho Jovaniçit e tradhëtarëve të tjerë jugosllavë, dështoi dhe këta trockistë jugosllavë edhe kur ishin akoma të maskuar, nuk mundën dot ta hidhnin Partinë tonë në kthetrat e tyre dhe të padronëve të tyre imperialistë, me të cilët ishin në ujdi që në fillim të luftës. Partia jonë, megjithëse ishte një parti e re dhe pa eksperiencë të madhe, triumfoi mbi të gjitha këto rreziqe se ajo kishte dritën dhe eksperiencën e Partisë Bolshevike. Eksperienca e madhe e Partisë Bolshevike dhe eksperienca e Partisë dhe e luftës sonë i mësoi komunistët dhe popullin të dallojnë, të zbulojnë, të godasin pa mëshirë armiqtë e jashtëm dhe ata të brendshëm të maskuar. Lufta kundër armiqve të Partisë dhe të popullit tonë ka qenë një proces i gjatë. Partia dhe populli e fituan luftën dhe mbyllën me sukses një etapë të shkëlqyer të historisë së vendit tonë. U vendos në vendin tonë diktatura e demokracisë popullore, u ngrit pushteti i ri, u bënë të

popullit të gjitha pasuritë e feudalëve dhe të borgjezisë pasanike, u shtetëzuan fabrikat dhe minierat, u bënë reformat e mëdha ekonomike, sociale dhe kulturele dhe gjithë populli ju përvesh punës së rindërtimit të atdheut dhe të ndërtimit të bazave të socializmit. Këto realizime, natyrisht, nuk u bënë pa luftë dhe pa përpjekje. U desh të luftohej dhe të thyhej rezistenca e klasës kapitaliste dhe të privilegjuar, u desh të goditeshin komplotistët, armiq të popullit, u desh një luftë heroike e Partisë dhe e popullit për të shfarosur veprën agjenturale të imperialistëve anglo-amerikanë, që u përpoqën me organizime komplotesh dhe sabotazhesh, me shantazhe politike dhe me kërcënime, të zhduknin diktaturën e demokracisë popullore në vendin tonë dhe ta hidhnin Shqipërinë dhe popullin shqiptar në kthetrat e gjakosura të tyre. Lufta e ashpër dhe e drejtë e Partisë sonë i bëri të dështojnë të gjitha këto orvatje dhe Partia, pushteti si dhe fuqia mbrojtëse e vendit tonë, pas këtyre ngjarjeve dolën më të fortë dhe më të çelniktë. U desh një luftë e vazhdueshme kundër elementëve oportunistë brenda në Parti, të cilët, duke shtrembëruar marksizëm-leninizmin, kërkonin të likuidonin fitoret e Luftës nacional-çlirimtare. U desh një luftë e ashpër kundër trockistëve jugosllavë me agjentin e imperializmit Tito në krye, për të shpëtuar edhe një herë vendin tonë nga një llahtarë e madhe, që i përgatitnin fshehurazi agjentët anglo-amerikanë, trockistët e Beogradit dhe agjentët e tyre të maskuar në Partinë Komuniste të Shqipërisë me Koçi Xoxen në krye. Komploti i titistëve dhe i Koçi Xoxes me shokë ishte një nga më të stërholluarit. Imperializmi, në radhë të parë ai

amerikan, duke përdorur agjentët e Beogradit, kërkonte të kolonizonte, jo vetëm vendin tonë, por edhe demokracinë e tjera popullore motra dhe t'i shndërronte këto në shtete borgjeze e t'i hidhte në luftë kundër Bashkimit Sovjetik. Trockistët jugosllavë, në bashkëpunim të ngushtë me agjentët e tyre në Partinë tonë, u përpoqën për disa vjet me radhë, nën maskën e miqësisë dhe të komunizmit, të shkatërronin Partinë tonë, të minonin demokracinë tonë popullore, të sabotonin ekonominë dhe ndërtimin e bazave të socializmit, të hidhnin në duart e tyre pasuritë e vendit tonë dhe gjithë Shqipërinë. Titistët dhe Koçi Xoxe me shokë i shkaktuan Partisë dhe popullit tonë dëme të mëdha politike dhe ekonomike, organizuan rrjetat e tyre të spiunazhit dhe të sabotazhit dhe përgatitnin grushtin e shtetit, për të likuiduar udhëheqjen e shëndoshë të Partisë dhe të shtetit tonë dhe të pushtonin ushtarakisht vendin. Imperialistët anglo-amerikanë, titistët dhe monarko-fashistët e kanë halë në sy Shqipërinë demokratike që po ndërton socializmin në vendin e saj dhe që qëndron heroike dhe e pamposhtur përpara kërcënimeve të tyre. Partia jonë e Punës, me politikën e saj të drejtë, të zgjuar, të vendosur, me besnikërinë e saj ndaj marksizëm-leninizmit dhe Bashkimit Sovjetik, i dërmoi të gjitha këto orvatje të imperializmit e të agjentëve të tij dhe kurdoherë në të ardhshmen do t'i dërmojë dhe do të triumfojë mbi çdo orvatje të luftëdashësve imperialistë dhe agjentëve të tyre. Jugosllavia, ku sundon terrori fashist i agjentëve të imperializmit me Titon në krye, është bërë qendra e spiunazhit amerikan dhe e komplotëve, që kurdisen në prapaskena

kundër Bashkimit Sovjetik, demokracive popullore motra dhe vendit tonë. Jugosllavia e Titos si dhe Greqia e Caldarisit janë bërë qendra e tradhëtarëve shqiptarë që mbahen me shpresë dhe përgatiten për t'i bërë dëm Shqipërisë. Qëllimi i Titos aq sa dhe i Caldarisit është copëtimi i Shqipërisë ndërmjet tyre. Më kot agjenti Tito kërkon me demagogji të fshehtë tradhëtinë e tij dhe fytyrën prej tradhëtari. Më kot ai kërkon të shfaqësohet përpara fakteve që vërtetojnë se ai është për copëtimin e Shqipërisë. «Fshati që duket s'do kallauz». Ata që tradhëtojnë kauzën e shenjtë të popujve të tyre, s'janë gjë tjetër veçse ujqër për popujt e tjerë. E tillë është klika e Titos. Tradhëtia e titistëve është aq e qartë dhe armiqësia e tyre është aq e egër kundër popullit tonë sa që ata nuk janë në gjendje që ta fshehin.

Siç e pohon një notë e tyre, drejtuar qeverisë sonë, Tito është plotësisht i kënaqur me politikën agresive të fashistit Caldaris kundër Shqipërisë. Ky dhe avoketët e miqtë e tij të ngushtë, imperialistët amerikanë dhe anglezë që luftojnë egërsisht kundër të drejtave legjitime të Shqipërisë në OKB, mbrojnë me cinizëm dhe poshtërsi rivendikimet tokësore të monarko-fashistëve grekë mbi të ashtuquajturin Epir të Veriut. Duke dashur t'i lënë rrugën e hapur agresionit kundër vendit tonë, në mënyrë të turpshme, këta armiq luftojnë që kufitë e Jugut të Shqipërisë të mos njihen definitivisht nga Greqia monarko-fashiste. Por më kot lehin këta qenër të tërbuar kundër Shqipërisë dhe integritetit të saj. Këta kurrë nuk do t'ja arrijnë qëllimit. Kurrë nuk do të mundin të prekin një pëllëmbë tokë të vendit tonë, që di të mbrohet dhe të fitojë, pse në

krye ka Partinë e tij heroike të Punës, vigjilente për të mbrojtur interesat e popullit, pse ka mbrojtës besnikë dhe të pathyeshëm Bashkimin Sovjetik, demokracitë popullore motra dhe gjithë popujt përparimtarë të botës Kampi i paqes dhe i socializmit, do të fitojë mbi nxitësit e luftës, imperialistët amerikanë dhe anglezë e shërbëtorët e tyre. Shqipëria do të triumfojë, pse është një pjesëtarë e pamposhtur e kampit të socializmit dhe të paqes.

Kongresi I i Partisë sonë demaskoi gjithë këtë punë armiqësore të trockistëve të Beogradit dhe të agjentëve të tyre shqiptarë dhe caktoi detyrat për ndërtimin e bazave të socializmit. Partia luftoi për të përmirësuar gjendjen shumë të vështirë ekonomike që na shkaktoi puna armiqësore e titistëve, ndreqi shtrembërimet, fshiu shfaqjet e anarkisë e të konfuzionit që kishte mundur të fuste në radhët tona klika e Beogradit.

Ky vit ka qenë një vit përpjekjesh shumë të mëdha për Partinë dhe për popullin, ashtu sikundër ka qenë dhe një vit suksesesh të rëndësishme, që ka bërë të forcohen bazat e socializmit në vendin tonë. Vështirësitë u kapërcyen me sukses, sepse rreth Partisë dhe nën udhëheqjen e saj u mobilizuan masat e gjera të popullit. U mbarua me sukses ndarja e re administrative, e cila lejoi që pushteti të jetë sa më afër popullit, sa më demokratik dhe nën kontrollin e afërt të masave punonjëse. U riorganizua aparati i shtetit në baza të shëndosha dhe u spastrua mjaft nga burokratizmi, që krijonte konfuzion dhe mungesë përgjegjësie. U bënë zgjedhjet e reja të këshillave popullore, për të cilat populli votoi në mënyrë dërmuese dhe mbrojti pushtetin e tij nga

infiltrimi i elementëve armiq. U nxuarën shumë ligje dhe urdhëresa ekonomike të rëndësishme, të cilat vunë në rrugën e drejtë zhvillimin e sektorit ekonomik të vendit tonë dhe spastruan shtrembërimet që kishin mundur të futnin në të trockistët. U hartua dhe u shpall plani ekonomik dyvjeçar i shtetit, gjë që u bë dhe mendihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë si dhe të demokracive popullore. Të gjithë punonjësit e vendit tonë janë mobilizuar për realizimin e planit të shtetit. Me heroizëm luftojnë anëtarët e Partisë në ballë të klasës sonë punëtore, të rinisë, të fshatarësisë dhe të të gjitha masave të tjera punonjëse. Jeta e popullit tonë përmirësohet dita-ditës. Industria jonë zmadhohet e forcohet. Në sektorin e bujqësisë ne kemi arritur mjaft rezultate, financat tona po përmirësohen, po përmirësohet furnizimi i popullit dhe në lëmin arësimor dhe kultural ne kemi rezultate të kënaqshme.

Patjetër ne kemi të meta, pengesa edhe mungesa, ne hasim akoma vështirësi dhe duhen sakrifica dhe përpjekje që këto të kapërcehen me sukses. Partia dhe populli ynë kanë hasur në rrugën e tyre pengesa shumë më të mëdha dhe i kanë kapërcyer. Për ndërtimin e socializmit asgjë s'mund ta pengojë hovin e popullit tonë, i cili nën drejtimin e sigurtë të Partisë do të ndërtojë të ardhshmen e tij më të mirë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka çelnikosur radhët e saja duke i spastruar këto nga elementët dhe influencat trockiste. Struktura e Partisë është forcuar. Janë riorganizuar dhe forcuar aparatet e saj, që nga qendra deri në bazë; është forcuar organizimi dhe kontrolli; është vendosur në baza të drejta udhëheqja kolektive dhe

është siguruar uniteti i saj dhe i zbatimit të vijës së saj. Është vendosur dhe respektohet centralizmi demokratik dhe zbatimi i rregullave të demokracisë së brendshme, që ishin marrë nëpër këmbë nga agjentura e Titos, e cila ishte përpjekur të vendoste një regjim sektar burokratik në Parti. Zgjedhjet e organeve udhëheqëse të Partisë, të bëra në bazë të Statutit, treguan pjekurinë e anëtarëve të Partisë për të kryer drejt detyrat që u vihen përpara. Edukimit ideo-politik të anëtarëve i është kushtuar rëndësi e veçantë dhe kjo ka dhënë rezultate të ndieshme dhe ka armatosur njerëzit e Partisë për të zgjidhur problemet e vështira që u dalin përpara. Kritika dhe autokritika bolshevike në Partinë tonë kanë marrë rrugën e drejtë. Por komunistët nuk mund të kënaqen me këto rezultate të arritura. Partia jonë ka akoma shumë e shumë për të bërë dhe për të mësuar nga eksperiencia e pakufishme e Partisë Bolshevike dhe nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit. Duke pasur kurdoherë parasysh detyrat e rënda, që kanë mbi supet dhe përgjegjësinë e madhe, që kanë para popullit dhe Partisë për t'i kryer me nder këto detyra, anëtarët e Partisë duhet të jenë të ndërgjegjshëm se duhet të bëjnë përpjekje të mëdha në punë dhe të jenë shembull për të gjithë e për çdo gjë, në çdo kohë dhe në çdo sektor. Ata duhet të jenë më të zotët, më të ndërgjegjshmit, më të ndershmit, më trimat dhe më të sakrificës se kushdo tjetër, pse çdo anëtar partie duhet të jetë një udhëheqës që të kryejë me përpikëri detyrën e tij dhe të mësojë e të edukojë të tjerët në shembullin e tij.

Dita e përvjctorit të themelimit të Partisë sonë, që është kaq e afërt me ditën e përvjctorit të Revolu-

cionit të madh të Tetorit, të frymëzojë gjithë anëtarët e Partisë dhe tërë popullin punonjës të vendit tonë me energji të reja në luftë dhe në punë për ndërtimin e bazave të socializmit. Të forcohet dashuria për Partinë dhe kjo të çelënikosë radhët e saja, të forcohet dita-ditës më shumë dashuria për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike, për shokun e madh Stalin dhe për kampin e socializmit. Populli ynë me Partinë e tij në krye të luftojë me të gjitha forcat për mbrojtjen e paqes në botë, që kërcënohet nga imperialistët luftëdashës. Partia jonë duke mbajtur kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar dhe duke i qëndruar besnik marksizëm-leninizmit, që i jep forcë dhe jetë, duke ndjekur rrugën e Bashkimit Sovjetik, të Partisë Bolshevike dhe të Stalinit, do të ecë përpara, do të triumfojë si kurdoherë mbi armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm dhe do ta udhëheqë popullin tonë drejt socializmit, do të ruajë dhe do të mbrojë me heroizëm kundër çdo rreziku atdheun tonë të shtrenjtë, Republikën tonë Popullore.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 269 (342), 8 nëntor 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 269 (342), 8 nëntor 1949

**TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT ÇU EN LAI
NË LIDHJE ME VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE
DIPLOMATIKE MIDIS RPSH DHE RP TË KINËS**

19 nëntor 1949

**SHOKUT ÇU EN LAI
MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS**

P e k i n

Kam nderin të sjell në dijeninë Tuaj se Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë duke dashur që të zhvillohen dhe të përforcohen gjithnjë e më shumë lidhjet miqësore, që ekzistojnë midis dy vendeve tona, ka vendosur t'i komunikojë, Qeverisë Suaj dëshirën e saj dhe atë të popullit shqiptar për të lidhur marrëdhënje diplomatike midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës.

Populli shqiptar dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, që kanë ndjekur me interesim të veçantë luftën e madhe çlirimtare të popullit heroik kinez me në krye udhëheqësin e tij të shquar Mao Ce Dun, kanë përshëndetur me entuziazëm fitoret historike të tij si dhe formimin e Republikës Popullore të Kinës e

zgjedhjen e Qeverisë Popullore Qendrore, që përfaqësojnë vullnetin dhe aspiratat shekullore të masave të gjera të popullit të madh kinez.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë është e bindur se marrëdhënjet diplomatike midis vendeve tona, që do të shpien në lidhje gjithnjë më të ngushta miqësie midis dy popujve tanë, do të kontribuojnë në përforcimin e kampit të demokracisë dhe të socializmit, në përforcimin e luftës së përbashkët për paqe të kampit tonë, që ka në krye Bashkimin Sovjetik, mikun më të madh dhe më të shtrenjtë të popujve tanë dhe të mbarë njerëzimit.

Ju lutem të pranoni, shoku ministër, sigurimet e konsideratës sime të lartë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave
dhe Ministri i Punëve të Jashtme
të RP të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 280 (353), 20 nëntor 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 280 (353),
20 nëntor 1949*

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË ÇLIRIMIT

29 Nëntor 1949

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Sot populli dhe Ushtria Popullore festojnë pesëvjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatorët nazifashistë dhe tradhëtarët e vendit. 29 Nëntori i 1944-s i dha fund një herë e përgjithmonë okupacionit dhe regjimit feudalo-borgjez në vendin tonë.

Viti i pestë i çlirimit, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë e të ndihmës së singërtë të Bashkimit Sovjetik, e gjen vendin tonë me suksese të mëdha. Populli ynë i bashkuar si një blok i vetëm nën udhëheqjen e drejtë e të sigurtë të Partisë e të qeverisë, ka vënë të gjitha forcat për realizimin me sukses të planit dyvjeçar dhe ecën i sigurtë në rrugën për ngritjen e bazave të socializmit.

Në vitet e pasluftës ushtria jonë ka korrur suksese të dukshme në përgatitjen e saj luftarake dhe politike sipas shembullit të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe artit ushtarak stalinian. Ushtria jonë, e frymëzuar nga ndjenja e lartë e patriotizmit dhe traditat luftarake

të popullit tonë, ka kryer me sukses detyrat e saja për mbrojtjen e atdheut.

Për asnjë çast nuk duhen harruar armiqtë e vendit tonë dhe tentativat që bëjnë imperialistët amerikanë e të tjerë për shpërthimin e një lufte të re.

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Përvetësoni më tepër artin ushtarak, lartësoni nivelin tuaj politik dhe të jeni kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm për të mbrojtur fitoret e luftës dhe frutet e punës paqësore pesëvjeçare të popullit tonë, që është i vendosur përkrah kampit demokratik me në krye Bashkimin Sovjetik.

Ushtria jonë të jetë mburojë e fortë e atdheut dhe e popullit tonë paqedashës kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikanë, anglezë dhe satelitëve të tyre.

Ju përshëndes me rastin e pesëvjetorit të çlirimit dhe ju uroj suksese të reja për modernizimin e ushtrisë sonë.

Për kremtimin e kësaj dite,

U r d h ë r o j :

Sot, në kryeqytetin e Republikës Popullore të Shqipërisë në Tiranë, në orën 9,30 të shtihen 10 breshëri artilerie dhe në qytetet: Korçë, Gjirokastër, Vlorë e Shkodër të shtihen 5 breshëri artilerie.

Rroftë përvjetori i pestë i çlirimit të atdheut tonë!
Rroftë populli shqiptar!
Rroftë Ushtria jonë Popullore!
Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe Gjeneralisimi Stalin!
Rroftë kampi demokratik dhe antiimperialist!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të
Armatosura të Republikës
Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 288 (361), 29 nëntor 1949*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 288 (361),
29 nëntor 1949*

TELEGRAM URIMI DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN E 70-VJETORIT TË DITËLINDJES

20 dhjetor 1949

GJENERALISIMIT STALIN
KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BRSS

Kremlin-Moskë

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes Suaj, ju urojmë nga zemra me plot dashuri, jetë të gjatë për të mirën dhe lumturinë e popujve sovjetikë, të gjithë popujve përparimtarë të botës dhe të popullit tonë.

Në ditën e 70-vjetorit Tuaj, ne kujtojmë me respektin më të madh, luftën Tuaj të lavdishme përkrah gjenisë së madhe të Leninit për triumfin e Revolucionit socialist të Tetorit dhe për ndërtimin e shtetit të parë socialist në botë, kujtojmë veprat Tuaja të pavdekshme si udhëheqës i shtetit sovjetik në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, udhëheqjen Tuaj të shquar në luftën kundër hordhive nazifashiste për mbrojtjen e Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe për shpëtimin e botës nga mortaja fashiste, udhëheqësin e luftës të të gjithë popujve përparimtarë në luftën për

paqe kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikano-anglezë etj.

Jeta dhe veprat Tuaja të lavdishme për ne kanë qenë janë dhe do të jenë gjithnjë drita që ndriçon rrugën tonë për fitoret e deritanishme dhe për fitoret tona të ardhshme.

Populli shqiptar sheh te Ju, shoku Stalin, mikun dhe mbrojtësin e tij më të madh, që në krye të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, e shpëtoi nga skllavëria, e ndihmon në ndërtimin e jetës së re dhe për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut të tij.

Përherë mirënjohës dhe besnik ndaj Jush dhe mësimëve Tuaja, populli ynë ecën i sigurtë në ndërtimin e socializmit, do të qëndrojë gjithmonë i paepur kundër orvatjeve të imperialistëve luftëdashës amerikano-anglezë dhe shërbëtorëve të tyre trockistëve të Beogradit dhe monarko-fashistëve të Athinës, i radhitur me vendosmëri në kampin demokratik antiimperialist.

Duke festuar 70-vjetorin Tuaj me punë ndërtimtare paqësore, populli ynë brohorit me entuziazëm: «Të rrosh sa malet, shoku Stalin!»

Kryetari i Këshillit të Ministrave të RP
të Shqipërisë
Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 306 (379), 20 dhjetor 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 306 (379), 20 dhjetor 1949

**FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE
ORGANIZUAR ME RASTIN E 70-VJETORIT TË
DITËLINDJES SË J. V. STALINIT**

20 dhjetor 1949

Shokë dhe shoqe,

Nesër mbush 70 vjet të jetës së tij mësuesi dhe udhëheqësi i madh i proletariatit botëror, dishepulli më besnik i Leninit, strategu i ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, mbrojtësi i madh i paqes dhe i lirisë së popujve, Josif Visarionoviç Stalin. 70-vjetori i shokut të madh Stalin festohet me madhështi nga të gjithë njerëzit liridashës e përparimtarë.

Njerëzit sovjetikë dhe gjithë popujt e botës shohin në shokun Stalin, Leninin e sotshëm, udhëheqësin dhe mësuesin e tyre më të dashur, i cili përkrah Leninit të madh themeloi dhe ndërtoi Partinë Bolshevike, i cili përkrah Leninit udhëhoqi Partinë Bolshevike dhe popujt e Rusisë së skllavëruar në Revolucionin triumfues të Tetorit, që shënoi kthesën rrënjësore të kursit të historisë së njerëzimit. Njerëzit sovjetikë dhe gjithë njerëzit e thjeshtë të botës shohin te Stalini, pasardhësin më besnik të Leninit, që ka udhëhequr dhe po udhë-

heq Partinë Bolshevike dhe popujt sovjetikë në rrugën e Leninit për ndërtimin e socializmit në një të gjashtën e botës. Stalini, për popujt sovjetikë dhe për të gjithë botën përparimtare është një nga strategët e mëdhenj të shkencës marksiste-leniniste. Ai me urtësi dhe guxim drejtoi anijen e socializmit nëpër të gjitha dallgët e luftës së komplikuar, ai udhëhoqi popujt sovjetikë në ndërtimin e kështjellës së fuqishme të socializmit e të komunizmit, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik; Stalini për popujt sovjetikë dhe për të gjithë botën përparimtare është mjeshtri i fitores mbi fashizmin, është ai që udhëhoqi atë luftë të madhe, e cila shpëtoi botën nga skllavëria fashiste.

Ata që i kanë vënë vetes si detyrë skllavërimin e botës, njerëzit e kompleteve kundër paqes dhe kundër popujve, nxitësit e një lufte të re, shohin në shokun Stalin armikun e tyre më të madh, sepse shoku Stalin është mbrojtësi më i madh i paqes, është miku më i madh i të gjithë popujve të botës dhe i lirisë së tyre. Planet e imperialistëve kanë dështuar deri më sot dhe me siguri do të dështojnë kurdoherë, sepse bota përparimtare, kundërshtarë e imperializmit, ecën jo në rrugën e Çerçillit dhe të Trumanit, por në rrugën e Stalinit.

«Nuk e di — ka thënë shoku Stalin më 1946 — nëse z. Çerçill dhe miqtë e tij do të mund të organizojnë një fushatë ushtarake të re kundër «Evropës Lindore», mbas Luftës së dytë botërore. Por edhe sikur të mundnin ta bënin këtë gjë, që është pak e mundshme, sepse miliona njerëz të thjeshtë bëjnë roje për të mbrojtur

çështjen e paqes — mund të thuhet me siguri që ata do të munden, në të njëjtën mënyrë siç u mundën dhe herë tjetër, këtu e njëzet e gjashtë vjet më parë»¹.

Sot popujt e Bashkimit Sovjetik kanë ndërtuar socializmin dhe po kalojnë gradualisht në ndërtimin e komunizmit me besim të patundur në forcat e tyre dhe në të ardhshmen e tyre, sepse udhëhiqen nga Partia Bolsheviqe dhe shoku Stalin. Sot demokracitë popullore janë vënë në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe po ecin me siguri e me besim të plotë drejt të ardhshmes së tyre të lumtur, sepse ecin në rrugën e Bashkimit Sovjetik, në rrugën e Stalinit, ndihmohen dhe mbrohen prej tij. Sot popujt e të gjithë botës po shtërrojnë radhët e frontit të paqes dhe kanë besim të patundur në triumfin e tyre mbi imperializmin, sepse fronti demokratik dhe antiimperialist ka në krye Bashkimin e lavdishëm Sovjetik e shokun Stalin. Populli ynë i vogël, po ecën me besim të patundur në rrugën, që i tregon Partia jonë heroike, që është rruga e Partisë Bolsheviqe, rruga e Stalinit.

Jeta e shokut Stalin, është e lidhur me jetën e luftën e Leninit të madh, me Revolucionin socialist të Tetorit, me triumfin e popujve sovjetikë kundër intervencionit kapitalist, me Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, me triumfin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, me

¹ Intervistë e J. V. Stalnit dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda» në lidhje me fjalimin që mbajti Çerçilli në qytetin Fullton të SHBA-së. «Pravda», Nr. 62 (10144), 14 mars 1946.

triumfin e popujve sovjetikë mbi Gjermaninë naziste, me sukseset e Partisë Bolshevike. E gjithë veprimtaria e Stalinit është e shkrirë në historinë e Partisë Bolshevike, në historinë e Bashkimit Sovjetik. Këto nuk mund të ndahen. Nuk mund të flasësh për veprimtarinë e Stalinit, pa folur për ndërtimin e socializmit në vendet e demokracive popullore, për sukseset dhe përpjekjet e klasës punëtore të vendeve kapitaliste dhe të proletarëve të të gjithë botës. Historia e jetës së shokut Stalin është historia e internacionalizmit proletar në luftë kundër kapitalizmit. Nuk mund të flasësh për veprimtarinë e shokut Stalin, pa folur për luftën, përpjekjet dhe sukseset e njerëzimit përparimtar për mbrojtjen e paqes kundër nxitësve të luftës. Veprimtaria e shokut Stalin është e lidhur me historinë e njerëzimit përparimtar në luftë kundër fashizmit dje dhe në luftë kundër nxitësve të luftës e për mbrojtjen e paqes sot. Po kështu nuk mund të flasësh për historinë e Partisë sonë dhe të popullit shqiptar, pa folur për shokun Stalin.

I. — STALINI, BASHKËPUNËTORI MË I NGUSHTË I LENINIT

Stalini, në të gjitha problemet e Partisë dhe të shtetit ka qenë bashkëpunëtori më i ngushtë i Leninit.

Duke qëndruar kurdoherë përkrah Leninit të madh, Stalini dha një kontribut të shquar në hedhjen e themeleve të partisë së tipit të ri, të Partisë Bolshevike. Bashkë me Leninin ai luftoi për ta armatosur Partinë

Bolshevike me teorinë marksiste. Lenini e përkrah tij Stalini, të parët në histori zbuluan deri në fund rrënjët dhe burimet e oportunizmit, ngritën në lartësinë e duhur rëndësinë dhe nevojën e teorisë revolucionare për partinë revolucionare të proletariatit dhe realizuan bashkimin teorik dhe praktik të lëvizjes punëtore me socializmin.

Lenini dhe Stalini e armatosën partinë e tipit të ri, Partinë Bolshevike, me bazat organizative të saj, simbas të cilave, në kundërshtim me partitë e mëparshme të Internacionales së dytë, partia e klasës punëtore është reparti avangardë, i organizuar, i disiplinuar dhe i ndër-gjegjshëm i klasës punëtore, e armatosur me teorinë revolucionare, është forma më e lartë e organizimit të të gjitha organizatave të tjera të klasës punëtore. Lenini dhe Stalini e armatosën Partinë Bolshevike me taktikën dhe strategjinë marksiste revolucionare. Lenini zbuloi ligjin e zhvillimit të pabarabartë të kapitalizmit në epokën e imperializmit dhe arriti në konkluzionin teorik dhe praktik mbi mundësinë e triumfit të revolucionit proletar në një vend të vetëm dhe në udhëheqje të partisë bashkë me Stalinin ai e vuri në zbatim këtë konkluzion, duke drejtuar proletariatin rus më 1917 në sulmin e tij vendimtar kundër regjimit kapitalist në një të gjashtën e botës.

Lenini dhe Stalini përpunuan të gjitha bazat teorike të Partisë Bolshevike simbas materializmit dialektik dhe materializmit historik.

Stalinin e gjejmë krahas Leninit në të gjitha betejat e ashpra politike dhe ideologjike, që ka drejtuar i madhi Lenin kundër shërbëtorëve dhe agjentëve të bor-

gjezisë në radhët e proletariatit, kundër socialrevolucionarëve, menshevikëve, anarkistëve, nacionalistëve borgjezë, trockistëve dhe të gjitha rrymave antimarksiste leniniste, që u shfaqën në radhët e Partisë Bolshevike gjatë kohës që jetonte Lenini.

Lenini dhe Stalini e bënë Partinë Bolshevike partinë marksiste më të fortë në botë, e bënë partinë e tipit të ri, partinë e diktaturës së proletariatit, të pastër nga oportunizmi, intrasigjente përpara konciliatorëve dhe kapitullantëve, revolucionare përpara borgjezisë dhe pushtetit të saj shtetëror. Ata e bënë Partinë Bolshevike, partinë e masave, të lidhur ngushtësisht me masat e gjera të klasës punëtore, të armatosur me teorinë e pararojës së lëvizjes punëtore, me teorinë marksiste-leniniste. Ata e bënë Partinë Bolshevike një parti luftarake dhe revolucionare

«... mjaft e sprovuar për t'u orientuar në kon-ditat e ndërlikuara të situatës revolucionare dhe mjaft e shkathët për t'ju shmangur çfarëdo shkëmbi që ndodhet nën ujë në rrugën që shpie drejt qëllimit»¹.

Stalini që bashkëpunëtori më i ngushtë i Leninit në organizimin dhe drejtimin e sulmit vendimtar të proletariatit dhe të fshatarësisë së varfër të Ruisë kundër regjimit borgjez reaksionar. Lenini këshillohej me Stalinin për çdo çështje kryesore, e pyeste atë dhe merrte parasysh mendimet e tij. Stalini e dëgjonte

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 174

Leninin si mësuesin e tij dhe i zbatonte vendimet e Leninit me përpikëri. Stalini gjendej kudo ku lufta ishte më e vështirë, sepse atij i besonte Lenini detyrat më të koklavitura, më delikate dhe të vështira, nga zgjidhja e të cilave varej fati i revolucionit.

Më 31 gusht 1918 shoku Stalin, që drejtonte në Caricin luftën kundër forcave kundërrevolucionare, i shkruante kështu Leninit:

«I dashuri shoku Lenin!

Po luftohet për Jugun dhe për Kaspikun. Për ta mbajtur gjithë këtë zonë (edhe ajo mund të mbahet!) duhet të kemi disa torpediniera të lehta dhe nja dy nëndetëse (për hollësitë pyesni Artjomin). Ju lutem shumë të thyni të gjitha pengesat dhe të na ndihmoni t'i marrim pa vonesë ato që po ju kërkojmë. Bakuja, Turkestani, Kaukazi Verior do të jenë (patjetër!) tanët, në qoftë se kërkesat tona plotësohen menjëherë.

Punët tona në front shkojnë mirë. Nuk dyshoj se do të shkojnë edhe më mirë (kozakët po shturen përfundimisht).

I shtërngoij dorën Iliçit tim të dashur dhe të shtrenjtë.

I juaji STALIN»¹.

Lenini me të marrë këtë letër të Stalinit, i grisi adresimin dhe firmën dhe tekstin e letrës së Stalinit ua

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 4, f. 123.

dërgoi organeve vartëse si urdhër e me porosi që të zbatohesh menjëherë. Në dokumentat e Leninit zakonisht gjenden anëshkrime të këtilla, të cilat janë të shumta: «Stalinit për shqyrtim», «shokut Stalin për ta parë», «lutem me pritë ose me ju drejtue Stalinit», «flisni me Stalinin si duhet zgjidhur kjo çështje», «ja referoni çështjen komisionit të Stalinit» etj. Stalini është bashkëpunëtori më i ngushtë i Leninit në triumfin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit që theu definitivisht frontin imperialist botëror dhe hapi një epokë të re në historinë e njerëzimit, epokën e revolucioneve proletare dhe të triumfit të socializmit. Lenini dhe Stalini udhëhoqën popujt sovjetikë në triumfin kundër forcave kundërrevolucionare dhe të intervencionit të huaj, në ndërtimin e shtetit të parë socialist në botë, të diktaturës së parë të proletariatit dhe në hedhjen e bazave të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Lenini dhe Stalini janë dy emra të të njëjtit simbol. Lenini dhe Stalini janë dy kolosë të pathyeshëm përpara të cilëve nuk ka forcë kundërshtare që të rezistojë, të cilët kanë një mendim dhe një vullnet të përbashkët: luftën e pandërprerë dhe të pamëshirshme kundër të gjithë armiqve të proletariatit dhe të të gjithë popujve dhe fitoren e socializmit dhe të komunizmit për mirëqenjen dhe lumturinë e miliona e të qindra miliona njerëzve të thjeshtë të të gjithë botës, që me shekuj, kanë vuajtur nën skllavërinë kapitaliste.

Ka qenë një fat i madh për njerëzimin përparimtar që për të ardhshmen e tij punoi e luftoi dje Lenini gjeneral dhe është një fat i madh jo vetëm i popujve të Bashkimit Sovjetik, po edhe i të gjithë popujve, i nje-

rëzve të shtypur e përparimtarë që kemi sot në krye të frontit të paqes, të frontit demokratik dhe antiimperialist, të frontit socialist, bashkëpunëtorin më të ngushtë të Leninit, shokun e madh Stalin.

II. — STALINI, VAZHUES I VEPRËS SË LENINIT, KLASIK I MARKSIZËM-LLENINIZMIT, GJIGAND I MENDIMIT DHE I VEPRIMIT REVOLUCIONAR

Qysh kur ishte në internim, në një fshat të humbur të Siberisë, Stalini paraqitet, pas Leninit, si teoricieni më i madh i shkencës marksiste-leniniste. Qysh atëhere ai përpunoi një sërë veprash teorike të një rëndësie të madhe për lëvizjen proletare në Rusi dhe për të gjithë lëvizjen revolucionare të proletariatit ndërkombëtar. Ai shkroi veprat «Letra nga Kutaisi», «Shkurt mbi divergjencat në parti», «Klasa e proletarëve dhe partia e proletarëve», «Parathënje e botimit gjeorgjian të broshurës së K. Kautskit», «Forcat lëvizëse dhe perspektivat e revolucionit rus» etj. Revolucioni demokratiko-borgjez i vitit 1905 vërtetoi plotësisht të gjitha parimet themelore mbi partinë, mbi rolin e teorisë, mbi kryengritjen e armatosur, mbi hegjemoninë e klasës punëtore në revolucionin demokratiko-borgjez etj., të përpunuara nga Lenini dhe Stalini. Mbas këtij revolucioni, që nuk pati sukses, në vitet e reaksionit dhe të zbritjes së dallgës revolucionare, shoku Stalin shkroi veprën «Anarkizëm apo socializëm?», me të cilën ai përcaktonte dhe zhvillonte bazat teorike të partisë marksiste, materializmin dialektik dhe materializmin historik. Më

1913 shoku Stalin botoi veprën «Marksizmi dhe çështja nacionale», vepër e cila përcaktonte parimet marksiste-leniniste mbi çështjen nacionale dhe luajti një rol teorik dhe praktik të dorës së parë jo vetëm për çështjen e revolucionit proletar në Rusi, por edhe për të gjithë çështjen e lëvizjes revolucionare ndërkombëtare. Shoku Stalin, në Konferencën VII (të prillit) e PPSD (bolshevike) të Rosisë më 1917 mbajti referatin mbi çështjen nacionale. Stalini bashkë me Leninin e drejtojnë vetë personalisht gazetën «Pravda», organ i Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike. Në kohën e Revolucionit të Tetorit, nuk kishte ditë që në shtypin e partisë të mos dilnin artikujt e Leninit dhe të Stalinit.

Pas vdekjes së Leninit, Stalinit i ra barra e rëndë historike jo vetëm që të drejtonte shtetin sovjetik në ndërtimin e socializmit, por edhe të luftonte kundër të gjitha pikëpamjeve antileniniste të të gjitha rrymave, që u shfaqën në radhët e Partisë Bolshevike dhe ta ngrinte shkencën marksiste-leniniste në një shkallë më të lartë, duke e pasuruar atë me eksperiencën e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe me eksperiencën e të gjithë lëvizjes revolucionare ndërkombëtare. Shoku Stalin shkroi veprën me vlerë të madhe marksiste-leniniste «Çështje të leninizmit» në të cilën përmbli-dhen në mënyrë të koncentruar parimet marksiste-leniniste dhe luftohen të gjitha tentativat e armiqve të klasës punëtore, që mundohen t'i shtrembërojnë këto parime. Shoku Stalin ka marrë pjesë direkt në hartimin e «Kursit të shkurtër të Historisë së Partisë Komuniste (b) të BRSS», që është një vepër me vlerë të madhe

për shkencën marksiste-leniniste etj. Veprat e shokut Stalin janë vepra të një klasiku të madh të marksizëm-leninizmit. Ato jo vetëm mbrojnë parimet marksiste-leniniste, por edhe i zhvillojnë ato më tej, i pasurojnë ato me eksperiencë të re revolucionare. Veprat e shokut Stalin vlejnë për edukimin e të gjithë komunistëve të botës, ato janë një armë e fuqishme për të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë të botës, në luftën e tyre kundër zgjedhës kapitaliste dhe kundër nxitësve të luftës. Prej vitit 1917 dhe deri më sot veprat e shokut Stalin janë botuar në 101 gjuhë të ndryshme dhe në 539 milion kopje. Koleksioni i veprave teorike të shokut Stalin, që po botohet në 16 volume me vendim të Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike janë një thesar me vlerë të madhe ideologjike dhe kulturalë në Bashkimin Sovjetik pas veprave të Leninit.

Duke u bazuar në Marks, Engelsin dhe Leninin, shoku Stalin zhvilloi më tej materializmin dialektik si botëkuptimi i partive marksiste-leniniste. Duke përcaktuar metodën dialektike si të vetmen metodë të drejtë nëpërmjet së cilës mund të shpjegohen dhe të njihen e të zbulohen fenomenet e natyrës, shoku Stalin ka thënë:

«Në kundërshtim me metafizikën, dialektika e merr natyrën jo si një grumbull të rastit sendesh, fenomenesh të shkëputura nga njëri-tjetri, të izoluar nga njëri-tjetri dhe të pavarura nga njëri-tjetri — por si një të tërë të lidhur dhe të pandarë, ku sendet, fenomenet janë të lidhura organikisht me njëri-tjetrin, va-

ren nga njëri-tjetri dhe kondicionojnë njëri-tjetrin»¹.

«Për metodën dialektike e rëndësishme para së gjithash nuk është ajo që në një çast të dhënë duket e qëndrueshme, por që ka filluar të vryshket, porse ajo që lind dhe zhvillohet, edhe në qoftë se në një çast të dhënë mund të duket e paqëndrueshme, sepse për metodën dialektike e pathyeshme është vetëm ajo që lind dhe zhvillohet»².

«Prandaj metoda dialektike thotë se procesi i zhvillimit nga më e ulëta te më e larta bëhet jo nëpërmjet një evolucioni të harmonishëm të fenomeneve, por nëpërmjet zbulimit të kontradiktave që kanë sendet, fenomenet, nëpërmjet «luftës» së tendencave të kundërta që veprojnë mbi bazën e këtyre kontradiktave»³.

Këto ligje marksiste-leniniste të metodës dialektike në shqyrtimin e çështjeve dhe fenomeneve jo vetëm të natyrës, por edhe të shoqërisë njerëzore, të përcaktuara në mënyrë kaq të qartë nga shoku Stalin, janë të një rëndësie të dorës së parë për të gjithë lëvizjen revolucionare ndërkombëtare. Lenini dhe Stalini, sikurse Marksi dhe Engelsi, në shqyrtimin dhe sqarimin e të gjitha çështjeve politike, ideologjike dhe ekonomiko-shoqërore kanë përdorur metodën dialektike. Kjo metodë marksiste-leniniste u jep mundësinë komunistëve

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 153.

2 Po aty, f. 154.

3 Po aty, f. 158.

të gjithë botës që të orientohen drejt në të gjitha situatat sado të komplikuar që të jenë. Shkenca marksiste, e krijuar nga Marksi dhe Engelsi, e pasuruar dhe e zhvilluar nga Lenini e Stalini është arma më e fortë e partive komuniste në luftën e tyre kundër kapitalit. Bolshevikët e Leninit dhe të Stalinit e kanë përdorur metodën marksiste-leniniste, metodën dialektike, si instrument kryesor për të analizuar e për të vlerësuar gjendjen në një moment të caktuar dhe për të arritur në konkluzionet pozitive në lidhje me atë gjendje. Gjenia e Stalinit, e vazhduesit dhe e pasuruesit të veprës së Leninit, konsiston në kapacitetin e tij të madh për të analizuar forcat vepruese në një moment të caktuar, për të përcaktuar se cilat forca rriten dhe zhvillohen dhe cilat plaken dhe vdesin, cilat forca kanë përpara një perspektivë dhe të ardhshme të sigurtë dhe cilat kanë përpara katastrofën dhe vdekjen e paevitueshme.

Me mijëra shembuj i ilustrojnë vetiat e shquara të shokut Stalin. Emrin Stalin, që do të thotë i çelniktë, shoku Josif Visarionoviç e ka fituar në zjarrin e luftërave dhe të përpjekjeve të Partisë Bolshevike, të proletariatit rus dhe të popujve sovjetikë e të mbarë botës kundër armiqve të revolucionit dhe të paqes. Stalini është kolosi me vullnet të çelniktë, i papërkulshëm dhe i pathyeshëm si çelniku. Dhe ajo që e bën të çelniktë, të pathyeshëm, gjigand të mendimit dhe të veprimit, Stalinin, është zotërimi i shkencës marksiste-leniniste, prej së cilës ai mëson dhe njëkohësisht e pasuron dhe e zhvillon atë, është besimi i patundur në çështjen e revolucionit, të revolucionit botëror, të cilit i takon e ardhshmja.

Stalini, njeriu i çelniktë jo vetëm për qëndruesh-

mërinë e tij politike dhe ideologjike, por edhe për rezistencën e tij të pathyeshme përpara vështirësive e për vullnetin e tij për kapërcimin e këtyre vështirësive, kur ishte i burgosur, mbasi u torturua në mënyrën më barbare nga xhandarët e Carit, Stalini i çelniktë, ecte me këmbët e tij e me kokën lart nga dhoma e torturave për në qelinë e errët përpara xhandarëve dhe spiunëve të Carit, pa e fshehur fytyrën e tij të plagosur nga torturat dhe duke ju thënë armiqve në fytyrë: «ne përfaqësojmë të ardhshmen dhe prandaj ne nuk do ta ulim kurrë kokën përpara jush». Kjo ishte jo vetëm shprehja e urrejtjes së shokut Stalin kundrejt regjimit të Carit, por njëkohësisht edhe vlerësimi marksist-leninist i gjendjes revolucionare dhe i zhvillimit historik që ai bënte. Për shokun Stalin dhe për të gjithë bolshevikët ishte e qartë se proletariati rus ishte forca më revolucionare së cilës i takonte e ardhshmja, sepse po rritej e po zhvillohej çdo ditë, ndërsa regjimi i Carit ishte i destinuar të zhdukej, sepse po kalbej e po dobësohej çdo ditë, ndodhej përpara katastrofës dhe vdekjes. Le të kujtojmë momentet tragjike të vitit 1941. Ishte nëntor. Gëbelsi deklaronte me të madhe: «ushtria hitleriane i shikon me sy kabanat e kishave të Moskës». Kurse gjithë bota i kishte kthyer sytë nga Stalini. Do të binte Moska? Fronti ishte afër Moskës sa ç'është Vora nga Tirana. Artileria gjermane rrihte lagjet e jashtme të Moskës. Dara gjermane po shtërngohej në Veri nga ana e qytetit Kalinin dhe në Jug nga ana e Tulës. Hitlerianët dhe shërbëtorët e tyre deklarorin rënjen e Moskës.

Në këto momente të tmerrshme, më 6 nëntor 1941 Josif Visarionoviç Stalini, i qetë, i vendosur, ndërsa e

gjithë Moska tundej nga zhurma e artilerisë dhe e avionit, në mbledhjen solemne të organizuar për të festuar përvjetorin e 24-të të Revolucionit socialist të Tetorit duke ju drejtuar popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë popujve të botës tha:

«Armiku nuk është aq i fuqishëm, sa e përfytyrojnë disa të ashtuquajtur intelektualë të trembur... Po të gjykojmë jo sipas deklaratave mburracake të propagandistëve gjermanë, por sipas gjendjes reale të Gjermanisë, nuk do të jetë vështirë të kuptojmë se zaptontësit fashistë gjermanë ndodhen para katastrofës... Zaptontësit gjermanë po bëjnë përpjekjet e fundit. Nuk ka dyshim se Gjermania nuk mund ta mbajë gjatë këtë tension. Edhe disa muaj, edhe një gjysmë viti, ndofta edhe një vit dhe Gjermania hitleriane duhet të shëmbet nën peshën e krimeve të saj»¹.

Duke dëgjuar këto fjalë të shokut Stalin, popujt e Bashkimit Sovjetik dhe e gjithë bota përparimtare muarën frymë, fituan forca të reja, sepse përpara tyre u bë e qartë perspektiva e fitores së sigurtë mbi skllavërinë hitleriane. Shoku Stalin analizoi në këtë mbledhje shkaqet e tërheqjes së përkohshme të Ushtrisë së Kuqe, faktorët vendimtarë, që përcaktonin stabilizimin e frontit gjermano-sovjetik, perspektivën e afërt të kalimit të

¹ J. V. Stalin. «Mbi Luftën e madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik», Tiranë, 1952, f. 31.

Ushtrisë së Kuqe në kundërofensivë dhe fitoren definitive mbi ushtrinë fashiste. Stalini, me metodën marksiste-leniniste, me metodën dialektike analizonte forcat, që rriteshin dhe forcat që kalbeshin, bënte diagnozën historike të gjendjes, analizonte shkencërisht raportin e forcave, që vepronin në arenën e luftës dhe përcaktonte matematikisht katastrofën e hitlerianëve dhe fitoren e Ushtrisë Sovjetike.

Analiza marksiste-leniniste që i ka bërë shoku Stalin çështjes nacionale është një kontribut i madh për marksizëm-leninizmin. Në bazë të parimeve leniniste-staliniane mbi çështjen nacionale është ndërtuar BRSS, në të cilin përfshihen 60 kombësi të ndryshme. Duke zbatuar parimet leniniste-staliniane mbi të drejtën e vetëvendosjes së popujve, Partia Bolshevike ka mundur të krijojë shtetin më të fortë e të përparuar në botë, në të cilin të gjithë popujt që e përbëjnë, kanë të drejta dhe detyra të barabarta, rrojnë në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin, të gjithë së bashku përbëjnë familjen e madhe, që quhet Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike. Kushtetuta staliniane, vepër e shokut Stalin, është kushtetuta më demokratike në botë, e cila u rezervon të drejta të barabarta të gjithë popujve, që përbëjnë Bashkimin Sovjetik, garanton të drejtën e vetëvendosjes së popujve deri në ndarje të plotë.

Mendimi i Stalinit i ndrit rrugën të gjithë botës përparimtare. Idetë dhe mësimet e Stalinit u përkasin të gjitha partive marksiste-leniniste të botës. Të gjithë ata, që kanë tentuar të shtrembëronin idetë dhe parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, janë dërmuar nga forca e logjikës staliniane. Sot bota është e ndarë

në dy kampe dhe në dy ideologji. Kamp të tretë ose ideologji të tretë, nuk mund të ketë. Renegatët dhe tradhëtarët titistë pretendojnë se mbrojnë një vijë të tretë, e cila gjoja është vija e vërtetë. Kjo është demagogji, për të mbuluar fytyrën dhe rolin e vërtetë prej tradhëtari dhe agjenti në shërbim të imperializmit që ka grupi i Titos.

Sot i gjithë njerëzimi përparimtar i mban sytë nga Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevike dhe shoku Stalin, sepse po të mos ishin ato, sot hitlerianët do të shtrinim sundimin e tyre të urryer mbi popujt e botës dhe ndoshta bota sot do të ishte akoma nën skllavërinë fashiste. Prandaj sot i gjithë njerëzimi, të gjithë ata, që duan paqën dhe urrejnë luftën, të gjithë ata, që duan lirinë dhe urrejnë skllavërinë, përshëndesin shokun Stalin me rastin e 70-vjetorit të tij dhe i urojnë atij jetë të gjatë. Partia jonë dhe populli ynë me gjithë shpirt i urojnë shokut Stalin jetë të gjatë për të mirën e gjithë njerëzimit dhe për të mirën edhe të popullit tonë. Të rrojë sa malet tona shoku i madh Stalin!

III. — STALINI, MJESHTRI I TË GJITHIA FITOREVE TË USHTRISË SOVJETIKE, STRATEGU I MË I MADH I KOHËS

Emri i shokut Stalin është i pandarë nga historia e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe nga fitoret e saja. Ushtria Sovjetike lindi në zjarrin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit. Pionierët e saj ishin grupet e punëtorëve dhe të fshatarëve të armatosur që sulmonin regjimin e borgjezisë reaksionare. Lenini e bashkë me të edhe Stalini qenë frymëzuesit, organizatorët dhe

udhëheqësit e të gjitha forcave revolucionare, të proletariatit rus dhe të fshatarësisë së varfër, që me anën e dhunës revolucionare të organizuar, përmbysën regjimin kapitalist dhe vendosën diktaturën e proletaria-tit më 1917 në Rusinë e Carit.

Emri i Stalinit është ngushtësisht i lidhur me të gjitha betejat vendimtare të Ushtrisë së Kuqe gjatë viteve të luftës civile në Bashkimin Sovjetik, kundër forcave kundërrevolucionare të brendshme dhe intervencionit kapitalist të huaj. Kudo ku ishte gjendja më e vështirë, në frontet më me rëndësi, Lenini dërgonte Stalinin, se kishte besim të plotë në kapacitetin drejtues të shokut Stalin dhe në cilësitë e tija ushtarake të pakrahasueshme.

Stalini është organizatori dhe drejtuesi i Ushtrisë Sovjetike, i ushtrisë më të fortë dhe më të përparuar në botë. Stalini është krijuesi i strategjisë dhe i taktikës staliniane, i artit dhe i shkencës ushtarake staliniane, që janë arti dhe shkenca më të përparuara në botë. Shoku Stalin krijoi artin dhe shkencën ushtarake staliniane duke studjuar eksperiencën e luftërave të kohërave të kaluara, eksperiencën e luftërave të klasës, eksperiencën e revolucioneve dhe të luftërave civile. Këtë studim shoku Stalin e ka bërë duke përdorur metodën marksiste-leniniste, metodën dialektike. Eksperiencën e luftërave dhe të revolucioneve të kaluara shoku Stalin e pasuroi me eksperiencën e Revolucionit të Tetorit dhe me eksperiencën e luftës civile.

Në Luftën e dytë botërore Bashkimi Sovjetik dhe ushtria e tij mbajtën peshën më të madhe të luftës, peshën më të madhe të sakrificës dhe të kontributit.

Fitoret e Ushtrisë Sovjetike dhe të popujve sovjetikë në Luftën e dytë botërore, janë fitore të udhëheqjes staliniane, sepse të gjitha operacionet e mëdha luftarake kundër Gjermanisë naziste në Leningrad, Moskë, Stalingrad, Kursk etj. u përgatitën dhe u drejtuan personalisht nga shoku Stalin. «Është fati ynë që në vitet e vështira të luftës, ka thënë shoku Molotov, Ushtrinë e Kuqe dhe popullin sovjetik e udhëhoqte përpara udhëheqësi i urtë dhe i sprovuar i Bashkimit Sovjetik — Stalini i madh. Me emrin e Gjeneralisimit Stalin do të hyjnë në historinë e vendit tonë dhe në historinë botërore fitoret e lavdishme të ushtrisë sonë»¹.

Një nga karakteristikat kryesore të shkencës ushtarake staliniane është pastërtia e kësaj nga çdo lloj shablonizmi. Ndërsa strategjia prusiane e Hitlerit karakterizohej nga shablonizmi, shkenca ushtarake staliniane karakterizohet nga metoda dialektike në studimin dhe vlerësimin e të gjithë elementëve, që përcaktojnë një fitore strategjike ose taktike. Ndërsa strategjia hitleriane karakterizohej nga hedhja në fushën e betejës të të gjitha forcave disponibël që në momentin e parë të betejës, për të mbërritur suksesin vendimtar që në fazën e parë të luftës (lufta e vetëtimshme-blitzkrieg), strategjia staliniane karakterizohet nga përdorimi i drejtë dhe racional i forcave, nga përdorimi i drejtë dhe jo i parakohshëm, por në momentin e duhur të rezervave strategjike, nga përdorimi i mbrojtjes jo si lloji kryesor i luftimit, por si një formë luftimi e nevojshme

¹ Shih: Josif Visarionoviç Stalin — Biografi e shkurtër. Tiranë, 1950, f. 197.

për të harxhuar forcat e armikut dhe për t'u dhënë kohë e mundësi forcave të veta që të organizojnë kundërofensivën dhe grushtin kryesor të saj në atë drejtim, në të cilin veprimi mund të korrë në kohën më të shkurtër maksimumin e rezultatit. Ndërsa strategjia hitleriane karakterizohet nga mbivlerësimi i disa armëve dhe nënvletësimi i disa të tjerave, p.sh. nga mbivlerësimi i tanksave dhe i aviacionit dhe nga nënvleftësimi i këmbësisë dhe armëve të tjera, strategjia staliniane karakterizohet nga vlerësimi i drejtë i të gjitha armëve të ndryshme, që përbëjnë ushtrinë, nga përgatitja me kohë e këtyre armëve dhe nga organizimi shkencor i bashkëveprimit të të gjitha armëve në fushën e betejës, pa të cilin nuk mund të ketë fitore luftarake.

Një rëndësi të madhe i jep shoku Stalin edhe vlerësimit të gjendjes luftarake. Ndërsa strategjia hitleriane niset nga premisa joreale dhe udhëhiqej nga metoda metafizike në vlerësimin e gjendjes, strategjia staliniane nisët nga të dhënat konkrete dhe materiale të situatës dhe udhëhiqet nga metoda dialektike në vlerësimin e një situatë të caktuar. Shoku Stalin na mëson se

«Plani i strategjisë është plani i organizimit të goditjes vendimtare në drejtimin që mund të japë maksimumin e rezultateve»¹.

«... të përcaktosh drejtimin e goditjes kryesore do të thotë të vendosësh qysh më parë ka-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 159.

rakterin e operacioneve për gjithë periudhën e luftës, pra, të vendosësh qysh më parë 9/10 e fatit të gjithë luftës. Kjo është detyra e strategjisë»¹.

Asnjë shtet tjetër në botë nuk do të kishte mundur të rezistonte përpara Hitlerit, përveç shtetit sovjetik. Lufta e dytë botërore tregoi se forma sovjetike e shtetit është forma më e lartë dhe më vitale nga të gjitha format shtetërore të borgjezisë. Në saje të politikës staliniane të Partisë Bolshevike, popujt e Bashkimit Sovjetik u bashkuan si një trup i vetëm rreth Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, u mobilizuan të tëra forcat dhe burimet shtetërore për çështjen e Luftës së madhe patriotike dhe çdo gjë ju kushtua fitores mbi Gjermaninë naziste. Pa një mobilizim të këtillë, pa sakrifica të atilla, si ato që bëri Bashkimi Sovjetik, nuk do të kishte qenë e mundur fitorja mbi Gjermaninë naziste. Duke analizuar faktorët që përcaktuan fitoren e madhe historike të Bashkimit Sovjetik mbi Gjermaninë hitleriane, shoku Stalin ka thënë:

«Që të kuptohet rëndësia e madhe historike e fitores sonë, duhet që kjo çështje të shikohet në mënyrë më konkrete.

Atëhere, si duhet shikuar fitorja jonë mbi armiqtë, çfarë don të thotë kjo fitore nga pikëpamja e gjendjes dhe e zhvillimit të forcave të brendshme të vendit tonë?

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 160.

Fitorja jonë don të thotë, para së gjithash, se ka fituar rendi ynë shoqëror sovjetik, se rendi shoqëror sovjetik u sprovua me sukses në zjarrin e luftës dhe tregoi vitalitetin e vet të plot"...

Lufta ka treguar se rendi shoqëror sovjetik është një rend me të vërtetë popullor, i dalë nga gjiri i popullit dhe i mbështetur në përkrahjen e fuqishme të tij, se rendi shoqëror sovjetik është një formë plotësisht vitale dhe e qëndrueshme e organizimit të shoqërisë.

Madje tani nuk bëhet më fjalë nëse është apo nuk është vital rendi shoqëror sovjetik, sepse pas mësimëve konkrete të luftës, asnjëri nga skeptikët nuk guxon më të shfaqë dyshime në lidhje me vitalitetin e rendit shoqëror sovjetik. Tani është fjala se rendi shoqëror sovjetik... është një formë më e mirë organizimi e shoqërisë, se çdo rend shoqëror josovjetik.

Fitorja jonë don të thotë, së dyti, se ka fituar rendi ynë shtetëror sovjetik, se shteti ynë shumëkombesh sovjetik i kaloi të gjitha provat e luftës dhe e tregoi vitalitetin e vet... Tani nuk bëhet më fjalë për vitalitetin e rendit shtetëror sovjetik... Rendi shtetëror sovjetik u bë model shteti shumëkombesh... ku çështja kombëtare dhe problemi i bashkëpunimit të kombeve janë zgjidhur më mirë se në çfarëdo shteti tjetër shumëkombesh.

Fitorja jonë don të thotë, së treti, se kanë fituar forcat e armatosura sovjetike, ka fituar

Ushtria jonë e Kuqe, se Ushtria e Kuqe u qëndroi heroikisht të gjitha vështirësive të luftës, i dërmoi keq ushtritë e armiqve tanë dhe doli fitimtare nga lufta.

...Lufta ka treguar se Ushtria e Kuqe nuk është një «kolos me këmbë argjili», por një ushtri moderne e dorës së parë, e pajisur me armë të reja, me një efektiv komandues shumë të provuar dhe me cilësi të larta luftarak morale. Nuk duhet harruar se Ushtria e Kuqe është pikërisht ajo ushtri që e dërmoi keq ushtrinë gjermane, e cila deri dje u kallte tmerr ushtrive të shteteve evropiane»¹.

Ushtria Sovjetike fitoi mbi ushtrinë hitleriane, shpëtoi Bashkimin Sovjetik dhe çliroi popujt e shtypur nga zgjedha fashiste, sepse ajo u organizua dhe u edukua nga Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, nga vetë shoku Stalin, sepse ajo është pjella e popujve sovjetikë, e shoqërisë socialiste sovjetike, sepse çështja që ajo mbron, është e drejtë, është çështje e socializmit dhe e komunizmit, është çështje e paqes dhe e demokracisë në botë, është çështje e interesave të popujve sovjetikë dhe e popujve të të gjithë botës. Ushtria Sovjetike, kurdoherë fitimtare mbi armiqtë, e pajisur me mjetet më moderne të luftës, e edukuar nga Partia Bolshevike dhe Stalini,

¹ J. V. Stalin. Fjalim në mbledhjen elektorale të rrethit «Stalin» të Moskës, 9 shkurt 1946. «Pravda» Nr. 35 (10117), 10 shkurt 1946.

e frymëzuar me ndjenjën e patriotizmit sovjetik dhe të internacionalizmit proletar është bërë kolosi i pathyeshëm dhe pengesa më e madhe përpara imperialistëve amerikanë dhe anglezë për zbatimin e planit të tyre skllavërues të botës.

Stalini është strategu i të gjitha fitoreve të Ushtrisë Sovjetike, është strategu i ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në Bashkimin Sovjetik, është strategu i fitores mbi Gjermaninë hitleriane.

Emri i Stalinit është bërë për qindra milion njerëz në të katër anët e botës një simbol i lartë i paqes së qëndrueshme të njerëzimit përparimtar dhe nën flamurin e tij të lavdishëm dhe me emrin e tij me qindra milion njerëz të thjeshtë janë mobilizuar në kampin e paqes dhe luftojnë me ashpërsinë më të madhe për ta mbrojtur paqen në botë, që kërcënohet seriozisht nga luftëdashësit imperialistë anglo-amerikanë dhe satelitët e tyre. Gjaku i derdhur në Luftën e dytë botërore akoma nuk është tharë; plagët dhe mjerimet e panumërta, që ju shkaktuan popujve nga kjo kasaphanë e madhe, janë akoma të hapëta dhe kampi imperialist dhe luftëdashës, që udhëhiqet nga imperializmi amerikan po përgatit një kasaphanë tjetër më të tmerrshme, me qëllim që të vendosë me forcë sundimin e tij dhe të zhdukë lirinë dhe demokracinë në botë. Lufta e dytë botërore, e shkaktuar nga agresorët fashistë gjermanë, të nxitur dhe të armatosur nga imperialistët, kishte për qëllim zhdukjen dhe shkatërrimin e atdheut të madh të socializmit. Por as fashistët gjermanë, as imperialistët luftëdashës nuk mundën dot t'ja arrinin qëllimit djallëzor të tyre. Popujt e Bashkimit Sovjetik nën udhëheqjen e

Stalinit, e thyen Gjermaninë e Hitlerit dhe dolën më të fortë se kurrë nga kjo luftë e përgjakshme. Stalini ka thënë:

«Lufta nuk ka qenë vetëm një mënxyrë. Ajo ka qenë njëkohësisht edhe një shkollë e madhe, një provë e të gjitha forcave të popullit. Lufta nxori në pah të gjitha faktet dhe ngjarjet në prapavijat dhe në front, ajo çori pa mëshirë të gjitha mbulesat dhe perdet, që fshihnin fytyrën e vërtetë të shteteve, të qeverive, të partive dhe i nxori në skenë pa maskë, pa zbukurime, me të gjitha të metat dhe meritat e tyre»¹.

Imperialistët menduan se Bashkimi Sovjetik do ta kishte të zorshme për t'u rimëkëmbur, pas kësaj lufte kaq të tmerrshme, peshën më të madhe të së cilës e mbajti vetëm Bashkimi Sovjetik. Por të gjitha pretendimet dhe dëshirat e imperialistëve plasën si flluska sapuni. Bashkimi i madh Sovjetik u rindërtua, u ngrit si një kolos edhe më i fortë nga ç'ishte më parë dhe atje u vërtetua një zhvillim i papërshekrueshëm në të gjithë lëmët ekonomikë dhe kulturalë. Ekonomia sovjetike po njuh tani një zhvillim të fuqishëm. Plani pesëvjeçar stalinian i pasluftës, po realizohet para afatit, prodhimi industrial jo vetëm që ka kapërcyer nivelin e paraluftës, por e ka kapërcyer me një përqindje të lartë. Bujqësia

¹ J. V. Stalin. Fjalim në mbledhjen elektorale të rrethit «Stalin» të Moskës, 9 shkurt 1946. «Pravda» Nr. 35 (10117), 10 shkurt 1946.

shkon përpara me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë. Jeta e popujve sovjetikë është përmirësuar. Zhvillimi kulturall i njerëzve sovjetikë po njih një hov të ri e të papërshkrueshëm dhe masat e gjera të popullit punojnë me një hov të dhjetëfishuar, për të zbukuruar atdheun e tyre, jetën e tyre dhe të ardhshmen e lumtur të brezave të rinj.

Imperialistët anglo-amerikanë gjatë luftës dhe pas saj, që të shpëtonin fashizmin nga një shkatërrim total, me qëllim që ta mëkëmbnin dhe ta bënë këtë një armë, për një luftë të re, ata haptas shkelën të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, që përcaktonin rregullimin e çështjes gjermane dhe japoneze. Imperialistët amerikanë dhe anglezë në vend që të zbatonin vendimet e marrura së bashku me Bashkimin Sovjetik, në lidhje me Traktatin e Paqes me Gjermaninë lidhur me çarmatimin, denazifikimin dhe demokratizimin e Gjermanisë, ata u bënë mbrojtësit e vendosur të mbeturave naziste dhe fashiste në Gjermani dhe në botë, duke filluar organizimin dhe riarmatimin e tyre për një luftë të re kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Nxitësit e një lufte të re, me në krye imperializmin amerikan, po përgatiten me ethe të mëdha në të gjitha drejtimet për një luftë tjetër. Buxhetet e tyre të luftës kanë marrë proporcione kolosale, ata po armatosen dhe po armatosin të gjithë satelitët e tyre, ata po përgatitin kudo në vendet që kanë hedhur në kthetrat e tyre të gjakosura, baza ushtarake detare dhe ajrore, ata kanë vënë në shërbim të tyre tradhëtarët e klasës punëtore, socialistët e djathtë, të cilët tok me qeveritë proamerikane janë duke skllavëruar popujt e Evropës

dhe duke rekrutuar mish për top. Plani skllavërues Marshall, i cili po pëson fiasko, ka pasur të vetmin qëllim që të robërojë popujt e atyre vendeve, që ju nënshtruan këtij plani, të hedhë në dorë e në drejtimin e amerikanëve, të gjithë ekonominë e këtyre vendeve dhe ta përdorë këtë për një agresion të ri kundër forcave të paqes e të socializmit, të udhëhequra nga Bashkimi i madh Sovjetik. Po për të njëjtën gjë shërben dhe Bashkimi Perëndimor dhe bloku ushtarak i Atlantikut të Veriut, i drejtuar kundër popujve paqedashës dhe në radhë të parë kundër Bashkimit Sovjetik. Politika agresive e imperialistëve amerikanë e anglezë shfaqet haptas dhe pa asnjë rezervë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duke luftuar propozimet paqësore të Bashkimit Sovjetik, duke mos pranuar ndalimin e armës atomike, megjithëse legjenda e «monopolit atomik amerikan» u rrëzua për tokë nga komunikata e TASS-it e lëshuar më 25 shtator 1949, që lajmëronte se Bashkimi Sovjetik zotëronte sekretin e armës atomike që në vitin 1947. Imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre kërkojnë ta shndërrojnë Organizatën e Kombeve të Bashkuara në një mekanizëm vote për të aprovuar agresionet e tyre kundër popujve dhe paqes. Imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre, mendojnë që krizën ekonomike, që piqet në vendet e tyre dhe në gjithë sistemin kapitalist, ta zhdukin duke kthyer pas rrotën e historisë dhe duke mbuluar njerëzimin me gjak.

Lenini ka thënë se luftërat janë shoqe të pandara të kapitalizmit. Plaçkitja e tokave të të tjerëve, zaptimi dhe grabitja, pushtimi i tregjeve të reja kanë qenë më se një herë, shkaqet e luftërave grabitqare, që kanë bërë

shtetet kapitaliste. Për vendet kapitaliste lufta është një fenomen aq natyral dhe i ligjshëm sa dhe shfrytëzimi i klasës punëtore.

Por, përballë kampit imperialist luftëdashës, ngrihet madhështor dhe i fuqishëm kampi demokratik dhe antiimperialist, që ka në krye Bashkimin Sovjetik dhe që udhëhiqet nga politika e lavdishme staliniane.

«Në kujtesën e popujve janë aq të gjalla tmerret e luftës së kaluar dhe forcat shoqërore që luftojnë për paqe janë aq të mëdha, sa që dishepujt e Çerçillit në punë të agresionit nuk mund t'i mposhtin e t'i hedhin në një luftë të re»¹ — ka thënë Stalini.

Natyra e vetë regjimit socialist sovjetik, ku janë zhdukur klasat antagoniste dhe të interesuara për luftë, përjashton luftën. Shteti sovjetik është shteti armik i vendosur i shtypjeve nacionale dhe raciale dhe politika staliniane bazohet në respektin e të drejtave, të independencës dhe të sovranitetit të të gjithë popujve të mëdhenj dhe të vegjël. Bashkimi Sovjetik, që ka ndërtuar socializmin dhe po ecën në komunizëm, është kundër luftës dhe është faktori kryesor i ruajtjes dhe i konsolidimit të paqes në botë. Politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik në marrëdhënjet me shtetet kapitaliste bazohet në mundësinë që sistemet socialiste dhe kapitaliste të bashkekzistojnë dhe të bashkëpunojnë paqësisht. Që

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda» Nr. 303 (11044) 29 tetor 1948.

më 1934 shoku Stalin ka formuluar shumë qartë këtë politikë me këto fjalë:

«Politika jonë e jashtme është e qartë: ajo është politika e ruajtjes së paqes dhe e forcimit të marrëdhënjeve tregëtare me të gjitha vendet. BRSS nuk ka ndër mend t'i kanoset askujt dhe — aq më pak — të sulmojë ndokënd. Ne jemi për paqen dhe mbrojmë çështjen e paqes. Por ne nuk trembemi nga kërcënimet dhe jemi gati t'i përgjigjemi me grushte çdo grushti të nxitësve të luftës»¹.

Politika paqësore staliniane që ka mobilizuar të gjithë njerëzit e thjeshtë të botës ka demaskuar plotësisht manevrat dhe intrigat e imperializmit amerikano-anglez etj. dhe ka armatosur më së miri popujt e botës për të luftuar me sukses nxitësit e luftës dhe për të bërë të dështojnë të gjitha planet e imperializmit. Kampi demokratik antiimperialist po forcohet dita-ditës më shumë dhe ai imperialist dhe luftëdashës po dobësohet. Demokracitë popullore po forcojnë pushtetin e tyre, ekonominë e tyre dhe si një blok graniti rreth Bashkimit të madh Sovjetik, shpëtimtarit të tyre, ato ndërtojnë socializmin dhe shkatërrojnë komplotet e intrigat e imperialistëve dhe të agjentëve të tyre titistë etj. Me miliona njerëz në botë janë grumbulluar në kampin e paqes dhe luftojnë me të gjitha forcat e tyre, duke ndjekur me përpikëri mësimet e të madhit Stalin dhe

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 294-295.

rrugën e lavdishme të Bashkimit Sovjetik. Popujt nuk e duan luftën, ata janë për paqen dhe luftojnë për paqen. Popujt do të fitojnë kurdoherë kundër nxitësve të luftës. Planet e luftëdashësve imperialistë do të dështojnë. Populli shqiptar, i madh e i vogël, historia e të cilit është mbushur me vuajtje, mjerime dhe luftëra, që hoqi në kurrizin e tij tmerret e Luftës së dytë botërore, do të mobilizohet i tëri për të luftuar, për të mbrojtur paqen. Deri në kasollet më të largëta të malësive duhet të çohet fjala e Stalinit, të mobilizohen njerëzit e vendit tonë për të ndërtuar jetën e re, për të forcuar Republikën tonë Popullore, për të ndërtuar socializmin. Të gjithë të jenë vigjilentë dhe të ashpër e të pamëshirshëm kundër armiqve të Bashkimit Sovjetik, kundër armiqve të popullit tonë dhe të kampit të socializmit dhe të paqes.

Sot, në vigjiljen e 70-vjetorit të lindjes të Stalinit të madh, i gjithë populli shqiptar, mendon dhe brohorit me gjithë shpirt për Josif Visarionoviç Stalinin. S'mund të gjendet njeri i thjeshtë, njeri i ndershëm, njeri i drejtë, njeri që e do popullin dhe atdheun që të mos ushqejë në zemër një dashuri të pakufishme, një mirënjohje të pafund dhe një besnikëri të madhe për udhëheqësin e lavdishëm të të gjithë popujve të botës, Josif Stalinin. Njerëz të tillë nuk mund të gjenden në vendin tonë dhe kurrë nuk do të ketë. Përpjekjet më të përgjakshme të popullit tonë për t'u çliruar nga zgjedha e fashistëve italo-gjermanë dhe feudalo-borgjezëve, të gjitha fitoret e luftës së popullit, vendosja e diktaturës së demokracisë popullore, jeta e re dhe e lirë e popullit tonë, e ardhshmja e lumtur dhe e sigurtë e

tij, janë të lidhura ngushtë e të pandara me emrin dhe veprën e Stalinit të madh.

Çfarë i mëson popullit shqiptar historia e tij e hidhur shkullore? I mëson këtë gjë të madhe, se dëshirat e zjarra të tija, për realizimin dhe ruajtjen e fitoreve, për të cilat ai kishte derdhur lumenj gjaku, u plotësuan vetëm pas Luftës heroike nacional-çlirimtare dhe kjo u bë e mundur pse ekzistonte në botë i fuqishëm e i pathyeshëm Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, i udhëhequr nga shoku i madh Stalin. Pesë shekuj me radhë populli ynë lëngoi nën robërinë e halldupëve otomanë dhe të bejlerëve gjakpirës, që vranë e grinë popullin, por nuk arritën dot ta shfarosnin. Luftëtarët heroikë të popullit shqiptar, të udhëhequr nga Skënderbeu i madh, tmerruan imperatorinë otomane dhe ndaluan për shumë vjet të sulmohej Evropa nga hordhitë e Anadollit. Një grusht popull, i shpërndarë nëpër male, por që donte të rronte i lirë në vendin e tij, u ngrit si rrebesh dhe u bë mburoja e Evropës. Ai s'u mund asnjëherë në beteja, fitoi mbi sulltanët e Stambollit, mbi venecianët kolonizatorë, mbi intrigat e Vatikanit, mbi tradhëtinë e Moisi Golemit dhe të Hamza Kastriotit dhe mbi ushtritë e renegatit Ballaban Baderit. Por, ajo Evropë e asaj kohe, e sunduar nga mbretër e nga tiranë, që i hidhte lule popullit shqiptar, kur ky luftonte dhe e mbronte, ishte pikërisht ajo Evropë e sundimtarëve, që i futi thikën në shpinë dhe e la në baltë. Vuajtjet vazhduan të tmerrshme për stërgjyshërit tanë, që s'i hodhën kurrë armët për të fituar lirinë e shtrenjtë, për të qenë zotër të tokës dhe të shtëpisë së tyre, për të ruajtur nderin e shqiptarit, gjuhën dhe zakonet. Mesjeta me të gjitha

tmerret e saj mbretëronte në vendin tonë. Shqipëria dhe populli shqiptar vuajti të zezat e ullirit, vuajti nga uria, vuajti nga sëmundjet, nga plaçkitjet, nga djegjet e rrënimet. Vendi dhe populli ynë u bënë vazhdimisht plaçkë e imperialistëve, e intrigave të tyre dhe e shërbëtorëve të tyre. Imperialistët anglezë, amerikanë, gjermanë, francezë, italianë, serbë, grekë e sulmonin, e okuponin dhe e shisnin vendin tonë si në ankand, e shfrytëzonin popullin tonë në palcë, i rrëmbenin tokën dhe çdo pasuri që kishte, e përdornin vendin tonë si bazë strategjike për të sulmuar dhe për të robëruar popuj të tjerë; ata kishin në plan shfarosjen e plotë të popullit shqiptar dhe përpiqeshin që t'i impononin një shpirt prej skllavi që të punonte tërë jetën me zgjedhë në qafë për hajdutët imperialistë dhe për bejlerët e borgjezinë e vendit tonë. Po këta imperialistë i imponuan me armë popullit tonë xhelatin Ahmet Zogu dhe gjithë bandën e tij prej kriminelësh, të cilët pasi e shtypën, e ropën dhe e gjakosën për shumë vjet popullin tonë, ja shitën Shqipërinë fashizmit italian. Të papërshekrueshme kanë qenë vuajtjet e popullit tonë. Nata me re të zeza mbulonte botën dhe popujt, por retë e zeza që mbuluan njerëzimin, u shpartalluan nga rrezet e fuqishme të diellit, që ishte Revolucioni i madh i Tetorit, vepra gjeniale e të madhit Lenin dhe Stalin.

U ngjallën shpresat e njerëzimit përparimtar, u forcuan zemrat, lindi drejtësia e pamposhtur në botë dhe kjo përfaqësohej nga shteti i fuqishëm i proletarëve dhe i fshatarëve të varfër, që ndërtoi Partia e lavdishme Bolshevike, që ndërtoi Lenini dhe Stalini.

Na mbuloi fashizmi me forcat e tija të gjakosura

dhe të armatosura deri në dhëmbë. Ai organizoi tradhëtinë, bejlerët, feudalët, spiunët, renegatët, trockistët, krijoi «Ballin Kombëtar», «Legalitetin», për t'i përgatitur zinxhirët e përjetshëm popullit tonë, për të përjetësuar regjimin e litarit dhe të plumbit. Por populli ynë ishte i pavdekshëm, i pamposhtur dhe ai, që në ditët e para të robërisë, filloi epopenë e tij legjendare, luftën e tij të ashpër, të pamëshirshme kundër shkelësve barbarë dhe agjentëve të tyre shqiptarë. Jo, nuk do të mposhtej më populli ynë, nuk do të lejonte më që të përsëritej e kaluara e tij e hidhur, nuk do të lejonte më që punëtori shqiptar të punonte si skllav i fabrikantëve borgjezë gjakpirës dhe i kolonizatorëve italo-gjermanë. Jo, bujku shqiptar nuk do të lejonte që toka e tij të okupohej nga bujqit kolonizatorë të Musolinit, të shitej me shtëpi e pasuri prej beut dhe agait; nuk do të lejonte më që fati i kalamanëve të tij të ishte në duart e vrasësve dhe të spiunëve. Patriotët shqiptarë nuk mund të duronin që vendi i tyre i dashur të rrëmbehej nga të huajt dhe të bëhej pasuri e okupatorëve dhe e xhelatëve të tij shekullorë. «Poshtë robëria, me armë në dorë për të fituar lirinë», kjo ishte britma, që ushtoi në fusha e në male të Shqipërisë dhe këtë kushtim e dha Partia, Partia jonë e lavdishme Komuniste dhe këtij kushtimi ju përgjegj në këmbë me armë në dorë i gjithë populli. Dhe Parti e popull, të bashkuar si një trup i çelniktë, u hodhën në betejat më të përgjakshme, më heroike, që kurrë s'kishte parë historia shekullore e popullit tonë. Me Partinë tonë heroike në krye populli shqiptar doli fitimtar.

Populli ynë u çlirua nga çdo zgjedhë e jashtme dhe

e brendshme dhe përgjithmonë; ai mori frymë lirisht për të parën herë, në epokën e lavdishme staliniane. Lufta e popullit tonë ishte e pandarë nga lufta e popujve sovjetikë dhe lufta jonë u forcua, u zhvillua, sepse Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, sepse populli ynë në kryengritjen e përgjithshme të armatosur ndoqën këmba-këmbës dhe me besnikërinë më të madhe parimet e pavdekshme dhe kurdoherë triumfuese të Stalinit të madh. Zemrat e popullit shqiptar ishin lidhur ngushtë me ato të popujve sovjetikë. Ndjenja të thella lidhnin shpirtërat e partizanëve shqiptarë me Ushtrinë heroike Sovjetike në përpjekjet vigane për të njëjtat qëllime të larta njerëzore dhe çliruese. Sulmi tradhëtar i hitlerianëve kundër atdheut të socializmit e dogji në zemër popullin tonë, por i shtoi edhe më tepër urrejtjen kundër barbarëve fashistë gjermanë dhe italianë. Dhimbjet e popujve vëllezër sovjetikë, ishin dhimbjet e popullit tonë, ashtu siç ishin fitoret e tyre, fitoret tona, pse në saje të fitoreve të shkëlqyera të sovjetikëve, ushtria jonë forconte organizimin, ashpërsonte përpjekjet kundër okupatorëve dhe kuislingëve dhe korrote fitore të reja. Në luftë për jetë a për vdekje, populli ynë fitoi jetën, pse ai u vendos krah për krah me Bashkimin Sovjetik. Partia jonë Komuniste që lindi, u mbrujt dhe u rrit në zjarrin e luftës, Partia që udhëhoqi popullin nëpërmjet dallgëve të tërbuara me aq vetëmohim dhe urtësi, lindi, u rrit dhe u forcua në rrugën dhe me mësimet e pavdekshme dhe triumfuese të bolshevizmit. Partia jonë ishte një parti e tipit të ri leninist, e frymëzuar dhe e edukuar nga mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit, e pastër nga çdo ideologji e huaj bor-

gjeze dhe tradhëtare, ajo lindi dhe u rrit në epokën staliniane, në epokën e socializmit triumfues, në epokën kur të gjitha rrugët të çojnë në komunizëm. Mësimet e Leninit dhe të Stalinit e bënë Partinë tonë të çelniktë dhe të aftë të përballonte sulmet e armiqve të fuqishëm e të pabarabartë. Dashuria dhe besnikëria e popullit tonë dhe e Partisë ndaj Stalinit të madh, ndaj Partisë Bolshevike dhe popujve të dashur sovjetikë, e bënë popullin tonë të pathyeshëm. Armiqtë fashistë, kuislingët tradhëtarë, ballistët, zogistët dhe spiunët u përpoqën me të gjitha mjetet që këtë dashuri dhe besnikëri të popullit dhe të Partisë sonë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, ta shkallmonin, ta zhduknin. Por më kot. Ato rriteshin dhe forcoheshin çdo ditë në zemrat e popullit tonë dhe këtu qëndronte forca jonë më e madhe, garancia e fitoreve tona. Tradhëtarët e shitur te okupatorët, ballistët, zogistët etj. na shanin dhe na akuzonin se s'luftonim për popullin tonë, por për Rusinë. Po, ne luftuam për popullin tonë me Bashkimin Sovjetik e Stalinin në zemër, ne luftuam njëkohësisht me heroizëm për Bashkimin e madh Sovjetik.

Drejtësinë dhe qartësinë e vijës së Partisë sonë e vërtetoi historia, e vërtetoi lufta, e vërtetoi e sotmja e ndritur e vendit tonë, do ta vërtetojë dhe e ardhshmja e lumtur e popullit, që ndërton socializmin me mësimet, në shembullin dhe me ndihmën e vendit të lavdishëm të sovjetëve, ku popujt rrojnë të lumtur dhe ecin drejt komunizmit. S'ka male, shkëmbenj e gërxhe, s'ka fusha, lumenj e kasolle, ku ka luftuar shqiptari, ku kanë rënë trimat e Partisë dhe të popullit tonë, që të mos kenë dëgjuar emrin e Stalinit në momentet kur

ata binin në fushën e nderit për popullin tonë, për Stalinin e madh, që simbolizonte popujt e Bashkimit Sovjetik, Partinë Bolshevike, Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, socializmin, komunizmin, shpëtimtarë të gjithë botës nga kthetrat e kapitalit dhe të imperialistëve.

Dhe këto ndjenja të larta dashurie dhe besnikërie ndaj Stalinit u bënë prona më e çmueshme e gjithë popullit tonë punonjës, u rrënjosën në zemrën e tij, pse ai kuptoi që në ditët e para se Stalini ishte një udhëheqës i lavdishëm, një mësues i madh, që i tregonte rrugën e shpëtimit nga skllavëria e që do ta ndihmonte të ndërtonte socializmin në Shqipëri. Djemtë dhe vashat më të mira të popullit dhe të Partisë sonë, në momentin suprem të jetës së tyre, mendimet e tyre dhe fjalët e tyre të fundit i kishin për popullin, për Partinë, për Stalinin. Plumbat e armikut, duke shpuar kraharorët e të rinjve tanë heroikë, që luftonin si luanë, shponin njëkohësisht dhe veprat e Stalinit, të cilat i mbanin si thesar të shtrenjtë në gji, pse ato ishin ushqimi më i çmueshëm për ta dashur popullin me gjithë shpirt dhe për të luftuar për të deri në vdekje.

Pas luftës, vendi dhe populli ynë u gjendën përpara vështirësive të mëdha politike dhe ekonomike. Imperialistët anglo-amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, u përpoqën me njëmijë mënyra, duke kurdisur komplete, atentate, shantazhe, provokacione të hapëta dhe të fshehta që t'i rrëmbenin nga duart popullit tonë fitoren e madhe, që ai e fitoi me aq sakrifica, vuajtje dhe mjerime. Po ata imperialistë të djeshëm ishin, që kërkonin ta copëtonin Shqipërinë, ta bënin atë një koloni të tyre, ta shfrytëzonin e t'i pinin gjakun, të sillnin përsëri në

fuqi katilat, kuislingët, tradhëtarët, bejlerët. Por me gjithë këto manevra dhe kërcënime, imperialistëve anglo-amerikanë nuk u ndriti. Ata dështuan në orvatjet e tyre prej ujqish të etur për gjak dhe për mish njeriu. Por tani s'ishte më Shqipëria e parë, ajo kishte zot dhe pikërisht zot ishte vetë populli dhe Partia e tij heroike Komuniste, vigjilente e pamposhtur për të mbrojtur me sukses fitoret e popullit, për të mbrojtur Republikën dhe kufitë e saj. Republika Popullore e Shqipërisë s'ishte më vetëm dhe e izoluar si në kohët e vjetra, ajo kishte mbrojtës Bashkimin Sovjetik dhe të madhin Stalin. Partia jonë, që dita-ditës forcohej nga mësimet e Stalinit, populli ynë që me besnikërinë më të madhe ndiqte rrugën e Partisë së tij të dashur, ditën t'i kapërcejnë këto vështirësi dhe t'i dërmojnë intrigat dhe komplotet e imperialistëve dhe të tradhëtarëve. Këta, në pamundësi ta dëmtojnë Shqipërinë, përpiqen vazhdimisht të na nxjerrin pengesa në lëmin ndërkombëtar, duke bërë akuza false dhe të kota, duke kurdisur provokacione, duke shkelur të drejtat tona të fituara me gjak, duke na akuzuar për gjëra të paqena dhe të shpifura kokë e këmbë. Por mbrojtësi i madh e i fuqishëm i popullit tonë, Bashkimi Sovjetik i ka dërmuar shpifjet e tyre, i ka demaskuar orvatjet e poshtra të imperialistëve, të monarko-fashistëve, të agjentëve titistë të Beogradit dhe të të gjithë çakejve, që çirren për luftë dhe që kërcënojnë vendin tonë. Shqipëria, as nuk ka qenë, as nuk do të jetë kurrë e izoluar dhe e vetmuar, siç pretendojnë armiqtë e vendit tonë, që shohin ëndrra me sy hapët, në pamundësi të bëjnë ndryshe. Stalini i madh e ndihmoi popullin shqiptar që të shpëtojë nga klika tradhë-

tare e Titos. Kjo bandë trockistësh në shërbim të imperialistëve amerikanë, që e shiti vendin e vet me dollarë amerikanë, që e shndërroi Partinë Komuniste Jugosllave në një rrjetë agjenturale në shërbim të amerikanëve, që e shndërroi Republikën Popullore Federative të Jugosllavisë në një republikë borgjeze dhe e bëri një kamp përqëndrimi dhe burg për popujt e Jugosllavisë dhe për patriotët jugosllavë, thurte plane për zhdukjen e Republikës Popullore të Shqipërisë, shndërrimin e saj në një koloni të amerikanëve dhe të anglezëve, likuidimin e Partisë sonë heroike, likuidimin e Qeverisë së Republikës Popullore dhe të vendosnin regjimin e borgjezisë dhe të kulakëve, regjimin e spiunëve dhe të vrasësve. Titistët organizuan në vendin tonë, me anën e të dërguarve të tyre dhe të agjentëve trockistë, Koçi Xoxe me shokë, rrjetin e tyre të spiunazhit, ekzekutuan planet e tyre të sabotazhit në gjithë ekonominë tonë, përgatitën me kujdes vrasjen e një numri udhëheqësish të Partisë dhe të shtetit tonë, filluan me anën e njerëzve të tyre propagandën helmuese prej trockistësh kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Partisë së lavdishme Bolshevike, përgatitën planin për okupimin e Shqipërisë me anën e ushtrisë jugosllave. Klika renegate e Beogradit është armikja më e egër e popullit tonë. Partia dhe populli ynë duhet të mobilizohen të tërë për të goditur pa mëshirë të gjithë agjentët titistë që do të tentojnë të dëmtojnë vendin tonë dhe duhet të jenë kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm për të bërë të dështojë çdo plan i tyre kriminal kundër popullit tonë, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër demokracive popullore motra, kundër kampit të socializ-

mit. Por nxitësit e luftës, imperialistët anglo-amerikanë dhe shërbëtorët e tyre titistët dhe monarko-fashistët e të tjerë spiunë nën çdo maskë që do të fshihen, do të dështojnë në veprën e tyre djallëzore, pse kampi i socializmit dhe i paqes është i pathyeshëm dhe ka në krye Gjeneralisimin e madh Stalin.

Vendi ynë i prapambetur dhe i shkatërruar nga lufta nuk mund të mëkëmbej pa pasur një ndihmë dhe kjo ndihmë ju dha popullit tonë që në fillim nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini i madh. Populli ynë i është mirënjohës për jetë atdheut të madh të socializmit dhe shokut Stalin që vetë personalisht interesohet për mbarëvajtjen e popullit tonë, për ndërtimin e ekonomisë sonë socialiste. Përparime të mëdha ka bërë vendi ynë në të gjithë sektorët e jetës së tij. Fabrikat tona ekzistuese u rimëkëmbën në saje të ndihmave që na dërgoi Bashkimi Sovjetik; Kombinati i tekstileve «Stalin», ai i sheqerit e fabrika të tjera, që na ka akorduar Bashkimi Sovjetik po projektohen dhe do të ngrihen. Me qindra traktorë sovjetikë po çajnë fushat tona; transporti në vendin tonë si me hekurudha, si me automjete po konsolidohet në saje të ndihmës, që na jep Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore. Populli ynë po punon me të gjitha forcat e tija dhe sheh rezultatet e përpjekjeve të tija. Jeta e tij po përmirësohet dita-ditës e më shumë. Partia jonë e Punës, po forcohet dita-ditës dhe udhëheq me sukses popullin tonë në rrugën e lavdishme të socializmit, në shembullin e Bashkimit Sovjetik e sipas mësimëve të Stalinit të madh. Njerëzit tanë, punëtorët, fshatarët, rinia jonë heroike dhe e artë, e përvetësojnë me etje të madhe eksperiencën

sovjetike. I tërë populli ynë, i madh e i vogël, në kantiere, në fabrika, në fshatra e në shkolla, është hedhur në sulm me rastin e 70-vjetorit të mësuesit dhe udhëheqësit të lavdishëm, shokut Stalin. Kjo tregon dashurinë e punonjësve tanë për shokun Stalin dhe për popujt e Bashkimit Sovjetik. Edhe njerëzit sovjetikë ushqejnë një dashuri të pakufishme për popullin tonë e për Partinë tonë. Me dhjetëra delegacione shqiptare të përbëra nga punëtorë, fshatarë, dijetarë, artistë, të rinj etj. kanë shkuar në Bashkimin Sovjetik e janë njohur me jetën e sukseset e popujve sovjetikë. Sa të prekshme janë fjalët e tyre kur tregojnë se me sa dashuri janë pritur nga njerëzit sovjetikë dhe sa simpati kanë ata për popullin tonë të vogël.

Sot, në 70-vjetorin e ditëlindjes të Josif Visarionoviç Stalinit, populli ynë i vogël me gjithë shpirt e falenderon dhe i uron jetë të gjatë dhe lavdi, pse ai e mëson, e ndihmon të shpëtojë për jetë nga hallet. Populli ynë ndërton jetën e tij të re me një entuziazëm të papërshkrueshëm, me një hov të madh revolucionar, ashtu si e mëson ai, si na mëson Partia e lavdishme Bolshevike, si na mëson Partia jonë, besnike e marksizëm-leninizmit, e Partisë Bolshevike, e popujve të dashur sovjetikë. Populli ynë lufton dhe punon i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, ai do të çelënikosë dita-ditës dashurinë e tij të pafund për popujt e Bashkimit Sovjetik, për Partinë Bolshevike, për shokun Stalin. Mëmat shqiptare do t'i edukojnë fëmijët e tyre që në djep ta duan Bashkimin e madh Sovjetik, ta duan Partinë Bolshevike, ta duan Stalinin njësoj si popullin e vet dhe Partinë e Punës, pse ata janë garanci e madhe e ruaj-

tjes së pavarësisë së atdheut tonë, pse ata janë garanci për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë, pse ata janë garancia e ruajtjes së paqes në botë.

Sot në ditën e jubileut të të madhit Stalin një zë buçet nga të gjithë kraharorët e gjithë njerëzve të Shqipërisë:

Lavdi për Stalinin e madh, lavdi për popujt sovjetikë, lavdi për Partinë Bolshevike, lavdi për Ushtrinë Sovjetike!

Të rrojë sa malet dhe ju bëftë dita njëmijë mësuesit tonë të shtrenjtë, Stalinit të madh!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 307 (380), 21 dhjetor 1949

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E
BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH ME
EASTIN E SHQYRTIMIT TË RAPORTIT MBI
GJENDJEN E BUJQËSISË PARAQITUR
NGA MINISTRIA E BUJQËSISË**

23 dhjetor 1949

Ky raport që na është paraqitur nga ana e Ministrisë së Bujqësisë është jo vetëm shumë i gjatë, por në të nuk gjen ndonjë gjë të re, në të na thuhet gjëra shumë të zakonshme, të cilat i kemi dëgjuar edhe herë të tjera. Unë mendoj se Ministria e Bujqësisë duhet të na paraqiste dhe të ngrinte në këtë raport më konkretisht ato probleme që i duhen Partisë e jo ta futë Byronë Politike në hollësira të tilla, sikur të ishte aparat bujqësie. Duhet të kritikohet edhe Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror të Partisë, e cila e ka parë një raport të tillë dhe ka qenë dakord që t'i paraqitet Byrosë Politike.

Problemin e bujqësisë ne e kemi marrë në shqyrtim edhe herë të tjera, por kurdoherë raportet që na janë paraqitur nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e Drejtorisë së bujqësisë pranë Komitetit Qendror, në Byronë Politike, në Sekretariat ashtu dhe në qeveri, kanë qenë

të një modeli. Kjo tregon se këta shokë drejtues nuk i njohin mirë problemet e bujqësisë dhe kërkojnë që Byroja Politike, sikur të ishte ndonjë levë e tyre, t'u zgjidhë disa probleme me karakter teknik. Byroja Politike ka të dhëna nga shumë burime mbi situatën e përgjithshme në bujqësi dhe në bazë të të dhënave që ka, duke u mbështetur në vendimet e Komitetit Qendror, jep direktiva e udhëzime, të cilat zërthehen dhe më së fundi kërkohet llogari për zbatimin e tyre. Prandaj, herë tjetër raporte të tilla ne nuk do të pranojmë.

Partia ka një politikë të caktuar për sektorin e bujqësisë, qëllimi i së cilës është që ky sektor të përparojë dhe të modernizohet. Këto janë dy fjalë, por përbëjnë një program të tërë lufte dhe pune. Me çlirimin e Shqipërisë dhe me zbatimin e reformës agrare, qëllimet dhe detyrat tona revolucionare në drejtim të nxjerrjes së bujqësisë nga prapambetja, nuk mbarojnë me kaq. Këtë gjë unë ja kam thënë shumë herë ministrit të bujqësisë dhe duhet të gjithë ta kuptojmë thellë se sa i koklavitur është problemi i bujqësisë, por jo i pazgjydhshëm. Ndërtimi i socializmit kërkon medoemos transformimin socialist edhe të bujqësisë. Ne kemi një fshatarësi patriote, që e ka dëgjuar dhe e dëgjon fjalën e Partisë, por të mos harrojmë se në të njëjtën kohë, ajo, prej natyre, është mikroborgjeze, sepse prona private ka lënë gjurmat e veta në psikologjinë e saj. Sot kemi shumë vështirësi ekonomike, ne e dimë që ka dhe pakënaqësi, por, më vonë, masat që po merren e do të merren nga Partia dhe pushteti do të sjellin një gëzim e kënaqësi të madhe për fshatarësinë.

Ndihma që shteti duhet t'i japë fshatarësisë është

një çështje e madhe politike. Shoku Stalin na ka thënë se po nuk e pa fshatarësia shtetin që ta ndihmojë, atëhere as ajo nuk e ndihmon shtetin. Kjo do kuptuar mirë. E them këtë sepse shpeshherë shokët tanë shkojnë me mendimin që vetëm të grumbullojnë nga fshati prodhime bujqësore e blegtorale. Këtë gjë ne do ta bëjmë, por kjo varet shumë nga një sërë masash të tjera, që duhet të marrim, me qëllim që fshatari të shohë konkretisht ndihmën e pushtetit të tij. Prandaj ne duhet që fshatarëve t'u sigurojmë farëra, plehra kimike, maqina bujqësore, si plugje etj. Por në këtë drejtim ka shumë pakujdesi nga ana e Ministrisë së Bujqësisë. Plugje ka, por shumë herë ato qëndrojnë në shi dhe nuk punohet që t'i marrin fshatarët, të cilët kanë nevojë për ta. Këtu mund të nxiren arësye sa të duash, por është fakt se po të ishte Ministria e Bujqësisë në pozita luftarake, problemi do të ishte zgjidhur. Nga ana tjetër qeveria për fshatarët e varfër ka vënë në dispozicion fonde të konsiderueshme, por këto fonde nuk po harxhohen. Ka maqina të ndryshme bujqësore dhe ato nuk janë shfrytëzuar. Për të gjitha këto përgjegjësia kryesore bie mbi Ministrinë e Bujqësisë, e cila është ngarkuar për zbatimin e politikës së Partisë në sektorin e bujqësisë. Partia si kurdoherë do të mobilizohet për problemet e bujqësisë, por çështja është që kjo ministri ta luajë si duhet rolin e saj të madh.

Një detyrë e rëndësishme që na del është që sektori shtetëror i bujqësisë të bëhet shembull për sektorin privat. Ne kemi feramat, të cilat duhet të jenë një model, ku fshatari të shohë e të mësojë si punohet për të dalë bujqësia nga prapambetja, por përkundrazi ato

janë shumë mbrapa. Një fermë mund të mos i realizojë detyrat dhe të ketë humbje një apo dy vjet, por si ta shpjegojmë faktin që te ne ka ferma, të cilat nuk po i realizojnë detyrat dhe po dalin me humbje pesë vjet me radhë? Kur bëhet gabimi një herë, nxirren mësimë që të mos përsëriten gabimet, por në sektorin e bujqësisë po vazhdohet me të njëjtin avaz. Le të shtrojmë pyetjen: kur sektori i shtetit, që e kemi nën kontrollin tonë, shkon kaq keq, si mundet të flasim për sektorin privat? Ministria e Bujqësisë duhet të kishte dalë mirë të paktën në sektorin kooperativist dhe në atë të shtetit, pse i ka pasur të gjitha mundësitë, por, si duket, ajo s'punon mirë as në këta sektorë. Mund të na thuhet se sektori privat i ha shumë kohë Ministrisë së Bujqësisë, por në asnjë mënyrë kjo nuk duhet të jetë në dëm të dy sektorëve të rëndësishëm: kooperativist e shtetëror. Parimet për ne janë parime dhe duhen respektuar. Kur themi që këta dy sektorë duhet të bëhen shembull, kjo nuk mund të mbetet një frazë boshe. Po çfarë shembulli mund të marrë fshatari në fermat tona, kur ato janë keq për vete? Të marrin shembull për pambukun, i cili në këta sektorë socialistë është për të qarë hallin, apo për bagëtinë, që ngordhin me mijëra? Me këto rezultate, që kanë këta sektorë, ne i komprometojmë parimet. Prandaj, duhet që Ministria e Bujqësisë patjetër ta përmirësojë punën e saj drejtuese. Personalisht ministri i bujqësisë duhet të marrë masa të forta dhe të drejtojë më mirë. Askush nga ne nuk e mohon faktin se shoku ministër është një patriot i njohur, njeri i ndershëm dhe komunist, ne nuk mohojmë gjithashtu as zotësinë e tij teknike, por, për të drejtuar këtë di-

kaster kaq të rëndësishëm, duhet të bëjë më shumë përpjekje.

Bujqësia ka disa probleme kyçe, të cilat duhen kapur si duhet. Për shembull, çështja e kadastrës, për të cilën ne kemi folur gjithnjë dhe e kemi kritikuar, por akoma nuk është përfunduar. Po si mund të bëjë bujqësia pa kadastrë? Ajo është një bazë me shumë rëndësi për sektorin e bujqësisë. Problemi i regjistrimit të tokës, që nga reforma agrare e këtej, nuk e ka preokupuar si duhet këtë ministri, akoma s'ka klasifikim të tokave. Ne nuk mund të pranojmë propozime të pastudjuara, të cilat e bëjnë të detyrueshme mbjelljen e patates edhe në ato vende ku nuk bëhet. Si i lejon këto mungesa Drejtoria e bujqësisë pranë KQ, apo ajo është bërë një apendis i Ministrisë së Bujqësisë? Ajo duhet të ndihmojë e të kërkojë që të plotësohen detyrat për të cilat flasim. Po të veprohet kështu edhe çështja e kadastrës do të marrë fund, do të zgjidhet.

Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë duhet gjithashtu të studjohet problemi i madh i rajonizimit të kulturave bujqësore. Kjo gjë të bëhet mirë dhe njëkohësisht të merren edhe masa të shëndosha organizative për zgjidhjen në praktikë të këtij problemi.

Çështjen e pyjeve Ministria e Bujqësisë nuk e ka studjuar si duhet dhe prandaj na vijnë këtu propozime pa baza. Pyjet janë një pasuri e madhe për vendin tonë dhe ne nuk dimë fare se çfarë bëhet në këtë sektor. Këtu mungon organizimi, ndihma dhe kontrolli shtetëror. Këto gabime dhe të meta ne nuk duhet t'i lejojmë, se i sjellin një dëm të madh popullit. Po kështu, ne nuk dimë mirë çfarë kullotash kemi dhe të shohim se,

në rast se nuk kemi kullota të mjaftueshme, të dimë se çfarë masash të tjera duhet të marrim për sigurimin e bazës ushqimore të bagëtive. Në rast se nuk kemi kullota, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar kullota dhe bazën ushqimore për bagëtitë në mënyrë që ato të mos na ngordhin. Për të gjitha këto probleme, është e domosdoshme që edhe komitetet ekzekutive të rretheve të marrin masat, që u takojnë dhe të zbatojnë si duhet detyrat e tyre. Pushteti në rreth nuk duhet të presë vetëm udhëzime e ndihmë, po të veprojë vetë.

Në fushën e punës politike na mbetet shumë për të bërë. E gjithë puna e revistës që boton Ministria e Bujqësisë duhet të ndryshojë rrënjësisht. Fshatari ynë, ashtu siç botohet kjo revistë, nuk e lexon. Prandaj, agjitacioni me anën e shtypit duhet të jetë sa më i thjeshtë që të kuptohet nga punonjësit e bujqësisë. Të mos kënaqemi me artikuj të gjatë e të përgjithshëm që shkruhen, të cilët fshatari as që i lexon fare.

Problem kryesor për ne është edhe ai i sigurimit të bukës si dhe i bimëve industriale e në këto të fundit në radhë të parë çështja e pambukut. Por për t'u zhvilluar këto kultura, ne duhet t'i japim edhe ndihmën e duhur fshatarit, përndryshe ai nuk i prodhon ato që shteti ynë ka interes. Ministria e Bujqësisë duhet ta kuptojë se pa realizuar pambukun, do të na mbetet pa lëndë të parë kombinati që po ngremë. Për bimët industriale duhet të shihet mirë çmimi i blerjes së tyre nga shteti si dhe zonat ku do të mbillen, me qëllim që fshatari të ketë leverdi të mbjellë dhe plani i shtetit për këto bimë të plotësohet. Të gjitha këto duhet t'i zgjidhni ju, shokë të ministrisë.

Ju, shokë të Ministrisë së Bujqësisë, duhet të mësoni të jepni më konkretisht llogari. Herë tjetër të na raportoni: ç'bëni për përhapjen e eksperiencës së përparuar në bujqësi, ç'keni bërë për të siguruar një evidencë të shpejtë, të plotë e të saktë si dhe për problemet e tjera që theksova e që diskutuan me radhë shokët e Byrosë Politike.

Nga të gjitha këto që diskutuam del se problemet e bujqësisë kanë një rëndësi të madhe dhe, që të zgjidhen shpejt e drejt ato, kërkohet një organizim dhe kontroll i shëndoshë. Për dobësitë e vërtetuara në sektorin e bujqësisë një përgjegjësi të madhe kanë edhe zëvendësministrat, që nuk kanë kontribuar sa duhet për përmirësimin e gjendjes në bujqësi. Të gjithë shokët që drejtojnë sektorin e bujqësisë të shkojnë e të ndihmojnë më shumë bazën. Kur vete një udhëheqës për të kontrolluar në bazë, duhet të arrijë që puna e tij të japë menjëherë rezultate dhe ta ndryshojë gjendjen brenda pak ditëve. Por që të ndodhë kështu kërkohet nga shokët që do të shkojnë në bazë për ndihmë, një studim paraprak i problemeve për zgjidhjen e të cilave do të përgjigjet edhe ai vetë.

Me rëndësi të veçantë është çështja e kuadrit që punon në sektorin e bujqësisë. Të tregohet kujdes që të punohet për ngritjen e nivelit të tyre dhe kjo të mos mbetet detyrë vetëm e zyrave të kuadrit, të cilat nuk janë fabrika kuadrosh. Pa punuar për rritjen e aftësive dhe ngritjen e kuadrove, është vështirë që të kryhen gjithë këto detyra të mëdha që ka përpara bujqësia. Është e nevojshme që herë pas here të organizohen seminare dhe mbledhje me kryetarët e kooperativave

bujqësore. Për të plotësuar nevojat e bujqësisë me specialistë me arësim të lartë, vitin e ardhshëm do të dërgojmë më shumë studentë në universitete; po kështu edhe brenda vendit shkollat e kurset e bujqësisë duhet të ndihmohen e të kontrollohen më tepër nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH, që
gjendet në AQP*

PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË SITUATËS SË BRENDSHME TË VENDIT TONË

*Fjala e mbylljes mbajtur në Plenumin IV të
KQ të PPSH¹*

28 dhjetor 1949

Rezolutat e Byrosë Informative dhe referatet e sho-
këve sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë që pun-
nuan këto rezoluta, na bëjnë të qarta përpjekjet krimi-
nale të imperializmit amerikan dhe anglez, të cilët
kërkojnë të hedhin botën në një luftë të tretë. Nga ana
tjetër ato na tregojnë si t'u bëjmë ballë kërcënimeve
të tyre dhe të dalim fitimtarë mbi nxitësit e luftës. Im-
perializmi amerikan dhe anglez armatoset me shpejtësi
dhe për t'ja arritur qëllimeve të tij ai ka vënë në lë-
vizje të gjitha levat e tija dhe forcën e vet ekonomike
e ka vënë në shërbimin e përgatitjes së luftës, ashtu

¹ Në këtë Plenum të KQ të PPSH u shqyrtuan rezolutat e
Byrosë Informative të disa partive komuniste e punëtore:
a) «Mbi mbrojtjen e paqes dhe luftën kundër nxitësve të luftës»,
b) «Uniteti i klasës punëtore dhe detyrat e partive komuniste
e punëtore», c) «Partia Komuniste Jugosllave në duart e vra-
sësve dhe spiunëve». Këto rezoluta ishin adaptuar njëzëri në
Konferencën e Byrosë Informative që zhvilloi punimet në gjys-
mën e dytë të nëntorit 1949 në Hungari.

siç ka vënë gjithë agjenturën e tij, të gjithë tradhëtarët e klasës punëtore, socialistët e djathtë dhe trockistët, shtypin dhe radion, me qëllim që të helmotosë mendjen e njerëzve që luftojnë për liri, demokraci dhe paqe.

Imperializmi amerikan dhe satelitët e tij kanë shpërthyer një demagogji të madhe për të çorientuar popujt që këta të mos jenë në gjendje të shohin ku është rruga e shpëtimit të tyre. Imperialistët janë mobilizuar kundër Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit të kampit të paqes dhe të socializmit, kundër vendeve të demokracisë popullore, kundër partive komuniste në botë. Imperializmi amerikan kërkon të vendosë hegjemoninë e tij në botë me anën e një lufte tjetër të tmerrshme. Ai kërkon të zhdukë krizën që po kërcënon kapitalizmin, me anë të luftës. Të gjitha paktet dhe traktatet që ka nënshkruar ai me vendet satelite, synojnë skllavërimin e popujve dhe përgatitjen e një lufte të tretë botërore kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Imperializmi amerikan jo vetëm armatoset për vete, po armatos edhe të gjitha vendet që ka hedhur nën kthetrat e tija; ai ka në shërbim të vet të gjitha partitë e borgjezisë, ai ka organizuar dhe ndihmon reaksionin në të gjitha vendet ku lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve kanë marrë hov dhe përpiqet t'i mbytë në gjak këto lëvizje dhe të robërojë popujt. Por kundër kampit imperialist luftëdashës, që ka në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qëndron i pathyeshëm dhe kurdoherë fitimtar kampi antiimperialist dhe demokratik, që ka në krye Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga Stalini i madh.

Për mbrojtjen aktive të paqes duhet të mobilizohen

të gjithë popujt e botës. Lufta kundër imperializmit amerikan dhe anglez, kundër agjentëve të tyre, socialistëve të djathtë, kundër tradhëtarëve trockistë të Beogradit, kundër gjithë borgjezisë në shërbim të imperializmit amerikan dhe anglez, duhet të mobilizojë të gjitha energjitë e popujve. Paqja, mbrojtja aktive e saj, ruajtja e saj i intereson kampit tonë të socializmit, ajo është apanazhi i kampit tonë, i Bashkimit Sovjetik, i vendeve të demokracisë popullore dhe i të gjithë popujve të botës. Kampi ynë është kundër luftërave imperialiste, kundër gjakderdhjes. Regjimi socialist është kundër luftërave agresive. Çdo lëshim nga ana jonë, çdo neglizhencë, çdo nënvleftësim nga ana jonë i orvatjeve dhe i intrigave të armikut, i bën dëm kauzës së madhe dhe të shenjtë të paqes së qëndrueshme. Armiku kurdoherë përfiton prej tyre në dëmin tonë, prandaj lufta jonë duhet të jetë e vazhdueshme, konsekuente, e ashpër kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, nën çdo maskë që ata do të përipiqen të fshehin fytyrën e tyre të ndyrë. Që të korrin kurdoherë suksese në këtë rrugë jetike për popullin dhe për kampin tonë të paqes dhe të socializmit, na vihen detyra të rëndësishme përpara që, jo vetëm të mos i nënvleftësojmë e të mos i neglizhojmë, por t'i kryejmë me përpikërinë më të madhe dhe me zemër e ndërgjegje. Ne nuk duhet të na zërë gjumi mbi këto suksese, përkundrazi, ato duhet të bëhen nxitje për suksese më të mëdha.

Forcimi i situatës së brendshme është një çështje me shumë rëndësi për popullin dhe Partinë tonë dhe

detyra kryesore për ne. Në radhë të parë ne duhet të forcojmë Partinë dhe pushtetin popullor. Populli ynë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të luftuar me sukses çdo orvatje të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tij, që do të përpiqen të krijojnë situata të vështira në vendin tonë me qëllim që të rrëzojnë pushtetin popullor dhe të zhdukin Partinë tonë. Që të mundet Republika jonë Popullore të ecë në rrugën e drejtë të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, kusht i parë është që të kemi Partinë të pastër dhe të fortë.

Partia jonë është e re, por është parti luftarake. Anëtarët e saj kanë kaluar nga zjarri i luftës dhe janë të pajisur me një eksperiencë shumëvjeçare. Partia jonë ka baza të thella në popull, ajo lufton të forcohet gjithnjë e më shumë për të kapërcyer çdo vështirësi dhe pengesë që do të përpiqen të na krijojnë imperialistët dhe agjentët e tyre titistë, brenda dhe jashtë vendit. Partia duhet të ruhet nga armiqtë e jashtëm, por duhet të ruhet shumë dhe nga armiqtë e brendshëm.

Partia jonë është pararoja e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse të vendit. Klasa jonë punëtore është akoma e vogël, ajo nuk ka pasur në aktivin e saj një luftë të gjatë revolucionare dhe përpjekje të shumanshme në të kaluarën, megjithatë edhe në vendin tonë ka ekzistuar një lëvizje punëtore e komuniste, që u bë bërthama e Partisë rreth së cilës u grumbulluan të gjithë ata që e donin komunizmin dhe luftonin për triumfin e tij në Shqipëri. Klasa jonë punëtore megjithatë do të forcohet, do të zmadhohet dhe do të çelënikoset në luftëra.

Pas formimit të Partisë u dukën sëmundje edhe në

radhët e saja, që u suallën nga elementë të borgjezisë, sëmundje që Partia nuk mund t'u shmangej, por ato ajo i luftoi me sukses. Sëmundje do të shfaqen edhe në të ardhshmen, ato do të jenë gjithnjë më të pakta në rast se ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet për forcimin e klasës sonë punëtore, për ngritjen ideologjike të anëtarëve të Partisë, për armatosjen e tyre me shkencën e pararojës, marksizëm-leninizmin. Nga ana e gjithë komunistëve kërkohet një vigjilencë e madhe revolucionare për të mbrojtur Partinë nga çdo rrezik; duhet të përdoret e të zhvillohet mirë kritika dhe autokritika, të jemi të ashpër ndaj gabimeve e të metave tona. Ne duhet të jemi të pamëshirshëm, sidomos, kundër të gjithë deviatorëve, qofshin këta të djathtë ose të majtë, të hapët ose të fshehtë, pse qëllimi i tyre është t'i bëjnë varrin Partisë. Lufta e përditshme do të bëjë që elementë të tillë të dalin në shesh, të luftohen dhe të mënjanohen nga radhët tona.

Gjatë jetës së Partisë sonë janë dukur shfaqje të tilla, siç janë oportunizmi e sektarizmi, të cilat ajo i ka bërë çështje dhe i ka luftuar. Kanë dalë renegatë e tradhëtarë si Koçi Xoxe me shokë, agjentë të trockistëve të Beogradit. Por Partia jonë i ka luftuar me sukses këto shfaqje. Edhe pas kongresit, Partia ka zbuluar shumë shfaqje të sëmura, siç ishin ato që u vunë re në Komitetin e Partisë të Lushnjës dhe të Peshkopisë. Partia i ka analizuar këto sëmundje, ka gjetur burimin dhe shkaqet dhe i ka shtruar në Parti me qëllim që të luftohen dhe të shërohen. Materialet mbi këto shfaqje kanë shërbyer për Partinë, por jo aq sa duhet, pse ka përsëri shfaqje të atilla edhe pas punimit të letrave që

u dërguan poshtë, bile ka njerëz që i kanë punuar këto letra, por vetë nuk janë të pastër, ruajnë po ato të meta dhe shumë herë më të rënda. Lufta e klasës në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm nuk shuhet, prandaj edhe në Partinë tonë asgjë nuk mund të mbetet e fshehtë, asnjë shfaqje e sëmurë nuk mundet të mos dalë në dritë dhe të rrijë e pazbuluar. Sa më e madhe të jetë vigjilenca e anëtarëve të Partisë, aq më shpejt do të zbulohen e do të luftohen këto shfaqje dhe këta njerëz.

Ka shfaqje të atilla, që janë shtruar dhe luftuar shumë herë nga Partia, si ajo e simpative dhe miqësive të sëmura, që çojnë në formim grupesh jashtë Partisë dhe bëhen çerdhe pikëpamjesh jo të shëndosha dhe antiparti. Këta shokë kritikojnë nga të katër anët çdo forum dhe çdo njeri, mbarë e mbrapsht, ushqejnë iluzionin sikur janë këta që mbrojnë Partinë dhe zbatojnë vijën e saj, por në realitet ata thyejnë vijën e Partisë dhe zbatojnë vijën e grupit, direktivat e grupit. Ata shkojnë në punë dhe në detyrë me konkluzionet e arritura në grup dhe natyrisht të gabuara, që janë rezultat i bisedimeve në rrethe të ngushta shokësh të sëmurë. Nuk mund të pretendohet që në Partinë tonë të mos ketë njerëz ose forume që nuk gabojnë. Këto gabime duhet të kritikohen ashpër, të ndreqen dhe ndaj atyre që nuk i ndreqin, të merren masa. Por diskutimet e kritikave duhet të bëhen në organizatën bazë të Partisë dhe jo në rrethe shokësh e miqsh. Ata, që përmenda më lart, këtë punë nuk e bëjnë brenda në organizatat bazë të Partisë dhe t'i ndihmojnë kështu shokët për të luftuar dhe zhdukur gabimet e të metat në punë. Këta njerëz

të sëmurë, që mblidhen nëpër rrethe shokësh, vuajnë nga megalomania, hiqen si njerëz të zot e të zgjuar, të aftë të kryejnë sipas mendjes së tyre, çdo gjë me sukses. Ata, siç mendojnë për veten e tyre, janë «të pagabueshëm», por në realitet bëjnë më shumë gabime dhe mbi të gjitha bëjnë gabimin parimor që me këto veprime thyejnë vijën e Partisë. Kur bien në kontakt me realitetin dhe hasin vështirësi në punë, ata nuk janë të zot t'i kapërcejnë këto dhe gabojnë rëndë, mirëpo gabimet i fshehin, u gjejnë arsëyet dhe, në rrethin e sëmurë të shokëve, krijojnë besimin se ato s'janë të tyre, por të të tjerëve. Të tillë njerëz revoltohen kur kritikohen drejt, ata preken dhe venë për të gjetur ngushëllim në grupin e tyre. Një veprimtari si kjo të çon drejt fraksionit.

Ka pastaj shokë që bëjnë faje të tilla të rënda, për të cilat në kohë lufte ato dënohen me pushkatim. Në autokritikat që bëjnë, ata pohojnë se gabimet e tyre e kanë burimin te mosbesimi dhe paragjykimet që kanë ushqyer ndaj Partisë në të kaluarën dhe në të tanishmen dhe në shumë prapamendime ose paragjykime të tjera të rënda. Ata që janë shokë me këta elementë të sëmurë, i mbrojnë dhe, duke pëshpëritur andej-këtej nëpër rrethe miqsh, kërkojnë jo vetëm t'i nxjerrin të pastër e të larë, por përpiqen të diskreditojnë edhe udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit. Është për t'u çuditur se si një komunist mund të mbrojë një fajtor, kur ky vetë pohon se ka bërë një gabim të pafalshëm, se s'ka pasur besim te Partia dhe udhëheqja. Kjo të jep të kuptosh se ata që mbrojnë një element të tillë, janë në të njëjtat ujëra dhe pozita, d.m.th. nuk janë në

rregull në këto çështje. Partia i kupton këto gjëra dhe mënyra veprimi dhe natyrisht do të marrë dhe masa për t'i ndrequr. Lëshime në këtë drejtim nuk lejohen: ose në rrugën e Partisë ose në rrugën e kundërt me të. Rrugë të mesme nuk ka. Ne duhet të kemi durim me njerëzit, t'i ndihmojmë këta të shërohen, kur kanë gabime, por në rast se nuk ndreqen, atëhere t'u jepet grushti. Nuk përjashtohet që në këto çështje të ketë edhe gisht armiku. Komunisti do të bëjë gabim në rast se përjashton një gjë të tillë, veçanërisht, kur një person nuk ndreqet dhe vazhdon në rrugën e tij. Një njeri me koskë komuniste, nuk bën gabime të tilla. Atyre që gabojnë në mënyrë të vazhdueshme e s'korrigjohen, po t'u studjohet e shkuara e tyre si komunistë, do të gjendet lehtë filli se kanë qenë të sëmurë prej kohe, se gabimet e tyre s'janë të rastit, po specifike. Detyra e Partisë është t'i studjojë njerëzit dhe aktivitetin e tyre, pse vetëm kështu do të shërojnë njerëzit e sëmurë dhe do të spastrojë nga radhët tona të pashërueshmit. Disa nga këta njerëz kanë bërë gabime të dënueshme, të cilat u janë falur, duke marrë parasysh rrethanat. Por kur situatat janë të qarta, kur puna e Partisë është forcuar dhe këta njerëz vazhdojnë të përsëritin gabimet e vjetra, Partia jo vetëm që nuk i harron ato, por nuk u fal as të rejtat, ajo nuk mund të mbyllë sytë përpara këtyre gjërave.

Ka në radhët tona njerëz megalomanë dhe karrieristë, që rrojnë për grada dhe poste, që trillojnë çështje dhe vënë në rrezik jetën e Partisë, duke pritur momentin për të ndezur minën. Mirëpo kur zbulohen, ata përpiqen të hiqen si qingja dhe mbajnë qëndrime nga

më servilet. Komunistët e vërtetë nuk janë të kësaj stufe. Të tilla qëndrime të këtyre njerëzve të sëmurë, nuk janë të rastit dhe, për të fshehur gabimet e tyre, ata pretendojnë se po persekutohen. Ka pastaj nga këta, që thonë se Partia i sheh me sy të keq, ose ndaj tyre ka kurdoherë përshtypjet e vjetra, kur ata kishin gabuar. Këto gjëra ata i thonë, kur vazhdojnë të bëjnë gabime shumë të rënda dhe në veten e tyre e ndjajnë se kanë bërë faj të madh ndaj Partisë, por që nuk janë nga ata komunistë, që të njohin gabimet haptas dhe të bëjnë autokritikë bolshevike. Natyrisht, këto arësye që nxjerrin nuk kanë asnjë vlerë përpara Partisë, sepse kjo është sjellë drejt me këta njerëz, i ka kritikuar haptas kur kanë bërë gabime dhe më vonë i ka ndihmuar, i ka graduuar, i ka shpënë deri në Komitetin Qendror. Kur një person vazhdon të punojë kundër vijës së Partisë dhe aktiviteti i tij zbulohet, ai trillon arësye për ta fshehur gabimin. Mirëpo, Partia i kupton këto gjëra dhe jo vetëm e gjykon atë si një anëtar partie që gabon, por e gjykon dhe e dënon si një recidivist, si element, që vazhdon të përsëritë fajet e mëparshme në një shkallë më të madhe.

Ka shokë të Partisë, që u rritet mendja kur bëhen drejtorë ose anëtarë apo kandidatë të Komitetit Qendror dhe nuk peshojnë as mendimet e shokëve, as pikëpamjet e forumeve. Këta njerëz duhet të shërohen, ndryshe Partia do t'ua presë barin nën këmbë, ajo nuk do të lejojë, cilindo qoftë, që të marrë nëpër këmbë anëtarët e tjerë të Partisë dhe forumet e saj. Pikëpamjet e një forumi të Partisë janë më të drejta se pikëpamjet e një individi. Në rast se pikëpamjet e një individi janë të

drejta, organizata bazë ose forumi janë plotësisht në gjendje t'i çmojnë ato, t'i pranojnë dhe t'i vënë në zbatim, por në rast se janë të gabuara, organizata bazë ose forumi janë prapë në gjendje t'i gjykojnë si të pavlefshme dhe t'i flakin tej. Anëtari i Partisë sa më lart që të shkojë, aq më shumë duhet të ndjejë përgjegjësinë ndaj Partisë. Të shkëputesh nga Partia, të konsiderosh shokët e tjerë të vegjël dhe organizatën bazë e forumet si të pavlefshme, është një gabim i rëndë, që të çon në shumë veprime të rrezikshme.

Jeta është luftë dhe ne nuk mund të pretendojmë nga njerëzit e Partisë një përsosmëri në jetën dhe punën e tyre. Por jeta dhe puna që bën anëtari i Partisë në organizatë e çon atë drejt perfeksionimit. Arma e kritikës dhe e autokritikës e formon komunistin e vërtetë. Por ka dhe njerëz të çuditshëm që preken në minutë nga një kritikë që u bëhet; atyre u mungon gjakftohtësia dhe s'bëjnë përpjekje t'i zgjidhin çështjet në rrugën e Partisë, por nga një pakënaqësi kalojnë në një tjetër dhe kështu formohet në shpirtin e tyre një lëmsh mërish, zënkash, hatëresh të mbetura, të cilat zhvillohen dhe bëhen pastaj të rrezikshme për Partinë. Këta njerëz do të bëjnë patjetër gabime në jetën e tyre, do të kritikohen, por është e qartë se ata nuk do t'i pranojnë kritikën, pse s'janë në gjendje të bëjnë një autokritikë të vërtetë. Këta njerëz i mbulon një shqetësim i madh, rrojnë si mbi gjëmba, krijojnë dyshime, ua hedhin fajin shokëve të tjerë ose forumeve dhe duke mos qenë të pastër vetë, pëshpërisin se e ka fajin Partia ose Komiteti Qendror. Shërimi i vetëm i këtyre është autokritika bolshevike. Një komunist, që bën autokri-

tikë të hapët, nuk ka pse të shqetësohet, përkundrazi ai duhet dhe e ndjen veten të çliruar nga ajo që e shtypte.

Ka njerëz që dyshojnë për çdo gjë, kanë frikë. Pse ngjet kjo? Kjo ngjet se këta njerëz kanë bërë gabime, s'i kanë njohur këto dhe pra nuk janë të pastër. Po t'i lejohet një shoku pa përgjegjësi të bëjë një shaka me ta, ata e lidhin këtë shaka pa asnjë farë kuptimi me njëmijë çështje, që ziejnë në kokën dhe zemrën e tyre dhe krijojnë pikëpamje të dëmshme për Partinë. Te këta armiku ka mundësi të mëdha të hedhë ganxhat, pse njerëz të tillë shpirtërisht janë të prirë të shkojnë në rrugën antiparti. «Nuk jam dakord me Partinë» thotë shoku. . . Por, në rast se ai nuk është dakord me Partinë, edhe Partia nuk është dakord me të. Të mos jesh dakord me Partinë, do të thotë të jesh dakord me armikun dhe ata që janë kundër Partisë, janë renegatë, trockistë e titistë.

Po janë marrë edhe masa të pamatura, të cilat duhet të shihen që të mos merren më qafë shokët. Çdo gjë në Partinë tonë duhet të zgjidhet drejt, asgjë nuk mund të lihet pa u vënë në rrugë të drejtë. Komunisti nuk djeg jorganin për një plesht. Ai ka besimin më të madh në drejtësinë e Partisë dhe kurdoherë ka durim. Partia duhet të jetë vigjilente ndaj elementit të dobët dhe të lëkundshëm, që ka infiltruar në radhët e Partisë sonë në momentet e Luftës nacional-çlirimtare. Partia duhet të ruajë pastërtinë e radhëve të saja, të luftojë presionin e borgjezisë, të luftojë pikëpamjet borgjeze e mikroborgjeze, që ekzistojnë në një sërë shokësh. Për këtë duhet të bëhen përpjekje për ngritjen ideologjike,

sepse çështja e studimit nuk ka arritur akoma në një shkallë të kënaqshme. Ka ndër ne anëtarë partie prakticienë të mirë, por që përtojnë të lexojnë edhe organet kryesore të shtypit. Çështja e së ardhshmes së vendit tonë është e kondicionuar me forcimin e Partisë, si nga ana organizative, ashtu edhe nga ana politike, ideologjike dhe kulturele. Kështu do të bëhet Partia jonë drejtuesja e çelniktë e popullit, si në çështjet shtetërore, ashtu edhe në aktivitetin shoqëror, kultural etj.

Armiqtë e vendit tonë do të orvaten ta dëmtojnë Shqipërinë e re nga brenda. Ata do të përpiqen të organizojnë grupe e akte sabotazhi si dhe atentate kundër udhëheqësve. Por një gjë të tillë ata do të mundin ta bëjnë vetëm po të flejë Partia. Partia jonë nuk fle dhe as nuk do të flejë.

Rrezik nga më kryesorët për ne, është veprimtaria armiqësore e renegatëve të Beogradit, kësaj agjente të imperializmit. Trockistët e Beogradit, që janë armiq të betuar të Bashkimit Sovjetik, të kampit të socializmit dhe të vendit tonë, do të përpiqen të futin te ne, me çdo mënyrë, agjentë dhe diversantë. Duke i mobilizuar në radhët e reaksionit të brendshëm dhe të elementëve renegatë, ata do të përpiqen t'i vënë këta në lëvizje kundër pushtetit tonë popullor. Për këtë qëllim ata kanë grumbulluar në Jugosllavi edhe një sërë tradhëtarësh e kriminelësh lufte shqiptarë, që t'i përdorin kundër vendit tonë. Të tillë elementë ata i organizojnë dhe i armatosin për t'i futur në momentet e volitshme për ta, këtej kufirit tonë, për të bërë turbullira. Titistët po bëjnë një propagandë të poshtër në Kosovë për të rekrutuar mercenarë, me të cilët men-

dojnë të kryejnë akte diversioni dhe sabotazhi në vendin tonë. Armiqtë trockistë jugosllavë në asnjë mënyrë nuk duhet të nënvleftësohen. Ata janë armiq të egër të popullit shqiptar dhe të Bashkimit Sovjetik. Ne do të jemi kurdoherë në përpjekje me ta dhe me agjenturën e tyre brenda vendit tonë. Ata do të përpiqen kurdoherë të na dëmtojnë. Borgjezia në vendin tonë, tradhëtarët dhe agjentët, të gjitha shpresat i kanë varur jashtë. Ata do të përpiqen të organizohen nën hijen e titistëve.

Ju e dini demagogjinë e madhe që bëjnë renegatët titistë se, gjoja, ata po ndërtojnë socializmin etj. Njerëzit që nuk e durojnë dot drejtësinë e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor, ata që kanë halë në sy popullin në fuqi, do t'i bëjnë të tyret këto parulla demagogjike dhe do të inkuadrohen në radhët e spiunëve titistë për të luftuar Partinë dhe pushtetin tonë popullor. Që me kohë tradhëtarët e Beogradit dhe agjentët e tyre, që ishin në Shqipëri, kanë bërë përçapje të afrojnë dhe të grumbullojnë rreth tyre reaksionarët shqiptarë për të pregatitur terrenin për momentin vendimtar, kur ata kishin vendosur t'i futnin thikën në shpinë Republikës Popullore të Shqipërisë. Ata u përpoqën, që njerëzit e borgjezisë dhe spiunët t'i futnin në Partinë tonë dhe në pushtet dhe për këtë ata punuan dhe u përpoqën deri në fund. Pushtimi i Shqipërisë me anë të divizionit jugosllav s'do të ishte përveçse faza e fundit e përpjekjeve të tyre për të siguruar marrjen e pushtetit në dorë nga ana e Koçi Xoxes dhe për të likuiduar përgjithmonë Republikën Popullore të Shqipërisë dhe Partinë tonë të Punës. Titistët jugosllavë dështuan në që-

llimet e tyre djallëzore, po ata nuk i kanë hedhur armët, ata do ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre armiçësore me të tjera metoda dhe me po këta lloj njerëz. Prandaj, vigjilenca e Partisë dhe e popullit në asnjë moment nuk duhet të ulet, po me ashpërsinë më të madhe duhet të goditen të gjitha përpjekjet që do të bëjnë armiqtë për të dëmtuar vendin tonë. Pra, armët e saja Partia duhet t'i ketë kurdoherë të mprehta dhe të godasë pa mëshirë.

Për këtë qëllim duhet t'i kushtohet kujdes i madh në radhë të parë forcimit të pushtetit, pse ndërtimi i socializmit dhe mbrojtja e vendit nuk mund të bëhen me një pushtet të dobët. Pushteti ynë është duke u forcuar, por duhen bërë akoma përpjekje të mëdha në këtë drejtim. Sëmundja e vjetër që Partia të mos ja japë të tëra kompetencat që i takojnë pushtetit, është një pengesë për forcimin e tij dhe një gabim që duhet ndrequr. Nga një pengesë e tillë ndodh që punët të mos ecin me atë hov që dëshirojmë. Komitetet e Partisë marrin çdo punë mbi vete dhe errësojnë kompetencat e pushtetit. Një gjë e tillë nuk duhet të ngjasë. Partia është e domosdoshme të jetë motori drejtues si për çdo sektor, edhe për pushtetin, ku ajo duhet të këshillojë, të drejtojë, të korrigjojë, por ajo duhet të bëjë gjithashtu që njerëzit në pushtet të kryejnë detyrat e tyre brenda kompetencave që u takojnë, të jenë përgjegjës, të japin llogari përpara Partisë dhe organeve shtetërore e qeverisë. Kryetari, sekretari dhe këshilli i pushtetit, nën drejtimin e Partisë, duhet të jenë ata që të drejtojnë me të vërtetë pushtetin dhe të zgjidhin problemet shtetërore dhe të popullit. Por në realitet nuk ngjet kështu dhe ka lëshime në këtë drejtim. Organizatat e Partisë

herë-herë i nënçmojnë njerëzit e pushtetit dhe punën e tyre. Për faktin që shokët e komiteteve të Partisë përgjithësisht janë më të ngritur nga ata të pushtetit, kërkohet prej tyre që të mos bëhen fodullë dhe të nënçmojnë njerëzit e pushtetit, por t'i drejtojnë, t'i ndihmojnë, t'i ngrenë dhe t'u japin kompetencat që u takojnë, për të kryer mirë punët.

Në praktikën e punëve tona është vënë re se sekretarët e Partisë thirren vazhdimisht në qendër për t'i instruktuar dhe për t'u kërkuar llogari. Kjo është një gjë e drejtë, por ajo që nuk është e drejtë, është praktika që njerëzve të pushtetit u kërkohet pak llogari, këta nuk vihen përpara përgjegjësive që kanë. Nga ana tjetër, pushtetin duhet ta bëjmë sa më demokratik dhe të jetë i afërt me masat, populli të ushtrojë vazhdimisht kontrollin mbi të. Kjo do të thotë që njerëzit e pushtetit, s'duhet të harrojnë kurrë se janë përgjegjës përpara popullit dhe t'i japin llogari atij. Prandaj, neve na bie barra ta forcojmë sa më shumë pushtetin, pse me anën e tij ekonomia e vendit tonë do të përmirësohet, do të përparojë dhe në këtë mënyrë do të luftohet armiku dhe ky do të gjejë vështirësi të mëdha për të organizuar luftën kundër pushtetit tonë.

Partia duhet të ushtrojë gjithashtu vigjilencën e saj të madhe revolucionare në të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë, të ndihmojë që të luftohen kudo dhe të korrigjohen të gjitha të metat dhe gabimet që bëhen.

Duhet të forcojmë dita-ditës e më shumë ushtrinë, Armën e Sigurimit të Shtetit, policinë, rojet e kufirit, duke mbushur vazhdimisht radhët e tyre me patriotë të vendosur dhe vigjilentë. Ato janë kurdoherë në luftë

me sabotatorët dhe diversantët që dërgon armiku. Nuk është më situata si në kohën e Plenumit XI, kur Arma e Sigurimit të Shtetit shikohej me një sy të dyshimtë. Ky është një sukses i madh, pse Arma e Sigurimit tanimë është pastruar nga elementët antiparti e trockistë të Koçi Xoxes dhe të jugosllavëve dhe po korr suksese në luftën kundër armiqve të vendit. Megjithatë, siç e thanë një shok këtu ka akoma disa shokë, që punën e njerëzvetë organeve të sigurimit e konsiderojnë si diçka jo të ndershme. Të tillë njerëz s'janë as komunistë as patriotë. Aktiviteti i punëtorit të Sigurimit të Shtetit, puna e tij e frutshme, mund të konsiderohet, në disa raste, më heroike se sa fitorja e një gjenerali në një betejë, pse pikërisht frutet e punës së një njeriu të sigurimit shmangin betejën, ku, me gjithë fitoren, derdhet gjak, mbeten me qindra shokë të vrarë. Njerëzve të tillë, që i shohin shokët e sigurimit me atë sy që i shikonte populli agjentët e Musa Jukës, të cilët punonin për të mbajtur në këmbë një regjim skllavërues dhe shtypës për masat punonjëse, kur këta janë të thjeshtë, t'u shpjegohet e të sqarohen se punëtorët e Sigurimit të Shtetit shërbejnë me heroizëm dhe vetëmohim për mbrojtjen dhe forcimin e pushtetit popullor nga armiqtë. Partia duhet t'u japë të gjithë ndihmën e vet këtyre organeve, ndihmë që duhet të jetë e shumanshme dhe konkrete. Njerëzit e organeve të sigurimit të jenë nga më të vendosurit dhe më të zgjuarit, të nderohet dhe të çmohet vepra e tyre, pse kjo kryhet në rrethana të zorshme dhe në luftë të vazhdueshme me armikun. Në këtë armë duhet të shkojnë kuadro të mirë të Partisë, duhet punuar që ata të edukohen në frymën e patriotiz-

mit të lartë, në frymën e internacionalizmit proletar, t'u krijohen kushte të përshtatshme e ambient i ngrohtë shoqëror, sepse kështu lufta që do të bëjnë ata kundër armiqve do të jetë më efikase.

Si thashë edhe më parë, armiku do të orvatet të krijojë vështirësi brenda në vendin tonë, prandaj rojet e kufirit duhet ta bëjnë kufirin gardh, të papërshtatshëm. Shokët e Partisë duhet të mendojnë se ushtarakët, që shërbejnë për mbrojtjen e kufirit vite me radhë, qëndrojnë heroikë nëpër male dhe mbrojnë me vigjilencë kufitë e atdheut. Ata nuk mërzhiten aspak si ai sekretari për punë organizative i një komiteti partie rrethi, i cili rrethin e tij, ku e ka ngarkuar Partia të punojë, e konsideron si një varr dhe ka nostalgjinë e Tiranës, pse këtu ka më shumë teatro, kinema, dëfrime etj. Partia, pra, t'i forcojë këto armë të diktaturës së proletariatit dhe të tregojë një kujdes të veçantë për to.

Për forcimin e gjendjes në vendin tonë një rëndësi të dorës së parë ka çështja e realizimit të planit të shtetit. Ne e kemi thënë gjithnjë se këtu kemi shumë të meta, që mundet dhe duhet t'i ndreqim. Kjo do të arrihet në rast se vendosim disiplinë të hekurt dhe përgjegjësi në detyrë nga të gjithë dhe në radhë të parë nga komunistët. Për të realizuar me sukses planet tona ne kemi ndihmën e madhe nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë, pastaj dhe nga vendet e demokracisë popullore motra. Në vitin 1950 kjo ndihmë do të jetë më e madhe nga ajo e vitit 1949. Ne jemi përgjegjës përpara popullit për realizimin e plotë të planit. Populli duhet të shohë rezultatet e drejtimit të Partisë dhe të

qeverisë, të shohë konkretisht përmirësimin e jetës së tij, ndryshe ai humb besimin te Partia dhe pushteti. Ka pasur momente shumë të vështira gjatë të cilave ne duhej të mëkëmbnim ekonominë. Këto tani i kemi kapërcyer, por për mungesë organizimi, disipline e kontrolli në punë, ne kemi pasur dëme, të cilat po të ishin evituar me kohë, kjo do të përbënte një plus të madh në përmirësimin e jetës së popullit.

Na kanë tërhequr çështjet duke menduar vetëm si të grumbullohen prodhimet bujqësore e blegtorale dhe të vilen taksat nga populli. Këto janë të domosdoshme, pse përsëri ato i shkojnë popullit në forma të ndryshme, por jemi preokupuar më pak dhe e kemi organizuar dobët furnizimin e popullit. Populli s'merr në rregull vajin, kripën dhe shumë artikuj të tjerë, për të cilët ka nevojë. Kushtet tona ekonomike nuk janë në atë shkallë që popullin ta furnizojmë me bōllëk; në të ardhshmen edhe kjo do të vijë patjetër, por tani ne nuk e kemi furnizuar as brenda mundësive që na lejohej. Prandaj, të rishikojmë shpejt punët në këtë drejtim, organet shtetërore të kryejnë me ndershmëri detyrën, çdo njeri të marrë përgjegjësitë që i takojnë dhe Partia të jetë vigjilente kundër neglizhuesve dhe të marrë masa më të rrepta. Këtej e tutje çështjet nuk duhet të shkojnë kështu si kanë shkuar.

Duhet të mendohet që planet tona të jenë sa më reale. Plani i këtij viti është bërë në bazë të të dhënave të sektorëve përkatës, po në shumë raste ai u përgatit pa u thelluar dhe pa u kontrolluar nga udhëheqja e dikasterit. Një praktikë e tillë duhet të marrë fund. Në hartimet e planeve ekziston edhe një rrezik tjetër; duke

u bazuar gjoja në mundësitë tona, hartohen plane të vogla, shkohet me pikëpamjen «për të qenë brenda» për t'i thënë nesër Komitetit Qendror dhe qeverisë se plani u realizua. Plani duhet të hartohet brenda mundësive, por duhet të bëhen përpjekje të mëdha, që të punohet kudo me rendiment sa më të madh që plani të tejkalohet. Në rast se njerëzit, që i hartojnë dhe i zbatojnë planet, nuk e shohin çështjen në këtë drejtim, atëherë ata nuk kanë punuar në vijën e Partisë.

Një çështje tjetër, që duhet të kemi kurdoherë parasysh, ka lidhje me përpjekjet e Partisë për të forcuar klasën punëtore dhe për ta bërë këtë shtyllën e çelniktë të saj. Klasa jonë punëtore në të ardhshmen, me zgjerimin e industrisë, do të shtohet dhe do të forcohet. Klasa jonë punëtore do të shtohet me elementë të rinj nga radhët e fshatarësisë. Prandaj, Partisë i vihet për barrë që të bëjë një punë intensive për edukimin e klasës sonë punëtore dhe një rol i madh në këtë drejtim u takon bashkimeve profesionale.

Politika jonë në fshat duhet t'jetë e drejtë që fshatarësinë ta mobilizojë rreth problemeve të shtetit dhe t'i pregatitë asaj një jetë më të mirë. Po të kishim qenë më shumë vigjilentë dhe të ishin bërë më pak lëshime, ne do të kishim evituar mjaft gabime që janë vërtetuar në fshat. Ne bëmë reformën e madhe agrare, por padrejtësitë, që mund të ishin bërë gjatë dhe pas zbatimit të saj, ne nuk i shikuam, nuk i korigjuam, por i lamë dhe u bënë një vandak i madh dhe pastaj u ramë shkurt. Nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme nga ana e organeve të Partisë dhe të shtetit që fshatari i varfër të marrë kredi nga shteti për të përmirësuar ekonominë e

vet bujqësore dhe të sigurojë sa më tepër rendiment nga toka. Fshatarët nuk po e përdorin kredinë shtetërore; komitetet e Partisë në rrethe, jo vetëm nuk i nxitin në këtë drejtim, por kënaqen me mendimin se fshatari s'ka nevojë. Ka fshatarë të varfër që janë të zhveshur dhe pa mjete pune të mjaftueshme. Është e mundur që ai të mos pranojë kredinë e shtetit me kushte kaq të favorshme për të? Është krijuar opinioni se fshatari ka me bollëk. Kjo s'është kurdoherë e vërtetë. Ka fshatarë të tillë, që nuk kanë me të vërtetë nevojë për të marrë kredi nga shteti, por ka edhe të tjerë, që janë të varfër, sidomos në vende malore, ku, megjithëse është përmirësuar jeta e tyre, nuk mundet të themi kurrë se ata nuk kanë nevojë për kredi. Kjo vjen pse Partia nuk ka punuar sa duhet për t'i bërë ata të qartë që të shohin dhe të pranojnë ndihmën që u jep pushteti i tyre, për të përmirësuar jetesën dhe për të modernizuar bujqësinë. Në fshat duhet të bëhet një propagandë sa më e madhe, si për çështjet bujqësore, ashtu edhe për çështjet politike. Të përkrahet shkolla, të luftohet analfabetizmi dhe të shpërndahet shtypi i Partisë, i cili gati nuk shkon fare. Nga një punë e shëndoshë në fshat, jo vetëm bujqësia jonë do të përparojë, por ne do të tërheqim në fabrikat tona fshatarë, që do të punojnë me të gjitha forcat dhe me ta do të çelmosim radhët e punëtorëve.

Ne shumë herë flasim për përmirësimin e kushteve të punëtorëve, por deri tani nuk është bërë sa duhet në këtë drejtim. Dhe ajo që është e dobët te ne, është se nuk del përgjegjësia e personit ose e entit që pengon zbatimin e plotësimin të kësaj direktive të Partisë. Nxirren

justifikime, i hidhet gabimi herë njërit, herë tjetrit, po rezultati është se punëtorit i mungojnë sendet e domosdoshme të jetesës. Në këtë çështje ka shkelje disipline, konfuzion, me të cilat u nxirren vështirësi Partisë dhe shtetit nga njerëz dhe ente të ndryshme, që pengojnë për ta përmirësuar këtë situatë. Qendrat e punës nuk furnizohen në rregull dhe komunistët, që drejtojnë këto qendra, jo vetëm nuk bëjnë përpjekjet e duhura për ta përmirësuar situatën, por nuk ndihmojnë as Partinë as shtetin që të gjenden përgjegjësitë. Këto gjëra duhet të ndreqen sa më parë. Komunistët duhet t'i vrasë ndërgjegjja për përmirësimin e kushteve të jetesës së punëtorëve dhe këtë duhet ta konsiderojnë si një nga problemet e tyre më të rëndësishme.

Një gabim tjetër, që vërehet në lidhje me problemin e punëtorisë, është çështja e masave administrative që merren ndaj punëtorëve, pse venë me disa minuta vonesë në punë etj. Ky është një gabim i madh. Funkionarët që marrin këto masa mund të thonë se ekzistojnë rregullore e ligje, po këto veçse duhen interpretuar drejt. Më parë, p.sh. prokuroritë dhe gjykatat, duke treguar një oportunitizëm të madh, linin pa dënuar njerëz që bënin faje të rënda në dëm të ekonomisë shtetërore. Tani funksionarët e këtyre organeve janë hedhur në anën tjetër. Po ndaj atij që, për pakujdesi ose mosdrejtim të mirë të punëve, i ka shkaktuar shtetit me dhjetëra milion lekë humbje, ç'duhet të bëjmë? Prandaj, këto qëndrime të gabuara duhet të ndreqen. Problemi kryesor aktual për ne është tani që të grumbullojmë fshatarët që janë pa punë, t'i tërheqim ata në fabrika e qendra pune për realizimin e planit të

shtetit. S'duhet të harrojmë natyrën e fshatarit; ai është i lidhur me ekonominë e tij dhe me jetën e fshatit, prandaj, kur vjen në qendrën e punës, ai ruan nostalgjinë e fshatit të tij. Duke pasur parasysh këtë, natyra e tij mikroborgjeze dhe nostalgjia e tij për fshatin, nuk mund të luftohet «me sopatë» dhe procedime, por me një punë të shëndoshë politike dhe edukative dhe duke i krijuar kushte më të mira jetese se ato që kishte në fshat. Të tilla punë të pamatura nga organet ekonomike e gjyqësore janë bërë, por vihet pyetja: Po syri i Partisë ku ka qenë në këtë kohë? Në rast se sekretari i komitetit të Partisë në rreth, nuk do të drejtojë punën, por do të merret dhe me gjërat e vogla që nuk i përkasin, ai do të lërë të bëhen gabime të tilla. Këto gabime të rënda mund të jenë të rastit, po mund të jenë edhe si pasojë e punës së armikut, i cili na godit tamam atje ku na dhemb më shumë, prandaj komunistët nuk mund dhe nuk duhet të lejojnë që të kalojnë këto gjëra në këtë mënyrë. Njerëzit mund të bëjnë gabime, po këto duhet t'u falen atyre që i bëjnë padashur ose nga injoranca, kurse në rast se përsëriten, ato duhet të goditen rëndë. Njerëzit e Partisë dhe masat e popullit duhet kurdoherë të vigjilojnë dhe të luftojnë për mbrojtjen e vijës së Partisë, për mbrojtjen e atdheut dhe për interesat e popullit.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që ndodhet në Arhivin Qendror të Partisë, me disa shkurtime

L E N D A

PARATHENJE PËR VËLLIMIN 6

V—VII

1949

FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E MBYLLJES SË KURSIT TË SHTATË PËR OFICERË (7 janar 1949) ..	1—5
FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN AKADEMIKE ME RASTIN E 25-VJETORIT TË VDEKJES SË V. I. LENINIT (20 janar 1949)	6—8
FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E PARË TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE (15 shkurt 1949) ..	9—34
NGA FJALA E MBAJTUR NË FSHATIN BRATILË TË GRAMSHIT, PARA USHTARËVE DHE POPULLIT ME RASTIN E INAUGURIMIT TË PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E RRUGËS GRAMSH-LOZHAN (2 mars 1949)	35—37
LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PARTI (6 mars 1949)	38—51
LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË KOMBINATIT VAJGUROR KUÇOVË-PATOS NË LI-	

DHJE MË GJENDJEN E KRIJUAR NË ORGANIZATËN E PARTISË TË KOMBINATIT (12 mars 1949)	52—55
MBI DISA PROBLËME NË FSHAT — Letër e hapur dërguar rreshterit Safet (16 mars 1949)	56—82
NGA PËRSHËNDETJA DREJTUAR POPUJVE TË BASHKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI I MOSKËS ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NË BRSS (21 mars 1949)	83—84
PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE TË BASHKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI I MOSKËS ME RASTIN E LARGIMIT TË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NGA BRSS (11 prill 1949)	85—86
NGA FJALA PARA POPULLIT TË KRYEQYTETIT ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NGA VIZITA NË BRSS (11 prill 1949)	87—90
«MBI MASAT E MARRURA PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË KONGRËSIT I TË PKSH DHE DETYRAT QË SHTROHEN PARA PARTISË DHE POPULLIT» — Raport në Plenumin II të KQ të PPSH (28 prill 1949)	91—154
FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN VII TË LEGJISLATURËS SË PARË TË KUVENDIT POPULLOR ME RASTIN E PARAQITJES PËR APROVIM TË PROJEKTLIGJIT TË PLANIT DYVJEÇAR TË SHITËTIT PËR VITIN 1949—1950 (1 qershor 1949)	155—187
LETËRSIA JONË TË ECË NË RRUGËN E REALIZMIT SOCIALIST — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (7 qershor 1949)	188—194

MBI PUNËN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE DISA MASA PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 qershor 1949)	195—197
FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË ZONËS ELEKTORALE NR. 60 TË QYTETIT TË TIRANËS (14 qershor 1949)	198—200
KËSHILLA PËR SHKRIMTARËT E RINJ (23 qershor 1949)	207—211
TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT VASIL KOLAROV ME RASTIN E VDEKJES SË GJERGJ DIMITROVIT (3 korrik 1949)	212—213
MBI RËNDËSINË E DËRGIMIT TË BRIGADAVE KULTURALE NË FSHAT DHE MBI ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË KP TË RRETHEVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (14 korrik 1949)	214—216
LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË LIDHJE ME GABIMET E VËRTETUARA NË ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT TË LUSHNJËS (23 korrik 1949)	217—236
MBI DISA MASA QË DUHEN MARRË PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PRODHIMIT TË NAFTËS NË KUÇOVË E PATOS — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 korrik 1949)	237—241
NGA FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH DHE TË QEVERISË SË RPSH ME RASTIN E SHQYR-	

TIMIT TË REALIZIMIT TË PLANIT TË GJASHTË-MUJORIT TË PARË (2 gusht 1949)	242—251
NGA DISKUTIMI NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH DHE TË QEVERISË SË RPSH ME RASTIN E SHQYRTIMIT TË PROJEKTVENDIMIT PËR MBJELLJET E VJESHTËS (15 gusht 1949)	252—254
LETËR DËRGUAR OFICERËVE PENSIONISTË SHOKËVE RIZA KODHELI DHE AHMET STARAVECKA ME TË CILËN I FALENDERON PËR GATISHMËRINË E SHFAQUR PËR TË LUFTUAR NË MBROJTJE TË KUFIRIT (26 gusht 1949)	255—256
TELEGRAM URIMI DËRGUAR POPULLIT TË PESHKOPISE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË ÇLIRIMIT TË QYTETIT (31 gusht 1949)	257—258
FJALA E MBAJTUR PARA USHTARËVE TË PLAGOSUR NË PROVOKACIONET E MONARKO-FASHISTËVE GREKË KUNDËR RPSH (2 shtator 1949)	259—266
TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË HEKURUDHËS KASHAR-ZONA INDUSTRIALE (4 shtator 1949)	267—268
FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË QYTETIT DHE TË MALËSIVE TË SHKODRËS (15 shtator 1949)	269—299
FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E UNIFIKIMIT TË DY ORGANIZATAVE TË RINISË (16 shtator 1949)	300—312
NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË RRETHIT TË MIRDITËS DHE PUNËTORËVE TË	

MINIERËS SË RUBIKUT (18 shtator 1949)	313—320
NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË RRETHIT TË LEZHËS (18 shtator 1949)	321—329
NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT TË MILOTIT (18 shtator 1949)	330—333
NGA FJALA E MBAJTUR PARA POPULLIT NË URËN E ZEZË (18 shtator 1949)	334—337
TË SHTOJMË VIGJILENCËN REVOLUCIONARE PËR TË RUAJTUR FITORET E ARRITURA, TË VËMË TË GJITHA FORCAT PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT — Fjala e mbylljes në Plenumin III të zgjeruar të KQ të PPSH (13 tetor 1949)	338—374
TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT MAO CE DUN ME RASTIN E FORMIMIT TË RP TË KINËS (19 tetor 1949)	375—376
TELEGRAM URIMI DËRGUAR OTO GROTEVOLIT ME RASTIN E FORMIMIT TË RD GJERMANE (20 tetor 1949)	377—378
FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E DYTË TË SINDIKATAVE (23 tetor 1949)	379—398
RROFTË SA MALET PARTIA JONË E DASHUR (8 Nëntor 1949)	399—409
TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT ÇU EN LAI NË LIDHJE ME VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE DIPLOMATIKE MIDIS RPSH DHE RP TË KINËS (19 nëntor 1949)	410—411
URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË ÇLIRIMIT (29 Nëntor 1949)	412—414

TELEGRAM URIMI DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN E 70-VJETORIT TË DITËLINDJES (20 dhjetor 1949)	415—416
FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE ORGANIZUAR ME RASTIN E 70-VJETORIT TË DITËLINDJES SË J. V. STALINIT (20 dhjetor 1949)	417—457
NGA FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E BY-ROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH ME RASTIN E SHQYRTIMIT TË RAPORTIT MBI GJENDJEN E BUJQËSISË PARAQITUR NGA MINISTRIA E BUJQËSISË (23 dhjetor 1949)	458—465
PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË SITUATËS SË BRENDSHME TË VENDIT TONË — Fjala e mbyljes mbajtur në Plenumin IV të KQ të PPSH (28 dhjetor 1949)	466—487

Shtypur NISH Shtyp. «M. DURI», Stab. «8 NËNTORI» — Tiranë